



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Albpetrol sh.a
Patos

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË
PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË
ALBPETROL Sh.A PATOS

TIRANË 2023

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3 - 52
1	<i>Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit</i>	
2	<i>Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve</i>	
3	<i>Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit</i>	
II	HYRJA	52 – 56
	a. <i>Titulli.....</i>	
	b. <i>Marrësi.....</i>	
	c. <i>Objektivat dhe qëllimi.....</i>	
	d. <i>Identifikimi i çështjes.....</i>	
	e. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
	f. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.....</i>	
	g. <i>Kriteret e vlerësimit</i>	
	h. <i>Standardet e auditimit.....</i>	
	i. <i>Metodat e auditimi</i>	
	j. <i>Dokumenti i auditimit.....</i>	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	56 - 354
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	56 – 56
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejttimeve të auditimit.....	56 - 354
2.1	<i>Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, si dhe vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.....</i>	56 – 71
2.2	<i>Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe administrimi i marrëdhënieve të punës..</i>	71 – 87
2.3	<i>Auditim mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë, si dhe ndjekja e realizimit të këtyre treguesve.....</i>	87 – 122
2.4	<i>Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese. Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.....</i>	122 – 144
2.5	<i>Mbi zbatimin e ligjshmërisë për inventarizimin, për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, si dhe për dhënien dhe marrjen me qira të aseteve dhe zbatimi i kontratave.....</i>	144 – 149
2.6	<i>Mbi zbatimin e ligjshmërisë në veprimet e arkës dhe bankës, si dhe blerjet me vlera të vogla.....</i>	149 – 150
2.7	<i>Mbi zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimeve, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, si dhe efektiviteti i investimeve, për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022..</i>	150 – 233
2.8	<i>Mbi zbatimin e procedurave të ankandeve për shitjen e naftës bruto, etj.....</i>	233 – 252
2.9	<i>Mbi zbatimin e detyrimeve të marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura me kompanitë e huaja që operojnë në sektorët e kërkimit dhe nxjerrjes së hidrokarbureve.....</i>	252 – 293
2.10	<i>Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të auditit të brendshëm..</i>	293 – 300
2.11	<i>Zbatimi i rekomandimeve nga auditimi i fundit.....</i>	300 – 350
2.12	<i>Të ndryshme (ankesa).....</i>	350 - 354
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI.....	354 – 415
V.	ANEKSE.....	415 - 434

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1202/1, datë 16.01.2023 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 17.01.2023 deri në datën 20/04/2023, në Institucionin Albpetrol sh.a Patos, u krye auditimi i “Përputhshmërisë”. Auditimi mbuloi periudhën prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2022 dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit, sipas pikave të programit të auditimit, si dhe u shqyrtuan disa ankesa të ardhura në KLSH.

Auditimi u krye mbi bazën e riskut. Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt aktet e konstatimit dhe pas kryerjes së takimit përmbyllës mes palëve nga subjekti u paraqitën kundërshtitë për aktet e mbajtura. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe Projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë të materialit në Projektraport dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjithashtu në ambientet e KLSH është realizuar takimi përmbyllës datë 18.07.2023, midis përfaqësuesve të Albpetrol sh.a dhe KLSH, për të cilin është mbajtur protokollu përkatës.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
I	Nga auditimi ka rezultuar se nga pronat të kaluara me VKM nr. 219/2004, datë 16.04.2004 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në administrim Albpetrol sh.a Patos.”, VKM nr.784/2006, datë 15.09.2006 “Për Ristrukturimin e Shoqërive Tregtare me Kapital Shtetëror Albpetrol sh.a Patos, “S...M” sh.a dhe “T...A” sh.p.k”, VKM nr. 275/2010, datë 26.04.2010 “Për përthithjen nga Albpetrol sh.a Patos të “U...E” dhe “U...S” shpk , Urdhri nr. 1480/2016, datë 29.02.2016 për zbatimin e Vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.2037/2017, datë 04.07.2017 të “Për kalimin e pronësisë së sendit të pranuar si blerje e kreditorit” të Shoqërisë Përmbartimore private “T...P” shpk, shoqërisë Albpetrol sh.a Patos kanë kaluar në pronësi Troje për 10 962 126 m ² (Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 2 029 038 m ² , Puse me sipërfaqe për 4 198 588 m ² dhe Rrugë për 4 198 588 m ²) të pasqyruara në kontabilitet për vlerën 9, 533,519 mijë lekë. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka certifikuar 3 950 459 m ² (Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 1 207 108 m ² , Puse me sipërfaqe për 2 448 000 m ² dhe	I lartë	122-144	Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për evidentimin e gjendjes fizike të pronave të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të kaluara me VKM dhe regjistrim në ASHK Drejtoria Fier. Gjithashtu, Drejtoria e Financës të përlloraritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie. Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në bashkëpunim me Drejtorinë e Auditit të Brendshëm të marrë mision auditimi të veçantë në të gjitha Asetet në përdorim/pronësi të kaluara

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Rrugë për 295 351 m²) ose 36% e totalit dhe nuk ka certifikatë 6 958 117 m² (Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 821 930 m², Puse me sipërfaqe për 2 232 950 m² dhe Rrugë për 3 903 237 m²) ose 64% e totalit ose nga 6497 prona janë certifikuar 3799 prona ose 58% e totalit, janë në proces për regjistrim 870 prona. Rezultojnë që ka 28 prona me mbivendosje dhe 440 prona të zaptuara nga të tretë t cilat shfrytëzohen pa asnjë detyrim financiar ndajë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, duke krijuar të ardhura të munguara.</p> <p>Sa më lart kontabilizimi i tyre nuk është mbështetur në dokumente hipotekore në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.</p>			<p>me VKM të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për evidentimi e tyre mbi gjendjen fizike, si dhe shfrytëzimin e tyre të tretë.</p> <p>Për rastet e konstatuara për shfrytëzim nga të tretë të kërkohet lidhja e kontratës së qirave për rastet e objekteve me certifikatë pronësie ose bllokimi i pronës dhe marrja në përdorim nga vetë shoqëria Albpetrol sh.a.</p>
2	<p>Nga auditimi u konstatua se shoqëria në regjistrat e saj ka materiale të cilat janë stok ose me qarkullim të ngadalshëm për shkak të ndryshimit të teknologjisë apo kalimit të afatit të skadencës në vlerën 1,306,029 mijë lekë për të cilat shoqëria ka njohur zhvlerësime vetëm për vlerën 137,487 mijë lekë në periudha të mëparshme, pra sipas SNK 2 “Inventarët”, duhet të njihen dhe të pasqyrohen në kontabilitet për vlerën më të vogël.</p> <p>Nga drejtimi i shoqërisë nuk janë kryer analiza për periudhat kur janë bërë hyrje në magazinë si dhe përqindjet e shfrytëzimit të tyre, si dhe pasojat e mos mbajtjes së të dhënave të kontabilitetit me programe kompjuterike, nuk mundësojnë vlerësime të detajuara për rritjen e mallrave stok. Rritja e vlerave të mallrave stok dhe e mallrave me qarkullim të ngadalshëm ka ardhur si pasojë e përlllogaritjeve jo me saktësi e përgjegjshmëri të sasive të artikujve të kërkuar, duke krijuar material stok, që përveç se ka alokuar fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.</p> <p>Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, pika 103, 107, 108 dhe 109.</p>	I lartë	122-144	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse Qendrave kërkues të mallit/aktivit, të llogarisin me kujdes nevoja për blerje të materialeve teknologjike e tjera, duke evidentuar më parë gjendjen ekzistuese në magazinë dhe nevojat reale mbi këtë gjendje. Kërkesat për mall të shoqërohen me argumentim dhe relacion përkatës, duke përcaktuar saktë nevojën e përdorimit të tyre përdorimin e mallit dhe jo lënien në magazinë dhe daljen jashtë funksioneve.</p>
3	<p>Nga auditimi u konstatua se me datë 31.12.2020 debitorët janë deklaruar në vlerën 18,671,912 mijë lekë dhe me datë 31.12.2021 janë deklaruar për vlerën 18,887,733 mijë lekë, (“A...O” sh.a në vlerën 11,464,502 mijë lekë, Subjekte Privatë në vlerën 6,835,836 mijë lekë, Subjekte Shtetërore në vlerën 331,858 lekë dhe O...E në vlerën 255,535 mijë lekë), me rritje gjatë vitit 2021, në vlerën 215,821 mijë lekë</p>	I lartë	122-144	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit dhe Drejtorisë së Financës, të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>debitorë privat, ku sipas moshës së krijimit debitorë mbi 5 vite janë në vlerën 16,086,667 mijë lekë ose 85 % e debitorëve në total.</p> <p>Për detyrimin që “A...O” sh.a, ka ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos e cila është në proces gjyqësor, shoqëria Albpetrol sh.a Patos, ka detyrime ndaj shoqërisë “A...O” sh.a, për shumën 6,312,329 mijë lekë, konstatohet se për diferencën 5,152,172 mijë lekë (11,464,502 -6,312,329), janë krijuar provigjone në vitin 2021.</p> <p>Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e “Llogarive të arkëtueshme tregtare” në vlerën 13,174,589 mijë lekë. Në pasqyrat financiare janë paraqitur të drejta që i përkasin periudhave të mëparshme duke iu kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumente ligjore, subjekte që kanë falimentuar etj. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, pika 3, germa “g”.</p>			<p>debitorëve në vlerën 18,887,733 mijë lekë, si dhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.</p>
4	<p>Nga auditimi ka rezultuar se shoqëria Albpetrol sh.a Patos për muajt Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2022, ka blerë energji elektrike me TVSH në vlerën 863,819,525 lekë, me TVSh të zbritshëm në shumën 143,969,921 lekë, nga ku rezulton se kjo sasi e energjisë elektrike nuk është faturuar për konsumatorët fundor shoqëritë koncesionare, private dhe qendrat e vetë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.</p> <p>Në deklaratimet mujore të TVSH, rezulton se kjo sasi është deklaruar si TVSh e zbritshëm, gjë e cila çon që situata e TVSH në shitje në muajt përkatës të mos jetë reale për pasojë vlera e TVSH së pagueshme nuk është e saktë, pasi nga shoqëria nuk është deklaruar TVSh e shitje së energjisë së këtyre majave në adresë të koncesionarëve.</p> <p>Nga të dhënat e FDP-ve për muajt Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2022, shitjet e tatueshme janë deklaruar në vlerën 3,625,810,585 lekë me TVSH të llogaritur në vlerën 681,690,817 lekë, kur në fakt shitje të tatueshme duhej të deklaroheshin në vlerën 4,489,630,110 lekë, me TVSH të llogaritur në vlerën 825,660,768 lekë, pra nuk janë deklaruar të ardhura nga shitje të energjisë elektrike, minimalisht llogaritur sipas çmimit të blerjes në vlerën 863,819,525 lekë me TVSH, me TVSH të llogaritur në vlerën 143,969,921 lekë, veprime të cilat çojnë në deformim të situatës për TVSH e zbritshëm dhe TVSH së pagueshme.</p> <p>Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, neni 97 “Lëshimi i faturave”, pika 1. Personi i tatueshëm duhet të sigurohet për lëshimin e faturës nga ai vetë ose nga blerësi i tij ose në emrin e tij dhe për llogari të tij nga të tretët, në rastet e</p>	I lartë	122-144	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masat për faturimin e energjisë së blerë dhe të përdorur nga konsumatorët fundor për të shmangur penalitete që lindin nga mos deklarimi i shitjeve nga organet fiskale, të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	mëposhtme, germa “a” për çdo furnizim malli ose shërbimi që kryen kundrejt një personi tjetër të tatueshëm ose një personi juridik të patatueshëm.			
5	<p>-Për vitin 2022 Albpetrol sh.a ka arritur një rezultat financiar bruto rreth 412.2 milion lekë. Ndikim në përmirësimin e situatës kanë patur: rritja e çmimit të naftës Brut nga 37,169 lekë/ton në 51,893 lekë/ton, pra me një rritje prej 139,6%.</p> <p>-Për vitin 2022 është realizuar një volum shitje prej 95,883 ton, kundrejt 108,736 ton të programuar ose 88.2%</p> <p>-Nga aktiviteti i shoqërisë prodhimi i naftës është realizuar 70,570.5 ton kundrejt 75,920 ton të programuar ose 93%, me mosrealizim prej 5,350 ton naftë. Mosrealizimi vjetor i prodhimit të naftës nga shoqëria, vendburimet në administrimin e saj ka ardhur kryesisht për pasojë të 6 mujorit të parë, me një deficit ndaj programit -6,577 ton naftë dhe një bazë ditore prej 171.7 ton/ditë kundrejt 208 ton/ditë të programuar.</p> <p>-Detyrimet e mbetura pa shlyera deri më 31 Dhjetor 2022 ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a nga kompanitë konçesionare për naftën bruto rezultojnë 134,401 ton naftë duke u rritur me rreth 17,557 ton krahasuar me fundin e vitit 2021.</p> <p>-Gazi i prodhuar nga vet Albpetrol është gaz shoqëruës dhe për vitin 2022 është realizuar 110 mijë N/m3 nga 270 mijë N/m3 programuar ose 40.8 %.</p> <p>-Investimet për vitin 2022 janë realizuar në vlerën 243,602 mijë lekë nga 836,126 mijë lekë të programuar ose rreth 29.1 %.</p> <p>-Janë realizuar të ardhura rreth 6.59 miliardë lekë dhe janë kryer shpenzime rreth 7.6 miliardë lekë. Duke filluar nga muaji Shkurt 2022, në evidencën e bilancit të grumbullimit dhe shpërndarjes të naftës për kompaninë, nuk janë përpunuar të dhënat për vitin 2022, referuar faktit që bilanci i dërguar nga Qendra e Administrimit Shitjeve të Naftës dhe Gazit ka patur problematika të cilat janë bërë prezente zyrtarisht nga Drejtoria e Programimit, pasi nevojitet vendimmarrje e shoqërisë.</p> <p>Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit sipas pasqyrës PASH të bilancit kontabël të shoqërisë janë realizuar 6,587,574 mijë lekë.</p> <p>Krahasuar me ato të programuara 5,851,206 mijë lekë janë realizuar 112.6 % ose me tejkalim prej 736,367 mijë lekësh, kryesisht nga tejkalimi i të ardhurave nga shitja e naftës.</p> <p>Për vitin 2022 në Regjistrin e prokurimeve publike janë parashikuar për tu prokuruar 167 procedura, detajuar për Investime 78 procedura, Materiale 48 procedura dhe Shërbime 41 procedura.</p> <p>Nga monitorimi i elementeve të Regjistrit të Prokurimeve për vitin 2022, rezulton se nga 167</p>	I lartë	71-87	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat e tjera të shoqërisë, të marrë masa konkrete për kryerjen e investimeve në sektorët strategjik të shoqërisë me qëllim maksimizimin e prodhimit të naftës si burimi i saj kryesor i të ardhurave dhe uljen e kostove për nxjerrjen e saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e institucionit të bëjnë dhe një analizë të thelluar për arsyet e mos realizimit të zërave kryesor të programuara në fillim viti.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>elementë të parashikuar në regjistër 54 elementë ose 33 % e totalit kanë vijuar me procedurat, ndërsa 113 elemente ose 67 % e totalit janë me statusin të pazhvilluar (ose anuluar).</p> <p>Nga procedurat e parashikuara për tu prokuruar në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2022, është arritur të realizohen procedura me kontratë gjithsej 54 procedura me vlerë totale të kontratave 564,227,021 lekë.</p> <p>-Gazi i prodhuar nga vet Albpetrol është gaz shoqëruës dhe për vitin 2022 është realizuar 110 mijë N/m3 nga 270 mijë N/m3 programuar ose 40.8 %.</p> <p>10) Detyrimet e kontraktorëve për prodhimin e gazit ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a rezultojnë në sasinë 24,426,313 Nm³.</p> <p>Sa më sipër bie në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”.</p>			
6	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, rezulton se:</p> <p>Nga 74 procedura me fond limit 1,170,945 mijë lekë, janë zhvilluara procedura prokurimi me 1 OE, gjithsej 32 procedura me fond limit 449,105 mijë lekë ose 38% e fondit të prokuruar, nga e cila: të vitit 2021 janë 17 procedura me fond limit 365,722 mijë lekë ose 50.9 % e fondit dhe të vitit 2022 janë 15 procedura me fond limit 83,383 mijë lekë ose 18.3% e fondit të prokuruar.</p> <p>Kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me llojin e procedurës dhe të mirë argumentuara, gjë e cila ka çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, veprime këtë që çojnë në përdorimin e fondeve pa efektivitet si rezultat u mungesë së konkurrencës në garë.</p> <p>Për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022 në 8 procedura me fond limit 254,111 mijë lekë u konstatua vendosja e kriterëve të paargumentuara jo në përputhje me procedurat e zhvilluara, të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE ose në skualifikimin e OE me oferta të leverdishme, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumnin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumnin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit, etj. - Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim, është kërkesë e tejkaluar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkaluar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të 	I lartë	150-233	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a në bashkëpunime me Drejtorinë e Prokurimit Publik, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumnet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.</p> <p>Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kriteret të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>periudhës së kërkuar. Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021.</p> <p>- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, konstatohet se nga AK në të gjitha rastet është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për periudha të ndryshme.</p> <p>- Është kërkuar certifikatë ISO 3834-2:2005 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, kërkesë e gabuar pasi shërben për prodhimin me saldim.</p> <p>Veprime këto në shkëlqje të neneve 1, 2, pika 1 e nenit 21, neni 78 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve dhe 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.</p>			
7	<p>Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë Nr.6245, datë 01.09.2021 i lidhur me subjektin “K...I” sh.p.k. u konstatua se në dosje nuk ka procesverbal të dorëzimit të objektit të dhënë me qira, si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës, si dhe për arkëtimin e të ardhurave, gjithashtu në dosje ndodhet dhe një procesverbal ku është konstatuar që subjekti përdor 53.184 m² sipërfaqe ndërtimi më shumë se sa kontrata, dhe 4610.816 m² sipërfaqe funksionale më shumë se sa kontrata dhe duhet të bëhet arkëtimi i detyrimit mujor 142,186 lekë.</p> <p>Nga auditimi i kontratës së qirasë Nr.9030, datë 12.11.2021 i lidhur me subjektin “B...M” shpk, dhe kontratës së qirasë Nr.9030, datë 12.11.2021 i lidhur me subjektin “G...D” sh.p.k. me objekt kontrate “ish-Remonti Kapital në ish-QPN Marinëz” në administrim nga QAKP Patos, janë dy kontrata qiraje me të njëjtin numër protokoll, por me dy subjekte të ndryshme, në dosje nuk ka procesverbal të dorëzimit të objektit të dhënë me qira, si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës, si dhe për arkëtimin e të ardhurave, gjithashtu në dosje ndodhet dhe një procesverbal nga 4 punonjës të “Albpetrol” sh.a. ku është konstatuar që subjekti “B...M” sh.p.k. përdor 2466.89 m² sipërfaqe funksionale më shumë se sa kontrata dhe duhet arkëtuar detyrimi mujor 69,073 lekë nga subjekti, si dhe të përcaktohet periudha që është përdorur objekti padrejtësisht nga subjekti. Për të njëjtin objekt janë dy kontrata qiraje me të njëjtin numër protokoll, por me dy subjekte të ndryshme, nuk ka proces verbal të dorëzimit të objektit si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1 dhe pikën 7 të nenit 5 të Kontratës së Qirasë.</p>	I lartë	122-144	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës të marrë masa që në të ardhmen për secilën kontratë qiraje të zbatohen të gjitha etapat e përshkruara shumë qartë në kuadrin ligjor, për lidhjen dhe zbatimin e tyre.</p> <p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës dhe Drejtorinë e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik, të ndërmarrë një plan konkret masash për rritjen e efikasitetit për lëshimin e objekteve me qira, veçanërisht në fushën e marketingut të shoqërisë.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Kontratë qiraje me nr.671 prot , datë 24.01.2022 ndërmjet qiradhënësit “Albpetrol “ sh.a dhe qiramarrësit Z. A. M. , për dhënien me qira të objektit “<i>Ish guzhina Vllahinë</i>” me sipërfaqe 48 m², në administrim të Qendrës Prodhimit të Naftës Gorisht. Çmimi i kontratës nr.671 prot , datë 24.01.2022 është llogaritur në përputhje me pika 5 të kreut III te VKM nr.54, datë 05/02/2014 “ Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies më qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar (48m² x 75 lekë/m²= 3600 lekë /muaj pa t.v.sh). Në shumën prej 3600 lekë/muaj nuk është e përfshirë konsumi i energjisë elektrike dhe ujit nga qiramarrësi. Subjekti A. M. në rolin e qiramarrësit objektin me sipërfaqe 48 m² do e përdor për ushtrim aktiviteti privat (Bar – kafe). Në nenin 2 të kontratës nr.671 prot, datë 24.01.2022 nuk është përcaktuar kohëzgjatja e kontratës të nënshkruar nga palët “Albpetrol” sh.a dhe subjektit A. M. , në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05/02/2014 germa “a”, pika 5, kreu I në të cilën citohet “<i>dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m² të jepen me afat deri në 1 vit</i>”.</p> <p>Kontratë qiraje me nr.1132 prot, datë 04.02.2022 ndërmjet qiradhënësit “Albpetrol” sh.a dhe qiramarrësit dhe shoqërisë “A...6” shpk, për dhënien me qira të makinerisë “Vinç Cjap 5 Ton”. Çmimi i kontratës nr.1132 prot, datë 04.02.2022 është llogaritur në përputhje me kreun III, pika 5 e VKM nr.54, datë 05/02/2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies më qira , enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Makinaria “Vinç Cjap 5 Ton” është dhënë me qira shoqërisë “A...6” shpk, mbështetur në kreu I, pika 5, germa b të VKM nr.54 , datë 05/02/2014 ku citohet: “<i>makineritë dhe pajisjet e shkëputura jepen me qira për një afat 1 vjeçar</i>”. Kontrata nr.1132 prot, datë 04.02.2022 është nënshkruar më 04.02.2022 , por në nenin 2 të saj nuk është përcaktuar afati i skadimit të saj. Makinaria “Vinç Cjap 5 Ton” është në administrim të Q.F.T Patos dhe nuk është e nevojshme për ushtrimin e aktivitetin e kësaj qendre, per pasojë është dhënë në gëzim të përkohshëm shoqërisë “A...6” shpk me çmimin e përcaktuar në nenin 3 të kontratës nr.1773 prot , datë 24.02.2022. Për makineritë dhe pajisjet vlera e detyrimit mujor të qirasë përcaktohet sa 1/10 e vlerës aktuale minimale të llogaritur si diferencë e vlerës fillestare të kontabilizuar minus amortizimin në vite, mbështetur në Vendimin nr. 401, datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave (pjesa për investime) shumëzuar me indeksin e çmimeve të muajit përkatës publikuar nga INSTAT-i. Në pikën 2 të nenit 3 të kontratës cilësohet se detyrimi mujor i qiramarrësit “A...6 “ sh.p.k është në vlerën 2000 lekë</p>			

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
8	<p>Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes Pronave, në bashkëpunim me Qendrat e Shoqërisë dhe me ZVRPP-të e rretheve, ka të listuar dhe të përditësuara të gjitha pronat e zëna nga posedues të paligjshëm si dhe pronat me mbivendosje. Këto prona janë zënë gjatë një periudhe të gjatë përpara periudhës së auditimit dhe megjithëse dhe nga grupet e mëparshme të KLSH-së është rekomanduar që të ndërmerren hapa ligjorë për këtë problematik, nga ana e Albpetrol sh.a ende nuk është marrë një veprim i tillë.</p> <p>Administratori i shoqërisë i kërkon të gjitha Qendrave që në rast të konstatimit të poseduesve të paligjshëm në asetet e shoqërisë duhet ti kallëzojnë ato pranë organeve ligj zbatuese. Ky urdhër ka mbetur thjesht si një procedurë burokratike pasi ende nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret që këto objekte apo pasuri truall të zaptuara, apo sipërfaqe të Shoqërisë me mbivendosje në ZVRPP të rikthehen e gëzohen në përdorim e pronësi të Shoqërisë.</p> <p>Shoqëria Albpetrol Sh.a ka të dokumentuara 3,500 puse nga të cilat ka 160 puse me vërtetime hipotekore dhe 3,340 puse me certifikate pronësie që do të thotë se ende 4,5% e kësaj lloji prone nuk zotërohet e regjistruar me certifikate pronësie.</p> <p>Objektet e dokumentuara në ZRPP vendore gjithsej 454 objekte, nga të cilat 25 janë me vërtetim hipotekor ndërsa 429 janë të dokumentuara me certifikate pronësie.</p> <p>Pra, janë regjistruar gjithsej 3,954 pasuri, puse dhe objekte të shoqërisë nga të cilat 185 pasuri janë me vërtetim hipotekor dhe 3,769 pasuri të shoqërisë janë me certifikate pronësie të rregullta. Pronat e regjistruara me vërtetim hipotekor zënë rreth 4,7% të pronave të regjistruara me certifikate pronësie.</p> <p>Konstatohet se janë të pa regjistruara në ZVRPP vendore përkatëse 1,776 puse dhe 21 objekte të Shoqërisë ose në total 1,797 pasuri të shoqërisë janë të paregjistruara.</p> <p>Nga auditimi rezulton se, pasuritë e patundshme të shoqërisë janë gjithsej 5,751 pasuri. Numri i pronave të paregjistruara zë një peshë prej 31,2% por duke llogaritur edhe 4,7% të pronave që janë regjistruar me vërtetim hipotekor, pasuritë pa dokumentin ligjor të vërtetimit të pronësisë, certifikatën e pronësisë, shkon në 39% të numrit total të pronave që tregojnë për një punë të dobët të stafit drejtues të Shoqërisë dhe Ministrisë së linjës.</p>	I lartë	122-144	<p>Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës të ndërmarr hapa konkret duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në bashkëpunim me organet kompetente ligj zbatuese për marrjen në dorëzim të pronave të ligjshme të shoqërisë.</p> <p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë hapa konkret për regjistrimin e aseteve të pa regjistruara. Regjistrimi dhe certifikimi i tyre sa më shpejtë ndikon në mënyrë direkte në rritjen e vlerës së shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.</p>
9	<p>Shoqëria Albpetrol sh.a, bazuar në Aktin Normativ Nr. 2, datë 16.06.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28/07/1993 “Për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim)”, të ndryshuar, mund të tregtojë produktet hidrokarbure për tregun vendas, apo për eksport sipas çmimit të bursës ndërkombëtare për hidrokarburet, ku Ministria</p>	I lartë	233-252	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që në të ardhmen procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandeve të shitjes së naftës, të kryhet duke bërë vlerësime për vlerën aktuale</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>përgjegjëse që drejton veprimtarinë, miraton procedurat e tregimit të hidrokarbureve, të parashikuara në Urdhrin nr. 83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve Hidrokarbure” të ndryshuar.</p> <p>Shoqëria Albpetrol, naftën bruto të prodhuar vetë, dhe sasinë e naftës bruto të përfituar nga kushtet e zbatimit të marrëveshjes me kontraktorët e ndryshëm, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës dhe gazit, e shet nëpërmjet ankandeve publike për tregun e brendshëm ose për eksport. Në lidhje me realizimin e procedurave të shitjes së naftës me ankand, grupi auditues kreu verifikimet mbi zbatimin e bazës ligjore në fuqi dhe përgjegjësive të parashikuara në aktet rregullatorë për strukturat përgjegjëse në shoqërinë Albpetrol sh.a, për të evidentuar problematikat kryesore si mos saktësime në Urdhrin nr. 83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve Hidrokarbure” të ndryshuar, si dhe zbatimin e tij.</p> <p>-Në udhëzimin e mësipërm në lidhje me përcaktimin e çmimit të shitjes janë pikat 6 e 7.</p> <p>Nga verifikimet e bëra për koeficientin e konvertimit të çmimit Brent sipas cilësisë së produktit të prodhuar u konstatua se grupi i ekspertëve të propozuar nga Albpetrol sh.a Patos, përbëhet nga katër anëtar të shoqërisë si dhe një anëtar i MIE. Për sa më sipër grupi i eksperteve, për përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar të shitjes së naftës bruto bazohet në studimin e faktorëve që ndikojnë në vendosjen e korrespondencës së cilësisë së naftës së prodhuar nga secili vendburim, duke e krahasuar me karakteristikat e naftës bruto me emrin “Brent”.</p> <p>Nafta “Brent” është nafta që grumbullohet nga 15 vendburime të ndryshme në Detin e Veriut në portin Sullom Voe, me karakteristikat, densiteti 37.5 gradë API, përmbajtja e sqfurit 0.4% dhe aciditeti 0.07 TAN mg KOH/g.</p> <p>-Grupi i auditimit u kërkoi specialistëve të Albpetrol sh.a Patos se në cilën metodologji, referencë, ose manuale të tregjeve botërore që kuotojnë çmimin Brent, bazohej formula e mësipërme e cila përcakton se luhatjet nga norma të disa komponentëve kanë efekt në uljen e çmimit.</p> <p>Dokumenti kryesor dhe i vetëm për përcaktimin e çmimit është një raport që ka bërë Banka Botërore në tetor të vitit 2004, për parashikimet e çmimeve të naftës bruto nga qeveritë e vendeve në zhvillim, të cilët nuk përfshijnë në komponentët e cilësisë dhe faktorin e aciditetit.</p> <p>Pa pretenduar të vlerësojmë përlllogaritjet specifike të kryera nga specialistët, konstatojmë se veprohet me një model që nuk i korrespondon tregut të naftës bruto, por është një relacion i Bankës Botërore në vitin 2004, për efekte parashikimi. Ky model nuk është testuar me</p>			<p>monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare.</p> <p>Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë të botohen në gazetata e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>tregun, nuk është i studiuar për karakteristikat e naftës që nxirret në vendburimet tona si dhe nuk është aprovuar nga organet përkatëse. Nga verifikimet e kryera në shitjet që kanë kryer shoqëritë koncesionare, u konstatua se çmimet e shitjes që ka në tregun e jashtëm ose të brendshëm janë rreth 7-15 % më të larta.</p> <p>-Grupi i auditimit konstatoi se në të gjitha procedurat e ankandit ftesat për ofertë, dokumentet me të dhënat dhe kriteret e kualifikimit janë dërguar për botim vetëm në gazetatat kombëtare si dhe në gazetën e botuar në gjuhën angleze “Albanian Daily News”, dhe jo në gazeta të huaja me shpërndarje në Evropë. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën b, të kreut III, të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar dhe me nenin 16 të Ligjit Nr. 9874, datë 14/02/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 10 346, datë 04.11.2010, dhe Ligjin Nr. 12/2017, ku citohet: <i>Metodat e përlllogaritjes së vlerës fillestare në ankandin publik. Përcaktimi i vlerës fillestare të një objekti ankandi bazohet në Vlerën Aktuale Monetare (VAM), çmimet e tregut, të dhënat e INSTAT-it apo të organeve të tjera shtetërore. Në vlerën fillestare përfsihien edhe detyrimet fiskale që lidhen me natyrën e objektit. Mënyra e përlllogaritjes së vlerës fillestare do të përcaktohet në rregullat e ankandit publik.</i></p> <p>Sa më sipër është në kundërshtim me pikën b, të kreut III, të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar.</p> <p>Në kontratën për sasinë 40,000 ton për shitje brenda vendit e fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria “R...E” sh.a., Elbasan, me NUIS ...dhe “A...L” sh.a., Tiranë me NUIS ..., u konstatua diferenca nga çmimet e shitjes së shoqërive koncesionare me çmimet e llogaritura nga Albpetrol në vlerën 54,900 mijë lekë.</p> <p>Më datë 07.04.2021 është bërë njoftim ankandi për shitje naftë bruto me sasi 100,000 ton. Më datë 19.04.2021 është shpallur fitues Operatori ekonomik “E...A” sh.a. me NUIS Në zbatimin e kontratës prej 100,000 ton nga krahasimi i çmimeve të shitjes me ato të shoqërive koncesionare u konstatuan diferenca në vlerën 235,500 mijë lekë.</p> <p>Më datë 29.04.2022 është bërë njoftim ankandi për shitje naftë bruto me sasi 120,000 ton. Më datë 03.06.2022 është lidhur kontrata me afat 12 muaj, me Kontraktori, BOE “E...A” sha. dhe “R...E sha. Në zbatimin e kontratës prej 120,000 ton nga krahasimi i çmimeve të shitjes me ato të B...M u konstatuan diferenca në vlerën 536,300 mijë lekë.</p> <p>Modelet e llogaritjeve mund të përdoren për orientime ose për parashikime por është tregues që vendos se sa është çmimi i produktit (nafta bruto), dhe në rastin kur ky produkt naftë bruto nga shoqëritë koncesionare që</p>			

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	menaxhojnë burimet hidrokarbure në Shqipëri e shesin me çmim më të lartë është tregues se modeli ekzistues nuk është i saktë dhe i krijon humbje financiare shoqërisë për një vlerë prej 826,750 mijë lekë .			
10	<p>Në procesin e shqyrtimit të kontratave të ankandeve u konstatuan përlllogaritje të penalteteve për vonesa jo në përputhje me dokumentet e ankandit.</p> <p>-Në kontratën e lidhur nga Albpetrol sh.a., me shoqërinë E...L sh.a., me nr. 2815 Prot., datë 04.05.2021, për shitjen e sasisë 100,000 ton u konstatua se:</p> <p>-Në Dokumentet Standarde të Ankandit Publik të përdorura në procedurën e ankandit për shitje, në pjesën kushtet e përgjithshme, neni nr. 1.1, "Qëllimi", citohet: Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen/shitjen e Mallrave/objekteve/ me anë të ankandit të hapur. Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore: b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.</p> <p>Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet, 25.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së ofertuesit fitues. Në kontratën e lidhur mes palëve neni 5.9, përcakton :” Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë apo në rast të mos tërheqjes së sasisë së mallit sipas mënyrës së përcaktuar (siç përcaktohet në aneksin nr. 1, bashkëlidhur), blerësi është dakord me penaltitetet ditore që do të llogariten sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”. Kontrata është lidhur bazuar në Urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, i ndryshuar. Kontrata mes palëve nuk ka pasqyruar kushtet e përgjithshme të procedurës së ankandit. Këto mospërputhje kanë pasur efektet në përlllogaritjen e penalteteve ditore për vonesat në tërheqjen e sasive të mallit. Albpetrol sha ka përlllogaritur 25 ditë vonesë për vlerën 403,212 lekë penaltite, kur sipas nenit 24 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet</p>	I lartë	233-252	Këshilli Mbikëqyrësi i shoqërisë Albpetrol sh.a, Patos, të analizojë situatën në lidhje me të ardhurat e munguara të shoqërisë në vlerat 80,918,801 lekë dhe 57,025,938 lekë, si dhe të marrë masa që në të ardhmen të llogarisë penaltitetet për vonesa në tërheqjen e produktit naftë bruto nga OE fitues sipas dokumenteve standarde të procedurës së ankandit.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës, ku vlera totale e kontratës është 4,594,332,577 lekë, pra 25 % është 1,148,583,144 lekë dhe 2/1000 është 2,297,166 lekë është penalteti ditor, për 25 ditë në total prej 57,025,938 lekë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë Albpetrol sha.</p> <p>-Në kontratën e lidhur nga Albpetrol sh.a., me BOE shoqërinë E...L sh.a., dhe "R...E" sh.a., me nr. 3493/15 Prot., datë 03.06.2022, për shitjen e sasisë 120,000 ton u konstatua se: -Në Dokumentet Standarde të Ankandit Publik të përdorura në procedurën e ankandit për shitje, në pjesën kushtet e përgjithshme, neni nr. 1.1, "Qëllimi", citohet: Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen/shitjen e Mallrave/objekteve/ me anë të ankandit të hapur. Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore: b) <i>Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.</i> Neni 25: <i>Negociatat dhe Amendamentet, 25.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së ofertuesit fitues.</i> Në kontratën e lidhur mes palëve neni 5.9, përcakton: " Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë apo në rast të mos tërheqjes së sasisë së mallit sipas mënyrës së përcaktuar (siç përcaktohet në aneksin nr.1, bashkëlidhur), blerësi është dakord me penaltetet ditore që do të llogariten sipas Ligjit nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare". Kontrata është lidhur bazuar në Urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure", i ndryshuar.</p> <p>Kontrata mes palëve nuk ka pasqyruar kushtet e përgjithshme të procedurës së ankandit.</p> <p>Këto mospërputhje kanë pasur efektet në përlllogaritjen e penalteteve ditore për vonesat në tërheqjen e sasive të mallit. Albpetrol ka përlllogaritur vonesa në vlerën 66,211 lekë penaltete, kur sipas nenit 24, Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore: Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës, ku vlera totale e kontratës është 4,769,065,763 lekë, pra 25 % është 1,192,266,441 lekë dhe 2/1000 është 2,384,533 lekë</p>			

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>është penaliteti ditor, për shoqërinë E...L sh.a., janë llogaritur 66,211 lekë, kur penalitetet janë 26,229,863 lekë dhe për shoqërinë “R...E” sh.a., janë llogaritur 89,110 lekë, kur penalitetet janë 54,844,259 lekë.</p> <p>Vlera 80,918,801 lekë e pallogaritur si penalitet për vonesat në tërheqjen e sasive të produktit naftë bruto përbën dëm ekonomik për shoqërinë Albpetrol sha.</p> <p>Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin Nr. 9874, datë 14/02/2008 “Për ankandin publik” i ndryshuar me Ligjin Nr. 10 346, datë 04.11.2010, dhe Ligjin Nr. 12/2017, Kreu VI, zbatimimi i kontratës, Neni 40 ku citohet: <i>“Kushtet për zbatimin e kontratës 1. Autoriteti shitës mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e ankandit ose në dokumentet e ankandit. 2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminues dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Neni 41 Rregullat që zbatohen për kontratën 24 1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e ankandit dhe në ofertën fituese.”</i></p> <p>Vlerat 80,918,801 lekë dhe 57,025,938 lekë të pallogaritura si penalitet për vonesat në tërheqjen e sasive të produktit naftë bruto përbëjnë të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.</p>			
II	<p>Në auditimin e lëvizjeve të produktit naftë bruto nga qendrat e prodhimit në qendrën e shitjeve u konstatua se produkti naftë në shumë raste dorëzohet jashtë standardit teknologjik S SH 51:1986 (Naftë bruto – Karakteristikat). Sipas standardit sasia e ujit nuk duhet të tejkalojë në përqindje për sektorët Ballsh 2%, Visokë 3%, Kasnicë 5%, Marinëz 2%, Marinëz sektorët 5,6,7 3%, Gorisht Amenicë 2% dhe Kuçovë 3%. Në fletë hyrjet e Qendrës së Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit, QASHNG, u konstatuan raste të pranimit të produktit naftë në kushtet kur tejkalohet sasia e pranuar e ujit.</p> <p>-Në lidhje me sasi të ujit që tejkalojnë normat teknologjike në produktin naftë argumentimet e specialistëve të QASHNG, Qendra e Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit, janë se nafta vjen jashtë standardeve nga qendrat e tjera, dhe për këtë fakt janë njoftuar administratorët, të cilët kanë lëshuar urdhra për pranimin e produktit naftë bruto dhe jashtë standardeve teknologjike, (me ujë mbi 3%, deri në 14%). Urdhrat nr. 182 datë 07.09.2021, “Për procedurë e inspektimit dhe kontrollit të qarkullimit të produktit Naftë Bruto”, 182/2 datë 16.12.2021, dhe 182/3 datë 17.12.2021.</p> <p>Argumentet e sjella nga qendrat janë se nuk kanë pajisjet për të bërë ndarjen e plotë të ujit dhe se nuk mund të ndalojnë punën në puse. Në momentin kur produkti i gatshëm i shitet kompanive fituese të</p>	I lartë	233-252	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a, të analizojë me kujdes situatën dhe të marrë masa për përfundimin e investimeve që do të mundësojnë përgatitjen e produktit naftë sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare për të rritur performancën dhe të ardhurat si dhe uljen e riskut të abuzimeve dhe cenimeve të aktiveve të shoqërisë.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>ankandeve, në depozitat e shitjes nafta bruto ngrohet dhe përgatitet në parametrat teknologjikë me përqindje uji më të vogël se 3%, ndërkohë që pjesa tjetër është produkt i gatshëm në mungesë. QASHNG Patos është magazinë fiskale stokimi dhe nuk lejohen shkarkime uji teknologjik pas përgatitjes, si trajtim me sistem ngrohje me kaldajë mbi vlerën e lejuar.</p> <p>Mos marrja e masave për zgjidhjen e problemeve për pasjen e produktit të gatshëm naftë bruto sipas standardeve teknike nga ana e administratorëve ka sjellë diferenca të produktit të gatshëm të kaluar në sistemin e doganës me kontabilitetin e mbajtur në shoqërinë Albpetrol sha.</p> <p>Laboratorët e përdorur në Albpetrol sha për analizat e produktit naftë bruto nuk janë të akredituar nga autoritetet përkatëse.</p> <p>Shoqëria Albpetrol sha, nuk ka përmbyllur investimet për të ngritjen e strukturave teknologjike të cilat do të mundësojnë heqjen e sasive të ujit mbi normë.</p> <p>Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me VKM Nr. 612, datë 2.9.2012 i ndryshuar, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, aneksi nr.17 matjet e produkteve, dhe me Standardet kombëtare të produktit naftë bruto.</p> <p>Duke qenë se produkti naftë lëvizet nga vendburimet në stacionin e shitjes me tubacione dhe autobote, verifikimi në depozitë për përqindjen e ujit dhe zbritja në kontabilitet si produkt i gatshëm shton riskun e abuzimeve në produktin e gatshëm.</p>			
12	<p>Qendra e Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit menaxhon shitjen e produktit naftë bruto tek Operatori Ekonomik fitues i procedurave të ankandit. Procedurat e marrjes së kampioneve dhe analiza e naftës kryhet sipas nenit 6 të Udhëzimit nr. 83 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, i ndryshuar.</p> <p>Faturat bëhen për çdo autobot në bazë të peshës dhe duke marrë të dhënat e analizave të kryera në fillim të procesit dhe duke ju referuar temperaturës 15%.</p> <p><i>Gjendja e strukturave dhe pajisjeve nga ku realizohet lëvrimi tek klientët është jashtë standardeve përkatëse.</i></p> <p><i>Depozitat e naftës, pajisjet matëse nuk janë certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, laboratorët që kryejnë analizat e mostrave nuk janë të akredituar nga institucionet përkatëse.</i></p> <p><i>Nga kontrollet periodike të ushtruara nga Dega e Doganës Fier kanë rezultuar diferenca materiale të produktit naftë bruto të rezultuar nga matjet faktike me atë kontabël të mbajtur nga Albpetrol sh.a Patos</i></p> <p>Grupet e kontrollit të Degës së Doganës Fier, në kontrollet në lidhje për pagesat për akcizën, procedurat për matjen e sasive të naftës bruto në rezervuare, i kanë të përcaktuar në VKM nr. 612, datë 02.09.2012,</p>	I lartë	233-252	<p>Administratori i shoqërisë të analizojë situatën në të cilën kryhet procesi i shitjes së naftës bruto, të vlerësojë procedurat përkatëse të kontrollit, të evidentojë zonat me risk në cenimin e produktit të gatshëm, si dhe të krijojë grupe pune që në procesin e matjes së naftës bruto në shitjet që kryen shoqëria, të garantohet zbatimi i standardeve kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p>Në zbatim të standardeve SSH EN ISO 3170:2004 dhe SSH EN ISO 3171:2004, densiteti i naftës bruto të matet në mënyrë automatike dhe nëse nuk është e mundur të zbatohet standardi i matjes në mënyrë manuale, duke shpeshuar matjet dhe numrin e kampioneve për të pasur të dhëna reale e të besueshme, me synim uljen e</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>ndryshuar, të cilat ndryshojnë nga metodologjia që përdor Albpetrol sh.a Patos.</p> <p>Kjo metodologji që përdor shoqëria nuk është e saktë dhe korrekte pasi kryhen tre matje të temperaturës dhe densitetit për një depozitë 5000 ton, dhe ndërkohë lëvrimi i sasisë mund të zgjasë deri në një javë si dhe depozita nuk zbrazet plotësisht.</p> <p>Komisionet e caktuara për kryerjen e analizave të densitetit, bazohen në pikën 6.9, të Urdhrit nr. 83, ku citohet: <i>“Densiteti i kampionit do të përcaktohet sipas metodës SSH 33, duke përdorur një aerometër të përshtatshëm dhe të kontrolluar. Temperatura dhe densitetet e matura dhe të korrektuara do të regjistrohen në “Raportin e analizave të naftës bruto” të përgatitur për kampionimi.”</i> Ky standard është shfuqizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve dhe është zëvendësuar me SSH EN ISO 3675:1998. Ky standard në lidhje me marrjen e mostrave i referohet ISO 3170 (SSH EN ISO 3170:2004 59 faqe, KT 19, Produkte të lëngëta të naftës - Marrjen e mostrave manualisht), ose ISO 3171 (SSH EN ISO 3171:1999 59 faqe, KT 19, Metodatat e provës për naftën dhe produktet e saj - Lëngjet e naftës -Marrja automatike e mostrave me tubacion).</p> <p>Mos përcaktimi i saktë i dendësisë së naftës bruto, në momentin e shitjes ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në çmimin e shitjes dhe reflekton në të ardhurat e shoqërisë. Në elementët e llogaritjes së çmimit të shitjes, pjesa më e madhe është përcaktuar nga faktorë të tjerë si çmimi në bursë, kursi i këmbimit të dollarit, etj., që janë të kontrolluar dhe pas faktit. Dy elementët që variojnë dhe maten për çdo shitje janë peshat e autoboteve që transportojnë produktin që shitet dhe densiteti i naftës bruto i cili përcaktohet një herë për një depozitë prej 5000-8000 m³. Në përcaktimin e riskut për dëmtimin e asetëve të shoqërisë si vjedhje ose mashtrime këto dy elementë kanë riskun më të madh.</p> <p>Veprimet më sipër janë në kundërshtim me ligjin Nr. 10 296, datë 08/07/2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 22, VKM nr. 612, datë 02.09.2012, ndryshuar me: Vendimin Nr. 128 datë 20.2.2013, Vendimin Nr. 501, datë 22.5.2013, Vendimin Nr. 30, datë 14.1.2015, Vendimi nr. 38, date 21.01.2016, Vendimi nr. 28, date 18.01.2017 Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”. Neni 96, Neni 99 Pika 2.</p>			<p>riskut të mos faturimit të sasive të produktit të shitur.</p>
13	<p>Nga auditimi i tre procedurave të ankandëve të shitjes së naftës u konstatua se grupi i eksperteve, për përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar të shitjes së naftës bruto ka bërë ulje shpenzimesh nga çmimi i shitjes së përcaktuar të ankandit, duke presupozuar shpenzime për vënien e produktit në kushtet FOB sipas kushteve të Bursës Ndërkombëtare për</p>	I lartë	233-252	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që procesi i përcaktimit të çmimit të shitjes së naftës bruto të kryhet bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të kostove të shoqërisë, të çmimit</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>hidrokarburet (Bursës Ndërkombëtare Brent), bazuar në udhëzimin 83, datë 10.02.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, pika 5, Të dhënat e bursës “Platts”, kuotojnë çmimin Naftë Bruto-Brent (Ddl), në dollarë dhe me kushte lëvrimi FOB (Free on Board), pra lëvrimi deri kuvertën e anijes në një port të caktuar.</p> <p>Grupi i ekspertëve ka bërë përllogaritje të ndryshme për transportin me autobote në porte të caktuara, ngrohjen e naftës gjatë rrugës, siguracionin, magazinimin në port, shpenzime shkarkimi etj, <u>duke rezultuar me një ulje në çmimin që duhet të paguajë Operatori Ekonomik fitues i ankandit të shitjes së naftës</u>. Pjesa më e madhe e shpenzimeve të përllogaritura në çmimet e shitjes nuk ndodhin pasi shitjet e naftës janë kryer me operatorë ekonomikë vendas.</p> <p>Relacionet për përllogaritjen e çmimit fillestar, pas aprovimit nga administratori, janë dërguar për miratim te Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës.</p> <p>-Në procedurën për sasinë 40,000 ton e fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria “R...E” sh.a., Elbasan, dhe “A...L” sh.a., Tiranë, vlera e shpenzimeve të pa kryera janë 3.55 USD/bbl për sasinë 40,000 ton, arrijnë në shumën 859,000 USD.</p> <p>-Në procedurën për shitje naftë bruto me sasi 100,000 ton, me fitues “E...A”, vlera e shpenzimeve të pa kryera janë 3.6 USD/bbl, për sasinë 100,000 ton, arrijnë në shumën 2,307,000 USD.</p> <p>-Në procedurën për shitjen e 120,000 ton naftë bruto, me fitues BOE “E...A” sha, dhe “R...E” sha, vlera e shpenzimeve të pa kryera arrin në shumën 2,630,000 USD.</p> <p>Vlera 5,797,000 USD përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos</p> <p>Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 296, datë 08/07/2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Neni 3, udhëzimit 83, datë 10.02.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure” Pika 5.</p>			<p>të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të kostove reale që mund të dalin gjatë procesit të shitjes së produktit, për të shmangur mungesën e të ardhurave nga një proces jo transparent dhe jo efektiv.</p>
14	<p>Kontraktori “B.....”, rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 <i>vërehet se, Prodhimi i Përgjithshëm</i> i deklaruar nga shoqëria BPAL është realizuar, madje është tejkaluar. Gjatë vitit 2021 prodhimi ishte 3,786.19 MBbl, shifër kjo e cila është mbi parashikimin e bërë në PP&B 2021. <i>Shpenzimet Operative (OPEX)</i>. Shpenzimet operative kapin vlerën 54,344 M\$ nga 60,659 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 6,315 M\$ ose 10%. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi me një</p>	I lartë	252-293	<p>Administratori në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>diferencë relativisht të vogël. Shpenzimet Administrative (G&A): Realizimi i G&A për vitin është realizuar mesatarisht në masën 69%.</p> <p>Investimet Kapitale (CAPEX): Realizimi i Capex për vitin është realizuar mesatarisht në masën 60%. Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.</p> <p>Për vitin 2022: Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria BPAL është realizuar vetëm në masën 86%. Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 prodhimi ishte 2,520 Mbbl, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021.</p> <p>Shpenzimet Operative (OPEX): Shpenzimet operative kapin vlerën 44,394 M\$ nga 46692 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 2,298 M\$ ose 2%. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2022 janë më të ulta sesa parashikimi me një diferencë relativisht të vogël. Shpenzimet Administrative (G&A): Realizimi i G&A për vitin është realizuar mesatarisht në masën 74%.</p> <p>Investimet Kapitale (CAPEX): Realizimi i Capex për vitin është realizuar mesatarisht në masën 50%. Cost Recovered: Në vitin 2022, sipas Faktit të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.</p>			<p>pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol.</p>
15	<p>Kontraktori “B.....” ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetroli ka kryer auditet vjetore dhe rezultat e tyre në vite janë kontestuar nga B...S dhe janë çuar për gjykim në Gjykatën e Arbitrazhit. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:</p> <p>Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020 për B.....A është 2,913,868 (dy milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) USD.</p> <p>Në bazë të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure” “Albpetroli do të ketë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj nga marrja e secilës deklarate të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione përsa i përket ndonjë deklarate të tillë të Llogarisë Kosto, me kusht që Albpetroli nuk do të titullohet të kryejë më shumë se dy audite të librave të Llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një Vit Fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakort për çdo rregullim të kërkuar. Dokumente shtesë dhe</p>	I lartë	252-293	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t’i kërkojë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën 2,913,868 USD të konstatuar për vitin 2020.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>llogarie do të bëhen të disponueshme për Albpetrolin gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës së mësipërme prej dymbëdhjetë (12) muaj Albpetroli nuk ka -këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë do të konsiderohet e aprovuar.</i></p>			
16	<p>Kontraktori "A...." SH.A. rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se, Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria A...O është 27,733.99 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 29,678 Ton, pra me një mosrealizim prej 7%. Ky është prodhimi më i lartë i realizuar në vendburimin Ballsh-Hekal.</p> <p>Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 2,214.96 M\$ nga 1,899.7 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 315.26 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të larta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një realizim në masën 17% më shumë se parashikimi.</p> <p>Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 527.95 M\$ nga 410 M\$ të parashikuara në PP&B 2021 Realizimi i G&A për vitin është realizuar madje është tejkaluar në masën 29% nga parashikimi.</p> <p>Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 janë kryer 1,893.74 M\$ Investime nga 3,628 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021. Sipas kontraktorit, kjo ka ardhur kryesisht prej mosrealizimit të investimeve që kërkojnë leje dhe që janë ende pezull.</p> <p>Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.</p> <p>Për 9-Mujorin e vitit 2022 vërehet se:</p> <p>Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria A...O është 19,982.09 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 21,940.35 Ton, pra me një mosrealizim prej 9%. Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 1,130.88 M\$ nga 1,693 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 562.12 M\$. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022, me një mosrealizim në masën 33% më pak se parashikimi.</p> <p>Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e vitit 2022, kanë qenë</p>	I lartë	252-293	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, duke kërkuar respektimin e planit të miratuar, bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>381.97 M\$ nga 366.75 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Realizimi i G&A per vitin është realizuar madje është tejkaluar në masën 4% nga parashikimi.</p> <p>Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 1,605.51 M\$ Investime nga 2,597 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për 9-Mujorin e vitit 2022, janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022.</p> <p>Cost Recovered: Për 9-Mujorin e vitit 2022, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.</p> <p>Shoqëria A. sha, megjithëse ka pasur rritje të të ardhurave nuk ka realizuar investimet e parashikuara në Planin e Punës.</p>			
17	<p>Kontraktori "A...." SH.A. ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim te Nenit 25 "Auditet" të Marrëveshjes Hidrokarbure "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Ballsh-Hekal" ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:</p> <p>Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020 për A.... Sh.A është 71,306.21 USD.</p>	I lartë	252-293	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën 71,306,21 USD të konstatuar për vitin 2020.</p>
18	<p>Kontraktori D....., ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim te Nenit 25 "Auditet" të Marrëveshjes Hidrokarbure "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Delvinë" ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar se vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperushme për vitin 2020 për shoqërinë "D...Y" LTD është 161,373.29 USD.</p>	I lartë	233-252	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën 161,373.29 USD të konstatuar për vitin 2020.</p>
19	<p>Kontraktori "T....SS" SH.A., rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se, Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria "T....SS" SH.A. është 14,827.3 Ton , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 27,228 Ton, pra me një mosrealizim prej 46%. Kjo diferencë përgjithësisht i atribuohet faktit që pavarësisht se të parashikuara në Buxhet 4-Projektet e përmirësimit të puseve ekzistuese nuk kanë dhënë akoma impaktin e parashikuar në Prodhim.</p> <p>Shpenzimet Operative (OPEX), shpenzimet operative</p>	I lartë	252-293	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën 20,569 USD të konstatuar për vitin</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>kapin vlerën 2,779 M\$ nga 3,689.73 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 910.73 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021. Peshën me të madhe e zënë shpenzimet për energji elektrike dhe për holluesin teknologjik për shkak të karakteristikave që ka nafta e Vb. Visokë.</p> <p>Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 1,582 M\$ nga 688 M\$ të parashikuara në PP&B 2021 Realizimi i G&A për vitin është realizuar madje është tejkaluar.</p> <p>Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 janë kryer 866 M\$ Investime nga 3,173.13 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021.</p> <p>Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.</p> <p>Për 9-Mujorin e vitit 2022, vërehet se, Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria TOS është 9,947 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 16,962 Ton, pra me një mosrealizim prej 41%. Kjo diferencë përgjithësisht i atribuohet faktit që pavarësisht se të parashikuara në Buxhet 4-Projektet e përmirësimit të puseve ekzistuese nuk kanë dhënë akoma impaktin e parashikuar në Prodhim.</p> <p>Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 1,766 M\$ nga 3,122.92 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 1,356.92 M\$. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022. Peshën me të madhe e zënë shpenzimet për energji elektrike dhe për holluesin teknologjik për shkak të karakteristikave që ka nafta e Vb. Visokë.</p> <p>Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e Vitit 2022, kanë qenë 1,130 M\$ nga 560 M\$ të parashikuara në PP&B 2022 Realizimi i G&A për vitin është realizuar madje është tejkaluar.</p> <p>Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 936 M\$ Investime nga 2,232.8 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për 9-Mujorin e vitit 2022 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022.</p> <p>Cost Recovered: Në 9-Mujorin e vitit 2022 sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.</p> <p>Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në</p>			2020.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	vendburimin Visoke” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditimi i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar se <i>vlera totale prej 20,569 USD nuk njihet si Kosto Hidrokarbure dhe duhet të zbritet nga Llogaria Kosto.</i>			
20	Kontraktori “F.....M” Sh.a, ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Nga kontrolli që grupi auditit të “Albpetrol” Sha, ka kryer mbi kompaninë “F.....M” Sh.a për periudhën Q1,Q2,Q3 dhe Q4 2020 si dhe pas kërkesave të shumta që u ka dërguar përfaqësuesve të kësaj kompanie nëpërmjet postës elektronike dhe verbale, për dërgimin e një CRS-je të detajuar, fatura TVSH-je dhe statement banke, grupit të auditit nuk i është vënë në dispozicion asnjë nga dokumentet e kërkuara. Për sa më sipër, shoqëria “Albpetrol” Sha, ka kërkuar të procedohet me zbritjen e të gjitha kostove me vlerën 77,977 USD dhe shpenzimeve nga Llogaria Kosto, për vitin 2020, të cilat nuk janë kualifikuar si kosto hidrokarbure në zbatim të të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Finiq-Kranë dhe P...Z”	I lartë	233-252	Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t’i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën 77,977 USD të konstatuar për vitin 2020.
21	Kontraktori “SH...M”., ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Kuçovë” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditimi i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar se, vlera totale e kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020, për SIPL është 248,807 USD.	I lartë	252-293	Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t’i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën 248,807 USD të konstatuar për vitin 2020.
22	Nga auditimi ka rezultuar se detyrimet e koncesionarëve ndajë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për energjinë e shitur/faturuar me dhe pa kontrata janë në shumën 1,429,616 mijë lekë, nga e cila kamatëvonesë për mos pagim në afat për vlerë 1,583,865 mijë lekë. Nga ana e sajë shoqëria Albpetrol sh.a Patos, ka vijuar me pagesat sipas akt-marrëveshjes datë 03.10.2022, midis FSHU sh.a dhe shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për pagesë me 24 këste të detyrimeve, duke paguar në mënyrë të padrejtë dhe për detyrimet e koncesionarëve. Gjithashtu, shoqëria Albpetrol sh.a Patos, nga ana e sajë nuk ka marrë asnjë masë shtrëngues për arkëtimin e detyrimeve të energjisë elektrike të konsumuar nga shoqëritë koncesionarëve. Ky veprim përben risk të lartë për shoqërinë “ALBPETOL” sha me efekt financiar me dëm në shumën 3,013,481,000 lekë së bashku me kamatëvonesat, pasi në rast falimentimi	I lartë	122-144	Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të njoftoj Këshillin Mbikëqyrës dhe të nxjerrë përgjegjësitë për detyrimet që shoqëritë koncesionare kanë ndajë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për energjinë e shitur/faturuar me dhe pa kontrata, si dhe të ndjek të gjithë rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 3,013,481,000 lekë (principlial në vlerën 1,429,616,000 lekë dhe kamatëvonesë në vlerën 1,583,865,000 lekë) , për të shmangur lindjen e borxhit të keq.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>ose largimi të ndonjë prej shoqërive koncesionare detyrimet për energjisë mbesin për likuidim shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, gjë e cila bëhet akoma dhe më e vështirë për ato shoqëri koncesionare që nuk kanë kontratë shitje energjie për të kërkuar në gjykatë detyrimet, duke rënduar situatën financiare të shoqërisë Albpetrol.</p> <p>Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 3, Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: germa “g”, ku citohet:Garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblihet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta.</p> <p>si dhe neni 10 i kontratës me O...E per jo familjar, kamatëvonesa për pagesë të vonuar, ku citohet: “Pas kalimit të afatit të pagesës caktuar në nenin 9.1, Klienti është i detyruar të paguajë një kamatë vonesë të barabartë me 0.1 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.”</p>			
23	<p>Nga auditimi i dokumentacionit në dosjet e procedurave dhe sistemin SPE, rezulton se në 3 procedurave OE e shpallur fitues nga KVO nuk janë në kushtet e plotësimi të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK. Gjithashtu gjatë auditimit të këtyre procedurave është konstatuar fakti se disa nga mangësitë e evidentuara në mos plotësimin e kriterëve nga OE të shpallur fitues, KVO i ka përdorur si element skualifikues në OE e skualifikuar por me ofertë ekonomike më të leverdishme se OE e shpallur fitues (qëndrim me dy standarte), veprime me efekt financiar negativ në vlerën 10,364,872 lekë.</p> <p>Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.</p>	I lartë	150-233	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a, Patos, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për vlerësimin e fakteve të konstatuara nga grupi i KLSH dhe nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës për vlerësimin e gabuar të procedurës në shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të miratuara nga AK, si dhe trajtimin e dy standarte në vlerësim, duke skualifikuar OE me mangësi të njëjta dhe mos vlerësuar kriterin kryesorë “çmimi më i leverdishëm”, veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, Patos, për vlerën 10,364,872 lekë pa TVSh.</p>
24	<p>Nga auditimi i procedurës me objekt “Përmirësim i infrastrukturës së stacionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos”, me fond limit 59,970,906 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur</p>	I lartë	150-233	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>shoqëria “Z....I” shpk me vlerë kontrate (pa TVSh) prej 59,955,454 lekë, rezulton se nuk janë zbatuar kushtet e kontratës nr. 2905/9, datë 22.6.2021 të lidhur midis shoqërisë “Z....I” shpk dhe Autoritetit Kontraktor Albpetrol sh.a Patos, për përfundimin e punimeve brenda afatit të 4 muajve, ose nga data 22.6.2021 deri me datë 21.10.2021.</p> <p>Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Financës në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, është likjuar shuma totale 71,944,212 lekë.</p> <p>Nga shoqëria “Z....I” shpk janë paraqitur fatura për likuidimin e situacioneve jashtë afatit të zbatimit të kontratës (data 21.10.2021), konkretisht fatura nr. 5/2022, datë 15.3.2022 në shumën 10,473,575 lekë me TVSh ose në vlerën 8,727,979 lekë pa TVSh, për të cilën nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos (<i>personat përgjegjës</i>) nuk janë llogaritur penalitet në referencë të nenit 9 të kontratës, kjo për 144 dite vonesë.</p> <p>Gjithashtu nga shoqëria “Z....I” shpk nuk është bërë i mundur që në momentin e deklarimit të përfundimit të punimeve dhe akt-marrjes së përkohshme të depozitohej dhe fatura e shoqëruar me situacion përfundimtar për punimet e mbyllura, duke lënë jashtë afateve vlerën e mësipërme, për të cilën nga personat përgjegjës duhej të llogaritej penaliteti në vlerën 8,633,585 lekë $\{(59,955,454 \text{ lekë} \times 25\%) = (14,988,863 \text{ lekë} \times 4/1000 \text{ ditë vonesë} \times 144 \text{ ditë})\}$, vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, në kundërshtim me nenin 9 të kontratës nr. 2905/9, datë 22.6.2021 për “Përmirësim i infrastrukturës së Statcionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos”.</p>			<p>Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 8,633,585 lekë, për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 2905/9, datë 22.6.2021 nga shoqëria “Z....I” shpk.</p>
25	<p>Nga auditimi i procedurës me objekt “<i>Blerje kalimatës naftë (flow-metër)</i>”, me fond limit 37,936,920 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur shoqëria “V....S” me vlerë kontrate (pa TVSh) 37,178,181 lekë, rezulton se nuk janë zbatuar kushtet e kontratës nr. 1079/9, datë 19.4.2022 të lidhur midis shoqërisë “V....S” shpk dhe Autoritetit Kontraktor shoqërisë Albpetrol sha për përfundimin e punimeve brenda afatit 4 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës ose nga data 19.4.2022 deri me datë 19.8.2022.</p> <p>Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Financës në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, konstatohet se është paraqitur për likuidim vlera 44,613,816 lekë, nga e cila likjuar në masën 80% sipas pikës 3.2 të nenit 3 të kontratës në vlerën 35,691,053 lekë dhe nuk është likjuar vlera prej 8,922,763 lekë ose 20% e kontratës po sipas nenit 3 të kontratës, pika 3.2, pasi 20% do likjohet pasi pajisja të jetë instaluar në vend.</p> <p>Mallrat janë bërë hyrje në magazinë e QFT Patos, kjo sipas pikës 4.8/a të nenit 4 të kontratës, konstatuar kjo</p>	I lartë	150-233	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a të ngrerë një grup pune dhe të analizojë përgjegjësinë e personave përgjegjës në mos zbatimin e kushteve të kontratës me objekt “<i>Blerje Kalimatës naftë (flow-metër)</i>”, ku për personat përgjegjës të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën 1,606,096 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.</p> <p>Të marra masa të menjëhershme për vënien në punë të kalimatasve sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e zbatimit.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>dhe nga komisioni i marrjes në dorëzim me PV nr. 472/2, datë 16.9.2022, sipas urdhrit datë 20.4.2022.</p> <p>Konstatohet se nuk është bërë instalimi i kalimatasve, vënia në punë dhe realizimi i asistencë teknike, siç përcaktohet në pikën 2.4.3 të nenit 4 të kontratës me 180 ditë vonesë, ku megjithëse nga shoqëria <i>Albpetrol sh.a Patos</i> është kërkuar me urgjencë për shitjen e naftës sipas kërkesave të doganës, akoma edhe sot qëndrojnë të pamontuara në magazinë dhe të pa vënë në punë, duke bërë që nafta të matet me sasi/ton, duke e klasifikuar këtë shpenzim një shpenzim paefektivitet për shoqërinë me fond 37,936 mijë lekë nga mosvënia në punë e kalimatasve për të cilën është realizuar procedura e prokurimit.</p> <p>Nga sa trajtuam kontrata nuk ka përfunduar sipas kushteve të përcaktuara në nenin 9 të kontratës, brenda periudhës 4 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës së bashku me shtesën ose <u>nga data 19.4.2022 deri me datë 31.8.2022</u>, pasi mallrat qëndrojnë akoma në magazinë pa u vënë në funksion për të cilën shoqëria “ALBPETROL” sha ka kryer shpenzimin.</p> <p>Kështu për vlerën 8,922,763 lekë, që korrespondon 20% të vlerës së kontratës e cila nuk është zbatuar, penalteti përlllogarit në vlerën 1,606,096 lekë ($8,922,763 \text{ lekë} \times 25\%$) = ($2,230,690 \times 4/1000 \times 180 \text{ ditë vonesë}$), veprime me dëm në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.</p> <p>Gjithashtu konstatojmë se pavarësisht faktit se nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 6774 <i>prot</i>, datë 24.9.2020 dhe shkresës së Drejtorisë së Doganës Fier nr. 2399 <i>prot</i>, datë 7.6.2021 i është kërkuar shoqërisë <i>Albpetrol sh.a Patos</i> për pajisjen e pikave fundore të shitjes së naftës bruto me paisje për matjen (kaliamtës), nga shoqëria <i>Albpetrol sh.a Patos</i> megjithëse procedura është zhvilluar dhe lidhur kontrata me subjektin fitues “V...S” shpk, nuk është bërë i mundur vënia në punë e këtyre aparaturave sipas kushteve të kontratës ose nga data 23.8.2022, megjithëse këto paisje janë bërë hyrje në magazinë, duke e bërë këtë një shpenzim jo me efektivitet dhe që pengon procesin e shitjes së naftës, në kundërshtim me nenin 20 të ligjit nr. 61/2012 “Për AKCIZAT në RSH”, i ndryshuar dhe kushtet e kontratës nr. 10790/10, datë 19.4.2022 për realizimin e blerjes me objekt “<i>Blerje Kalimatas naftë (flow-metër)</i>”.</p>			
26	<p>Nga auditimi i procedurës me objekt “<i>Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “Eternit” i çatave të repartit Mekanik dhe repartit Elektrik në QMN Kuçovë</i>”, me fond limit 9,953,982 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur shoqëria “A...T” me vlerë kontrate (pa TVSh) 9,187,380 lekë, rezulton se: Preventivi është hartuar nga specialistët <i>ing. R.G</i>,</p>	I lartë	150-233	<p>Administratori i shoqërisë <i>Albpetrol sh.a Patos</i> në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>bazuar në çmimet sipas VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar. Nga verifikimi i çmimeve sipas manualit, konstatohet se ato janë nuk janë në zbatim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015, i ndryshuar.</p> <p>Nga sa trajtuam mësipërm vlera e preventivit është rënduar më shumë prej 521,220 lekë, veprime me efekt negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në kundërshtim VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.</p>			<p>administrative e ligjor për arkëtimin e vlerës 521,220 lekë, ndajë ing. R.G si personi përgjegjës për hartimin e disa prej zërave të projektit në kundërshtim VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.</p>
27	<p>Nga auditimi i procedurës me objekt “Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “Eternit” i çatave të repartit Mekanik dhe repartit Elektrik në QMN Kuçovë”, me fond limit 9,953,982 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur shoqëria “A....T” me vlerë kontrate (pa TVSh) 9,187,380 lekë, rezulton se nuk janë zbatuar kushtet e kontratës nr. 8489/9, datë 3.3.2022 të lidhur midis shoqërisë “A....T” Shpk dhe Autoritetit Kontraktor Albpetrol sha Patos, për përfundimin e punimeve brenda afatit të 8 javëve, ose nga data 29.3.2022 (data e fillimit të punimeve) deri me datë 4.5.2022.</p> <p>Nga të dhënat e marra nga Drejtoria Financës, rezulton se nuk është likuaduar asnjë vlerë e situacionuar, kjo pasi sipas znj. A.B në dosjen teknike të përcjell për likuidim nuk është bashkëlidhur situacioni përfundimtar i punimeve.</p> <p>Me shkresën nr. 134/6, datë 15.12.2022 të Drejtorit të Qendra Mekanike e Naftës QMN Kuçovë përcjellë në adresë të Drejtorisë së Financës shkresa me lëndë “Dërgim dokumentacioni”, në të cilën janë listuar dhe dokumentacioni që shoqëron. Në këtë liste është dhe situacioni përfundimtar.</p> <p>Me MEMO nr. 9218/1, datë 22.12.2022 të Drejtorisë së Programimit në adresë të E. D. me detyrë Administrator, është përcjellë informacion mbi zbatimin e kontratës me nr. 8449/12, datë 3.3.2022, duke informuar administratorit mbi fazat e zbatimit të kontratës nga momenti i përfundimit të punimeve datë 4.5.2022 deri në hartimin e akt kolaudimit. Në këtë MEMO në pikën 3 thuhet se situacioni përfundimtar është në përputhje me projekt preventivit.</p> <p>Me shkresën nr. 134/7, datë 22.12.2022 (prot ALBPETRO nr. 9218, datë 22.12.2022), DMN Kuçovë kërkesë për likuidim, duke rreshtuar gjithë dokumentacionin e plotë.</p> <p>Pas ballafaqimit të problematikës mbi arsyet e moslikuidimit nga znj. A.B u rishpjegua se dokumentacioni shoqëruar nuk është i saktë. Për këtë me MEMO datë 17.01.2023 (e pa protokolluar në instucionin) dhe panëshkruar nga personat se kujt i</p>	I lartë	150-233	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 505,305 lekë, për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 8489/9, datë 3.3.2022 nga shoqëria “A....T” shpk.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>është adresuar, thuhet se me anë të kësaj shkrese kërkohet plotësimi i praktikës me dokumentacion me argumentin se “Nuk mund të vijohet me procedurën e likujdimit pasi kjo kontratë është e paplotësuar me dokumentacioni justifikues dhe kërkohet plotësimi i saj”.</p> <p>Në këtë MEMO për veç faktit se nuk është e protokolluar dhe pa nënshkruar nga personat të cilëve ju është adresuar MEMO në instuticioni, në kundërshtim me rregulloren e Albpetrol sh.a Patos (miratuar me vendimit nr. 20, datë 3.12.2022), por nuk është e specifikuar se cilat nga dokumentacioni justifikues nuk është paraqitur ose është i parregullt.</p> <p>Me shkresën nr. 1081, datë 13.2.2023 Drejtoria e Programimit për dijeni dhe Administratorit z. E. D i përcjellë Drejtorisë së Financës dokumentacionin e plotë për zbatimin e kontratës nr. 1081, datë 13.2.2023, duke listuar të gjithë dokumentet, ku bë pjesë dhe situacioni përfundimtar (nr. 27 i listës).</p> <p>Nga znj. A.B për sqarimin e situatës është paraqitur situacioni i cili është pa datë por i nënshkruar nga gjithë personat përgjegjës, situacion i cili në dosjen e zbatimit dhe dokumentacioni shoqërues për likujdim mungonte. Pretendimi i Drejt/Financës se situacioni është i panënshkruar nuk qëndron, pasi ai është nënshkruar nga subjekti mbikëqyrës si dhe E. D. në cilësinë e Administratorit.</p> <p>Referuar sa mësipërm fatura nr. 35/2022, datë 29.6.2022 në shumën 11,024,856 lekë e cila është depozituar në Drejtorinë e Financës me datë 22.12.2022 nuk është mundësuar likujdimi i saj deri në datë 31.3.2023, në kundërshtim me nenin 29 pika 5 e kontratës nr. 8489/9, datë 3.3.2022.</p> <p>Sipas dokumentacionit në financë, shoqëria “A...T” shpk ka paraqitur për likujdim faturën nr. 35/2022, datë 29.6.2022 në shumën 11,024,856 lekë me TVSh (vlera e plotë e kontratës).</p> <p>Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se nga shoqëria fatura është paraqitur jashtë afatit të zbatimit dhe kjo e pashoqëruar me situacion përfundimtar (data 29.6.2022), dokumentacion bazë që tregon përfundimin e punimeve për të cilën nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos nuk janë llogaritur penalitet në masën 4/1000 në ditë jo më pak se 25% e vlerës së kontratës, kjo në referencë të nenit 33 të kontratës, për ditëvonesat përlllogaritjen prej 55 dite vonesë nga data 4.5.2022 deri datë 29.6.2022.</p> <p>Nga sa trajtuam mësipërm shoqëria “A...T” shpk nuk ka plotësuar kushtet e kontratës për mbylljen e sajë brenda afatit ligjorë duhet të llogaritet penaliteti në shumën 505,305 lekë $\{ (9,187,380 \times 25\% = (22,96,845 \text{ lekë} \times 4/1000 \text{ ditë vonesë} \times 55 \text{ ditë}) \}$, vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.</p>			

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
28	<p>Nga auditimi i procedurës me objekt: “Shërbime për punime me autosondë me kullë me kapacitet ngritës > 70 ton”, me fond limit 15,900,000 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur fitues shoqëria “S...B” shpk me vlerë kontrate (pa TVSh) prej 14,900,000 lekë, rezulton se:</p> <p>Nga shoqëria nuk janë plotësuar kushtet e kontratës nr. 6081/11, datë 30.9.2021 të lidhur midis shoqërisë “S...B” shpk dhe AK (Albpetrol sha), me vlerën 14,900,000 lekë pa TVSh ose vlera 17,880,000 lekë me TVSh për zbatimin e afatit brenda 12 muajve ose nga data 30.9.2021 deri me datë 30.9.2022.</p> <p>Nga të dhënat e marra nga Drejtoria Financës në shoqërinë <i>Albpetrol sh.a Patos</i>, shoqëria ka paraqitur për likuidim fatura në shumën totale 6,339,710 lekë, vlerë e cila është likuiduar nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos deri me datë 16.9.2022.</p> <p>Nga ana e shoqërisë “S...B” shpk nuk është mbyllur kontrata për vlerën 17,880,000 lekë, kjo deri me datë 30.9.2022, duke mbetur pa zbatuar vlerën 11,540,290 lekë (17,880,000 – 6,339,710), për ditë vonesat janë 180 dite vonesë nga data kur duhej mbyllur kontrata.</p> <p>Për zbatimin e kësaj kontrate është ngarkuar z. I.Ç me profil ing. Naftë pranë Drejt/Prodhimit, në zbatim të urdhrin nr. 6081/12, datë 30.9.2021.</p> <p>Konstatohet se nuk ka asnjë dokument justifikues mbi vonesat e mos mbylljes në afat të kontratës, veprime në shkelje të nenit 14 të kontratës 6081/11, datë 30.9.2021, ku deri me datë 30.3.2023 detyrimi për kamatëvonesën e pallogaritur përlllogaritet në shumën 2,682,000 lekë (14,900,000 x 25%) = (3,725,000 lekë x 4/1000 x 180 ditë vonesë), vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.</p>	I lartë	150-233	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin të gjitha masat për ndjekjen e procedurave administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës 2,682,000 lekë nga shoqëria “S...B” shpk, si dhe marrjen e masave ndajë personave përgjegjës në mos ndjekjen e kontratës sipas afateve</p>
29	<p>Nga auditimi i procedurës me objekt “Ndërtim RVM 1500 m3 në parkun Dekantim Gorisht”, me fond limit 14,666,892 lekë pa TVSh viti , në të cilën kanë marrë pjesë 2 OE, fitues është shpallur shoqëria “A...6” shpk me ofertë 13,976,934 lekë më të lartë se OE i skualifikuar, rezulton se:</p> <p>Me shkresën nr. Ska, datë ska të Drejtorisë Financës i është kërkuar Administratorit që në zbatim të kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021 dhe amendament kontrate nr. 605, datë 20.01.2022 likuidimin e shumës 16,772,320 lekë me TVSh ndaj shoqërisë “A...6” shpk.</p> <p>Sipas kontratës fillestare afati i përfundimit të punimeve është 3 muaj ose nga datë 15.10.2021 deri me datë 15.01.2022. Sipas të dhëna të Sektorit të Menaxhimit të Kontratave punimet kanë filluar me datë 21.10.2021. Nisur nga fakti se kjo kontratë ka shtesë afati për një periudhë 30 ditë, afati i punimeve është nga data 20.10.2021 deri me datë 22.02.2022.</p>	I lartë	150-233	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 223,630 lekë pa TVSh ndaj shoqërisë “A...6” shpk për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Me shkresën nr. 3183, atë 19.4.2022 Drejt/Programimit dhe zhvillimit me autorizim zj. V.S i është drejtuar Drejt/Financës për dijeni administratores znj. A. H. për likujdim situacioni përfundimtar, kjo në referencë të shkresë së QPN Gorisht nr. 282, datë 12.4.2022 (<i>prot Albetrol nr. 3183, datë 15.4.2022</i>).</p> <p>Sipas kësaj shkrese me datë 6.4.2022 nr. 2862prot, është protokolluar në Albetrol sha dokumentacioni nga kolaudatori i punimeve shoqëria “V....G” shpk.</p> <p>Me shkresën nr. 3921prot, datë 20.5.2022 të znj. A.B me detyrë Drejt/Financës i është kërkuar interpretim Drejt/Çështjeje ligjor në lidhje me mangësitë e dokumentacionit shoqërues të faturës për likujdim, duke theksuar se dokumentacioni nuk është nënshkruar nga ish- administratori, pasi situacioni nuk është nënshkruar nga AK (Albetrol sha), por është nënshkruar nga komisioni i ngritur nga qendra e QPN Gorisht (persona që ndjekin kontratën).</p> <p>Për këtë është kërkuar interpretimi juridik që bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2021 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve” që dokumentacioni i përcjellë juridikisht është i rregullt ose jo.</p> <p>Nga Drejt/ Çështjeje ligjore me shkresën nr. 3921/1, datë 6.6.2022 i kthen përgjigje Drejt/Financë që situacioni përfundimtar i datës 30.3.2022 i cili rezulton i nënshkruar nga sipërmarrës, mbikëqyrësi i punimeve dhe komisioni i QPN Gorisht në cilësinë e përfaqësuesit të AK Albetrol sh.a Patos sh, në zbatim të kreut II pika 7, pikën 17 dhe 18 të udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2021 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, dokumentacioni është i rregullt.</p> <p>Me shkresën nr. 4462prot, datë 10.6.2022 Drejt/Financës i drejtohet Drejt/ Programimit se vlera e faturës për likujdim nuk përputhet me vlerën e situacionit përfundimtarë. Me shkesën nr. 4462/1prot, datë 13.6.2022 Drejt/Programimit i drejtohet Drejt/Financës se fatura tatimore elektronike është pranuar nga Sektori i Financës në QNP Gorisht, me faturën elektronike të korrigjuar nr. 384, datë 10.6.2021.</p> <p>Me shkresën nr. 282, datë 12.4.2022 të Q.P.N Gorisht (<i>financieri S.D dhe Drejtori N.B</i>), i është drejtuar Drejt/Financës Albetrol sha për likujdimin e situacioni përfundimtar sipas faturës 109, datë 10.6.2022 në shumën 16,770,640 lekë me TVSh e cila është likujduar me datë 23.6.2022 në shumën 15,932,108 lekë me TVSh, duke zbritur garancinë 5%.</p> <p>Me shkresën nr. <i>Ekstra</i> datë 01.4.2022 të shoqërisë “A...6” shpk është depozituar dokumentacioni për likujdimin e kontratës se punimeve nr. 6082/10, datë 15.10.2021.</p>			

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Nga të dhënat e mësipërme punimet nuk kanë përfunduar në afatin e caktuar në kontratë dhe amendament kontratë, pra nga datë 22.10.2021 deri me datë 22.02.2022, pasi ato janë mbyllur me datë 30.3.2022 (data situacioni përfundimtar) ose datë fatura 8.4.2022.</p> <p>Në zbatim të nenit 33 pika 33.1 germa (a), ndaja shoqërisë 'A...6' shpk nga Sektori Financës QPN Gorisht (S.D) dhe Drejt/Financës Albpetrol sh.a Patos (A.B) duhej të ishin llogaritet penalitetet për mos respektim të kushteve të kontratës për afatet e zbatimit në vlerën 223,630 lekë ($13,976,934 \times 25\%$) = ($3,494,233 \text{ pa TVSh} \times 4/1000 \times 16 \text{ ditë vonesë}$), në kundërshtim me nenin 33 pika 33.1 germa (a) e kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021 të lidhur midis shoqërisë "A...6" shpk dhe shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.</p>			
30	<p>Grupi i auditimit konstatoi se bazuar në listë pagesat e periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 janë paguar dieta për trajtim ushqimor në masën 500 lekë ndërkohë që me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 68, datë 7.2.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë]", pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar në masën 300 lekë. Në lidhje me këtë VKM rezulton se nga Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit nuk është marrë asnjë iniciativë për implementimin dhe zbatimin e saj, si dhe vënien në dijeni të Administratorit dhe aparatit të shoqërisë, për përmirësimet ligjorë, duke qenë një detyrë funksionale e kësaj drejtorie.</p> <p>-Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se me VKM nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë", pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, Drejtorisë së Burimeve njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjorë për caktimin e dietës ushqimorë në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet përkatëse për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive.</p> <p>Nga llogaritja e listpagesave të periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 425,231,740 lekë, nga 255,231,740 lekë që duhej të</p>	I lartë	71-87	<p>Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masat dhe të ndiqen procedurat administrative e ligjore ndaj personave përgjegjës për arkëtimin e shumës 170,092,696 lekë, për mos përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive rekomanduar kjo dhe në auditimet e tjera të KLSH. Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit të marrë masat e duhura dhe të kryejë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatës për mos vazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga përcaktimet ligjore.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>ishte pra është paguar më tepër shuma prej 170,092,696 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë. (Shënim: Llogaritja është kryer në bazë të shumës totale të përfituar, pjesëtuar me vlerën prej 500 lekë/ditë, dhe më pas është shumëzuar me 200 lekë/ditë, e cila është shuma e përfituar më tepër). Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a).</p>			
31	<p>Referuar situatës së krijuar të pandemisë COVID-19 procesi i ristrukturimit është pezulluar me Vendimin nr. 6, datë 29.04.2020, të Këshillit Mbikëqyrës duke e shtyrë afatin e njoftimit deri në një vendim të dytë dhe sipas vendimit punonjësit të cilët preken nga procesi do të trajtohen me pagën e luftës.</p> <p>Me shkresën nr. 1821 prot., datë 30.03.2020, Administratori i Shoqërisë E.M ka hartuar një plan masash shtrënguese në kuadër të shpalljes së gjendjes emergjente për shkak të pandemisë së COVID-19. Me shkresën nr. 1821/1 prot., datë 01.04.2020, nga Administratori i Shoqërisë E.M janë njoftuar Drejtoritë dhe qendrat e prodhimit në varësi të Shoqërisë “Albpetrol” Sh.a për zbatimin e planit të masave sipas përcaktimeve përkatëse.</p> <p>Reduktimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore (brenda datës 06.04.2020), reduktimi i shpenzimeve për dieta dhe orët jashtë orarit (nga data 01.04.2020), aplikimi i lejes së zakonshme për vitin 2020 (brenda datës 03.04.2020), pezullimi i këshillave teknik dhe ndalimi i pagesave të tyre (duke filluar nga data 01.04.2020), shfuqizimi i dhënies së shtesave mbi pagë për komisionet e drejtoritë përkatëse (menjëherë), reduktimi i konsumit të karburantit të programuar për muajin prill (duke filluar nga data 01.04.2020), kryerjen e inventarit fizik të mallrave gjendje në magazinë (brenda datës 10.04.2020), etj.</p> <p>-Punonjësit e Albpetrol sh.a kanë hapur padi ndaj shoqërisë dhe për periudhën objekt auditimi kanë fituar çështje gjyqësore si më poshtë:</p> <p>-Pagat e fituara me vendime gjyqësore në vlerën 2,438,069 lekë,</p> <p>-Shpenzime gjyqësore në vlerën 658,520 lekë,</p> <p>-Tarifa e shërbimit përmbarimor plus TVSH në vlerën 361,200 lekë.</p> <p>Sa më sipër për shkak të vendimeve të kundër ligjshme, dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar, vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe tarifa e shërbimit përmbarimor plus TVSH rezulton në vlerën 1,019,720 lekë dhe konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a.</p>	I lartë	71-87	Këshilli Mbikëqyrës në bashkëpunim me Administratorin e shoqërisë Albpetrol sh.a, të analizojë situatën dhe të marrin masa për ndjekjen e rrugëve ligjore lidhur me arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën 1,019,720 lekë nga personat përgjegjës.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
32	<p>Me vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021, administratori i shoqërisë ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil/benzine, ku tërheqja e kësaj sasive do të bëhet me tollona pranë magazinës së Albpetrol nga drejtoria e përfaqësimit dhe koordinimit me institucionet. Në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për 7 muaj të vitit 2021.</p> <p>Me vendimin nr. 5132 datë 28.07.2021, administratori ka shfuqizuar vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021 duke përcaktuar si kuotë mujore, për këshillin mbikëqyrës sasinë prej 1000 litra/gazoil/benzinë, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për një muaj.</p> <p>Me vendimin nr. 5256 prot., datë 03.08.2021, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për muaj të vitit 2021. Me vendimin nr. 2529 prot., datë 24.03.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 250 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 5256/1 prot., datë 04.06.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 7911 prot., datë 31.10.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 1000 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës.</p> <p>Të gjithë vendimet e sipërcituara baza ligjore e përdorur për dhënien e këtyre vendimeve nuk citon për miratimin e dhënies së kuotës mujore me karburant për llogari të Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu nuk është përcaktuar arsyeja e dhënies së sasisë së karburantit për Këshillin Mbikëqyrës dhe si do të justifikohet nga ana e Këshillit konsumi i karburantit të dhënë. Nga auditimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura nga Sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës nuk konstatohet të jenë kryer mbledhje në selinë e Shoqërisë Albpetrol sh.a por të gjitha mbledhjet ku Këshilli ka marrë vendime për shoqërinë janë mbajtur në Tiranë.</p> <p>Pra vendimet e administratorit për periudhën respektive të ushtrimit të funksionit brenda periudhës së auditimit. Për sa me lart, vlera e karburantit e përfituar nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës është në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi, dhe nuk është parashikuar në asnjë akt rregullator, të shoqërisë Albpetrol. Nga ana e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe anëtarëve të tij, nuk është mbajtur ose administruar pranë shoqërisë Albpetrol sh.a asnjë dokumentacion justifikues ligjorë mbi dokumentimin e konsumit të karburantit. Vlera prej 3,320,276 lekë do të konsiderohet shpenzim për të cilat mungon dokumentacioni justifikues ligjor dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a, dëm i cili duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit përfitues.</p>	I lartë	56-71	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 3,320,276 lekë nga personat përgjegjës.</p> <p>Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të analizojë me kujdes vlerën 3,320,276 lekë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara për mos plotësimin me dokumentacion plotësues dhe justifikues të konsumit të karburantit nëpërmjet tollonave nga Këshilli Mbikëqyrës, si dhe marrjen e masave për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
33	<p>Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar shpërblim për anëtarët e vet, në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit.</p> <p>Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë mujore të njëvleftshme me pagën e Administratorit të Albpetrol sha shpërblim janë:</p> <p>Zj. E.B për vlerën 226,100 lekë. Zj. E.M për vlerën 226,100 lekë. Z. I. G. për vlerën 226,100 lekë. Zj. L.O për vlerën 226,100 lekë Zj. R.B për vlerën 226,100 lekë.</p> <p>Për vlerën totale prej 1,130,500 lekë të përfituar nga Këshilli Mbikëqyrës në trajtën e shpërblimit financiar, nuk provohet plotësisht bazueshmëria ligjore e përfitimit të tij. Vlera prej 1,130,500 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili është në vlerën 226,100 lekë.</p>	I lartë	56-71	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marri masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 1,130,500 lekë nga personat përgjegjës. Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.</p>
34	<p>Vendimi nr. 1796 prot., datë 12.03.2021 “<i>Mbi miratimin e pagesës së shpërblimit të disa punonjësve të Albpetrol sha</i>”. Ky vendim është marrë pas propozimit me shkresën nr. 1795 prot., datë 12.03.2021 mbi këtë shpërblim nga ana e 3 Drejtorive, Prokurimeve, Organizative dhe Juridike.</p> <p>Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë shpërblim janë:</p> <p>Z. M.B për vlerën 195,760 lekë, Zj. A.B për vlerën 140,000 lekë, Zj. E.V për vlerën 95,000 lekë, Zj. B.N për vlerën 95,000 lekë, Zj, A.D për vlerën 80,000 lekë Zj. XH.H për vlerën 95,000 lekë.</p> <p>Vlera prej 700,760 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.</p> <p>Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 2 paga shpërblim janë: z. F.M për vlerën 280,000 lekë, z. R.Ç për vlerën 280,000 lekë, z. D.H për vlerën 210,000 lekë, z. E.B për vlerën 280,000 lekë, zj. E.T për vlerën 230,000 lekë, z. S.K për vlerën 380.000 lekë, zj. A. H. për vlerën 280,000 lekë, z. A.L për vlerën 280,000 lekë, z. D.F për vlerën 230,000 lekë dhe zj. O.F për vlerën 230,000 lekë.</p> <p>Vlera prej 2,680,000 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.</p> <p>Vendimi nr. 3238 prot., datë 21.05.2021 “<i>Mbi miratimin e pagesës së shpërblimit të disa punonjësve të Albpetrol sha</i>”.</p> <p>Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 2 paga shpërblim.</p>	I lartë	56-71	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marri masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 6,371,520 lekë nga personat përgjegjës. Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Vlera prej 2,525,760 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.</p> <p>Vendimi nr. 5129 prot., datë 27.07.2021 “Në kushtet e një pune intensive nga punonjësit e QEMNG Patos”. Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë shpërblim.</p> <p>Vlera prej 465,000 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.</p> <p>Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga ana e punonjësve të shoqërisë Albpetrol sha është 6,371,520 lekë vlerë e cila do të konsiderohet dëm ekonomik për shoqërinë. Pasi personat përfitues nuk kanë kryer asnjë detyrë jashtë detyrave funksionale të tyre të mirpërcaktuara në rregulloren e shoqërisë.</p>			
35	<p>-Me shkresën nr. 7605 prot., datë 06.10.2021, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për paradhënie për pjesëmarrjen në konferencën me temë Eage delivering for the energy challenge today and tomorrow” në Amsterdam. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë : znj. A. H., I.M, z. R.Ç, z. S.K, znj. R.B. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për 7 ditë qëndrimi, dy ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 400 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 48,640 lekë në total për 5 punonjësit. <i>Vlera prej 400 € do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, më konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili është në vlerën 80€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 9,728 lekë.</i></p> <p>-Me shkresën nr. 831 prot., datë 27.01.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje në kurset e trajnimit Leadership & People Managment Skills dhe International Oil and G...S Explotation Contracts” në Londër. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë: znj. A. H., z. R.Ç, D.B, A.Z, I.K dhe Y.S. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për periudhën 20-28.03.2022, katër ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 960 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 117,504 lekë në total për 6 punonjësit. <i>Vlera prej 960 € do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili</i></p>	I lartë	56-71	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marri masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 286,744 lekë nga personat përgjegjës. Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>është në vlerën 160€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 19,584 lekë.</p> <p>-Me shkresën nr. 2054 prot., datë 04.03.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje në kursin e trajnimit Corrosion Control Oil and G...S Exploration Industry” në Londër. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë : E.DH, A.RR, S.LL, N.B dhe znj. R.B. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për periudhën 05-12.06.2022, pesë ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 1000 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 120,600 lekë në total për 5 punonjësit. Vlera prej 1000 € do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili është në vlerën 200€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 24,120 lekë.</p>			
36	<p>Nga auditimi i kryer në marrëdhëniet tregtare me kontraktorin “B.....A”, u konstatuan shkelje të menaxhimit financiar.</p> <p>Me shkresën Nr.10826 prot. datë 31.12.2021, nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku është kërkuar lëshim Urdhër Ekzekutimi për faturat dhe pas lëshimit të Urdhrit të Ekzekutimit, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit i është drejtuar Zyrës së Përbarimit Privat “E...P” shpk për vënien në ekzekutim të titujve ekzekutiv Fatura Tatimore Shitje.</p> <p>Midis Zyrës së Përbarimit “E...P” shpk përfaqësuar nga përbaruesi gjyqësor z. E. M dhe shoqërisë “Albpetrol” sh.a. përfaqësuar nga Administratori z. F. M, është lidhur Kontrata e Shërbimit Nr.1113 prot. datë 04.02.2022 dhe Nr.27 prot. datë 04.02.2022, e cila është likjuar në datë 09.02.2022 në shumën 14,613,456 lekë.</p> <p>Nga auditimi i kartelës financiare dhe ditarit të bankës në Drejtorinë e Financës u konstatua se faturat me nr.08, datë 17.02.2021, fatura nr.38, datë 23.03.2021, fatura nr.108 dhe nr.109, datë 17.05.2021 janë likjuar plotësisht nga kompania “B.....A”.</p> <p>-Nga Drejtoria e Financës nuk është kthyer përgjigje shkresore nëpërmjet arkivës, shkresës Nr.9401, datë 23.11.2021 “Kërkesë për dokumentacion” të DÇLP, si dhe nuk ka akt rakordimi për detyrimet e ndërsjella me kompaninë “B.....A”, ku të pasqyrohet shuma e detyrimit e dokumentuar me dokumente justifikues.</p> <p>Shkeljet e konstatuara në menaxhimin financiar janë: Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit ka kryer veprime mbështetur në vlerën e saldove totale 948,890,551 lekë, të një shkrese të marrë nga Drejtoria</p>	I lartë	233-252	Nga Albpetrol sha, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimit e vlerës 14,613,456 lekë, nga R.Ç, A.LL, A.B dhe F. M.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>e Financës për një kontraktor tjetër, dhe ka kryer veprime për nxjerrje titull ekzekutiv pa pasur një aprovim nga kjo drejtori.</p> <p>Ndërkohë që drejtorit i Drejtorisë së Financës A.B, sipas sektorit të protokollit, kjo shkresë i është dërguar në email sipas praktikave të aprovuara. Emailin e datës 23.11.2021, drejtori i DF A.B, ja ka dërguar specialistes së financës së administratës për nxjerrjen e kartelës financiare të kontraktorit deri më 30.09.2021, si dhe specialistes së Qendrës së Furnizimit dhe Shërbimit Elektrik, për të dërguar faturat që kishin diskutuar në telefon tek DÇLP.</p> <p>Në shkresën nr. 527 Prot., datë 24.11.2021, drejtori i QFSHE, ka miratuar shkresën e specialistes për faturat dhe i ka dërguar Drejtorisë së Financës kopjet origjinale të faturave për muajt janar, shkurt e prill 2021. Në shkresë është cituar se pas aprovimit nga Drejtoria e Financës, faturat ti përcillen DÇLP. Në observacionin e z. R.Ç kjo shkresë bashkë ciklimin e Drejtorit të Departamentit, dhe citimin se faturat janë origjinale dhe për tu përdorur për procedurat gjyqësore, pretendohet se provojnë se faturat ishin aprovuar nga Drejtoria e Financës dhe se nuk mban përgjegjësi për veprimet e mëtejshme por shkresa e QFSHE i ishte drejtuar Drejtorisë së Financës dhe i kërkonte atyre verifikimin e faturave. Nga Drejtoria e Financës nuk ka pasur aprovim shkresor për faturat e cipërcituara. E pyetur për këtë çështje znj. A.B me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës ka deklaruar se i ka dërguar dorazi Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit kartelën financiare të kompanisë “B.....A”, por nuk i ka dërguar faturat tatimore të shitjes”.</p> <p>Gjykimi i grupit të auditimit është se Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, drejtori i Drejtorisë së Financës dhe ish-administratori i shoqërisë me veprime ose mosveprime kanë sjellë në dëm ekonomik nga shoqërisë Albpetrol sh.a në vlerën 14,613,456 lekë me TVSh.</p> <p>Së pari, ish drejtori i DÇLP z. R.Ç dhe kryespecialistja zj. A.LL, kanë kërkuar në shkresën Nr. 9401 prot. datë 23.11.2021, një database ku të jenë të listuara faturat me numër dhe datë, për të cilat do të kërkohej librat e blerjes së deklaruara nga shoqëria, fatura tatimore shitjeje, të cilat duhet të jenë të nënshkruara rregullisht nga të dyja palët dhe të dorëzohen me procesverbal në origjinal pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, ditarin/kartelën financiare/akt rakordimin e klientit, që është mbajtur nga kreditori dhe provon rakordimit midis palëve si dhe masën e detyrimit që përbën titull ekzekutiv.</p> <p>Nga këto dokumente të kërkuara Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, ka pasur katër fatura dhe një saldo totale të detyrimit, si dhe nga specialistja e financës i është dorëzuar dhe kartela financiare. Nga</p>			

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>shqyrtimi i kartelës financiare konstatohet se katër faturat (nr. 8, 38, 108 e 109) që janë bërë objekt i veprimeve gjyqësore janë likuiduar të gjitha deri më datë 16.07.2021, dhe të regjistruara në sistemin e kontabilitetit të shoqërisë. Z. R.Ç dhe znj. A.LL mund të bënin verifikimet në kartelë se faturat tatimore ishin likuiduar.</p> <p>Së dyti, drejtori i Drejtorisë së Financës, për çështje si likuidimin nga klientët ku është përgjegjës direkt, kërkesës së DÇLP për detyrimet e kontraktorit duhet ti përgjigjej me përgjegjshmëri, qartësi dhe saktësi. Gjendja debitore në një datë të caktuar nuk jep informacion të plotë dhe të saktë por nga kjo drejtori duhet të plotësohej një informacion i qartë shkresor me faturat e palikuiduara shoqëruar me detajet si dhe kamatëvonesat përkatëse të llogaritura.</p> <p>Drejtori i Drejtorisë së Financës A.B në momentin e pagesës së shumës 14,613,456 lekë me TVSh duhet të bënte verifikimet nëse ekzistonin kushtet për pagesën e tarifës dhe nëse faturat ishin të likuiduara ose të palikuiduara.</p> <p>Së treti, ish administratori në momentet që ka urdhëruar procedurat gjyqësore si dhe ka firmosur në lidhjen e kontratës me përmblyesin gjyqësor duhet të sigurohej me nëpunësen zbatuese për vërtetësinë e shkresave që firmoste.</p> <p>Nga shoqëria Albpetrol sh.a është likuiduar në llogarinë bankare të Zyrës së Përmblyesimit “E...P” shpk shuma 14,613,456 lekë me TVSH në datën 09.02.2022, sipas Kontratës së Shërbimit Nr.1113 prot. datë 04.02.2022 dhe Nr.27 prot. datë 04.02.2022, e lidhur midis Zyrës së Përmblyesimit “E...P” shpk. dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a.. Ky likuidim është kryer nga Drejtoria e Financës pa u verifikuar shlyerja e faturave tatimore të shitjes për të cilat ka dalë urdhri ekzekutiv dhe është në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12 , pika 3 germa “e” ku citohet: “Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: “pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi”.</p> <p>Në kushtet e pagesës së kontratës nuk janë përcaktuar pjesë si pagesa pas mbledhjes së detyrimit siç është bërë në kontrata të tjera, por është përcaktuar pagesë vetëm me paraqitjen e faturës tatimore nga ana zyrës përmblyesimor.</p> <p>Nga veprime e mosveprimet e ish drejtorit të DÇLP R.Ç dhe kryespecialistes A.LL, drejtorit të DF A.B dhe ish administratorit F. M shoqërisë Albpetrol sh.a i është krijuar një dëm ekonomik prej 14,613,456 lekë.</p> <p>Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10 296, datë 08/07/2010, “Për</p>			

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me Rregulloren e Brendshme të shoqërisë e miratuar me Vendimin Nr.20, datë 03.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës neni 64, paragrafi I Sektori i Financës, pika 37.			
37	<p>Gjatë periudhës 2021-2022, kompania B...M nuk ka kryer pagesat për energjinë elektrike. Për këto mospagesa Albpetrol sh.a. ka maturuar penalitete e kamatëvonesa. Gjatë vitit 2022 Albpetrol ka ndërmarrë veprime administrative duke marrë vendime gjykate si tituj ekzekutiv për faturat e papaguara. Gjithashtu është marrë si titull ekzekutiv dhe një faturë penalitetesh për mospagesat e faturave të energjisë elektrike. Llogaritja e kamatëvonesave është kryer sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”. Llogaritja bazuar në këtë ligj është më e vogël se kamatëvonesa që ka aplikuar O...E për faturat e papaguara nga Albpetrol sh.a. Vlera e kamatëvonesës së aplikuar nga O...E me atë që ka llogaritur Drejtoria Ekonomike e Albpetrol sh.a., përbën dëm ekonomik për shoqërinë.O...E sh.a. ka bërë një akt-rakordimi për detyrimet që ka Albpetrol sh.a., për principalin dhe kamatë vonesat.</p> <p>Ligji Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Neni 19, Përgjegjësitë e ERE-s, citon se është <i>ERE</i> që miraton dhe publikon, në përputhje me parimin e transparencës, metodologjitë e llogaritjes së tarifave të transmetimit, shpërndarjes, si dhe metodologjitë e tjera të aplikueshme si dhe kontratat mes palëve si dhe kamatëvonesat e aplikuar për çdo ditë vonesë.</p> <p>Shoqëria Albpetrol sha nuk ka pasqyruar në marrëdhëniet me shoqëritë koncesionare të gjitha detyrimet që i lindin nga kontratat që ka me Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU).</p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Albpetrol sha ka kërkuar kamatëvonesa për pagesat me vonesë të B.....A në vlerën 175,458,324 lekë, kur detyrimi që Albpetrol ka ndaj FSHU sha, për kontratat përkatëse për kamatëvonesa është 1,356,345,939 lekë. Vlera 1,180,887,615 përbën shpenzime jo të justifikuar nga Albpetrol sha.</p>	I lartë	233-252	Nga Albpetrol sha, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 1,180,887,615 lekë nga shoqëria B.....A.
38	<p>Nga grupi i auditimit konstatohet se në pesë raste punonjësit (në pozicione drejtuese) janë shkarkuar nga detyra me urdhër Administratori. Këta punonjës kanë ngritur padi dhe kanë nisur procese gjyqësore kundër Albpetrol SHA, duke detyruar shoqërinë të paguajë <i>dëmshpërblim</i> ndaj tyre në vlerën 11,977,746 lekë, si dhe <i>shpenzime gjyqësore dhe tarifë përmbarimi</i>, me urdhër sekuestro në vlerën 1,887,270 lekë.</p> <p>Këta punonjës janë ripunësuar në Albpetrol SHA (në pozicione drejtuese), përgjithësisht gjatë proceseve</p>	I lartë	233-252	Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të analizohet dëmi ekonomik në vlerën 14,486,894 lekë , dhe të marrë masa të menjëhershme për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore lidhur me dëmin ekonomik.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>gjqësore. Në asnjë rast nuk ka qenë objekt padie rikthimi i tyre në punë.</p> <p>-Në lidhje me proceset gjyqësorë në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësorë në apel, nga ku janë humbur 25 çështje gjyqësorë në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, si dhe janë humbur e janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë.</p> <p>-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet 42,600,758 lekë, nga ku shpezimet përmbarimore rezultojnë 3,931,821 lekë dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën 2,146,912 lekë.</p> <p>-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet 61,851,420 lekë, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë 6,272,200 lekë dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën 2,172,200 lekë.</p> <p>Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera 104,452,178 lekë e cila konsiderohet efektit financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.</p> <p>Vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe vlera shpenzimeve përmbarimore lidhur me ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatave dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar për çdo rast, duke rezultuar në pagesë të këtyre vlerave me urdhër sekuestro bankare, prej 14,486,894 lekë konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë.</p> <p>Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015, neni 155, pika 3) “<i>Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme, të pajustificuar, të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata, me kërkesë të punëmarrësit dhe duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos dëmshpërblimin, deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim.</i>”</p>			
39	<p>Lidhur me “Detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale” dhe “Kontributin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë paguar gjoba dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën 726,099 lekë, vlerë kjo që konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë Albpetrol SHA.</p> <p>Afatet e deklarimit dhe pagesës se kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë</p>	I lartë	233-252	Nga Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Financës të merren të analizohet situata dhe të ndiqen të gjitha procedurat lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën 726,099 lekë .

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</p> <p>Mos likuidimi sipas afateve ligjore të detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ka sjellë pasojë dem ekonomike në vlerën 726,099 lekë.</p>			
40	<p>- Nga auditimi i procedurës me objekt “<i>Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2022</i>”, rezultojnë se fondi limit është përcaktuar në vlerën 22,330,000 lekë për sigurimin e 1400 punonjësve sipas pozicioneve të punës, duke mos i përcaktuar sipas vështirësive të punës në terren.</p> <p>Gjithashtu nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore por dhe nga observacioni i paraqitur nga z. E.L me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore me shkresën nr. 11/103, datë 28.4.2023, në lidhje me numrin e punonjësve të siguruar sipas pozicioneve të renditura për vështirësi dhe sigurim jetë, ky numër nuk është 1400 pozicione por është 1338 pozicione, pra numri i punonjësve për të cilën është kërkuar të sigurohen është më i lartë për 62 punonjës duke rënduar padrejtësisht fondin limit për vlerën 928,388 lekë $\{(1400 - 1338) \times 14,917 \text{ primë sigurimi}\}$, veprime në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.</p> <p>- Nga auditimi i procedurës me objekt “<i>Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2021</i>”, rezultojnë se fondi limit është përcaktuar në vlerën 22,330,000 lekë për sigurimin e 1400 punonjësve sipas pozicioneve të punës, duke mos i përcaktuar sipas vështirësive të punës në terren.</p> <p>Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në lidhje me numrin e punonjësve të siguruar sipas pozicioneve të renditura për vështirësi dhe sigurim jetë, ky numër nuk është 1400 pozicione por është 1388 pozicione, konkretisht si vijon: <i>Operator te remontit nëntokësor, ndihmës operator te remontit, sondist, traktorist remonti, janë 75 punonjës.</i> <i>Elektracist te fushës ose terrenit, janë 43 punonjës.</i> <i>Saldator, janë 24 punonjës.</i></p>	I lartë	150-233	<p>Administratori i shoqërisë <i>Albpetrol sh.a Patos</i> të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës për llogaritje jo të saktë të fondit limit të procedurës me objekt “<i>Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2022</i>”, duke rënduar padrejtësisht për vlerën 1,129,788 lekë, nga e cila për vitin 2022 në vlerën 928,388 lekë dhe në vitin 2021 për vlerën 191,400 lekë.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>Drejtues Mjetesh Transporti Mallrash si dhe drejtuesit e mjeteve janë 72 punonjës.</i> <i>Manovratorë Mjetesh, vinçier, skrepist, buldozerist, e te ngjashëm janë 40 punonjës.</i> <i>Punonjësit e stacioneve Kuçovë ,Zharrëz, Gorisht, Usoje, Visoke, Stacioni i Gazit Fier janë 77 punonjës.</i> <i>Punonjësit e avarisë ne QEMNG janë 30 punonjës.</i> <i>Reparti i fonderisë, kovacanes, prodhimit te detaleve prej gome janë 13 punonjës.</i> <i>Brigada e likuidimit te avarive elektrike dhe ajo e linjave elektrike si dhe brigada e mjedisit janë 99 punonjës.</i> <i>Përgjegjës Turni, Operator Prodhimi, Ndihmës Operator Prodhimi, Operator Studimi, janë 486 punonjës</i> Dekantimi e të ngjashëm. <i>Fugist,Tornitor, Axhustator, Xhenerik, Mekanik Fushe dhe Mekanik Mjetesh janë 219 punonjës.</i> <i>Stafi inxhiniero-teknik janë 174 punonjës.</i> <i>Dega e Monitorimit te Brendshëm janë 18 punonjës</i> <i>Kontrolloret e pajisjeve te naftës, pranë qendrave te prodhimit janë 18 punonjës.</i></p> <p>Nga të dhënat evidentohet fakti se numri i punonjësve për të cilën është kërkuar të sigurohen është më i lartë për 12 punonjës (1400 – 1388) x 15,950 primë sigurimi), duke rënduar padrejtësisht fondin limit për vlerën 191,400 lekë, në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.</p>			
41	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të listpagesave në muaj të caktuar, rezultojnë se: Pagesa e orëve shtesë lidhur me ditët normale të punës, dhe në ditët e pushimit/festive, hartohet duke ndjekur hapat e mëposhtëm: -Kryespecialisti i secilës drejtori konceptohen shkresë për punën e kryer nga punonjësi/t e shoqërisë Albpetrol sh.a, -Drejtori i Drejtorisë pranon dhe konfirmohet nga Drejtori Organizativ ose Drejtori Teknik (sipas varësive të eprorëve përkatës), -Miratohet nga Administratori i shoqërisë.</p> <p>Pas kontrollit të dokumentacionit dhe rakordimit të formularëve me listëprezencën e orëve jashtë orarit (kopjet origjinale të firmosura nga eprorët përkatës), orët për çdo punonjës hidhen në sistemin e pagave, të ndara në ditë feste, të diela dhe orët normale. -Përlllogaritja për orët shtesë të punës që punëdhënësi duhet t’i paguajë punëmarrësit është shtesa prej 25% mbi pagën normale. Orët shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompensohen me një shtesë prej 50% mbi pagë normale. Vlera totale e orëve jashtë orarit për periudhën objekt auditimi rezultojnë në vlerën 4,412,419 lekë dhe</p>	I lartë	71-87	Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të analizojë efektin financiarë prej 4,412,419 lekë , si rezultat i kryerjes së pagesave në kundërshtim me urdhrin e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos nr. 5620prot, datë 12.8.2021 dhe korrigjimin e pagesave për orët shtesë sipas orëve dhe ditëve të punës.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>konsiderohet efektit financiar negativ</i> për buxhetin e shoqërisë.</p> <p>Sa më sipër bie në kundërshtim me Urdhri e Administratorit nr.5620 prot, datë 12.08.2021, ku përcaktohet se:</p> <p><i>“2.Kërkesat për miratimin e pagës për orët jashtë kohës normale të punës do t’i nënshtrohen procedurës së mëposhtme:</i></p> <p><i>-Qendra e Transportit dhe Furnizimit Patos, në çdo rast të marrjes së konfirmimit me e-mail nga QASHNG Patos, për çdo lëvizje mbas orarit 15:00 të produktit “Naftë Brut” me mjetet e shoqërisë, do të njoftojë për numrin e mjeteve dhe drejtuesit përkatës nëpërmjet e-mail zyrtar po atë ditë të marrjes së kërkesës Drejtorin Teknik, Drejtorin Organizativ dhe Administratorin.</i></p> <p><i>-Çdo javë QFT Patos do të përcjellë një evidencë për orët e kryera jashtë kohës normale të punës duke e shoqëruar dhe me dokumentacionin provues.</i></p> <p><i>-Mbas kryerjes së kësaj procedure konfirmimi, drejtoria e financës do të kryejë pagesën.</i></p> <p><i>3.Ndalimn e aplikimit për orë jashtë kohës normale të punës për punonjësit e Administratës për të cilët, në zbatim të Kodit të Punës, akteve nënligjore dhe Kontratës Kolektive në fuqi, do të trajtohen me ditë pushimi rast pas rasti.</i></p> <p><i>4.Përrjashtime do të ketë vetëm për punonjësit që do të angazhohen në detyra specifike, me Urdhër të posaçëm të Administratorit të shoqërisë.”</i></p>			
42	<p>Nga grupi i auditimit konstatohet se në pesë raste punonjësit (në pozicione drejtuese) janë shkarkuar nga detyra me urdhër Administratori. Këta punonjës kanë ngritur padi dhe kanë nisur procese gjyqësore kundër Albpetrol SHA, duke detyruar shoqërinë të paguajë dëmshpërblim ndaj tyre në vlerën 11,977,746 lekë, si dhe shpenzime gjyqësore dhe tarifë përmbarimi, me urdhër sekuestro në vlerën 1,887,270 lekë.</p> <p>Këta punonjës janë ripunësuar në Albpetrol SHA (në pozicione drejtuese), përgjithësisht gjatë proceseve gjyqësore. Në asnjë rast nuk ka qenë objekt padie rikthimi i tyre në punë.</p> <p>-Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, nga ku janë humbur 25 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, si dhe janë humbur e janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë.</p> <p>-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet 42,600,758 lekë, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë 3,931,821 lekë dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën 2,146,912 lekë.</p>	I lartë	71-87	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Jurike, Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të analizojnë efekti financiar negativ në shumën prej 104,452,178 lekë, si dhe të merren masa ndajë personave përgjegjës për shkëputjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, pasojë e sëcilës janë vendimet gjyqësore për dëmshpërblimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>-Për vitin 2021 vlera dëmshtëpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet 61,851,420 lekë, nga ku shpenzimet përmbartimore rezultojnë 6,272,200 lekë dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën 2,172,200 lekë.</p> <p>Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshtëpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera 104,452,178 lekë e cila konsiderohet efektit financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.</p> <p>Vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe vlera shpenzimeve përmbartimore lidhur me ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatave dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar për çdo rast, duke rezultuar në pagesë të këtyre vlerave me urdhër sekuestro bankare, prej 14,486,894 lekë konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë.</p> <p>Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015, neni 155, pika 3) “<i>Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme, të pajustificuar, të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata, me kërkesë të punëmarrësit dhe duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos dëmshtëpërblimin, deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim.</i>”</p>			
43	<p>Në auditimin e dokumentacionit në dosjen e procedurave dhe sistemin SPE, është konstatuar se në 10 procedura me fond limit 392,730 mijë lekë, OE të shpallur fitues nga KVO nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK. Nga KVO këto OE nuk duhej të ishin shpallur fitues dhe lidhur kontrata shërbimesh/punimesh, por duhej anuluar dhe zhvilluar procedura të tjera me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE në procedura për një përdorim me efektiv të fondeve të prokura për vlerën 392,730 mijë lekë, nga e cila: me efekt negativ me dëm në vlerën 10,364,872 lekë.</p> <p>Veprime në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “<i>Parimet e përzgjedhjeje</i>”, neni 98, “<i>Anulimi i një procedure</i>”, neni 76 “<i>Kriteret detyruese për skualifikim</i>”, neni 92, “<i>Shqyrtimi i ofertave</i>”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “<i>Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave</i>”, neni 67, “<i>Klasifikimi i ofertave</i>”, neni 83, “<i>Njoftimi i fituesit</i>”.</p>	I lartë	150-233	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike.</p> <p>Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësive publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
44	<p>Kontraktori “B.....”, ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021, nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se, detyrimi që shoqëria “B.....”, ka ndaj Albpetrol Sh.a. në naftë bruto, për llogari të P.... sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 24,939.596 (njëzet e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë pikë pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto.</p> <p>Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 21,100.41 (njëzet e një mijë e njëqind pikë dyzet e një) Ton naftë bruto.</p> <p>Pra, janë tërhequr rreth 3,839.186 (tre mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë pikë njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.</p> <p>Shoqëria “B.....”, me anë të shkresës me Nr. 329 Prot., datë 15.04.2022, protokolluar në Albpetrol me Nr. 3249 Prot., datë 20.04.2022 ka dërguar Llogaritjen e Faktorit R në fund të tremujorit të katërt të vitit 2021 (Q4-2021).</p> <p>Në bazë të përlllogaritjeve, Faktori R, për zonën “Main/Kryesore” rezulton më i madh se 1 (një) në fund të tremujorit të katërt të vitit 2021.</p> <p>Përsa më sipër, në përputhje me Nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” dhe Nenit 3.2 dhe 3.3 të Amendimit të Marrëveshjes Hidrokarbure, duke nisur nga Tremujori i katërt i vitit 2021, Pjesa e Prodhimit të Albpetrol (PPA), do të llogaritet nga 1% që është aktualisht, në 3% të naftës së disponueshme.</p> <p>Për vitin 2022, nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se, detyrimi që shoqëria “B.....”, ka ndaj Albpetrol Sh.a. në naftë bruto, për llogari të P.... sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 29,884.163 (njëzet e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëqind e gjashtëdhjetë e tre) Ton naftë bruto.</p> <p>Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 14,407.612 Ton naftë bruto. Pra, janë tërhequr rreth 15,476.551 (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë pesëqind e pesëdhjetë e një) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022.</p> <p>Detyrimi që shoqëria “B.....” ka ndaj Albpetrol sh.a. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) për periudhën nga data efektive deri me 31/12/2022 është 78,915.002 ton naftë bruto, me vlerë 39,247,000 USD. Këto veprime kanë sjellë ulje të të ardhurave nga kompania Albpetrol për sasinë e naftës bruto e cila nuk është tërhequr për pamundësi depozitimi.</p> <p>Për tu theksuar është dhe problemi se kur këto sasi të</p>	I lartë	252-293	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa për tërheqjen e sasisë 78,905.002 ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfutur nga marrëveshja hidrokarbure. Vlera e sasisë 78,905.002 ton me çmimet e deklaruara nga kontraktori është 39,247,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.</p> <p>Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	tërhiqen nga Albpetrol sha, çmimi mund të ulet duke sjellë dëm ekonomik për shoqërinë.			
45	<p>Kontraktori “A....” SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021, detyrimi që shoqëria “A....” SH.A., ka ndaj Albpetrol Sh.a. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 10,773.49 (dhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre pikë dyzet e nëntë) Ton naftë bruto. Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 7,816.946 (shtatë mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë nëntëqind e dyzet e gjashtë) Ton naftë bruto. Pra, janë tërhequr rreth 2,956.544 (dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë pesëqind e dyzet e katër) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.</p> <p>Për vitin 2022, detyrimi që shoqëria “A....” SH.A., ka ndaj Albpetrol Sh.a. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 9,794.455 (nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër pikë katërqind e pesëdhjetë e pesë) Ton naftë bruto.</p> <p>Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 8,570.083 (tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë pikë zero tetëdhjetë e tre) Ton naftë bruto. Pra, janë tërhequr rreth 1,224.372 Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022.</p> <p>Detyrimi që shoqëria “A....” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për periudhën nga 02.05.2018 deri më 31/12/2022 është 29,103.96 (njëzet e nëntë mijë e njëqind e tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë) ton naftë bruto. Vlera e sasisë 29,103.96 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 14,476,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.</p>	I lartë	252-293	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa, për tërheqjen e sasisë 29,103.96 ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe te Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfitur nga marrëveshja hidrokarbure.</p> <p>Vlera e sasisë 29,103.96 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 14,476,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.</p> <p>Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.</p>
46	<p>- Kontraktori D....., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Detyrimi që D..... ka ndaj Albpetrol SH.A., në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31 Dhjetor 2022, për vendburimin Delvinë Kondesat është 2,902.86 (dy mijë e nëntëqind e dy pikë tetëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto. Detyrimi që D..... ka ndaj Albpetrol SH.A., në gaz natyror për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31 Dhjetor 2022, për vendburimin Delvinë Gaz është 23,630,398.320 (njëzet e tre milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e</p>	I lartë	252-293	<p>Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë 2,902.86 ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe te Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, dhe 23,630,398.320 Nm³ Gaz, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfitur nga marrëveshja hidrokarbure.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	tetë pikë treqind e njëzet) Nm3 Gaz. Vlera e sasisë 2,902.86 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 1,443,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.			Vlera e sasisë 2,902.86 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 1,443,000 USD , dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë. Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.
47	<p>Kontraktori “T...SS” SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P..., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria “T...SS” SH.A., ka ndaj Albpetrol Sh.a. në naftë bruto, për llogari të P... dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 2,825.802 (dy mijë e tetëqind e njëzet e pesë pikë tetëqind e dy) Ton naftë bruto.</p> <p>Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P..., për vitin 2021, sasinë prej 657.793 Ton naftë bruto.</p> <p><i>Pra, janë tërhequr rreth 2,168.009 Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P..., për vitin 2021.</i></p> <p>Për vitin 2022 vërehet se, detyrimi që shoqëria “T...S” SH.A., ka ndaj Albpetrol Sh.a. në naftë bruto, për llogari të P... dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 2,558.788 (dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë pikë shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) Ton naftë bruto.</p> <p>Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P..., për vitin 2022, sasinë prej 2,011.008 (dy mijë e njëmbëdhjetë pikë zero tetë) Ton naftë bruto.</p> <p><i>Pra, janë tërhequr rreth 547.78 (pesëqind e dyzet e shtatë pikë shtatëdhjetë e tetë) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P..., për vitin 2022.</i></p> <p>Detyrimi që shoqëria “T...S” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a. në nafte bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për periudhën nga data efektive deri më 31/12/2022 është 10,332.89 (dhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy pikë tetëdhjetë e nëntë) ton nafte bruto.</p> <p>Vlera e sasisë 10,332.89 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 5,139,553 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.</p>	I lartë	252-293	<p>Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa, për tërheqjen e sasisë 10,332.89 ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha nafte të përfutuar nga marrëveshja hidrokarbure. Vlera e sasisë 10,332.89 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 5,139,553 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.</p> <p>Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.</p>
48	Kontraktori “F...M” SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P..., sipas	I lartë	252-293	Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Petrol të marrë

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria “F...M” SH.A., ka ndaj Albpetrol Sh.a. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. P...Z sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 75.997 (shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) Ton naftë bruto. Shoqëria “Albpetrol” SH.A. nuk e ka tërhequr këtë sasi naftë gjatë vitit 2021.</p> <p>Për vitin 2022 vërehet se, detyrimi që shoqëria “F...M” SH.A., ka ndaj Albpetrol Sh.a. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. P...Z sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 81.246 (tetëdhjetë e një pikë dyqind e dyzet e gjashtë) Ton naftë bruto. Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 41.201 (dyzet e një pikë dyqind e një) Ton naftë bruto.</p> <p><i>Pra, janë tërhequr rreth 40.045 (dyzet pikë zero dyzet e pesë) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022.</i></p> <p><i>Detyrimi që shoqëria “F...M” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. Pekishy-Murritz, për periudhën deri më 31/12/2022 është 52.185 (pesëdhjetë e dy pikë njëqind e tetëdhjetë e pesë) ton naftë bruto”.</i></p>			<p>masa, për tërheqjen e sasisë 52.185 ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe te Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. Vlera e sasisë 52.185 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 25,954 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.</p>
49	<p>Kontraktori “SH...M”, ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria “SH...M”, ka ndaj Albpetrol Sh.a. në naftë bruto, për llogari të P.... sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 606.437 (gjashtëqind e gjashtë pikë katërqind e tridhjetë e shtatë) Ton naftë bruto. Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 590.068 (pesëqind e nëntëdhjetë pikë zero gjashtëdhjetë e tetë) Ton naftë bruto. Pra, janë tërhequr rreth 16.369 (gjashtëmbëdhjetë pikë treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.</p> <p>Për vitin 2022 vërehet se, detyrimi që shoqëria SIPL., ka ndaj Albpetrol Sh.a. në naftë bruto, për llogari të P.... sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 548.17 (pesëqind e dyzet e tetë pikë shtatëmbëdhjetë) Ton naftë bruto.</p> <p>Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 567.949 (pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë nëntëqind e dyzet e nëntë) Ton naftë bruto.</p> <p><i>Pra, janë tërhequr rreth 19.779 (nëntëmbëdhjetë pikë shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) Ton naftë bruto më shumë nga detyrimi për P...., për vitin 2022.</i></p>	I lartë	252-293	<p>Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë 581.683 ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe te Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. Vlera e sasisë 581.683 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 289,300 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.</p> <p>Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>Detyrimi që shoqëria "SH...M", ka ndaj Albpetrol sh.a. në nafte bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31/12/2022 është 581.683 (pesëqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) ton nafte bruto".</i></p>			<p>produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.</p>

Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Albpetrol sh.a Patos për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet auditimit të hartimit dhe zbatimit të programit ekonomik financiar, mbi pagat dhe shpërblimet, në fushën e prokurimeve publike, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, dhe çështjeve të tjera që dalin gjatë auditimit. Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000.

*Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Albpetrol sh.a Patos, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kundërt** 1.*

Baza për opinionin e kundërt

Bazuar në punën e kryer të auditimit, evidencat e marra për veprimtarinë e Albpetrol sh.a Patos, rezultuan anomali, nga të cilat më kryesoret janë:

- Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar, duke sjelle mangësi në të gjithë elementët e tij kryesorë.
- Mos marrja e masave shtrënguese nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos, për arkëtimin e energjisë elektrike nga shoqëritë koncesionare në vlerën **3,013,481,000 lekë** së bashku me kamatëvonesat.
- Kryerja e pagesave për kompensimin ushqimor në kundërshtim me VKM nr. 68, datë 7.2.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore", pika 2, germa a), me efekt negativ në buxhetin e shoqërisë për vlerën **170,092,696 lekë**.
- U konstatuan shpenzime të cilat kanë sjellë efekte negative financiare në buxhetin e shoqërisë në vlerën **118,939,072 lekë**, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e vendime gjyqësore për largime nga puna të punonjësve në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, për shpërblime dietash me vlerë më të madhe se kufijtë e lejuar ligjorë, si dhe persona të punësuar mbi strukturën e aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

1 Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt, kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura.

- Kryera e shpenzimeve për shpërblim e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në shumën 6,371,520 lekë, në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit.

- Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real të gjendjes së “Llogari të pagueshme tregtare” (Furnitorët) në vlerën **10,043,406 mijë lekë** në të cilat janë të përfshira dhe llogari kreditore të subjekteve të cilët kanë kaluar afatin më shumë se **10 vite**. Aktualisht prej disa viteve ka kaluar afati i parashkrimit të detyrimeve, nuk ekziston asnjë kërkesë e subjekteve kreditore për shlyerje detyrimi dhe njëkohësisht është parashkruar afati për tu kërkuar në rrugë gjyqësore. Për më tepër qendrat nuk zotërojnë dokumentacionin provë për detyrimin e lindur. Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë vlerësuar risqet për pagesat e kreditorëve në afat për të shmangur kamatëvonesat apo penalitet të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë.

- Mos kryerja e veprimeve nga Administratori i shoqërisë për realizimin e procedurës së nxjerrjes së jashtë përdorimit të makineri e pajisje, mjete transporti dhe pajisje zyre dhe informatike, janë vlerësuar dhe propozuara për jashtë përdorimit, duke miratuar nxjerrjen jashtë përdorimit të **2214 copë** makineri e pajisje, mjete transporti dhe pajisje zyre dhe informatike me **vlerë të mbetur 96,264,022 lekë**.

- Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e “Llogarive të arkëtueshme tregtare” në vlerën **13,174,589 mijë lekë**.

- Nga Albpetrol sha është kërkuar kamatëvonesa për pagesat me vonesë të B.....A në vlerën 175,458,324 lekë, kur detyrimi që Albpetrol ka ndaj FSHU sha, për kontratat përkatëse për kamatëvonesa është 1,356,345,939 lekë. **Vlera 1,180,887,615 përbën shpenzime jo të pa justifikuara nga Albpetrol sha.**

- Kontraktori “B....” ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer auditet vjetore dhe rezultatet e tyre në vite janë kontestuar nga B...S dhe janë çuar për gjykim në Gjykatën e Arbitrazhit. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3,Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:
Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperushme për vitin 2020 për B.....A është 2,913,868 USD.

- Kontraktori “A....” SH.A. ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Ballsh-Hekal” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:
Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020 për A.... Sh.A është 71,306.21 USD.

- Detyrimi që D..... ka ndaj Albpetrol sh.a Patos., në gaz natyror për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën **nga data efektive deri më 31 Dhjetor 2022**, për vendburimin Delvinë Gaz është 23,630,398.320 (njëzet e tre milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë pikë treqind e njëzet) Nm3 Gaz. **Vlera e sasisë 2,902.86 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 1,443,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.**

- Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P....., për vitin 2022, sasinë prej 8,570.083 (tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë pikë zero tetëdhjetë e tre) Ton naftë bruto. Pra, **janë tërhequr rreth 1,224.372 Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P....., për vitin 2022.**

Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 29,884.163 (njëzet e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëqind e gjashtëdhjetë e tre) Ton naftë bruto.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P....., për vitin 2022, sasinë prej 14,407.612 Ton naftë bruto. Pra, **janë tërhequr rreth 15,476.551 (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë pesëqind e pesëdhjetë e një) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P....., për vitin 2022.**

Detyrimi që shoqëria "B...." ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) për periudhën nga data efektive deri më 31.12.2022 është 78,915.002 ton naftë bruto, me vlerë **39,247,000 USD**. Këto veprime kanë sjellë ulje të të ardhurave nga kompania Albpetrol për sasinë e naftës bruto e cila nuk është tërhequr për pamundësi depozitimi.

Detyrimi që shoqëria "A...." SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për periudhën nga 02.05.2018 deri më 31.12.2022 është 29,103.96 (njëzet e nëntë mijë e njëqind e tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë) ton naftë bruto. Vlera e sasisë 29,103.96 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është **14,476,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.**

- Nuk është kryer inventarizimi i plotë i aktiveve afatgjata dhe detyrimeve për periudha 2021 e 2022, duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre.

- Nga auditimi u konstatua se shoqëria në regjistrat e saj ka materiale të cilat janë stok ose me qarkullim të ngadalshëm për shkak të ndryshimit të teknologjisë apo kalimit të afatit të skadencës në vlerën **1,306,029 mijë lekë** për të cilat shoqëria ka njohur zhvlerësime vetëm për vlerën **137,487 mijë lekë** në periudha të mëparshme, **pra sipas SNK 2 "Inventarët"**, duhet të njihen dhe të pasqyrohen në kontabilitet për vlerën më të vogël.

- Janë konstatuar mangësi në emërimet e punonjësve, lëvizje paralele dhe largime të tyre pa procedurë të rregullt.

- Janë konstatuar shpenzime për karburant në vlerën 3,320,276 leke për të cilat mungon dokumentacioni justifikues, si dhe shpenzime të tjera për këtë zë në vlerën 2,126,154 lekë për drejtoritë e administratës qendrore, për të cilin edhe pse ka një miratim për kuotën e shpenzuar, dokumentacioni justifikues i shpenzimit nuk është i plotë.

- Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nuk ka krijuar komitetin për përcaktimin e standardeve për emërimin e Administratorit nga Asambleja e Përgjithshme, për përcaktimin e skemës së shpërbllimit individual të administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, si dhe për kontrollin financiar. Për periudhën e audituar janë emëruar katër administratorë, por në asnjë rast nuk është nënshkruar kontratë pune midis Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit të shoqërisë.

Në auditimin e **30** procedurave me fond limit 968, mijë lekë të vlerësuara për auditim, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **13 procedura** me fond limit 968,140 mijë lekë ose 82.7% e procedurave të audituara, shkelje të cilat kanë konsistuar në:

1. Në aplikimin e kriterëve jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën, veprime të cilat kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në garë dhe mos përdorimin me efektivitet të fondeve të prokuruar, evidentuar kjo në **10** procedura.

2. Në shpalljen fitues të OE me kriterë të paplotësuara sipas kërkesave të DST, evidentuar kjo në **12** procedura me fond limit 318,476 mijë lekë, nga e cila me efekt financiar **3** procedura me vlerë **10,364,872 lekë**.

3. Në mos llogaritje të saktë të fondit limit në përputhje me aktet ligjore, evidentuar kjo në **1** procedura, **veprime me efekt negativ në buxhet për vlerën 521,220 lekë**.

4. Në mos zbatimin e kushteve të kontratës, evidentuar kjo në **5** procedura, **veprime me efekt financiar me dëm ekonomik në shumën 13,650,616 lekë**.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos

Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe për përdorimin e këtyre fondeve me economicitet eficient dhe efektivitet etj.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Përgjegjësia jonë është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

-Të vlerësojmë nëse informacionet mbi çështjet e audituara janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryejmë në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300).

-Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).

-Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, si dhe në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1202/1, datë 16.01.2023 i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 17.01.2023 deri në datën 20.04.2023, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2022 në subjektin Albpetrol sh.a Patos, u krye auditimi “Mbi Auditimin e Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1. Z. K.GJ, Përgjegjës Grupi**
- 2. Z. B.SH, Auditues**
- 3. Z. P.GJ, Audituese**
- 4. Z. A.R, Auditues**
- 5. Zj. I.B, Auditues**

a- Qëllimi i auditimit: Qëllimi i auditimit është vlerësimi objektiv, profesional dhe i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi; vlerësimin dhe evidentimin e shkeljeve të parimeve të menaxhimit të shëndoshë financiar për miradministrimin e pasurisë shtetërore dhe fondeve publike.

b- Objektivi i auditimit: Dhënia një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me aktivitetin e subjektit, sipas pikave të programit të auditimit., si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

c-Identifikimi i çështjes: Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për periudhën objekt auditimi (01.01.2021 – 31.12.2022).

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi: Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, si dhe vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, pagat dhe shpërblimet, administrimi i marrëdhënieve të punës, hartimi, miratimi dhe realizimi i programit ekonomiko-financiar të shoqërisë, organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabël, hartimi dhe miratimi i bilancit, gjendja dhe ecuria e detyrimeve debitorë dhe kreditorë, derdhja e detyrimeve fiskale në buxhetit të shtetit, procesi i inventarizimit, dhënien dhe marrjen me qira të aseteve dhe zbatimi i kontratave të qirasë, veprimet e arkës dhe bankës, zbatimi i ligjshmërisë në procedurat e prokurimeve, të ankandeve për shitjen e naftës bruto, mbi zbatimin e detyrimeve të marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura me kompanitë e huaja që operojnë në sektorët e kërkimit dhe nxjerrjes së hidrokarbureve, zbatimi i ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të auditit të brendshëm, etj.

d-Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Është detyrimi i menaxherëve të shoqërisë që në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

-*Nëpunësi autorizues* është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale.

-*Nëpunësi zbatues* është personi përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

e-Përgjegjësitë e Audituesve: Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (*INTOSAI*), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*).

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (*ISSAI 1500, ISA 300*).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në *ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”*, si dhe *ISSAI 30 “Kodi Etik”*, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

f-Kriteret e vlerësimit

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Ligji nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.
- Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
- Ligji nr. 8438, datë 28/12/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 7853, datë 29/04/1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)” i ndryshuar me ligjin nr. 7853, datë 29/07/1994, ligjin nr. 8297 datë 04/03/1998, nr. 10137 datë 11/05/2009.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik”.
- Ligji nr. 7746, datë 28/08/1993 “Për kërkimin, zhvillimin, prodhimin, trajtimin, transportimin dhe shitjen e naftës bruto, gazit dhe rërave bituminoze brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9154, datë 06/11/2003, “Për arkivat”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9874, datë 14/02/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.
- VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- VKM nr. 68, datë 07/02/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”.
- Vendim nr. 570, datë 03/10/2018 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore”
- VKM nr. 54, datë 05/02/2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.
- VKM nr. 629, datë 15/07/2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre.
- VKM nr. 33, datë 19/01/2011, si dhe akti normativ i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 16.06.2010, i dalë në zbatim të ligjit nr. 7746, datë 28/07/1993 “Për hidrokarburet”, i ndryshuar.
- Statuti dhe Rregullorja e brendshme e shoqërisë.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve”, etj.

g-Standardet e auditimit

- ✓ ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ✓ ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ✓ ISSAI 4000 “Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- ✓ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
- ✓ INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.

Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.

Rregullore “Për Procedurat e Auditimit” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.107, datë 08/09/2017, i ndryshuar.

h-Metodat (Procedurat) e auditimit:

Metodat dhe teknikat e kontrollit me bazë risku të përdorura nga audituesit gjatë auditimit konkluduan në metodologjinë e aplikuar gjatë planifikimit në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Objektivi i Audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu

bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

Kontroll aritmetik që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.

Inspektim fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në auditimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.

Kontrolli i vlerësimit për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Intervistimi i personelit, pyetësorë te ndryshëm, etj.

i-Dokumentimi i auditimit. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion u konsiderua i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Dokumentimi i punës audituese në teren është bërë në aktet e mbajtura në subjektin e audituar. Me shkresën nr. 1202/15 *prot*, datë 19/05/2023, nga KLSH-ja është përcjellë subjektit Albpetrol sh.a Patos Projekt Raport Auditimi, për shqyrtim e gjetjet e konstatuara nga grupi i KLSH të cilat nuk janë argumentuar me observacionet e paraqitura nga subjekti në fazën e akt konstatimeve.

Me shkresën nr. 11/180 *prot*, datë 20/06/2023 (*prot KLSH nr. 1202/22, datë 22/06/2023*), nga subjekti Albpetrol SH.A Patos janë paraqitur kundërshti mbi Projekt Raport Auditimin të cilat pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga grupi i auditimit të KLSH, janë marrë në konsideratë ato që kishin mbështetjen ligjore dhe me dokumentacion mbështetës. Ndërsa për rastet e tjera kundërshtitë e paraqitura nuk argumentonin ligjërisht gjetjet e evidentuara nga grupi i KLSH, të cilat gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit për përmirësimin e punës në të ardhmen nëpërmjet rekomandimeve të evidentuara në Kapitullin IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos, funksionon si shoqëri me kapital 100% shtetëror, e themeluar më 6 Prill të vitit 1999, e cila trashëgoi të gjitha asetet dhe vendburimet e naftës në Shqipëri. Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Patosit ndërsa shoqëria ushtron aktivitetin e saj në qendrat e prodhimit në Fier, Ballsh, Kuçovë, Patos etj. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos është në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është kërkimi dhe prodhimi i hidrokarbureve, i cili përfshin ciklin e plotë të punimeve sizmike, gjeologjike, mekanike, gjeofizike, kërkimin, nxjerrjen, marketimin e naftës bruto në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarisë dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit si dhe çdo aktivitet tjetër të mundshëm në përputhje me interesat e saj. Gjithashtu Albpetrol sha është kompania shtetërore e ngarkuar me monitorimin e marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura me kompanitë koncesionare.

Prej vitit 2003 shoqëria Albpetrol sh.a Patos zotëron të drejtën e Furnizimit me energji elektrike të klientëve të kualifikuar; tregtimin e energjisë elektrike; transmetimin e gazit natyror. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos disponon leje mjedisore për veprimtari me diktim në mjedisë për vendburimet

e naftës në zonat Kuçovë, Patos-Marinëz (Drizë +Goran), Ballsh-Hekal, Amonicë-Gorisht, për vendburimet e gazit në zonën Divjakë- Lushnje, Frakull-Fier, Povelcë-Fier, Finiq-Sarandë, rrjeti i transmetimit të produkteve të naftës dhe të gazit, vendburimin e rërës bituminoze Kasnic-Fier, U...E dhe U...S.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

Pika 2.1 e programit. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, si dhe vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Titulli i gjetjes: *Mungesë dokumentacioni shoqërues mbi vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës.*

Situata:

Nga auditimi mbi vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë s Albpetrol sh.a Patos, rezulton se: Mungojnë dokumentacionet ose projekt vendimet e propozuara në Këshillin Mbikëqyrës të cilat kanë çuar në marrjen e vendimeve. Mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albpetrol sha për vendimet e datave 08.11.2022, 24.01.2022, 04.02.2022, 08.04.2022, 27.05.2022, 16.05.2022, 02.08.2022, 08.11.2022 dhe 15.12.2022.

-Nuk është nënshkruar kontratë pune midis Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorëve të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, B. Z., F. M., A. H. dhe K. C., veprim në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë. Është nënshkruar kontratë individuale pune nga Këshilli Mbikëqyrës, I. G., Kryetar i Këshillit dhe Administratorit aktual E. D, u konstatua se kontrata e nënshkruar është e pa protokolluar në shoqërinë Albpetrol sha.

Kriteri:

Statuti i shoqërisë Albpetrol sha, Kreu V, neni 25 “Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës”, pika 1 dhe 2 dhe Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 30, datë 04.12.2019, Kreu III, “Funksionimi i Shoqërisë”, Neni 15, “Marrëdhëniet me Këshillin Mbikëqyrës”, Pika 1, germa a dhe d.

Statuti i Shoqërisë Kreu IV, Neni 17, Emërimi i Administratorit, pika 1.

Ndikimi/efekti:

Nga mos informimi ose dërgimi i materialeve konkrete nga Shoqëria Albpetrol sh.a Patos, Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë vendime jo të sakta.

Shkaku:

Albpetrol sha nuk ka vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: I Lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që në të gjitha rastet e propozimeve për marrje vendimi nga Këshilli Mbikëqyrës, projekt vendimet të shoqërohen me dokumentacionin mbështetës për çdo çështje.

Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për lidhjen e kontratës së punës me Administratorin e Shoqërisë sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Titulli i gjetjes 2: *Konsumim i karburantit nga Këshilli Mbikëqyrës pa dokumentacion justifikues ligjor.*

Situata:

Me vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021, Administratori i shoqërisë ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil/benzine, ku tërheqja e kësaj sasive do të behej me tollona pranë magazinës së

Albpetrol nga drejtoria e përfaqësimit dhe koordinimit me institucionet. Në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për 7 muaj të vitit 2021.

Me vendimin nr. 5132 datë 28.07.2021, administratori ka shfuqizuar vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021 duke përcaktuar si kuotë mujore, për këshillin mbikëqyrës sasinë prej 1000 litra/gazoil/benzinë, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për një muaj.

Me vendimin nr. 5256 prot., datë 03.08.2021, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për muaj të vitit 2021. Me vendimin nr. 2529 prot., datë 24.03.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 250 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 5256/1 prot., datë 04.06.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 7911 prot., datë 31.10.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 1000 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës.

Të gjithë vendimet e sipërcituara baza ligjore e përdorur për dhënien e këtyre vendimeve nuk citon për miratimin e dhënies së kuotës mujore me karburant për llogari të Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu nuk është përcaktuar arsyeja e dhënies së sasisë së karburantit për Këshillin Mbikëqyrës dhe si do të justifikohet nga ana e Këshillit konsumi i karburantit të dhënë. Nga auditimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura nga Sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës nuk konstatohet të jenë kryer mbledhje në selinë e Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos por të gjitha mbledhjet ku Këshilli ka marrë vendime për shoqërinë janë mbajtur në Tiranë.

Pra vendimet e administratorit për periudhën respektive të ushtrimit të funksionit brenda periudhës së auditimit. Për sa me lart, vlera e karburantit e përfituar nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës është në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi, dhe nuk është parashikuar në asnjë akt rregullator, të shoqërisë Albpetrol. Nga ana e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe anëtarëve të tij, nuk është mbajtur ose administruar pranë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos asnjë dokumentacion justifikues ligjorë mbi dokumentimin e konsumit të karburantit. Vlera prej 3,320,276 lekë do të konsiderohet shpenzim për të cilat mungon dokumentacioni justifikues ligjor dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, dëm i cili duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit përfitues.

Kriteri:

Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Neni 160, pika 1, VKM nr. 570, datë 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, pika 6.

Ndikimi/efekti:

Përdorim pa EEE i fondeve në shumën 3,320,276 lekë.

Shkaku:

Albpetrol sha nuk ka vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: I Lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **3,320,276 lekë** nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të analizojë me kujdes vlerën **3,320,276 lekë** e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara për mos plotësimin me dokumentacion plotësues dhe justifikues të konsumit të karburantit nëpërmjet tollonave nga Këshilli Mbikëqyrës, si dhe marrjen e masave për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Titulli i gjetjes 3: Dieta të përfituara padrejtësisht.

Situata:

Nga auditimi i listë pagesave të administratës së shoqërisë Albpetrol sha për periudhën Maj-Shtator 2022, u konstatua se për këtë periudhë janë trajtuar me dieta K. C., me detyrë ish-Administrator i shoqërisë dhe L. L, me detyrë ish-shofer i Administratorit.

Vlerat e përfituara padrejtësisht janë si më poshtë:

Muaji	K. C.	L. L
Qershor	17,000 lekë	18,600 lekë
Korrik	20,000 lekë	26,200 lekë
Gusht	20,000 lekë	26,300 lekë
Shtator	20,000 lekë	22,800 lekë
Tetor	4,000 lekë	
TOTALI	81,000 lekë	93,900 lekë

Të dhënat Albpetrol sha

Vlera prej **174,900 lekë** përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, dëm i cili duhet të dëmshpërblehet nga K. C., me detyrë ish Administrator dhe L. L, me detyrë drejtues i mjetit të Administratorit.

Kriteri:

Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 10.

Ndikimi/efekti:

Përdorim pa EEE i fondeve në shumën 174,900 lekë.

Shkaku:

Albpetrol sha nuk ka vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: I Lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marri masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **174.900 lekë** nga K. C., me detyrë ish Administrator dhe L. L, me detyrë drejtues i mjetit të Administratorit.

Titulli i gjetjes 4: *Shpërblim i padrejtë i Këshillit Mbikëqyrës për anëtarët e tij.*

Situata:

Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar shpërblim për anëtarët e vet, në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit, pasi punonjësit të cilët kanë përfitur nga 1 pagë mujore të njëvleftshme me pagën e Administratorit të Albpetrol sha shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfitur
1	E.B	226,100
2	E.M	226,100
3	I. G.	226,100
4	L.O	226,100
5	R.B	226,100
	TOTALI	1,130,500

Për vlerën totale prej **1,130,500 lekë** të përfitur nga Këshilli Mbikëqyrës në trajtën e shpërblimit financiar, nuk provohet plotësisht bazueshmëri ligjore e përfitimit të tij. *Vlera prej 1,130,500 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili është në vlerën 226,100 lekë.*

Kriteri:

Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 5 “Interesat private”, pika 1/a.

Ndikimi/efekti:

Përdorim pa EEE i fondeve në shumën 1,130,500 lekë.

Shkaku:

Albpetrol sha nuk ka vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: I Lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marri masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 1,130,500 **lekë** nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës.

Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Titulli i gjetjes 5: *Shpërblim i padrejtë për punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në ankandet e shitjes së naftës.*

Situata:

Vendimi nr. 1796 prot., datë 12.03.2021 “Mbi miratimin e pagesës së shpërblimit të disa punonjësve të Albpetrol sha”. Ky vendim është marrë pas propozimit me shkresën nr. 1795 prot., datë 12.03.2021 mbi këtë shpërblim nga ana e 3 Drejtorive, Prokurimeve, Organizative dhe Juridike.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1	M.B	195,760
2	A.B	140,000
3	E.V	95,000
4	B.N	95,000
5	A.D	80,000
6	XH.H	95,000
	TOTALI	700,760

Vlera prej **700,760 lekë**, do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 2 paga shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1		280,000
2	R.Ç	280,000
3	D.H	210,000
4	E.B	280,000
5	E.T	230,000
6	S.K	380,000
7	A. H.	280,000
8	A.L	280,000
9	D.F	230,000
10	O.F	230,000
	TOTALI	2,680,000

Vlera prej **2,680,000 lekë** do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Vendimi nr. 3238 prot., datë 21.05.2021 “Mbi miratimin e pagesës së shpërblimit të disa punonjësve të Albpetrol sha”.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 2 paga shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1	M.B	195,760
2	A.B	140,000

3	E.V	95,000
4	B.N	95,000
5	A.D	160,000
6	S.S	230,000
7	A.P	380,000
8	R.Ç	0
9	D.H	210,000
10	H.GJ	280,000
11	E.T	0
12	S.K	0
13	A. H.	0
14	R.P	280,000
15	O.F	0
16	F.S	230,000
17	SH. H	230,000
	TOTALI	2,525,760

Vlera prej **2,525,760** lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Vendimi nr. 5129 prot., datë 27.07.2021 “Në kushtet e një pune intensive nga punonjësit e QEMNG Patos”.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1	H.LL	80,000
2	D.K	50,000
3	T.S	50,000
4	A.RR	50,000
5	P.K	45,000
6	T.SH	50,000
7	G.P	50,000
8	Y.B	45,000
9	E.M	45,000
	TOTALI	465,000

Vlera prej **465,000** lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga ana e punonjësve të shoqërisë Albpetrol sha është **6,371,520** lekë vlerë e cila do të konsiderohet dëm ekonomik për shoqërinë. Pasi personat përfitues nuk kanë kryer asnjë detyrë jashtë detyrave funksionale të tyre të mirpërcaktuara në rregulloren e shoqërisë.

Kriteri:

Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar “Kodi i Punës”, Kontratën kolektive të punës, Statutin e shoqërisë dhe Rregulloren e Brendshme.

Ndikimi/efekti:

Përdorim pa EEE i fondeve në shumën 6,371,520 lekë.

Shkaku:

Albpetrol sha nuk ka vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: I Lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marri masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **6,371,520** lekë nga personat përfitues.

Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Për sa më sipër është dërguar observacioni me nr. 11/179 prot., datë 19.06.2023 nga E. D. nga ana e të cilit pretendohet se:

Pretendimi i subjektit:

Unë, E.D, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë...në asnjë moment të periudhës, objekt auditimi, nuk kam dhënë asnjë shpërblim, por dua të argumentoj edhe nëse do të jepja...në disa raste të veçanta mund dhe ka të drejtë të ngrejë grupe pune të përbërë nga punonjës....duke patur parasysh rezultatin e arritur, u miratuan disa shpërblime me vendim të administratorit...

Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH^{-së}:

Lidhur me pretendimin e tuaj mbi shpërblimet e dhëna për shitjen e naftës, nuk është vendosur dokumentacion justifikues për punën e kryer nga ana e punonjësve, lidhur me pretendimin tuaj se kryerja e këtij procesi është jashtë natyrës së punës së punonjësve, ju sqarojme është detyrë funksionale e mirpërcaktuar në rregulloren e shoqërisë dhe për këtë arsye paguhet rregullisht për këtë detyrë.

Lidhur me pretendimin tuaj se udhëtimi në Milano për takimin me përfaqësuesit e zyrës së avokatisë është i justifikuar, ju sqarojmë se punonjësit që keni përcaktuar në këtë takim në asnjë moment nuk kanë qënë pjesë e grupit të punës të cilët kanë punuar ngushtësisht me studion ligjore C.... dhe si për pasojë me caktimin e këtyre punonjësve ju si Administrator keni rënduar buxhetin e shoqërisë. Observacioni juaj do të merret në konsideratë dhe në të ardhmen të mos përseriten raste të tilla.

Situata:

-Me shkresën nr. 7605 prot., datë 06.10.2021, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për paradhënie për pjesëmarrjen në konferencën me temë Eage delivering for the energy challenge today and tomorrow” në Amsterdam. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë: A. H., I.M, R.Ç, S.K, R.B. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për 7 ditë qëndrimi, dy ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 400 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 48,640 lekë në total për 5 punonjësit. *Vlera prej 400 € do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, me konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili është në vlerën 80€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 9,728 lekë.*

-Me shkresën nr. 831 prot., datë 27.01.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje në kurset e trajnimit Leadership & People Managment Skills dhe International Oil and G...S Explotation Contracts” në Londër. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë: znj. A. H., z. R.Ç, D.B, A.Z, I.K dhe Y.S. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për periudhën 20-28.03.2022, katër ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 960 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 117,504 lekë në total për 6 punonjësit. *Vlera prej 960 € do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili është në vlerën 160€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 19,584 lekë.*

-Me shkresën nr. 2054 prot., datë 04.03.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje në kursin e trajnimit Corrosion Control Oil and G...S Exploration Industry” në Londër. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë: E.DH, A.RR, S.LL, N.B dhe R.B. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për periudhën 05-12.06.2022, pesë ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 1000 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 120,600 lekë në total për 5 punonjësit. *Vlera prej 1000 € do të konsiderohet si efekt negativ financiar për Albpetrol sha, me konkretisht nga secili është në vlerën 200€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 24,120 lekë.*

Kriteri:

Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar. neni 5, pika 1. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 10.

Ndikimi/efekti:

Shpenzime pa efektivitet mbi buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha.

Shkaku:

Albpetrol sha nuk ka vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: I Lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të analizojë efektin financiar prej **286,744 lekë**, si rezultat i qëndrimit të punonjësve me tepër ditë jashtë vëndit se sa është përcaktuar në urdhrin e Administratorit.

Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Titulli i gjetjes 6: *Pjesëmarrje në takim me studion ligjore pa ftesë, ka sjellë rendimin e buxhetit të shoqërisë Albpetrol sha.*

Situata:

Bazuar në e-mailin e dërguar pranë Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure me datë 04.11.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje e punonjësve të shoqërisë Albpetrol sha, në takimin që do të zhvillohet me avokatët e studios ligjore C...., në kuadër të Arbitrazhit Ndërkombëtar kundër shoqërisë B....A” në Milano, Itali, drejtuar Administratorit. Nga ana e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sha është marrë vendimi me nr. 8219 prot., datë 10.11.2022 për marrjen pjesë në këtë takim, në e-mailin e dërguar nga studio ligjore C.... specifikohet se punonjësit që janë ftuar për të marrë pjesë janë I.K, J.S dhe A.Z. Punonjësit do të qëndrojnë nga data 29.11.2022 deri me 03.12.2022.

Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit të cilët kanë udhëtuar për në Milano janë: A.B, I.K, J.S, A.Z, A. H., dhe R.B.

Për punonjësit A.B, A. H. dhe R.B, pjesëmarrja në këtë takim nuk është e justifikuar pasi jo vetëm që nuk kanë qenë të ftuar në këtë takim por as nuk kanë qenë pjesë përbërëse e grupit i cili është marrë me këtë proces për të cilin është zhvilluar takimi, nuk arsyetohet nga ana e Administratorit të shoqërisë arsyeja e marrjes pjesë në këtë takim. Për këto arsye udhëtimi i kryer nga këto punonjës ka renduar buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha duke i shkaktuar efekt negativ financiar në vlerën 96,726 lekë.

Nga auditimi i të gjithë praktikave të udhëtimeve jashtë vëndit nuk vërtetohet nëse është paguar tarifa e regjistrimit në konferenca, nuk vërtetohet pjesëmarrja nga ana dokumentare dhe nuk vërtetohet nëse këta punonjës janë trajtuar financiarisht nga bonuset e trajnimit siç është specifikuar në vendimin e Administratorit, ku janë ngarkuar për dokumentimin e plotë të praktikës me kompanitë koncesionare Drejtoria e Marrëveshjeve, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Kabinetit.

Kriteri:

Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar. neni 5, pika 1. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 10.

Ndikimi/efekti:

Rendim i pajustificuar i buxhetit të shoqërisë Albpetrol sha në vlerën 96,726 lekë.

Shkaku: Albpetrol sha nuk ka vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: I Lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të analizojë efektin financiar prej **96,726 lekë**, si rezultat i qëndrimit të punonjësve me tepër ditë jashtë vëndit se sa është përcaktuar në urdhrin e Administratorit.

Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Për vitin 2021

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë Albpetrol sha, rezulton të jenë marrë 12 vendime të natyrave të ndryshme.

Për vitin 2022

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë Albpetrol sha, rezulton të jenë marrë 25 vendime të natyrave të ndryshme.

Nga auditimi i vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, u konstatuan me mungesa si më poshtë:
Mungojnë dokumentacionet ose projekt vendimet e propozuara në Këshillin Mbikëqyrës të cilat kanë çuar në marrjen e këtyre vendimeve, veprim në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 30, datë 04.12.2019, Kreu III, “*Funksionimi i Shoqërisë*”, Neni 15, “*Marrëdhëniet me Këshillin Mbikëqyrës*”, Pika 1, germa a dhe d. *Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi z. H.GJ me detyrë Drejtor i Kabinetit në shoqërinë Albpetrol sha.*

Nuk është nënshkruar kontratë pune midis Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorëve të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, B. Z., F. M., A. H. dhe K. C., veprim në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë Kreu IV, Neni 17 *Emërimi i Administratorit*, pika 1. *Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi Këshilli Mbikëqyrës, I. G., Kryetar., E.B, E.M, znj. L.O, anëtarë.*

Është nënshkruar kontratë individuale pune nga Këshilli Mbikëqyrës, I. G., Kryetar i Këshillit dhe Administratorit aktual E. D., u konstatua se kontrata e nënshkruar është e pa protokolluar në shoqërinë Albpetrol sha.

Mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albpetrol sha për vendimet e datave 08.11.2022, 24.01.2022, 04.02.2022, 08.04.2022, 27.05.2022, 16.05.2022, 02.08.2022, 08.11.2022 dhe 15.12.2022, *veprim në kundërshtim me Statutin e shoqërisë Albpetrol sha, Kreu V, neni 25 “Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës”, pika 1 dhe 2. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi sekretarja Këshilli Mbikëqyrës në shoqërinë Albpetrol sha, znj. R.B.*

Vendimet e marra nga Administratori dhe zbatimi i tyre

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi vendimmarrjen e Administratorit në shoqërinë Albpetrol sha, rezulton të jenë marrë vendime të natyrave të ndryshme.

Nga auditimi i vendimeve u konstatuan me shkelje vendimet si më poshtë:

-Vendimi nr. 1941 prot., datë 18.03.2021 “*Për miratimin e propozimit të Drejtorive të Albpetrol sha dhe shpërblimin e punonjësve të angazhuar në këtë proces pune me një pagë shpërblim*”. Bashkangjitur vendimit nuk ka relacione apo kërkesa nga i cili është marrë ky vendim.

U konstatua se vendimi i sipërcituar nuk është zbatuar nga ana e Drejtorisë së Financës në Albpetrol sha, lidhur me moszbatimin e urdhrin të Administratorit nuk u vendos asnjë dokumentacion justifikues ligjor për moszbatimin e tij. *Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi A.B, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës.*

-Vendimi nr. 1796 prot., datë 12.03.2021 “*Mbi miratimin e pagesës së shpërblimit të disa punonjësve të Albpetrol sha*”. Ky vendim është marrë pas propozimit me shkresën nr. 1795 prot., datë 12.03.2021 mbi këtë shpërblim nga ana e 3 Drejtorive, Prokurimeve, Organizative dhe Juridike.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1	M.B	195,760
2	A.B	140,000
3	E.V	95,000
4	B.N	95,000
5	A.D	80,000
6	XH.H	95,000
	TOTALI	700,760

Vlera prej 700,760 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi B. Z., me detyrë Administrator i shoqërisë Albpetrol sha.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 2 paga shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1		280,000
2	R.Ç	280,000
3	D.H	210,000
4	E.B	280,000
5	E.T	230,000
6	S.K	380,000
7	A. H.	280,000
8	A.L	280,000
9	D.F	230,000
10	O.F	230,000
	TOTALI	2,680,000

Vlera prej 2,680,000 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi B. Z., me detyrë Administrator i shoqërisë Albpetrol sha.

-Vendimi nr. 3238 prot., datë 21.05.2021 “Mbi miratimin e pagesës së shpërblimit të disa punonjësve të Albpetrol sha”.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 2 paga shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1	M.B	195,760
2	A.B	140,000
3	E.V	95,000
4	B.N	95,000
5	A.D	160,000
6	S.S	230,000
7	A.P	380,000
8	R.Ç	0
9	D.H	210,000
10	H.GJ	280,000
11	E.T	0
12	S.K	0
13	A. H.	0
14	R.P	280,000
15	O.F	0
16	F.S	230,000
17	SH. H	230,000
	TOTALI	2,525,760

Vlera prej 2,525,760 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi B. Z., me detyrë Administrator i shoqërisë Albpetrol sha.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë mujore të njëvleftshme me pagën e Administratorit të Albpetrol sha shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1	E.B	226,100
2	E.M	226,100
3	I. G.	226,100
4	L.O	226,100
5	R.B	226,100
	TOTALI	1,130,500

U konstatua se Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar shpërblim për anëtarët e vet, në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 5 “Interesat private”, pika 1/a, ku citohet: “Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre”. Për vlerën totale prej 1,130,500 lekë të përfituar nga Këshilli Mbikëqyrës në trajtën e shpërblimit financiar, nuk provohet plotësisht bazueshmëri ligjore e përfitimit të tij. *Vlera prej 1,130,500 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili është në vlerën 226,100 lekë. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, I. G., Kryetar, E.B., E.M, L.O, anëtarë, dhe R.B, sekretare e Këshillit Mbikëqyrës.*

-Vendimi nr. 5129 prot., datë 27.07.2021 “Në kushtet e një pune intensive nga punonjësit e QEMNG Patos”.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1	H.LL	80,000
2	D.K	50,000
3	T.S	50,000
4	A.RR	50,000
5	P.K	45,000
6	T.SH	50,000
7	G.P	50,000
8	Y.B	45,000
9	E.M	45,000
	TOTALI	465,000

Vlera prej 465,000 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi z. B. Z., me detyrë Administrator i shoqërisë Albpetrol sha.

Nga auditimi i vendimeve të Administratorit të Albpetrol sha rezulton se janë kryer disa udhëtime jashtë vendit, trajtuar më hollësisht si më poshtë:

Me shkresën nr. 7605 prot., datë 06.10.2021, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për paradhënie për pjesëmarrjen në konferencën me temë Eage delivering for the energy challenge today and

tomorrow” në Amsterdam, drejtuar Drejtorisë së Financave dhe miratuar nga Administratori. Nga ana e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sha janë dhënë autorizimet përkatëse për marrjen pjesë në këtë konferencë, ku specifikohet se punonjësit do të qëndrojnë për një periudhë 5 ditore. Gjithashtu specifikohet se Shoqëria Albpetrol sha nëpërmjet Bonusit të trajnimit nga kompanitë koncesionare merr përsipër pagesën e plotë për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit/akomodimit/dietave/etj. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë: A. H., I.M, R.Ç, S.K, R.B.

-Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për 7 ditë qëndrimi, dy ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 400 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 48,640 lekë në total për 5 punonjësit. *Vlera prej 400 € do të konsiderohet si efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, me konkretisht nga secili është në vlerën 80€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 9,728 lekë.*

Me shkresën nr. 831 prot., datë 27.01.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje në kurset e trajnimit Leadership & People Managment Skills dhe International Oil and G...S Explotation Contracts” në Londër , drejtuar Administratorit. Nga ana e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sha është marrë vendimi me nr. 832 prot., datë 27.01.2022 për marrjen pjesë në këtë konferencë, ku specifikohet se punonjësit do të qëndrojnë nga data 21-25.03.2022. Gjithashtu specifikohet se Shoqëria Albpetrol sha nëpërmjet Bonusit të trajnimit nga kompanitë koncesionare, është ngarkuar Drejtoria e Marrëveshjeve, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Kabinetit për kryerjen e procedurave të regjistrimit për pjesëmarrjen në konferencë, të përlllogaritjeve të shpenzimeve si dhe njoftimit për Kontraktorin i cili do të mundësojë financimin për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara. Me vendimin nr. 2333 prot., datë 16.03.2022 është bërë ndryshimi i punonjësit E.M me punonjësin D.B. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë: A. H., R.Ç, D.B, A.Z, I.K dhe Y.S.

-Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për periudhën 20-28.03.2022, katër ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 960 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 117,504 lekë në total për 6 punonjësit. Gjithashtu nuk vërtetohet nëse është paguar tarifa e regjistrimit për këtë konferencë, nuk vërtetohet pjesëmarrja nga ana dokumentare dhe nuk vërtetohet nëse këta punonjës janë trajtuar financiarisht nga bonuset e trajnimit siç është specifikuar në vendimin e Administratorit. *Vlera prej 960 € do të konsiderohet si efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht është në vlerën 160€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 19,584 lekë.*

Me shkresën nr. 2054 prot., datë 04.03.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje në kursin e trajnimit Corrosion Control Oil and G...S Exploration Industry” në Londër, drejtuar Administratorit. Nga ana e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sha është marrë vendimi me nr. 2367 prot., datë 16.03.2022 për marrjen pjesë në këtë konferencë, ku specifikohet se punonjësit do të qëndrojnë nga data 22-26.05.2022. Me vendimin nr. 2788 prot., datë 05.04.2022 është bërë ndryshimi i vendimit me nr. 2367 prot., datë 16.03.2022 duke shtuar si pjesëmarrës edhe R.B me detyrë sekretare e Këshillit Mbikëqyrës dhe shfuqizimi i këtij vendimi për shkak të pamundësisë së marrjes në kohë të vizave për në Britaninë e Madhe. Gjithashtu specifikohet se Shoqëria Albpetrol sha nëpërmjet Bonusit të trajnimit nga kompanitë koncesionare, është ngarkuar Drejtoria e Marrëveshjeve, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Kabinetit për kryerjen e procedurave të regjistrimit për pjesëmarrjen në konferencë, të përlllogaritjeve të shpenzimeve si dhe njoftimit për Kontraktorin i cili do të mundësojë financimin për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara, ku specifikisht do të mbulohen shpenzimet ditore, të udhëtimit, vizat dhe akomodimi,

ku specifikohet se punonjësit do të qëndrojnë nga data 06-10.06.2022. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë : E.DH, A.RR, S.LL, N.B dhe znj. R.B.

-Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për periudhën 05-12.06.2022, pesë ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 1000 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 120,600 lekë në total për 5 punonjësit.

Gjithashtu nuk vërtetohet nëse është paguar tarifa e regjistrimit për këtë konferencë, nuk vërtetohet pjesëmarrja nga ana dokumentare dhe nuk vërtetohet nëse këta punonjës janë trajtuar financiarisht nga bonuset e trajnimit siç është specifikuar në vendimin e Administratorit. *Vlera prej 1000 € do të konsiderohet si efekt negativ financiar buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht nga secili është në vlerën 200€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 24,120 lekë.*

Bazuar në e-mailin e dërguar pranë Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure me datë 04.11.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje e punonjësve të shoqërisë Albpetrol sha, në takimin që do të zhvillohet me avokatët e studios ligjore C...., në kuadër të Arbitrazhit Ndërkombëtar kundër shoqërisë B.....A” në Milano, Itali, drejtuar Administratorit. Nga ana e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sha është marrë vendimi me nr. 8219 prot., datë 10.11.2022 për marrjen pjesë në këtë takim, në e-mailin e dërguar nga studio ligjore C.... specifikohet se punonjësit që janë ftuar për të marrë pjesë janë I.K, J.S dhe A.Z. Punonjësit do të qëndrojnë nga data 29.11.2022 deri me 03.12.2022.

Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit të cilët kanë udhëtuar për në Milano janë: A.B, I.K, J.S, A.Z, znj. A. H., dhe znj. R.B.

Për punonjësit A.B, znj. A. H. dhe znj. R.B, pjesëmarrja në këtë takim nuk është e justifikuar pasi jo vetëm që nuk kanë qenë të ftuar në këtë takim por as nuk kanë qenë pjesë përbërëse e grupit i cili është marrë me këtë proces për të cilin është zhvilluar takimi, nuk arsyetohet nga ana e Administratorit të shoqërisë arsyeja e marrjes pjesë në këtë takim. Për këto arsye udhëtimi i kryer nga këto punonjës ka renduar buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha.

Nga auditimi i të gjithë praktikave të udhëtimeve jashtë vendit nuk vërtetohet nëse është paguar tarifa e regjistrimit në konferenca, nuk vërtetohet pjesëmarrja nga ana dokumentare dhe nuk vërtetohet nëse këta punonjës janë trajtuar financiarisht nga bonuset e trajnimit siç është specifikuar në vendimin e Administratorit, ku janë ngarkuar për dokumentimin e plotë të praktikës me kompanitë koncesionare Drejtoria e Marrëveshjeve, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Kabinetit. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar. **neni 5, pika 1.** Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, **pika 10. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi znj. A.B, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës, I.K, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Marrëveshjeve Hidrokarbure, A.B, me detyrë Drejtor Organizativ.**

Për sa trajtuar më lartë për udhëtimet jashtë vendit efekti negativ financiar ndaj buxhetit të shoqërisë Albpetrol sha në total është 383,598 lekë.

Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar padrejtësisht
R.B	66,090 lekë
A. H.	61,554 lekë
R.Ç	29,312 lekë
I.K	19,584 lekë
A.Z	19,584 Lekë
D.B	19,584 Lekë

Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar padrejtësisht
S.K	9,928 lekë
I,M	9,728 Lekë
E.DH	24,120 Lekë
A,RR	24,120 Lekë
S.LL	24,120 Lekë
N.B	24,120 Lekë
A.B	32,242 Lekë
Y.S	19,584 Lekë
TOTALI	383,598 lekë

Vlera prej 383,598 lekë do të konsiderohet si efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sha nga Administratorët e shoqërisë me vendimet e tyre. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi z. F. M., z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i shoqërisë Albpetrol sha.

U konstatua se në shumicën e udhëtimeve jashtë vendit pjesëmarrëse është edhe sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës znj. R.B, pjesëmarrja e znj. B. nuk është e justifikuar pasi nuk është punonjëse e shoqërisë Albpetrol sha por është punonjëse e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu detyra e saj funksionale është e përcaktuar qartë se nuk është përfaqësuese e Këshillit Mbikëqyrës, përfaqësues të Këshillit Mbikëqyrës janë vetëm anëtarët e tij siç është përcaktuar qartë në Statutin e shoqërisë Albpetrol sha. Nuk ka asnjë arsye përse Administratori i shoqërisë urdhëron që sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës të marrë pjesë në konferenca të ndryshme me shpenzimet e shoqërisë Albpetrol sha përderisa sekretarja e Këshillit ka vetëm detyrën e mbajtjes së dokumentacionit mbi Këshillin Mbikëqyrës dhe asnjë detyrë apo kontribut tjetër në shoqërinë Albpetrol sha, caktimi i sekretares së Këshillit rëndon shpenzimet e shoqërisë Albpetrol sha. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi z. F. M., z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i shoqërisë Albpetrol sha.

Me vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021, administratori i shoqërisë ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil/benzine, ku tërheqja e kësaj sasive do të bëhet me tollona pranë magazinës së Albpetrol nga drejtoria e përfaqësimit dhe koordinimit me institucionet. Në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për 7 muaj të vitit 2021.

Me vendimin nr. 5132 datë 28.07.2021, administratori ka shfuqizuar vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021 duke përcaktuar si kuotë mujore, për këshillin mbikëqyrës sasinë prej 1000 litra/gazoil/benzinë, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për një muaj.

Me vendimin nr. 5256 prot., datë 03.08.2021, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për muaj të vitit 2021. Me vendimin nr. 2529 prot., datë 24.03.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 250 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 5256/1 prot., datë 04.06.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 7911 prot., datë 31.10.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 1000 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës.

Të gjithë vendimet e sipërcituara baza ligjore e përdorur për dhënien e këtyre vendimeve nuk citon për miratimin e dhënies së kuotës mujore me karburant për llogari të Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu nuk është përcaktuar arsyeja e dhënies së sasisë së karburantit për Këshillin Mbikëqyrës dhe si do të justifikohet nga ana e Këshillit konsumi i karburantit të dhënë. Nga auditimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura nga Sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës nuk konstatohet të jenë kryer mbledhje në selinë e Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos por të gjitha mbledhjet ku Këshilli ka marrë vendime për shoqërinë janë mbajtur në Tiranë.

Pra vendimet e administratorit për periudhën respektive të ushtrimit të funksionit brenda periudhës së auditimit, ***bien në kundërshtim me:***

Ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Neni 160, pika 1, VKM nr. 570, datë 03/10/2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, pika 6. Për sa me lart, vlera e karburantit e përfituar nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës është në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi, dhe nuk është parashikuar në asnjë akt rregullator, të shoqërisë Albpetrol. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Administratorët e shoqërisë Albpetrol sha, z. B. Z., z. F. M., znj. A. H., z. K. C. dhe E. D..*

Nga ana e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe anëtarëve të tij, nuk është mbajtur ose administruar pranë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos asnjë dokumentacion justifikues ligjorë mbi dokumentimin e konsumit të karburantit, **veprim në kundërshtim me** Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, **pika 10**.

Karburanti i tërhequr nga magazina e Albpetrol sh.a Patos është tërhequr nga z. S.SH me detyrë Drejtues Mjeti, znj. R.B, me detyrë Sekretare e Këshillit mbikëqyrës dhe R.Ç, me detyrë ish Drejtor i Çështjeve Ligjore, për llogari të Këshillit Mbikëqyrës. Trajtuar më hollësisht si më poshtë:

Muaji	Punonjësi që ka tërhequr	Litrat e tërhequra	Vlera në Lekë
Janar	S.SH	1000	155,160
Shkurt	S.SH	1000	164,004
Mars	S.SH	1000	167,700
Prill	S.SH	1000	167,700
Maj	S.SH	1000	169,800
Qershor	S.SH	500	85,104
Korrik	S.SH	500	87,000
Gusht	S.SH	500	88,002
Shtator	S.SH	500	86,682
Tetor	S.SH	500	88,998
Nëntor	S.SH	500	94,386
Dhjetor	S.SH	500	93,408
TOTALI		8500 litra	1,447,944 lekë

Të dhënat për vitin 2021

Muaji	Punonjësi që ka tërhequr	Litrat e tërhequra	Vlera në Lekë
Janar	S.SH	500	92,808
Shkurt	R.Ç	500	99,300
Mars	S.SH	500	101,412
Prill	S.SH	250	57,018
Maj	S.SH	250	58,577
Qershor	S.SH	250	59,217
Korrik	R.B	1000	238,920
Gusht	R.B	1000	225,996
Shtator	R.B	1000	233,076
Tetor	R.B	1000	245,004
Nëntor	R.B	1000	240,000
Dhjetor	R.B	1000	221,004
TOTALI		8250 litra	1,872,332 lekë

Të dhënat për vitin 2022

Vlera prej 3,320,276 lekë do të konsiderohet shpenzim për të cilat mungon dokumentacioni justifikues ligjor dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, dëm i cili duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit përfitues. *Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, z. I. G., Kryetar, z. E.B, znj. E.M, znj. L.O, anëtarë, znj R.B, sekretare e Këshillit Mbikëqyrës, R.Ç, me detyrë ish Drejtor i Çështjeve Ligjore dhe z. S.SH, me detyrë Drejtues Mjeti.*

Nga auditimi i listë pagesave të administratës së shoqërisë Albpetrol sha për periudhën Maj-Shtator 2022, u konstatua se për këtë periudhë janë trajtuar me dieta z. K. C., me detyrë ish-administrator i shoqërisë dhe L. L, me detyrë ish-shofer i Administratorit. Veprim i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, “Regjistrimet kontabël justifikohen me dokumentet kontabël, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 10, “Çdo menaxher, nëpunës apo punonjës i njësisë publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre sipas kompetencave që mbulon, duke dokumentuar veprimet e ndërmarra prej tij për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka nën përgjegjësi”.

Vlerat e përfituara padrejtësisht janë si më poshtë:

Muaji	K. C.	L. L
Qershor	17,000 lekë	18,600 lekë
Korrik	20,000 lekë	26,200 lekë
Gusht	20,000 lekë	26,300 lekë
Shtator	20,000 lekë	22,800 lekë
Tetor	4,000 lekë	
TOTALI	81,000 lekë	93,900 lekë

Të dhënat Albpetrol sha

Vlera prej 174,900 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, dëm i cili duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit përfitues. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi z. K. C., me detyrë ish-Administrator, z. L. L, me detyrë shofer i ish-Administratorit dhe znj. A.B, me detyrë Drejtor Finance.

Pika 2.2 e programit. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe administrimi i marrëdhënieve të punës.

- Struktura Organizative

Për sa i përket strukturës organizative të Albpetrol sh.a Patos, konstatohet se kjo strukturë është ndryshuar, si më poshtë:

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 26.12.2019, është miratuar ndryshimi i pagave të punonjësve të qendrave të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, marrëdhënia financiare e të cilave fillon më 1 Janar 2020.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 24.01.2022, janë miratuar 2 ndryshime në strukturën organizative të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, ku janë shtuar pozicionet: Koordinator i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit dhe Drejtor për Marrëdhëniet me Komunitetin dhe Çështjet Mjedisore, brenda numrit total të punonjësve të miratuar.

-Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 1192/1, datë 11.02.2022 “Mbi miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë “Albpetrol sh.a Patos”, janë miratuar nga aksionari 2 shtesat e mësipërme brenda numrit total të punonjësve të miratuar.

Gjatë periudhës objekt auditimi konstatohet se në nivel drejtues janë bërë këto ndryshime:

-Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 18.03.2021 është larguar nga detyra Administratori i Albpetrol sh.a Patos z. B.Z.

-Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 18.03.2021 është emëruar Administrator i Albpetrol sh.a Patos.

- Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 30.07.2021 është larguar nga detyra Administratori i Albpetrol sh.a Patos.
- Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 30.07.2021 është emëruar Administrator i Albpetrol sh.a Patos z. F.M.
- Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 01.04.2022 është larguar nga detyra Administratori i Albpetrol sh.a Patos z. F.M.
- Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 6, datë 01.04.2022 është komanduar Administratore e Albpetrol sh.a Patos znj. A. H.
- Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 10, datë 04.05.2022 është larguar nga detyra Administratori i Albpetrol sh.a Patos znj. A. H.
- Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 04.05.2022 është emëruar Administrator i Albpetrol sh.a Patos z. K. C.
- Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 16, datë 05.10.2022 është larguar nga detyra Administratori i Albpetrol sh.a Patos z. K. C.
- Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 7473/4, datë 13.10.2022 është emëruar Administrator i Albpetrol sh.a Patos E. D.

Ndryshimet e shpeshta në drejtimin e Albpetrol sh.a Patos, kanë sjellë për pasojë emërimin dhe shkarkimin nga detyra të 35 drejtorëve të drejtorive të kësaj shoqërie për vitin 2021 dhe 24 drejtorë drejtorie për vitin 2022.

Po ashtu për vitin 2021 janë emëruar 172 punonjës dhe janë larguar 179 punonjës. Për vitin 2022 janë emëruar 115 punonjës dhe janë larguar 154 punonjës.

Për vitin 2021 shkaqet e largimeve nga detyra janë: largime nga puna me motivacion shkelje disiplinore / mungesë në vendin e punës 21%, dalje në pension 41%, dhe dorëheqje 15%.

Për vitin 2022 shkaqet e largimeve nga detyra janë: largime nga puna me motivacion shkelje disiplinore / mungesë në vendin e punës 24%, dalje në pension 51%, dhe dorëheqje 20%.

Ndryshimet e shpeshta të Administratorëve dhe të drejtorëve të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, rrezikojnë të sjellin pasiguri dhe performancë të ulët te punonjësit e shoqërisë për shkak të paqëndrueshmërisë në vendin e punës. Vihet re trendi rritës i pushimeve nga puna dhe dorëheqjeve, që për pasojë ka rezultuar në kosto shtesë në procese gjyqësore, dëmshpërblime për largimin e padrejtë nga puna, duke rënduar kështu situatën ekonomiko - financiare të kësaj shoqërie.

Për sa më sipër për ndryshimet e shpeshta në strukturën organizative mbajnë përgjegjësi, në cilësinë e anëtarëve dhe ish – anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës z. I.GJ, z. E.M, z. G.L, z. E.N, znj. L.O, z. S.K, znj. F.K, në cilësinë e ish Administratorëve të Albpetrol sh.a Patos z. B.Z, z. F.M, z. K. C., në cilësinë e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos E. D.

Titulli gjetjes 1: <i>Ndryshimet e shpeshta në drejtimin e Albpetrol sh.a Patos.</i>

Situata:

Ndryshimet e shpeshta në drejtimin e Albpetrol sh.a Patos, për periudhën objekt auditimi janë emëruar dhe shkarkuar 6 Administratorë, kjo ka sjellë për pasojë emërimin dhe shkarkimin nga detyra të 35 drejtorëve të drejtorive të kësaj shoqërie për vitin 2021 dhe 24 drejtorë drejtorie për vitin 2022.

Po ashtu për vitin 2021 janë emëruar 172 punonjës dhe janë larguar 179 punonjës. Për vitin 2022 janë emëruar 115 punonjës dhe janë larguar 154 punonjës.

Për vitin 2021 shkaqet e largimeve nga detyra janë: largime nga puna me motivacion shkelje disiplinore / mungesë në vendin e punës 21%, dalje në pension 41%, dhe dorëheqje 15%.

Për vitin 2022 shkaqet e largimeve nga detyra janë: largime nga puna me motivacion shkelje disiplinore / mungesë në vendin e punës 24%, dalje në pension 51%, dhe dorëheqje 20%.

Kriteri: Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe të Administratorëve.

Ndikimi/Efekti:

Ndryshimet e shpeshta të Administratorëve dhe të drejtorëve të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, rrezikojnë të sjellin pasiguri dhe performancë të ulët te punonjësit e shoqërisë për shkak të paqëndrueshmërisë në vendin e punës. Vihet re trendi rritës i pushimeve nga puna dhe dorëheqjeve, që për pasojë ka rezultuar në kosto shtesë në procese gjyqësore, dëmshtëpërblime për largimin e padrejtë nga puna, duke rënduar kështu situatën ekonomiko - financiare të kësaj shoqërie.

Shkaku:

Emërimet dhe shkarkimet e pajustificuara të administratorëve dhe strukturave drejtuese.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të analizohet situata e lëvizjeve të shumta të punonjësve dhe të strukturave drejtuese dhe të merren masa lidhur me qëndrueshmërinë e punonjësve duke përmirësuar performancën e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

-Është hartuar Rregullorja e Brendshme, miratuar nga Administratori me nr. 37 prot, datë 05.01.2021.

-Marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 10645 prot., datë 22.11.2019 midis Albpetrol sh.a Patos të përfaqësuar nga Administratori E.M dhe Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptar (SRNSH) të përfaqësuar nga K.K, për një periudhë 3 vjeçare nga data e nënshkrimit të saj deri më 22.11.2022.

-Marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 1026 prot., datë 10.02.2023 midis Albpetrol sh.a Patos të përfaqësuar nga Administratori E.D, Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptar (SRNSH) të përfaqësuar nga K.K, dhe Sindikatës të Sektorit Hidrokarbur (SSH), për një periudhë 3 vjeçare.

Sa më sipër konstatohet se kontrata kolektive është lidhur gati 3 muaj me vonesë.

Tabela nr.1: Të dhëna përmbledhëse për treguesit e punës për Albpetrol sh.a Patos për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022

(mijë lekë)

Nr	Emërtimi	Viti 2021		Viti 2022	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Nr mesatar i punonjësve	1,790	1,745	1,790	1,645
2	Paga mesatare (lekë)	56,934	55,478	57,160	55,363
3	Fondi i pagave	1,222,944	1,161,819	1,272,792	1,093,051

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Financës dhe e Programimit, përpunoi grupi i auditimit

Sipas programit ekonomik në Albpetrol sh.a Patos për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 1,790 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar 1,745 punonjës. Fondi i pagave është 1,222,944 mijë lekë, pra **61,125 mijë lekë** më pak se programi.

Sipas programit ekonomik në Albpetrol SHA për vitin **2022**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2022 është realizuar 6,156 punonjës. Fondi i pagave është 1,272,792 mijë lekë, pra **179,741 mijë lekë** më pak se programi.

Mos plotësimi i nevojave të shoqërisë me numrin e parashikuar të punonjësve ndikon në performancën dhe në rezultatin e saj financiar.

Titulli gjetjes 2: Mos plotësimi i numrit mesatar të punonjësve.

Situata:

Sipas programit ekonomik në Albpetrol sh.a Patos për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 1,790 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar 1,745 punonjës. Fondi i pagave është 1,222,944 mijë lekë, pra **61,125 mijë lekë** më pak se programi.

Sipas programit ekonomik në Albpetrol SHA për vitin **2022**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2022 është realizuar 6,156 punonjës. Fondi i pagave është 1,272,792 mijë lekë, pra **179,741 mijë lekë** më pak se programi.

Mos plotësimi i nevojave të shoqërisë me numrin e parashikuar të punonjësve ndikon në performancën dhe në rezultatin e saj financiar.

Kriteri: Përcaktimet e programeve ekonomike të viteve 2021 dhe 2022.

Ndikimi/Efekti:

Mos plotësimi i nevojave të shoqërisë me numrin e parashikuar të punonjësve ndikon në performancën e saj.

Shkaku: Numri i punonjësve të shoqërisë është më i ulët se parashikimet e programit dhe për pasojë sjell mos plotësimin e nevojave të saj.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e nevojave për punonjës të shoqërisë referuar parashikimeve të programit ekonomik.

- **Procedura e Rekrutimit të Punonjësve**

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se në Albpetrol sh.a Patos:

-Nuk është hartuar “Procedura e lëvizjeve të stafit”, “Rregullore për emërimet”.

-Nuk është bërë për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve.

-Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzore, pranë Albpetrol sh.a Patos nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura.

Po ashtu procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhje nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.

- **Masat Disiplinore**

Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 188 masa disiplinore, nga këto 35 masa “Tërheqje vëmendje”, 18 masa “Vërejtje me gojë”, 58 masa “Vërejtje me shkrim”, 8 masa “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, 6 masa “Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët”, dhe 63 masa “Pushim nga puna”. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komision apelimi.

Tabela nr.2 : Evidencat e masave disiplinore për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022

Nr	Viti	Tërheqje vëmendje	Vërejtje me gojë	Vërejtje me shkrim	Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna	Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët	Pushim nga puna
1	2021	25	9	41	5	3	41
2	2022	10	9	17	3	3	22
Totali	188	35	18	58	8	6	63

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Administratës, përpunoi grupi i auditimit.

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet lidhur me procedurat e rekrutimit, plotësimin të vakancave dhe të masave disiplinore mbajnë përgjegjësi, në cilësinë e ish Administratorëve të Albpetrol sh.a Patos z. B.Z, z. F.M, z. K. C., në cilësinë e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos E. D., në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Administratës z. E.L, znj F.A dhe për dijeni z. A.C (emërimi nr. 9203 prot, datë 22.01.2022).

Titulli gjetjes 3: *Procedura e Rekrutimit të Punonjësve dhe dhënia e masave disiplinore.*

Situata:

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se në Albpetrol sh.a Patos:

-Nuk është hartuar “Procedura e lëvizjeve të stafit”, “Rregullore për emërimet”.

-Nuk është bërë për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve.

-Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzore, pranë Albpetrol sh.a Patos nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura.

Po ashtu procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhjes nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.

-Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 188 masa disiplinore, nga këto 35 masa “*Tërheqje vëmendje*”, 18 masa “*Vërejtje me gojë*”, 58 masa “*Vërejtje me shkrim*”, 8 masa “*Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna*”, 6 masa “*Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët*”, dhe 63 masa “*Pushim nga puna*”. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komisioni apelimi.

Kriteri:

Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015.

Ndikimi/Efekt:

Mos zbatimin e procedurave të rekrutimit të marrëdhënies të punës sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015 sjell parregullsi dhe mangësi në punësimin e punonjësve për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.

Shkaku:

Mos zbatimin e ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” dhe mangësitë në zbatimin e procedurave rekrutimit të punonjësve të rinj të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimi dhe miratimi i rregulloreve për emërimin dhe procedurat e lëvizjeve të stafit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me masat disiplinore në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.

- *Plotësimi i listë pagesave nga punonjësi i caktuar për pagat, si dhe mbështetja në të dhënat e dokumentacionit bazë (listë prezencë e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Kontrolli dhe nënshkrimi nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.*

Nga auditimi në tërësi të listë pagesave për periudhën e përcaktuar në program, rezultoi se shuma e përgjithshme e listë pagesave është e njëjtë me urdhër xhirimin e përgatitur për këtë qëllim. Përmbledhëset e listë pagesës në çdo rast janë të nënshkruara nga eprori direkt dhe drejtori i departamenti etj. Listë pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat përkatëse për çdo drejtori. Listë pagesat paraqesin nga paga bruto, shtesat, ndalesat deri në pagën neto.

Në procedurën e pagesës hartohet listë prezenca dhe nënshkruhet nga drejtorët e drejtorive më pas hartohet listë pagesa mbi bazën e klasifikimit të pagave, shtesa për pozicione të veçanta pune të cilat janë të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, duke kryer llogaritjet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë plotësohet listë-pagesa përkatëse dhe dërgohet në bankë për pagesë.

Janë kryer ndalesat për tatimin e të ardhurave personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

-Është përlllogaritur, ndalur dhe derdhur në organet tatimorë kontributi i sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 i ndryshuar “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11. 5.1993 “Për sigurimet shoqërorë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësorë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë” i ndryshuar, dhe pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 457, datë 09.07.2014, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008, të këshillit të ministrave, “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërorë në republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10383, datë 24.2.2011, “për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

-Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimorë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr.3: Të dhëna përmbledhëse për detyrimet nga marrëdhëniet e punës periudha 01.01.2021 – 31.12.2022

Nr	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
1	Fondi i pagave gjithsej (sipas PF) 2022 operative	1,467,098,309	1,336,721,955
a	Fond page	1,162,313,079	1,092,947,788
b	Kuota ushqimore (500 lekë /ditë)	221,211,375	204,020,365
c	Shpërblime	63,677,892	21,410,899
d	Antidotë	19,895,963	18,342,903
	Totali i shpenzimeve të personelit	1,467,098,309	1,336,721,955
2	Detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale	109,333,774	94,646,922
3	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	127,254	14,079
4	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	30,152	3,472
5	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	323,434,054	326,891,496
6	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	394,547	49,439
7	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	94,962	12,194

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Financës, përpunoi grupi i auditimit.

-Janë audituar me zgjedhje listë-pagesat e periudhës objekt auditimi 2021-2022 (për vitin 2021: Janar, Shkurt, Mars, Prill, Qershor, Shtator, Dhjetor; dhe për vitin 2022: Janar, Mars, Prill, Gusht, Shtator, Nëntor, Dhjetor) nga të cilat rezultojnë se:

-Lidhur me “Detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale” dhe “Kontributin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, rezultojnë se për periudhën objekt auditimi janë paguar gjopa dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën **726,099 lekë**, vlerë kjo që konsiderohet **dëm ekonomik** në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Për sa më sipër për gjopat dhe interesat e paguara mbajnë përgjegjësi, në cilësinë e ish – Drejtorit të Financës z. A.L dhe në cilësinë e Drejtorit të Financës znj. A.B.

-Bazuar në listë pagesat e periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 janë paguar dieta për trajtim ushqimor në masën 500 lekë ndërkohë që me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar në masën 300 lekë. Në lidhje me këtë VKM rezultojnë se nga Drejtoria Juridike nuk është marrë asnjë iniciativë për implementimin dhe zbatimin e saj, si dhe vënien në dijeni të Administratorit dhe aparatit të shoqërisë, për përmirësimet ligjorë, duke qenë një detyrë funksionale e kësaj drejtorie.

-Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se; Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjorë për caktimin e dietës ushqimore në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet përkatëse për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive.

Nga llogaritja e listpagesave të periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultojnë se ky përfitim është në masën 425,231,740 lekë, nga 255,231,740 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej **170,092,696 lekë** e cila konsiderohet **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë. (Shënim: Llogaritja është kryer në bazë të shumës totale të përfituar, pjesëtuar me vlerën prej 500 lekë/ditë, dhe më pas është shumëzuar me 200 lekë/ditë, e cila është shuma e përfituar më tepër).

Për sa më sipër lidhur me shpërblimin e pagës në natyrë mbajnë përgjegjësi, në cilësinë e anëtarëve dhe ish – anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës z. I.GJ, z. E.M, z. G.L, z. E.N, znj. L.O, z. S.K, znj. F.K, në cilësinë e ish Administratorëve të Albpetrol sh.a Patos z. B.Z, z. F.M, znj. A. H., z. K. C., në cilësinë e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos E. D., në cilësinë e ish Drejtorit Juridik z. R.Ç, në cilësinë e Drejtorit Juridik z. A.T, në cilësinë e ish Drejtorit të Financës z. A.L, në cilësinë e Drejtorit të Financës znj. A.B.

Titulli gjetjes 4: *Paga në natyrë më tepër nga kuota e miratuar.*

Situata:

Bazuar në listë pagesat e periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 janë paguar dieta për trajtim ushqimor në masën 500 lekë ndërkohë që me VKM nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar në masën 300 lekë. Në lidhje me këtë VKM rezultojnë se nga Drejtoria Juridike nuk është marrë asnjë iniciativë për implementimin dhe zbatimin e saj, si dhe vënien në dijeni të Administratorit dhe aparatit të shoqërisë, për përmirësimet ligjorë, duke qenë një detyrë funksionale e kësaj drejtorie.

-Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se; me VKM nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i

përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa (a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimorë në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet përkatëse për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive.

Nga llogaritja e listpagesave të periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 425,231,740 lekë, nga 255,231,740 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej **170,092,696 lekë** e cila konsiderohet **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë. (Shënim: Llogaritja është kryer në bazë të shumës totale të përfituar, pjesëtuar me vlerën prej 500 lekë/ditë, dhe më pas është shumëzuar me 200 lekë/ditë, e cila është shuma e përfituar më tepër).

Kriteri:

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a).

Ndikimi/Efekti:

Dëmi ekonomik në vlerën prej **170,092,696 lekë**.

Shkaku:

Mos azhurnimi i ndryshimeve ligjore dhe ndryshimi i kontratës kolektive të shoqërisë në përputhje me këto ndryshime.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrin masat e duhura për mos azhurnimin e legjislacionit dhe të ndiqen procedurat administrative e ligjore ndaj personave përgjegjës për arkëtimin e shumës **170,092,696 lekë**, për mos përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive rekomanduar kjo dhe në auditimet e tjera të KLSH.

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masat e duhura dhe të kryejë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatës për mos vazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga përcaktimet ligjore.

Titulli gjetjes 5 : *Vonesa në likuidimin e detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.*

Situata:

Nga auditimi mbi mënyrën e llogaritjes dhe pagesës së detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat, rezulton se “Detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale” dhe “Kontributin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, për periudhën objekt auditimi janë paguar gjoba dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën **726,099 lekë**, vlerë kjo që konsiderohet **dëm ekonomik** në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Kriteri:

Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:

Mos likuidimi sipas afateve ligjore të detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ka sjellë pasojë dëmin ekonomik në vlerën **726,099 lekë**.

Shkaku: Mos zbatimi i afateve të përcaktuara në ligj.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të analizojnë situatën penaliteteve në shumën **726,099 lekë**, duke nxjerrë përgjegjësitë nga mos kryerja e pagesës së tatimit mbi të ardhurat dhe kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, ku në rast të neglizhencës nga punonjës të caktuar të kërkohet mbajtja e gjobës nga paga. Ndërsa në rast mos pasjes së gjendjes financiare të merren masa për planifikimin e saktë të shpenzimeve buxhetore në fillim të periudhave ushtrimore për paga/sigurime dhe mos krijimin e diferencave shkak për penalizim nga mos likuidimi.

- Përshkrimi i procedurave për orët jashtë kohës normale të punës:

Pagesa e orëve shtesë lidhur me ditët normale të punës, dhe në ditët e pushimit/festive, hartohet duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

-Kryespecialisti i secilës drejtori konceptohen shkresë për punën e kryer nga punonjësi/t e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos,

-Drejtori i Drejtorisë pranon dhe konfirmohet nga Drejtori Organizativ ose Drejtori Teknik (sipas varësive të eprorëve përkatës),

-Miratohet nga Administratori i shoqërisë.

Pas kontrollit të dokumentacionit dhe rakordimit të formularëve me listëprezencën e orëve jashtë orarit (kopjet origjinale të firmosura nga eprorët përkatës), orët për çdo punonjës hidhen në sistemin e pagave, të ndara në ditë feste, të diela dhe orët normale.

-Përllogaritja për orët shtesë të punës që punëdhënësi duhet t'i paguajë punëmarrësit është shtesa prej 25% mbi pagën normale.

Orët shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompensohen me një shtesë prej 50% mbi pagë normale.

Tabela nr.4: Të dhëna mbi orët e punës jashtë orarit Albpetrol sh.a Patos

Albpetrol sh.a Patos	Orë jashtë orari		Vlera ALL	
	Ditë Normale	Ditë Feste	Ditë Normale	Ditë Feste
Viti 2021	2,197.2	2,675.2	857,409	1,265,248
Viti 2022	2,503	2,670.04	1,008,983	1,280,779
Totali	4,700.2	5,345.24	1,866,392	2,546,027

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Programimit, përpunoi grupi i auditimit

Sa më sipër bie në kundërshtim me urdhrin e Administratorit F.M nr.5620 prot, datë 12.08.2021, ku përcaktohet se:

“2.Kërkesat për miratimin e pagës për orët jashtë kohës normale të punës do t'i nënshtrohen procedurës së mëposhtme:

-Qendra e Transportit dhe Furnizimit Patos, në çdo rast të marrjes së konfirmimit me e-mail nga QASHNG Patos, për çdo lëvizje mbas orarit 15:00 të produktit “Naftë Brut” me mjetet e shoqërisë, do të njoftojë për numrin e mjeteve dhe drejtuesit përkatës nëpërmjet e-mail zyrtar po atë ditë të marrjes së kërkesës Drejtorin Teknik, Drejtorin Organizativ dhe Administratorin.

-Çdo javë QFT Patos do të përcjellë një evidencë për orët e kryera jashtë kohës normale të punës duke e shoqëruar dhe me dokumentacionin provues.

-Mbas kryerjes së kësaj procedure konfirmimi, drejtoria e financës do të kryejë pagesën.

3.Ndalim e aplikimit për orë jashtë kohës normale të punës për punonjësit e Administratës për të cilët, në zbatim të Kodit të Punës, akteve nënligjore dhe Kontratës Kolektive në fuqi, do të trajtohen me ditë pushimi rast pas rasti.

4.Përfundime do të ketë vetëm për punonjësit që do të angazhohen në detyra specifike, me Urdhër të posaçëm të Administratorit të shoqërisë.”

Vlera totale e orëve jashtë orarit për periudhën objekt auditimi rezulton në vlerën **4,412,419 lekë** dhe konsiderohet **efektit financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Për sa më sipër për pagesën e orëve të punës jashtë orarit pa bazë ligjore mbajnë përgjegjësi, në cilësinë e ish Administratorëve të Albpetrol sh.a Patos z. B.Z, z. F.M z. K. C., në cilësinë e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos E. D., në cilësinë e ish Drejtorit të Financës z. A.L, në cilësinë e Drejtorit të Financës znj. A.B.

Titulli gjetjes 6: Mos zbatimi i urdhrit të Administratorit të shoqërisë në pagesën e orëve jashtë orarit.

Situata

Pagesa e orëve shtesë lidhur me ditët normale të punës, dhe në ditët e pushimit/festive, hartohet duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

-Kryespecialisti i secilës drejtori konceptohen shkresë për punën e kryer nga punonjësi/t e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos,

-Drejtori i Drejtorisë pranon dhe konfirmohet nga Drejtori Organizativ ose Drejtori Teknik (sipas varësive të eprorëve përkatës),

-Miratohet nga Administratori i shoqërisë.

Pas kontrollit të dokumentacionit dhe rakordimit të formularëve me listëprezencën e orëve jashtë orarit (kopjet origjinale të firmosura nga eprorët përkatës), orët për çdo punonjës hidhen në sistemin e pagave, të ndara në ditë feste, të diela dhe orët normale.

-Përlllogaritja për orët shtesë të punës që punëdhënësi duhet t'i paguajë punëmarrësit është shtesa prej 25% mbi pagën normale.

Orët shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompensohen me një shtesë prej 50% mbi pagë normale.

Albpetrol sh.a	Orë jashtë orari		Vlera ALL	
	Ditë Normale	Ditë Feste	Ditë Normale	Ditë Feste
Viti 2021	2,197.2	2,675.2	857,409	1,265,248
Viti 2022	2,503	2,670.04	1,008,983	1,280,779
Totali	4,700.2	5,345.24	1,866,392	2,546,027

Vlera totale e orëve jashtë orarit për periudhën objekt auditimi rezulton në vlerën **4,412,419 lekë** dhe konsiderohet **efektit financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Kriteri:

Urdhri e Administratorit nr.5620 prot, datë 12.08.2021, ku përcaktohet se:

“2.Kërkesat për miratimin e pagës për orët jashtë kohës normale të punës do t'i nënshtrohen procedurës së mëposhtme:

-Qendra e Transportit dhe Furnizimit Patos, në çdo rast të marrjes së konfirmimit me e-mail nga QASHNG Patos, për çdo lëvizje mbas orarit 15:00 të produktit “Naftë Brut” me mjetet e shoqërisë, do të njoftojë për numrin e mjeteve dhe drejtuesit përkatës nëpërmjet e-mail zyrtar po atë ditë të marrjes së kërkesës Drejtorin Teknik, Drejtorin Organizativ dhe Administratorin.

-Çdo javë QFT Patos do të përcjellë një evidencë për orët e kryera jashtë kohës normale të punës duke e shoqëruar dhe me dokumentacionin provues.

-Mbas kryerjes së kësaj procedure konfirmimi, drejtorja e financës do të kryejë pagesën.

3.Ndalim e aplikimit për orë jashtë kohës normale të punës për punonjësit e Administratës për të cilët, në zbatim të Kodit të Punës, akteve nënligjore dhe Kontratës Kolektive në fuqi, do të trajtohen me ditë pushimi rast pas rasti.

4.Përfundime do të ketë vetëm për punonjësit që do të angazhohen në detyra specifike, me Urdhër të posaçëm të Administratorit të shoqërisë.”

Ndikimi/Efekti:

Pagesa e orëve të punës jashtë orarit, në mos përputhje të plotë me Kodin e Punës, neni 7, pika 1 dhe 2, i ka sjellë shoqërisë **efekt financiar negativ** në vlerën **4,412,419 lekë**.

Shkaku:

Mos zbatimi i përcaktimeve ligjore të Kodit të Punës lidhur me pagesën e orëve të punës jashtë orarit.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë masa për analizimin e vlerës 4,412,419 lekë të efektit financiar negativ dhe korigjimin e pagesave për orët shtesë sipas orëve dhe ditëve të punës.

- Respektimi i dispozitave ligjore për dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.

Nga auditimi, konstatohet se fondi i shpërblimeve përdorët sipas nevojave të cilat dalin në pah në varësi të nevojave të ndryshme në periudhën objekt auditimi. Vlera totale e këtij fondi është në vlerën 103,972 mijë lekë.

Tabela nr.5: Të dhëna përmbledhëse për shpërblimet në Albpetrol sh.a Patos, periudha 01.01.2021 – 31.12.2022

Nr	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
1	Fondi i veçantë (8 Marsi)	280 ,000	0
2	Shpërblime për rezultate në punë	6,585,000	0
3	Shpërblime për fund viti	3 ,040,000	
4	Shpërblime sëmundje	1,820,000	1 ,280 ,000
5	Për largim nga puna	0	0
6	Për dalje në pension	228 ,000	190,000
6	Për raste fatkeqësie/lindje	270 ,000	280 ,000
7	Këshilli Mbikëqyrës	3,329,536	2,234,236
8	Shpërblime të tjera (leje zakonshme)	2,077,000	1,986,000
9	Këshilli teknik i brendshëm	1,080,000	1,310,000
	Totali	18,709,536	7,280,236

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Programimit, përpunoi grupi i auditimit.

- Proceset Gjyqësore për Ndërprerjen e paligjshme të marrëdhënie të punës

Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se:

-Me Vendimin e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos, nr. 5795 prot, datë 19.08.2021, njoftohet zgjidhja e marrëdhënieve të punës me z. H.GJ, me datë shkëputje të marrëdhënieve financiare 19.08.2021

-Me vendimin e Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Fier, me vendim nr. 62 – 2021 – 5479, datë 11.12.2021, me paditës z.H.GJ, i paditur Albpetrol sh.a Patos dhe Urdhrin e Përmbartuesit Privat Gjyqësor, z. N.Ç nr. 778 rregj, datë 19.11.2021 “Për vënien e sekuestros konservative në llogarinë e palës debitore”, (pas refuzimit nga Albpetrol sh.a Patos i ekzekutimit vullnetar administruar në Albpetrol sh.a Patos me shkresë hyrëse nr. 9068 prot, datë 15.11.2021), është vendosur masa e sekuestros konservative për shumën objekt detyrimi plus shpenzimet gjyqësore në masën 2,633,370 lekë, si dhe detyrimin e pagesës të tarifës përmbartimore në masën 252,803 lekë, pra në total **2,886,174 lekë**.

-Me vendimin e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos, nr. 504 prot, datë 18.11.2022 z. H.GJ emërohet në pozicionin “Drejtor Kabineti”.

-Me shkresën e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos, nr. 7318 prot, datë 23.12.2020, njoftohet zgjidhja e marrëdhënieve të punës me z. Y.S, me datë shkëputje të marrëdhënieve financiare 23.12.2020.

-Me vendimin e Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Fier, me vendim nr. 62 – 2021 – 4927(994), datë 18.10.2021, me paditës z.Y.S, i paditur Albpetrol sh.a Patos dhe Urdhrin e Përmbauesit Privat Gjyqësor, z. N.Ç nr. 880 rregj, datë 07.03.2022 “Për vënien e sekuestros konservative në llogarinë e palës debitore”, (pas refuzimit nga Albpetrol sh.a Patos i ekzekutimit vullnetar me shkresë hyrëse nr. 2095 prot, datë 07.03.2022), është vendosur masa e sekuestros konservative për shumën objekt detyrimi plus shpenzimet gjyqësore në total **2,873,065 lekë**.

-Me vendimin e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos, nr. 18 prot, datë 25.08.2021 z. Y.S emërohet në pozicionin “Drejtor Kabineti”.

-Me vendimin e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos, nr. 477 prot, datë 09.11.2022.08 z. Y.S shkarkohet nga pozicioni “Drejtor Kabineti”.

-Me shkresën e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos, nr. 578 prot, datë 12.06.2020, njoftohet zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës me z. A.C .

-Me vendimin e Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Fier, me vendim nr. 171, datë 01.02.2021, me paditës z. A.C , i paditur Albpetrol sh.a Patos dhe Urdhrin e Përmbauesit Privat Gjyqësor, z. N.Ç nr. 712 rregj, datë 12.02.2021 “Për vënien e sekuestros konservative në llogarinë e palës debitore”, (pas refuzimit nga Albpetrol sh.a Patos i ekzekutimit vullnetar me shkresë nr. 714 rregj, datë 08.02.2021), është vendosur masa e sekuestros konservative për shumën objekt detyrimi plus shpenzimet gjyqësore në masën 1,971,400 lekë, si dhe detyrimin e pagesës të tarifës përmbaimore në masën 236,568 lekë, pra në total **2,207,968 lekë**.

-Me vendimin e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos, nr. 568 prot, datë 22.12.2022 z. A.C emërohet në pozicionin “Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Administratës”.

-Me shkresën e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos, nr. 9029 prot, datë 07.10.2019, njoftohet zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës me z. A.B.

-Me vendimin e Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Fier, me vendim nr. 62 – 2020 – 3158, datë 21.09.2020, me paditës z. A.B, i paditur Albpetrol sh.a Patos dhe Urdhrin e Përmbauesit Privat Gjyqësor, z. N.Ç nr. 886 rregj, datë 28.04.2022 “Për vënien e sekuestros konservative në llogarinë e palës debitore”, (pas refuzimit nga Albpetrol sh.a Patos i ekzekutimit vullnetar), është vendosur masa e sekuestros konservative për shumën objekt detyrimi plus shpenzimet gjyqësore në masën 1,771,480 lekë, si dhe detyrimin e pagesës të tarifës përmbaimore në masën 212,621 lekë, pra në total **1,984,101 lekë**.

-Me vendimin e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos, nr. 261 prot, datë 12.01.2021 z. A.B emërohet në pozicionin “Drejtor i Qendrës të Shërbimeve Gjeofizike”.

-Me shkresën e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos, nr. 478 prot, datë 14.10.2019, njoftohet zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës me z. S.H.

-Me vendimin e Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Fier, me vendim nr. 62 – 2021 – 1488 (423), datë 16.03.2021, me paditës z. S.H, i paditur Albpetrol sh.a Patos dhe Urdhrin e Përmbauesit Privat Gjyqësor, z. N.Ç nr. 939 rregj, datë 09.12.2022 “Për vënien e sekuestros konservative në llogarinë e palës debitore”, (pas refuzimit nga Albpetrol sh.a Patos i ekzekutimit vullnetar), është vendosur masa e sekuestros konservative për shumën objekt detyrimi plus shpenzimet gjyqësore në masën 1,671,40 lekë, si dhe detyrimin e pagesës të tarifës përmbaimore në masën 200,568 lekë, pra në total **1,871,968 lekë**.

-Me vendimin e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos, nr. 261 prot, datë 12.01.2021 z. A.B emërohet në pozicionin “Drejtor i Qendrës të Shërbimeve Gjeofizike”.

Tabela nr.6: Të dhëna përmbledhëse për rikthimet pa vendim Gjykatë në Albpetrol sh.a Patos, periudha 01.01.2021 – 31.12.2022

Nr	Kreditorët	Nr Regj		Paga		Shuma e fituar	Shpenzime Gjyqi	Detyrimi	Tarifa përbarimore	Totali
1	Y.S	880	17.5	115,000	2,012,500	2,059,545	64,354	2,123,899	203,894	2,327,794
			9 dite		47,045					
2	S.H	939	11	140,000	1,540,000	1,540,000	131,400	1,671,400	200,568	1,871,968
3	A.B	886	11	152,000	1,672,000	1,728,000	43,480	1,771,480	212,621	1,984,101
			8 dite		56,000					
4	H.GJ	778	18	140,000	2,520,000	2,581,650	51,720	2,633,370	252,804	2,886,174
			Muaj Prill		61,650					
5	A.C	714	16	120,000	1,920,000	1,920,000	51,400	1,971,400	236,568	2,207,968
6	H.GJ	873					40,000	40,000	18,000	58,000
7	Y.S	724			311,163	311,163	51,200	362,363	36,000	398,363
8	Y.S	937					63,000	63,000		63,000
9	Y.S	724/1				65,908		65,908	18,000	83,908
						10,206,266	496,554	10,702,820	1,178,455	11,881,276

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Financës, përpunoi grupi i auditimit.

Sa më sipër duke qenë se nuk ka patur objekt padie në asnjë rast rikthimi i punonjësve në vendin e punës dhe nuk ka vendim gjykatë lidhur me këtë çështje, rikthimi në punë i këtyre punonjësve bie në kundërshtim me Ligjin 7961, datë “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 155, pika 3) “Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme, të pajustificuar, të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata, me kërkesë të punëmarrësit dhe duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos dëmshpërblimin, deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim.”

-Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, nga ku janë humbur 25 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, si dhe janë humbur e janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë.

-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **42,600,758 lekë**, nga ku shpenzimet përbarimore rezultojnë **3,931,821 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,146,912 lekë**.

-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **61,851,420 lekë**, nga ku shpenzimet përbarimore rezultojnë **6,272,200 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,172,200 lekë**.

Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **104,452,178 lekë e cila konsiderohet efektit financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe vlera shpenzimeve përbarimore lidhur me ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatave dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar për çdo rast, duke rezultuar në pagesë të këtyre vlerave me urdhër sekuestro bankare, prej **14,486,894 lekë** konsiderohet **dëm ekonomik** në buxhetin e shoqërisë.

Për sa më sipër për ndryshimet e shpeshta në strukturën organizative mbajnë përgjegjësi, në cilësinë e ish Administratorëve të Albpetrol sh.a Patos z. B.Z, z. F.M, znj. A. H., z. K. C., në cilësinë e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos E. D., në cilësinë e ish Drejtorit Juridik z. R.Ç, në cilësinë e Drejtorit Juridik z. A.T, në cilësinë e ish Drejtorit të Financës z. A.L, në cilësinë e Drejtorit të Financës znj. A.B.

Titulli gjetjes 7: Proceset gjyqësore për ndërprerjen e paligjshme të marrëdhënieve të punës.

Situata:

-Nga grupi i auditimit konstatohet se në pesë raste punonjësit (në pozicione drejtuese) janë shkarkuar nga detyra me urdhër Administratori. Këta punonjës kanë ngritur padi dhe kanë nisur procese gjyqësore kundër Albpetrol sh.a Patos, duke detyruar shoqërinë të paguajë **dëmshpërblim** në vlerën **11,977,746 lekë**, si dhe **shpenzime gjyqësore dhe tarifë përmbarimi**, me urdhër sekuestro në vlerën **1,887,270 lekë**.

Këta punonjës janë ri punësuar në Albpetrol sh.a Patos (në pozicione drejtuese), përgjithësisht gjatë proceseve gjyqësore. Në asnjë rast nuk ka qenë objekt padie rikthimi i tyre në punë.

-Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë **humbur 81 çështje gjyqësore** në apel, nga ku janë **humbur 25 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit**, si dhe janë **humbur e janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë**.

-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **42,600,758 lekë**, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë **3,931,821 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,146,912 lekë**.

-Për vitin 2022 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **61,851,420 lekë**, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë **6,272,200 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,172,200 lekë**.

Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **104,452,178 lekë** e **cila konsiderohet efektit financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe vlera shpenzimeve përmbarimore lidhur me ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatave dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar për çdo rast, duke rezultuar në pagesë të këtyre vlerave me urdhër sekuestro bankare, prej **14,486,894 lekë** konsiderohet **dëm ekonomik** në buxhetin e shoqërisë.

Kriteri:

Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015, neni 155, pika 3) “Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme, të pajustificuar, të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata, me kërkesë të punëmarrësit dhe duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos dëmshpërblimin, deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim.”

Ndikimi/Efekti:

Efekt financiar negativ në shumën prej **104,452,178 lekë** dhe dëm ekonomik në vlerën **14,486,894 lekë**.

Shkaku:

Mos zbatimi i ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, dhe mangësitë në zbatimin e procedurave të largimit dhe rikthimit në punë të punonjësve, të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të analizojë efektin financiar negativ në shumën prej **104,452,178 lekë** dhe dëmin ekonomik në vlerën **14,486,894 lekë**, si dhe të merren masa për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore lidhur me dëmin ekonomik nga personat përgjegjës për largimet e padrejta nga puna shkak për humbjen e proceseve gjyqësore.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shpalljes së marrëdhënies të punës me punonjësit e saj dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

- *Proceset Gjyqësore lidhur me masat shtrënguese për pagat e punonjësve për shkak të pandemisë COVID – 19*

Referuar situatës së krijuar të pandemisë COVID-19 procesi i ristrukturimit është pezulluar me Vendimin nr. 6, datë 29.04.2020, të Këshillit Mbikëqyrës duke e shtyrë afatin e njoftimit deri në një vendim të dytë dhe sipas vendimit punonjësit të cilët preken nga procesi do të trajtohen me pagën e luftës. Me shkresën nr. 1821 prot., datë 30.03.2020, Administratori i Shoqërisë E.M ka hartuar një plan masash shtrënguese në kuadër të shpalljes së gjendjes emergjente për shkak të pandemisë së COVID-19. Me shkresën nr. 1821/1 prot., datë 01.04.2020, nga Administratori i Shoqërisë E.M janë njoftuar Drejtoritë dhe qendrat e prodhimit në varësi të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për zbatimin e planit të masave sipas përcaktimeve përkatëse.

Reduktimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore (brenda datës 06.04.2020), reduktimi i shpenzimeve për dieta dhe orët jashtë orarit (nga data 01.04.2020), aplikimi i lejes së zakonshme për vitin 2020 (brenda datës 03.04.2020), pezullimi i këshillave teknik dhe ndalimi i pagesave të tyre (duke filluar nga data 01.04.2020), shfuqizimi i dhënies së shtesave mbi pagë për komisionet e drejtoritë përkatëse (menjëherë), reduktimi i konsumit të karburantit të programuar për muajin prill (duke filluar nga data 01.04.2020), kryerjen e inventarit fizik të mallrave gjendje në magazinë (brenda datës 10.04.2020), etj.

Punonjësit e Albpetrol sh.a Patos kanë hapur padi ndaj kësaj shoqërie dhe për periudhën objekt auditimi kanë fituar çështje gjyqësore si më poshtë:

-Pagat e fituara me vendime gjyqësore në vlerën **2,438,069 lekë**,

-Shpenzime gjyqësore në vlerën **658,520 lekë**,

-Tarifa e shërbimit përbarimor plus TVSH në vlerën **361,200 lekë**.

Sa më sipër për shkak të vendimeve të kundër ligjshme, dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar, vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe tarifa e shërbimit përbarimor plus TVSH rezulton në vlerën **1,019,720 lekë** dhe konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Për sa më sipër për vendimin e kundërligjshëm lidhur me reduktimin e pagave në periudhën e pandemisë COVID 19 mbajnë përgjegjësi, në cilësinë e anëtarëve dhe ish – anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës z. E.B, z. I.GJ, z. E.M, znj. A.G, znj. L.O në cilësinë e ish Administratores të Albpetrol sh.a Patos z. E.M në cilësinë e ish Drejtorit Juridik z. R.Ç, në cilësinë e Drejtorit Juridik z. A.T, në cilësinë e ish Drejtorit të Financës z. A.L, në cilësinë e Drejtorit të Financës znj. A.B.

Titulli gjetjes 7: Ndryshimet e shpeshta në drejtimin e Albpetrol sh.a Patos.

Situata:

Referuar situatës së krijuar të pandemisë COVID-19 procesi i ristrukturimit është pezulluar me Vendimin nr. 6, datë 29.04.2020, të Këshillit Mbikëqyrës duke e shtyrë afatin e njoftimit deri në një vendim të dytë dhe sipas vendimit punonjësit të cilët preken nga procesi do të trajtohen me pagën e luftës. Me shkresën nr. 1821 prot., datë 30.03.2020, Administratori i Shoqërisë **zj. E.M** ka hartuar një plan masash shtrënguese në kuadër të shpalljes së gjendjes emergjente për shkak të pandemisë së COVID-19. Me shkresën nr. 1821/1 prot., datë 01.04.2020, nga Administratori i Shoqërisë **zj. E.M** janë njoftuar Drejtoritë dhe qendrat e prodhimit në varësi të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për zbatimin e planit të masave sipas përcaktimeve përkatëse.

Reduktimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore (brenda datës 06.04.2020), reduktimi i shpenzimeve për dieta dhe orët jashtë orarit (nga data 01.04.2020), aplikimi i lejes së zakonshme për vitin 2020 (brenda datës 03.04.2020), pezullimi i këshillave teknik dhe ndalimi i pagesave të tyre (duke filluar nga data 01.04.2020), shfuqizimi i dhënies së shtesave mbi pagë për komisionet e drejtoritë përkatëse (menjëherë), reduktimi i konsumit të karburantit të programuar për muajin prill (duke filluar nga data 01.04.2020), kryerjen e inventarit fizik të mallrave gjendje në magazinë (brenda datës 10.04.2020), etj.

-Punonjësit e Albpetrol sh.a Patos kanë hapur padi ndaj shoqërisë dhe për periudhën objekt auditimi kanë fituar çështje gjyqësore si më poshtë:

-Pagat e fituara me vendime gjyqësore në vlerën **2,438,069 lekë**,

-Shpenzime gjyqësore në vlerën **658,520 lekë**,

-Tarifa e shërbimit përmbarrimor plus TVSH në vlerën **361,200 lekë**.

Sa më sipër për shkak të vendimeve të kundërligjshme dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar, vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe tarifa e shërbimit përmbarrimor plus TVSH rezulton në vlerën **1,019,720 lekë dhe konsiderohet dëm ekonomik** në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Kriteri:

Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe të Administratorit të shoqërisë.

Ndikimi/Efekti:

Vendimet e kundërligjshme të Këshillit Mbikëqyrës dhe ish – Administratorit të shoqërisë kanë rezultuar në dem ekonomik në vlerën **1,019,720 lekë**.

Shkaku:

Plani i masave shtrënguese në kuadër të shpalljes së gjendjes emergjente për shkak të pandemisë së COVID-19.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës në bashkëpunim me Administratorin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të analizojë situatën dhe të marrin masa për ndjekjen e rrugëve ligjore lidhur me arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **1,019,720 lekë nga personat përgjegjës**.

Për sa më sipër është dërguar observacioni me nr. 11/136 prot., datë 12.06.2023 ku pretendohet se:

Pretendim i subjektit:

Përsa më sipër, shpreh kundërshtimet në lidhje me këtë pike duke argumentuar si më poshtë....rreth orës 3 të mëngjesit të një dite më pas...nga manuali i trajtimit të cilin e zotëroj edhe fizikisht....

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet nga ana juaj theksojmë se dokumentacioni i paraqitur nga ana juaj është shikuar dhe në fazën e mëparshme pasi dokumentacioni është i njëjtë, për këtë arsye qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon dhe observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër është dërguar observacioni me nr. 11/157 prot., datë 16.06.2023 nga A.B nga ana e të cilit pretendohet se:

Pretendim i subjektit:

Sikurse kam observuar në lidhje me këtë gjetje....faktet më sipër po i paraqes për të kuptuar se të dy drejtuesit e mësipërm kanë qenë në fazën e njohjes se problematikave....për motive të justifikuara pune dhe nuk përbën asnjë shkelje apo rëndim të financave të shoqërisë....

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet nga ana juaj theksojmë se dokumentacioni i paraqitur nga ana juaj është shikuar dhe në fazën e mëparshme pasi dokumentacioni është i njëjtë, për këtë arsye qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon dhe observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër është dërguar observacioni me nr. 1202/18 prot., datë 19.06.2023 nga znj. A. H. nga ana e të cilës pretendohet se:

Pretendim i subjektit:

Nuk kam ndër marrë procedura vendimmarrje ne lidhje me çështjet...i përmenda të gjitha këto që në krye të herës....dhe nga ana tjetër thoni dëmin ta paguaj personi që e ka përfituar....shprehemi se shpërblimi për arritjen me sukses....gjithashtu periudha kohore prej një muaji është mëse e justifikueshme me mos realizimin e konstatimeve tua...

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet nga ana juaj theksojmë se dokumentacioni i paraqitur nga ana juaj është shikuar dhe në fazën e mëparshme pasi dokumentacioni është i njëjtë, për këtë arsye qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon dhe observacioni nuk merret në konsideratë.

Pika 2.3 e programit. Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar, si dhe ndjekja e realizimit të treguesve.

Programi ekonomik-financiar për vitin 2021 i është dërguar për miratim Këshillit Mbikëqyrës me shkresën nr. 7212 prot., datë 18.12.2020. Ai është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.25, date 24.12.2020 dhe me Vendimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.41/1, date 19.01.2021.

Programi ekonomik-financiar për vitin 2022 i është dërguar për miratim Këshillit Mbikëqyrës me shkresën nr.751/4 prot., datë 25.01.2022. Ai është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.5, datë 04.02.2022 dhe me Vendimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.1290/1, datë 16.02.2022.

Prodhimi i naftës gjithsej nga veprimtaria Albpetrol sh.a Patos dhe nga zbatimi i Marrëveshjeve Hidrokarbure për vitin 2022 është realizuar 104.4 %.

Nga aktiviteti i shoqërisë prodhimi i naftës është realizuar 70,570.5 ton kundrejt 75,920 ton të programuar ose 93%, me mosrealizim prej 5,350 ton naftë.

Me zhvillimin e ankandit të naftës dhe lidhjen e kontratës shites ne muajt Maj- Qershor, ka nisur puna për evadimin e sasisë së naftës në depozita dhe stacione, shitja e saj dhe më pas rritja e bazës ditore të prodhimit.

Në kushtet e trendit rritës të çmimit të naftës brent është rritur edhe çmimi i shitjes të naftës të shoqërisë duke ndikuar në % përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë.

Për vitin 2022 Albpetrol sh.a Patos ka arritur një rezultat financiar bruto rreth 412.2 milion lekë.

1. Treguesit kryesorë

Për vitin 2022, Albpetrol sh.a Patos ka realizuar treguesit kryesorë të Programit të Zhvillimit si më poshtë:

Nr	Treguesit	Prog.	Fakt	Dif +/-	Real %
1	Prodhim Gjithsej (1+2), ton. ekv	112,473	115,190	2,716	102.4
	*Naftë, ton	108,972	113,725	4,753	104.4
	*Gaz 000/Nm3	3,501	1,464.73	-2,036	41.8
a	Prodhimi i Albpetrol, ton.ekv	76,190	70,681	-5,509	92.8
	Nxjerrje nafte, ton	75,920	70,571	-5,350	93.0
	Nxjerrje Gazi,000/Nm3	270	110	-160	40.8
b	Detyrim i Naftës M-H (PPE+ASP), ton ekv.	36,283	44,509	8,226	122.7
	*Naftë, ton	33,052	43,154	10,102	130.6
	*Gazi, 000/Nm3	3,231	1,355	-1,877	41.9
2	Të Ardhurat 000 lekë	5,851,206	6,587,574	736,367	112.6
3	Shpenzimet,000 lekë	5,491,683	7,590,618	2,098,935	138.2
4	Ndryshimi gjendjes të produkteve , 000 lekë	0	1,415,277	1,415,277	0.0
5	Fitimi Bruto para tatimit ,000 lekë	359,523	412,233	52,710	114.7
6	Shpenzime Tatim fitimi, 000 lekë	53,928	397,317	343,389	736.7
7	Fitimi Net para tatimit ,000 lekë	305,594	14,916	-290,678	4.9

Nr	Treguesit	Prog.	Fakt	Dif +/-	Real %
8	Investime ,000/lekë	836,126	243,602	-592,524	29.1
9	Nr.mesat.punonjesh	1,790	1,645	-145	91.9
10	Fondi i pagave ,000 lekë	1,227,792	1,093,045	-134,747	89.0
11	Paga mesatare , lekë	57,160	55,362	-1,798	96.9
12	Naftë e shitur, ton	108,736	95,883	-12,853	88.2
13	Çmimi mesatar i shitjes, lekë/ton	37,169	51,893	14,724	139.6

2.1 Nxjerrja e Naftës

2.1.1 Prodhimi naftës nga veprimtaria e vet Albpetrol.

Nxjerrja e naftës në fushatën e naftës që shoqëria Albpetrol sh.a Patos administron, për vitin 2022 u realizua në 70,570.5 Ton nga 75,920 Ton të programuar ose 93 % me një bazë mesatare ditore prej 193.34 Ton/ditë.

Ecuria e realizimit të nxjerrjes së naftës krahasuar me programin sipas qendrave të prodhimit dhe vendburimeve është paraqitur në tabelën si më poshtë:


Nr.	Qendrat	Prog.	Fakt	Diferenca	Mesatare Ditore	Në %
1	Q.P.N. Fier	19,710	16,896	-2,815	46.29	85.7
	Vendburimi Patos	5,840	4,722.5	-1,118	12.94	80.9
	Vendburimi Cakran-Mollaj	13,870	12,173	-1,697	33.35	87.8
2	Q.P.N. Kuçovë	18,615	17,405.5	-1,210	47.69	93.5
3	Q.P.N. Gorisht	37,595	36,270	-1,326	99.37	96.5
	Vendburimi Gorisht-Kocul	32,850	33,128.0	278	90.76	100.8
	Vendburimi Karbunarë	365	89.0	-276	0.24	24.4
	Vendburimi Amonicë	4,380	3,053	-1,328	8.36	69.7
	Total	75,920	70,571	-5,350	193.34	93.0

Viti 2022 paraqitet me mos realizim të programit të nxjerrjes së naftës pothuajse në të gjitha Qendrat e Prodhimit të Naftës në administrim të shoqërisë, përveç vendburimit Gorisht - Kocul. Mosrealizimi me i madh është në vendburimin Cakran - Mollaj duke u pasuar nga QPN Kuçovë.

Ecuria e prodhimit të naftës nga shoqëria sipas muajve është si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nxjerrja e naftës në ton		Baza ditore në ton/ditë	
		Program	Fakt	Program	Fakt
1	Janar	6,448	6,944	208.00	224.00
2	Shkurt	5,824	6,076	208.00	217.00
3	Mars	6,448	4,836	208.00	156.00
4	Prill	6,240	3,345	208.00	111.50
5	Maj	6,448	4,991	208.00	161.00
6	Qershor	6,240	4,879	208.00	162.63
7	Korrik	6,448	6,680.5	208.00	215.50
8	Gusht	6,448	6,913	208.00	223.00
9	Shtator	6,240	6,600	208.00	220.00
10	Tetor	6,448	6,789	208.00	219.00
11	Nëntor	6,240	6,255	208.00	208.50
12	Dhjetor	6,448	6,262	208.00	202.00
	Viti 2022	75920	70,570.5	208.00	193.34

Më poshtë paraqitet grafikisht realizimi i këtij prodhimi naftë:



Si shohim edhe nga grafiku i mësipërm mosrealizimi vjetor i prodhimit të naftës nga shoqëria, vendburimet në administrimin e saj ka ardhur kryesisht për pasojë të 6 mujorit të parë, me një deficit ndaj programit -6,577 ton naftë dhe një bazë ditore prej 171.7 ton/ditë kundrejt 208 ton/ditë të programuar. Në muaj të veçantë jo vetëm u arrit baza ditore e programuar, por madje edhe u tejkalua duke arritur deri në 224 ton në Janar. Gjithashtu dhe treguesit e shfrytëzimit të vendburimeve në përgjithësi për gjatë vitit 2022 kanë ardhur në përmirësim nga njëri muaj në tjetrin.

Për vitin 2022 treguesit e shfrytëzimit të vendburimeve janë si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Vendburimi. Patos	Vendburimi. Cakran - Mollaj	Vendburimi. Gorisht-Kocul	Vendburimi. Amonicë	Vendburimi. Karbunarë	Vendburimi. Kuçovë	Albpetrol
1	Nxjerrje naftë (ton)	4,722.5	12,173.0	33,128.0	3,052.5	89.00	17,405.5	70,570.5
2	Baza ditore (t/d)	12.94	33.35	90.76	8.36	0.24	47.69	193.34
3	Ditë punë	4,336	4,463	18,104	2,743	93	280,259	309,998
4	Nr. puse në punë	20	19	96	19	1	969	1,123
5	Nr.mez. Ditë puse	11.9	12.2	49.6	7.5	0.3	767.8	849.3
6	Debit mez. Ditor	1.09	2.73	1.83	1.11	0.96	0.06	0.23
7	Koefiçient. Shfrytëzimit	0.74	0.64	0.55	0.76	0.26	0.71	0.76

Prodhimi vjetor i naftës nga shoqëria paraqitet në 70,570.5 ton dhe është realizuar nga aktiviteti i rreth 1,123 puseve mesatarisht në punë me një debit mesatar prej 0.23 ton/ditë/pus dhe koefiçienti shfrytëzimi prej 0.76, tregues këta të cilët erdhën duke u përmirësuar nga njëri muaj në tjetrin deri në përfundim të vitit 2022.

Në mosrealizimin e prodhimit të naftës për vitin 2022 kanë ndikuar disa faktorë të shumtë, të karakterit objektiv dhe subjektiv si më poshtë:

a) Mos realizimi i shitjes së produktit naftë bruto prej më shumë se një muaji në vendburimin Gorisht - Kocul si rrjedhojë e mbarimit të afatit të kontratës të garancive doganore duke sjellë mos shitjen e naftës bruto te QASHNG dhe te operatori privat.

a) Përfundimi i kontratës së gazoilit, solli ndalimin e punës së kaldajës për trajtimin e naftës bruto në dekantimin Gorisht duke sjellë edhe reduktimin dhe madje ndalimin e aktivitetit prodhues në vendburimin Gorisht - Kocul Kjo pati një impakt negativ duke çuar fillimisht në seleksionimin e puseve duke vijuar me reduktime deri në ndaljen e aktivitetit prodhues (ndalje e puseve të prodhimit në gjendje punë) në vendburimet Gorisht - Kocul.

b) Ndikime të tjera në mos realizimin e treguesve të prodhimit për këtë periudhë kanë patur dhe disa faktorë të tjerë të karakterit teknik, infrastrukturor dhe administrativ etj, si:

- Mos realizimi i investimeve në vite në infrastrukturën sipërfaqësore (*rrugë, sheshe, tubacione, depozita, etj.*) pothuajse në gjithë vendburimet si Cakran - Mollaj, Patos - Marinëz, Gorisht - Kocul, Amonicë, Karbunarë dhe Kuçovë. Theksojmë se duke qenë se për një periudhë të gjatë kohore nuk është arritur të investohet në funksion të përmirësimit të infrastrukturës sipërfaqësore, aktualisht sistemet e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit të naftës në të gjithë vendburimet që administrojnë shoqëria Albpetrol sh.a Patos, janë në gjendje shumë të amortizuara.
- Për periudhën Janar – Shtator të vitit 2022, nuk u arrit të realizoheshin disa nga investimet e parashikuara në Programin e Zhvillimit Ekonomik të Albpetrol sh.a Patos, të vitit 2022, për zërat ndërtim rezervuar metalik në infrastrukturën sipërfaqësore në vendburimet e naftës si ndërtimi i 1 RVM 1000 m³ në Parkun e ri në Dekantim Gorisht, ndërtimi i 3 RVM 60 m³ dhe 1 RVM 100 m³ në Vendburimin Cakran-Mollaj; ndërtimi i 1 RVM 120 m³ me ngrohje në Dekantimin Usojë; ndërtimi i 1 RVM 400 m³ me ngrohje në Dekantimin Kuçovë, të cilat ndikuan direkt në nxjerrjen dhe trajtimin e naftës. Në mosrealizimin e tyre ndikoi: mosparaqitja e asnjë ofertuesi në procedurat e shpallur për prokurim në fund të vitit 2021 për rezervuarët nga 60, 100, 120, m³ në sektorin Cakran - Mollaj dhe Patos pasi vlerat e vogla të preventivuar sipas manualit dhe programuar për këto RVM nuk paraqisnin interes për subjektet privatë në kushtet e rritjes së çmimeve të materialeve në treg: pezullimi i procesit të prokurimit në kohën kur nuk po realizohej shitja e naftës dhe kishte reduktim të puseve në punë në vendburimin Gorisht - Kocul; dalja e aktit normativ nr.10, datë 18.05.2022 të Këshillit të Ministrave për kompensimin e çmimit për disa materiale ndërtimi solli nevojën e rishikimit të vlerave të programuara për disa investime të shoqërisë përfshirë dhe RVM 1000 m³ në Dekantim Gorisht dhe 400 m³ me ngrohje në Dekantimin Kuçovë.

Në krijimin e një gjendje të tillë infrastrukture të vendburimeve vazhdojnë të ndikojnë faktorë si:

- Korrozioni për shkak të agjentëve atmosferikë, në kushtet që rrjetet e grumbullimit, transportit dhe trajtimit të naftës të vendburimeve tona i përkasin projekteve të realizuara para viteve 90.
- Përmbajtja e ujit teknologjik në fluidin e nxjerrë nga shtresa, me përqendrim të konsiderueshëm kripërash.
- Prezenca e gazit sulfhidrik (H₂S) dhe klorureve (Cl⁻) si elementë përshpejtues të procesit të korrozionit.
- Defektet e ardhura si pasojë e amortizimit si, çarje të depozitave, defektet e ndryshme në rrjetin teknologjik veç të tjerave kryesisht tubacionit magjstral të pompimit nga Q-17 në Dekantimin Usojë etj, të cilat shoqërohen me humbje prodhimi dhe ndotje të ambientit të cilat kanë ndikim negativ në rezultatin financiar dhe penalitete për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.
- Mosgatishmëria e plotë e auto sondave dhe traktorëve të remontit nëntokësor në kushtet që këto mjete janë tejet të amortizuara duke krijuar probleme në kryerjen e shërbimeve në puse.
- Mungesa e depozitave matëse të prodhimit në puse të veçantë.
- Mungesa e dokumentacionit të nevojshëm për disa mjete që transportojnë tubo, depozita etj ka sjellë edhe mos qarkullimin e tyre duke sjellë vonesa në kryerjen e punimeve dhe shërbimeve në tubacione, magjstrale, puse dhe grupe prodhimi.

-Megjithë mosrealizimet e prodhimit si më sipër, një rol të rëndësishëm në arritjen dhe ruajtjen e nivele të prodhimit, kanë luajtur edhe treguesit e punimeve operacionale të remontit nëntokësor.

Pikërisht me hyrjen në fuqi të kontratës së shitjes së produktit naftë bruto, situata e aktivitetit prodhues të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos filloi të ndryshojë, u krijuan hapësirat depozituese grumbulluese në vendburime, filloi gradualisht rivënia në punë e puseve të ndalur duke filluar me Amonicën, Kuçovën, Gorisht - Kocul, Patos dhe Cakran - Mollaj kryesisht nëpërmjet kryerjes së punimeve të remontit kapital dhe shërbimeve të remontit nëntokësor t puseve .

-Duke qenë se pusët kanë qenë të ndalur për një kohë të gjatë kryesisht përgjatë 2020 - 2021 disa deri edhe në muajt e parë të 2022, nisur nga karakteristikat e ndryshme kolektorale të vendburimeve si dhe të parametrave të ndryshëm fiziko - kimike të naftave të tyre, gjatë rivënies në punë të puseve,

rast pas rasti, u shfaqen probleme për të cilat u kryen punime operacionale të ndryshme shtesë si: Çkunjosje; Shkundje; Këmbim pompe ose komplete; Kontroll i fundit të pusit etj.

Më poshtë janë treguesit vjetor te punimeve te remontit ne puse :

Nr.	Qendra	Punime në puse	Puse të filluar	Ore punë	Koeficienti i shfrytëzimit në %
	QPN Fier	75	45	4745	60
	QPN Gorisht	103	98	1024	95
	QPN Kuçovë	456	386	6730	85
	Kompania	634	529	12499	80

Për sa me sipër, janë kryer ndërhyrje në 634 në puse nga të cilat 529 puse kanë rezultuar me dhënie prodhimi, pra rreth 80 % e ndërhyrjeve kanë rezultuar me sukses.

-Janë vënë në punë gjatë muajit Mars dhe Prill 2022 dy puse potencial Ca 57 dhe Ca 62, me teknologjinë Jetë – Pompë në vendburimin Cakran-Mollaj të QPN Fier me punimet e remontit nëntokësor të kryer nga nënkontraktorit privat.

-Këto janë puse me debitë përkatësisht 2.8 ton/ditë për Ca 57 dhe 3 ton/ditë për pusin Ca 62. Vënia në punë e këtyre puseve ka sjellë impakt pozitiv në realizimin e prodhimit të muajit Prill 2022 në Sektorin Cakran-Mollaj duke arritur në një bazë ditore 38 ton/ditë.

-Në muajin Korrik 2022 u vendos në punë pusi Ca 65 me punimet e remontit nëntokësor, pas një kohë të gjatë ndalur me prodhim ditor 1 ton/ditë, të cilit ju ndryshua teknologjia nga Jetë-Pompe në lëkundës. Në 6 - mujorin e II-të nga Albpetrol është ndërhyrë ne 42 puse më shumë se në 6 - mujorin e I-rë me punime të remontit kapital dhe nëntokësor duke dhënë impakt pozitiv edhe ne realizimin dhe madje tejkalimin e bazës mesatare ditore te prodhimit te naftës.

Më poshtë po japim treguesit e këtyre tre puseve potencial ne vendburimin Cakran-Mollaj për vitin 2022 si vijon:

Vendburimi	Pusi	Periudha Janar - Dhjetor 2022	
		Saia e naftës, në ton	Ditët faktike, numër
Vendburimi. Cakran- Mollaj	Ca 57	370	142
	Ca 62	532	157
	Ca 65	119	57
Shuma		1021	356

Volumet e punimeve të remontit nëntokësor për vitin 2022 janë si më poshtë:

Nr	Operacioni	Q.P.N Fier	Q.P.N Gorisht	Q.P.N Kuçovë	Albpetrol.SHA
1	Larje tapa rëre	0	0	0	0
2	Injektione në shtresë	0	0	0	0
3	Kalime ne objekte te rinj	0	0	0	0
4	Përforcime	0	0	0	0
5	Rifreskim pajis. Nëntokësore	0	0	0	0
6	Zëvendësim tubo p-k(komplete)	32	22	57	111
7	Këmbim pompe	39	55	254	348
8	Keputje e zvidhime purteke	0	26	145	171
9	Të tjera	0	0	0	0
10	Naftë me lugë	0	0	154	154
	Gjithsej opërac. Remonti nent.	71	103	610	784
	Ore punë gjithsej	4,745	1,024	7,322	13,091

2.1.2 Prodhimi naftës nga Partneret.

Referuar eksperiencave të mëparshme, në treguesit e kompanisë Albpetrol sh.a Patos përfshihen dhe detyrimet nga aktiviteti i Marrëveshjeve –Hidrokarbure. Aktualisht ne fushat naftëmbajtëse te

shoqërisë Albpetrol sh.a Patos operojnë 6 kompani me te cilat janë lidhur Marrëveshje Hidrokarbure për prodhimin e naftës.

2.1.2.1 Detyrimet e Naftës (PPE+PPA) nga Partneret.

Detyrimi (PPE+PPA) nga kompanitë kontraktore te naftës ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos i llogaritur për vitin 2022 është 43,154 ton kundrejt një programi prej 33,052 ton ose 130.6%, sipas kompanive kontraktorëve detajuar si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Detyrimi (PPE+PPA)			
		Prog.	Fakt	Dif.,-	%
1	B....A.	19,405	29,884	10,479	154.0
2	T...S SHA	2,658	2,559	-99	96.3
3	SH...M Ltd.	557	548	-8	98.5
4	F...M SHA.	80	105	25	130.9
5	A...L &G...Z SHA	9,833	9,794	-38	99.6
6	D...Y Ltd (kondesat)	520	264	-255	50.8
	Totali	33,052	43,154	10,102	130.6

Detyrimet e periudhës ushtrimore, pra detyrimet e vitit 2022 në total për të gjitha marrëveshjet Hidrokarbure janë realizuar në masën 130.6 %.

Po t'i referohemi të dhënave analitike për çdo kompani kontraktore tejkalmi i detyrimeve për naftën prej 10,102 ton vjen kryesisht nga kompania B...A Ltd. Tejkalmi i detyrimeve vjetore ka të bëjë kryesisht me këtë kompani, me sjelljen e nje PP& Buxheti për vitin 2022 të rishikuar në Albpetrol sh.a Patos, mbas miratimit nga instancat eprore të Program & Buxhetit të Albpetrol sh.a Patos, ku janë përfshirë edhe këto detyrime.

Në versionin e fundit i PP & Buxhetit të Bankares, shqyrtuar edhe në mbledhjen e Komitetit Këshillimor, detyrimi vjetor i Pjesës së Prodhimit të Albpetrolit (PPA) deklarohet nga ata i rritur, përlllogaritur me 3%, pra deklaruar në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2022.

Gjithë kompanitë e tjera, përveç B...S dhe F...K, kanë mosrealizim të këtyre detyrimeve për sa i përket naftës. Mosrealizimi kryesor i detyrimeve të këtyre kompanive ndaj Albpetrol sh.a Patos, vjen nga mosrealizimi i Pjesës së Prodhimit të Albpetrolit (PPA) e cila është në varësi të realizimit të Prodhimit të Përgjithshëm të Naftës që kompanitë prodhojnë në zbatim të PP & Buxhetit për vitin 2022.

Nga Albpetrol sh.a Patos , drejtorja e MH dhe sektorin e monitorimit është bërë monitorimi i këtyre kompanive kontraktore.

Theksojmë se në të gjitha rastet, të dhënat për Prodhimin Para-Ekzistues ("PPE") janë përlllogaritur në bazë të Nenit 3.5.1 të Marrëveshjes Hidrokarbure. Por, duhet theksuar fakti që me kontraktorët "A...L & G...Z" SHA., "B...A" Ltd, ka diferenca në përlllogaritjen e PPE-së, për shkak të interpretimit të ndryshëm të zbatimit të formulës përkatëse. Kontraktori "B...A" Ltd, çështjen e rënies eksponenciale të parashikuar në formulë e ka dërguar në arbitrazh ndërkombëtar.

Edhe me shoqërinë "SH...M". dhe "F...M" Ltd, kemi diferenca në përlllogaritjen e PPE-së.

2.1.2.2 Hyrjet e Naftës nga Partneret.

Për vitin 2022 janë bërë hyrje ne Albpetrol sh.a Patos sasia 25,598 ton naftë detajuar me kontraktore si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Hyrjet(PPE+PPA)
1	B...A Ltd.	14,407.612
2	T...S SHA	2,011.008
3	SH...M Ltd.	567.949
4	F...M SHA.	41.201
5	A...L &G...Z SHA	8,570.083
6	D...Y Ltd (kondesat)	0
	Totali	25,597.853

Në 6 mujorin e II-të nga shoqëria është punuar edhe për tërheqjet e naftës detyrim nga koncesionare. Në këtë 6 mujor janë bërë hyrje në kompani rreth 20,266 ton naftë ndërsa në të parin janë bërë hyrje vetëm 5,332 ton naftë. Puna është intensifikuar kryesisht për blerjen nga B...S, A...L etj. Kufizimi dhe shterimi i kapaciteteve depozituese pranë Albpetrol sh.a Patos dhe përgjatë 2022, kushtëzoi dhe bëri të pamundur jo vetëm tërheqjen e detyrimeve të prapambetura por edhe atyre koherente të kontraktorëve të marrëveshjeve hidrokarbure (detyrimet për llogari të P...), gjatë vitit 2022.

2.1.2.3 Detyrimet e Pashlyera të Naftës nga Partnerët.

Detyrimet e mbetura pa shlyera deri më 31 Dhjetor 2022 ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos nga kompanitë koncesionare për naftën bruto rezultojnë 134,401 ton naftë duke u rritur me rreth 17,557 ton krahasuar me fundin e vitit 2021.

Detajuar sipas partnerë kontraktore rezultojnë si më poshtë:

Ton

Nr.	Emërtimi	Detyrime të mbetura pa shlyer (PPE+PPA) deri 31 Dhjetor 2022
1	B...A Ltd.	-78,915.002
2	T...S SHA	-10,332.890
3	SH...M Ltd.	-581.683
4	F...M SHA.	-90.575
5	A...L &G...Z SHA	-29,103.960
6	D...Y Ltd (kondesat)	-2,901.520
7	T...A Ltd	-13,550.010
8	P...X vendburimi.Amonicë	-1,925.500
	TOTALI	-137,401.140

Për detyrimet nga BPAL dhe T...C shoqëria Albpetrol është në Arbitrazh.

Ndikim në drejtim të vjeljes së këtyre detyrimeve ka padysim edhe mungesa e shitjeve në periudha të caktuara dhe kufizimi i kapaciteteve depozituese të Albpetrol sh.a Patos. Është përgjegjësi kryesorë e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure që të gjejë rrugë për vjeljen e detyrimeve jo vetëm vjetore por edhe te prapambetura nga kompanitë koncesionare. Po kështu në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë së Shitjeve duhet të bëhet vjelja e këtyre detyrimeve, jo vetëm në natyrë por dhe në vlerë.

Prodhimi i përgjithshëm i naftës për vitin 2022 (MH + Albpetrol) është si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Prodhimi i Përgjithshëm i Naftës			
		Prog.	Fakt	Dif.+,-	%
1	B...A Ltd.	624,608	542,321	-82,287	86.8
2	T...S SHA	23,474	13,350	-10,124	56.9
3	SH...M Ltd.	1,834	904	-931	49.3
4	F...M SHA.	1,364	2,603	1,239	190.9
5	A...L &G...Z SHA	29,603	27,405	-2,198	92.6
6	D...Y Ltd (kondesat)	6,933	163	-6,770	2.3
	Totali MH	687,816	586,745	-101,071	85.3
7	Albpetrol sh.a Patos	75,920	70,571	-5,350	93.0
	Totali (Albpetrol+MH)	763,736	657,315	-106,420	86.1

1.2 Prodhimi i Gazit

Prodhimi gazit është një tjetër tregues i veprimtarisë së shoqërisë Albpetrol sh.a Patos .i cili përbëhet nga gazi i Albpetrol sh.a Patos, si dhe pjesa e detyrimit (PPE+PPA) që i takon shoqërisë nga hidrokarburet.

1.2.1 Prodhimi i Gazit nga vet Albpetrol.

Gazi i prodhuar nga vet Albpetrol është gaz shoqërues dhe për vitin 2022 është realizuar 110 mijë N/m³ nga 270 mijë N/m³ programuar ose 40.8 % me vendburime si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Prog.	Fakt	Dif.	Ne %
1	QPN Fier	000/Nm ³	100	0	-100	0.0
	Vendburimi Cakran-Mollaj	000/Nm ³	100	0	-100	0.0
	Vendburimi.Gazit	000/Nm ³	0	0	0	0.0
2	QPN Kuçovë	000/Nm ³	170	110	-60	64.8
	Totali	000/Nm³	270	110	-160	40.8

Në lidhje me mosrealizimin e prodhimit të gazit në Q.P.N. Fier - Vendburimi. Cakran - Mollaj nuk është grumbulluar gaz shoqërues pasi ka munguar tregu i shitjes, kryesisht në konsumatorë privatë. Prodhimi i gazit nuk mund të grumbullohet për shitje. Prodhimi i realizuar në këtë periudhë i përket vendburimit Kuçovë i destinuar për shitje drejt konsumatorëve familjarë.

1.2.2 Detyrimi i Gazit nga Partneret.

Në treguesit e kompanisë është përfshirë dhe pjesa e detyrimit (PPE+PPA), që i takon shoqërisë Albpetrol sh.a Patos nga marrëveshjet me kontraktorët. Për vitin 2022 këto detyrime që i përkasin kompanisë D...Y Ltd janë llogaritur 1,354.538 mijë N/m³ kundrejt 3,231.052 mijë N/m³ të programuar ose 42 % si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Prog.	Fakt	Dif.	Në %
1	D...Y Ltd (Gaz)	000/Nm ³	3231.052	1354.538	-1876.514	41.9
	M-H	000/Nm³	3231.052	1354.538	-1876.514	42

Duhet të theksojmë se detyrimi i mësipërm është detyrim i llogaritur, por për vendburimin natyror të Delvinës shlyerja e detyrimit PPE+PPA, dhe për vitin 2022 është zero, duke rritur detyrimet e pashlyera në bazë të licensës të marrëveshjes të lidhur, pra nuk është prodhuar gaz në këtë vendburim.

2.2.3 Detyrimet e pashlyera të Gazit nga Partneret.

Nga kalkulimet e të dhënave detyrimi (PPE+PPA) për produktin Gaz deri me 31 Dhjetor 2022 është 24,426,313 Nm³, e detajuar sipas kontraktorëve, si më poshtë:

Nr.	Kontraktori	Njësia	Detyrimi gjithsej deri 31.12.2022 (PPE+ASP)
1	D...Z	Nm ³	-23,630,398.29
2	Gaz pjesa nga P...X(Frakulla)	Nm ³	-795,914.71
	Shuma M-H	Nm³	-24,426,313.00

Detyrimet e kontraktorëve për prodhimin e gazit ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos kanë ardhur duke u rritur nga njëri 3 muaj në tjetrin, për rrjedhojë nga njëri vit në tjetrin për këtë vendburim.

1.3 Shitja e Naftës

Një nga prioritetet e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos përgjatë vitit 2022 ka qenë shitja e naftës brut. Ky tregues është parë si i tillë nga shoqëria në dy drejtime të rëndësishme:

- Si një në aktivitetet kryesorë të veprimtarisë ku gjenerohen rreth 90% e të ardhurave financiare të kompanisë, si dhe primare në përmirësimin e situatës financiare të saj.
- Si një element themelor për evadimin dhe çbllokimin e gjendjes së naftës në Qendrat e Prodhimit të Naftës, vazhdimin e punës së puseve në gjithë vendburimet e naftës dhe zhvillimin normal të aktivitetit të saj prodhues.

Elementet kryesor në procesin e shitjeve të naftës si produkti kryesor nga ku sigurohen të ardhurat kryesorë të shoqërisë kanë qenë:

1. Volumi i shitjeve
2. Çmimi mesatar i shitjes të naftës brut.

-Për vitin 2022 është realizuar një volum shitje prej 95,883 ton, kundrejt 108,736 ton të programuar ose 88.2%.

Çmimi i shitjes naftës për këtë periudhë është realizuar 51,893 lekë/ton, kundrejt 37,169 lekë/ton i programuar, ose 139.6% që cili ka ardhur duke u ulur nga 54,802 lekë/ton në 6 - mujorin e parë në 50,694 lekë/ton në 6-mujorin e dytë, në varësi kjo të çmimit të naftës Brent në tregun ndërkombëtar.

Më poshtë po japim treguesit e shitjes naftës të realizuar për vitin 2022, të detajuar sipas muajve:

Nr	Muaji	Sasia e naftës, ton	Çmimi Mesatar, lekë/ton	Të ardhurat, 000/lekë
1	Janar	7,145	42,953	306,884,506
2	Shkurt	5,820	47,174	274,544,315
3	Mars	6,213	61,113	379,674,630
4	Prill	503	55,909	28,116,643
5	Maj	208	58,712	12,231,508
6	Qershor	8,091	65,737	531,884,865
7	Korrik	10,545	63,155	665,979,547
8	Gusht	11,059	53,354	590,044,338
9	Shtator	12,351	49,074	606,123,285
10	Tetor	8,897	51,340	456,777,099
11	Nëntor	16,668	47,073	784,631,850
12	Dhjetor	8,383	40,414	338,780,672
	Totali	95,883	51,893	4,975,673,258

Faktorët që kanë ndikuar mosrealizimin e shitjeve të programuara janë:

- Përfundimi i kontratës së shitjes të naftës dhe domosdoshmëria e lidhjes së një kontrate të re në periudhën e parë të vitit.
- Koha e domosdoshme për kryerjen e procedurave të shitjes së naftës me ankand të hapur nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos, i cili përfundoi me sukses në kualifikimin e operatorit ofertues.
- Bllokimi i kapaciteteve depozituese dhe grumbulluese të naftës deri në reduktim të aktivitetit prodhues kryesisht në vendburimin Gorisht – Kocul, si vendburimi me potencial më të madh prodhues.

-Me zhvillimin e ankandit të naftës në 3 mujorin e dytë, u arrit me lidhjen e kontratës së re të shitjes të naftës në Qershor 2022 për sasinë 120,000 ton naftë.

Sasia e naftës tërhequr nga koncesionet dhe parametrat e saj për vitin 2022 janë:

Muaji	B...M			A...O			T...S SHA. (T...L)			F...K			SH...D		
	CTF Fier			Ballsh Hekal			Visoke			Pekisht			Kuçovë		
	Sasia (ton)	densiteti gr/cm ³	H ₂ O %	Sasia (ton)	densiteti gr/cm ³	H ₂ O %	Sasia (ton)	densiteti gr/cm ³	H ₂ %	Sasia (ton)	densiteti gr/cm ³	H ₂ O %	Sasia (ton)	densiteti gr/cm ³	H ₂ O %
Janar	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Shkurt	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Mars	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Prill	1216.62	1.01	1.50	938.95	0.99	0.65	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	91.80	0.98	0.00
Maj	2793.86	1.01	2.30	844.31	0.99	0.30	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Qershor	2789.10	1.01	1.90	918.72	1.00	0.20	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	90.04	0.98	0.00
Korrik	2768.324	1.056	2.5	868.459	0.995	0.2	00	000	00	00	00	00	00	00	00
Gusht	2726.18	1.056	1.8	844.919	0.995	0.5	00	00	00	00	00	00	95.06	0.983	1.01
Shtator	2070.584	1.056	2.1	825.665	0.997	0.4	00	00	00	00	00	00	93.81	0.98	0
Tetor	2555.99	1.006	0.015	919.31	0.991	0.52	00	00	00	00	00	00	00	00	00
Nëntor	2535.74	1.006	0.019	811.77	0.9925	0.7	327.3	1.01 9	1.9	00	00	00	126.4 26	0.983	0.2
Dhjetor	1644.018	1.006	0.019	844.836	0.993	0.6	330.5	1.01 7	1	00	00	00	00	00	00
TOTAL	21100.410	1.04	2	7816.945	0.994	0.4	657.8	00	00	00	00	00	590.0 7	0.983	0.2

Treguesit e furnizimit të naftës nga Qendrat e Prodhimit të Naftës për vitin 2022 janë:

Nr.	Blerë nga QPN	Sasia(ton)	Densiteti gr/cm3	H ₂ O %
1	QPN Fier	26,752.923	0.9624	5.3
2	Gorisht	36,073.465	0.9555	1.05
3	Kuçovë	17,389.851	0.961	1.4
	Totali	80,216.239	0.960	2.58

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se problematikë ka qenë blerja nga QPN Fier (sektori VI dhe Cakran - Mollaj) ku % e ujit është mesatarisht 5.3%, e cila është sjellë brenda standardeve të shitjes në stacionin e shitjeve Zharrëz nga QASHNG Patos.

Rëndësi i është kushtuar transportit të naftës nga magazinat fiskale në Stacionin Qendror të Shitjeve në Zharrëz në funksion të ecurisë normale prodhuese në Qendrat e Prodhimit, grumbullim - depozitimit të naftës bruto në kufijtë e lejuar në dekantimet në stacionet e QP ku bëhet edhe trajtimi e përgatitja për shitje dhe më pas, kalimi në magazinat fiskale, pranë tyre ku dhe shitet.

Shitja e naftës sipas magazinave fiskale për vitin 2022 është si vijon:

Nr	Magazinat Fiskale	Sasia (ton)	H ₂ O %
1	Zharrëz	53,730,468	<3%
2	Gorisht	22,804,235	<3%
3	Amonicë	1,662,791	<3%
4	Kuçovë	15,419,031	<3%
5	Usoje	2,266,782	<3%
	TOTAL	95,883,304	<3%

Gjatë këtij viti është punuar për ndjekjen dhe zbatimin e dy kontratave të shitjes njëra për sasinë 100,000 ton që është lidhur midis Albpetrol sh.a Patos dhe E...A SHA në datën 04.05.2021 dhe tjetra e lidhur midis Albpetrol sh.a Patos dhe Bashkimit të Operatorëve R...N & E...A SHA për sasinë 120,000 ton në datën 03.06.2022.

Për të dyja kontratat e mësipërme treguesit kryesor, duke u bazuar në formulat e llogaritjes të çmimit sipas secilës kontratë të shitjes për vitin 2022 janë:

Nr	Kontrata	Sasia, ton	Densiteti mesatar	y mesatare	Çmimi \$/bbl	Çmimi \$/ton	Çmimi Lekë/ton	Brenti mesatar	Kursi dollarit mesatar
1	E...L	19888	0.960	6.550	69.93	458.03	49799	100.3	108.4
2	BO R...H&E...L	75995	0.970	6.484	72.35	469.09	52358	100.5	115.0
	Totali	95883	0.965	6.517	71.14	463.56	51893	100.4	111.7

Çmimi i shitjes naftës ka qenë në varësi të çmimit Brent i cili gjatë kësaj periudhë ka patur në përgjithësi trend rritës nga 3 – mujori i parë në të dytin dhe në të tretin, dhe më pas rënie në 3 – mujorin e katërt.

2.4 Investimet

Investimet për vitin 2022 janë realizuar në vlerën 243,602 mijë lekë nga 836,126 mijë lekë të programuar ose rreth 29.1 %.

Rreth 73% e vlerës së investimeve të realizuara përgjatë vitit 2022 i përkasin zërit « Makineri e Pajisje ».

Duke qenë se investimet janë një aspekt i Rëndësishëm për shoqërinë, mosrealizimi i tyre ka dhënë efekte në të gjithë treguesit e tjerë të shoqërisë për këtë periudhë, kryesisht në treguesin e prodhimit të naftës. Një zë i rëndësishëm i investimeve janë edhe « Ndërtim Montimet », të cilat për vitin 2022 janë realizuar vetëm 27.1%.

-Sipas strukturës këto investime janë realizuar si më poshtë:

000/lekë

Nr	Emërtimi	Prog.	Fakt	Dif,+	Ne %
	Investime Gjithsej	836,126	243,602	-592,524	29.1
	Nga këto:			0	
1	Ndërtim Montime	230,235	62,449	-167,786	27.1
2	Makineri e Pajisje	565,581	176,833	-388,748	31.3
3	Pajisje e Orendi	2,120	50	-2,070	2.4
4	Studime e Projektme	0	0	0	0.0
5	Shpim Puse & Remonte Kapitale te puseve	8,250	0	-8,250	0.0
6	Mjedisi	6,000	0	-6,000	0.0
7	Informatizim Investime te tjera	23,941	4,270	-19,670	17.8

Në këtë realizim ka ndikuar dhe vlera e investimeve të programuara në Programin e Zhvillimit të Kompanisë në Vitin 2021 të cilat kanë qenë në proces zhvillimi (Procedurë prokurimi, lidhje kontratë, etj.) gjatë këtij viti. Këto investime janë realizuar përgjatë vitit 2022 kryesisht në zërin ndërtim - montime, blerje makineri e pajisje, si dhe në informatizim.

A) **Ndërtim - montime** janë realizuar në vlerën 62,449 mijë lekë nga 230,235 mijë lekë të programuara ose 27.1 %, ku rreth 55,676.4 mijë lekë në këtë realizim e zënë investimet e vitit 2021. -Nga ndërtim montimet gjithsej te realizuara:

a) - *Investimet e vitit 2021* për të cilat procedurat ligjore (procedura prokurimit, kontrata, etj.) ishin në proces gjatë vitit 2021 e në vazhdim dhe janë realizuar ne 2022 janë punimet në vlerën rreth 55,676.4 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

➤ “Përmirësimi i infrastrukturës në stacionin e naftës Zharrëz” objekt në administrim të Q.A.SH.N.G. Patos me vlerë 9,333.7 mijë lekë (vlera e situacionit pjesorë si dhe vlera e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit prej rreth 605.7 mijë lekë, investim në proces nga 2021).

➤ “Ndërtim RVM 1500 m³ në parkun e vjetër në Dekantimin Gorisht me vlerë 13,975.5 mijë lekë, përfunduar në vitin 2022. (vlera e kontratës 15,364.8 mijë lekë dhe vlera e programuar 15,700 mijë lekë).

➤ “Rikonstruksion i zyrave të administratës dhe ambienteve të tjera në Q.M.N. Kuçovë” me vlerë 5,255.67 mijë lekë (vlera e programuar 8,100 mijë lekë në programin e vitit 2021).

➤ “Riparim pjesor dhe pastrim i mbetjeve të RVM 5000/8 m³ në stacionin e shitjes të naftës Zharrëz”, në Q.A.SH.N.G. Patos me vlerë rreth 17,803 mijë lekë, ku në këtë vlerë është e përfshirë dhe vlera prej rreth 442 mijë lekë (Kontrata e mbikëqyrësit dhe e kolaudatorit), investim i programuar në vitin 2021 dhe i realizuar në vitin 2022.

➤ “Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “eternit” i çative të repartit mekanik dhe elektrik”, në Q.M.N. Kuçovë me vlerë rreth 9,308.5 mijë lekë ku në këtë vlerë është e përfshirë dhe vlera prej rreth 121 mijë lekë (Kontrata e mbikëqyrësit dhe e kolaudatorit), investim i programuar në vitin 2021 dhe i realizuar në vitin 2022.

b) *Investimet ndërtimore të parashikuara në vitin 2022* dhe të realizuara nga Albpetrol sh.a Patos gjatë vitit 2022 janë në vlerën 6,772.7 mijë lekë dhe i përkasin:

✓ “Riparim pjesor i një RVM 400 m³ në dekantimin Usojë” me vlerë 1,530.4 mijë lekë, investim i kryer nga Albpetrol sh.a Patos,

✓ “Riparim pjesor i një RVM 60 m³ në Vendburimin Cakran - Mollaj” me vlerë 260 mijë lekë, investim i kryer nga Albpetrol sh.a Patos,

✓ “Riparim pjesor i një RVM 120 m³ në Vendburimin Cakran - Mollaj” me vlerë 439 mijë lekë, investim i kryer nga Albpetrol sh.a Patos,

✓ “Zëvendësim tubacioni magjstral nga Q.17 Vendburimi. Cakran-Mollaj) - Usojë” në Q.P.N. Fier me vlerë rreth 2,008 mijë lekë, investim i kryer nga Albpetrol sh.a Patos,

✓ Riparim RVM 1000/4 në Q.P.N. Gorisht me vlerë 1,859.4 mijë lekë, investim i realizuar nga Albpetrol sh.a Patos.

✓ Riparim RVM 200 m³ në Q.P.N. Kuçovë me vlerë 677.7 mijë lekë, investim i realizuar nga Albpetrol sh.a Patos.

B) Makineri e Pajisje janë realizuar rreth 176,833 mijë lekë nga 565,581 mijë lekë të programuara ose rreth 31.3%, nga të cilat për “blerje makineri e pajisje”, 149,311.3 mijë lekë dhe “Remont makineri e pajisje” 27,521.7 mijë lekë.

B.1-Në investimet për “**Blerje makineri e pajisje**” një peshë të konsiderueshme zënë:

a) *Blerjet e makinerive e pajisjeve të cilat kanë qenë të programuara në programin e vitit 2021 dhe janë realizuar në 2022* të cilat zënë rreth 139,776.2 mijë lekë dhe konkretisht:

- “Zjarrfikës”, për aktivitetin e Q.E.M.N.G. Patos me vlerë 11,129 mijë lekë,
- “Tubo pompe kompresori TS”, për Vendburimi. Cakran dhe Amonicë, me vlerë 22,125 mijë lekë, (75,000 kg*295 lekë/kg)
- “Autobote 30-33 m³”, për aktivitetin e transportit të naftës (Q.F.&T. Patos) me vlerë rreth 58,780 mijë lekë (3 kokë tërheqese+3 rimorkio) *(12090+7503.333) lekë/copë),
- “Distributore elektronik karburanti” me vlerë 589 mijë lekë,
- “Çift rrotor stator” me vlerë rreth 9,975 mijë lekë (10*9975.35 lekë),
- “Kalimates naftë” për stacionet Zharrëz, Usojë, Kuçovë dhe Visokë me vlerë rreth 37,178.2 mijë lekë (2*10,694.318+2*7,894.77).

b) *Blerjet e makinerive e pajisjeve të cilat kanë qenë të programuara në programin e vitit 2022 dhe janë realizuar në 2022* të cilat zënë rreth 9,535.1 mijë lekë dhe konkretisht:

- “Gjenerator saldimi” me vlerë 870 mijë lekë nga 900 mijë lekë vlera e programuar.
- “Blerja e inventar 75kë” me vlerë 2,345 mijë lekë i domosdoshëm për aktivitetin e auto sondës elektrike në administrim të Q.P.N. Fier.
- “Të tjera investime” me vlerë 35 mijë lekë për QPN Fier.
- “Makineri e pajisje” të prodhuara nga Q.M.N. Kuçovë me vlerë rreth 6,285 mijë lekë kryesisht:
1-“Pompa thellësie” për Q.P.N. Fier (Vendburimi. Patos) me vlerë 3,500 mijë lekë (10 copë);
2-“makineri e pajisje të tjera me vlerë 240 mijë lekë”;

3 - RVM të kapaciteteve të ndryshme të nevojshme në aktivitetin e vendburimeve të naftës si vijon:

- RVM 15 m³ (1 copë) me vlerë 668 mijë lekë për Vendburimi. Patos;
- RVM 36 m³ (1 copë) me vlerë 770 mijë lekë për Vendburimi. Cakran-Mollaj në Q.P.N. Fier,
- RVM 3 m³ me vlerë 437 mijë lekë (3 copë) të cilat shërbejnë në aktivitetin e Q.P.N. Kuçovë,
- RVM 20 m³ me vlerë 670 mijë lekë për Q.P.N. Gorisht.

B.2- Në investimet për “**Remontet Kapitale**” përfshihen remontet që bëjnë Q.P.N. Fier, Gorisht dhe Kuçovë, kryesisht remont motorra elektrik, panel elektrikë, reduktorë, etj. dhe transformatorë të fuqive të ndryshme për aktivitetin e qendrave të prodhimit dhe Q.F.SH.E. Patos si

- Q.M.N. Kuçovë - 24,501.2 mijë lekë,
- Q.SH.GJ. Patos - 2,733.4 mijë lekë, dhe
- Remonte të tjera të kryera nga vet qendra (Q.M.N. Kuçovë) me vlerë rreth 287.1 mijë lekë në funksion të aktivitetit të saj.

C) Investimet në “Informatizim” janë realizuar në vlerën 4,270.2 mijë lekë ose 17.84 %. Kjo vlerë i përket investimeve në “Informatizim” të programuara në Vitin 2021 dhe konkretisht “Blerje pajisje kompjuterike” me vlerë rreth 3,328.2 mijë lekë, pajisje këto të nevojshme për mbarëvajtjen e punës në qendra e njësi të kompanisë si dhe investime të tjera në informatizim me vlerë 942 mijë lekë, investime për aktivitetin e punës në kompani (Financa 5, shtim poste punë).

3. Treguesit Ekonomik Financiare

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos, për vitin 2022 ka realizuar fitim bruto rreth 412.2 milion lekë.

Janë realizuar të ardhura rreth 6.59 miliardë lekë dhe janë kryer shpenzime rreth 7.6 miliardë lekë. (përfshirë këtu 2.12 miliardë lekë për krijimin e provizioneve).

Efekt pozitiv ka dhënë edhe ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces në vlerën rreth 1.42 miliardë lekë, ku efektin më të madh e ka produkti naftë.

Fitimi neto vjetor rezulton rreth 15 mln lekë, pas zbritjes së tatimit prej 397.3 mln lekë.

Detajuar treguesit financiare kryesorë paraqiten si më poshtë vijon:

000/lekë

Nr	Emërtimi	Prog.	Fakt	Dif, +,-	Real. %
1	Të ardhura Gjithsej	5,851,206	6,587,574	736,367	112.6
2	Shpenzime Gjithsej	5,491,683	7,590,618	2,098,935	138.2
3	Ndryshimi I gjendjes produkteve dhe prodhimit ne proces	0	1,415,277	1,415,277	0.0
4	Fitimi Bruto para Tatimit	359,523	412,233	52,710	114.7
5	Shpenzime Tatim fitimi, 000 lekë	53928	397317	343,389	736.7
6	Fitimi Neto para tatimit ,000 lekë	305,594	14,916	-290,678	4.9

Të ardhurat gjithsej përfshirë këtu shitjen e produkteve dhe nënprodukteve, punën e kapitalizuar dhe të tjera financiare, janë realizuar 112.6 % e programit për vitin 2022.

Shpenzimet gjithsej janë realizuar 138.2 % të programit. Në këto shpenzime janë përfshirë rreth 2.118 miliardë lekë për krijimin e provizioneve të detajuara si më poshtë vijon:

Shpenzimet e kompanisë (pa provizionet) janë realizuar 5,472,624 mijë lekë ose 99.7% e programit vjetor.

Në treguesit financiar faktik kryesorë të shoqërisë përveç të ardhurave dhe shpenzimeve është përfshirë edhe ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces në vlerën 1,415,277 mijë lekë. Duke filluar nga muaji Shkurt 2022, në evidencën e bilancit të grumbullimit dhe shpërndarjes të naftës për kompaninë, nuk janë përpunuar të dhënat për vitin 2022, referuar faktit që bilanci i dërguar nga Qendra e Administrim Shitjeve të Naftës dhe Gazit ka patur problematika të cilat janë bërë prezente zyrtarisht nga Drejtoria e Programimit, pasi nevojitet vendimmarrja e shoqërisë.

3.1. Të Ardhurat

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit sipas pasqyrës PASH të bilancit kontabël të shoqërisë janë realizuar 6,587,574 mijë lekë.

Krahasuar me ato të programuara 5,851,206 mijë lekë janë realizuar 112.6 % ose me tejkalim prej 736,367 mijë lekësh, kryesisht nga tejkalimi i të ardhurave nga shitja e naftës.

-Sipas burimeve të krijimit të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin 2022 rezultojnë si më poshtë:

000/lekë

Nr	Emërtimi	Prog.	Fakt	Dif, +,-	Real. %
1	Nga shitja e naftës	4,041,606	4,975,673	934,068	123.1
2	Nga shitja e gazit	277,460	4,660	-272,801	1.7
3	Nga shitja e energjisë	1,518,054	1,486,848	-31,206	97.9
4	Te tjera (sherb., invest.financ. etj)	14,087	120,393	106,306	854.7
	TOTALI	5,851,206	6,587,574	736,367	112.6

A)Të ardhurat nga shitja e Naftës.

Shitja e naftës, përbën burimin kryesor të ardhurave vjetore të kompanisë, të cilat janë realizuar me 123.1 % krahasuar me programin ose me tejkalim prej 934,068 mijë lekësh.

Sipas 3 - mujorëve realizimi i të ardhurave nga shitja e naftës është si vijon:

000/lekë

Nr.	3-Mujorët	Prog.	Fakt	Dif,+,-	Realiz.ne %
1	3.M-I	1,008,760	961,103	-47,657	95.3
2	3.M-II	1,013,858	572,233	-441,625	56.4

Nr.	3-Mujorët	Prog.	Fakt	Dif,+,-	Realiz.ne %
3	3.M-III	1,014,801	1,862,147	847,346	183.5
4	3.M-IV	1,004,187	1,580,190	576,003	157.4
	TOTALI	4,041,606	4,975,673	934,068	123.1

Rreth 19.3% e të ardhurave nga shitja e naftës janë realizuar në 3 - mujorin e parë, 11.5% në 3 – mujorin e dytë, 37.4% në 3 – mujorin e tretë dhe 31.8% në 3 – mujorin e katërt.

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në tejkalimin e të ardhurave nga shitja e naftës prej 934,068 mijë lekë për vitin 2022 janë kryesisht sasia e shitjeve dhe çmimi mesatar i shitjes. -Efektet janë si më poshtë:

- Mosrealizimi o sasisë se naftës shitur prej 12,853 ton krahasuar me programin vjetor ka sjellë uljen e Të ardhurave nga shitja e naftës me -477,729 mijë lekë.
- Tejkalmi i çmimit mesatar të shitjes se naftës me 14,724 lekë/ton krahasuar me programin vjetor ka sjellë rritjen e Të ardhurave nga shitja me 1,411,796 mijë lekë.

B) Të ardhurat nga shitja e Gazit.

Të ardhurat nga shitja e gazit janë realizuar 1.7 % krahasuar me programin. Në program ishte parashikuar të shitej dhe prodhimi detyrim PPE+PPA nga MH ne vendburimin e Delvinës me kompaninë D...Z.

-Ndikim ne këtë mosrealizim të lartë ka:

- Mos prodhimi gazit në vendburimin e Delvinës dhe mos shlyerja e detyrimit PPE & PPA nga kontraktori.

- Mosrealizimi i prodhimit të gazit shoqërues nga Albpetrol sh.a Patos për vitin 2022 me 160 mijë N/m³, kryesisht nga vendburimi Cakran - Mollaj nga i cili ishte programuar të grumbullohej 100 mijë Nm³ gaz ku në fakt nuk është grumbulluar asnjë Nm³ pasi nuk ka patur treg për shitjen e tij. Po kështu gazi shoqërues në vendburimin e Kuçovës për vitin 2022 është realizuar 110 mijë Nm³ gaz kundrejt 170 mijë Nm³ qe është programuar. Mungesa e tregut të shitjes është dhe faktori kryesor nga ku varet grumbullimi i gazit shoqërues, dhe shitja e tij.

- *C) Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike.*

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike janë realizuar 1,486,848 mijë lekë, nga shitja të tretëve kryesisht kompanive kontraktore që operojnë me Marrëveshje Hidrokarbure në vendburimet e naftës. Këto të ardhura janë realizuar 97.9 % krahasuar me programin, pra mos realizim në vlerën prej rreth 31.2 milion lekë.

Këto të ardhura i përkasin periudhës 8 - mujore Janar - Gusht 2022, pasi nga shtatori deri në Dhjetor 2022, për mungesë çmimi shitje për të tretët nga ana e shoqërisë, QFSHE nuk ka bërë faturime në vlerë. Kontraktori A...Oil & Gaz për vitin 2022 nuk ka pranuar matjet e energjisë elektrike të evidentuara nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos, nëpërmjet QFSHE, duke ndikuar kështu jo vetëm në mosrealizimin e të ardhurave nga shitja e energjisë, por në mbylljen përfundimtare të bilancit të shpërndarjes së energjisë, sasisë së humbjeve, etj për vitin 2022.

D) Të ardhurat të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit

Të ardhura të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit për këtë periudhë janë realizuar 120,393 mijë lekë, kryesisht nga kryerja e shërbimeve, investimeve dhe prodhimeve brenda ekonomisë, qera, interesa, bonuse, gjoba penalitete etj, të detajuar si më poshtë:

- Investime 33,134,365 lekë
- Shitje shërbime 6,231,558 lekë
- Nga qiratë 4,867,439 lekë
- Shitje brenda grupit 47,245,525 lekë
- Konsum vetjak 423,466 lekë
- Gjoba penalitete 6,394,992 lekë
- Nga konvertimi valutor 6,154,582 lekë
- Nga bonuset 13,955,424 lekë
- Nga grantet 795,285 lekë.

- Te tjera 1,190,131 lekë.

-Efekte në uljen e të ardhurave gjithsej për vitin 2022 kanë dhënë:

- 1) Mosrealizimi i prodhimit të naftës nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos prej 5,350 ton
- 2) Mos vjelja e detyrimeve vjetore të naftës nga MH dhe mos shitja e tyre prej 17,557 Ton.
- 3) Mosrealizimi i prodhimit të gazit nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos me 160 mijë N/m³.
- 4) Mosrealizimi i sasisë të shitjeve të naftës, prej 12,853 ton.

3.2 Shpenzimet dhe kostoja për njësi/prodhimi

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos për vitin 2022 ka realizuar gjithsej 7,987,935 mijë lekë shpenzime. Këto shpenzime përbëhen:

1. Shpenzime për kryerjen e operacioneve hidrokarbure dhe administrative 5,472,623 mijë lekë.
2. Provizione 2,117,994 lekë përlllogaritur për kërkesat e arkëtueshme të shoqërisë.
3. Shpenzime për tatim fitimin 397,317 mijë lekë.

Analiza e detajuar ekonomike e shpenzimeve që ndikojnë direkt në kosto/njësi prodhimi, shpenzimet për kryerjen e operacioneve hidrokarbure dhe administrative, paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime operacionale dhe administrative që kryhen nga shoqëria në funksion të procesit të prodhimit të shoqërisë mbi bazën e të cilave behet llogaritja e koston/njësi prodhimi në vlerën 3,769,657 mijë lekë.
- Shpenzimet jashtë koston në vlerën 1,702,967 mijë lekë, i përkasin kryesisht shpenzimeve për blerje energjie elektrike që vijnë nga koncesionare dhe të tretët dhe që nuk marrin pjesë në procesin e prodhimit të kompanisë.

Struktura e shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Prog	Fakt	Dif, +, -	Real %
1	Shpenzime Konstante	2,315,392	1,943,315	-372,076	83.9
2	Shpenzime Variabel	773,342	489,179	-284,163	63.3
3	Shpenz.te Tjera(Administr.+Detyrim Ligjor)	1,400,634	1,337,163	-63,471	95.5
4	Rezerve	10,000	-	-10,000	-
	Shuma - 1	4,499,367	3,769,657	-729,710	83.8
5	Shpenz.jashtë koston(energji elektrike III)	992,316	1,702,967	710,651	171.6
	Shuma -2	5,491,683	5,472,623	-19,060	99.7
6	Provizione	-	2,117,994	2,117,994	-
	Shuma -3	5,491,683	7,590,618	2,098,935	138.2
7	Shpenz.tatim fitimi	53,928	397,317	343,389	736.7
	Totali	5,545,612	7,987,935	2,442,323	144.0

3.2.1. Shpenzimet (operacionale) për llogaritje kosto

Shpenzimet operacionale, pra shpenzimet që janë realizuar nëpërmjet veprimtarinë e shoqërisë për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, administrative dhe ligjore, janë realizuar në vlerën 3,769,657 mijë lekë ose 83.8 % të parashikimit në program.

Referuar praktikave këto shpenzime kryen nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos për aktivitetin e saj prodhues mbi bazën e të cilave është pranuar edhe llogaritja e koston/njësi prodhimi.

Sipas strukturës shpenzimet operacionale prej 3,769,657 mijë lekë janë realizuar:

- konstante 1,943,915 mijë lekë ose 51.6 %
- variable 489,179 mijë lekë ose 13.0 %.
- Të tjera (Administrative + Detyrim ligjor) 1,337,163 mijë lekë ose 35.4 %

Përgjithësisht të gjitha Qendrat e shoqërisë për këtë periudhë nuk kanë realizuar shpenzimet gjithsej krahasuar me parashikimet e programit.

3.2.1.1 Shpenzimet konstante

Këto shpenzime për vitin 2022 zënë 51.6 % të shpenzimeve operacionale gjithsej, me një mos realizim 372,076 mijë lekë kundrejt programit si më poshtë:

- a. Paga & trajtimet e punonjësve -287,979 mijë lekë
 - *Fond page* - 134,748 mijë lekë
 - *Trajtime & shpërblime & ndihma ekonomike* -153,231 mijë lekë
- b. Sigurimet shoqërore & shëndetësore -46,330 mijë lekë
- c. Amortizimi -37,768 mijë lekë

Mosrealizimi në zërin “Fond page” ka ardhur si pasojë e mosrealizimit të numrit mesatar vjetor të punonjësve me 145 punonjës më pak se programi i cili ishte 1790 krahasuar me realizimin prej 1645 punonjës, si dhe pagës mesatare me 1,798 lekë më pak se programi i cili ishte 57,160 krahasuar me realizim prej 55,363 lekë/muaj.

-Shpenzimet e amortizimit rezultojnë me një diferencë prej 37,768 mln lekë llogaritur konform rregullave të kontabilitetit. Shpenzimet në këtë zë janë programuar sipas normave të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës me vendim Nr. 4, datë 11.04.2018.

3.2.1.2 *Shpenzimet variabël*

Këto shpenzime janë më të rëndësishme pasi kryhen direkt në pusët e naftës, grupe, dekantime dhe stacione pra direkt në prodhim apo shërbime. Ato janë realizuar në vlerën 489,179 mijë lekë krahasuar me parashikimin prej 773,342 mijë lekë, ose 63.3%.

Me rritjen e nxjerrjes së naftës në 3 - mujorët e tretë dhe të katërt, kryerja e këtyre shpenzimeve rrit krahasuar me 3 - mujorin e dytë ku janë kryer më pak, kjo për faktin se vazhdoi reduktimi i puseve në punë dhe kryesisht në vendburimin Gorisht - Kocul dhe Amonicë, nuk janë kryer shumë operacione hidrokarbure dhe janë bërë pak shpenzime në puse, grupe, stacione etj. Qendra e Prodhimit Gorisht, si qendra me prodhimin më të lartë në kompani, e programuar me më shumë shpenzime variabël, me fillimin e shitjes së naftës filloi çbllokimi në dekantime, depozita grumbulluese, stacione e shitjesh. Rikthimi në normalitet të aktivitetit prodhues dhe tregtar u shoqërua me operacione intensive hidrokarbure, shpenzime materiale shtesë, shërbime të brendshme dhe me palë të treta, punime dhe zëvendësime pjesore në tubacione dhe magjistrale, punime të remontit nëntokësor, etj.

Më poshtë paraqiten detaje mbi shpenzimet variabël që ndikojnë në prodhim:

Në zërin *Shpenzimet Materiale* të cilat janë realizuar 53.4 % e programit, përfshihen materiale për puse, grupe, tubacione, magjistrale, stacione dhe mjete që shërbejnë në funksion të tyre, si karburant dhe lubrifikant, rripa, servo, acid, pjesë këmbimi, materiale, vlera e të cilave është 206,065 mijë lekë. Brenda kësaj kategorie shpenzimet për *karburant, lubrifikant* për mjetet janë realizuar rreth 65.0 milion lekë kundrejt 105.163 milion lekë të programuara ose 61.8 %.

Harxhimi i karburant – lubrifikantëve për mjetet në natyrë për këtë vit është realizuar:

Nr.	Emërtimi	Për vitin 2022			Realizim në %
		Program.	Fakt	Dif, +,-	
1	Gazoil, 000/litra	500.000	310.685	-189.315	62.1
2	Benzine, 000/litra	5.000	1.645	-3.355	32.9
3	Lubrifikante, 000/litra	46.260	15.784	-30.476	34.1

-Në 3 - mujorin e parë janë konsumuar për mjetet 71.527 mijë litra rreth 23% e totalit, në 3 - mujorin e dytë janë konsumuar për mjetet 60.175 mijë litra rreth 19.4% e totalit, në 3 - mujorin e tretë janë konsumuar për mjetet 74.449 mijë litra rreth 24% e totalit në 3 - mujorin e katërt janë konsumuar për mjetet 104.534 mijë litra rreth 33.6% e totalit.

Për vitin 2022 konsumi i gazoilit evidentuar nga Drejtoria e Logjistikes sipas grup mjeteve paraqitet:

- Autovetura 56.185 mijë litra
- Fuoristrade 24.348 mijë litra
- Autobus, Furgonë 15.024 mijë litra
- Skrep 20.913 mijë litra
- Zjarrfikës 4.000 mijë litra
- Kamion 67.689 mijë litra

- Zetora 6.168 mijë litra
- Autobote 40.233 mijë litra
- Moto saldimi +gjeneratorë 8.733 mijë litra
- Auto sonda 10.830 mijë litra
- Traktorë pastrimi 14.943 mijë litra
- Nevoja teknologjike+etj 20.308 mijë litra

Ne zërin kimikate kryesisht servo (demulgator) në Qendrat e prodhimit është respektuar programi Në këtë zë janë shpenzuar -8.9 mln lekë më pak se programi. Si kompani janë konsumuar 15.2 ton servo kundrejt 19.06 ton të programuar.

Në shpenzimet për rripa për kompaninë nuk ka tejkalime si ne vlerë dhe ne sasi. Janë konsumuar 2,644 copë rripa nga 5,247 copë të programuar dhe ne vlerë janë kursyer rreth 7.8 milion lekë.

-Në zërin pjesë këmbimi dhe materiale të tjera realizimi është në vlerën rreth 126 milion kundrejt rreth 248.8 milion ose rreth 50.7 %.

-Shpenzimet për lëndë djegëse janë realizuar 66,354 mijë lekë kundrejt 173,839 mijë lekë ose 38.2% e programit. Këto shpenzime i përkasin:

a) konsumit të solarit për kaldajën në stacionin e shitjes Zharrëz, në QASHNG, në sasinë vjetore 43.608 ton kundrejt 250 ton të programuar. Në vlerë këto shpenzime janë realizuar 5,275 mijë lekë kundrejt 32,500 mijë lekë. Konsumi nën program në stacionin Zharrëz ka të bëjë me faktin që sasia e naftës që kërkon trajtim e përgatitje për shitje në këtë stacion ka qenë më e vogël se ajo e programuar dhe në këto kushte kaldaja ka punuar më pak orë punë. Sasia prej 20 ton solar e programuar në furrën Amonicë nuk është përdorur pasi nuk ka qenë e domosdoshme për vitin 2022.

b) Konsumi i gazoilut për kaldajën në stacionin e dekantimit Gorisht paraqitet në sasinë 336.253 mijë litra krahasuar me 480 mijë litra të programuara. Në këtë sasi, 3 mujori i parë nuk ka konsum, pasi në 3 mujorin e parë mungoi gazoili duke qenë se përfundoi kontrata ekzistuese, kontrata e garancive doganore dhe kaldaja e instaluar për trajtim naftë në dekantimin Gorisht nuk punoi. Ndikim në mosrealizimin e këtyre shpenzimeve ka mos shitja e naftës sipas programit vjetor kryesisht në 6 mujorin e parë, mos trajtimi i emulsionit të naftës gjatë 3 mujorit të parë në dekantimin e naftës Gorisht dhe ndaljen e vendburimit në këtë 3 mujor. Shpenzimet paraqiten në vlerën 60,730 mijë lekë krahasuar me 76,320 mijë lekë të programuara ose 79.6 %.

c) Konsumi i gazoilut për kaldajën në stacionin e dekantimit Kuçovë. Megjithëse ishte programuar sasia prej 250 mijë litra, në fakt nuk është konsumuar pasi nuk u realizua investimi i programuar “RVM 400 M3 me ngrohje në Dekantimin Kuçovë”, për të cilin do të përdorej gazoili.

d) Konsumi i gazit të lëngshëm i programuar në sasinë 250 mijë litra për QPN Fier në RVM -të e sektorit Patos, në Zharrëz dhe Usojë, investime të cilat nuk janë kryer, dhe si pasojë nuk ka shpenzime.

e) Përdorimi i naftës së vendburimit Pekisht dhe Drashovicë për reduktorët në QPN Kuçovë, QPN Gorisht dhe një pjesë në UMN Kuçovë. Këto shpenzime janë realizuar 349 mijë lekë kundrejt 669 mijë lekë ose 52.2%. Janë përdorur 9.398 ton kundrejt 18 ton të programuar.

- Shpenzimet për energji elektrike.

Për vitin 2022 shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka blerë, ka shpenzuar për *energji elektrike* gjithsej (për Albpetrol sh.a Patos dhe furnizim për kontraktorët) në vlerën rreth 2.117 miliardë lekë kundrejt 1.313 miliardë lekë të programuar me një tejkalim prej 803.8 milion lekë ose rreth 161.2 % të programit, në varësi të sasisë energjisë aktive dhe reaktive dhe çmimit përkatës të blerjes/njësi. Në lidhje me tejkalimin e shpenzimeve të blerjes së energjisë. Ky tejkalim argumentohet si më poshtë:

- Kryesisht prej rritjes së çmimit të blerjes së energjisë elektrike në treg nga FSHU, si pasojë edhe shoqëria Albpetrol sh.a Patos e ka blerë energjinë aktive që zë peshën kryesore në shpenzimet totale të energjisë me çmimin rreth 18.8 lekë kundrejt 11.0 dhe 14 lekë mesatarisht programuar nga shoqëria. Ky çmim është transmetuar në koston e Qendrave të Prodhimit dhe Shërbimit të kompanisë si dhe në çmimin e shitjes së energjisë të tretëve përlllogaritur (Janar - Gusht 2022) në varësi të këtij çmimi në bazë të metodologjisë të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.

11, datë 16.05.2022, me ndikim edhe ne tejkalimin e të ardhurave mujore që shoqëria Albpetrol sh.a Patos merr nga shitja e kësaj energjie.

- Ndikim në këtë tejkalim ka blerja e rreth 1.8 milion kwh energji aktive nga kompania Albpetrol sh.a Patos e cila i përket konsumit nga kontraktorët.

Në bazë të bilancit operativ të blerjes së energjisë për vitin 2022 në shpenzimet e blerjes të energjisë për kompaninë (blerë nga QFSHE dhe QPN Gorisht) për këtë vit përfshihen:

- Energjia që konsumohet nga Albpetrol sh.a Patos që rëndon koston e kompanisë në vlerën rreth 414.4 milion lekë kundrejt programit prej 321.2 mln lekë.

- Energjia e blerë për tu furnizuar jashtë kompanisë që konsumohet nga kontraktorët e MH dhe privatë te tjerë, që janë jashtë kosto/njësi të shoqërisë në vlerën rreth 1.703 miliardë lekë kundrejt programit prej rreth 992.4 milion lekë. Për periudhën 4 mujore Shtator - Dhjetor 2022 ka munguar çmimi i shitjes së energjisë në të tretë nga shoqëria dhe nga QFSHE nuk është faturuar energjia e konsumuar kryesisht nga kontraktorët duke ndikuar edhe në uljen e të ardhurave nga energjia për vitin 2022.

Gjithashtu, kontraktori A...Oil&G...Z për vitin 2022 nuk ka pranuar matjet e energjisë elektrike të evidentuara nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos nëpërmjet QFSHE, duke ndikuar kështu jo vetëm në mosrealizimin e të ardhurave nga shitja e energjisë, por edhe në mbylljen përfundimtare të bilancit të shpërndarjes së energjisë në vlerë dhe shpenzimeve për humbjet për vitin 2022.

Nga analiza e bërë veçmas aktivitetit të Qendrës Furnizimit dhe Shërbimit Elektrik Patos e cila objekt të punës së vetë ka furnizimin me energji elektrike të gjithë Qendrave të shoqërisë (përveç vendburimit Gorisht - Kocul dhe Karbunarë), si dhe firmave koncesionare, për këtë vit. **Aktiviteti elektrik ka rezultuar me humbje rreth 671.5 milion lekë**, përfshirë këtu edhe koston e shërbimit të QFSHE, në kushtet e mos faturimit të energjisë të të tretëve për periudhën Shtator - Dhjetor 2022.

Për vitin 2022 blerja e energjisë elektrike për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos është bërë nga QFSHE Patos dhe QPN Gorisht.

Energjia elektrike në natyrë e blerë për vitin 2022 nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos paraqitet si më poshtë:

000/kwh

Nr.	Emërtimi	E.Aktive			E.Reaktive		
		Prog.	Fakt	Dif, +,-	Prog.	Fakt	Dif, +,-
1	QFSHE	105607	108469	2862	26539	27770	1230
2	QPN Gorisht	3043	2003	-1040	11993	7831	-4162
	TOTALI	108650	110472	1822	38533	35601	-2932

Bilanci operativ i shpërndarjes së energjisë elektrike për kompaninë Albpetrol sh.a Patos për vitin 2022 konsiston:

000/kwh

Nr	Emërtimi	E.Aktive			E.Reaktive		
		Prog.	Fakt.	+,-	Prog.	Fakt.	+,-
1	Blerje	108650	110472	1822	38533	35601	-2932
2	Shpërndarje	96009	99369	3360	32566	31003	-1563
a.	Qendrave- shoqërisë	10097	9233	-864	18513	15657	-2856
b.	Te tretëve	85912	90135	4223	14053	15345	1293
3	Humbje	12641	11103	-1538	5967	4598	-1369

- Shërbimet teknologjike.

Për të patur një panoramë me të saktë të koston variabël/njësi prodhimi në këtë kategori janë përfshirë vetëm shërbimet lidhur me teknologjinë në puse, si ato për punime me auto sondë me të tretë, riparimeve të mjeteve, transportit të mallrave, punimeve me autobot, karotazh, gjeofizikë,

transport naftë bruto, ato për transmetimin e gazit etj, si shërbime që ndikojnë direkt në prodhimin e naftës, ku ato që kryhen brenda kompanisë pra nga qendrat e shërbimeve janë të evidentuara por nuk përfshihen në shpenzimet totale, pra nuk janë shpenzime të kompanisë. Shërbimet e tjera të karakterit ligjor, pra që nuk varen nga prodhimi, por janë detyrim, si psh : ruajtja e objekteve, marrja e tokave me qera dhe zhdëmtimet e tyre, janë përjashtuar nga kostoja variabël dhe është pranuar të përfshihen në një kategori të tretë të shpenzimeve të « Tjera », ku përfshihen ato *administrative dhe ato si detyrim ligjor* me efekt në koston totale të kompanisë.

Për këtë vit shpenzimet në zërin « Shërbime teknologjike » janë realizuar në vlerën 19,232 mijë lekë ose 42.7% krahasuar me programin. Peshën më të madhe specifike në këtë shpenzim e zënë ato për shërbimin e transportit të naftës brut ne vlerën 13,317 mijë lekë dhe 5,283 shërbime me auto sondë ne sektorin Cakran - Mollaj dhe Amonicë. Ndërsa shpenzimet prej 631 mijë lekë janë shërbime për riparime të vogla mjetesh me të tretë.

Shërbimi i transportit të naftës brut i përket shërbimit të kontraktuar me subjekte të tretë dhe është kryer në bazë te kontratës te lidhur në vitin 2021 me nr.3510/10, datë 13.07.2021. Ky shërbim me te tretë është realizuar ne vlerën 13,317 mijë lekë kundrejt 24,600 mijë lekë te programuara ose 54.13%. Janë transportuar gjithsej 16,803.440 ton naftë në distancën rreth 44.03 km me tarifën 18 lekë/ton/km dhe volum transporti prej 739,860.72 ton/km. Kjo kontratë ka përfunduar me 13 korrik 2022.

Me përfundimin e kontratës së transportit te naftës brut me të tretë dhe shtimin e inventarit të mjeteve autobot të QFT-së, nevojat për këtë shërbim janë plotësuar nga vetë shoqëria.

Shërbimi me auto sondë me kontraktore te tretë ka vazhduar te kryhet ne sektorin Cakran-Mollaj te QPN Fier kryesisht në pusët Ca 57 dhe Ca 62 ku është punuar rreth 145 ditë gjithsej ne te dy pusët dhe është marre nje prodhim naftë rreth 490 ton. Gjithashtu këto punime janë kryer edhe ne sektorin Amonicë. Për këtë shërbim si kompani janë realizuar gjithsej 5,283 mijë lekë shpenzime pasi kanë qenë te domosdoshme për vënien ne punë te këtyre puseve me debitë të konsiderueshme për këto vendburime dhe janë kryer në bazë te kontratës së lidhur me të tretë.

-Në shpenzimet në zërin “Të tjera” ku përfshihen ato me karakter admirativ, si : dietat, kancelari të ndryshme, shpenzime protokollare, bankare, post - telecom, taksa e kolaudime mjetesh, gjyqe, gjoba , honorare, taksa vendore, siguracioni, shpenzime auditimi, etj, *si dhe ato shërbime të cilat shoqëria i ka detyrim ligjor* për ti kryer, që nuk varen nga prodhimi i naftës si : ruajtja e objekteve, transporti i punonjësve, siguracioni i mjeteve, kolaudimi dhe taksat e mjeteve, furnizim me ujë të pijshëm, shërbimet e garancisë për sistemet IT, shërbimet për monitorimin e mjedisit dhe sigurimit teknik të mjeteve, pajisjeve dhe punonjësve, shërbime në lidhje çertifikimin e pronave, etj të këtij karakteri. Këto shpenzime zënë një peshë të konsiderueshme në shpenzimet totale të kompanisë dhe janë realizuar 1.337 miliardë lekë kundrejt 1.401 miliardë lekë të programuara, me nje realizim 95.5%.

-Tejkalimet ka në zërin “Shpenzime për siguracioni, taksa vendore, tatime etj”, të cilat për vitin 2022 janë realizuar 210,117 mijë lekë kundrejt 187,100 mijë lekë, dhe kanë të bëjnë me likuidimin jo vetëm të detyrimit vjetor të taksave vendore 2022, por edhe marrja nga Bashkia Roskovec të vlerës prej 49,999,900 lekë me ekzekutim nga banka për llogari të situacionit të detyrimit të vitit 2021 (vlera 7,800,000 lekë) dhe për llogari të situacionit të detyrimit të vitit 2022 (vlera 42,199,900 lekë), çështje kjo e cila është në gjykatë. Po kështu në program është planifikuar 29,100 mijë lekë për auditimin e Pasqyrave Financiare, pra për ekspertët kontabël dhe janë shlyer përveç këtij detyrimi dhe 10,458 mijë lekë për shërbimin e vitit 2021.

Shpenzimet vjetore për “tatim pasurie, taksa mjetesh, siguracioni, taksat bashkiake dhe komunave, rivlerësime AA” të detajuara ne fakt janë si më poshtë:

- 210,117 mijë lekë e zë tatimi i pasurisë dhe taksat bashkiake e të komunave;
- 565 mijë lekë janë shpenzuar për rinovim leje mjedisore.
- 11,335 mijë lekë për garancitë doganore;
- 39,558 mijë lekë shpenzime për auditim bilanci ;
- 18,872 mijë sigurimi i jetës punonjësve
- 4,160 mijë lekë për siguracioni mjetesh.

- 4,785 mijë lekë shpenzime për akt – padi të ndryshme.
- 6,118 mijë lekë taksa, kolaudime mjetesh dhe depozitash, pasaporta dhe çertifikata për mjetet etj.

Shpenzimet për gjyqet dhe tarifat përmbartimore janë likuiduar në vlerën rreth 96,816 mijë lekë kundrejt 107,990 mijë lekësh të programuara ose 89.7%.

Shpenzimet në zërin “Humbje” përfshijnë ato që i përkasin humbjeve të naftës dhe energjisë elektrike. Vlera e humbjeve varet nga sasia dhe çmimi i vlerësimit të tyre.

Kështu humbjet ligjore të naftës në sasi për vitin 2022 janë 190.384 ton. Humbjet faktike i përkasin firove të transportit (95.192), firove për operacione të thjeshta (95.192). Këto humbje janë në përputhshmëri me vendimin Nr.612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat, Aneksi 3, 4, Kodi nr.2709”. Këto humbje në vlerë janë realizuar 6,631 mijë lekë kundrejt 8,101 mijë lekë të programuara në kushtet e mos realizimit të transportit të naftës në sasi dhe shitjeve të naftës sipas programit.

Në lidhje me humbjet e energjisë elektrike për vitin 2022, shpenzimet për to janë operative në mbështetje të bilancit operativ vjetor të blerjes dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, mos shitjes së energjisë konsumatorëve privat si pasojë e mungesës të çmimit të shitjes të energjisë për 4 mujorin Shtator - Dhjetor. Pavarësisht se humbjet e energjisë elektrike qoftë të asaj aktive dhe reaktive në natyrë (në kwh) nuk janë realizuar kundrejt programit, tejkalimi i çmimit të blerjes së energjisë (çmim me të cilin ato kontabilizohen), jep efekt në tejkalimin në vlerë të shpenzimeve të tyre. Sasia e humbjeve të energjisë elektrike të realizuara në kwh sipas bilancit operativ në natyrë të energjisë për shoqërinë, janë brenda atyre të programuara. Humbjet për energjinë elektrike aktive janë realizuar 11,103 mijë kwh kundrejt 12,641 mijë kwh të programuara. Koeficienti i humbjeve në QFSHE në % aktive është realizuar 10.24% kundrejt 11.97% i programuar për energjinë aktive. Përmirësimi i koeficientit të humbjeve në fakt për këtë periudhë ka ardhur si rezultat i përmirësimit të raportit të energjisë të shitur me energjinë e blerë. Sasia e humbjeve për energjinë reaktive është realizuar 4,598 mijë kwh kundrejt 5,967 mijë kwh të programuar ose -1,369 mijë kwh më pak.

Shpenzimet që i përkasin « Rentës » janë realizuar në vlerën prej 498,033 mijë lekë kundrejt 404,161 mijë lekë të programuar ose 123.2 %. Tejkalimi është si pasojë e rritjes të çmimit të shitjes të naftës me 14,724 lekë/ton kundrejt programit.

Për vitin 2022 janë kryer edhe disa shpenzime të tjera që përkasin atyre për procesin e Arbitrazhit të cilat janë likuiduar në vlerën 108,797 mijë lekë nga 150,000 mijë lekë të programuara. Këto shpenzime janë përfshirë në përlllogaritje kosto/njësi për efekte krahasuese pasi janë programuar dhe miratuar.

3.3 Kosto për njësi prodhimi

Referuar praktikës së deritanishme, përlllogaritja e kosto/njësi është bërë mbi bazën e dy treguesve kryesorë prodhimin në ton ekv. dhe shpenzimeve totale operative (zbritur shpenzimet për blerjen e energjisë që konsumohet nga të tretët që i përkasin firmave koncesionare dhe disa privatëve të tjerë).

Treguesi i prodhimin në ton ekuj (naftë+gaz) në shkallë kompanie është realizuar 115,190 ton ekujv nga 112,473 ton ekujv të programuar, ose 102.4%. Në këtë prodhim për llogaritje kosto është përfshirë detyrimi i llogaritur (PPE+PPA) nga zbatimi I MH, ë cili për këtë periudhë zë rreth 38.6 % të totalit.

Kosto totale për njësi prodhimi në ton ekv për vitin 2022 është realizuar 32,726 lekë/ton ekv. nga 39,967 lekë/ton ose 7,241 lekë/ton më pak.

Realizimi i kosto/njësi për vitin 2022 më i ulët se ai i programuar, tregon se prodhimi është rritur me ritme më të shpejtë se shpenzimet. Në lidhje me prodhimin në ton ekujvalent, ai është realizuar 102.4 %, ku pavarësisht mosrealizimit të prodhimin nga Albpetrol sh.a Patos, tejkalimi i përket kryesisht detyrimeve (PPE+PPA) nga zbatimi i MH kryesisht nga kontraktori B...A Ltd.

Ndërsa, shpenzimet për llogaritje kosto janë realizuar 83.8 %. Përfshirja e naftës dhe gazit detyrim i koncesionare ndaj shoqërisë në prodhimin total përlllogaritje kosto/njësi e ul ndjeshëm koston/ton ekujvalent të shoqërisë.

Më poshtë paraqitet struktura e shpenzimeve pjesë e kostos/njësi prodhimi:

Nr.	Emërtimi	Vlera, 000 lekë	Ne % ndaj totalit
	Shpenzime gjithsej	3,769,657	
	Nga kjo:		
1	Shpenzime konstante	1,943,315	51.6
	*Paga&trajtime&shpërblime	1,541,119	40.9
	*Amortizimi	402,197	10.7
2	Shpenzime variabël	489,179	13.0
3	ShpenziM...E tjera(administrative&detyrim ligjor)	1,337,163	35.5
4	Shpenzime rezerve	0	0

Kosto totale për njësi prodhimi për vitin 2022 është realizuar 32,726 lekë/ton nga 39,967 lekë/ton ose 7,241 lekë/ton më pak.

Mosrealizimi i prodhimit të naftës dhe gazit nga Albpetrol sh.a Patos sipas programit vjetor ndikon dhe në koston/njësi prodhimi për shoqërinë .

Për *aktivitetin prodhues*, kosto totale/njësi për vitin 2022 është realizuar 20,884 lekë/ton nga 27,570 lekë/ton e programuar, ose me një ulje prej 6,687 lekë/ton, ndërsa kostoja variabël u realizua 5,801 lekë/ton nga 8,305 lekë/ton me një ulje prej 2,504 lekë/ton.

-Detaje për realizimin e koston /njësi prodhimi për çdo QPN dhe aktivitetin prodhues në tërësi është si më poshtë:

Lekë/ton ekv.

Nr.	Qendrat	Kosto Totale			Kosto Variabel		
		Prog.	Fakt	Dif,+	Prog.	Fakt	Dif,+
1	Qendra PN.Fier	34,227	29,743	-4,483	7,921	8,201	280
	Sektori PN Patos	41,783	40,822	-961	10,890	10,095	-795
	Sektori PN Cakran-Mollaj	24,949	20,492	-4,457	7,428	7,706	278
	Sektori P Gazit	0	0	0	0	0	0
	Administrata e QPN Fier	0	0	0	0	0	0
2	Qendra PN.Kuçovë	33,924	25,236	-8,687	7,691	4,719	-2,972
3	QPN Gorisht	20,887	14,656	-6,232	8,814	5,206	-3,608
	Vendburimi. Gorisht-Kocul	19,989	13,798	-6,192	8,474	4,997	-3,477
	Vendburimi. Amonicë	27,697	23,992	-3,705	11,395	7,481	-3,914
	Totali QPN-ve	27,570	20,884	-6,686	8,305	5,801	-2,504

Pavarësisht se kostoja /njësi në aktivitetin prodhues nuk është realizuar, në shpenzimet faktike të evidentuara të aktivitetit prodhues, pra në shpenzimet gjithsej për çdo Qendër Prodhimi nuk janë përfshirë disa shpenzime të konsiderueshme për kompaninë si renta, arbitrazhi, si dhe disa shpenzime të kontraktuara nga shoqëria që kontabilizohen në administratën qendrore dhe disa shpenzime që përkasin administratës qendrore. Me përfshirjen e këtyre shpenzimeve vetëm QPN Gorisht dhe vendburimi Cakran - Mollaj rezultojnë me kosto të ulët, pra me fitim, nëse vendburimi Patos dhe QPN Kuçovë rezultojnë jo fitim prurës.

-*Aktiviteti i transportit dhe shitjes*, i cili kryhet nga QASHNG Patos, e rrit koston e kompanisë me 2,185 lekë/ton ekuj, pra nga 20,884 lekë/ton me transportin dhe shitjen shkon në 23,069 lekë/ton.

-*Aktiviteti i shërbimeve* me shpenzimet e tyre pothuajse e ka dyfishuar koston e kompanisë për prodhimin e 1 ton naftë.

3.4 *Gjendja financiare dhe shlyerja e detyrimeve.*

Për vitin 2022 flukset hyrëse të parasë kanë qenë kryesisht në monedhë shqiptare. Fluksi i likuiditeteve në shoqërinë Albpetrol sigurohet kryesisht nga aktiviteti i shfrytëzimit, i investimit dhe ai financiar.

Duke analizuar fluksin hyrës të parasë për këtë periudhë, rezulton se likuiditetet e gjeneruara nga aktiviteti i shfrytëzimit janë përmirësuar kryesisht nga shitjet e naftës brut. Nga përpunimi i të dhënave rreth 71.2 % e arkëtimeve është siguruar nga klientë të shitjes së naftës brut.

Gjithashtu janë siguruar arkëtime të konsiderueshme nga shitja e energjisë elektrike, të cilat zënë rreth 28.4% të totalit vjetor.

Arkëtime ka edhe nga shitja e gazit shoqëruar familjarëve në QPN Kuçovë si dhe shërbime të kryera në të tretë.

Cash - Flow sipas elementeve përbërës të tij për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Totali/ lekë
1	Celja 01.01.2022	546,471,290
2	Totali Arkëtime viti 2022	8,455,998,171
	Arkëtime nga shitja e naftës bruto	6,017,585,226
	Nga Klientë gazi	5,591,980
	Nga Klientë energji	2,403,628,389
	Nga Klientë të tjerë	15,298,973
	Bonus sipas MH	13,893,603
3	Totali Pagesa viti 2022	7,526,430,984
	Paga	1,151,801,771
	Kredi superiore	96,017,121
	Kredi italiane	7,648,914
	Pagesa përmbarues	97,641,801
	Taksa vendore	270,289,999
	Detyrime buxhetore	1,885,314,219
	Pagesa të tjera	945,330,894
	Taksa mjetesh	5,140,964
	Pagesa (Arbitrazhi)	142,121,645
	FSHU	2,925,123,656
4	Gjendja dt 31.12.2022	1,476,038,477

Siç shihet nga tabela, pagesat kryesore në Cash për këtë vit janë bërë në monedhë shqiptare dhe i përkasin kryesisht pagave dhe trajtimit të punonjësve në vlerën rreth 1.15 miliardë lekë ose 15.3% të totalit, detyrimet buxhetore në vlerën rreth 1.9 miliardë lekë ose 25%, detyrimeve ndaj FSHU në rreth 2.9 miliardë lekë ose 38.9% të pagesave gjithsej.

-Gjatë këtij viti është kushtuar rëndësi shlyerjes së detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit si vijon:

Nr	Emërtimi	Detyrimet buxhetore, në lekë
		Likuidimi
1	TVSH	850,155,214
2	Renta minerare	484,782,174
3	Sigurime shoq.shendets	325,783,682
4	TAP	99,522,171
5	Tatim në burim	12,836,328
	Tatim fitimi	112,234,650
	TOTAL	1,885,314,219

4. Treguesit e Punës dhe menaxhimi i Burimeve Njerëzore

-Numri mesatar i punonjësve si kompani, nga 1,790 i programuar është realizuar 1,645 punonjës mesatar ose 145 punonjës mesatarisht me pak.

Detaje për afatet e emërimeve, largimeve, arsyet etj janë evidentuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore:

-Fondi i pagave është realizuar 1,093,045 mijë lekë nga 1,227,792 mijë lekë i programuar ose 89 % rreth 134,747 mijë lekë kursim.

-Paga mesatare është realizuar 55,362 lekë/punonjës nga 57,160 lekë/punonjës e programuar ose - 1,798 lekë/punonjës.

-Numri fizik i punonjësve gjendje me 31 Dhjetor 2022 është 1,668 punonjës.

4.1 Ecuria e numrit të fuqisë punëtore për vitin 2022

Një element i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për kryerjen dhe vazhdimin e gjithë operacioneve hidrokarbure është fuqia punëtore, pra burimet njerëzore që marrin pjesë në aktivitetin e Albpetrol sh.a Patos.

Ecuria e numrit fizik të punonjësve nga njëri muaj në tjetrin për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Nr.	Muaji	Numri fizik i punonjësve		
		Prog.	Fakt	Dif,+,-
1	Janar	1,790	1,698	-92
2	Shkurt	1,790	1,695	-95
3	Mars	1,790	1,692	-98
4	Prill	1,790	1,676	-114
5	Maj	1,790	1,667	-123
6	Qershor	1,790	1,647	-143
7	Korrik	1,790	1,638	-152
8	Gusht	1,790	1,626	-164
9	Shtator	1,790	1,624	-166
10	Tetor	1,790	1,623	-167
11	Nëntor	1,790	1,638	-152
12	Dhjetor	1,790	1,668	-122

Të dhënat e mësipërme përfaqësojnë gjendjen e punonjësve fizik në fund të çdo muaji.

Bilanci i fuqisë punëtore të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për vitin 2022 me të gjithë elementet përbërës paraqitur si vijon:

Nr.fizik

1	Gjendja me 1 Janar 2022	1,717
2	Shtesa (Lidhje kontratë individuale punë të reja)	116
3	Pakësime (Përfundime kontratash punë)	92
a.	Me procedure	24
b.	Dalje ne Pension	44
c.	Përfundime kontratash ne mënyrë vullnetare	20
d.	Largime për arsye të tjera	4
4	Gjendja me 30 Qershor 2022	1,647

5. Mjedisi dhe siguria ne punë

5.1 Mjedisi

Gjatë 2022 problem për shoqërinë kanë ngelur ndotjet të cilat janë të trashëguara si sasi të naftore në sheshet e puseve, kimikatet e skaduar, bateritë e dala jashtë përdorimit, eternitet, gomat jashtë përdorimi, etj.

Është lidhur kontrata e sigurimit të jetës për 1400 punonjës që punojnë në vende pune me rrezikshmëri të lartë.

5.2 Aksidentet ose incidentet ne punë

Gjatë këtij viti kanë ndodhur 4 aksidente në punë, ku shoqëria Albpetrol nëpërmjet Drejtorisë dhe specialisteve përkatës ka ndjekur gjithë procedurat ligjore dhe ka bërë analiza të detajuara për çdo rast aksidenti.

Në këto aksidente njëri ka përfunduar me humbje jete, nëse në tre të tjerët punonjësit janë dërguar për të marrë kontrollin e specializuar.

5.3 Kontrollat mjekësore

Mbështetur në këtë program për periudhën vjetore, janë realizuar kontrole mjekësore për Administratën dhe 10 Qendrat sipas grafikut të miratuar. Kontrollat mjekësore janë kryer në zbatim të kontratës së lidhur me shoqërinë e sigurimit “S...L”, si gjashtë mujor kanë përfunduar ekzaminimet nga mjeku i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos 1665 punonjës nga të cilët 144 punonjës janë evidentuar të prekur me Covid-19 dhe nuk ka patur asnjë humbje jete prej Covid-19.

5.4 Ndhimat ekonomike

Në zbatim të Kontratës Kolektive lidhur midis shoqërisë dhe “S...E” në Programin e Zhvillimit të Albpetrol. SHA për vitin 2022 janë parashikuar dhe miratuar ndihma në raste sëmundjesh dhe fatkeqësish për punonjësit e shoqërisë.

Shpenzimet e dhëna për ndihma ekonomike në përputhje me kontratën kolektive janë 8,850 mijë lekë ose +3350 mijë lekë krahasuar me ato të programuara. Për këtë vit kanë përfituar ndihma ekonomike 133 punonjës.

-Detaje për shpenzimet e kryera për ndihmat ekonomike për vitin 2022 sipas qendrave janë:

Nr	QENDRAT	Ndihma Ekonomike ,000 lekë	
		Prog	Fakt
1	QPN Fier	800	1090
2	Qendra PN.Kuçovë	800	690
3	Qendra e PN Gorisht	800	1670
4	Qendra Ad.Shitje.N.G.Patos	300	490
5	Qendra Sherb.Gjeofizik	500	710
6	Qendra Adm.Kontroll.Prones Patos	250	650
7	Qendra E.M.N.G. Patos	250	630
8	QFSHE Patos	300	150
9	Qendra M.N.Kuçovë	200	120
10	Qendra e Furnizimit&Transportit Patos	600	1090
11	Administrata	700	1560
	Kompania	5500	8850

5.5 Kontratat e marrjes së tokës me qera nga fermerët.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos. për të vazhduar aktivitetin hidrokarbur normalisht gjatë vitit 2022 ka hasur vështirësi, ka pasur nevojë të marrë në përdorim toka bujqësore nga fermerë të ndryshëm. Këto toka janë përdorur për sheshe pusesh (ku ka pasur puse të reja) dhe rrugë hyrje për në puse apo asete të ndryshme ku ka lindur nevoja.

Për nevoja të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos. dhe për të mundësuar aktivitetin normal të Qendrave të Prodhimit të Naftës për vitin 2022 janë lidhur dhe zbatuar 15 kontrata të marrjes së tokës bujqësore fermerëve të ndryshëm në përdorim të përkohshëm. Kanë dalë 12 Urdhra për likuidimin e vitit 2022 me vlerë totale 1,595,318 lekë, **sipas Aneksi 2.3.1 bashkëlidhur Projekt Raport Auditimit.**

5.6 Zhdëmtimet bujqësore, drufrutore dhe riaftësimi i tokave bujqësore

Gjatë vitit 2022 janë kryer procedurat e zhdëmtimeve bujqësore si pasojë e avarive të ndryshme të ndodhura në Q.P.N. dhe QASHNG sipas Rregullores së Zhdëmtimeve Bujqësore që disponojmë, komfor ligjit Nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore” dhe Ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

Nga përlllogaritjet e bëra në akt - vlerësimet për fitimin e munguar bujqësor për këtë vit kanë dalë 12 “Urdhra” për 35 fermerë me një shpenzim total prej 2,912,444 lekësh, nga 8 000 000 lekë të planifikuara për vitin 2022.

Në këtë shumë të shpenzuar për vitin 2022 përfshihen edhe dëmtime të tokave bujqësore të shkaktuara nga avari të ndodhura në fund të vitit 2021.

-Konkretisht për dëmshpërblimet financiare të tokave dhe kulturave bujqësore për vitin 2021 kanë dale 3 urdhra në 6-mujorin e parë të 2022 për të likuiduar 5 fermerë me një shumë totale

385,622 lekë. Ndërsa për zhdëmtime bujqësore nga avari të ndodhura në vitin 2022 kanë dale 9 urdhra për te dëmshpërblyer 30 fermerë me nje shumë prej 2,526,822 lekë, sipas **Aneksi 2.3.2 bashkëlidhur Projekt Raport Auditimit.**

Faktorët kryesorë që kanë diktuar këto shpenzime për zhdëmtime bujqësore janë kryesisht avari të ndodhura nga çarje të magjstralit të naftës sidomos në periudhën e dimrit për shkaqe të ndryshe teknologjike, rrjedhje gropash avarie dhe sepërorëve, çlirimi i gazit në dekantime dhe grupe zëvendësime të pjesshme të tubacioneve të transportit të naftës, shkarjet e dherave si rezultat i terrenit kodrinor, sjellin për pasojë zhvendosje e shkëputje të tubacioneve të naftës e gazit, si dhe për shkak të amortizimit dhe korodimit të tubacioneve të transportit të naftës.

-Kryerja e proceseve për eliminimin e avarive ka kërkuar kalimin e mjeteve të rënda nga ana e Qendrave duke shkaktuar dëmtimin e tokave, kulturave bujqësore dhe drufrutorëve të fermerëve.

-Duhet theksuar fort se Qendra e Prodhimit më problematikë përse i përket avarive të shkaktuara dhe dëmet financiare që i shkaktohen kompanisë Albpetrol është QPN Fier, dhe më konkretisht Sektori Cakran -Mollaj. Shkaqet e këtyre dëmtimeve kanë ardhur si pasojë e amortizimeve të mëdha që kanë linjat e transportit të fluidit nga qendrat Nr 38, Nr 59, Nr 29, drejt Qendrës Nr 17, ku bëhet dhe grumbullimi i fluidit të këtij vendburimi naftë. Gjithashtu ngelet një problem shqetësues permanent edhe linja e transportit të fluidit nga Qendra Nr.17 drejt dekantimit Usojë.

Duhet theksuar se zëvendësimet e pjesshme nuk e kanë zgjidhur situatën dhe kompanisë tonë i shkaktohen humbje të fluidit, kosto shtesë për zhdëmtimet e fermerëve, si dhe penaltitetet e vendosura nga ISHPMUT Fier.

5.7.Sigurimi Teknik, Mjedisi dhe MNZ

-Shoqëria Albpetrol sh.a Patos, specialistet përkatës kanë punuar vazhdimisht për mbarëvajtjen e punës dhe zbatimin e rregullave të sigurimit teknik, ruajtjes së shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit. Puna në këtë vit është përqendruar në këto drejtime kryesorë:

-Janë kryer inspektime mbi gjendjen mjedisore përcaktimin e hotspotëve mjedisore dhe evidentimin e problematikave të lidhura me sigurinë në punë .

-Janë bërë inspektime në qendrat dhe njësite në varësi për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik, ruajtjes së shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit.

-Po ndiqet zbatimi i kontratës të sigurimit të jetës nga aksidentet në punë me ekzaminimet mjekësore për punonjësit të cilët mbulojnë me policë sigurimi.

-Është ndjekur instruktimi i punonjësve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë, mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit (për çdo profesion) mbështetur në rregulloren e brendshme dhe legjisllacionin në fuqi.

-Është punuar në drejtim të vlerësimit të dokumentit të risqeve për uljen e tyre në punë dhe parandalimin e incidenteve të ndryshme dhe prezantimi me të i gjithë punonjësve.

-Janë ndjekur inspektimet e kryera nga inspektoratet shtetërore mbi Sigurinë në Punë dhe Mbrojtjen e Mjedisit. Gjithashtu është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me këto inspektorate apo institucione shtetërore mbi informacionet e kërkuara prej tyre.

6. Përfaqësimet e procese me palët e treta.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos pjesë të veprimtarisë së saj për vitin 2022 ka patur aktivitetin ligjor duke ndjekur proceset gjyqësore në të gjitha shkallët, si në gjykatat e shkallës së parë, gjykatat administrative dhe gjykatat e apelit.

Për vitin 2022 janë ndjekur gjithsej 365 çështje gjyqësore nga te cilat 307 çështje gjyqësore janë ndjekur në Gjykata të Shkallës së Parë Fier, Vlore, Tirane dhe Gjirokastrë dhe 58 procese gjyqësore në Gjykatën e Apelit Vlore dhe Tiranë.

-Proceset gjyqësore të ndjekura ku shoqëria Albpetrol sh.a Patos, ka qenë në cilësinë e të paditurit, janë me objektet si më poshtë:

- dëmshpërblim për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës;
- dëmshpërblim për vjetërsi në punë;

- dëmshpërblim ndotje toke;
- konstatim diskriminimi;
- përmbushje detyrime kontraktuale;
- detyrimin për të paguar diferencën e pagave për muajit prill, maj dhe qershor;
- njohje e vjetërsisë në punë;
- paga e 13;
- orët shtesë, ditët e festave dhe ditët e diela;
- dëmshpërblim page me punonjësit e T...Kut.

Numri i proceseve ka ardhur duke i rritur për shkak të hapjes së proceseve gjyqësore me objekt pagat e pandemisë.

Çështjet gjyqësore, për të cilat shoqëria Albpetrol sh.a Patos i është drejtuar Gjykatës, pra shoqëria Albpetrol sh.a Patos është në cilësinë e palës paditëse janë me objektet si më poshtë:

- pavlefshmëri titulli;
- kthim shumë;
- pavlefshmëri i vendimeve të Komisionerit për mbrojtjen nga Diskriminimi;
- kundërshtim veprimesh përmbare, etj.

-Detaje për proceset gjyqësore të humbura dhe ato të fituara paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Çështjet e Ndjekura për Vitin 2022						
		Gjithsej, çështje ne numër.	Sipas 3 mujoreve				Vlera, ne lekë	
			I	II	III	IV	Për çështje te fituara	Për çështje te rrezuara
1	Ne Gjykatën e Shkallës Parë	307	67	92	51	97	11,981,320	0
2	Ne Gjykatën e Apelit	58	12	15	7	24	25,771,069	773,537
3	Ne Gjykatën e Lartë	0	0	0	0	0	0	0
	Totali	365	79	107	58	121	37,752,389	773,537

Në të gjitha proceset gjyqësore që Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit ka respektuar afatet ligjore për sa i përket depozitimit të deklaratave të mbrojtjes, Ankimeve në Gjykatat e Apelit dhe Rekurseve në Gjykatën e Lartë.

7. Bonuset nga marrëveshjet hidrokarbure dhe shpenzimet e tyre.

Për vitin 2022 detyrimet për bonuset nga Marrëveshjet Hidrokarbure janë në vlerën 150,000 USD. Përgjatë vitit janë shpenzuar 89,395.54 USD dhe detyrimi i mbetur është 60,604.46 USD.

-Detaje për objektin e shpenzimeve te kryera dhe vlerat e tyre paraqiten si më poshtë:

Nr.	Kompania	Njësia	Viti 2022			
			Detyrimet sipas Marrëveshjeve Hidrokarbure	Shpenzuar për llogari te Banuesve te Trajnimit Vjetor	Emërtimi për shpenzimet e kryera	Detyrim i mbetur
1	A...L&G...Z SHA	USD	20,000.00	15,390.65	International Oil and Exploitation Contracts dhe "Leadership & People Menagement Siklls	4,609.35
2	T...S SHA	USD	20,000.00	10,362.00	Takim me Avokatet e Studios Ligjore C..., ne kuader te procesit te Arbitrazhit Ndërkombetar	9,638.00
3	SH...M Ltd	USD	50,000.00	26,723.48	International Oil and Exploitation Contracts dhe "Leadership & People Menagement Siklls	23,276.52
4	F...K	USD	10,000.00	-		10,000.00
a)	P...Z	USD	5,000.00	-		5,000.00
b)	F...E	USD	5,000.00	-		5,000.00
7	D...Y Ltd	USD	50,000.00	36,919.41	International Oil & Gaz Exploitation Contract	13,080.59
	TOTALI		150,000.00	89,395.54		60,604.46

8. *Ecuria e procesit të prokurimeve.*

Pjesë veprimtarisë së shoqërisë Albpetrol sh.a Patos përgjatë vitit 2022 janë kryer procedurat e prokurimeve publike për realizimin e blerjeve të investimeve, materialeve dhe shërbimeve.

-Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe procedurat e prokurimit publik të realizuara janë përgatitur elektronikisht dhe janë publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, të aksesueshme pa pagesë nga çdo i interesuar dhe në çdo moment. Automatizimi i këtyre dy regjistrave ka ndikuar për rritjen e përgjegjësisë së Albpetrol sh.a Patos si Autoritet Kontraktor në planifikimin e nevojave për prokurim gjatë vitit në vijim si dhe për garantimin e informacionit për operatorët ekonomikë mbi të gjitha procedurat dhe fondet publike që do të prokurohen gjatë vitit në kohë reale, duke rritur në mënyrë të dukshme transparencën në lidhje me përdorimin dhe menaxhimin e fondeve publike.

Për vitin 2022 në Regjistrin e prokurimeve publike janë parashikuar për tu prokuruar 167 procedura, detajuar për Investime 78 procedura, Materiale 48 procedura dhe Shërbime 41 procedura.

Nga monitorimi i elementeve të Regjistrit të Prokurimeve për vitin 2022, rezulton se nga 167 elementë të parashikuar në regjister 54 elementë ose 33 % e totalit kanë vijuar me procedurat, ndërsa 113 elemente ose 67 % e totalit janë me statusin të pazhvilluar (ose anuluar).

Nga procedurat e parashikuara për tu prokuruar në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2022, është arritur të realizohen procedura me kontratë gjithsej 54 procedura me vlerë totale të kontratave 564,227,021 lekë.

Detaje të procedurave të realizuara në investime, shërbime dhe material paraqiten si më poshtë:

Nr.	Procedura	Procedura të parashikuara për prokurim për vitin 2022		Procedura të realizuara me kontratë për vitin 2022	
		Numri	Vlera, lekë	Numri	Vlera, lekë
1	Investime	78	621,521,960	6	104,147,519
2	Materiale	48	697,249,163	30	402,992,533
3	Shërbime	41	160,059,711	18	57,086,969
	Totali	167	1,478,830,834	54	564,227,021

Në lidhje me fondin limit të procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurave të zhvilluara për vitin 2022, si rezulton nga të dhënat e mësipërme, përqindjen më të madhe e zënë procedurat për materiale me fond limit 402,992,533 lekë pa TVSH, ose 58 % të fondit limit total të parashikuar .

Detaje për kontratat e lidhura gjatë vitit 2022 janë si më poshtë:

a) Kontrata të lidhura në vitin 2022 nga procedura të parashikuara në regjistrin e prokurimeve të vitit 2022 gjithsej 21 kontrata nga të cilat për investime 2, materiale 13 dhe shërbime 6 si vijon:

Nr	Lloji i Procedurës	Objekti i Prokurimit	Fondi limit	Vlera kontratës (pa TVSH)	Data e lidhjes së kontratës	Operatori fitues
1	INVESTIME	Purteka (16 mm, 22 mm,25mm)	17,585,000	17,319,100	22.12.2022	“U...O” shpk
2		Rinovim dhe shtim postesh program Financa 5	1,980,000	1,952,440	08.06.2022	I...R” shpk
1	MATERIALE	Blerje Lëndë djegëse e lenget për përdorim teknik dhe industrial (për kaldajat)	33,877,980	32,224,230	10.06.2022	“R...R” SHA
2		Blerje Demulgator (servo)	9,541,000	9,454,000	08.11.2022	“A...I” SHA
3		Blerje Bateri	2,168,700	2,150,000	09.07.2022	A...V shpk
4		Blerje Litar celiku	6,500,273	6,424,500		A...V shpk
5		Blerje Oksigjen&acitilen	2,053,800	2,020,410	31.08.2022	G...S
6		Blerje Pajisje mbrojtëse individuale për punonjësit dhe veshmbathje	8,631,920	8,590,000	24.10.2022	V...4
7		Blerje Gazoil 10 ppm	182,692,600	182,692,012	22.04.2022	A...I
8		Blerje Vula sigurie	5,246,430	4,097,212	12.07.2022	L...B
9		Blerje Pjesë këmbimi	28,182,320	27,500,000	20.04.2022	A...V
10		Blerje Goma Automjetesh	12,934,500	12,402,000	29.07.2022	S...O COMPANY

Nr	Lloji i Procedurës	Objekti i Prokurimit	Fondi limit	Vlera e kontratës (pa TVSH)	Data e lidhjes se kontratës	Operatori fitues
11		Blerje Profile hekuri	1,357,950	1,352,100	06.12.2022	N...4
12		Blerje Dedektore gazi individuale	3,653,333	2,750,000	08.11.2022	A...L
13		Blerje pjesë këmbimi për automjetet		27,500,000		
1	SHËRBIME	Rinovim Garancie Doganore te Magazinate Fiskale	11,786,070	11,424,300	10.03.2022	S...A
2		Sigurim i jetës se punonjësve ,sig. shëndeti nga aksidentet ne punë	20,883,330	20,465,200	01.08.2022	S...A
3		Shërbim për sigurac, shërbim TPL+kasko.	4,900,000	4,826,500	23.11.22	S...A
4		Shërbim interneti	2,598,800	2,339,064	16.11.2022	A...M
5		Transport i punonjësve te QPN Gorisht	9,885,667	9,861,800	13.06.2022	G...E
6		"Shërbim periodik për 3 autobotet tip Renault"	1097735	1,075,375	19/09/2022	Q...J

b)Kontrata të realizuara në vitin 2022 nga procedura të parashikuara në regjistrin e prokurimeve të vitit 2021 gjithsej 13 kontrata nga të cilat për investime 6, materiale 5 dhe shërbime 2 si vijon:

Nr/R	Lloji i Procedurës	Objekti i Prokurimit	Fondi limit lekë pa TVSh	Vlera e kontratës pa TVSh	Data e lidhjes se kontratës	Operatori fitues
1	INVESTIME	Zëvendësim i mbulesave ekzistuese "Eternit" i çatave te reparitit Mekanik dhe reparitit Elekëtrik ne Q.M.N. Kuçove	9,953,982	9,187,380	3/3/2022	A...T
2		Nëtim i bazamentit te peshores dhe sistemim i sheshit përreth tij ne stacionin Visoke	1,199,357	1,067,430	21/01/2022	SH...I
3		Riparim pjesore+ pastrim RVM 5000/8 dhe pastrim i mbeturinave mekanike tedy RVM 700 m3 /3/4 ne stacionin Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	18,337,055	17,383,255	3/3/2022	A...6
4		Çift rrotor stator për PCP për Q.P.N.Gorisht+ Polishrot për pusët me PCP për Q.P.N. Gorisht	12,491,900	11,987,530	15/02/2022	S...B
5		Kalimates naftë (floë-M...Er), 4 (kater) cope	37,936,920	37,178,181	19/04/2022	V...S
6		Pajisje kompjuterike për qendrat dhe administratën	3,488,800	3,476,825	3/2/2022	P...E
1	MATERIALE	Blerje aksesor elektrike+materiale ndihmese	10,056,845	9,789,000	14/01/2022	V...4
2		Lubrifikante(Vajra+graso)	10,752,208	9,425,600	1/2/2022	K...L
3		Materiale laboratorike	1,155,587	1,130,030	7/3/2022	K...N
4		Profile hekuri dhe çeliku	2,016,867	1,990,040	15/02/2022	N...4
5		Tube naftësjellësi	17,797,600	15,602,808	15/03/2022	A...O
1	SHËRBIME	Shërbim për kolaudim aparatësh matëse QFSHE	1,456,719	1,454,550	17/01/2022	H...S
2		Shërbim për ruajtjen e pronës	61,234,732	61,024,694	24/01/2022	M...M

c)Kontrata të lidhura në vitin 2022 nga procedura të parashikuara në regjistrin e prokurimeve të vitit 2022 me blerje të vogla, gjithsej 16 procedura nga të cilat për investime 0, materiale 7 dhe shërbime 9 kontrata si vijon:

Nr.	Lloji i procedurës	Objekti i Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues
1	MATERIALE	Blerje Adblue	213,333	22/12/2022	E...L
2		Blerje Brume gome antivaj+gome batistrad	317,500	18/08/2022	A...V
3		Blerje Kushineta	775,000	23/11/2022	A...V
4		Blerje Leter A4/A3	777,777	20/04/2022	L...U
5		Blerje Materiale sanitare	600,000	22/12/2022	A...O
6		Blerje Rripa trapezoidal(volanti/kalbri/pompe/tjerë)	575,000	22/12/2022	A...V
7		Gjenerator saldimi (Vendburimi. Amonicë)	870,000	22/09/2022	V...0
1	SHËRBIME	Certifikate e Inspektimit të cisternave të transportit të lëndëve të rrezikshme	161,700	24/11/2022	A...H
2		Furnizim vendosje moket profesional në godinën qendrore të Albpetrol	250,000	23/12/2022	A...J
3		Furnizim-vendosje motor automjeti tip "LAND ROVER DISCOVERY"	979,000	19/12/2022	M...G
4		Mirembajtje për pajisjet fotokopjuese/printuese	855,000	24/11/2022	A...A
5		Paisja me certifikate ADR të autoboteve të Albpetrolit+ lëndë rrezikshme	165,000	22/12/2022	A...H
6		Paisja me vertetim teknik të pajisjeve nën presion	350,000	30/12/2022	A...T
7		Shërbim për kualifikim spec.Elekëtrik	249,950	13/07/2022	S...A(F...L)
8		Shërbim Furnizim me uje të pijshëm	790,000	24/11/2022	L...T
9		Shërbim karta sim	273,600	28/10/2022	O...A

Autoriteti Kontraktor Albpetrol sh.a Patos ka zhvilluar ankandin me objekt: "Shitje naftë brut, sasia 120,000 ton" për vitin 2022.

Me shkresën nr. 3170/1 prot datë 27.04.2022 të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë është miratuar çmimi minimal fillestar i shitjes dhe është dhënë miratimi për vazhdimin e procedurave përkatëse sipas Urdhrit nr.83, datë 10.02.2012 'Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure', i ndryshuar. Në zbatim të kësaj shkrese, Titullari i Autoritetit Shitës ka nxjerrë Urdhër nr. 3493, datë 28.04.2022 për fillimin e procedurave të ankandit dhe ngritjen e Komisionit të Ankandit. Për sa më sipër, në përfundim të procedurave, fituesi për ofertën e paraqitur ishte Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "E...A" SHA me NUIS ... dhe "R...E" SHA me NUIS ... me vlerë të ofertës: 75.33 % e Çmimit Brent – 3.36 USD/bbl + K, ku K= 0.0105 USD/bbl.

9. Administrimi i pronës dhe taksat e pushtetit vendor.

Përgjatë vitit 2022 nga shoqëria ka vazhduar verifikimin i ndërtimeve informale në qendra dhe njësi të shoqërisë, në zonat naftëmbajtëse sipas kërkesave të bëra nga Drejtoritë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Është mbajtur korrespondencë për secilin rast me Drejtoritë Rajonale të ASHK-ve.

Gjithashtu është punuar për monitorimin dhe evidentimin e pronave të zëna nga posedues të paligjshëm dhe po hidhen hapat ligjor për lirimin e pronave të zëna. Është krijuar një pasqyrë përmbledhëse nga Drejtoria e Administrimit të Pronës për të gjitha pronat e zëna në çdo qendër dhe do të hidhen të gjithë hapat ligjorë për lirimin e tyre.

9.1 Kontrata për dhënien me qera të aseteve.

Përgjatë vitit 2022 shoqëria ka punuar për monitorimin e kontratave të qiradhënies së objekteve të lidhura.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka patur në zbatim gjithsej 18 kontrata qiradhënie nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos për objekte apo makineri e pajisje, nga të cilat janë realizuar 1,343,871 lekë. Të dhënat për kontratat e qiradhënies së aseteve të shoqërisë paraqiten, si më poshtë :

-13 kontrata janë në Qarkun Fier nga të cilat 6 kontrata janë për makineri e pajisje dhe 6 kontrata janë me sipërfaqe nën 200 m² dhe 6 kontrata në Qarkun Berat.

Nr.	Ndërmarrja, Shoqëria, Institucioni Qiradhënës	Objekti i dhënë me qira	Vendndodhja	Kontrata të lidhura		Të ardhura nga qiraja për periudhën	Detyrimi për periudhën
				Nr. Prot datë	m ²	Lekë	Lekë
		Kontrata nën 200 m²					
1	Albpetrol.SHA	Torno tip "Demon"	Patos	1572/17.02.2022		30,240	30,276
2	Albpetrol.SHA	Vinc çaj 5 Ton	Tirane	5920/16.08.2022		30,969	30970
3	Albpetrol.SHA	Torno SBF	Fier	3114/13.04.2022		25,920	22,795
4	Albpetrol.SHA	Radifike aksiale	Fier	1136/21.02.2020		17,280	17,280
5	Albpetrol.SHA	Vinc ure 5 Ton	Fier	1773/24.02.2022		19,200	19,200
6	Albpetrol.SHA	Ish zyrat e sek Divjak	Divjak	674/24.01.2022		157,608	170,932
7	Albpetrol.SHA	Gr.4 sek.II, ish QPN Marinez	Marinz	9022/12.11.2021	200	134,160	134,160
8	Albpetrol.SHA	Tetoja sek III Marinez	Marinz	7596/20.10.2022	200	15,188	15,188
9		Tetoja sek III Marinez	Marinz	7595/20.10.2022	200	22,312	22,312
10	Albpetrol.SHA	Teto traktori, ish QPN Marinez	Marinz	672/24.01.2022	200	198,888	198,888
11	Albpetrol.SHA	Ish remonti kapital Marinez	Marinz	9030/12.11.2021	200	82,080	82,080
12	Albpetrol.SHA	Ish remonti kapital Marinez	Marinz	9029/12.11.2021	200	113,100	113,100
13	Albpetrol.SHA	Vinc	Fier	14.07.2021		28,000	28,000
14	Albpetrol.SHA	Magazina e produktit gatshem	Kuçovë	9303/28.12.2022	169	219,024	219,024
15	Albpetrol.SHA	Pike servisi	Kuçovë	9082/16.11.2021	99	128,304	128,304
16	Albpetrol.SHA	Godine e centralit telefonik	Kuçovë	8810/08.11.2021	60	77,760	77,760
17	Albpetrol.SHA	Kendi I Mbledhjeve	Kuçovë	10151/14.12.2021	28	35,018	36,288
18		Garazh	Patos	5041/05.07.2022	17.5	8,820	8,820
			Shuma			1,343,871	1,355,377
		Kontrata mbi 200 m²					
1	MIE	Tubacion		2583Rep.nr.519Kol/5		0	720,000
	MIE	Nëtese		/27.12.2018		0	228,000
2	MIE	God rep saraçineskave	Kuçovë	4247Rep.1979/kol	1630	213,792	276,316
			Shuma	/19.08.2022		213,792	1,224,316
			SHUMA			1,557,663	2,579,693

Shpërndarja e kontratave sipas qendrave të shoqërisë paraqitet si më poshtë:

- QASHNG Patos 1 kontratë
- QPN Kuçovë 2 kontratë
- UMN Kuçovë 2 kontratë
- QAR Patos 6 kontrata
- QFT Patos 2 kontrata
- QPN Fier 1 kontratë
- QSHGJ Patos 4 kontrata.

-Problematikat dhe zgjidhjet gjatë këtij procesi janë si më poshtë:

➤ Nuk janë rinovuar gjithsej 8 kontrata: Janë njoftuar të gjitha subjektet qiramarrëse për lirim prone, nëse nuk rinovojnë kontratat e qirave, së bashku me Qendrat do merret sipas proces verbalit të dorëzimit objekti i dhënë me qira.

➤ Është lidhur një kontratë qiradhënie nga MIE, me afat kohor 20 vjeçar, me objekt “Reparti i saraçineskave Kuçovë” por subjekti ka kërkuar pezullim të kontratës për shkak së kërkon prishjen e objektit ekzistues pasi ka rrezikshmëri shembjeje.

➤ Është prishur kontrata e qirasë lidhur ndërmjet MIE dhe Shoqërisë A...G shpk, dhe janë në proces gjyqësor për marrjen e objektit në dorëzim pasi shoqëria qiramarrëse nuk e ka dorëzuar me mirëkuptim.

Për sa më sipër, Shoqëria Albpetrol sh.a Patos i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me “Kërkesë – Padi” me nr.5320 Prot., datë 15.07.2022 me objekt lirim dhe dorëzim sendi, si dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë deri në shqyrtimin e çështjes në themel nga Gjykata. Në vijim, Gjykata pasi ka shqyrtuar Kërkesë – Padinë dhe aktet e depozituara nga Shoqëria Albpetrol sh.a Patos me vendimin nr.(618) datë 18.07.2022, ka vendosur:

➤ Shpalljen e mos kompetencës lëndore të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për shqyrtimin e çështjes civile me nr.110006-01895-62-2022 (1279) Akti, datë 15.07.2022 regjistrimi.

➤ Dërgimin për shqyrtim të kërkesë-padisë dhe akteve shoqëruese, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

-Albpetrol sh.a Patos monitoron dy kontrata 1 Euro të lidhura me Ministrinë e Zhvillimit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si më poshtë.

- Kontrata nr. 4687 rep nr.833/1 kol datë 28.10.2014 lidhur me Shoqërinë “T...L” SHPK, me objekt dhënia me qira e objektit, “Ish Ndërmarrja Gjeofizike” Patos, me sipërfaqe të përgjithshme 12 507 m², prej nga sipërfaqja nën objekt 4 168 m², me afat 20 vjet.

- Kontrata nr. 1905 rep nr.521/5 kol datë 13.03.2015 lidhur me Shoqërinë “P...I” SHPK, me objekt dhënia me qira të objekteve “Reparti i Axhusterise me Tetonë dhe Repartin e Instrumentave” Patos, me sipërfaqe të përgjithshme 9 800 m², prej nga sipërfaqja nën objekt 3 364 m², me afat 20 vjet.

Për realizimin e të gjitha kontratave është mbledhur informacion nga çdo qendër për monitorimin dhe realizimin e kontratave, si dhe realizimin e të ardhurave për çdo kontratë sipas aseteve të dhëna me qira që disponon çdo qendër dhe kemi informuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Degët e Shoqërive Publike Fier dhe Berat ku shtrihen asetet e dhëna me qera.

Problematikë serioze është mos rinovimi i kontratave të qirave duke sjell mospagim të vlerës së tyre në kushtet kur asetit është në posedim nga qiramarrësi.

Tre kontratat e qirasë të monitoruara nga QPN Gorisht, që nuk janë pasqyruar në evidencën e mësipërme nuk kanë sjell asnjë të ardhur dhe qendra që ka detyrë monitorimin dhe realizimin e tyre nuk ka bërë asgjë për këtë situatë.

9.2 Taksat e pushtetit vendor

Nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos gjatë vitit 2022 janë ndjekur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore si dhe shlyerja e tyre ndaj bashkive dhe komunave që operojnë në zonat naftëmbajtëse të Albpetrolit.

Pagesat e kryera nga shoqëria ndaj detyrimeve të lindura për taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022 është si më poshtë:

Nr.	Bashkia	Detyrimet e viti 2022 sipas bashkive, ne lekë	Marre ne ngarkim si shpenzime viti 2022 ne lekë	Likujduar 2022		
				Gjithsej	Detyrime te vitit 2021	Detyrime te vitit 2022
1	Fier	22,864,040	22,864,040	22,864,040	-	22,864,040
2	Patos	46,570,039	46,570,039	46,570,039	-	46,570,039
3	Rroskovec	1,538,292	1,538,292	51,538,192	7,800,000	43,738,192
4	Mallakaster	66,695,073	66,695,073	66,695,073	-	66,695,073
5	Kuçovë	66,366,020	66,366,020	66,366,020	-	66,366,020
6	Cerrik	4,753,447	4,753,447	4,753,447	-	4,753,447
7	Selenice	-	0	10,000,000	10,000,000	-
8	Ura Vajgurore	1,243,042	1,243,042	1,503,188	260,146	1,243,042
9	Divjak	-	0	-	-	-
10	Delvinë	-	0	-	-	-
11	Finiq	-	0	-	-	-
12	Tirane	72,641	72,641	-	-	-
13	Te tjera ZRVPP	14,000	14,000	-	-	-

Nr.	Bashkia	Detyrimet e viti 2022 sipas bashkive, ne lekë	Marre ne ngarkim si shpenzime viti 2022 ne lekë	Likujduar 2022		
				Gjithsej	Detyrime te vitit 2021	Detyrime te vitit 2022
	Shuma	210,116,594	210,116,594	270,289,999	18,060,146	252,229,853

Për Bashkinë Roskovec, shoqëria ka likujduar vetëm vlerën e detyrimit prej 1,538,192 lekë, nëse vlera 49,999,900 lekë është marrë nga kjo bashki me ekzekutim nga banka për llogari të situacionit të detyrimit të vitit 2021 vlera 7,800,000 lekë dhe për llogari të situacionit të detyrimit të vitit 2022 vlera 42,199,900 lekë, çështje kjo e cila është ne gjykatë.

9.3 Shërbimi i Ruajtjes së Pronave

Albpetrol sh.a Patos ka lidhur kontratën e shërbimit “ruajtjes së pronës”, me nr.9757/13 Prot., datë 24.01.2022, me bashkimin e përkohshëm të shoqërive i përbërë nga “M...Y” shpk dhe F.....M shpk me afat 12 muaj me vlerë fillestare 61,024,693.7 lekë.

Si pasojë e VKM-së nr.158 datë 12.03.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, paga minimale në shkallë vendi nga 30 000 (tridhjetë mijë) kaloi në 32 000 (tridhjetë e dy mijë) lekë dhe vlera e këtij shërbimi është rritur në vlerën 3 171 863.44 lekë.

Shërbimi i Ruajtjes së Pronave, numri i vend rojeve në total është 16 vend roje të shpërndara sipas qendrave:

Administrata	1 vendroje me shërbim 24 orë
QSHGJ Patos	1 vendroje me shërbim 24 orë
QFT Patos	3 vendroje me shërbim 24 orë
QFSHE Patos	1 vendroje me shërbim 24 orë
QPN Fier	3 vendroje me shërbim 24 orë
QPN Gorisht	4 vendroje me shërbim 24 orë
QPN Kuçovë	3 vendroje me shërbim 24 orë

-Nga shoqëria janë bërë kontrole të vazhdueshme për monitorimin dhe realizimin e kësaj kontratë. Në bazë të proces verbaleve të ardhura nga qendrat për ruajtjen e pronave për çdo vend roje, sipas qendrave për Qarkun Vlorë, Fier dhe Kuçovë të mbajtura midis përfaqësuesit të subjektit të Rojeve Privatë dhe përgjegjësit të objektit ku kryhet shërbimi, në zbatim të kontratës Nr.9757/13 Prot., datë 24.01.2022 me objekt “*Shërbimi i Ruajtjes së Pronës*” dhe performancë mbi shërbimin e kryer, janë përpiluar relacionet mbi shërbimin e kryer për muajt korrekt dhe mbi bazën e gjithë dokumentacionit përkatës Drejtoria e Financës ka bërë shlyerjen e detyrimeve mujore të kësaj kontratë. Kjo kontratë ka përfunduar më 23.01.2023.

Konkluzione lidhur me vitin 2021:

1)Nga auditimi konstatohet se aktiviteti i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në muajt Janar – Shtator ka patur rezultat financiar negativ në vlerën rreth 36.2 milion lekë. Në muajt Tetor – Dhjetor situata ndryshoi duke bërë kështu që shoqëria të arrijë në rezultat bruto pozitiv vjetor rreth 82.9 milionë lekë.

Ndikim në përmirësimin e situatës kanë patur: **rritja e çmimit të naftës Brut nga 29,500 lekë/ton në 33,961 lekë/ton**, kryesisht në 6 – mujorin e dytë, tejkalimi i nxjerrjes së naftës, shlyerja e disa prej detyrimeve të prapambetura nga koncensionarët, për furnizimin me energji elektrike, në favor të Albpetrol sh.a Patos në vlerën 26.7 milion lekë.

2)Lidhur me nxjerrjen e naftës të gjitha qendrat rezultojnë me mos realizim, konkretisht: nga programimi në 80,300 ton në 60,462 ton, pra është realizuar 75%.

3)Ankandi i parë i shitjes të naftës brut dhe lidhja e kontratës u realizua në muajin shkurt, mes Albpetrol sh.a Patos dhe BOE R...H & A...L, për sasinë 40,000 ton.

Gjatë vitit 2021 janë shitur **120,139 ton naftë, krahasuar me programimin prej 140,000 ton, pra realizimi është 85.3%**

Si rezultat i mosrealizimit të shitjes, aktiviteti prodhues i vendburimeve: Gorisht – Kocul, Amonicë, Karbunarë, Kuçovë, dhe Cakran – Mollaj, është seleksionuar deri në ndalje thujse gjatë gjithë 3 – mujorit të parë të vitit 2021.

4) Detyrimet e mbetura pa shlyer deri në 31.12.2021 ndaj Albpetrol sh.a Patos, nga kompanitë koncesionare për naftën bruto rezultojnë rreth **117,117 ton naftë**, duke u rritur me rreth 6,615 ton naftë krahasuar me vitin 2020.

5) Gazi i prodhuar (grumbulluar) nga Albpetrol sh.a Patos është gaz shoqërues dhe për vitin 2021 është realizuar **140.15 mijë N/m³ krahasuar me 756 mijë N/m³**, pra realizimi është vetëm **18.5%**.

6) Detyrimet e kontraktorëve për prodhimin e gazit ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për vitin 2021 rezultojnë në sasinë **23,071,775.05 N/M³**.

7) Investimet për vitin 2021 janë realizuar në vlerën rreth **107,566 mijë lekë nga rreth 558,848 mijë lekë të programuara, pra realizimi është vetëm 19.25%**.

8) Të ardhurat janë realizuar në vlerën 5,681,088 mijë lekë, pra 106.4% (rreth 72% e tyre janë realizuar nga shitja e naftës). Shpenzimet janë realizuar në vlerën 5,036,655 lekë, pra 101.2%.

9) Prokurimet janë realizuar në vlerën 717,698,613 lekë dhe 66 procedura, krahasuar me 1,003,023,618 lekë dhe 128 procedura të programuara, pra rreth 71% në vlerë lekësh dhe 51% si numër procedurash.

Konkluzione lidhur me vitin 2022:

1) Për vitin 2022 Albpetrol sh.a Patos ka arritur një rezultat financiar bruto rreth 412.2 milion lekë. Ndikim në përmirësimin e situatës kanë patur: **rritja e çmimit të naftës Brut nga 37,169 lekë/ton në 51,893 lekë/ton**, pra me një rritje prej 139.6%.

2) Për vitin 2022 është realizuar një volum shitje prej 95,883 ton, kundrejt 108,736 ton të programuar ose 88.2%.

3) Nga aktiviteti i shoqërisë prodhimi i naftës është realizuar 70,570.5 ton kundrejt 75,920 ton të programuar ose 93%, me mosrealizim prej 5,350 ton naftë. Mosrealizimi vjetor i prodhimit të naftës nga shoqëria, vendburimet në administrimin e saj ka ardhur kryesisht për pasojë të 6 mujorit të parë, me një defiçit ndaj programit -6,577 ton naftë dhe një bazë ditore prej 171.7 ton/ditë kundrejt 208 ton/ditë të programuar.

4) Detyrimet e mbetura pa shlyera deri më 31 Dhjetor 2022 ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos nga kompanitë koncesionare për naftën bruto rezultojnë 134,401 ton naftë duke u rritur me rreth 17,557 ton krahasuar me fundin e vitit 2021.

5) Gazi i prodhuar nga vet Albpetrol është gaz shoqërues dhe për vitin 2022 është realizuar 110 mijë N/m³ nga 270 mijë N/m³ programuar ose 40.8 %.

6) Investimet për vitin 2022 janë realizuar në vlerën 243,602 mijë lekë nga 836,126 mijë lekë të programuar ose rreth 29.1 %.

7) Janë realizuar të ardhura rreth 6.59 miliardë lekë dhe janë kryer shpenzime rreth 7.6 miliardë lekë. Duke filluar nga muaji Shkurt 2022, në evidencën e bilancit të grumbullimit dhe shpërndarjes të naftës për kompaninë, nuk janë përpunuar të dhënat për vitin 2022, referuar faktit që bilanci i dërguar nga Qendra e Administrim Shitjeve të Naftës dhe Gazit ka patur problematika të cilat janë bërë prezente zyrtarisht nga Drejtoria e Programimit, pasi nevojitet vendimmarrja e shoqërisë.

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit sipas pasqyrës PASH të bilancit kontabël të shoqërisë janë realizuar 6,587,574 mijë lekë.

Krahasuar me ato të programuara 5,851,206 mijë lekë janë realizuar 112.6 % ose me tejkalim prej 736,367 mijë lekësh, kryesisht nga tejkalimi i të ardhurave nga shitja e naftës.

8) Për vitin 2022 në Regjistrin e prokurimeve publike janë parashikuar për tu prokuruar 167 procedura, detajuar për Investime 78 procedura, Materiale 48 procedura dhe Shërbime 41 procedura.

Nga monitorimi i elementeve të Regjistrit të Prokurimeve për vitin 2022, rezulton se nga 167 elementë të parashikuar në regjistër 54 elementë ose 33 % e totalit kanë vijuar me procedurat, ndërsa 113 elemente ose 67 % e totalit janë me statusin të pazhvilluar (ose anuluar).

Nga procedurat e parashikuara për tu prokuruar në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2022, është arritur të realizohen procedura me kontratë gjithsej 54 procedura me vlerë totale të kontratave 564,227,021 lekë.

9) Gazi i prodhuar nga vet Albpetrol është gaz shoqëruës dhe për vitin 2022 është realizuar **110 mijë N/m3 nga 270 mijë N/m3 programuar ose 40.8 %**.

10) Detyrimet e kontraktorëve për prodhimin e gazit ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos rezultojnë në sasinë **24,426,313 Nm³**.

Për sa më sipër për ndryshimet e shpeshta në strukturën organizative mbajnë përgjegjësi, në cilësinë e ish Administratorëve të Albpetrol sh.a Patos z. B.Z. , z. F.M, znj. A. H. (si dhe në cilësinë e Drejtorit të Programit dhe Zhvillimit Strategjik), z. K. C., në cilësinë e Administratorit të Albpetrol sh.a Patos E. D.

Titulli i gjetjes 1: Mos realizimi faktik i zërave kryesor të shoqërisë të parashikuar.

Situata:

-Për vitin 2022 Albpetrol sh.a Patos ka arritur një rezultat financiar bruto rreth 412.2 milion lekë. Ndikim në përmirësimin e situatës kanë patur: ***rritja e çmimit të naftës Brut nga 37,169 lekë/ton në 51,893 lekë/ton***, pra me një rritje prej 139,6%.

-Për vitin 2022 është realizuar një volum shitje prej 95,883 ton, kundrejt 108,736 ton të programuar ose 88.2%

-Nga aktiviteti i shoqërisë prodhimi i naftës është realizuar 70,570.5 ton kundrejt 75,920 ton të programuar ose 93%, me mosrealizim prej 5,350 ton naftë. Mosrealizimi vjetor i prodhimit të naftës nga shoqëria, vendburimet në administrimin e saj ka ardhur kryesisht për pasojë të 6 mujorit të parë, me një deficit ndaj programit -6,577 ton naftë dhe një bazë ditore prej 171.7 ton/ditë kundrejt 208 ton/ditë të programuar.

-Detyrimet e mbetura pa shlyera deri më 31 Dhjetor 2022 ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos nga kompanitë koncesionare për naftën bruto rezultojnë 134,401 ton naftë duke u rritur me rreth 17,557 ton krahasuar me fundin e vitit 2021.

-Gazi i prodhuar nga vet Albpetrol është gaz shoqëruës dhe për vitin 2022 është realizuar 110 mijë N/m3 nga 270 mijë N/m3 programuar ose 40.8 %.

-Investimet për vitin 2022 janë realizuar në vlerën 243,602 mijë lekë nga 836,126 mijë lekë të programuar ose rreth 29.1 %.

-Janë realizuar të ardhura rreth 6.59 miliardë lekë dhe janë kryer shpenzime rreth 7.6 miliardë lekë. Duke filluar nga muaji Shkurt 2022, në evidencën e bilancit të grumbullimit dhe shpërndarjes të naftës për kompaninë, nuk janë përpunuar të dhënat për vitin 2022, referuar faktit që bilanci i dërguar nga Qendra e Administrim Shitjeve të Naftës dhe Gazit ka patur problematika të cilat janë bërë prezente zyrtarisht nga Drejtoria e Programimit, pasi nevojitet vendimmarrja e shoqërisë. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit sipas pasqyrës PASH të bilancit kontabël të shoqërisë janë realizuar 6,587,574 mijë lekë.

Krahasuar me ato të programuara 5,851,206 mijë lekë janë realizuar 112.6 % ose me tejkallim prej 736,367 mijë lekësh, kryesisht nga tejkallimi i të ardhurave nga shitja e naftës.

Për vitin 2022 në Regjistrin e prokurimeve publike janë parashikuar për tu prokuruar 167 procedura, detajuar për Investime 78 procedura, Materiale 48 procedura dhe Shërbime 41 procedura.

Nga monitorimi i elementeve të Regjistrit të Prokurimeve për vitin 2022, rezulton se nga 167 elementë të parashikuar në regjistër 54 elementë ose 33 % e totalit kanë vijuar me procedurat, ndërsa 113 elemente ose 67 % e totalit janë me statusin të pazhvilluar (ose anuluar).

Nga procedurat e parashikuara për tu prokuruar në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2022, është arritur të realizohen procedura me kontratë gjithsej 54 procedura me vlerë totale të kontratave 564,227,021 lekë.

-Gazi i prodhuar nga vet Albpetrol është gaz shoqëruës dhe për vitin 2022 është realizuar **110 mijë N/m3 nga 270 mijë N/m3 programuar ose 40.8 %**.

10) Detyrimet e kontraktorëve për prodhimin e gazit ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos rezultojnë në sasinë **24,426,313 Nm³**.

Kriteri:

Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”.

Ndikimi:

Mos arritja e objektivave kryesor të Shoqërisë.

Shkaku: Planifikimi jo i saktë dhe performancë e dobët nga sektorët kryesorë të Shoqërisë.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa konkrete për kryerjen e investimeve në sektorët strategjik të shoqërisë me qëllim maksimizimin e prodhimitarisë së naftës si burimi i saj kryesor i të ardhurave dhe uljen e kostove për nxjerrjen e saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e institucionit të bëjnë dhe një analizë të thelluar për arsyet e mos realizimit të zërave kryesor të programuara në fillim viti.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga Shoqëria Albpetrol sh.a Patos është paraqitur observacioni me shkresën e datës 29.04.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1202/4 prot., datë 02.04.2023, “Mbi aktkonstatimin nr. 1, datë 20/04/2023”, nga znj. A. H. ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Unë, A. H., jam komanduar në detyrën e Administratorit të shoqërisë në zbatim të vendimit të aksionerit me Vendim nr. 2835/1, datë 01.04.2022, dhe jam larguar me vendim të aksionerit datë 04.05.2022, pra kam ushtruar këtë detyrë për një periudhë të shkurtër rreth 1 muaj dhe gjatë kësaj periudhe nuk kam ndërmarrë procedura vendimmarrje në lidhje me strukturën organizative të shoqërisë.

2. ...Po ashtu, nuk jam përgjegjëse në pozicionin e punës si Drejtore e Drejtorisë së Programimit dhe Zhvillimit Strategjik pasi nuk kam qenë pjesë e vendimmarrjeve për ndryshime në strukturën e organizimit dhe vendimeve të emërimeve, largimeve të punonjësve nuk i janë adresuar kësaj drejtorie...

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga znj. A. H. ish-Administratore e Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos sqarojmë se,

Së pari: Observacioni juaj është jashtë kontekstit lidhur me Akt – Konstatimin nr. 2, pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Së dyti: Observacioni juaj është jashtë kontekstit lidhur me Akt – Konstatimin nr. 2, pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Pika 2.4 e programit. Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, hartimi dhe miratimi i bilancit, si dhe auditim i gjendjes dhe ecurisë së detyrimeve debitorë dhe kreditorë, derdhja e detyrimeve fiskale në buxhetit të shtetit.

Albpetrol sh.a Patos është shoqëri aksionere që ka për objekt kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure në përputhje me ligjin Nr. 7746, datë 28/08/1993, “Për prodhimin, zhvillimin, trajtimin, transportin, magazinimin dhe shitjen e naftës bruto, gazit dhe rërave bituminoze brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe çdo operacion tjetër tregtar apo shërbime që i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë.

Shoqëria, brenda hapësirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi kryen çdo operacion projektues – preventives, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarisë dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit si dhe çdo aktivitet tjetër të mundshëm e të ligjshëm në përputhje me interesat e saj. Realizimi i objektit të veprimtarisë të shoqërisë bëhet nëpërmjet shfrytëzimit dhe zhvillimit të zonave ekzistuese naftëmbajtëse dhe ato gazmbajtëse të vendit, kërkimeve të reja, zhvillimit të blloqeve në administrim si dhe shfrytëzimit të rërave bituminoze, furnizimit me energji elektrike të klientëve të kualifikuar, tregtimin e energjisë elektrike, transmetimin e gazit natyror, shpërndarjen e gazit natyror, leje mjedisore për veprimtari me diktim në mjedis për vendburimet e naftës në zonat Kuçovë, Patos-Marinez, Ballsh Hekal, Amonicë Gorisht, për vendburimet e gazit në zonën Divjakë – Lushnjë, Frakull-Fier, Povelc Fier, Finiq –Sarandë, rrjeti i transmetimit të produkteve të naftës dhe të gazit, vendburimi i rërës bituminoze Kasnic-Fier, U...E dhe U...S. Shoqëria është themeluar në bazë të Vendimit të Gjykatës nr. 21158, datë, 8 Prill 1999, sipas regjistrit tregtar, bazuar në ligjin nr. 7638, datë 19 Nëntor 1992 “Mbi shoqëritë tregtare”. Selia e shoqërisë është në adresën Patos, Fier.

Aksionet e Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos janë nën pronësinë e Shtetit Shqiptar të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Drejtuesit e Shoqërisë janë Këshilli Mbikëqyrës dhe Bordi i Drejtorëve.

Në përputhje me veprimtarinë dhe organizimin administrativ, shoqëria ka organizuar kontabilitetin në disa njësi vartëse ose qendra, të cilat përgatisin secila Pasqyra Financiare më vete dhe nxjerrin rezultat të veçantë. Në qendër, shoqëria përgatit Pasqyrën Financiare përmbledhëse të bilanceve kontabël të njëjësive të saj. Kontabiliteti në qendër është i informatizuar, ndërsa në njësitë vartëse mbahet në mënyrë të përzier, manuale dhe të informatizuar.

Emërtimi i njëjësive vartëse është si me poshtë:

- 1-QPN Patos (Qendra Prodhimit të Naftës Patos)
- 2-QPN Kuçovë (Qendra Prodhimit të Naftës Kuçove)
- 3-QPN Ballsh (Qendra Prodhimit të Naftës Ballsh)
- 4-QASHNG (Qendra Administrimit të Shitjes Naftë e Gaz)
- 5-QAR (Qendra Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës)
- 6-QSHGJ (Qendra e Shërbimeve Gjeofizike)
- 7-QFSHE (Qendra e Furnizimit dhe Shërbimeve Elektrike)
- 8-QEMNG (Qendra Emergjencës, Mjedisit, Naftës e Gazit)
- 9-QFMT (Qendra Furnizimit Materialeve Teknike)
- 10-QT Patos (Qendra e Transportit)
- 11-QMN Kuçovë (Qendra Mekanike Naftës Kuçovë)
- 12-QPN Gorisht (Qendra Prodhimit Naftës Gorisht)
- 13-Administrata “ALBPETROL”

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe parimet e ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të aprovuara dhe të shpallura për zbatim nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostove historike, duke e kombinuar me elemente te metodave te tjera dhe parimin e të drejtave të konstatuara. Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale dhe e paraqitjes të pasqyrave financiare të Shoqërisë.

Titulli i gjetjes 1: *Mos respektim i afateve të aprovimit të pasqyrave financiare nga Këshilli Mbikëqyrës, me pasojë depozitimin me vonesë të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit.*

Situata:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe komunikimet mbi mbajtjen e evidencës kontabël dhe miratimit të bilancit, rezultoi se:

Është bërë deklarimi në sistem për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021 me datë 31.03.2022. Me shkresën nr. 1528.prot, datë 14.02.2022 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka caktuar audituesit ligjorë për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2021, me të cilët është lidhur kontratë shërbimi me nr 4726 prot., datë 23.06.2022 nga Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe shtesë kontrate nr. 4726/3 pro., datë 22.08.2022 me afat shtyrje deri me datë 18.09.2022.

Me vendimin nr. 21, datë 08.11.2022, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar pasqyrat financiare të shoqërisë dhe me vendimin nr. 9393/1, datë 30.12.2022, asambleja e ortakëve ka miratuar rezultatin e vitit ushtrimorë në vlerën 10,857 mijë lekë.

Sa më sipër rezulton se aprovimi është kryer jashtë afatit të caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1 ku citohet:

pika 1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi, pika 2. Shoqëritë tregtare, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kalendarik, vendimin e organit përgjegjës/vendimin. Për paraqitjen me vonesë të këtij vendimi zbatohet një gjobë prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh.

Për pasojë depozitimi i pasqyrave financiare të periudhës 2021, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, është kryer jashtë afateve ligjore në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46, pika 1 ku citohet.....

Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t’i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.

Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t’i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.

Kriteri:

Ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1, ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46, pika 1

Ndikimi/Efekti: Marrje e penaliteteve nga mosdorëzimi në afatet ligjore.

Shkaku:

Mos zbatim i afateve të aprovimit të pasqyrave financiare nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

-Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë dhe Nëpunësi Zbatues të merren masa që në të ardhmen pasqyrat financiare të hartohen, të aprovohen dhe të depozitohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë e vlerësimin e performancës ekonomike, në interes të vendim-marrjeve që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredi dhënie etj.

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 3, datë 20/04/2023, nga subjekti i audituar Albpetrol sh.a Patos. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Nga Drejtoria e financës, është kryer deklarimi në sistem i pasqyrave financiar të vitit 2021, në datë 31.03.2021. Gjatë vitit 2022 për një periudhë të shkurtër, janë ndërruar disa administratorë: Me vendim nr. 2836/1, datë 01.04.2022, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit, është miratuar Vendimi nr. 5, datë 01.04.2022 i Këshillit mbikëqyrës për lirimin nga detyra e administratorit të shoqërisë z F. M dhe me vendim nr. 2835/1, datë 01.04.2022, të Asamblesë së Përgjithshme të

Aksionerit, është miratuar Vendimi nr. 6, i Këshillit mbikëqyrës për emërimin e znj. A. H. në detyrën e administratorit të shoqërisë.

Me vendim nr. 3628/1, datë 04.05.2022, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit, është miratuar Vendimi nr. 10, datë 04.05.2022 i Këshillit mbikëqyrës për lirim nga detyra e administratorit të shoqërisë znj A. H. dhe me vendim nr. 3629/1, datë 04.05.2022, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit, është miratuar Vendimi nr. 11, datë 04.05.2022i Këshillit mbikëqyrës për emërimin e z. K. C. në detyrën e administratorit të shoqërisë.

Këto lëvizje kanë sjellë vonesa në lidhjen e kontratës së shërbimit të auditimit të pasqyrave financiare, kjo kontratë është lidhur në datë 23.06.2022 kjo ka shtyrë afatin e realizimit të shërbimit të auditimit të pasqyrave financiare.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet merret në konsideratë fakti që pasqyrat financiare nga Drejtoria e Financës në sistem janë deklaruar brenda afatit ligjorë, por theksojmë që nga Administratori i Shoqërisë duhet të merren masa që në të ardhmen, të aprovohen dhe të depozitohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë e vlerësimin e performancës ekonomike, në interes të vendim-marrjeve që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredi dhënie etj.

Zëri kontabël “Aktivet afatgjata materiale”, me kosto historike në fund të periudhës 31.12.2021 paraqitet në vlerën 32,017,937 mijë lekë (viti 2020: 31,894,548 mijë lekë) ndërsa për vlerën neto në fund të periudhës në pasqyrën e pozicionit financiare, paraqitet në vlerën 31,115,579 mijë lekë (2020: 31,401,901 mijë lekë), me ulje si rezultat i shtesave dhe paksimeve nga rivlerësimet dhe nga llogaritja e amortizimit që për vitin 2021 është llogaritur në vlerën 410,419 mijë lekë.

Aktivet afatgjata materiale me kosto historike në vlerën 32,017,937 mijë lekë sipas aktiveve paraqitet si më poshtë:

Toka (Truall) në vlerën 8,252,036 mijë lekë,

Ndërtesa në vlerën 1,281,483 mijë lekë,

Makineri dhe impiante në vlerën 21,569,861 mijë lekë,

Paisje informatike në vlerën 68,958 mijë lekë,

Të tjera në shfrytëzim në vlerën 817,506 mijë lekë.

Titulli i gjetjes 2: Prona të parregjistruara në ASHK dhe pasqyrim në kontabilitet të aktiveve të cilat nuk kanë titull pronësie.

Situata:

Nga auditimi ka rezultuar se nga pronat të kaluara me VKM nr. 219/2004, datë 16.04.2004 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në administrim Albpetrol sh.a Patos.”, VKM nr.784/2006, datë 15.09.2006 “Për Ristrukturimin e Shoqërive Tregtare me Kapital Shtetëror Albpetrol sh.a Patos, “S...M” sh.a dhe “T...A” sh.p.k”, VKM nr. 275/2010, datë 26.04.2010 “Për përthithjen nga Albpetrol sh.a Patos të “U...E” dhe “U...S” shpk , Urdhri nr. 1480/2016, datë 29.02.2016 për zbatimin e Vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.2037/2017, datë 04.07.2017 të “Për kalimin e pronësisë së sendit të pranuar si blerje e kreditorit” të Shoqërisë Përmbartimore private “T...P” shpk, shoqërisë Albpetrol sh.a Patos kanë kaluar në pronësi Troje për 10 962 126 m² (Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 2 029 038 m², Puse me sipërfaqe për 4 198 588 m² dhe Rrugë për 4 198 588 m²) të pasqyruara në kontabilitet për vlerën 9, 533,519 mijë lekë. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka certifikuar 3 950 459 m² (Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 1 207 108 m², Puse me sipërfaqe për 2 448 000 m² dhe Rrugë për 295 351 m²) ose 36% e totalit dhe nuk ka çertifikatë 6 958 117 m² (Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 821 930 m², Puse me sipërfaqe për 2 232 950 m² dhe Rrugë për 3 903 237 m²) ose 64% e totalit ose nga 6497 prona janë certifikuar 3799 prona ose 58% e totalit, janë në proces për regjistrim 870 prona. **Rezultojnë që ka 28 prona me mbivendosje dhe 440**

prona të zaptuara. Sa më lart kontabilizimi i tyre nuk është mbështetur në dokumente hipotekore në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

Kriteri:

Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

Ndikimi/Efekti: Mungesë dokumentacioni ligjorë për kontabilizimin e tyre dhe raportimin e tyre në pasqyrat financiare mbështetur në dokumente hipotekore.

Shkaku:

Mos ndjekje e procedurave për regjistrimin e tyre në ASHK.

-Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë të marren masa që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtoria Fier dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 3, datë 20/04/2023, nga subjekti i audituar Albpetrol sh.a Patos. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. Dokumente autorizues - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Te tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

Referuar për sa mësipërm, të gjitha regjistrimet që kanë të bëjnë me lëvizjet e aktiveve të cituara nga ju më lart, janë kryer me urdhër të të Asamblesë së përgjithshme të Aksionerit.

Çertifikimi i pronës së “Albpetrol “ sh.a nuk është detyrë e drejtorisë së Financës por e drejtorisë së Pronës.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet merret në konsideratë fakti që të të gjitha regjistrimet që kanë të bëjnë me lëvizjet e aktiveve, janë kryer me urdhër të të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit, por nga Administratori i Shoqërisë të marren masa që nëpërmjet Drejtorisë së Pronës, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtoria Fier dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie që është dokument bazë vërtetues i aktivitetit.

Titulli i gjetjes 3: Shoqëria Albpetrol sh.a Patos nuk ka zbatuar kërkesat e SNK 16 duke njohur vlerën prej 344,365 mijë lekë në paksim të “Aktive Afatgjata Materiale”, pasi këto kaluar në administrim të Bashkive respektive me qëllim privatizimin e tyre nga qytetarë të cilët i përdorin.

Situata:

Nga auditimi ka rezultuar se në grupin e “Aktive Afatgjata Materiale” të pasqyruara në bilanc në vlerën 31,115,579 mijë lekë është e përfshirë dhe vlera prej 344,365 mijë lekë që i përket banesave të cilat janë ndërtuar nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos të cilat nuk administrohen më për arsye se në zbatim të VKM nr. 97, datë 03.02.2008 “Për procedurat privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe i ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, kanë kaluar në administrim të Bashkive respektive me qëllim

privatizimin e tyre nga qytetarë të cilët i përdorin. Sa më sipër shoqëria Albpetrol sh.a Patos **nuk ka zbatuar kërkesat e SNK 16 duke njohur vlerën prej 344,365 mijë lekë në paksim** të “Aktive Afatgjata Materiale” dhe paraqitjen e tyre në vlerën sipas inventarit fizik dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kapitulli III, pika 28.

Kriteri:

Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kapitulli III, pika 28.

Ndikimi/Efekti:

Paraqitje e vlerës së “Aktive Afatgjata Materiale” në pasqyrat financiare më shumë pra jo në vlerën e tyre reale.

Shkaku:

Mos ndjekje e procedurave për kalimin e tyre në administrim të Bashkive respektive.

-Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos nëpërmjet Drejtorisë së Financës, të marrë masa për transferimin e objekteve të kthyera në banesa që administrohen nga Bashkitë, me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur nga “Aktive Afatgjata Materiale” vlerën 344,365 mijë lekë.

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 3, datë 20/04/2023, nga subjekti i audituar Albpetrol sh.a Patos. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Shoqëria Albpetrol ndër vite ka ndërtuar banesa për punonjësit e kompanisë me fondet e veta. Në zbatim të VKM nr.470, datë 31.08.2000, këto banesa i kanë kaluar Entit Kombëtarë të Banesave dhe më tej në zbatim të VKM nr.97, datë 03.02.2008 u është kaluar në administrim Bashkive respektive, ku sipas kuptimit të vendimit banesat dhe objektet e kthyera në ambiente banimi, të ndërtuara dhe të blera me fondet e shoqërisë, në zbatim të pikës 2 dhe 18 të vendimit do të trajtohen si shlyerje të detyrimeve të prapambetura që shoqëria ka ndaj buxhetit të shtetit. Nëpërmjet shkresës nr. 5135, datë 29.05.2019 nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos i është sugjeruar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që shuma prej 344,365 mijë lekë të kalojë në paksim të dividendit të shoqërisë.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet merret në konsideratë fakti që për aktivet të cilat sipas VKM nr.97, datë 03.02.2008 u është kaluar në administrim Bashkive respektive, ku sipas kuptimit të vendimit banesat dhe objektet e kthyera në ambiente banimi, të ndërtuara dhe të blera me fondet e shoqërisë, në zbatim të pikës 2 dhe 18 të vendimit do të trajtohen si shlyerje të detyrimeve të prapambetura që shoqëria ka ndaj buxhetit të shtetit, por në kuptim të SNK 16 në pasqyrat financiare vlera prej 344,365 mijë lekë duhet të zbriten nga të “Aktive Afatgjata Materiale” dhe paraqitjen e tyre në vlerën sipas inventarit fizik.

Titulli i gjetjes 4: *Për “Aktivet afatgjata materiale”, të vlerësuara për jashtë përdorimit për periudhën objekt auditimi u konstatua se nuk është ngritur komision për asgjësimin dhe vlerësimin e si mbeturinë, skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.*

Situata:

Nga auditimi ka rezultuar se zëri kontabël “Aktivet afatgjata materiale”, me kosto historike në fund të periudhës 31.12.2021 paraqitet në vlerën 32,017,937 mijë lekë (viti 2020: 31,894,548 mijë lekë). Nga procesi i inventarizimit të kryer në zbatim të Urdhrit nr 203, datë 21.09.2021 “Për

inventarizimin e përgjithshëm të pasurisë për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos për vitin 2021”, kanë rezultuar makineri e paisje, mjete transporti dhe paisje zyre dhe informatike të cilat nga grupet e inventarizimit sipas Qendrave janë vlerësuar si inventarë jashtë përdorimit.

Me vendim nr. 378, datë 13.09.2022 të Komisionit Qëndror i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos pas shqyrtimit të procesverbaleve të përgatitura nga Komisionet e Vlerësimit të Qendrave për makineri e paisje, mjete transporti dhe paisje zyre dhe informatike të cilat janë vlerësuar dhe propozuara për jashtë përdorimit, ka vendosur të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të **2214 copë makineri e paisje, mjete transporti dhe paisje zyre dhe informatike me vlerë të mbetur 96,264,022 lekë**. Sa më sipër për “*Aktivet afatgjata materiale*”, të vlerësuara për jashtë përdorimit për periudhën objekt auditimi u konstatua se **nuk është ngritur komision për asgjësimin dhe vlerësimin e si mbeturinë**, skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, pikat 109, 110 dhe 111.

Kriteri:

Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, pikat 109, 110 dhe 111.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash nga shitja e tyre për skrap.

Shkaku: Mos ndjekje e procedurave për asgjësim dhe vlerësim për skrap.

-Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos ti kërkojë Këshillit Mbikëqyrës të, të marrë masa që për “Aktivet afatgjata materiale”, vlerësuara për jashtë përdorimit për vlerën 96,264,022 lekë, të ngrëjë komisionin për asgjësimin dhe vlerësimin si mbeturinë, skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 3, datë 20/04/2023, nga subjekti i audituar Albpetrol sh.a Patos. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Në zbatim të ligjit nr 9228, datë 20.04.2004 “Për pasqyrat financiare” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe të Urdhrit nr 203, datë 21.09.2021 “Për inventarizimin e përgjithshëm të pasurisë për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos për vitin 2021”, gjatë muajit Tetor-dhjetor u krye inventarizimi. Nga këshilli mbikëqyrës është ngarkuar Drejtoria e Audit të Brendshëm të shoqërisë për verifikimin e procedurës së ndjekur. Deri në këtë moment nga Këshilli Mbikëqyrës nuk është miratuar procedura për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale. Vetëm pas miratimit të materialit për nxjerrjen jashtë përdorimit të AAM nga Këshilli Mbikëqyrës vazhdojnë procedurat për ngritjen e komisionit për asgjësimin dhe vlerësimin e si mbeturinë, skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave për shoqërinë.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet nga ana juaj theksojmë se konstatimi i grupit të auditimit ka të bëjë me moszbatimin e përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, pikat 109, 110 dhe 111 dhe në kuptim të ligjit nr 9228, datë 20.04.2004 “Për pasqyrat financiare” i ndryshuar, aktivet të cilat janë konstatuar si jashtë përdorimit duhet të asgjësohen me qëllim shitje dhe të vlerësohen si mbeturinë skrap pra nuk mund të qëndrojnë më si inventarë në kontabilitet.

Aktive afatgjata jo materiale

Zëri kontabël “Aktivet afatgjata jo materiale”, me kosto historike në fund të periudhës 31.12.2021 paraqitet në vlerën 96,932 mijë lekë (viti 2020: 98,176 mijë lekë) ndërsa për vlerën neto në fund të periudhës në pasqyrën e pozicionit financiare, paraqitet në vlerën 67,669 mijë lekë (2020: 83,453 mijë lekë), me ulje si rezultat i shtesave dhe pakësimeve nga rivlerësimet dhe nga llogaritja e amortizimit që për vitin 2021 është llogaritur në vlerën 29,263 mijë lekë.

Aktivitet afatshkurtra

000/lekë

Nr	Emertimi	31.12.2021	01.01.2021
1	Inventarët	2,937,812	3,725,152
2	Shpenzime të shtyra	2,994	0
3	Llogari të arkëtueshme tregtare	13,174,589	18,110,942
4	Llogari të arkëtueshme të tjera	4,276,594	4,203,422
5	Mjete monetare dhe ekujvalente të tyre	547,025	1,204
	Shuma	20,938,964	26,040,720

Zëri kontabël “Inventarët”, në fund të periudhës në pasqyrën e pozicionit financiare, paraqitet në vlerën 2,937,812 mijë lekë (2020: 3,725,152 mijë lekë), me ulje në vlerën 751,340 mijë lekë.

Vlera prej 2,937,812 mijë lekë përfaqëson lëndë të para dhe materiale të konsumueshme, prodhim në proces, produkte të gatshme dhe mallra të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

000/lekë

Nr	Emertimi	31.12.2021	01.01.2021	Diferenca
1	Lëndë të para dhe materiale të konsumueshme	292,784	287,674	5,110
a	Lëndë të para dhe materiale të konsumueshme	430,271	425,162	-
b	Zhvlerësim i materialeve	(137,487)	(137,487)	-
2	Prodhim në proces dhe gjysmë produkte	31,007	31,431	(421)
3	Produkte të gatshme	945,802	1,734,223	(788,421)
4	Mallra	1,668,219	1,671,784	(3,565)
	Shuma	2,937,812	3,725,152	(787,297)

Titulli i gjetjes 5: Nga drejtimi i shoqërisë nuk janë kryer analiza për vlerën e inventarëve stok ose me qarkullim të ngadalshëm për shkak të ndryshimit të teknologjisë apo kalimit të afatit të skadencës.

Situata:

Nga auditimi u konstatua se shoqëria në regjistrat e saj ka materiale të cilat janë stok ose me qarkullim të ngadalshëm për shkak të ndryshimit të teknologjisë apo kalimit të afatit të skadencës në vlerën 1,306,029 mijë lekë për të cilat shoqëria ka njohur zhvlerësime vetëm për vlerën 137,487 mijë lekë në periudha të mëparshme, **pra sipas SNK 2 “Inventarët”**, duhet të njihen dhe të pasqyrohen në kontabilitet për vlerën më të vogël. Nga drejtimi i shoqërisë nuk janë kryer analiza për periudhat kur janë bërë hyrje në magazinë si dhe përqindjet e shfrytëzimit të tyre, si dhe pasojat e mos mbajtjes së të dhënave të kontabilitetit me programe kompjuterike, nuk mundësojnë vlerësime të detajuara për rritjen e mallrave stok. Rritja e vlerave të mallrave stok dhe e mallrave me qarkullim të ngadalshëm ka ardhur si pasojë e përlllogaritjeve jo me saktësi e përgjegjshmëri të sasive të artikujve të kërkuar, duke krijuar material stok, që përveç se ka alokuar fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, pika103, 107, 108 dhe 109.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 1 dhe 2, Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, pika103, 107, 108 dhe 109.

Ndikimi/Efekti:

Artikujt e ngelur stok si dhe ato me qarkullim të ngadalshëm kanë tendencën që të dëmtohen dhe të bëhen të papërdorshëm, duke sjellë ulje të aktiveve të shoqërisë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

-Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë dhe strukturat e tjera kërkues të mallit/aktivitetit, të llogaritit me kujdes nevoja për blerje, duke evidentuar më parë gjendjen ekzistuese në magazinë dhe nevojat reale mbi këtë gjendje. Kërkesat për mall të shoqërohen me argumentim dhe relacion përkatës, duke përcaktuar saktë përdorimin e mallit pas blerjes.

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 3, datë 20/04/2023, nga subjekti i audituar Albpetrol sh.a Patos. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 si më poshtë

Pretendim i subjektit:

Në zbatim të ligjit nr 9228, datë 20.04.2004 “Për pasqyrat financiare” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe të Urdhrit nr 203, datë 21.09.2021 “Për inventarizimin e përgjithshëm të pasurisë për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos për vitin 2021”, gjatë muajit Tetor-dhjetor u krye inventarizimi fizik të “Inventarit”. Nga komisionet e inventarizimit janë evidentuar mallra stok në magazinë në vlerën 1,306,029 mijë lekë, në vitin 2022 shoqëria ka njohur zhvlerësim në vlerën 686,225,630 lekë dhe në pasqyrat financiare t vitit 2022 zhvlerësimi i inventarëve është për vlerën 823,713,099 lekë. Sasia e mallrave stok nuk ka ardhur si rezultat i përlllogaritjeve jo me saktësi të sasive të artikujve të kërkuara por si rezultat i ndryshimit të teknologjisë dhe janë mallra të vjetruara.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet nga ana juaj theksojmë se konstatimi i grupit të auditimit ka të bëjë me moszbatimin e përcaktimeve të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, pika 103, 107, 108 dhe 109. Procedurat e zhvlerësimit dhe çregjistrimit nga kontabiliteti duhet të bëhen në kohë me qëllim pasqyrimin real të vlerave të “Inventarëve” në pasqyrat financiare.

Gjithashtu, shoqëria paraqet prodhimin e vet në zërin produkte të gatshme, brenda zërit Inventarët, në vlerën 945,802 mijë lekë (2020: 1,734,223 mijë lekë).

Zëri kontabël “Shpenzime të shtyra”, në fund të periudhës në pasqyrën e pozicionit financiar, paraqitet në vlerën 2,944 mijë lekë (2020: 0 mijë lekë), të cilat përfaqësojnë parapagim INSIG për siguracionin mjetesesh.

Analiza e debitorëve

Zëri kontabël “Llogari të arkëtueshme tregtare” (debitorët), në fund të periudhës në pasqyrën e pozicionit financiare, paraqitet në vlerën 13,174,589 mijë lekë (2020: 18,110,941 mijë lekë), pasqyra si më poshtë:

000/lekë

Nr	Emertimi	31.12.2021	01.01.2021	Diferenca
1	Llogari të arkëtueshme (debitorë)	18,887,732	18,671,912	215,820
a	Deri në një vit	1,675,260	1,458,551	
b	Mbi një vit	17,212,472	17,213,361	
2	Zhvlerësimi i kërkesave të arkëtueshme	(5,713,143)	(560,971)	
	Shuma	13,174,589	18,110,941	(4,936,352)

Në zërin kontabël “Llogari të arkëtueshme tregtare” (debitorët), përfshihen të drejtat për arkëtim nga shoqëria “A...O” Sha, për shumën 11,464,502 mijë lekë (2020: 11,464,502 mijë lekë) që kjo shoqëri nuk zhvillon më aktivitet.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos, ka detyrime ndaj shoqërisë “A...O” Sha, për shumën 6,312,329 mijë lekë (2020: 6,312,329 mijë lekë), konstatohet se për diferencën 5,152,172 mijë lekë (11,464,502 - 6,312,329), janë krijuar provigjone në vitin 2021.

Debitorët të analizuar sipas njësisë vartëse dhe moshës së borxhit, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Njësit vartëse	01.01.2021	Shtesa paksime		31.12.2021	Deri 1vit	Deri3vit	Deri 5vit	Mbi 5vit
			D	K					
1	FSHE.Patos	636,334	1,813,027	1,804,647	644,714	160,353	12,788	125,573	346,000
2	Q.P.N Fier	132,736	364	355	132,746	27	774	-	131,944
3	UMN Kuçovë	15,628	6,418	6,585	15,461	1,737	170	218	13,336
4	QASHNG.Pat	104,812	5,901,207	5,815,950	190,069	85,453	10,542	(5)	94,079
5	QEMNG.Pato	7,319	120	-	7,439	466	-	-	6,974
6	QFT.Patos	56,315	3,537	4,517	55,335	441	-	224	54,670
7	QPN.Kucove	583	5,300	5,428	455	0.5	-	-	454
8	QSHGJ.Patos	42,650	5,077	11,777	35,949	1,419	553	-	33,976
9	Administrata	17,675,496	1,889,729	1,759,700	17,805,525	1,425,440	(214,621)	1,190,043	15,404,667
10	QPN Gorisht	38	-	-	38	-	38	-	-
	Totali	18,671,912	9,624,779	9,408,9601	18,887,732	1,675,337	(189,760)	1,316,053	16,086,101

Nga të dhënat e pasqyrës sa më sipër konstatohet se nivelin më të lartë të debitorëve e ka administrata në vlerën 17,805,525 mijë lekë ose 94 % e debitorëve gjithsej.

Sipas moshës së krijimit të debitorëve konstatohet se në totalin e tyre debitorë mbi 5 vite janë në vlerën 16,086,667 mijë lekë ose 85 % e debitorëve në total.

Debitorë të analizuar sipas subjekteve shtetore dhe privat dhe sipas moshës, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Njësit vartëse	01.01.2021	Shtesa paksime		31.12.2021	Deri 1 vit	Deri 3 vit	Deri 5 vit	Mbi 5 vit
			D	K					
1	A...O	11,464,502	-	-	11,464,502	-	(221,971)	-	11,686,473
2	Private	6,619,934	9,623,625	9,407,723	6,835,836	1,675,259	32,206	1,070,828	4,057,543
3	shtetërore	331,941	147	230	331,858	79	4	-	331,775
4	O...E	255,535	1,008	1,008	255,535	-	1	245,224	10,310
	Totali	18,671,912	9,624,779	9,408,961	18,887,733	1,675,337	(189,760)	1,316,053	16,086,101

Sa më sipër arkëtimi i detyrimit të “A...O” Sha ndaj Albpetrol sh.a Patos është në proces gjyqësor.

Albpetrol sh.a Patos ka depozituar kërkesë-padinë nr 413701, datë 21.02.2012 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë paditëse Shoqëria Albpetrol sh.a Patos, Fier dhe i paditur Shoqëria “A...O” sh.a Fier (A...E). Nisur nga vlera e madhe e objektit të kërkesë padisë është vendosur që ky proces gjyqësor të ndiqet nga një studio ligjore private e specializuar në fushën e ndjekjes së proceseve gjyqësore civile. Studio ligjore e cila po ndjek procesin gjyqësor është studio Ligjore “O...L”. Drejtoria Juridike menjëherë pas nënshkrimit dhe depozitimit të kërkesë padisë i ka kërkuar Administratorit të Albpetrol sh.a Patos që të kryhet pagimi i taksës gjyqësore sipas objektit të padisë. Taksa gjyqësore është paguar vetëm për detyrimin e panjohur. Albpetrol sh.a Patos nënshkroi marrëveshje me nr. 1604 prot., datë 13.02.2014 për shlyerjen me këste të detyrimit të njohur. A...O sh.a, nuk përmbushi detyrimin sipas marrëveshjes me nr 1604, datë 13.02.2014. Në këto kushte Albpetrol sh.a Patos depozitoi kërkesë padinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, për shlyerje të detyrimit të njohur si dhe kërkoi sigurimin e padisë. Me vendimin nr. 744, datë 16.08.2014 Gjykata e Shkallës Parë Tiranë vendosi masën e sigurimit të padisë dhe konkretisht:

-Vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë bankare të Shoqërisë A...O sh.a në të gjitha bankat e nivelit të dytë, deri në shumën 3,422,466,260 lekë e barabarte me shumën e detyrimeve të pranuar nga Shoqëria A...O sh.a.

-Vendosjen e sekuestros mbi aksionet e Shoqërisë A...O sh.a dhe asetet e saj të kapitalizuar e jo të kapitalizuar, përfshirë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe te paluajtshme.

Vendimi për sigurimin e padisë nr 744 akti, datë 26.08.2014 me objekt vendosjen e sekuestros konservative në llogaritë dhe asetet e shoqërisë Armo, u vu në ekzekutim pranë shoqërisë përmbarrimore “T...P” shpk.

Për detyrimin e njohur nga A...O është fituar procesi gjyqësor dhe është në procedurat ligjore përmbarrimore për tërheqjen e pjesës së njohur nga ish A...O.

Është kaluar pranë Albpetrol sh.a Patos nga Shoqëri Përmbaremore ish Rafineria e Cerrikut ne vlera 221,971,400 lekë.

Debitorë të tjerë shtetërore në shumën 331,858 mijë lekë.

Kjo shumë është e përbëre kryesisht nga: detyrimi i Ujësjetllësit Patos prej 289,335,297 lekë ndaj QSHET Patos. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 12.09.2007, Ujësjetllësi Patos ka kaluar në administrim të pushtetit lokal.

Në nën-zërin debitorë private janë përfshire:

Detyrimi prej 1,160,266,064 leke detyrim i “D...0” sha si detyrim i lindur nga moslikuidimin i naftës së blere nga zbatimi i kontratës së nënshkruar midis M...E dhe Bashkimit të Shoqërive “C...L & D...0” sha. Arkëtimi i këtij detyrimi është në proces gjyqësor i cili po ndiqet nga avokatura e shtetit. Pas hartimit të kërkesë padisë Avokatura e Shtetit i është drejtuar Gjykatës Shkallës Parë Fier për shlyerjen e detyrimit. Çështja është fituar ne shkallen e parë në Gjykatën Administrative Vlore, ka marre formë të prere dhe është dërguar për ekzekutim pranë shoqërisë Përmbaremore T...R.

Në këto debi kredi është përfshire edhe detyrimi prej 1,832,304,408 lekë, i palikujduara nga “S...L” dhe “T...K” shuma të cilat janë në procese përmbaremore për ekzekutimin pranë shoqërisë Përmbaremore T...R sipas faturave te paraqitura për likuidim.

Gjithashtu në këto detyrime është përfshire detyrimi prej 158,130,853, leke si detyrim i T...L i cili është në proces ndjekje dhe arkëtimi.

-Detyrimi prej 42,098,810 lekë i “P...X” është për ekzekutim nga shoqëria Përmbaremore T...R sipas faturave te paraqitura për likuidim.

Detyrimi prej 361,487,649 lekë i T...D janë detyrime të klientëve për shitje naftë të cilat janë në proces ndjekje nga përmbareuesi gjyqësor B. D.

Gjithashtu ne llogarite e Albpetrol sh.a Patos janë të përfshira edhe llogari kërkesash të subjekteve apo ish punonjësve te cilët kane kaluar përkatësisht afatin me shume se 12 vite dhe 5 vite.

Këto detyrime sipas SNK 37 janë provizionuar nga ana e Drejtorisë se Financës. Shuma e provizioneve te përlllogaritura është 642,939,837 lekë.

Drejtoria e Financës për debitorët sa më sipër gjatë vitit 2022, me shkresa i është drejtuar Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit për vlerën e debisë dhe kërkesë për informacion për procedurën e zbatuar nga ana e tyre për ekzekutimet nga shoqëritë përmbaremore të vendimeve të Gjykatave.

Titulli i gjetjes 6: *Subjekte debitorë që i përkasin periudhave të mëparshme duke iu kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumente ligjore, subjekte që kanë falimentuar, për të cilat shoqëria duhet të bëjë zhvlerësimin e tyre.*

Situata:

Nga auditimi u konstatua se me datë 31.12.2020 debitorët janë deklaruar në vlerën 18,671,912 mijë lekë dhe me datë 31.12.2021 janë deklaruar për vlerën 18,887,733 mijë lekë, (“A...O” sh.a në vlerën 11,464,502 mijë lekë, Subjekte Privatë në vlerën 6,835,836 mijë lekë, Subjekte Shtetërore në vlerën 331,858 lekë dhe O...E në vlerën 255,535 mijë lekë), me rritje gjatë vitit 2021, në vlerën 215,821 mijë lekë debitorë privat, sipas moshës së krijimit debitorë mbi 5 vite janë në vlerën 16,086,667 mijë lekë ose 85 % e debitorëve në total. Për detyrimin që “A...O” sh.a, ka ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos është në proces gjyqësor, shoqëria Albpetrol sh.a Patos, ka detyrime ndaj shoqërisë “A...O” Sha, për shumën 6,312,329 mijë lekë, konstatohet se për diferencën 5,152,172 mijë lekë (11,464,502 -6,312,329), janë krijuar provigjone në vitin 2021. Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e “Llogarive të arkëtueshme tregtare” në vlerën **13,174,589 mijë lekë**. Në pasqyrat financiare janë paraqitur të drejta që i përkasin periudhave të mëparshme duke iu kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumente ligjore, subjekte që kanë falimentuar

etj. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 3, *Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: germa “g”, ku citohet:Garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta.*

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, germa “g”.

Ndikimi/Efekti:

Mungesë të ardhurash dhe nga mos kryerja e zhvlerësime të aktiveve financiare sjell mos paraqitje të besueshme të situatës ekonomike të institucionit.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

-Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i Shoqërisë nëpërmjet Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit dhe Drejtorisë së Financës të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve, si dhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 3, datë 20/04/2023, nga subjekti i audituar Albpetrol sh.a Patos. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Ashtu si është paraqitur në Aktivitet e Pasqyrave Financiare të vitit 2021, llogaritë e arkëtueshme tregtare nga aktiviteti i shfrytëzimit janë paraqitur në vlerën 18,887,733 mijë lekë. Shoqëria trashëgon nga periudha të hershme dhe kryesisht nga ndarja e ish –Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës në tre kompani(Armo, Albpetrol dhe Servcom), detyrime debitore me vlera të larta. Këtë e tregon që debitorë mbi 5 vjet zënë 85%. Gjithashtu detyrime të shumta janë të Armos dhe T...K Albania me të cilat shoqëria është në proces gjyqësorë. Drejtoria e financës i ka paraqitur Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit herë pas here shkresa me të dhëna për debitorët sipas viteve të krijimit në mënyrë që të ndiqen procedurat ligjor për çregjistrimin e tyre, (shkresa nr 3882,datë 19.05.2022, shkresa nr 9201, datë 22.12.2022, nr. 7703/1, datë 27.10.2022, nr. 7220/1, datë 06.10.2022, nr. 7521/1, datë 20.10.2022). Për debitorët e vitit 2022 janë krijuar provizione në vlerën 700,000,000 lekë pra në total provizionet për postin “llogari të arkëtueshme Tregtare” të paraqitura në pasqyrat financiare të vitit 2022 janë në vlerën 6,413,143,254 lekë.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet nga ana juaj theksojmë se konstatimi i grupit të auditimit ka të bëjë me debitorët dhe procedurat e ndjekura për arkëtimin tyre të periudhës viti 2021. Ju në observacionin tuaj keni referuar shkresa që i jeni drejtuar Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit gjatë vitit 2022.

Zëri kontabël “Llogari të arkëtueshme të tjera”, në pasqyrën e pozicionit financiar, paraqitet në vlerën 4,276,594 lekë (2020: 4,203,422 mijë lekë).

Llogari të tjera të arkëtueshme me datë 31.12.2021 dhe 2020 detajohen sipas të dhënave të pasqyrës si më poshtë:

000/lekë

Nr	Emertimi	31.12.2021	01.01.2021
1	Të drejta nga kontraktorët	3,679,529	3,408,472
2	Zhvlerësim i kërkesave ndaj nënkontraktorëve	(400,000)	(200,000)
3	Hua të dhëna	652,634	652,634
4	Zhvlerësim i huave të dhëna	(112,800)	(112,880)
5	Aktive (kërkesa) të tjera	1,440,565	1,438,450

Nr	Emertimi	31.12.2021	01.01.2021
	<i>Deri 1 vit</i>	13,307	129,989
	<i>Mbi një vit</i>	1,427,258	1,233,625
6	Zhvlerësim i kërkesave të tjera	(983,254)	(983,254)
	Shuma	4,276,594	4,203,422

Situata:

Nga auditimi rezultoi se “*Të drejta ndaj të tretëve për kontrata hidrokarbure*”, në vlerën 3,679,529 mijë lekë (2020: 3,408,472 mijë lekë). Këto vlera përfaqësojnë vlerën neto përkatëse të sasisë së produktit, që është llogaritur sipas parashikimeve të kontratave hidrokarbure, por që nuk është lëvruar fizikisht në depozitat e “ALBPETROL”, për subjekte si më poshtë:

Nr	Subjekte që kanë kontrata për hidrokarbure	Gjendja në natyrë (ton)	Gjendja në natyrë (000/Nm ³)	Vlera e debisë
1	P...M LTD	63 438.45		1,647,587
2	T...B. Ballsh Hekal	(16 794.18)		(407,955)
3	T...B. Cakran	4 956.61		153,695
4	T...B. D...Zi		22 275.86	369,124
5	T...B. Debina Kondesat	2 637.48		80,006
6	T...B. Gorisht Kocul	25 387.58		712,464
7	T...P LTD	9 785.11		263,734
8	P...C Vb. Amonicë	1 925.5		59,706
9	P...C Vb. Frakull Gazi		795.91	16,146
10	P...C Vb. Finiq Krane	14.87		514
11	P...C Vb. Pekisht Murriz	12.14		883
12	SH...D	601.46		10,822
13	A...O Vb. Ballsh Hekal	27 879.59		746,352
14	Të Drejta penalitete (TOG)			26,451
	Totali	119 845	23 072	3,679,529

Këto vlera në tërësi nuk konfirmohen si detyrim nga ana e kontraktorëve, janë të kontestuar ose janë kundërshtuar në rrugë ligjore prej tyre, për këto shoqëria ka njohur zhvlerësim lidhur me këto të drejta për vitin 2021 në vlerën 400,000 mijë lekë (2020: 200,000 mijë lekë).

-*Të drejta ndaj të tretëve për huadhënie*, në vlerën 652,634 mijë lekë(2020: 652,634 mijë lekë). Këto vlera përfaqësojnë huatë e dhëna për shoqëri që kanë pushuar aktivitetin e tyre, për subjektet (A...A në vlerën 12,500 mijë lekë, P. A. në vlerën 24,000 mijë lekë, G...A sh.a në vlerën 3,457 mijë lekë, B...X në vlerën 2,089 mijë lekë, U.....O në vlerën 2,755 mijë lekë, K...G. Në vlerën 4,902 mijë lekë, A...M në vlerën 43,000 mijë lekë, A...D në vlerën 2,000 mijë lekë, T.....fi U.....e në vlerën 2,000 mijë lekë, T...E në vlerën 6,177 mijë lekë, A...E në vlerën 4,000 mijë lekë, K...E në vlerën 3,000 mijë lekë, P,,,,,m M.....e në vlerën 3,000 mijë lekë, A...Z në vlerën 371,656 mijë lekë dhe AKBN në vlerën 168,099 mijë lekë), sa më sipër shoqëria ka njohur zhvlerësim për këto të drejta vetëm për vlerën 112,800 mijë lekë.

-*Aktive të tjera mbi një vit*, në vlerën 1,440,564 mijë lekë(2020: 1,438,450 mijë lekë). Këto vlera përfaqësojnë, debitorë të tjerë në vlerën 1,365,728 mijë lekë dhe Akcizë në vlerën 74,836 mijë lekë, sa më sipër shoqëria ka njohur zhvlerësim për këto të drejta vetëm për vlerën 983,254 mijë lekë. Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e “*Llogarive të arkëtueshme të tjera*” në vlerën **4,276,594 mijë lekë**. Në pasqyrat financiare janë paraqitur të drejta që i përkasin periudhave të mëparshme duke iu kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumente ligjore, subjekte që kanë falimentuar etj. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, “*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues*”, pika 3, *Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësive publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: germa “g”, ku citohet:*

.....*Garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblihet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të*

gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, germa “g”.

Ndikimi/Efekti:

Mungesë të ardhurash dhe nga mos kryerja e zhvlerësime të aktiveve financiare sjell mos paraqitje të besueshme të situatës ekonomike të institucionit.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

-Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i Shoqërisë nëpërmjet Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit dhe Drejtorisë së Financës të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve që lindin nga kontratat e hidrokarbureve dhe debitorëve të tjerë, si dhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 3, datë 20/04/2023, nga subjekti i audituar Albpetrol sh.a Patos. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Për të drejtat ndaj të tretëve për kontrata hidrokarbure në vlerën 3,679,529, 086 lekë në vitin 2021 janë krijuar provizione në vlerën 400,000 mijë lekë. Dhe në vitin 2022 në vlerën 230,000 mijë lekë gjithsej 630,000 mijë lekë.

Shoqëria Albpetrol nëpërmjet urdhrave të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit me objekt “transferim fondesh” ka transferuar fonde në favor të disa shoqërive në formë huaje.

Në pasqyrat financiare të vitit 2021 “Të drejtat për huadhënie ndaj të tretëve” paraqiten në vlerën 652,634 mijë lekë, janë krijuar provizione për vitin 2021 në vlerën 112,879 mijë lekë dhe për vitin 2022 në vlerën 168,099 mijë lekë gjithsej në vlerën 280,978 mijë lekë. Nëpërmjet shkresës nr. 5135, datë 29.05.2019 nga shoqëria i është kërkuar MIE që huatë e dhëna të të kalojnë në paksim të dividendit të shoqërisë.

Debitorë të tjerë në vlerën 1,440,564 mijë lekë janë të mbartura nga periudhat e mëparshme. Në bazë të urdhrin nr.10, datë 17.01.2019 Drejtoria e Financës i ka paraqitur Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit materjalin e debitorëve pa shpresë arkëtimi për të ndjekur procedurat ligjore. Për këto debitorë janë krijuar provizione në vlerën 983,254 mijë lekë për vitin 2021 dhe në vitin 2022 në vlerën 213,985 mijë lekë gjithsej në vlerën 1,197,239 mijë lekë.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet nga ana juaj theksojmë se konstatimi i grupit të auditimit ka të bëjë me ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve dhe zhvlerësimin e tyre nga “Të drejta ndaj të tretëve për kontrata hidrokarbure”, në vlerën 3,679,529 mijë lekë, Të drejta ndaj të tretëve për huadhënie, në vlerën 652,634 mijë lekë dhe Aktive të tjera mbi një vit, në vlerën 1,440,564 mijë lekë të periudhës viti 2021, me qëllim që gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

KAPITALI DHE DETYRIMET.

Kapitali

Nr	Emertimi	31.12.2021	01.01.2021
1	Kaptali themeltarë	14,735,229	14,735,229
2	Prime të lidhura me kapitalin	8,214,405	8,214,405
3	Rezerva rivlerësimi	24,303,133	24,303,133
4	Rezerva ligjore	538,769	538,769

Nr	Emertimi	31.12.2021	01.01.2021
5	Rezerva statuore	512,954	512,954
6	Rezerva të tjera	909,719	909,719
7	Fitime të mbartura	(11,730,096)	(5,004,756)
8	Fitimi i ushtrimit	10,857	(1,576,288)
	Shuma	37,494,970	42,633,165

Sa më sipër kapitali themeltar në vlerën 14,735,229 mijë lekë (2020: 14,735,229), zotërohet 100% nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Nga aksioneri Ministria e Energjisë dhe Industrisë janë marrë vendime për ndryshimin e kapitalit të regjistruar, sipas shkresës nr 779, datë 03.02.2017, urdhër nr. 34, datë 01.02.2017 për zmadhim të kapitalit për vlerën e aseteve të marra nga AKBN për vend burimet Gorisht-Kocul dhe Cakran – Mollaj në shumën 615,490 mijë lekë.

Me vendim nr. 1180, datë 28.01.2019 aksioneri Ministria e Energjisë dhe Industrisë, është vendosur për zvogëlim të kapitalit për vlerën 92,731 mijë lekë, nr. 6428/4, datë 03.01.2018 ka marrë vendim për zvogëlim të kapitalit të regjistruar të shoqërisë për pasurinë nr. 44/5, volum 14, fq. 226 me emërtesë truall me sipërfaqe 15 739 m² në vlerën 9,803 mijë lekë.

Këto vendime të Aksionerit Ministria e Energjisë dhe Industrisë, nuk janë depozituar në QKB për tu reflektuar në vlerën e kapitalit me qëllim pasqyrimin e vlerës reale të kapitalit themeltarë.

Prime të lidhura me kapitalin në vlerën 8,214,405 mijë lekë (2020: 8,214,405), përfaqëson koston historike të tokës për të cilën shoqëria nuk disponon një dokument hipotekore e për pasojë shoqëria nuk e ka përfshirë në kapitalin ligjorë por e ka paraqitur si prime.

Detyrimet

Detyrimet afatgjata

Nr	Emertimi	31.12.2021	01.01.2021
1	Hua afatgjata	43,046	147,942
2	Provizione afatgjata	280,000	180,000
3	Detyrime të tjera	240,099	240,099
4	Grade dhe të ardhura të shtyra	62,150	63,371
	Shuma	625,655	631,412

Detyrime afatshkurtër

Nr	Emertimi	31.12.2021	01.01.2021
1	Pjesë e huasë afatshkurtër e huas afatgjatë	172,310	276,464
2	Llogari të pagueshme tregtare (401)	10,209,198	10,369,352
3	Llogari të pagueshme të tjera	3,620,187	3,615,789
	Shuma	14,001,695	14,261,605

Zëri kontabël “Llogari të pagueshme tregtare” (Furnitorët), në fund të periudhës në pasqyrën e pozicionit financiare, paraqitet në vlerën 10,209,198 mijë lekë (2020: 10,369,352 mijë lekë), e detajuar sipas qendrave pasqyra si më poshtë:

Nr	Emertimi	31.12.2021	01.01.2021
1	Furnitorë të papaguar	10,043,406	10,307,953
2	Furnitorë të tjerë	165,792	61,399
	Shuma	10,209,198	10,369,352

Furnitorët të analizuar sipas njërive vartëse dhe moshës, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Njësit vartëse	01.01.2021	Shtesa pakësime		31.12.2021	Deri 1vit	Deri3vit	Deri 5vit	Mbi 5vit
			D	K					
1	QFSHE.Patos	3,165,587	1,301,780	1,415,655	3,279,462	247,796	1,055,243	-	1,976,423
2	QAKP.Patos	1,001	48	274	1,227	226	-	-	1,001
3	Q.P.N Fier	247,977	4,300	117	243,794	261	(318)	403	243,449
4	UMN Kuçovë	33,462	7,396	9,530	35,596	8,489	745	270	26,092
5	QASHNG.Patos	64,842	129,812	104,727	39,756	21,000	30	483	18,243

Nr	Njësit vartëse	01.01.2021	Shtesa pakësime		31.12.2021	Deri 1vit	Deri3vit	Deri 5vit	Mbi 5vit
			D	K					
6	QEMNG.Patos	118	179	135	74	-	-	-	74
7	QFT.Patos	172,645	144,427	145,390	173,610	35,381	774	15,049	122,405
8	QPN.Kucove	248,776	1,685	1,050	248,142	40	-	-	248,101
9	QSHGJ.Patos	15,841	-	-	15,841	-	-	-	15,841
10	QPN.GORISHT	40,684	109,193	106,903	38,394	(15,240)	53,634	-	-
11	Administrata	6,317,018	1,211,172	861,665	5,967,510	31,695	(24,461)	4,949	5,955,327
	Totali	10,307,953	2,909,991	2,645,445	10,043,406	329,648	1,085,646	21,155	8,606,957

Nga të dhënat e pasqyrës sa më sipër konstatohet se detyrimet për furnitorët në vlerë e ka QFSHE Patos dhe administrata në vlerën 7,931,750 mijë lekë ose 79 % e furnitorëve gjithsej.

Sipas moshës së krijimit të detyrimeve për furnitorë konstatohet se në totalin e tyre mbi 5 vite janë në vlerën 8,606,957 mijë lekë ose 86 % në total.

Furnitorë të analizuar sipas subjekteve shtetërore dhe privat dhe sipas moshës, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Sipas subjekteve	01.01.2021	Shtesa pakësime		31.12.2021	Deri 1vit	Deri3vit	Deri 5vit	Mbi 5vit
			D	K					
1	A...O	6,312,329	-	-	6,312,329	-	-	-	6,312,329
2	Private	1,772,232	1,124,271	935,295	1,583,255	71,658	(15,219)	20,824	1,505,993
3	Shtetërore	248,758	350,895	249,641	147,504	10,204	(6,063)	331	143,032
4	O...E	1,974,634	1,434,826	1,460,509	2,000,317	247,786	1,106,928	-	645,604
	Totali	10,307,953	2,909,991	2,645,445	10,043,406	329,648	1,085,646	21,155	8,606,957

Titulli i gjetjes 7: Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real të gjendjes së “Llogari të pagueshme tregtare” në vlerën 10,043,406 mijë lekë në të cilat janë të përfshira dhe llogari kreditore të subjekteve të cilët kanë kaluar afatin më shumë se 10 vite.

Situata:

Nga auditimi u konstatua se “Llogari të pagueshme tregtare” (Furnitorët) me datë 31.12.2020 janë deklaruar në vlerën 10,307,953 mijë lekë dhe me datë 31.12.2021 janë deklaruar për vlerën 10,043,406 mijë lekë, (“A...O” sh.a në vlerën 6,312,329 mijë lekë, Subjekte Privatë në vlerën 1,583,255 mijë lekë, Subjekte Shtetërore në vlerën 147,504 mijë lekë dhe O...E në vlerën 2,000,317 mijë lekë), me paksim gjatë vitit 2021, në vlerën 264,547 mijë lekë (furnitor privat në vlerën 188,976 mijë lekë, furnitorë shtetërorë në vlerën 101,254 mijë lekë dhe furnitorë O...E në vlerën 25,930 mijë lekë), sipas moshës së detyrimeve për furnitorët i kemi, mbi 5 vite janë në vlerën 8,606,957 mijë lekë ose 86 % e furnitorëve në total. Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real të gjendjes së “Llogari të pagueshme tregtare” (Furnitorët) në vlerën **10,043,406 mijë lekë** në të cilat janë të përfshira dhe llogari kreditore të subjekteve të cilët kanë kaluar afatin më shumë se 10 vite. Aktualisht prej disa viteve ka kaluar afati i parashkrimit të detyrimeve, nuk ekziston asnjë kërkesë e subjekteve kreditore për shlyerje detyrimi dhe njëkohësisht është parashkruar afati për tu kërkuar në rrugë gjyqësore. Për më tepër qendrat nuk zotërojnë dokumentacionin provë për detyrimin e lindur. Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë vlerësuar risqet për pagesat e kreditorëve në afat për të shmangur kamatëvonesat apo penalitet të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 3, Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: germa “gj”, ku citohet: garantimin që të gjithë kreditorët të pagohen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesën nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t’ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, germa “gj”.

Ndikimi/Efekti: Mos pagesat e kreditorëve rëndojnë situatën financiare të Albpetrol.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

-Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të merren masat për të kryer pagesat e detyrimeve ndaj të tretëve në afatet e duhura, për të shmangur kamatëvonesat apo penalitetet të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë.

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 3, datë 20/04/2023, nga subjekti i audituar Albpetrol sh.a Patos. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Edhe “Llogaritë e pagueshme tregtare”, ashtu si dhe në rastin e “Llogarive të arkëtueshme tregtare” janë të mbartura nga periudhat paraardhëse. Detyrimet e prapambetura janë kryesisht ndaj subjekteve me të cilat kemi marrëdhënie të ndërsjellat debi-kredi si ish Armo dhe ish T...K. Detyrimet e pagueshme të periudhës koherente, janë detyrime ligjore të krijuara nga kontratat të ndryshme të blerjes së materialeve apo shërbimeve gjatë periudhës ushtrimore. Për këto detyrime shoqëria kryen pagesa sipas termave të kontratave.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet nga ana juaj theksojmë se konstatimi i grupit të auditimit ka të bëjë që përveç atyre detyrimeve që ju si shoqëri keni marrëdhënie të ndërsjellat debi-kredi të merren masa për likuidim të detyrimeve për ato të cilat i përkasin likuidimit të energjisë elektrike dhe furnitorëve privat dhe ato shtetore të periudhës korente pra të vitit të fundit, për shmangien e penaliteteve.

Zëri kontabël “Llogari të pagueshme të tjera”, në fund të periudhës në pasqyrën e pozicionit financiare, paraqitet në vlerën 3,620,187 mijë lekë (2020: 3,615,789 mijë lekë), e detajuar sipas qendrave pasqyra si më poshtë:

Nr	Emertimi	31.12.2021	01.01.2021
1	Paga personeli	64,195	100,867
2	Detyrime sigurime shoqërore dhe shëndetësore	23,598	26,210
3	Tatim fitimi	244,795	161,314
4	TVSh për tu paguar	12,031	52,626
5	Tatim mbi të ardhurat	12,737	8,548
6	Tatim në burim	421	687
7	Renta minerare	27,314	30,441
8	Gjoha dhe interesa të llogaritura	352,129	352,129
9	Divident për tu paguar	2,882,967	2,882,967
	Shuma	3,620,187	3,615,789

Nga analiza e të dhënave të pasqyrës sa më sipër u konstatua se: Shoqëria ka në detyrimet afatgjata vlerën **2,882,966,924 lekë** e cila përbën vlerën e dividendit të papaguar në llogarinë e ortakut të vetëm Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Pagesa e fundit është kryer në vitin 2017, e më pas nuk janë kryer më likuidime. Megjithatë shoqëria ka paraqitur pasqyra financiare me fitime ndër vite dhe ka vendosur për kalimin e tyre në Divident për tu paguar ndaj aksionarit kryesor, ritmet e pagesës së këtij detyrimi janë shumë të ulëta.

Të ardhurat e deklaruar në pasqyrat në fund të periudhës me datë 31.12.2021 janë për vlerën **5,676,396 mijë lekë** nga të cilat:

-Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit në vlerën 5,599,623 mijë lekë, ose 98.6% e totalit (nga shitja e naftës në vlerën 4,080,045 mijë lekë, nga shitja e gazit në vlerën 4,381 mijë lekë, nga shitja e energjisë në vlerën 1,508,482 mijë lekë dhe shërbime të tjera në vlerën 6,715 mijë lekë).

-Puna e kryer nga njësitë dhe që kapitalizohet në vlerën 26,722 mijë lekë ose 0.4% e totalit.

-Të ardhura të tjera në vlerën 50,051 mijë lekë, ose 1% e totalit.

Shpenzimet e deklaruar në pasqyrat në fund të periudhës me datë 31.12.2021 janë për vlerën **5,441,166 mijë lekë** nga të cilat:

-Lëndë të para dhe materiale të konsumueshme në vlerën 1,422,712 mijë lekë, ose 26% e totalit (shpenzime energji elektrike në vlerën 1,217,089 mijë lekë dhe shpenzime materiale në vlerën 205,623 mijë lekë).

-Ndryshim i gjendjes së inventarit e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces në vlerën 512,528 mijë lekë, ose 9.4% e totalit.

-Shpenzime personeli në vlerën 1,660,545 mijë lekë, ose 30.5% e totalit.

-Shpenzime konsumi dhe amortizimi në vlerën 424,959 mijë lekë ose 7.8% e totalit.

-Shpenzime të tjera të shfrytëzimit në vlerën 1,520,422 mijë lekë ose 28% e totalit.

Pagesat e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Financës rezultojnë se gjatë vitit 2021 janë bërë pagesa për detyrimet fiskale si më poshtë:

Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në vlerën 804,291,100 lekë,

Sigurime Shoq., Shëndet. dhe Tatim Ardhurat Personale (TAP) në vlerën 430,921,701 lekë.

Taksë mbi Rentën Minerare në vlerën 411,569,885 lekë.

Tatim në burim në vlerën 2,904,138 lekë.

Tatim mbi fitimin 41,108,257 lekë.

- Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.

Nga të dhënat rezultojnë se për kryerjen e inventarizimit fizik të llogarive inventariale të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, Administratori i shoqërisë ka nxjerrë Urdhër nr. 203, datë 21,09.2021 “Mbi inventarizimin e përgjithshëm të pasurisë për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, për vitin 2021”, ku në zbatim të këtij urdhri nga qendrat e shoqërisë kanë dalë urdhrat të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Qendrat	Urdhër	
		Nr prot	Datë
1	Administrata	203	21/09/2021
2	QPN Fier	1161	24/09/2021
3	QPN Kuçovë	99	1/10/2021
4	QASHNG	644	24/09/2021
5	QEMNG	952	11/10/2021
6	QMN Kuçovë	473/1	28/09/2021
7	QFSHE	393/1	05/10/2021
8	QAKP	534	4/10/2021
9	QPN Gorisht	852	11/10/2021
10	QSHGJ	370/1	30/9/2021
	QFT	914	5/10/2021

Nga të dhënat rezultojnë se urdhrat kanë dalë brenda afateve ligjore.

Me përfundimin e procesit të inventarizimit janë hartuar relacionet për gjendjen e inventarëve ku janë shprehur për tepricat dhe diferencat e konstatuara gjendjen e inventarëve që kanë rezultuar për jashtë përdorimit etj, të dhënat për përgatitjen e relacioneve jepen në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Qendrat	Urdhër	
		Nr prot	Datë
1	Administrata	2288	15/03/2022
2	QPN Fier	1554	13/12/2021

Nr	Qendrat	Urdhër	
		Nr prot	Datë
3	QPN Kuçovë	440/3	20/12/2021
4	QASHNG	848	25/11/2021
5	QEMNG	1110	23/11/2021
6	QMN Kuçovë	473/4	9/12/2021
7	QFSHE	393/3	29/10/2021
8	QAKP	793	1/12/2021
9	QPN Gorisht	13	7/01/2022
10	QSHGJ	370/7	15/12/21
11	QFT	203	14/02/2022

Nga auditimi rezulton se inventarëve janë pasqyruar në mbyllje të pasqyrave financiare për vitin 2021.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi nëpunësit autorizues dhe zbatues të shoqërisë, në detyrë përgjatë periudhës objekt i auditimit.

Titulli i gjetjes 8: Detyrime për fatura të palikujduara për të cilat janë llogaritur kamatëvonesa në vlerën 2,211,134 mijë lekë, vlerë e cila përbën efekt ekonomik financiar negativ për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Financës, ka rezultuar se shoqëria Albpetrol sh.a Patos, është furnizuar me energji elektrike nga shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” (FSHU) deri me datë 31.12.2021 ka detyrime për vlerën **2,000,317 mijë lekë**, për konsumatorët si më poshtë:

Nr.	Koncesionarët	Vlera
1	“B...S”	1,064,611 mijë lekë
2	“A...L&G...S”	122,901 mijë lekë
3	“T...A”	207,565 mijë lekë
4	“T...K”	26,607 mijë lekë
5	“D...S”	78 mijë lekë
6	“F...X”	544 mijë lekë
7	Detyrimet për fatura të palikujduara nga QFSHE	578,011 mijë lekë
	Totali	2.000.317 mijë lekë

Sa më sipër shoqëria Albpetrol sh.a Patos (QFSHE) ka lidhur kontratë nr. 5208/2 prot., datë 16.07.2018 për shitje energjie vetëm me shoqërinë “A....” nr. 9/1 prot., datë 16.07.20218, **ndërsa me subjektet e tjera nuk ka lidhur kontratë për shitje energjie.**

Për situatën sa më sipër, në vitin 2022 Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos., z. K. C. ka nxjerr Urdhrin nr. 204, datë 21.07.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e faturave të energjisë elektrike të palikujduara nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos”.

Me Akt-Rakordimin datë 03.10.2022, midis FSHU sh.a dhe shoqërisë Albpetrol sh.a Patos kanë rënë dakort për nënshkrimin e aktmarrëveshjes për pagesë me 24 këste të detyrimeve totale të energjisë elektrike që klienti Albpetrol sh.a Patos. ka ndajë shoqërisë “FSHU” sha, si më poshtë:

Principali në vlerën 1,995,797 mijë lekë,

Kamatëvonesë në vlerën 2,211,134 mijë lekë,

Detyrimi total në vlerën 4,206,930 mijë lekë.

Principali në vlerën **1,995,797 mijë lekë**, janë fatura të palikujduara nga Koncesionarët si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Koncesionare	Vlera
1	“B...S”	587,046 mijë lekë
2	“A...L&G...S”	128,728 mijë lekë
3	“T...A”	238,798mijë lekë
4	“T...K”	26,607 mijë lekë
5	“D...S”	68 mijë lekë
6	“F...X”	(135) mijë lekë
7	Detyrimet për fatura të palikujduara nga QFSHE	491,181 mijë lekë
8	Energji e blerë dhe e pa faturuar, si rezultat i mosmiratimit të çmimit për muajt shtator tetor 2022	523,502 mijë lekë
	Totali	1,995,797 mijë lekë

Energjia e blerë dhe e pa faturuar në vlerën **523,502 mijë lekë** i përket konsumatorëve si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Koncesionare	Vlera
1	“B...S”	364,275
2	“A...L&G...S”	19,169
3	“T...A”	64,877
4	“F...X”	48
	Shuma	448,369
	<i>Privatë</i>	<i>2,056</i>
	Energji e blerë dhe e pa faturuar për vetë shoqërinë	73,077
	Totali	523,502

Sa më sipër rezulton se për energjinë e blerë dhe të pa faturuar u konstatua se nga Administratori i shoqërisë nuk është nxjerr urdhër për miratimin e çmimit të energjisë për muajt shtatorë e në vazhdim, në zbatim me vendimit nr. 11, datë 16.05.2022 të Këshillit Mbikëqyrës, me qëllim faturimin e energjisë elektrike për konsumatorët fundorë (koncesionarët dhe subjekte privat). Rezulton se sipas aktrakordimet deri me datë 03.11.2022 janë llogaritur kamatëvonesa për fatura të palikujduara **në vlerën 2,211,134 mijë lekë, vlerë e cila përbën efekt ekonomik financiar negativ për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.**

Situata:

Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se detyrimet e koncesionarëve ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për energjinë e shitur/faturuar me dhe pa kontrata janë në shumën 1,429,616 mijë lekë, nga e cila kamatëvonesë për mos pagim në afat për vlerë 1,583,865 mijë lekë. Nga ana e sajë shoqëria Albpetrol sh.a Patos, ka vijuar me pagesat sipas aktmarrëveshjes datë 03.10.2022, midis FSHU sh.a dhe shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për pagesë me 24 këste të detyrimeve, duke paguar në mënyrë të padrejtë dhe për detyrimet e koncesionarëve. Gjithashtu, shoqëria Albpetrol sh.a Patos, nga ana e sajë nuk ka marrë asnjë masë shtrëngues për arkëtimin e detyrimeve të energjisë elektrike të konsumuar nga shoqëritë koncesionarëve.

Ky veprim përbën risk të lartë për shoqërinë “ALBPETOL” sha me efekt financiar me dëm në shumën 3,013,481 mijë lekë së bashku me kamatëvonesat, pasi në rast falimentimi ose largimi të ndonjë prej shoqërive koncesionare detyrimet për energjisë mbesin për likuidim shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, gjë e cila bëhet akoma dhe më e vështirë për ato shoqëri koncesionare që nuk kanë kontratë shitje energjie për të kërkuar në gjykatë detyrimet.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi: z. F. M dhe z. K. C. ish Administratorët e shoqërisë për periudhën objekt auditimi që nuk kanë marrë masat e duhura për pagesat e faturave në afat.

Kriteri:

Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 3, Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: germa “gj”, ku citohet: garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesën nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t’ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues, si dhe neni 10 i kontratës me OSHEE për jo familjar, kamatëvonesa për pagesë të vonuar, ku citohet: “Pas kalimit të afatit të pagesës caktuar në nenin 9.1, Klienti është i detyruar të paguajë një kamatë vonesë të barabartë me 0.1 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.”

Ndikimi/Efekti: Mos pagesat faturave të energjisë në afat janë llogaritur kamatëvonesa në vlerën 2,211,134 mijë lekë, vlerë e cila përbën efekt ekonomik financiar negativ për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.

Shkaku: Mos vlerësim i situatës sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i Shoqërisë të njoftoj Këshillin Mbikëqyrës dhe të nxjerrë përgjegjësitë për detyrimet e koncesionarëve ndajë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për energjinë e shitur/faturuar me dhe pa kontrata dhe të ndjek të gjithë rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,013,481 mijë lekë** (principlial në vlerën 1,429,616 mijë lekë dhe kamatëvonesë në vlerën 1,583,865 mijë lekë).

Titulli i gjetjes 9: Shoqëria Albpetrol sh.a Patos. për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2022, ka blerë energji elektrike e cila nuk është deklaruar si shitje për konsumatorët fundorë.

Situata:

Nga auditimi ka rezultuar se shoqëria Albpetrol sh.a Patos. për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2022, ka blerë energji elektrike me TVSH në vlerën 863,819,525 lekë, me TVSh të zbritshëm në shumën 143,969,921 lekë, të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Muaj	Vlera pa TVSH	TVSH	Vlera me TVSH
1	Shtator	168,186,844	33,637,369	201,824,213
2	Tetor	181,130,417	36,226,083	217,356,500
3	Nëntor	182,289,514	36,457,903	218,747,417
4	Dhjetor	188,242,829	37,648,566	225,891,395
	Totali	719,849,604	143,969,921	863,819,525

Rezulton se kjo sasi e energjisë elektrike nuk është faturuar për konsumatorët fundor **shoqëritë koncesionare**, privatë dhe qendrat e vetë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Në deklaratimet mujore të TVSH, rezulton se kjo sasi është deklaruar si TVSH e zbritshëm, gjë e cila çon që situata e TVSH në shitje në muajt përkatës **nuk është reale** për pasojë vlera e TVSH së pagueshme nuk është e saktë, **pasi nga shoqëria nuk është deklaruar TVSh e shitje së energjisë së këtyre muajve në adresë të koncesionarët.**

Nga të dhënat e FDP-ve për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2022, shitjet e tatueshme janë deklaruar në vlerën 3,625,810,585 lekë me TVSH të llogaritur në vlerën 681,690,817 lekë kur në fakt shitje të tatueshme duhej të deklaroheshin në vlerën 4,489,630,110 lekë, me TVSH të llogaritur në vlerën 825,660,768 lekë, të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Muajt	Deklaruar ne FDP, shitje të tatueshme		Duhej deklaruar FDP, shitje të tatueshme		Diferenca shitje të tatueshme	
		Vlera me TVSH	TVSH	Vlera me TVSH	TVSH	Vlera me TVSH	TVSH
1	Shtator	1,206,966,727	241,393,345	1,408,790,940	275,030,714	201,824,213	33,637,369
2	Tetor	710,892,054	98,707,111	928,248,554	134,933,194	217,356,500	36,226,083
3	Nëntor	1,246,228,835	249,245,767	1,464,976,252	285,703,700	218,747,417	36,457,903
4	Dhjetor	461,722,969	92,344,594	687,614,364	129,993,160	225,891,395	37,648,566
	Totali	3,625,810,585	681,690,817	4,489,630,110	825,660,768	863,819,525	143,969,921

Sa më sipër rezulton se nuk janë deklaruar të ardhura nga shitje të energjisë elektrike për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2022, minimalisht llogaritur sipas çmimit të blerjes në vlerën **863,819,525 lekë** me TVSH, me TVSH të llogaritur në vlerën **143,969,921 lekë**, **veprime të cilat çojnë në deformim të situatës për TVSH e zbritshëm dhe TVSH së pagueshme.**

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, neni 97 “Lëshimi i faturave”, pika 1. Personi i tatueshëm duhet të sigurohet për lëshimin e faturës nga ai vetë ose nga blerësi i tij ose në emrin e tij dhe për llogari të tij nga të tretët, në rastet e mëposhtme, germa “a” për çdo furnizim malli ose shërbimi që kryen kundrejt një personi tjetër të tatueshëm ose një personi juridik të patatueshëm.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi nëpunësit autorizues z.K. C. dhe z.E.D, në detyrë përgjatë periudhës objekt i auditimit.

Kriteri:

Ligji nr 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, neni 97 “Lëshimi i faturave”, pika 1. Personi i tatueshëm duhet të sigurohet për lëshimin e faturës nga ai vetë ose nga blerësi i tij ose në emrin e tij dhe për llogari të tij nga të tretët, në rastet e mëposhtme, germa “a” për çdo furnizim malli ose shërbimi që kryen kundrejt një personi tjetër të tatueshëm ose një personi juridik të patatueshëm.

Ndikimi/Efekti:

Mos deklarimi i shitjeve ndikon në TVSH e pagueshme, për të cilët llogariten penalitete.

Shkaku: Mos zbatim i kërkesave të ligjit për TVSH.

-Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë si Nëpunësi Autorizues të merren masat për faturimin e energjisë së blerë dhe të përdorur nga konsumatorët fundor për të shmangur penalitete që lindin nga mos deklarimi i shitjeve, të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë.

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 4, datë 20/04/2023, nga subjekti i audituar Albpetrol sh.a Patos. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Nga ana e Drejtorisë së Financës është ngritur shqetësim i mos faturimit të Energjisë Elektrike dhe moslikuidimit nga ana e kontraktorëve dhe ne çdo tremujor nga ana e drejtorisë sonë është dërguar informacion për Drejtorinë e Marrëveshjes Hidrokarbure e cila ka lidhje direkt me kontraktorët. Menjëherë me ardhjen e miratimit nga ERE kemi zbardhur vendimin për faturimin e çmimit për të gjithë konsumatorët e energjisë. Efekti i këtij mos faturimi në kohë do të bëhet në të ardhurat e vitit 2022 duke qenë se jemi në periudhë auditimi të pasqyrave financiare nga Ekspertët auditues të miratuar nga MIE dhe është i pa mbyllur bilanci i vitit 2022.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet nga ana juaj theksojmë se konstatimi i grupit të auditimit ka të bëjë se nuk janë deklaruar të ardhura nga shitje të energjisë elektrike për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2022, duke deformuar situatën e pagesës së TVSH, për sa observoni nuk merret në konsideratë.

Pika 2.5 e programit. Mbi zbatimimin e ligjshmërisë për inventarizimin, regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, dhënien dhe marrjen me qira të aseteve dhe zbatimimi i kontratave të qirasë

Titulli i gjetjes 1: Pasuritë e dhëna me qira dhe zbatimimi i kontratave të qirasë.

Situata:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë Nr.6245, datë 01.09.2021 i lidhur me subjektin “K...I” sh.p.k. u konstatua se në dosje nuk ka procesverbal të dorëzimit të objektit të dhënë me qira, si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës, si dhe për arkëtimin e të ardhurave, gjithashtu në dosje ndodhet dhe një procesverbal ku është konstatuar që subjekti përdor 53.184 m² sipërfaqe ndërtimi më shumë se sa kontrata, dhe 4610.816 m² sipërfaqe funksionale më shumë se sa kontrata dhe duhet të bëhet arkëtimi i detyrimit mujor 142,186 lekë.

Nga auditimi i kontratës së qirasë Nr.9030, datë 12.11.2021 i lidhur me subjektin “B...M” shpk, dhe kontratës së qirasë Nr.9030, datë 12.11.2021 i lidhur me subjektin “G...D” sh.p.k. me objekt kontrate “ish-Remonti Kapital në ish-QPN Marinëz” në administrim nga QAKP Patos, janë dy kontrata qiraje me të njëjtin numër protokoll, por me dy subjekte të ndryshme, në dosje nuk ka procesverbal të dorëzimit të objektit të dhënë me qira, si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës, si dhe për arkëtimin e të ardhurave, gjithashtu në dosje ndodhet dhe një procesverbal nga 4 punonjës të Albpetrol sh.a Patos. ku është konstatuar që subjekti “B...M” sh.p.k. përdor 2466.89 m² sipërfaqe funksionale më shumë se sa kontrata dhe duhet arkëtuar detyrimi mujor 69,073 lekë nga subjekti, si dhe të përcaktohet periudha që është përdorur objekti padrejtësisht nga subjekti. Për të njëjtin objekt janë dy kontrata qiraje me të njëjtin numër protokoll, por me dy subjekte të ndryshme, nuk ka proces verbal të dorëzimit të objektit si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1 dhe pikën 7 të nenit 5 të Kontratës së Qirasë.

Kontratë qiraje me nr.671 prot , datë 24.01.2022 ndërmjet qiradhënësit “Albpetrol “ sh.a dhe qiramarrësit Z. A. M. , për dhënien me qira të objektit “*Ish guzhina Vllahinë*” me sipërfaqe 48 m², në administrim të Qendrës Prodhimit të Naftës Gorisht. Çmimi i kontratës nr.671 prot , datë 24.01.2022 është llogaritur në përputhje me pika 5 të kreut III te VKM nr.54, datë 05/02/2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar (48m² x 75 lekë/m² = 3600 lekë /muaj pa t.v.sh). Në shumën prej 3600 lekë/muaj nuk është e përfshirë konsumi i energjisë elektrike dhe ujit nga qiramarrësi. Subjekti A. M. në rolin e qiramarrësit objektin me sipërfaqe 48 m² do e përdor për ushtrim aktiviteti privat (Bar – kafe). Në nenin 2 të kontratës nr.671 prot, datë 24.01.2022 nuk është përcaktuar kohëzgjatja e kontratës të nënshkruar nga palët Albpetrol sh.a Patos dhe subjektit A. M. , në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05/02/2014 gërma “a”, pika 5, kreu I në të cilën citohet “*dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m² të jepen me afat deri në 1 vit*”.

Kontratë qiraje me nr.1132 prot, datë 04.02.2022 ndërmjet qiradhënësit Albpetrol sh.a Patos dhe qiramarrësit dhe shoqërisë “A...6” shpk, për dhënien me qira të makinerisë “Vinç Cjap 5 Ton”. Çmimi i kontratës nr.1132 prot, datë 04.02.2022 është llogaritur në përputhje me kreun III, pika 5 e VKM nr.54, datë 05/02/2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira , enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Makineria “ Vinç Cjap 5 Ton “ është dhënë me qira shoqërisë “A...6” shpk , mbështetur në kreu I, pika 5, gërma b të VKM nr.54 , datë 05/02/2014 ku citohet: “*makineritë dhe pajisjet e shkëputura jepen me qira për një afat 1 vjeçar*”. Kontrata nr.1132 prot , datë 04.02.2022 është nënshkruar më 04.02.2022 , por në nenin 2 të saj nuk është përcaktuar afati i skadimit të saj. Makineria “Vinç Cjap 5 Ton” është në administrim të Q.F.T Patos dhe nuk është e nevojshme për ushtrimin e aktivitetin e kësaj qendre , per pasojë është dhënë në gëzim të përkohshëm shoqërisë “A...6 “ shpk me çmimin e përcaktuar në nenin 3 të kontratës nr.1773 prot , datë 24.02.2022. Për makineritë dhe pajisjet vlera e detyrimit mujor të qirasë përcaktohet sa 1/10 e vlerës aktuale minimale të llogaritur si diferencë e vlerës

fillestare të kontabilizuar minus amortizimin në vite, mbështetur në Vendimin nr. 401 , datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave (pjesa për investime) shumëzuar me indeksin e çmimeve të muajit përkatës publikuar nga INSTAT-i . Në pikën 2 të nenit 3 të kontratës cilësohet se detyrimi mujor i qiramarrësit “A...6 “ sh.p.k është në vlerën 2000 lekë.

Kriteri:

VKM 54, datë 5.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Ndikimi/efekti:

Veprimet në kundërshtim me VKM kanë sjellë pagesa jo të rregullta nga qiramarrësit si edhe kalimin e tyre në debitor ndaj shoqërisë. Gjithashtu nga veprimet dhe mos veprimet nga personat përgjegjës kanë paraqitur një përkushtim të dobët në drejtim të përfitimit që mund të realizonte Shoqëria nga një punë më efikase për lëshimin e objekteve të lira me qira, për të rritur të ardhurat si edhe mungon një plan i detajuar për përmirësimin e punës në këtë drejtim, sidomos në drejtim të marketingut në faqen zyrtare online të Shoqërisë.

Shkaku: Mos respektimi i legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: I Lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtorja Juridike, Drejtorja e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës të merren masa që në të ardhmen për secilën kontratë qiraje të zbatohen të gjitha etapat e përshkruara shumë qartë në kuadrin ligjor, për lidhjen dhe zbatimin e tyre.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtorja Juridike, Drejtorja e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës dhe nga Drejtorja e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik të ndërmerret një plan konkret masash për rritjen e efikasitetit për lëshimin e objekteve me qira, veçanërisht në fushën e marketingut të shoqërisë.

<u>Titulli i Gjetjes 2:</u> <i>Pronat e zëna nga posedues të paligjshëm dhe pronat me mbivendosje.</i>

Situata:

Drejtorja e Administrimit dhe Ruajtjes Pronave, në bashkëpunim me Qendrat e Shoqërisë dhe me ZVRPP-të e rretheve, ka të listuar dhe të përditësuara të gjitha pronat e zëna nga posedues të paligjshëm si dhe pronat me mbivendosje. Këto prona janë zënë gjatë një periudhe të gjatë përpara periudhës së auditimit dhe megjithëse dhe nga grupet e mëparshme të KLSH-së është rekomanduar që të ndërmerren hapa ligjorë për këtë problematik, nga ana e Albpetrol sh.a Patos ende nuk është marrë një veprim i tillë.

Administratori i shoqërisë i kërkon të gjitha Qendrave që në rast të konstatimit të poseduesve të paligjshëm në asetet e shoqërisë duhet ti kallëzojnë ato pranë organeve ligj zbatuese. Ky urdhër ka mbetur thjesht si një procedurë burokratike pasi ende nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret që këto objekte apo pasuri truall të zaptuara, apo sipërfaqe të Shoqërisë me mbivendosje në ZVRPP të rikthehen e gëzohen në përdorim e pronësi të Shoqërisë.

Nga auditimi u konstatua se dhënia me qira e objekteve, në përgjithësi nuk inicohet sipas rregullave të vendosura dhe disiplinuar në VKM 54, datë 5.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Shoqëria nuk ka ndjekur procedura ligjore komunikimi me publikun dhe i mungon informacioni online për publikun në faqen e saj mbi objektet që ajo është e interesuar të lëshojë me qira, pasi Albpetrol ka shumë objekte të tilla që nuk kryejnë asnjë funksion por që administrohen nga qendrat e saj. Zakonisht procedimi i dhënies me qira kryhet nëpërmjet të interesuarve që bëjnë konstatim fizik mbi objektet jashtë funksioni në pronësi të Shoqërisë Albpetrol.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka të dokumentuara 3,500 puse nga të cilat ka 160 puse me vërtetime hipotekore dhe 3,340 puse me certifikate pronësie që do të thotë se ende 4,5% e kësaj lloji prone nuk zotërohet e regjistruar me certifikate pronësie.

Objektet e dokumentuara në ZRPP vendore gjithsej 454 objekte, nga të cilat 25 janë me vërtetim hipotekor ndërsa 429 janë të dokumentuara me certifikate pronësie.

Pra, janë regjistruar gjithsej 3,954 pasuri, puse dhe objekte të shoqërisë nga të cilat 185 pasuri janë me vërtetim hipotekor dhe 3,769 pasuri të shoqërisë janë me certifikate pronësie të rregullta. Pronat e regjistruara me vërtetim hipotekor zënë rreth 4,7% të pronave të regjistruara me certifikate pronësie.

Konstatohet se janë të pa regjistruara në ZVRPP vendore përkatëse 1,776 puse dhe 21 objekte të Shoqërisë ose në total 1,797 pasuri të shoqërisë janë të paregjistruara. Nëse analizojmë tabelën më sipër, numri i pasurive të patundshme të shoqërisë është gjithsej 5,751 pasuri. Numri i pronave të paregjistruara zë një peshë prej 31,2%. Nëse do të llogarisim edhe 4,7% të pronave që janë regjistruar me vërtetim hipotekor, pasuritë pa dokumentin ligjor të vërtetimit të pronësisë, certifikatën e pronësisë, shkon 39% e numrit total të pronave. Ky është një numër shumë i lartë i pronave të paregjistruara dhe tregon edhe për një punë të dobët prej gjithë stafëve drejtuese të Shoqërisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës dhe në linjë vertikale kjo mangësi shkon deri tek stafet e Ministrisë së linjës e cila duhet të kishte bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të shmangur të gjitha mangësitë subjektive dhe burokracitë e ZVRPP-ve. Drejtuesit dhe personat përgjegjës për certifikimin e pasurive të Shoqërisë *Albpetrol sha* duket se kanë vepruar në mënyrë burokratike dhe janë mjaftuar vetëm me përgatitje shkresash apo aplikime në ZVRPP-të përkatëse dhe nuk e kanë ndjekur këtë çështje të rëndësishme në mënyrë këmbëngulëse.

Kriteri:

Udhëzimin 30 datë 27/12/2011 neni 29/b dhe neni 31 si edhe në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Ndikimi/Efekti:

Veprimet dhe mosveprimet në përputhje me ligjin kanë ulur seriozitetin dhe vlerën e Shoqërisë dhe e kanë lënë atë të papërgatitur për të maksimizuar fitimet në rast të privatizimit të sektorëve ose pasurive të veçanta të saj.

Shkaku:

Mos respektimi i legjisllacionit në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës të ndërmerren hapa konkretë për këtë problematikë duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në bashkëpunim me organet kompetente ligj zbatuese për marrjen në dorëzim të pronave të ligjshme të shoqërisë.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë të ndërmerren hapa konkretë për këtë problematikë pasi numri i aseteve të Shoqërisë të pa regjistruara është relativisht i lartë. Regjistrimi dhe certifikimi i tyre sa më shpejtë ndikon në mënyrë direkte në rritjen e vlerës së Shoqërisë.

Për sa më sipër është dërguar observacioni me nr. 11/179 prot., datë 19.06.2023 nga E. D. nga ana e të cilit pretendohet se:

Pretendimi i subjektit:

Së pari ju risjell në vëmendje se unë kam filluar ushtrimin e detyrës...për ndjekjen e procedurave ligjore nga strukturat përgjegjëse...dhe pajisjen me certifikatë pronësie të çdo pasurie të saj...

Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH - së:

Lidhur me pretendimin e tuaj dhe urdhërit nr. 89, datë 11.04.2023, “për ngritjen e strukturës së posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme të shoqërisë “Albpetrol” sh.a dhe pajisjen me certifikatë pronësie të çdo pasurie të saj”. Referuar urdhrit të paraqitur observacioni do të merret në konsideratë dhe do të auditohet në auditimin e ardhshëm mbi ecurinë e kësaj praktike.

Për sa më sipër është dërguar observacioni me nr. 11/149 prot., datë 15.06.2023 nga z. D.SH nga ana e të cilit pretendohet se:

Pretendim i subjektit:

Drejtoria e Kontrollit dhe Administrimit të Pronave, ka kërkuar informacion nga qëndrat në varësi...në kontratën e lidhur me subjektin "A...6" nuk është përcaktuar afati i skadimit të saj....nuk furnizohet me energji elektrike apo ujë nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos....për sa i përket objekteve të lira Drejtoria e Kontrollit dhe Administrimit të Pronave....për afishim dhe publikim në faqën zyrtare të shoqërisë....

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa observohet nga ana juaj theksojmë se ju i referoheni dokumentacionit i cili është audituar nga grupi i auditimit dhe ka dalur në konkluzionet e paraqitura, pra ju nuk keni paraqitur dokumentacion shtesë dhe për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë Nr.6245, datë 01.09.2021 i lidhur me subjektin "K...I" sh.p.k. u konstatua se në dosje nuk ka procesverbal të dorëzimit të objektit të dhënë me qira, si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës, si dhe për arkëtimin e të ardhurave, gjithashtu në dosje ndodhet dhe një procesverbal ku është konstatuar që subjekti përdor 53.184 m² sipërfaqe ndërtimi më shumë se sa kontrata, dhe 4610.816 m² sipërfaqe funksionale më shumë se sa kontrata dhe duhet të bëhet arkëtimi i detyrimit mujor 142,186 lekë.

Nga auditimi i kontratës së qirasë Nr.9030, datë 12.11.2021 i lidhur me subjektin "B...M" shpk, dhe kontratës së qirasë Nr.9030, datë 12.11.2021 i lidhur me subjektin "G...D" sh.p.k. me objekt kontrate "ish-Remonti Kapital në ish-QPN Marinëz" në administrim nga QAKP Patos, janë dy kontrata qiraje me të njëjtin numër protokoll, por me dy subjekte të ndryshme, në dosje nuk ka procesverbal të dorëzimit të objektit të dhënë me qira, si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës, si dhe për arkëtimin e të ardhurave, gjithashtu në dosje ndodhet dhe një procesverbal nga 4 punonjës të Albpetrol sh.a Patos. ku është konstatuar që subjekti "B...M" sh.p.k. përdor 2466.89 m² sipërfaqe funksionale më shumë se sa kontrata dhe duhet arkëtuar detyrimi mujor 69,073 lekë nga subjekti, si dhe të përcaktohet periudha që është përdorur objekti padrejhtësisht nga subjekti. Për të njëjtin objekt janë dy kontrata qiraje me të njëjtin numër protokoll, por me dy subjekte të ndryshme, nuk ka proces verbal të dorëzimit të objektit si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1 dhe pikën 7 të nenit 5 të Kontratës së Qirasë.

Kontratë qiraje me nr.671 prot, datë 24.01.2022 ndërmjet qiradhënësit "Albpetrol" sh.a dhe qiramarrësit Z. A. M., për dhënien me qira të objektit "Ish guzhina Vllahinë" me sipërfaqe 48 m², në administrim të Qendrës Prodhimit të Naftës Gorisht. Çmimi i kontratës nr.671 prot , datë 24.01.2022 është llogaritur në përputhje me pika 5 të kreut III te VKM nr.54, datë 05/02/2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies më qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar (48m² x 75 lekë/m² = 3600 lekë /muaj pa t.v.sh). Në shumën prej 3600 lekë/muaj nuk është e përfshirë konsumi i energjisë elektrike dhe ujit nga qiramarrësi. Subjekti A. M. në rolin e qiramarrësit objektin me sipërfaqe 48 m² do e përdor për ushtrim aktiviteti privat (Bar – kafe). Në nenin 2 të kontratës nr.671 prot, datë 24.01.2022 nuk është përcaktuar kohëzgjatja e kontratës të nënshkruar nga palët Albpetrol sh.a Patos dhe subjektit A. M. , në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05/02/2014 gërma "a", pika 5, kreu I në të cilën citohet "dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m² të jepen me afat deri në 1 vit".

Kontratë qiraje me nr.1132 prot, datë 04.02.2022 ndërmjet qiradhënësit Albpetrol sh.a Patos dhe qiramarrësit dhe shoqërisë "A...6" shpk, për dhënien me qira të makinerisë "Vinç Cjap 5 Ton". Çmimi i kontratës nr.1132 prot, datë 04.02.2022 është llogaritur në përputhje me kreun III, pika 5

e VKM nr.54, datë 05/02/2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira , enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Makineria “ Vinç Cjap 5 Ton “ është dhënë me qira shoqërisë “A...6” shpk , mbështetur në kreu I, pika 5, gërma b të VKM nr.54 , datë 05/02/2014 ku citohet: “*makineritë dhe pajisjet e shkëputura jepen me qira për një afat 1 vjeçar*”. Kontrata nr.1132 prot , datë 04.02.2022 është nënshkruar më 04.02.2022 , por në nenin 2 të saj nuk është përcaktuar afati i skadimit të saj. Makineria “Vinç Cjap 5 Ton” është në administrim të Q.F.T Patos dhe nuk është e nevojshme për ushtrimin e aktivitetin e kësaj qendre , per pasojë është dhënë në gëzim të përkohshëm shoqërisë “A...6 “ shpk me çmimin e përcaktuar në nenin 3 të kontratës nr.1773 prot , datë 24.02.2022. Për makineritë dhe pajisjet vlera e detyrimit mujor të qirasë përcaktohet sa 1/10 e vlerës aktuale minimale të llogaritur si diferencë e vlerës fillestare të kontabilizuar minus amortizimin në vite, mbështetur në Vendimin nr. 401 , datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave (pjesa për investime) shumëzuar me indeksin e çmimeve të muajit përkatës publikuar nga INSTAT-i . Në pikën 2 të nenit 3 të kontratës cilësohet se detyrimi mujor i qiramarrësit “A...6 “ sh.p.k është në vlerën 2000 lekë.

Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes Pronave, në bashkëpunim me Qendrat e Shoqërisë dhe me ZVRPP-të e rretheve, ka të listuar dhe të përditësuara të gjitha pronat e zëna nga posedues të paligjshëm si dhe pronat me mbivendosje. Këto prona janë zënë gjatë një periudhe të gjatë përpara periudhës së auditimit dhe megjithëse dhe nga grupet e mëparshme të KLSH-së është rekomanduar që të ndërmerren hapa ligjorë për këtë problematik, nga ana e Albpetrol sh.a Patos ende nuk është marrë një veprim i tillë.

Administratori i shoqërisë i kërkon të gjitha Qendrave që në rast të konstatimit të poseduesve të paligjshëm në asetet e shoqërisë duhet ti kallëzojnë ato pranë organeve ligj zbatuese. Ky urdhër ka mbetur thjesht si një procedurë burokratike pasi ende nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret që këto objekte apo pasuri truall të zaptuara, apo sipërfaqe të Shoqërisë me mbivendosje në ZVRPP të rikthehen e gëzohen në përdorim e pronësi të Shoqërisë.

Nga auditimi u konstatua se dhënia me qira e objekteve, në përgjithësi nuk iniciohet sipas rregullave të vendosura dhe disiplinuar në VKM 54, datë 5.02.2014, “*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”. Shoqëria nuk ka ndjekur procedura ligjore komunikimi me publikun dhe i mungon informacioni online për publikun në faqen e saj mbi objektet që ajo është e interesuar të lëshojë me qira, pasi Albpetrol ka shumë objekte të tilla që nuk kryejnë asnjë funksion por që administrohen nga qendrat e saj. Zakonisht procedimi i dhënies me qira kryhet nëpërmjet të interesuarve që bëjnë konstatim fizik mbi objektet jashtë funksioni në pronësi të Shoqërisë Albpetrol.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka të dokumentuara 3,500 puse nga të cilat ka 160 puse me vërtetime hipotekore dhe 3,340 puse me certifikate pronësie që do të thotë se ende 4,5% e kësaj lloji prone nuk zotërohet e regjistruar me certifikate pronësie.

Objektet e dokumentuara në ZRPP vendore gjithsej 454 objekte, nga të cilat 25 janë me vërtetim hipotekor ndërsa 429 janë të dokumentuara me certifikate pronësie.

Pra, janë regjistruar gjithsej 3,954 pasuri, puse dhe objekte të shoqërisë nga të cilat 185 pasuri janë me vërtetim hipotekor dhe 3,769 pasuri të shoqërisë janë me certifikate pronësie të rregullta. Pronat e regjistruara me vërtetim hipotekor zënë rreth 4,7% të pronave të regjistruara me certifikate pronësie.

Konstatohet se janë të pa regjistruara në ZVRPP vendore përkatëse 1,776 puse dhe 21 objekte të Shoqërisë ose në total 1,797 pasuri të shoqërisë janë të paregjistruara. Nëse analizojmë tabelën më sipër, numri i pasurive të patundshme të shoqërisë është gjithsej 5,751 pasuri. Numri i pronave të paregjistruara zë një peshë prej 31,2%. Nëse do të llogarisim edhe 4,7% të pronave që janë regjistruar me vërtetim hipotekor, pasuritë pa dokumentin ligjor të vërtetimit të pronësisë, certifikatën e pronësisë, shkon 39% e numrit total të pronave. Ky është një numër shumë i lartë i pronave të paregjistruara dhe tregon edhe për një punë të dobët prej gjithë stafëve drejtuese të

Shoqërisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës dhe në linjë vertikale kjo mangësi shkon deri tek stafet e Ministrisë së linjës e cila duhet të kishte bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të shmangur të gjitha mangësitë subjektive dhe burokracitë e ZVRPP-ve. Drejtuesit dhe personat përgjegjës për certifikimin e pasurive të Shoqërisë *Albpetrol sha* duket se kanë vepruar në mënyrë burokratike dhe janë mjaftuar vetëm me përgatitje shkresash apo aplikime në ZVRPP-të përkatëse dhe nuk e kanë ndjekur këtë çështje të rëndësishme në mënyrë këmbëngulëse. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me *Nenin 158/dh i Ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”*, i ndryshuar.

Ngarkohet më përgjegjësi Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, veprime në kundërshtim me *Udhëzimin 30 datë 27/12/2011 neni 29/b dhe neni 31* si edhe në *Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos*.

Pika 2.6 e programit. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në veprimet e arkës dhe bankës, si dhe blerjet me vlera të vogla.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti audituar, ka rezultuar se shoqëria *Albpetrol sh.a Patos*, për periudhën objekt auditimi për likuidim të mallrave dhe shërbimeve ka operuar me 2 baka të nivelit të dytë “R...N” dhe “C...S”. Për vitin 2021 dhe 2022, nuk ka veprime me arkë.

Për periudhën objekt auditimi shoqëria *Albpetrol sh.a Patos*, ka realizuar blerje shërbimesh dhe mallrash të dhënat në pasqyrën Aneks 6/1 bashkëlidhur.

Gjatë vitit 2021, janë zhvilluar 22 procedura me vlera të vogla me fond limit pa TVSH në vlerën 12,477,574 lekë me TVSH në vlerën 14,973,088 lekë janë lidhur kontrata me vlerë 12,014,974 lekë pa TVSH dhe me TVSH në vlerën 14,417,968 lekë ose 98% e fondit limit, nga të cilat janë likuiduar në vlerën 13,313,313 lekë, ose 92% e vlerës së kontratës.

Gjatë vitit 2022, janë zhvilluar 20 procedura me vlera të vogla me fond limit pa TVSH në vlerën 12,176,622 lekë dhe me TVSH në vlerën 14,611,946 lekë janë lidhur kontrata me vlerë 10,466,160 lekë pa TVSH dhe me TVSH në vlerën 12,559,392 lekë ose 86% e fondit limit, nga të cilat janë likuiduar në vlerën 7,853,595 lekë, ose 62% e vlerës së kontratës, të dhënat në pasqyrën Aneks 6/2 bashkëlidhur.

Nga auditimi në lidhje me likuidimet nëpërmjet bankës rezultoi se në përgjithësi përpilimi i Urdhër transfertës, ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si, Kontratë, kërkesë për likuidim nga qendra përkatëse, fatura e furnitorit shkresë për likuidim nga Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik, shkresë për marrjen në dorëzim të mallrave fletëhyrje etj. Vlerat e shënuara në Urdhër transfertës përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këto shpenzime.

Pika 2.7 e programit. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimeve dhe zbatimin e kontratave, si dhe efektiviteti i investimeve.

Titulli gjetjes 1: *Mos planifikim i saktë i procedurave dhe realizmi tyre.*

Situata:

- Referuar të dhënave të Drejtorisë së Procedurave për vitin 2021 janë parashikuar gjithsej 95 procedura me vlerë të lartë me fond limit 1,548,142 mijë lekë dhe 47 procedura me vlerë të vogël me vlerë 20,823 mijë lekë, nga të cilat: janë realizuar 43 procedura me vlerë të lartë dhe fond limit 562,818 mijë lekë ose 36.3% e fondit të parashikuar. Ndërsa në procedura me vlerë të vogël janë realizuar 25 procedura me fond limit 13,914 mijë lekë ose 65% e fondit të planifikuar.

Për vitin 2021 janë shtuar procedura me vlerë të lartë të paparashikuara në fillim të periudhës gjithsej 15 procedura me fond limit 22,108 mijë lekë.

Nga të dhënat e mësipërme evidentohet fakti se 53 procedura me vlerë të lartë dhe fond limit 985,324 mijë lekë nuk janë realizuar dhe 22 procedura me vlerë të vogël me fond limit 6,908 mijë lekë.

- Referuar të dhënave të Drejtorisë së Procedurave për **vitin 2022** janë parashikuar gjithsej 99 procedura me vlerë të lartë me fond limit 1,443,183 mijë lekë dhe 68 procedura me vlerë të vogël me vlerë 35,647 mijë lekë, nga të cilat: janë realizuar 32 procedura me vlerë të lartë dhe fond limit 455,933 mijë lekë ose 31.5% e fondit të parashikuar. Ndërsa në procedura me vlerë të vogël janë realizuar 22 procedura me fond limit 11,028 mijë lekë ose 31.4% e fondit të planifikuar.

Nga të dhënat e mësipërme evidentohet fakti se 63 procedura me vlerë të lartë dhe fond limit 987,249 mijë lekë nuk janë realizuar dhe 46 procedura me vlerë të vogël me fond limit 24,619 mijë lekë. Nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos, nuk u paraqit asnjë argument për mos kryerjen e këtyre procedurave të planifikuara.

Këto tregues vërtetojnë mos realizimin faktik të zërave të programit ekonomik, pasi planifikohen procedura mbi baza jo reale ose planifikohen procedura të panevojshme ose pa fonde në dispozicion të cila më pas çojnë në mos realizimin e tyre.

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Administratorin dhe Drejtorin e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik.

Ndikimi/Efekti:

Mos realizimi i procedurave të prokurimit të parashikuara con në mos realizimin e programit të buxhetit për vitin respektiv.

Shkaku: Planifikimi i procedurave të panevojshme në procesin e evidentimit të projekteve ose planifikimi i tyre pa mundur sigurimin e fondeve nga zbatimi i buxhetit.

Rëndësia: I mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik dhe Drejtoritë e Qendrave të kësaj shoqërisë, të marrin masa që gjatë procesit të planifikimit të procedurave të prokurimit (me vlerë të lartë/ të ulët) të bëhet një studim i mirfilltë i nevojave më të domosdoshme të shoqërisë duke verifikuar parapakishit gjendje e mallrave në magazinë, nevjëm e kryerjes së shërbimit/ blerjes apo investimit, si dhe gjendjen e fondeve në dispozicion.

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 – 31.1.2022 kemi:

EMERTIMI	Nr.	Fondi limit	Vl. Kontrate	Diferenca (FL-VLK)
Gjithsej realizuar 2021+2022	74	1,170,945,864	1,007,252,106	163,693,758
<i>Procedura te realizuara viti 2021</i>	43	716,722,867	562,818,376	153,904,491
<i>Procedura realizuara viti 2022</i>	31	454,222,997	444,433,730	9,789,267
Procedura vlerësuara per auditim	27	925638239	792849882	
<i>Nga viti 2021</i>	16	547,792,180	421,328,061	
<i>Nga viti 2022</i>	11	377,846,059	371,521,821	
<i>Shprehur ne %</i>	36.5	79	78.7	

Nga të dhënat, rezulton se për periudhën objekt auditimit (01.01.2021 – 31.12.2022), janë kryer gjithsej **74** procedura me fond limit 1,170,945 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 1,007,252 mijë lekë, me një diferencë nga fondi limit për vlerën 163,693 mijë lekë ose 86% e fondit të prokuruar.

Bazuar në materialiteti e grupit të KLSH, nga **74** procedura me fond limit 1,170,945 mijë lekë janë vlerësuar për auditim **30** procedura me vlerë të fondit limit prej 968,140 mijë lekë ose 82.7 %, sipas objekteve të dhënat janë në Aneks 2.7.1, bashkëlidhur Projekt Raport Auditmit.

Titulli gjetjes 2: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve të pjesëmarrjes kundrejt operatorëve ekonomikë, duke përdorur kritere të ekzagjeruar, të panevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe të pa-argumentuara.

Situata:

Nga **74** procedura me fond limit 1,170,945 mijë lekë, janë zhvilluara procedura prokurimi **me 1 OE**, gjithsej 32 procedura me fond limit 449,105 mijë lekë ose 38% e fondit të prokuruar, nga e cila: të vitit 2021 janë 17 procedura me fond limit 365,722 mijë lekë ose 50.9 % e fondit dhe të vitit 2022 janë 15 procedura me fond limit 83,383 mijë lekë ose 18.3% e fondit të prokuruar.

Zhvillimi i procedurave me vetëm një OE pjesëmarrje tregon se nga shoqëria Albpetrl sha, kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës dhe të mirëargumentuara, gjë e cila ka çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, në skualifikimin e OE të cilat mund të kenë mundësitë për realizimin e procedurës, veprime këtë mos përdorimin e fondeve me efektivitet si rezultat u mungesë së konkurrencës në garë.

Kështu për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore në **aplikimin e kriterëve** të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara gjithsej **8 procedura** me fond limit **254,111 mijë lekë**, kritere të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE ose në skualifikimin e OE me oferta të leverdishme, konkretisht:

Nr/R	Emertimi	Fondi limit leke pa TVSh
Procedura viti 2021		
1	Sigurim I jetës se punonjësve ,sig. shëndeti nga aksidentet ne pune	22,330,000
2	Autobote 30-33 m3 per Q.F.&T. Patos	61,200,000
3	Permiresimi i infrastrukturës se Stacionit te Shitjes se Naftës Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	59,970,906
4	Riparim pjesore+ pastrim RVM 5000/8 dhe pastrim i mbeturinave mekanike te dy RVM 700 m3 /3/4 ne stacionin Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	18,337,055
5	Zëvendësim i mbulesave ekzistuese "Eternit" i çative te repartit Mekanik dhe repartit Elektrik ne Q.M.N. Kuçove	9,953,982
6	Sherbim per transport nafte bruto	46,771,938
7	Ndertim RVM 1500 m3 ne parkun e vjetër Dekantimin Gorisht (trajtim nafte ne te ftohte me servo)	14,666,892
Procedura viti 2022		
8	Sigurim i jetës se punonjësve ,sig. shëndeti nga aksidentet ne pune	20,883,330

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit, etj.

Vendosja si kritere e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht çënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit të LPP, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.

- Kërkesa **për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim**, është kërkesë e tejkaluar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkaluar në këtë

mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar. Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5², të VKM nr. 285, datë 19/05/2021.

Nga AK, nuk është argumentuar me volume punimesh dhe me grafik numri i punonjësve. NJHDT duhet t'i referohej Kreut III³, të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", si dhe në mospërputhje me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punësimit të ndërtimit dhe të analizës teknike të tyre, i ndryshuar.

- Për certifikatë ISO 3834-2:2005 "Per sistemin e menaxhimit te cilësisë se saldimit", kërkesë e gabuar pasi shërben për prodhimin me saldimit, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën e shkrirjes me saldimit. Standartit EN ISO 3834-2 për certifikim ka të bëjë vetëm me burimin dhe cilësinë e produktit që mund të rrjedh nga burimi dhe operimet e ndërlidhura. Standartet janë përdorur si bazë për vlerësimin e cilësisë së saldimit të prodhuesve. Sa më sipër, referuar objektit të prokurimit objekt shqyrtimi. Nuk jemi në kushtet e blerjes së produkteve të prodhuara me metodën e shkrirjes me saldimit, në mënyrë që të kërkohej që prodhuesi i tyre të disponojë certifikimin për standardin EN ISO 3834-2. Në këto kushte, kjo certifikatë nuk është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet ta heqin këtë kërkesë.

Kriteri:

Veprime këto në shkelje të neneve 1, 2, pika 1 e nenit 21, neni 78 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 "Për prokurimin publik", si dhe 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"* dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Ndikimi/Efektiviteti:

Aplikimi i kriterëve jo të mirëargumentuara, çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë ose në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, veprime të cilat ndikojnë në mos përdorimin e fondeve me efektivitet nga mungesa e konkurrencës.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

- Administratori i shoqërisë Albpertil sh.a në bashkëpunim me Drejtorinë e Prokurimit Publik, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.
- Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasë dhe efektivitetit, bazuar në kriteret e vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

²Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi përpërvijën e mëparshme, kërkonvërtetime të lëshuaranga një entpublik, përpërbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohenvlera, afatiipërfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuarpërbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvijës së mëparshme të realizuar me sektorinprivat, autoriteti/enti kontraktor kërkonsi dëshmi, vërtetime, përpërbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohenvlera, afatiipërfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me faturatatimore dhe çdollojdokumentitjetër, qëparashikohetngalegjislacioni në fuqi, qëprovonrealizimin me sukses të punëve.

³"Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 22 mars – 23 tetor me 2(dy) turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3(tri) turne, për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera".

Titulli i gjetjes 2: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave duke kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret e pjesëmarrjes, konstatuar kjo në 12 procedura prokurimi.

Situata:

- Në auditimin e dokumentacionit në dosjen e procedurave dhe sistemin SPE, është konstatuar se në **10 procedura** me fond limit **392,730 mijë lekë**, OE të shpallur fitues nga KVO nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK. Nga KVO këto OE nuk duhej të ishin shpallur fitues dhe lidhur kontrata shërbimesh/punimesh, por duhej anuluar dhe zhvilluar procedura të tjera me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE në procedura për një përdorim me efektiv të fondeve të prokura për vlerën **392,730 mijë lekë lekë**, nga e cila: me efekt negativ me dem në vlerën **10,364,872 lekë**, konkretisht procedurat:

Nr/R	Emertimi	Fondi limit leke pa TVSh
Procedura viti 2021		
1	Sigurim I jetës se punonjësve ,sig. shëndeti nga aksidentet ne pune	22,330,000
2	Tube naftës/jellësi	17,797,600
3	Blerje Purteka (16 mm, 22 mm,25mm)	17,585,000
4	Riparim pjesore+ pastrim RVM 5000/8 dhe pastrim i mbeturinave mekanike te dy RVM 700 m3 /3/4 ne stacionin Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	18,337,055
5	Sherbim per transport nafte bruto	46,771,938
6	Ndertim RVM 1500 m3 ne parkun e vjeter Dekantimin Gorisht (trajtim nafte ne te ftohte me servo)	14,666,892
Procedura viti 2022		
7	Sigurim i jetës se punonjësve ,sig. shëndeti nga aksidentet ne pune	20,883,330
8	Gazoil 10 ppm	182,692,600
9	Tube pompe kompresori TS	38,854,800
10	Blerje Goma Automjetesh	12,815,800

Kriteri:

Në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

Ndikimi/Efektiviteti:

KVO, ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e BOE në paligjshmëri të LPP, pasi nuk plotëson kriteret e DT.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (Komisioni i Vlerësimit të Ofertave).

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqësisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Rastet e shkeljeve sipas procedurave paraqiten si vijon:

1- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje purteka 16mm, 22, dhe 25mm”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje purteka 16mm, 22,, dhe 25mm”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 80736, datë 4.11.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 80736, datë 4.11.2022 F. S. , Përgj prokurime E.DH, inf. naftë E. B, ekonomist	4. Komisioni VO nr. 8073/1, datë 4.11.2022 A. V, ing. mekanik V. H, Ekonomist M. P, Juriste
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur me mjete elektronik”,		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 17,585,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “N...4” ShPK me vlerën e ofertës 17,319,100 lekë pa TVSh, me afat 30 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 266 lekë pa TVSh ose 2.2 %.
8. Data e hapjes së tenderit 22.11.2022 REF -48683-11-04-2022	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 2: a-Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 1 OE
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 8073/10, datë 22.12.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 14,697,000 lekë me afat 90 ditë	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me urdhër nr. 7628, datë 21,10,2022 nga Titullari i AK E. D. është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit dhe të specifikimeve teknike të procedurës me objekt: “Blerje purteka 16mm, 22mm dhe 25 mm”, i përbërë nga z. E. DH me profil *ing. Naftë/Drej. Prodhimit* z. LL. R me profil *ing. naftë/Drej. Prodhimit* dhe z. E. B me profil *ekonomist/Drej. Prokurimit dhe Ankandeve*.

Me urdhrin e prokurimit nr. 80736, datë 4.11.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondit limit 17,585,000 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “E hapur me mjete elektronike” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 80736/1, datë 4.11.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 22.11.2022.

Nga NjP është mbajtur PV nr. 8073, datë 4.11.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 80736, datë 4.11.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 22.11.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

ME shkresën nr. 8073/3, datë 4.11.2022 nga shoqëria “Albpetrol” sh.a është përcjellë për në APP njoftimi i kontratës.

- Vlerësimi i kriterëve:

Në auditimin e kriterëve të vendosura u konstatuan se kriteret janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Zhvillimi procedurës.

Me PV nr. 2, datë 22.11.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

1. Shoqëria “N...4” shpk me Nipt ... dhe ofertë 16,603,515 lekë.
2. Shoqëria “U...B” shpk me Nipt ... dhe ofertë 17,319,100 lekë.

Me PV nr. 3, datë 2.12.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 22.11.2022 deri datë 2.12.2022 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës.

Në përfundim KVO ka vendosur se nga 2 OE pjesëmarrës është skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 1 OE.

Është skualifikuar shoqëria “N...4” shpk me Nipt ... dhe ofertë 16,603,515 lekë, pasi:

*Nuk ka paraqitur specifikimet teknike, ku shukë nga parametrat kryesorë mungojnë ose nuk plotësohen. Sipas katalogut nuk plotësohen të dhënat për **përbërjen kimike dhe mekanike**.*

Për të dhënat fizike dhe konstruktive të produktit 16mm, 22mm dhe 25 mm, në skedën teknike të paraqitur nga OE mungojnë të dhënat për zërat (gjatësi e purtekës, hapi i fletës në kokën e prutekës, lartësi e pjesës së filluar, kuadrati ku shtrëngon purteka dhe përmbajtja e qafës së purtekës).

Nga auditimi në lidhje me skualifikimin, rezulton se është në përputhje me dispozitat e LPP.

Ndërsa shoqëria ‘U...B’ shpk me Nipt ... dhe ofertë 17,319,100 lekë, plotëson kërkesat e DST, duke u kualifikuar për lidhjen e kontratës, me vendim unanim.

Me PV nr. 8073/6, datë 6.12.2022, KVO ka marrë në dorëzim dhe verifikoj dokumentacionin e firmës fitues përpara lidhjes së kontratës, kjo në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 285, datë 19.5.2021. Me shkresën nr. 8073/7, datë 06.12.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit (paraprak).

Me shkresën nr. 8073/8, datë 14.12.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Me shkresën nr. 8073/9, datë 14.12.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit.

Midis shoqërisë “U...B” ShPK dhe AK është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 8073/10, datë 22.12.2022 për “Blerje purteka 16mm, 22, dhe 25mm” me vlerën 17,319,100 lekë pa TVSh. me afat punimesh 90 ditë nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria ‘U...L’ shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

a- Nga shoqëria nuk është plotësuar pika 2.2.1 e DST për kopje të certifikuar të pasqyrave financiare vitit 2021, pasi **nga shoqëria nuk është paraqitur raport ekspertiza e pasqyrave financiare**.

b- Nuk është plotësuar pika 2.2.1 e DST për paraqitjen e xhiros së periudhave 2019-2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën njëri nga vitet të jetë jo më e vogël fondi limit. Nga shoqëria është paraqitur vërtetim nr. 14337/1, datë 11.11.2022 në vlerën 34,673,850 lekë për periudhën Mars- Shtator 2022, **vit për të cilën nuk është kërkuar sipas DST**.

c- Nuk plotëson pikën për punime të ngjashme, pasi sipas dokumentacionit që ka paraqitur (faturat e blerje), totali i këtyre faturave është në shumën 4,734,862 lekë me TVSh, ndërsa sipas kërkesës së DST subjektit duhet të plotësojë një të ardhur në masën jo më pak se 40% ose për vlerën 8,440,800 lekë > se vlera e faturave prej 4,782,815 lek. Gjithashtu faturat e paraqitura nuk janë të gjitha për artikullin purteka.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, **duke ngarkuar me përgjegjësi: z. E...A me detyrë administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e KVO, respektivisht: A. V, ing. Mekanik, V. H, Ekonomist dhe M. P, Juriste**.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarët e KVO (A. V, V. H, M. P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Nga verifikimi i ekstraktin historik të QKB, konstatohet se shoqëria është themeluar në mars 2022. Në këto kushte kjo shoqëri e kishte të pamundur paraqitjen e pasqyrave financiare të viteve 2019-2020-2021, si dhe të të ardhurave, duke paraqitur të ardhurat e peruidhës Mar – Shtator 2022 për një vlerë që e tejkalon fondit limit të prokuruar.

Në lidhje me punët e ngajshme, nga shoqëria janë paraqitur disa fatura që në total kapin vlerë 23 milionë lekë. Gabimisht nga grupi i KLSH është marrë vlera e Tvsh.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa është argumentuar nga subjekti, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë, pasi:

Në lidhje me mos paraqitjen e pasqyrave financiare shoqëria është krijuar në vitin 2022 dhe nuk mund të merrej si shoqëri që plotëson kriterin, kjo për faktin se nga ana e shoqërisë janë deklaruar vetëm të ardhurat e periudhës 8 mujore 2022, por nuk dihet kapaciteti ekonomik i sajë, aktivi. Pasivi, mjetet në dispozicion etj. Vendimi i KPP së cilës ju referoheni nuk është analog, pasi nga shoqëria janë paraqitur pasqyrat financiare të dy viteve dhe mungon vetëm njëri nga vitet, pra mund të shikohen kapaciteti financiar i shoqërisë.

Në lidhje me punët të ngjashme argumenti qëndron dhe merret në konsideratë. **Përfundimshëm procedura mbetet me probleme në vlerësim.**

2- Procedura me objekt “Blerje gazoil viti 2021”

Procedura me objekt “Blerje Karburant, viti 2021”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 2078, datë 25.3.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 2078, datë 25.3.2021 R.P E.V F.S	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 2078/1, datë 25.3.2021 H.GJ D.H M. P
2. Lloji i Procedurës “Hapur”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 113,176,400 lekë pa TVSh REF -91014-03-25-2021	6. Oferta fituese (pa TVSH) EO “A...1” ShPK me marzhë fitimi 21.8063% me kontratë nr. 2078/9 dt. 6.5.2021, me afat 12 muaj	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)
8. Data e hapjes së tenderit Datë 19.4.2021	9. Burimi Financimit ALBPETROL	10. OE Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE a) Skualifikuar 0 OE/BOE b) Kualifikuar 1 OE

Titulli gjetjes. Mos argumenti i fondit limit për sasinë e blerje së gazoilit.

Situata:

Në auditimin e procedurave të prokurimit për blere karburanti për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, u konstatua se sasia e përcaktuar për blerje dhe fondi limit përkatës nuk është llogaritur në përputhje me dispozitat ligjore, kjo për sasinë 820 000 litra vitit 2021 dhe sasinë 1 150 000 litra vitit 2022, pasi:

Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos nuk është të argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi; sasinë e karburantit gazoil/benzinë, gjendje në magazinë, me analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (motogenerator, kaldaja, etj.) në qarkullim e gjendje pune inventar i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, apo gjendje inventar në njësitë shpenzuese vartësi e bashkisë, mbi sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit Administrativ, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit.

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të prokurimit” neni 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” i ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:

Mos përcaktimi i saktë i sasisë së karburantit sipas nevojave të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, janë veprime në keq menaxhim të fondeve për blerjen e këtij malli, pasi kërkohet sasi të paargumentuara.

Shkaku:

Mos zbatimi i legjislacionit nga strukturat përgjegjëse

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve dhe Furnizimit, të marrë masa për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Referuar dokumentacionit në dosje, sugjerimeve të APP dhe kundërtive të subjektit, rezulton se kriteret e aplikuara janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarët e NJP (F.S, R.P, E.V, A.P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me kriter që pasqyrat financiar të mos shoqërohen me akt ekspertizë financiare, sqarojmë se procedura është zhvilluar me ligjin e vjetër dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, thuhet se për të provuar kapacitetin financiar, AK kërkon kopje të certifikuar të një ose më shumë bilanceve...

Në lidhje me konstatimin për punë të ngjashme ku thuhet në një vlerë jo më e vogël se 40%, sqarojmë se në zbatim të pikës 4 të nenit 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, thuhet se ...në çdo rast vlera e kërkuar duhet jo më e madhe se 40%.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Nga grupi i KLSH, pasi shqyrtojë observacionet e subjekti, kunkudon se argumentet qëndrojnë **dhe merren në konsideratë.**

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 19.4.2021 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht OE “A...1” me përqindje 21.806 %.

Me PV nr. 3, datë 21.4.2021 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 19.4.2021 deri datë 21.4.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Sipas KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit ka vlerësuar se bashkimi i OE “A...1” shpk, plotëson kushtet për kualifikim dhe shpallje fitues me marzh fitimi 21.8063%.

Me shkresën nr. 2078/6, datë 29.4.2021 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshtatur të gjithë procedurën.

Me shkresën nr. 2078/7, datë 4.5.2021 është plotësuar formulari i njoftim fituesit, I cili është shpallur në buletin e APP nr. 70, datë 10.5.2021.

Me PV nr. 2078/8, datë 6.5.2021 është bërë marrja në dorëzim i dokumentacionit të firmës fituese. Midis bashkimi i OE “A...1” Shpk dhe AK (Albpetro sha), është hartuar dhe firmosur kontrata shërbimi nr. 2078/9, datë 6.5.2021 për “Blerje gazoil viti 2021” me marzh fitimi 21.8063%, me afat punimesh 12 muaj.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i OE “A...1” Shpk në sistemin SPE të formularit të vetdeklarimit, rezulton se vlerësimi është bërë i saktë dhe në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP dhe në plotësim të kriterëve të DST.

3- Procedura me objekt “Blerje gazoil viti 2022”

Procedura me objekt “Blerje Karburant, viti 2022”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 1772, datë 24.2.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 1772, datë 24.2.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1772/1, datë 24.2.2022
2. Lloji i Procedurës “Hapur”	F.S EE.V A.P	TH.M E.B M. P
5. Fondi Limit (pa TVSH) 182,692,600 lekë pa TVSh REF -20621-02-24-2022	6. Oferta fituese (pa TVSH) EO “A...1” ShPK me marzhë fitimi 199.304% me kontratë nr. 1772/9 dt. 22.4.2022, me afat 12 muaj	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)
8. Data e hapjes së tenderit Datë 28.3.2022	9. Burimi Financimit Albpetrol	10. OE Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE a) Skualifikuar 1 OE/BOE b) Kualifikuar 1 OE

- Vlerësimi i kriterëve:

Në aplikimin e kriterëve me gjithë ndërhyrjet e APP dhe ndryshimet të bërë nga AK, janë konstatuar kriterë **janë në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Zhvillimi procedurës.

Me PV nr. 2, datë 28.3.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

- 1- OE “A...1” me vlerë 182,692,011 lekë pa TVSh
- 2- OE “E...A” shpk me vlerë 182,692,440 lekë pa TVSh

Me PV nr. 3, datë 6.4.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 28.3.2022 deri datë 6.4.2022 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Pas vlerësimit të dokumentacionit, KVO nga 2 OE pjesëmarrës ka skualifikuar OE “E...A” shpk me vlerë 182,692,440 lekë pa TVSh, për flaktin se:

Nuk ka paraqitur licensë për stacionin e shitjes së karburantit.

Nuk ka paraqitur dokumentacion pronësi të pikës së shitjes.

Sipas KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit ka vlerësuar se OE “A...1” shpk, plotëson kushtet për kualifikim dhe shpallje fitues me marzh fitimi 199.304%.

Me shkresën nr. 1772/8, datë 22.4.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën. Me shkresën nr. 1772/7, datë 11.4.2021 është plotësuar formulari i njoftim fituesit, i cili është shpallur në buletin e APP nr. 50, datë 19.4.2021. Me PV nr. 1772/6, datë 11.4.2021 është bërë marrja në dorëzim i dokumentacionit të firmës fituese.

Midis bashkimi i OE "A...1" Shpk dhe AK (Albpetro sha), është hartuar dhe firmosur kontrata shërbimi nr. 1772/9, datë 22.4.2022 për "Blerje gazoil viti 2021" me marzh fitimi 199.304%, me afat punimesh 12 muaj.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE "A...1" Shpk në sistemin SPE të formularit të vetdeklarimit, rezulton se vlerësimi **nuk është bërë i saktë** dhe në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP dhe në plotësim të kriterëve të DST, pasi:

Nga shoqëria nuk është deklaruar në formularin e vetdeklarimit (shtojca 8), *1 (nje) mjet autobot me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 m³, për të cilën subjekti në dosjen e procedurës ka depozituar kontratën e qirasë me shoqërinë "RESULIER" shpk me kontratë qiraje 317/195, datë 18.01.2021 me targë AA548SC.*

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 162, date 21.12.2020 "per prokurimin publik", neni 82, pika 5, si dhe VKM nr. 285, datë 19/05/2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 26, pika 6, **duke ngarkuar me përgjegjësi: z. F. M. me detyrë ish- Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e KVO, respektivisht: TH.M, E.B dhe M. P.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga anëtarët e KVO (TH.M, E.B, M. P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE NË SPE, vihet re se është ngarkuar dhe dokumentacioni përkatës për autobotin. Paraqitja në formularin përmbledhës është një koncept i ri futur ne legjislacionin e LPP. Sipas këtij legjislacioni mjafton që të paraqesim një formularë përmbledhës vetëdeklarim në vend të dokumentacionit vërtetues, neni 82 i ligjit.

Pra në referencë të këtij neni , OE mund të deklarojë në formularin për çdo rast AK ti kërkojë OE sqarime dhe dokumentacion mbështetës për sqarime kur është e nevojshme. Në rastin konkret OE ka paraqitur në SPE dokumentacionin e autobotit.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Për sa është kundërshtuar nga subjekti, pretendimi nuk qëndron dhe **nuk merret në konsideratë**, pasi autoboti nuk është vetëdeklaruar fare në shtojcën 8 dhe nuk len shkak që KVO të kërkojë sqarime tek OE. Megjithëse dhe kjo nuk ka ndodhur. Në këto kushte deklarimi në formularin bie ndesh me Ligji nr. 162, date 21.12.2020 "per prokurimin publik", neni 82, pika 5, si dhe VKM nr. 285, datë 19/05/2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 26, pika 6. Fillimisht duhet të deklarohe në formularin e vetdeklarimit mbi bazën e se cilës behet vlerësimi fillestar, më pas paraqiten dokumentet e mjetit.

Titulli gjetjes: *Mungesa e dokumentacionit në menaxhimin e karburantit.*

Situata:

Nga auditimi me zgjedhje në lidhje me konsumin e karburantit dhe pjesëve të ndërrimit në Qendër e Furnizimit dhe Transportit (QFT) u konstatua se, për katër mjete KIA me targë AA...BE, KIA me targë AA...AI, KIA me targë AA...AT dhe KIA me targë AA...AL, për vitin 2021 janë kryer shpenzime për riparim, konkretisht:

a- Për mjetin KIA me targë AA...AL, në vlerën 41,900 lekë.

b- Për mjetin KIA me targë AA...AI, në vlerën 70,000 lekë nga kjo (goma në 56,000 lekë).

Për vitin 2022 janë kryer shpenzime vetëm për mjetin KIA me targë AA...AI, në vlerën 211,500 lekë.

Për konsumin e karburanti rezultoi se qendrat bëjnë kërkesë për furnizim pranë Drejtorisë së Shërbimeve dhe Furnizimit. Nga auditimi në lidhje me kërkesat për karburant nga QFT për katër mjete KIA me targë AA...BE, KIA me targë AA...AI, Kia me targë AA...AT dhe KIA me targë AA...AL rezultoi se për vitin 2021 janë furnizuar me 6990 litra karburant (*KIA me targë AA...AI, për 3065 litra dhe KIA me targë AA...AL, 3925 litra*).

Nga të dhënat e marra nga kartelat e harxhimit të karburantit të QFT rezulton se, për mjetet KIA me targë AA...AI dhe KIA me targë AA...AL, sipas flet udhëtimeve janë harxhuar 7745 litra (*KIA me targë AA...AI, për 3485 litra dhe KIA me targë AA...AL, për 4260litra*), **më shumë 755 litra.**

Për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk ka rakordim midis Drejtorisë së Shërbimeve dhe Furnizimit dhe Qendrën e Furnizimit dhe Transportit (QFT) për sasinë e karburantit të furnizuar dhe shpenzimit faktik sipas fletë udhëtimeve.

Gjithashtu rezulton se fletë udhëtimet, e plotësuar për harxhimin e karburantit nuk janë plotësuar saktë për km e përshkruara, nuk kanë emirin e personit që kanë firmosur për shërbimin e kryer, nuk janë të qarta për km dhe volumet e punëve të kryera, nuk janë nënshkruar nga nëpunësi urdhërues, janë plotësuar me shkrim të pakuptueshëm, nuk është mbajtur Procesverbal për konsumin e karburantit për çdo muaj, daljet e karburantit nga magazina nuk janë shoqëruar me urdhër dorëzimi dhe me flet kërkesë, pra dokumentacioni për argumentimin e konsumit të karburantit mungon.

Kriteri:

Veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27/12/2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikën 36, ku përcaktohet *Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e nje prove ligjore ose administrative¹². Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve, **pikën 38,** ku përcaktohet *Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve.**

Ndikimi/Efekti:

Mos evidentimi i karburantit me dokumentacion e rregullt ligjore, çon në keqadministrimin e tij dhe shkak për abuzime dhe keq menaxhim të fondeve.

Shkaku:

Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse në zbatimin e kuadrit ligjor për dokumentimin e veprimeve.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

- Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marri masa për hartimin e dokumentacionit ligjor në menaxhimin e karburantit, duke evidentuar me dokumentacion të saktë sasinë e harxhuar nga çdo Qendër e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos që është përdoruese e gazoilit në veprimtaritë vjetore.
- Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të nxjerrë mision auditimi për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e një kontrolli të thelluar të dokumentacionit ligjorë të përdorimit të gazoilit, të gomave dhe pjesëve të këmbimit të mjeteve nga çdo Qendër për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 nga momenti i furnizimit të tyre. Në rast të konstatimit të diferencave të pashoqëruara me dokumentacion ligjorë të evidentohen përgjegjësit dhe të merren masa për shpërbllim të dëmit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (*prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023*), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Drejtori i Drejtorisë së shërbimeve Mbështetëse dhe Furnizimit z. A.B, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse kryhen shpërndarjen e Gazoilit për çdo muaj duke hartuar draft shpërndarjen në bashkëpunim me drejtoritë respektive të Albpetrol sh.a Patos, konkretisht me Drejtorinë e Logjistikës, Drejt/ Prodhimit si dhe Drejt/ Teknike të Kompanisë Albpetrol sh.a Patos. Në fund del vendimi me miratim të Administratorit të Kompanisë, për sasinë që marrin në fund të muajt çdo qendër. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse nuk e ka të përcaktuar në rregullore dhe përgjegjësi me harxhimin e karburantit. Kjo drejtori ka në varësi Drejt/ Gazoilit të Albpetrolit sh.a, e cila kryhen furnizimin me gazoili të qendrave bazuar në autorizimin e nxjerrë nga titullari i qendrës.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Për sa është argumentuar nga përfaqësuesi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në lidhje me mos menaxhimin e karburantit, sqarojmë se ato **nuk janë bindës për grupin e KLSH** dhe tregojnë edhe njëherë nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos (drejtoritë përgjegjëse), nuk ushtrojnë asnjë lloj kontrolli të konsumit të karburantit të marrë për përdorim nga çdo qendër, mbi bazën e fletudhëtimeve, urdhrave të punës, etj, veprime në shkelje të UMF nr/ 30, datë 27.1.2011.

4- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje tubo pompe kompresori”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje tubo pompë kompresori.”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 8400, datë 17.11.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 8400, datë 17.11.2022	4. Komisioni VO nr. 8400/1, datë 17.11.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur me mjete elektronik”,	F. S. , Përgj prokurime LL. R E.B	A.B V. H M.P
5. Fondi Limit (pa TVSh) 38,854,800 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “V....S” ShPK me vlerën e ofertës 38,271,978 lekë pa TVSh, me afat 90 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,646 lekë pa TVSh ose 4.8 %.
8. Data e hapjes së tenderit 05.12.2022 REF -50413-11-17-2022	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 3: 1-A....O me ofertë 38,840,744 lekë. 2-L....S” me ofertë 38,650,000. 3-V...Sme ofertë 38.271,978 lekë a-Skualifikuar 1 OE , konkretisht: 2-L....S” me ofertë 38,650,000 b- Kualifikuar 2 OE: 1-A....O me ofertë 38,840,744 lekë. 2-V...S me ofertë 38.271,978 lekë
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 8400/10, datë 05.01.2023	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 38,271,978 lekë me afat 15 ditë	

- Vlerësimi i kriterëve:

Në auditimin e kriterëve të vendosura u konstatuan kriterë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Zhvillimi procedurës.

Me PV nr. 2, datë 5.12.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

3. Shoqëria “A....O” shpk me Nipt K.....M dhe ofertë 38,840,744 lekë.
4. Shoqëria “L....S” shpk me Nipt L...1S dhe ofertë 38,650,000 lekë.
5. Shoqëria “V....S” shpk me Nipt L....3S dhe ofertë 38,271,978 lekë.

Me PV nr. 3, datë 14.12.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 05.12.2022 deri datë 2.12.2022 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Në përfundim KVO ka vendosur se nga 3 OE pjesëmarrës është skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 2 OE.

Është skualifikuar shoqëria “L....S” shpk me ofertë 38,650,000 lekë, pasi:

Nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të vetdeklarimit, si dhe nuk paraqet punime të ngjashme si dhe nuk paraqet autorizim prodhuesi.

Nga 2 OE të mbetur në garë KVO ka vlerësuar në vend të parë shoqërinë “V....S” shpk dhe ofertë 38,271,978 lekë, më të leverdishme.

Me PV nr. 8400/6, datë 15.12.2022, KVO ka marrë në dorëzim dhe verifikoj dokumentacionin e firmës fitues përpara lidhjes së kontratës, kjo në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.5.2021. Me shkresën nr. 8400/7, datë 15.12.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit (paraprak). Me shkresën nr. 8400/8, datë 23.12.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën. Me shkresën nr. 8400/9, datë 23.12.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit.

Midis shoqërisë “V....S” Shpk dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 8400/10, datë 05.01.2023 për “Blerje tubo pompe kompresori” me vlerën 38,271,978 lekë pa TVSh. me afat punimesh 15 ditë nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria ‘V....S’ shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

d- Nga shoqëria vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi nuk rezulton të jetë paguar muajt i fundit (tetor 2022), ku sipas vërtetimit të debisë thuhet se detyrimi është pa përfshirë muajin tetor 2022, ndërkohë që procedura zhvillohet me datë 5.12.2022.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, **duke ngarkuar me përgjegjësi: E. D. me detyrë Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e KVO, respektivisht: A.B, V. H dhe M.P.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarët e KVO (A.B, V. H, M. P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

OE “V....S” shpk, i kualifikuar i pari në renditjen për vlerën më të ulët dhe i shpallur “fitues”, ka një veprimtari të suksesshme në tregtimin me shumice të materialeve të industrisë së naftës dhe gazit. Vërtetimi i debisë së O...E që operatori ekonomik ka paraqitur në këtë procedurë mban datën 01.11.2022, rezulton të ketë 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike pa përfshirë faturën e muajit Tetor 2022, gjë e cila vërteton se OE deri më këtë datë ka shlyer me korrektësi faturat përkatëse pa qenë ndonjëherë debitor. Ky fakt për KVO është mëse i mjaftueshëm dhe K...Nbindjen e qartë për të gjykuar seriozitetin e OE konkurrues dhe pa patur si qëllim diskriminimin e tij.

Nëse KVO do kishte skualifikuar shoqërinë “V....S” shpk me ofertë më të ulët se OE i renditur i dyti, do kishin kualifikuar një OE me ofertë më të larë dhe rritje të efektit me vlerë 379,000 lekë më shumë.

Nisur nga konkluzioni i grupit të KLSH, KVO i bën kërkesë shoqërisë fituese “V....S” shpk për të paraqitur si provë bindëse se vërtetimi i lëshuar nga FSHU me nr. 2022-7664187-UH datë 25.11.2022, lëshuar para datës së zhvillimit të procedurës nga KVO (5.12.2022), si dhe kopje MA të O...E -FSHU për klientin “V....S” shpk për faturën nr. 441535999, datë 18.11.2022 me vlerë 10,986.4 lekë.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Argumentet e paraqitura nga KVO **nuk sqarojnë situatën** për mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH, pasi dokumentacion bashkëlidhur nuk është pjesë e dosjes dhe sistemit SPE. **Procedura mbetet me probleme në vlerësim.**

5- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje goma automjetesh”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje goma automjetesh”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 3250, datë 20.4.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 3250, datë 20.4.2022	4. Komisioni VO nr. 3250/1, datë 20.4.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur me mjete elektronik”,	F. S. , Përgj prokurime A.RR M. P	R.Ç S.Z J.B
5. Fondi Limit (pa TVSh) 12,815,800 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “S...O” ShPK me vlerën e ofertës 12,402,000 lekë pa TVSh, me afat 30 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 413 lekë pa TVSh ose 3.2 %.
8. Data e hapjes së tenderit 6.5.2022 REF -25787-04-20-2022	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 4: a-Skualifikuar 3 OE b- Kualifikuar 1 OE
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 3250/9, datë 30.6.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 12,402,000 lekë me afat 30 ditë	

Me urdhër nr. 1622, datë 21.02.2022 nga Titullari i AK z. F. M. është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit dhe të specifikimeve teknike të procedurës me objekt: “Blerje goma automjetesh”, i përbërë nga A.RR me profil *ing. Mekanik/Drejtoria e Prodhimit*, zj. O.F *ing. gjeolog/Drej. Prodhim*, z. A.P me profil *Ekonomist/Drejt. Prodhimit*.

Me PV nr. 1622/2prot, datë 2.3.2022 nga komisioni është bërë llogaritja e fondit limit, i miratuar në programin ekonomik të vitit 2022 është në shumën 12,934,500 lekë pa TVSh. Nga grupi i punës janë analizuar të tre variantet e përcaktuar në nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 dhe në fund është konkluduar që të zbatohet pika (b), për marrjen e ofertave nga OE që kanë në objektin e veprimtarisë.

Sipas këtij PV nga komisioni i është dërguar e-mail zyrtarë INSTAT, Drejtorisë së tatimeve, dhe Drejt. Përgjithshme të Doganave mbi çmimet referues të këtyre gomave.

Ndodhur në këto kushte komisioni bëri testimin e tregut, duke kërkuar oferta në subjekte që e kanë këtë lloje veprimtarie, konkretisht:

- a- Shoqëria “K....J” shpk me ofertë 12,815,800 lekë.
- b- Shoqëria “A....I” shpk me ofertë 13,569,800 lekë.
- c- Shoqëria “G....Y” shpk me ofertë 19,144,400 lekë.

Në lidhje me çmimet sipas kontratave të ngjashme, nga komisioni nuk është marrë në konsideratë për faktin se çmimet e gomave kanë luhajtje si në tregun vendas dhe atë të jashtëm, pasi materiali bazë për prodhimin e tyre kanë pësuar rritje.

Referuar sa sipër komisioni përcaktojë fondin limit në vlerën 12,815,800 lekë.

Me urdhrin e prokurimit nr. 3250, datë 20.4.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 12,815,800 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “E hapur me mjete elektronike” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 3250/1, datë 20.4.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 6.5.2022.

Nga NjP është mbajtur PV nr. 3250/2, datë 20.4.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 3250, datë 20.4.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 6.5.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në auditimin e kriterëve të vendosura u konstatuan kriteret në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 6.5.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 4 OE, konkretisht:

6. Shoqëria “S....2” shpk me ofertë 10,336,000 lekë.
7. Shoqëria “A....A” shpk me ofertë 12,000,000 lekë.
8. Shoqëria “S...O” shpk me ofertë 12,402,000 lekë.
9. Shoqëria “A.H” PF me me ofertë 12,499,583 lekë

Me PV nr. 3, datë 13.5.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 6.5.2022 deri datë 2.12.2022 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Në përfundim KVO ka vendosur se nga 4 OE pjesëmarrës është skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar 1 OE.

Janë skualifikuar:

1-Shoqëria “S....2” shpk me dhe ofertë 10,336,000 lekë

Rezulton se nuk përmbushet kriteri i përcaktuar ne Dokumentet e tenderit, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” nen pika 2.3.1, ku përcaktohet se: “Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës” pasi faturat e paraqitura dhe dokumentacioni per te vërtetuar furnizime te ngjashme është ne nje vlere me te vogël se 40 % e fondit limit.

Katalogët e paraqitur nuk jane te përkthyer dhe te noterizuar pjesa e specifike te katalogut/skedës teknike ku jepen karakteristikat e mallit qe ofertohet ne kundërshtim me Dokumentet e Tenderit, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” nen pika 2.3.2 ku përcaktohet se “Katalogë/skeda teknike te përmbaje karakteristikat teknike te artikujve qe jane objekt i prokurimit për gomat si më sipër me qellim qe Autoriteti Kontraktor te gjykoje nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike te përcaktuara ne dokumentet e tenderit. Ne katalogun/et/skedat e paraqitur te shënohen ne mënyrë te dukshme te gjitha llojet e gomave te kërkuara nga AK.

2- Shoqëria “A....A” shpk me dhe ofertë 12,000,000 lekë.

Nga shqyrtimi i Katalogëve te paraqitur rezulton se është përkthyer dhe noterizuar vetëm per specififikimet e 5 modeleve te autogomave te kërkuara, ndërsa per modelet e tjera te gomave nuk ka paraqitur katalog te përkthyer dhe te noterizuar pjesa e specifike te katalogut/skedës teknike ku jepen karakteristikat e mallit qe ofertohet, ne kundërshtim me Dokumentat e Tenderit, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” nen pika 2.3.2 ku përcaktohet se “Katalogë/skeda teknike te përmbaje karakteristikat teknike te artikujve qe jane objekt i prokurimit për gomat si më sipër me qellim qe Autoriteti Kontraktor te gjykoje nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike te përcaktuara ne dokumentet e tenderit. Ne katalogun/et/skedat e paraqitur te shënohen ne mënyrë te dukshme te gjitha llojet e gomave te kërkuara nga AK. (Pjesët specifike te katalogut/skedës teknike ku jepen karakteristikat e mallit qe ofertohet n.q.s. nuk jane ne gjuhen shqipe te përkthehen ne gjuhen shqipe dhe te motorizohen)”.

Rezulton se është paraqitur autorizim distributori, por nuk është paraqitur asnjë lidhje midis distributorit dhe prodhuesit të gomave, kjo në kundërshtim me: Dokumentat e Tenderit, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” nën pika 2.3.3 ku përcaktohet se “..... Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton lidhjen e distributorit të autorizuar me firmën prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij”.

Rezulton se nuk përmbushet kriteri i përcaktuar në Dokumentat e tenderit, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” nën pika 2.3.1, ku përcaktohet se: “Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”, pasi faturat e paraqitura për të vërtetuar furnizime të ngjashme rezultojnë në një vlerë më të vogël se 40 % e fondit limit.

3. Shoqëria “A.H” PF me ofertë 12,499,583 lekë

Katalogët e paraqitur nuk janë të përkthyer dhe të noterizuar pjesa e specifike të katalogut/skedës teknike ku jepen karakteristikat e mallit që ofertohet në kundërshtim me Dokumentat e Tenderit, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” nën pika 2.3.2 ku përcaktohet se “Katalogë/skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të artikujve që janë objekt i prokurimit për gomat si më sipër me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në katalogun/et/skedat e paraqitur të shënohen në mënyrë të dukshme të gjitha llojet e gomave të kërkuara nga AK. (Pjesët specifike të katalogut/skedës teknike ku jepen karakteristikat e mallit që ofertohet n.q.s. nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të motorizohen)”.

Nuk është paraqitur autorizim prodhuesi ose distributor për mallrat e kërkuara në kundërshtim me Dokumentat e Tenderit, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” nën pika 2.3.3 ku përcaktohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqes autorizim prodhuesi ose distributor për mallrat e kërkuara. (nëse janë disa prodhues ose distributor autorizimi duhet të paraqitet nga secili prej tyre) Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton lidhjen e distributorit të autorizuar me firmën prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij”.

Me PV nr. 3250/6, datë 16.5.2022, KVO ka marrë në dorëzim dhe verifikoj dokumentacionin e firmës fitues përpara lidhjes së kontratës, kjo në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.5.2021.

Me shkresën nr. 3250/7, datë 15.12.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit (paraparak). Me shkresën nr. 3250/8, datë 26.5.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën. Me shkresën nr. 3250/7, datë 18.5.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit.

Midis shoqërisë “S...O” Shpk dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 3250/9, datë 30.6.2022 për “Blerje goma automjetesh” me vlerën 12,402,000 lekë pa TVSh. me afat punimesh 30 ditë nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “S...O” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

Nuk përmbushet kriteri i përcaktuar në DST, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” nën pika 2.3.1, ku përcaktohet se: “Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës” pasi faturat e paraqitura dhe dokumentacioni për të vërtetuar furnizime të ngjashme është në një vlerë më të vogël se 40 % e fondit limit, **pasi sipas dokumentacionit të paraqitur paraqet një xhiro prej 5,525,260 lekë nga vlera 6,151,584 lekë që duhet të paraqisje.** Nga të dhënat e kontratave/faturave si punë të ngjashme, rezulton se jo të gjitha faturat/kontrat kanë shitje gomash, pasi kanë dhe shitje pjesë këmbimi artikull që nuk kërkohet në DST. Gjithashtu fatura nr. 10/2021 datë 3.12.2021 në shumën 381,000 lekë e paraqitur si shitës, shoqëria “S...O” shpk është blerës dhe jo shitës.

Sipas dokumentacioni shoqëria ka këto fatura shitje, tabela:

Nr.Fatur/ Kontrate	Date	Blerësi	Vlera	
103	26.7.2019	D.....ë	1,586,000	Kontratë
29	19.7.2019	R.....A	273,600	Kontratë
13	3.12.2021	D.....s	593,820	Fature
2	30.4.2021	Q.....e	66,300	Fature
14	3.12.2021	L.....O	210,000	Fature
5	3.6.2021	P.....t	351,840	Fature
31	19.4.2022	N.....T	84,480	Fature
7	5.5.2022	D.....e	627,600	Fature
27	30.10.2020	D.....s	460,800	Fature
34	19.11.2020	L.....O	146,400	Fature
19	01.6.2021	P.....t	176,060	Fature
14	21.4.2021	S.....Y	249,360	Fature
13	16.4.2021	G.....I	162,480	Fature
12	14.4.2021	S.....Y	536,520	Fature
		SHUMA	5,525,260	

e- Nuk plotëson pikën 2.2.2 të DST, ku kërkohet kopje te certifikuar te bilancit për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi pasqyrat financiarë të viteve 2019,2020 dhe 2021 nuk janë të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e përzgjedhjeje", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit", **duke ngarkuar me përgjegjësi: z. K. C. me detyrë ish- Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e KVO, respektivisht: R.Ç, S.Z dhe J.B.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga z. R.Ç në cilësinë e anëtarit të KVO është paraqitur observacion me shkresën nr. datë 16/06/2023 (prot KLSH nr. 1202/20, datë 19/06/2023), si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me mos plotësimin e kriterit të furnizimeve të ngjashme deri në 40% fondit limit, sqarohet se faturat e paraqitura dhe dokumentacioni për të vërtetuar furnizimet e ngjashme është në një vlerë jo më të vogël se 40%, duke depozituar kontratat të ngjashme me vlerë shumë herë me të lartë se 40% e fondit limit. Ligji i prokurimit dhe në DST është kërkuar kontrata të ngjashme dhe jo identike.

Ndërsa në lidhje me mos paraqitjen e ekspertizës për pasqyrat financiare 2019-2020-2021, sqarohet se ato nuk janë në kushte të kërkesave të ligjit nr. 25/2018 "për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Ne lidhje me këtë konstatim informoj se Operatori ekonomik S...O ne zbatim te DST ka paraqitur Bilancet e 3 viteve te Fundit 2019, 2020, 2021 te Shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël dhe te konfirmuar nga organet Tatimore.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa këni argumentuar në lidhje me mos plotësimin e kriterit për punë të ngjashme të dhënat e faturave janë me TVSH, rrjedhimisht dhe krahasimi me fondin limit të bëhet me TVSh, pasi nuk mund të krahasohen dy shifra në kushte të pabarabarta (me dhe pa TVSh). Gjithashtu në referencë të dispozitave të LPP por dhe kërkesave të DST është kërkuar furnizime të ngjashme, pasi OE mund të këtë dhe shitje të tjera si mjete por që nuk është objekt i tipologjisë së procedurës.

Në lidhje me pasqyrat financiare, sipas të dhënave të sistem ato nuk janë të shoqëruar me akt ekspertize të ekspertit kontabël dhe se pasqyrat e vitit financiare 2020 plotësojnë kushtet e ligjit nr. 25/2018, pasi totali i aktivitetit është mbi 100 milionë dhe të ardhurat mbi 30 milionë lekë. **Përfundimisht procedura mbetet me probleme në vlerësim.**

11- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje autobote 0-33 m3”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje autobote 0-33 m3”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 2199, datë 31.3.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 2199, datë 31.3.2021	4. Komisioni VO nr. 2199/1, datë 31.3.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur me mjete elektronik”,	R.P E.GJ F.S	H.GJ S.Z M. P
5. Fondi Limit (pa TVSh) 61,200,000lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “A...H” ShPK me vlerën e ofertës 58,780,000 lekë pa TVSh, me afat 6 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,420 lekë pa TVSh ose 3.9 %.
8. Data e hapjes së tenderit 26.4.2021 REF - REF-91992-03-31-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 2: a-Skualifikuar 0 OE, b- Kualifikuar 2 OE
11. Ankimim PO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak/K PJO	13. Përgjigje KPP PO
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 2199/9, datë 25.10.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 58,780,000 lekë me afat 6 muaj	

Me urdhër nr. 1688, datë 8.3.2021 nga Titullari i AK **z. B. Z.** është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit dhe të specifikimeve teknike të procedurës me objekt: “Blerje autobote 0-33 m3”, i përbërë nga: **z. E.GJ me profil ing. Mekanik/QFT Patos, z. V.SH, me profil ing. Mekanik/QFT Patos, z. A.P me profil Ekonomist/Drejt. Prodhimit.**

Me PV nr. 1622/2prot, datë 2.3.2022 nga komisioni është bërë llogaritja e fondit limit, i miratuar në programin ekonomik të vitit 2021 në shumën 61,200,000 lekë pa TVSh. Nga grupi i punës janë analizuar të tre variantet e përcaktuar në nenet 23 dhe 28 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar dhe neni 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të PP” i ndryshuar është mundësuar për llogaritja e fondit limit.

Nga auditivi i dokumentacionit në dosje dhe shqyrtimi i kundërshtive të subjektit në lidhje me hartimin e fondit limit, **rezulton se procedura është e saktë në përcaktimin e këtij fondi.**

- Vlerësimi i kritereve:

Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *konkretisht.*

a) *Operatori ekonomik të ketë servis të autorizuar për shërbimet që mund ti kryhen automjeteve gjatë periudhës së garancisë.*

Per këtë ofertuesi te paraqesë:

Licence per autoriparimin e mjeteve rrugore lëshuar nga QKB. Ne rastin kur nuk ka vete servis automjeteve te paraqesë kontrate qeraje/bashkëpunimi te lidhur para noterit me nje servis, qe te përfshijë periudhën e garancisë per mjetet qe ofertohen, shoqëruar me licencën per autoriparimin e mjeteve rrugore ne emër te servisit lëshuar nga QKB.

Nga ana e AK nuk janë përcaktuar se çfarë defektesh mbulon garancia, në kundërshtim me nenin 46 të LPP, ku thuhet se:

Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Specifikime Teknike: Autobote 30000 - 33000 litra

(Tërheqës dhe Gjysërrimorkio me cisterna)

A - Për Mjetin: Tërheqës

Viti i prodhimit:	2021
Km:	0
Tërheqja:	Me aksin e pasëm aktiv
Amortizimi:	Ura e parë me balestra, ura e pasme me jastëk ajri
Lloji i kabinës:	Kabinëditore. Rripa sigurimi për shofer dhe pasagjer në sedilje Sedilje me amortizator të rregullueshëm. Varëse për rrobat në pjesën e pasme të kabinës Priza Eklektike, 24V+12V
	<u>Kondicioner</u>
	Xhama Elektrik
	Timon i rregullueshëm mekanikisht
Shasia:	Min. 4280[mm]
Ndotja:	Min. Euro 5 me teknologjinë SCR
Motori:	Min, 10800 [cm ³]dhe max, 11200[cm ³]
Fuqia:	Min 430[kf] max 450 [kf]
Momenti përdredhës:	Min 2100[Nm] dhe max 2200[Nm]
Sistemi i frenimit të motorit:	Min 290[kw]
Kambio:	Automatike, (min. 12 marshe)
Kambio (kapaciteti në nisje)	Min.600[Nm]
Peshapër aksin e parë:	Min.7[Ton]
Pesha për aksin e pasëm	Min.13[Ton]
Bateri AGM:	Min. 200[Ah]
ADR:	Për transportin e lëndëve të rrezikshme me dy dalje(një në kabinë dhe një jashtë kabine)
Gomat:	Të StandartitEU dhe EFTA
Përmasat e gomave të Tërheqësit:	315/80 R22.5 M+S
Gomat e para:	Klasi i rezistencës, C,
Gomat e pasme:	Klasi i rezistencës, D,
Goma rezervë:	Me disk e njëjta me gomat e përparme
Alternator:	Min. 110 [Amp]
Siguria :	EBS (Electronic Brake System dhe ESP (Electronic Stability Programme)
Lartësia max. e kabinës:	Max.4 metra
Afati dorëzimit :	Max. 6 muaj
<u>Garancia :</u>	<u>Min.12 Muaj</u>

Motori, kutia e shpejtësisë dhe aksi i pasëm, të jenë të prodhuara nga i njëjti prodhues.

Mjeti duhet të ketë klasifikimin sipas klasave FL ADR që mbulon klasa FL, EXII, EXIII dhe AT(shtypur në etiketën ADR UN ECE R105)

B - Për Mjetin: Gjysërrimorkio (Cisternë)

Viti i prodhimit:	2021
Kapaciteti i rezervuarit:	30000-33000[litra]
Materiali i rezervuarit:	304L –Celik CrNi
Ndarja e brendshme:	Konstruktive me llamarinë CrNi, spesormin. 4 [mm]
Volumi lëngut:	Një depozit 30000 litra deri në 33000 litra.
Mbulesa e cisternës nga jashtë:	Me fletë alumini spesor 1.2 [mm], materiali izolimit të jetë lesh xhamimin. me spesor 100 [mm].

Ngarkimi:	Në versionin nga sipër me bakaportë dhe kapak hermetik të pajisur me valvul shkarkimi për gazrat. Të ketë govat për grumbullimin e lëngut në rast avarie. (Standart)
Shkarkimi:	Shkarkimi të bëhet nga mbrapa me tubacion 4", saracinesk dhe gjysëmshunto alumini për mbërthimin e tubit freksibël të shkarkimit ose ngarkimit.
Shasia e gjysëmrimorkios:	Të jetë e prodhuar duke përdorur makineritë e saldimit me gaz inert nga çeliku me qëndrueshmëri të lartë me prerje të tërthortë. Mbingarkesa të jetë marrë në konsideratë gjatë llogaritjeve të qëndrueshmërisë, Cel 52me spesor5 [mm]
Akset:	Të jenë të prodhuar sipas standarteve Europiane me suspension ajri. Të ketë kapacitet mbajtës prej 3x9 [Ton] Aksi I parë të ngrihet në mënyrë automatike.
Niveli i lëngut:	Të ketë të montuar sistemin e matjes së nivelit të lëngur në cisterna.
Spinoti terheqjes (2" S):	Të jetë i prodhuar me çelik të fortë (42 Cr Mo 4), i cili duhet të jetë bazuar me normat sipas st. Spinotitë jetë i zëvendësueshëm
Sistemi Elektrik:	Dritat te jene LED. Të gjithë sistemet elektrike të jene sipas rregullave europiane , gjithashtu dhe sinjalistika me gjithë shenjat paralajmëruese në tabela . Rrjeti elektrik duhet të jetë kundra djegies dhe duhet të jetë 24 volt.
Lidhja elektrike:	Midis tërheqësit dhe gjysëmrimorkios, të bëhet me prizë dhe spine sipas standartit.
Gomat:	Gomat të kenë dimensionet 385/65 R 22.57 copë. Goma rezervë te jete e vendosur ne shasi dhe te këtë sistemin e ngjitjes mekanik.
Disqet e gomave:	Disqet të jenë standart 11.75x22.5 7 copë
Këmbët e gjysëmrimorkios:	Me ulje dhe ngritje mekanike, standart
Te tjera:	Lyerja e cisternes te jete bereme nje shtrese epoksi, dhe nje shtrese te fundit akrilik. Te jete shume e qëndrueshme kundër efekteve kimike. Ne shasine e mjetit te këtë kasete per mbajtjen e veglave dhe pajisjeve. Te këtë nje deposit per ujë ne mënyrë qe te përdoret nga shoferi. Te këtë kuti te ndihmës se shpejte dhe sinjalistikën portable per difekt ne rruge. Autoboti te jete i pajisur me fikëse zjarri te vogla per tërheqësin dhe fikëse te madhe per cisternën. Ne raste avarie ne rruge, mjeti te kenë ndriçim portable led. <u>Sinjalizime paralajmëruese dhe shkrime</u> Reflektorët ne pjesën e pasme dhe anësore Mbrojtjet e aluminit ne te dy anët. Parakolp prapa alumini Shkalle alumini ne te djathte Afati i dorëzimit: Max. 6 Muaj <u>Garancia: Min. 12 Muaj</u>

Ne momentin e dorëzimit mjetet duhet te kenë:

Dokumentacioni i mjeteve te jete ne emër te autoritetit kontraktor.

Siguracionin TPL, kolaudim dhe taksa të paguara për periudhë 1 vjeçare.

I gjithë dokumentacioni teknik ligjor (përfshirë certifikatat e kontrollit teknik te çisternos, të transportit të mallrave të rrezikshme dhe të ADR-së, pasaportat e çisternove) të jenë të vlefshme në momentin e dorëzimit dhe të jenë në emër të autoritetit kontraktor. Mjetet te jene me logo ne pjesën e pare, anësore dhe atë te pasem me logo (fosforeshente)te autoritetit kontraktor.

Specifikimet teknike të mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 27 Kontratat e mallrave,

3.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën

dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

Nuk është përcaktuar se kush është lëshuesi i garancisë, prodhuesi apo kontraktori.
Nuk është përcaktuar forma e garancisë (e noterizuar apo jo)
Nuk janë përcaktuar se çfarë defektesh mbulon garancia;
Në kundërshtim me këtë nen nuk janë përcaktuar fuqia e kondicionerit,
Nuk janë përcaktuar standarte EU dhe EFTA;
Sistemi Elektrik: Dritat te jene LED:
Nuk janë përcaktuar se kush janë rregullat Europiane,
Nuk janë përcaktuar se cilat janë shenjat paralajmëruese por është lënë vetëm përshkrimi “me gjithë shenjat paralajmëruese në tabela”.
Nuk janë përcaktuar se sa do të jetë numri I fikësve të zjarrit të vogla por vetëm është lënë përshkrimi “Autoboti te jete i pajisur me fikëse zjarri te vogla”;
Është kërkuar: “Sinjalizime paralajmëruese dhe shkrime”, pa I përcaktuar ato
Nuk është përcaktuar Dokumentacioni i mjeteve që duhet te jete ne emër te autoritetit kontraktor.
Mangësitë e konstatuara më sipër çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura, veprime në mos efektivitet të fondeve të prokuruar, **duke ngarkuar me përgjegjësi: z. F. M. me detyrë ish-Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e hartimit të specifikimeve teknike: z. E.GJ me profil ing. Mekanik/QFT Patos, z. V.SH. me profil ing. Mekanik/QFT Patos, z. A.P me profil Ekonomist/Drejt. Prodhimit.**

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 26.4.2021 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

10. Shoqëria “A...H” shpk me ofertë 58,780,000 lekë.

11. Shoqëria “M.....S” shpk me ofertë 59,990,001 lekë.

Me PV nr. 3, datë 13.5.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar dhe nenit 64 VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të PP” i ndryshuar, nga data 26.4.2021 deri datë 4.5.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës.

Sipas këtij PV nga 2 OE pjesëmarrës, KVO ka skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 1 EO, si më poshtë:

Është skualifikuar shoqëria “A....H” shpk, për arsye se:

Nuk disponon katalog teknik cisterna, por vetëm të kokës tërheqëse, duke mos plotësuar kriterin sipas pikës 2.3/d të shtojcës 9 të DST.

Në specifikimet teknike të kokës tërheqëse nuk specifikohet viti i prodhimit 2021, KM + 0, sistemi i frenimit të motorit min 290 kë dhe se motori, kutia shpejtësisë dhe aksi i pasëm të jenë të prodhuara nga i njëjti prodhues.

Ka mospërputhje në vlerën e fuqisë motorike. Sipas dokumentacionit origjinal përcaktohet 460 kf, ndërsa sipas dokumentacionit të përkthyer vlera është 450 kf (sipas DST kërkohet min 430 dhe max 450 kf)

Dokumenti mbi specifikimet teknike të kokës tërheqëse është i përkthyer, por mungon vërtetimi njësisë me origjinalin.

Në përfundim KVO ka vendosur të kualifikojë “M.....S” shpk me ofertë 59,990,001 lekë.

Ankesa

Me shtojcën 20 datë 7.5.2021 (prot ALBPETROL nr. 2970, datë 10.5.2021) shoqëria: “A....H” shpk, ka paraqitur pranë AK Albpetrol sh.a Patos ankesë për skualifikim të padrejtë, duke paraqitur faktet kundërshtues.

Me urdhër 2970/1, datë 10.5.2021, titullari i AK ka urdhëruar që në zbatim të pikës 3 e nenit 63, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar dhe pikave 5,6 të nenit 78, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të PP” i ndryshuar, pezullimin e procedurës deri në shqyrtimin e ankesës nga KSHA i përbërë nga **K.N, A.LL dhe L.S.**

Me vendim datë 14.5.2021, KSHA ka vendosur mos pranimin e ankesës së shoqërisë “A...H” shpk, dhe vijimin e punës nga KVO për shpallje fituesi.

Me shkresën nr. 3097/1, datë 14.5.2021 nga AK i është kthyer përgjigje shoqërisë për mos praninë të kërkesës. Me datë 17.5.2021 shoqëria “A...H” shpk ka paraqitur ankesë pranë KPP për skualifikim të padrejtë.

KPP pas shqyrtimit të ankesës me vendim nr. 413/2021 datë 278.7.2021 ka vendosur:

a- *Pranimin e ankesës së shoqërisë “A...H” shpk.*

b- *Anullimin e vendimit të AK për skualifikim të padrejtë të kësaj shoqërie, duke korrigjuar shkeljet dhe shpallur fitues.*

c- *AK brenda 10 ditë të njoftojë KPP për zbatimin e vendimit.*

Me shkresën nr. 2199/6, datë 20.8.2021 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Me shkresën nr. 2199/7, datë 23.8.2021 është plotësuar formulari i njoftimit fituesit.

Midis shoqërisë “A...H” ShPK dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 2199/9, datë 25.10.2021 për “*Blerje autobote 0-33 m³*” me vlerën 58,780,000 lekë pa TVSh. me afat punimesh 6 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

Nga shoqëri “ALBPEROL” sha për mos dorëzim në afat të mallit sipas kontratës janë llogaritur penaltitetet në vlerën 1,075,032 lekë, vlerë e cila është bërë minus nga vlera e faturave të paraqitura për likuidim.

12- Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Riparim pjesor + pastrim i RVM 5000/8 Zharrës (Q.A.SH.N.G. Patos)*”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ <i>Riparim pjesor + Pastrim i RVM 5000/8 Zharrës (Q.A.SH.N.G. Patos)</i> ”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 10118, datë 13.12.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 10118, datë 13.12.2021	4. Komisioni VO nr. 10118/1, datë 13.12.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “ <i>E hapur me mjete elektronik</i> ”,	F. S. , Përgj. prokurime R.G O.F	B.Ç A.P M. P
5. Fondi Limit (pa TVSh) 18,337,055 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “ <i>A...6</i> ” ShPK me vlerën e ofertës 17,383,255 lekë pa TVSh, me afat 4 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 954 lekë pa TVSh ose 5.2 %.
8. Data e hapjes së tenderit 29.12.2021 REF -14879-12-13-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 2: a- Skualifikuar 1 OE, b- Kualifikuar 1 OE,
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 10118/9, datë 3.3.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 17,383,255 lekë me afat 4 muaj.	

Me shkesën nr. 8145, datë 20.10.2021 të **ing. E.B** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Logjistikës, Koordinimit të Shërbimit dhe Projektimit, adresuar Drejtorisë së Prokurimeve dhe Administratorit **z. F. M.**, është kërkuar që në zbatim të urdhrit nr. 8003, datë 15.10.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektit dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt ‘*Riparim pjesorë dhe pastrim i mbetjeve të RVM 5000/8 në statcioni e shitjes së naftës Zharrës ,Qendra e Administrimit dhe Shitjes së Naftës dhe Gazit, Patos (QASHNG)*”.

Me shkresën nr. 1891/1, datë 12.4.2021 të **z. G.DH** me detyrë Drejtor i QASHNG Patos është kërkuar zbatimi i investimit me objekt *'Riparim pjesorë dhe pastrim i mbetjeve të RVM 5000/8 në stacioni e shitjes së naftës Zharrës*, miratuar kjo në programin e vitit 2021.

Preventivi është hartuar nga specialistët **ing. K.N** dhe **ing. R.G**, bazuar në çmimet sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre", i ndryshuar.

Nga verifikimi i çmimeve sipas manualit, konstatohet se ato janë në zbatim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015, i ndryshuar.

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 "Kontrata e mallrave" dhe neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, të cilat konsiderohen se, në mënyrë direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim, konkretisht:

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ose

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit

Kërkesa **për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim**, është kërkesë e tejkaluar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkaluar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar.

Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5⁴, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 "Për miratimin e rregullave të PP".

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë ku përfshihen.

Punime të përgjithshme ndërtimi

1. NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

Punime speciale ndërtimi:

⁴ Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

2. NS-18 A Punime topogjeodezike

Në lidhje me këtë kriter, duke marrë shkas nga punimet e përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventiv, projekt, specifikimet teknike dhe relacion teknik), rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të mëposhtme, sipas VKM nr.42, datë 16.01.2008.

- **N.P- 12 Punime të inxhinierisë mjedisore** - ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

Nga AK, nuk është argumentuar me volume punimesh dhe me grafik numri i punonjësve (staf teknik + punëtorë) prej **25 punonjës**. NJHDT duhet t'i referohej Kreut III⁵, të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", si dhe në mospërputhje me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punësimit të ndërtimit dhe të analizës teknike të tyre, i ndryshuar.

Për sa sipër ngarkohen me përgjegjësi duke ngarkuar me përgjegjësi: z. F. M. me detyrë ish-Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e NJHDT F. S. , R.G dhe O.F dhe anëtarët e hartimit të specifikimeve teknike Ing. K.N dhe ing. R.G.

Nga subjekti i audituar shoqëria Albpetrol sh.a Patos (personat përgjegjës anëtarët e NJP F. S., R.G dhe O.F), me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023, janë paraqitur kundërshti mbi aktkonstatimin nr. 08, datë 20.4.2023, si më poshtë vijon:

Pretendim i subjektit:

- Lidhur me pretendimin se për kriterin: "2.3.1. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, arsyetojmë se:

Në nenin 39 pika 5 e VKM n.r 285 datë 19/05/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", parashikohet se

"....5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Pra evidentohet qartë që kriteri për përvojën e ngjashme është në përputhje me parashikimet në VKM pasi në kërkesë nuk është tejkualuar kufiri monetar I parashikuar nga legjislacioni i prokurimit

- Lidhur me pretendimin se për kriterin: "2.3.1. Përvojën e suksesshme për punë të ngjashme përveç të tjerave të paraqitet edhe **certifikata e marrjes në dorëzim**...., është kërkesë e tejkualuar pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1-2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin trevjeçar të periudhës së kërkuar", arsyetojmë se:

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim të objektit ndër dokumenteve të tjera që plotësohen, është kërkesë e bazuar në legjislacionin e posaçëm të ndërtimit. Certifikata e marrjes në dorëzim të objektit të përfunduar mund të jetë e përkohshme ose përfundimtare, pas

⁵ "Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 22 mars – 23 tetor me 2(dy) turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3(tri) turne, për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera".

mbarimit të afatit të garancisë. Në çdo rast është pranuar certifikata e marrjes në dorëzim. Kjo nuk ka qenë një kërkesë e paqartë dhe nuk ka përbërë asnjëherë shkak për skualifikimin e OE edhe n.q.s. ata kanë dorëzuar certifikatën e përkohshme të marrje në dorëzim të lëshuar pas aktit të kolaudimit të objektit.

- Lidhur me pretendimin se për kriterin: “Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë ku përfshihen.

NP-12 Punime te inxhinierisë se mjedisit

NS-18 A Punime topogjeodezike,” duke marrë shkas nga punimet e përfshira në dokumentet teknike të procedurës rezulton, se zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të cituara sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, arsyetojmë se:

Lidhur me sa me sipër për pikën e licencës (NP-12 Punime te inxhinierisë se mjedisit) siç vërehet edhe nga zërat e preventivit punimet e parashikuara janë punime teknologjike që kanë të bëjnë me mbetje të konsiderueshme të rezervuara ndër vite, mbetje naftore të cilat janë të domosdoshme të largohen prej aty. Jo vetëm prezenca e tyre, largimi i tyre, prezenca e ndotjes së ajrit, rregullimi i territorit dhe përshtatja e tij për aktivitetin profesional e bën të domosdoshëm prezencën e inxhinierit të mjedisit bashkëshoqëruar me pikën në licencë. Ky vlerësim i yni ka të bëjë jo vetëm për nevojën në praktikë të një specialisti të tillë por dhe përshtatet me pikën e licencës në fjalë në lidhje me territorin.

Lidhur me sa me sipër për pikën e licencës (NS-18 A Punime topogjeodezike) argumentojmë se:

Nuk mund të realizohet asnjë punim ndërtimor apo teknologjik që ka të bëjë me kuota apo punime të tjera nivelimi pa prezencën e specialistit gjeodet. Siç shihet punime të tilla teknologjike që kanë të bëjnë me një domosdoshmëri të saktësisë së aksit të kolonës të brendshme të rezervuarit nuk mund të realizohen pa punime topogjeodezike. Po kështu edhe vendosja në nivel e rezervuarit, në të kundërt pasojat do të ishin të pallogaritshme.

- Lidhur me pretendimin se për kriterin: “Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, licencimet, çertifikimet, Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë inxhinierët Inxhinier Topograf/Gjeodet, Inxhinier Mjedisi,...nuk argumentohen me llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të cituara sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008”, arsyetojmë se:

Sqarojmë se vlen i njëjti argumentim si për pikat e licencës më sipër.

- Lidhur me pretendimin se për kriterin: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar për të paktën **25 (njëzet e pesë)** punonjës për tre muajt e fundit,...nuk argumentohen me volumin dhe grafikun e punimeve....”, arsyetojmë se:

Lidhur me sa më sipër numri prej 25 punonjës të kërkuar përfshirë staf teknik plus punëtorë është në minimumin e vet, duke patur parasysh që vetëm mjete janë 9 nëntë copë, staf teknik i domosdoshëm, inxhinierë plus teknik 5 pesë persona, sadatorë, bojaxhi, mekanik, specialistë ndërtimi 9 nëntë persona. Pa llogaritur këtu administratorin dhe administratën e kompanisë. Ndërkohë proceset e punës kanë të domosdoshëm prezencën e punëtorëve të thjeshtë ndihmës të paspecializuar apo roje dhe magazinierë. Ndaj ne pretendojmë se numri i kërkuar i punonjësve është minimal.

- Lidhur me pretendimin se për kriterin: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1(një) mjek** në bazë të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Veçanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 ” Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar,...rezulton të jetë një kriter i paargumentuar i cili sjell ngushtime të mëtejshme të konkurrencës, duke favorizuar operatorë të caktuar që kanë mjek në listëpagesë”, arsyetojmë se:

Në pikën 2.3.3 Stafit kryesor e mbështetës, punonjësit, licencimet, çertifikimet, germa (e) të DST-ve është kërkuar:

e. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1(një) mjek** në bazë të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Për Masat e Veçanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM Nr.108, datë 9.2.2011 "Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" i ndryshuar.

- Lidhur me pretendimin se "për certifikatën ISO 3834-2:2006 "Për sistemet e menaxhimit të cilësisë së saldimit" si kërkesë e gabuar, sqarojmë se:

Kjo ISO shërben për të treguar se OE përmbushin kërkesat dhe janë të certifikuar për prodhimin e pajisjeve teknologjike me anë të metodës së saldimit dhe për më tepër të pajisjeve nën presion siç është rezervuari metalik. Është domosdoshmëri kualifikimi i lartë dhe garancia për procesin e saldimit. Certifikata e sipërpërmendur është dokumenti i domosdoshëm për këtë garanci. Për sa më sipër kërkesa për paraqitjen e certifikatës iso është në përputhje të plotë me kushtet e procedurës dhe nuk është kërkuar përtej asaj që është e nevojshme.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Për sa është observuar nga subjekti në lidhje me mos argumentimin e disa prej kriterëve, sqarojmë se janë marrë në konsideratë ato që kishin mbështetje ligjore, të cilat nuk gjejnë pasqyrim në këtë Projektraport Auditimi. Ndërsa kriteret e tjera augmentet nuk qëndrojnë dhe gjejnë pasqyrim në këtë Projektraport auditimi, me argumentet e dhënë mësipërm.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 29.12.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

12. OE "SH.....I" shpk , me vlerë oferte në total 14,256,850 lekë (pa TVSH).

13. OE "A....6" shpk , me vlerë oferte në total 17,383,255 leke (pa TVSH).

Me PV nr. 3, datë 14.01.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 29.12.2021 deri datë 14.01.2022 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Në përfundim KVO ka vendosur se nga 2 OE pjesëmarrës është skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 1 OE.

Është skualifikuar shoqëria "SH.....I" shpk për arsyet e mëposhtme:

Oferta e paraqitur rezultoi me gabime aritmetike. Nga korrigjimi i gabimeve aritmetike të preventivit, rezultoi shuma absolute e korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës së paraqitur. Mbështetur në nenin 82 pika 3 të VKM-së Nr. 285, datë 19/05/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", oferta refuzohet . Skualifikimi qëndron sipas KLSH.

Me PV nr. 10118/6, datë 7.01.2022, KVO ka marrë në dorëzim dhe verifikoj dokumentacionin e firmës fitues përpara lidhjes së kontratës, kjo në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 "Për prokurimin publik" dhe të VKM nr. 285, datë 19.5.2021.

Me shkresën nr. 10118/7, datë 15.12.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit (paraparak). Me shkresën nr. 10118/8, datë 27.01.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën. Me shkresën nr. 10118/7, datë 18.01.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit.

Midis shoqërisë "A....6" Shpk dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 10118/9, datë 3.3.2022 për "Riparim pjesor + pastrim i RVM 5000/8 Zharrës (Q.A.SH.N.G. Patos)" me vlerën 17,383,255 lekë pa TVSh. me afat punimesh 4 muaj.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “A...6” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

a- Nuk plotëson kriterin e punimeve të ngjashme, pasi sipas dokumentacionit shoqëria ka paraqitur kontratën me shoqërinë Albpetrol sh.a Patos nr. 11309/11, datë 25.02.2019 me objekt “Rikonstruksion pjesore RVM/7 në Zharrës dhe pastrim i mbeturinave mekanike” me vlerë kontratë 19,023,156 lekë, të lidhur me bashkimin OE “A...6” me 56% të punimeve, “S...I” me 15% dhe “A...A” me 29% të punimeve. Pra nga sa shihet shoqëria “A...6” shpk ka 56% të punimeve ose në vlerën 10,652,967.36 lekë, vlera e cila është më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit prej 11,002,234 lekë (22,004,468 x 50%).

Sipas dokumentacioni nga shoqëria nuk është depozituar **çertifikata e marrjes në dorëzim** të objektit, sipas kërkesës së DT.

b- Nuk është vetëdeklaruar në shtojcën 8, kontrata për punë të ngjashme.

c- Asnjë nga çertifikatat ISO të kërkuara dhe paraqitura nga subjekti nuk dalin aktive të faqen e interneti të shoqërisë që i lëshoni ato.

d- Nga auditimi i shtojcës 8 (vetëdeklarim), konstatohet se disa nga mjetet nuk janë të deklaruar sipas kërkesave të DST, konkretisht:

Nr.	Emiri I mjetit	Deklaron	Mangësia
1	Rrul verbues min 10 ton	Rrul verbues Bitelli S P A 115	Nuk është deklaruar tonazhi
2	Eskavator me zinxhir 0.25 m3	Eskavator me zinxhirë Komatsu PC450LC-8	Nuk është deklaruar sa është kapaciteti mbajtës
	Vinç kulle me krahë min 3 ton	Vinç kulle Liebherr model 32H	Nuk është deklaruar tonazhi
	Gjenerator të paktën 50 kva	Generator FGR70MC	Nuk është përcaktuar fuqia

f- Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi nuk rezulton të jetë paguar muajt i fundit (tetor 2022), ku sipas vërtetimit të debisë thuhet se detyrimi është pa përfshirë muajin tetor 2022, ndërkohë që procedura zhvillohet me datë 29.12.2021.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, **duke ngarkuar me përgjegjësi: z. F. M. me detyrë ish- Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e KVO, respektivisht: B.Ç, A.P dhe M. P.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarët e KVO (B.Ç, M. P A.P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me pretendimin se në formularion e vetëdeklarimit nuk është deklaruar ortakun e shoqërisë, sqarojmë se është deklaruar Astrit Hoxha si administrator. Ndërsa ortakë kjo shoqëri nuk ka.

Në lidhje me mos deklarimin në shtojcën 8 të punimeve të ngjashme, sqarojmë se nga momenti që OE e ka ngarkuar këtë dokument në sistemin SPE është e verifikueshme nga KVO.

Në lidhje me konstatiomin që çertifikatat ISO nuk dalin aktive në faqen e shoqërisë që i lëshon ato, sqarojmë se KVO ka vlerësuar se në sistemin SPE janë deklaruar këto çertifikata.

Në lidhje me konstatimin se disa nga mjetet nuk janë të deklaruar në formulain e vetëdeklarimit shtojca 8, sqarojmë se deklarata e bërë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit që OE i disponon këto mjete, e vërtetuar kjo me nr.shasie ose kontratë qiraje.

Në lidhje me konstatimin se pagesa e energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi nuk deklarohet muajt i fundit (tetor 2022), sqarojmë se në formularin e vetëdeklarimit, OE deklaroi se ka paguar

të gjitha detyrimet e O...E , kjo sipas vërtetimit të depozituar në sistemin SPE. Sipas ekstraktit historik nuk rezulton që oe të kete deyrime ne O...E , kjo vërtetuar me dokumentain (vertetim) që OE "A....6" shpk paraqiti si provë të besieshme.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa është kundërshtuar nga KVO, sqarojmë se vetëm një argument qëndron i cili nuk gjen pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, ajo në lidhje me mosdeklarimin e ortakut në formularin e vetëdeklarimit. Ndërsa mangësitë e tjera qëndrojnë dhe nuk argumentohet nga KVO, pasi bien ndesh me dispizuitat e ligjit nr. 162, date 21.12.2020 "per prokurimin publik", neni 82, pika 5; VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregjillave te prokurimit publik,i ndryshar me vkm nr 710, datë 24.11.2021, neni 26, pika 6 "Mbi paraqitjen e dokumentacionit administrativo ligjor per procedurat e prokurimit".

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- Kopje të vërtetuar të bilancit per vitet ,2019, 2020,2021 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar
- Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2019,2020 ,2021
- Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2021
- Puna e ngjashme per 5 vitet e fundit
- Liçensa profesionale (NP1-NP2...)
- Deklarate per drejtuesin teknik
- Çertifikata ISO

Në lidhje me vërtetimin mbi pagesën e enegjisë elektrike, dokumentacioni i paraqitur nuk është pjesë e dosjes dhe sistemit SEP, pasi shoqëria ka depozituar tjetër si dokument që tregon pagesën e energjisë elektrike.

13- Në tenderin e zhvilluar me objekt "Përmirësim i infrastrukturës së statcionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Përmirësim i infrastrukturës së statcionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos".		
1. Urdhër Prokurimi nr. 2905, datë 13.12.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 2905, datë 13.12.2021	4. Komisioni VO nr. 2905/1, datë 13.12.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur me mjete elektronik",	R.P, Përgj prokurime R.G M. P	I.K L.B F. S.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 59,970,906 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) "Z....I" ShPK me vlerën e ofertës 59,955,454 lekë pa TVSh, me afat 4muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0.025%.
8. Data e hapjes së tenderit 01.6.2021 REF -94891-05-07-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 1: a-Skualifikuar 0 OE, b- Kualifikuar 1 OE,
11. Ankimim PO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K PO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 2905/9, datë 22.6.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 59,955,454lekë me afat 4 muaj.	

Me shkesën nr. 2769, datë30.4.2021 të **ing. E.B me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Logjistikës, Koordinimit të Shërbimit dhe projektimit**, adresuar Drejtorisë së Prokurimeve dhe Administratorit **z. F. M.**, është kërkuar që në zbatim të urdhrin nr. 8003, datë 15.10.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektit dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt 'Përmirësim i infrastrukturës së Statcionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos".

Me shkresën nr. 189, datë 12.4.2021 të z. **G.DH** me detyrë Drejtor i QASHNG Patos është kërkuar zbatimi i investimit me objekt “Përmirësim i infrastrukturës së Stacionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos”, miratuar kjo në programin e vitit 2021.

Preventivi është hartuar nga specialistët **ing. B.Ç dhe ing. R.G**, bazuar në çmimet sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i çmimeve sipas manualit, konstatohet se ato janë në zbatim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015, i ndryshuar.

Me urdhrin e prokurimit nr. 2905, datë 7.5.2021 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 59,970,906 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “E hapur me mjete elektronike” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 2905/1, datë 13.12.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 01.6.2021.

ANKESA.

Me shkresën datë 11.5.2021 (prot “ALBPETROL” nr. 3084, datë 14.5.2021), nga shoqëria “Z...O” shpk dhe me shkresën datë 14.5.2021 (prot “ALBPETROL” nr. 3126, datë 17.5.2021), nga shoqëria “L...O” shpk, janë paraqitur ankesë mbi disa kriteret të aplikuar të cilat janë jo të mirëargumetuara.

Me shkresën nr. 3084/1, datë 18.5.2021 nga AK “ALBETROL” sha është kthyer përgjigje në lidhje me ankesën mbi kriteret nga shoqëria “Z...O” shpk, duke theksuar se ankesa nuk merret në konsideratë, pasi nuk është sipas nenit 112, të ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, **pasi nuk keni paraqitur ankesën në KPP sipas nenit 111 të ligjit të LPP.**

Gjithashtu me të njëjtin argument me shkresën nr. 3126/1, datë 18.5.2021 nga AK “ALBETROL” sha është kthyer përgjigje në lidhje me ankesën mbi kriteret nga shoqëria “L...O” shpk, duke theksuar se ankesa nuk merret në konsideratë, pasi nuk është sipas nenit 112 të ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi nuk keni paraqitur ankesën në KPP sipas nenit 111 të ligjit të LPP.

Nga NjP është mbajtur PV nr. 2905/4, datë 01.6.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 2905, datë 7.5.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 01.6.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Vlerësimi i kriterëve:

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të cilat konsiderohen se, në mënyrë direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT R.P, R.G dhe M. P, konkretisht:**

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

Ose për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/

dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Certifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim, është kërkesë e tejkualuar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar.

Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5⁶, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021.

Sa më sipër kjo kërkesë e pengon OE për të marrë pjesë në garë për një punë për të cilën ende nuk e kanë marrë certifikatën e marrjes në dorëzim.

Per te paktën njërin nga inxhinieret drejtues teknik te paraqitet:

Certifikata për “Ekspert Privat Zjarrfikës” në fushën e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, lëshuar nga drejtorja e PMZSH-së, ose nga shoqëri të akredituara ose organizma ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Kërkesa e AK mbi disponueshmërinë e një ekspert zjarrfikës, shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës, në kuptim të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

OE ofertues duhet të ketë një punësim mesatar për të paktën 35 punonjës për tre muajt e fundit.

Per këtë te paraqitet:

Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për të paktën periudhën e tre muajve të fundit.

Kërkesa sa më sipër nuk është e argumentuar sipas grafikut dhe preventivit të punimeve bazuar në VKM nr.629, date 15.7.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te çmimeve te punimeve te ndërtimit dhe te analizave teknike te tyre", aq më tepër që ky numër nga 80 është ulur në mënyrë të paargumentuar në 55.

Operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet te jenë në përputhje me objektin e prokurimit:

Certifikata EN-ISO 3834-2:2006 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e certifikata ENISO 3834-2:2006”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, Certifikimi i sipërcituar shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën e shkrirjes me saldim. Standarti EN ISO 3834-2 për certifikim ka të bëjë vetëm me burimin dhe cilësinë e produktit që mund të rrjedh nga burimi dhe operimet e ndërlidhura. Standartet janë përdorur si bazë për vlerësimin e cilësisë së saldimit të prodhuesve. Sa më sipër, referuar objektit të prokurimit objekt shqyrtimi, rezulton se nuk jemi në kushtet e blerjes së produkteve të prodhuara me metodën e shkrirjes me saldim, në mënyrë që të kërkohet që prodhuesi i tyre të disponojë certifikimin për standardin EN ISO 3834-2. Në këto kushte, kërkimi nga ana e autoritetit kontraktor për disponimin e certifikatës të sipërcituar, nuk është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor nuk duhet ta vendoste këtë kërkesë.

ISO 1452-1:2009 specifikon karakteristikat e gypave me mur të ngurtë të bërë nga poli(vinilklorid) i paklasifikuar (PVC-U) për sistemet e tubacioneve të destinuara për furnizimin me ujë dhe për

⁶Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi përpërvijën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuar nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera,afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislati në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

kullimin dhe kanalizimet e groposura dhe mbi tokë nën presion. Ai gjithashtu specifikon parametrat e testimi për metodat e testimi të referuara.

Në lidhje me ISO 1452-1 dhe ISO 1452-5, **zbatohet për gypat PVC-U** të ekstraduar pa prizë dhe tubat me prizë (integrale ose jo), të destinuara për t'u përdorur për sa vijon:

- rrytet e ujit dhe shërbimet e groposura në tokë;
- bartja e ujit mbi tokë për ndërtesat e jashtme dhe të brendshme;
- kullimi dhe kanalizimi i groposur dhe mbi tokë nën presion.

Është i zbatueshëm për sistemet e tubacioneve të destinuara për furnizimin me ujë nën presion deri dhe duke përfshirë 25 °C (ujë i ftohtë) i destinuar për konsum njerëzor dhe për qëllime të përgjithshme, si dhe për ujërat e zeza nën presion. Zbatohet gjithashtu për tubacionet për bartjen e ujit dhe ujërave të zeza deri në dhe duke përfshirë 45 °C dhe për një sërë madhësish tubash dhe klasash presioni. Ai jep kërkesa në lidhje me ngjyrat.

Pra kjo ISO është për prodhuesit e tubove.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë ku përfshihen.

Punime të përgjithshme ndërtimi

NP– 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

Në lidhje me këtë kriter, duke marrë shkas nga punimet e përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventiv, projekt, specifikimet teknike dhe relacion teknik), rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të mëposhtme, sipas VKM nr.42, datë 16.01.2008.

- **N.P- 12 Punime të inxhinierisë mjedisore** - ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Për sa sipër ngarkohen me përgjegjësi: me detyrë ish- Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e NJHDT.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarët e NJP (R.P, R.G, M. P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Në shqyrtimin e preventivit të objektit ka të shprehur dhe punime ndërtimore për të cilat është i domosdoshëm prezencja e ing. Ndërtimit. Gjithashtu dhe të ing. Pyjesh. Ndërsa ing. Gjeolog duhet jo vetëm për shtresat e reja, për të cilat është i domosdoshëm tabani ku do kalojë transheja, por dhe për shkak të sigmës të qëndrueshmërisë.

Fakti që ka prezencë mbeturinash naftore të trashëguara, ambientet për të cilat do të bëhet rehabilitimi të shprehura në preventiv dhe në mbjelljen e pemëve e bën të domosdoshëm pikën e licensës së ing. Mjedisit.

Nuk ekziston mundësia e asnjë procesi pine, veçanërisht në ato infrastrukture të realizohet pa topografin, kjo për të realizuar kuotat, akset e rrugëve të kanaleve.

Në lidhje me licensën NS-8A punime metalike, është kërkuar pasi në preventiv ka punime kapriate metalike, kjo e bën të domosdoshëm ing. Mekanik.

Kërkesa për 35 punonjës është në minimumin e vet duke llogaritur numrin e specialistëve.

Gjatë procesit të zbatimit do të kemi të bëjmë me mbetje eterniti, toksitke ndaj është e nevojshme certifikata mbasi grumbullimi dhe largimi në vendepozitim e duhur kërko njohuri, mbasi është material kancerogjen.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa është observuar nga subjekti Albpetrol sh.a Patos Pasot, sqarojmë se nuk ka asnjë dokument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e aktkonstatimi, të cilat **nuk janë marrë në konsideratë nga grupi i KLSH**, duke shpjeguar arsyet në Projektraport Auditim nga grupi u morën në konsideratë ato që kishin mbështetje ligjore, të cilat nuk gjejnë pasqyrim në këtë Projektraport Auditimit. Ndërsa për kriteret e tjera argumenti nuk qëndron dhe jenë pasqyrim në këtë Projektraport auditimi, shpjegimet të cilat janë dhënë mësipërm.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 01.6.2021 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se ka marrë pjesë 1 OE, konkretisht: OE “Z...I” shpk me vlerë oferte në total 59,955,454 lekë (pa TVSH).

Me PV nr. 3, datë 7.6.2021 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 01.6.2021 deri datë 7.6.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës.

Me PV nr. 2905/8, datë 21.6.2021, KVO ka marrë në dorëzim dhe verifikoj dokumentacionin e firmës fituese përpara lidhjes së kontratës, kjo në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.5.2021.

Me shkresën nr. 2905/7, datë 22.6.2021 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Midis shoqërisë “Z...I” Shpk dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 2905/9, datë 22.6.2021 për “Përmirësim i infrastrukturës së Statcionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos” me vlerën 59,955,454 lekë pa TVSh. me afat punimesh 4 muaj. Në vlerësim të grupit të auditimit, pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit në fazën e aktkonstatimeve, vlerësimi i procedurës është në përputhje me dispozitat e LPP.

Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i kushteve të kontratës nr. 2905/9, datë 22.6.2021.

Situata:

Midis shoqërisë “Z...I” Shpk dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 2905/9, datë 22.6.2021 për “Përmirësim i infrastrukturës së Statcionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos” me vlerën 59,955,454 lekë pa TVSh ose vlera 71,946,544.8 lekë pa TVSh, me afat punimesh 4 muaj ose nga **data 22.6.2021 deri me datë 21.10.2021.**

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria Ekonomike në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, konstatohet se nga shoqëria janë likuiduar shuma totale 71,944,212 lekë, konkretisht:

FATURA SUBJEKTI			LIKUJDIMI		Garancia
Nr. Fature	Data	Shuma	Dt/USH	Shuma	
24/2021	15.9.2021	34,089,370	01.10.2021	32,384,901	523,679
17/2021	19.7.2021	27,381,267	20.8.2021	26,012,204	1,704,469
5/2022	15.3.2022	10,473,575	16.6.2022	9,949,896	1,369,063
		71,944,212		68,347,001	3,597,211

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se nga shoqëria janë paraqitur fatura për likuidimin e situacioneve jashtë afatit të zbatimit të kontratës (data 21.10.2021) shuma **10,473,575 lekë**, për të

cilën nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos (personat përgjegjës) nuk janë llogaritur penalitet në referencë të nenit 9⁷ të kontratës, **kjo për 144 dite vonesë.**

Nga sa trajtuam mësipërm shoqëria “Z....I” shpk nuk ka plotësuar kushtet e kontratës për mbylljen e sajë brenda afatit, për të cilën nga personat përgjegjës të shoqërisë “ALBPETROL” sha nuk janë llogaritur penalitet për mos dorëzim malli në afat në vlerën **8,633,585 lekë** (59,955,454 lekë x 25%) = (14,988,863lekë x 4/1000 ditë vonesë x 144 ditë), **vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.**

Kriteri:

Në kundërshtim me nenin 9 të kontratës nr. 2905/9, datë 22.6.2021 për “Përmirësim i infrastrukturës së Statcionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos”, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi:

Komisioni për marrjen në dorëzim të punimeve sipas shkresës Nr 437 Prot datë 21.07.2021, respektivisht: RR.B me detyrë Kryespecialist në Sektorin e Ndjekjes së Kontratave, z. V.N dhe V. H me detyrë specialist në Sektorin e Ndjekjes së Kontratave.

Shoqëria “Z....I” shpk për mos zbatim të kushteve të kontratës.

Ndikimi/Efekti:

Mos zbatimi i kushteve të kontratës, veprime në keq menaxhim të fondeve të prokuruar.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **8,633,585 lekë**, detyrim për kamatëvonesat për mos përfundimin në afat të punimeve nga shoqëria “Z....I” shpk.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Drejtori i Financës znj. A.B, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Përsa ju keni konstatuar ju bëjmë me dije se ne si Drejtori Finance i referohemi dokumentacionit justifikues i cili na sillet për likuidim nga Qendra përkatëse si dhe është i konfirmuar nga Sektori i Ndjekjes dhe zbatimit të kontratave ndërtimore pjese e Drejtorisë së Programimit.

Konkretisht ne kemi në dispozicion Aktin e Kolaudimit ne të cilën shprehet qarte koha e fillimit dhe e mbarimit të punimeve si dhe Çertifikatën e përkohshme të marrjes në Dorëzim të punimeve. Ne akt ka të përcaktuar që nuk ka asnjë ditë penalitet sipas kushteve të kontratës dhe janë zbatuar të gjitha afatet. Gjithashtu ne kërkesën për likuidim nuk ka asnjë dokumentacion tjetër shkresor që të lidhet me punimet me vonesë në objekt. Po kështu po ti referohemi Udhëzimit Nr 3 date 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit në piken 17 të tij përcaktohet “ Se situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi në faza të ndryshme të punimeve kontrollohen nga mbikëqyrësi i punimeve .Pagesa mund të kryhet vetëm në baze të këtij miratimi. Nisur sa me sipër ne si finance nuk mund të bënim llogaritje penalitetesh.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

⁷Dëmet e likuajuara përdorimin e vonuar do të llogariten me tarifën si vijon:

Për çdo ditë vonesë tej afatit për lëvrimin e mallit, kontraktues I është I detyruar ti paguaj AK penalitet në masën 4/1000 të vlerës së mbetur koresponduse pa u zbatuar nga cmimi total I kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% e vlerës së kontratës.

Për sa keni kundërshtuar në lidhje me konstatimin se punimet nuk keni paraqitur asgjë të re nga ato të paraqitura më fazën e aks konstatimeve, si shkresën për mbylljen e punimeve nga subjekti brenda afatit, si dhe argumentin ose faturat janë paraqitur me vonesë siç trajtohet në material.

14- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje kalimatës naftë (flow-metër)”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje kalimatës naftë (flow-metër)”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 10790, datë 30.12.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 10790, datë 30.12.2021	4. Komisioni VO nr. 10790/1, datë 30.12.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur me mjete elektronik”,	F.S, Përgj prokurime D.H E. B	E.B A. V M. P
5. Fondi Limit (pa TVSh) 37,936,920 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “V....S” ShPK me vlerën e ofertës 37,178,181 lekë pa TVSh, me afat 4muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1.9%.
8. Data e hapjes së tenderit 17.01.2022 REF -16770-12-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 5: a-Skualifikuar 3 OE, b- Kualifikuar 2 OE,
11. Ankimim PO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K PO	13. Përgjigje KPP PO
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 10790/9, datë 19.4.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 37,178,181lekë me afat 4 muaj.	

Me vendim nr. 41/1, datë 19.01.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve dhe nr. 25, datë 24.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë “ALBETROL” sha, është miratuar në programin ekonomik të vitit 2021, ndryshuar me nr. 686/1, datë 21.9.2021 procedura me objekt “Blerje 4 copë kalimatës naftë (flow-metër)”, me fond limit 38,400,000 lekë pa TVSh.

Me urdhër nr. 7870, datë 13.10.2021 të ish- Administratorit **z. F. M.** është ngritur grupi i punës për përcaktimin e sasive, hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit, nga anëtarët **z. D.H me profil ing. Kimist QASHNG Patos, zj. E.Z me profil ing. Mekanik në QASHNG Patos, zj. A.D me profil ing. Kimist në QASHNG Patos, z. A.P me profil Ekonomist në Drejtorinë e Prokurimeve dhe z. E. B me profil Ekonomist në Drejtorinë e Prokurimeve.**

Me PV nr. 7870/3, datë 9.12.2021 nga anëtarët **z. A.P me profil Ekonomist në Drejtorinë e Prokurimeve dhe z. E. B me profil Ekonomist në Drejtorinë e Prokurimeve** është mundësuar llogaritja e fondit limit në vlerën 37,936,920 lekë, kjo në referencë të nenit 76, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021.

Me urdhrin e prokurimit nr. 10790, datë 7.5.2021 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 37,936,920 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “E hapur me mjete elektronike” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 10790/1, datë 30.12.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 17.01.2022.

Nga NjP është mbajtur PV nr. 10790/2, datë 30.12.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 10790, datë 7.5.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 17.01.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- Vlerësimi i kriterëve:

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 17.01.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 5 OE, konkretisht:

14. OE "V...S" shpk me vlerë oferte në total 37,178,181 lekë (pa TVSH).
15. OE "N...T" shpk me vlerë oferte në total 32,400,000 lekë (pa TVSH).
16. OE "L...O" shpk me vlerë oferte në total 37,367,866 lekë (pa TVSH).
17. OE "F...C" shpk me vlerë oferte në total 37,520,000 lekë (pa TVSH).
18. OE "S...O" shpk me vlerë oferte në total 37,886,188 lekë (pa TVSH).

Me PV nr. 3, datë 7.6.2021 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 17.01.2022 deri datë 01.2.2022 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Sipas këtij PV nga 5 OE pjesëmarrës, KVO ka skualifikuar 2 OE me ofertë më të leverdishme dhe kualifikuar 4 OE, konkretisht:

Janë skualifikuar:

1- Shoqëria "N...T" shpk me vlerë oferte në total 32,400,000 lekë (pa TVSH), pasi:

- Nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme.
- Në katalogun e paraqitur nuk specifikohen densiteti dhe viskoziteti i fluidit (naftë bruto) sipas kërkesave të DST.

2- Shoqëria "F...C" shpk me vlerë oferte në total 37,520,000 lekë (pa TVSH), pasi:

- Nuk paraqet autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar.
- Nuk paraqet katalogun/broshurë teknike nga prodhuesi, të përkthyer dhe noterizuar.
- Nuk paraqet vërtetim ose kontratë pune apo çdo dokument mbi vërtetësinë e pajisjes së të paktën një ing. Elektronik dhe mekanik.
- Nuk paraqet ISO 9001/2015

3- Shoqëria "S...O" shpk me vlerë oferte në total 37,886,188 lekë (pa TVSH), pasi

- Nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme.
- Sipas katalogut nuk plotëson të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Në zbatim të nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, me konsensus KVO ka kualifikuar 2 OE nga 5 OE pjesëmarrës, duke klasifikuar në vend të parë shoqërinë "V...S" shpk me vlerë oferte në total 37,178,181 lekë (pa TVSH) me ofertë më të leverdishme se OE tjetër i mbetur në garë shoqëria "L...O" shpk me vlerë oferte në total 37,367,866 lekë (pa TVSH).

Me PV nr. 10790/6, datë 21.6.2021, KVO ka marrë në dorëzim dhe verifikoj dokumentacionin e firmës fituese përpara lidhjes së kontratës, kjo në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 "Për prokurimin publik" dhe të VKM nr. 285, datë 19.5.2021.

Me shkresën nr. 1079/7, datë 4.2.2022 është plotësuar formular njoftim fituesi.

Shpallur në buletin e APP nr. 19, datë 14.2.2022.

Me vendim nr. 166/2022prot, datë 15.2.2022 të KPP është vendosur:

Përfundimin e procedimit administrativ të procedurë me REF-...-12-30-2021 me objekt "Blerje kalimatës naftë" me fond limit 37,936,920 lekë nga AK "ALBPETRO" sha.

Kryerjen e veprimeve nga zyra e financës për derdhjen në buxhet të tarifës financiare të paguar nga shoqëria "N...T" shpk.

Sipas këtij vendimi sqarojmë se:

Me datë 31.12.2021 në SPE është publikuar procedura e hapur REF-...-12-30-2021 me objekt "Blerje kalimatës naftë" me fond limit 37,936,920 lekë.

Me datë 17.01.2022 AK ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Me datë 01.2.2022 OE pjesëmarrës janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar.

Me datë 7.2.2022 AK ka publikuar njoftim fituesin në SPE.

Me datë 7.2.2022 nga shoqëria "N...T" shpk është bërë ankesë në KPP, për skualifikim të padrejtë. Me shkresën datë 14.2.2022 (prot ALBPETROL nr. 228/3, datë 14.2.2022), shoqëria "N...T" shpk është tërhequr nga ankimi.

Në këto kushte në referim të nenin 117, të ligjit nr. 162/2022 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 105 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", KPP gjykon se tërheqja e shoqërisë nga ankesa është e drejtë dhe **nuk merret në shqyrtim pretendimet e tij.**

Me shkresën nr. 1079/8, datë 21.2.2022 është plotësuar formular njoftim fituesi.

Shpallur në buletin e APP nr. 26, datë 28.2.2022

Me shkresën nr. 10790/9, datë 21.2.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Midis shoqërisë "V...S" ShPK dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 10790/10, datë 19.4.2022 për "Blerje kalimatës naftë (flow-metër)" me vlerën 37,178,181 lekë pa TVSh. me afat punimesh 4 muaj.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria "V...S" shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK dhe është vlerësuar saktë nga KVO.

Titulli gjetjes: Mos zbatimi i kushteve të kontratës nr. 10790/10, datë 19.4.2022.

Situata:

Nga auditimi i procedurës me objekt "Blerje kalimatës naftë (flow-metër)", me fond limit 37,936,920 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria "V...S" me vlerë kontrata pa tvsh 37,178,181 lekë, rezulton se nuk janë zbatuar kushtet e kontratës nr. 1079/9, datë 19.4.2022 të lidhur midis shoqërisë "V...S" shpk dhe Autoritetit Kontraktor shoqërisë Albpetrol sha për përfundimin e punimeve brenda afatit 4 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës ose **nga data 19.4.2022 deri me datë 19.8.2022.**

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Financës në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, konstatohet se deri në datën e hartimit të këtij akti është paraqitur për likuidim vlera 44,613,816 lekë, nga e cila likuiduar në masën 80% sipas pikës 3.2 të nenit 3 të kontratës në vlerën 35,691,053 lekë dhe nuk është likuiduar akoma vlera prej 8,922,763 lekë ose 20% e kontratës po sipas nenit 3 të kontratës, pika 3.2, **pasi 20% do likujdohet pasi pajisja të jetë instaluar në vend.**

Mallrat janë bërë hyrje në magazinë në magazinën e QFT Patos, kjo sipas pikës 4.8/a të nenit 4 të kontratës, konstatuar kjo dhe nga komisioni i marrjes në dorëzim me PV nr. 472/2, datë 16.9.2022, sipas urdhrit datë 20.4.2022.

Konstatohet se nuk është bërë instalimi i kalimatasve, vënia në punë dhe realizimi i asistencë teknike, **siç përcaktohet në pikën 4.3 të nenit 4 të kontratës me 180 ditë vonesë**, ku megjithëse nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos është kërkuar me urgjencë për shitjen e naftës sipas kërkesave të doganës, akoma edhe sot qëndrojnë të pamontuara në magazinë dhe të pa vënë në punë, duke bërë që nafta të matet me sasi/ton, duke e klasifikuar këtë shpenzim një shpenzim paefektivitet për shoqërinë me **fond 37,936 mijë lekë nga mosvënia në punë e kalimatasve për të cilën është realizuar procedura e prokurimit.**

Nga sa trajtuam kontrata nuk ka përfunduar sipas kushteve të përcaktuara në nenin 9 të kontratës, brenda periudhës 4 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës së bashku me shtesën e kontratës ose **nga data 19.4.2022 deri me datë 31.8.2022, pasi mallrat qëndrojnë akoma në magazinë pa u vënë në funksion për të cilën shoqëria "ALBPETROL" sha ka kryer shpenzimin.**

Kështu për vlerën 8,922,763 lekë, që korrespondon 20% të vlerës së kontratës e cila nuk është zbatuar, penaliteti përlllogaritet në vlerën **1,606,096 lekë** ($8,922,763 \text{ lekë} \times 25\% = 2,230,690 \times 4/1000 \times 180 \text{ ditë vonesë}$), **veprime me efekt negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.**

Gjithashtu konstatojmë se pavarësisht faktit se nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 6774 prot, datë 24.9.2020 dhe shkresës së Drejtorisë së Doganës Fier nr. 2399 prot, datë 7.6.2021 i është kërkuar shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për pajisjen e pikave fundore të shitjes së naftës bruto me paisje për matjen (kaliamtës), nga shoqëria Albpetrol sha megjithëse procedura është zhvilluar dhe lidhur kontrata me subjektin fitues “V....S” shpk, **nuk është bërë i mundur vënia në punë e këtyre aparaturave sipas kushteve të kontratës ose nga data 23.8.2022**, megjithëse këto paisje janë bërë hyrje në magazinë, duke e bërë këtë një shpenzim jo me efektivitet dhe që pengon procesin e shitjes së naftës.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi:

Administratorit E. D. me detyrë Administrator i Albpetrol sh.a Patos.

z. E.B me detyrë Drejtor i QASHNG Patos për mos marrjen e masave në periudhën në vijim për vënien në punë të kalimatësve.

z. S.K, me detyrë ish- Drejtor i QASHNG Patos për mos zbatim të kontratës deri në përfundim të sajë sipas afateve të kontratës.

Komisioni i marrjes në dorëzim për mos identifikim të vonesave i përbërë nga z/zj. E.Ç, E.Z, A.Z, L.I dhe A.C.

Shoqëria “V....S” shpk për mos dorëzim malli në afat dhe mbylljen e procesit teknologjik.

Kriteri:

Në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 10790/10, datë 19.4.2022 për realizimin e blerjes me objekt “Blerje Kalimatës naftë (flow-metër)” dhe nenin 20 të ligjit nr. 61/2012 “Për AKCIZAT në RSH”, i ndryshuar.

Ndikim/Efekti:

Mos zbatimi i kushteve të kontratës çon në keqmenaxhim të fondeve në përdorim pa efektivitet të tyre.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.sa të ngrejë një grup pune dhe të analizojë përgjegjësinë e personave përgjegjës në mos zbatimin e kushteve të kontratës me objekt “Blerje Kalimatës naftë (flow-metër)”, ku për personat përgjegjës të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën **1,606,096 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

Të marra masa të menjëhershme për vënien në punë të kalimatasve sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e zbatimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Drejtori i QASHNG z. E.B, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Në AK nr. 14, me nr. 11/19, datë 20.4.2023, por dhe në pjesën takuse në Projektraport, ju i jeni referuar periudhës 01.01.2021-31.12.2022, ku theksohet se nuk është vënë në punë e aparaturave sipas kushteve të kontratës nga data 19.4.2022 – 23.8.2022. unë si Drejtor i QASHNG jam emëruar në këtë post me vendim nr. 121, datë 2.3.2023 dhe po ashtu keni mbajtur qëndrim se “nuk ka specifikuar se kush ka mbuluar atë”, sqarojë se në atë periudhë ka qenë drejtor në atë periudhë gjatë kohë së zbatimit të kontratës z. S.K.

Nga përshkrimi i mbajtur thuhet se “edhe sot kur unë jam drejtor”, kalimatësit janë në magazinë dhe nuk janë vënë në objekt, kjo në kundërshtim me AK nr. 14, datë 20.4.2023, ku ju i referoheni periudhës 01.01.201-31.12.2022., në të cilën më keni ngarkuar me përgjegjësi. Ndërsa në Projektraport thoni se nuk largon nga përgjegjësia se nuk janë vendosur kalimatësit.

Nga ana juaj nuk është marrë kontakt me mua si drejtor, mbi situatën e ndodhur dhe se çfarë masash mund kem marrë nga momenti i marrjes së detyrës, duke sqaruar se:

Siç është theksuar dhe nga ana juaj, afati për zbatimin e kontratës është 4 muaj, pra si mundet që unë i emëruar rishtazi të mund të realizojë zbatimin e kontratës për një periudhë kohore 1 muaj, ku vetëm njohja me problematikën, verifikimet, inspektimet, rakordimet për të cilat duhen të kishin kohën e nevojshme për marrjen e masave për ekzekutimin e kontratës. Megjithatë nga ana ime kam ndjekur dhe organizuar nisjen dhe vazhdimin për kryerjen e punimeve të domosdoshme teknologjike, ku shoqëria fituese i është vënë në dispozicion i gjithë sheshi i ndërtimit (informuar zyrtarisht duke inspektuar dhe 4 stacionet e shitjes), i cili ka përgjegjësinë për plotësimin e kushteve të kontratës dhe vazhdimin e montimit.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Për sa është argumentuar në lidhje me mos përfundimin e kontratës sipas afateve të caktuara nga shoqëria VITBIS shpk, **sqarojë se ato nuk merren në konsideratë**, për faktin se:

Së pari, Në lidhje me konstatimin tuaj se ju jeni emëruar si drejtor në një periudhë të mëvonshme se zbatimi i kontratës, sqarojmë se nga ana jona janë trajtuar të dy periudhat dhe përudha kur duhej përfunduar kontrata por dhe periudha deri në momentin e përfundimit të punës auditues në subjekti (terreni), që korrespondon me periudhën e emërimit tuaj, ku evidentohet se kalimatësit janë në magazinë dhe jo në objekt.

Së dyti, në lidhje me mos kontaktin me ju nga ana jonë si grupi auditimi është bërë njoftimi tek peroni kontaktit për njoftim dhe nuk është përgjegjësia jonë nëse ju nuk jeni venë në dijeni.

Së treti, në lidhje me faktin se kishin një periudhë të shkurtë emëruar si drejtor dhe vetë ngarkesa e pozicionit e bën të pamundur zbatimin e saj kur ajo nuk është zbatuar për 4 muaj, sqarojmë se nga ana juaj duheshin marrë masa për fillin e punës (lirimin e sheshit), procedura e cila në observacion shpreheni se ka përfunduar, **por procesi i punës akoma nuk është mbyllur pasi kalimatësit nuk janë vendosur nga subjekti megjithëse sheshi është i lirë**. Pra nga ana juaj si drejtor por dhe administratorit duhet detyruar shoqëria në zbatimin përfundimit të kontratës dhe vënien në punë të kalimatësve për proces për të cilën është kryer shpenzim mjaft i domosdoshëm për shitjen e produktit të naftës nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos.

15- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 4722, datë 22.6.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 4722, datë 22.6.2022 F. S. , Përgj prokurime E.L E.B	4. Komisioni VO nr. 4722/1, datë 22.6.2022 A.V V. H M.P
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur me mjete elektronik”,		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 20,883,330 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “S...L U.....TRI”, “A.....G”, “S...L Life U.....TRI”, “S.....UP”, “E...G” me vlerën e ofertës 20,465,200 lekë pa TVSh, me afat 90 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 417 lekë pa TVSh ose 1.9 %.
8. Data e hapjes së tenderit 8.7.2022 REF -33788-06-22-2022	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 1: a-Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 1 OE
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4722/9, datë 01.8.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 20,465,200lekë me afat 12 muaj	

Me urdhër të ish- Administratorit **zj. A. H.** nr. 3361, datë 26.4.2022 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e numrit të punonjësve, hartimin e termave të referencës/specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt: “*Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë*”. Grupi i punës është: **z. E.L** me profil Drejt. i Burimeve Njerëzore, **zj. K.L** me profil ing. Naftë, Drejt e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurimit teknik, **z. J.S** me profil Kryeinspektor i Kontrollit Shëndetësore, QEMNG Patos, **zj. O.F** me profil ing. Gjeologe, Drejt Prokurimit (Sek. llogaritjes së fondit limit) dhe **z. E,B** me profil Ekonomist Drejt Prokurimit (Sek. llogaritjes së fondit limit).

Nga ana e komisionit dhe konkretisht të anëtarëve **zj. O.F** me profil ing. Gjeologe, Drejt Prokurimit (Sek. llogaritjes së fondit limit) dhe **z. E,B** me profil Ekonomist Drejt Prokurimit (Sek. llogaritjes së fondit limit), në zbatim të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e PP” janë testuar të tre variantet që parashikon dispozita ligjore, si:

Është kërkuar me e-mail informacion tek INSTAT, por që nuk është kthyer përgjigje.

Janë marrë ofertat e tre OE që operojnë në këtë fushe, duke caktuar një mesatare të fondit limit prej 20,883,330 lekë kjo për 1400 punonjës sipas kategorive të përcaktuara në specifikimet teknike.

Është marrë në analiza dhe kontrata e mëparshme me shoqërinë “ALPETROL” sha, nr. 1401/11, datë 19.04.2021.

Në përfundim komisioni ka vendosur të marrë për bazë testimin e tregut pasi paraqet një vlerë më të ulët.

Titulli gjetjes: Mos llogaritja e saktë e fondit limit.

Situata:

Nga auditimi i procedurës me objekt “*Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2022*”, rezulton se fondi limit është përcaktuar në vlerën 22,330,000 lekë për sigurimin e 1400 punonjësve sipas pozicioneve të punës, duke mos i përcaktuar sipas vështirësive të punës në terren.

Gjithashtu nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore por dhe nga observacioni i paraqitur nga z. E.L me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore me shkresën nr. 11/103, datë 28.4.2023, në lidhje me numrin e punonjësve të siguruar sipas pozicioneve të renditura për vështirësi dhe sigurim jetë, ky numër nuk është 1400 pozicione **por është 1338 pozicione.**

Nga të dhënat evidentohet fakti se numri i punonjësve për të cilën është kërkuar të sigurohen është më i lartë për **62 punonjës** $\{(1400 - 1338) \times 14,917 \text{ primë sigurimi}\}$, duke rënduar padrejtësisht fondin limit për vlerën **928,388 lekë, veprime me efekt financiar negativ shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: z. E.L** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Kriteri:

Në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Ndikimi/Efekti:

Mos llogaritja e saktë e fondit limit, çon në rëndim të fondeve buxhetore dhe përdorim pa efikasitet të tyre.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë *Albpetrol sh.a Patos* të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës për llogaritje jo të saktë të fondit limit të procedurës me objekt “*Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2022*”, duke rënduar padrejtësisht për vlerën **928,388 lekë.**

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 15, datë 20.4.2023, nga subjekti i audituar shoqëria Albpetrol sh.a Patos është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 (nga anëtarët e NJP: O.F dhe E,B), si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me konstatimin e grupit të KLSH për mos llogaritje të saktë të fondit limit, sqarojmë se në zbatim të urdhrin nr. 3361, datë 26.4.2022 të administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos kemi qenë të ngarkua për llogaritjes e fondit, pasi nga Drejtoria e Burimeve njerëzore të jetë paraqitur numëri i punonjësve të siguruar. Mbasi ky numër është dhënë nga kjo drejtori, nga ana jonë është llogaritur fondi limit duke testuar tregon dhe kontratat e ngjashme, mbi bazën e së cilës është përcaktuar fondi 20 milionë lekë. Në këto kushte ne nuk jemi për gjegjës për numrin e punonjësve të siguruar.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa është observuar nga subjekti Albpetrol sh.a Patos nga grupi u morën në konsideratë fakti se mbi përgjegjësinë e cila i kalon **z. E.L** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuan kriterë jo në përputhje me kushtet zhvillimit të procedurës dhe zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për Prokurimin Publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht, konkretisht:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Lista e pozicioneve të punës në shoqërinë "Albpetrol" sh.a, me risk të lartë të dëmtimit të shëndetit dhe aksidenteve në punë.*

Operator te remontit nëntokësor, ndihmës operator te remontit, sondist, traktorist remonti.

Elektracist te fushës ose terrenit

Saldator, Drejtues Mjetesh Transporti Mallrash si dhe drejtuesit e mjeteve. Manovratorë Mjetesh, vinçier, skrepist, buldozerist, e te ngjashëm.

Punonjësit e stacioneve Kuçovë,Zharrëz,Gorisht, Usoje, Visoke, Stacioni i Gazit Fier.

Te gjithë punonjësit e avarisë ne QEMNG.

Reparti i fonderisë, kovaçhanës, prodhimit te detaleve prej gome.

Brigada e likuidimet te avarive elektrike dhe ajo e linjave elektrike si dhe brigada e mjedisit.

Përgjegjës Turni, Operator Prodhimi, Ndihmës Operator Prodhimi, Operator Studimi, Dekantimi e të ngjashëm..

Fugist,Tornitor, Axhustator, Xhenerik, Mekanik Fushe dhe Mekanik Mjetesh.

Stafi inxhiniero-teknik

Dega e Monitorimit te Brendshëm

Kontrolloret e pajisjeve te naftës, pranë qendrave te prodhimit

Në këtë liste duhej të ishte dhënë edhe numrin e punonjësve sipas pozicioneve dhe duhej të bëhen një ndarje e pozicioneve të punës, duke i vlerësuar sipas rëndësisë së tyre, pasi jo të gjithë punonjësit kanë të njëjtën vështirësi dhe rrezikshmëri sipas profileve që ato punojnë.

Për samësipër ngarkohen me përgjegjësi: me detyrë ish- Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe z. E.L me profil Drejt. i Burimeve Njerëzore, z. J.S me profil Kryeinspektor i Kontrollit Shëndetësore, QEMNG Patos.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarë i NJP zj.K.L, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Unë kam qenë në grupin e punës dhe nuk janë vendosur nga ana ime kriteret. Titullati i AK në zbatim të nenit 21 të LPP, ka nxjerrë urdhrin nr. 3361, datë 26.4.2022. në zbatim të pikës 3 të këtij urdhri detyra ime si anëtarë ka qenë hartimi i termave të referencës/specifikimeve teknike me nr. 3361/1prot, datë 27.4.2022 dhe jo lista dhe numëri i punonjësve me rrezikshmëri të lartë në vendin e punës, për të cilën kryhet ky shërbim.

Në lidhje me specifikimet teknike ku nga KLSH-ja citohet se duhet të ishte dhënë edhe numëri i punonjësve, nuk gjendet tek termat e referencës. Në zbatim të urdhrin të titullarit të AK, lista me profesione me rrezikshmëri të lartë në vendin e punës dhe numrin i punonjësve të cilët ju përmendi ka qenë detyrë e z. E.L në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, referuar kjo pikë 2 të urdhrin.. në këto kushte kërkoj largim tim nga përgjegjësia.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Për sa është argumentuar nga anëtarë i NJP zj. K.L është bërë sqarim mbi mos pasjen përgjegjësi, pasi nuk ka qenë personi i ngarkuar për kriteret e evidentuar nga KLSH si mangësi, por përgjegjësi e z. E.L në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore. Merret në konsideratë vetëm mos pasja përgjegjësi.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 8.7.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë një bashkim OE, konkretisht “S...L U.....TRI”, “A.....G”, “S...L Life U.....TRI”, “S.....UP”, “E...G”, me ofertë ekonomike 20,465,200 lekë pa TVSh.

Me PV nr. 3, datë 12.7.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 8.7.2022 deri datë 12.7.2022 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Në përfundim KVO ka vendosur se bashkim OE, konkretisht “S...L U.....TRI”, “A.....G”, “S...L Life U.....TRI”, “S.....UP”, “E...G”, me ofertë ekonomike 20,465,200 lekë pa TVSh.

Me PV nr. 4722/6, datë 15.7.2022, KVO ka marrë në dorëzim dhe verifikoj dokumentacionin e firmës fitues përpara lidhjes së kontratës, kjo në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.5.2021.

Me shkresën nr. 4722/7, datë 15.7.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit (paraparak). Shpallur në buletin e APP nr. 102, datë 25.7.2022.

Me shkresën nr. 4722/8, datë 19.7.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Midis shoqërisë “S...L U.....TRI”, “A.....G”, “S...L Life U.....TRI”, “S.....UP”, “E...G” dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 4722/9, datë 01.8.2022 për “Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë” me vlerën 20,465,200 lekë pa TVSh. me afat punimesh 12 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i OE ‘S...L U.....TRI’, ‘A.....G’, ‘S...L Life U.....TRI’, ‘S.....UP’, ‘E...G’ shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, pasi shoqëria “S.....UP” nuk ka plotësuar saktë shtojcën 8 (vetëdeklarim), konkretisht:

g- Në shtojcën 8 nuk është plotësuar pika B. Deklarata për nënkontraktori dhe subjektet e të cilave do të mbështete OE.

h- Në pjesën II- *Shkaqet e përjashtimit pika A-Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit*, nga shoqëria kuadrati i tretë nuk është plotësuar saktë, pasi nuk janë evidentuar emrat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe Aksionerët, si më poshtë:

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të padeklaruar: S. R., L. H., Ch. R., J. P., P. F. H. dhe Sh. N.
Aksionerët: R. D., E. P., Q. D., L. P, Sh. N.

Nga kompania janë deklaruar vetëm administratorët.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “*Parimet e përzgjedhjeje*”, neni 98, “*Anulimi i një procedure*”, neni 76 “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, neni 92, “*Shqyrtimi i ofertave*”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, neni 67, “*Klasifikimi i ofertave*”, neni 83, “*Njoftimi i fituesit*”, **duke ngarkuar me përgjegjësi: me detyrë ish- Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e KVO, respektivisht: A. V, ing. Mekanik, V. H, Ekonomist dhe M. P, Juriste.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (*prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023*), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarët e KVO (V.M, A. V, M. P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

OE ka paraqitur formularin përmbledhës sipas kërkesave të AK, ku secili nga pjesëmarrësit si BOE të paraqesë formularin të veçantë të vetëdeklarim.

OE ka paraqitur formulari përmbledhës të vetëdeklarim sipas kërkesave të AK duke deklaruar në këtë formularë emrat e administratorëve K.Ç, E.R dh A.P të cilët janë kryesorët dhe kanë fuqi përfaqësues.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit, konkullojmë se nuk është paraqitur asnjë e re nga ato të paraqitura në fazën e aktkonstatimeve. Për sa është observuar nga subjekti Albpetrol sh.a Patos nga grupi nuk u morë në konsideratë pasi nuk sqaron situatën e konstatuar nga grupi për vlerësim të gabuar, ashtu siç dhe ju vetë thoni në pikën (a) të observacionit ku secili nga pjesëmarrësit si BOE të paraqesë formularin të veçantë të vetëdeklarim.

15.1- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 1401, datë 24.2.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 1401, datë 24.2.2021, <i>Përgj prokurime (me shkresën nr. 1401/4, dt. 23.3.2021 zëvendësuar me zj. R.P)</i>	4. Komisioni VO nr. 1401/1, datë 24.2.2021 F.A S.M R.P zëvendësuar nga zj. M. P me shkresën nr. 1401/5, dt. 23.3.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur me mjete elektronik”,	D.SH F.S	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 22,330,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “S...L U.....TRI”, “A.....G”, S....D, “E...G” me vlerën e ofertës 21,700,000 lekë pa TVSh, me afat 12MUAJ.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 630 lekë pa TVSh ose 2.8 %.
8. Data e hapjes së tenderit 23.3.2021 REF -88204—02-24-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 1: a-Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 1 OE
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1401/11 datë 19.4.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 21,700,000lekë me afat 12 muaj	

Me urdhër të ish- Administratorit **z. B. Z.** nr. 871, datë 4.2.2021 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e numrit të punonjësve, hartimin e termave të referencës/specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt: “*Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë*”. Grupi i punës është: **z. D.SH** me profil *K/Specialist Drejt/ Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurimit Teknik*, **zj. E.Ç** me profil *Specialist Drejt/Burimeve Njerëzore*, **z. J.S** me profil *Kryeinspektor i Kontrollit Shëndetësore, QEMNG Patos*, **zj. O.F** me profil *ing. Gjeologe, Drejt Prokurimit (Sek. llogaritjes së fondit limit)* dhe **z. A.P** me profil *Ekonomist Drejt Prokurimit (Sek. llogaritjes së fondit limit)*.

Nga ana e komisionit dhe konkretisht të anëtarëve **zj. O.F** me profil *ing. Gjeologe, Drejt Prokurimit (Sek. llogaritjes së fondit limit)* dhe **z. A.P** me profil *Ekonomist Drejt Prokurimit (Sek. llogaritjes së fondit limit)*, në zbatim të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e PP” janë testuar të tre variantet që parashikon dispozita ligjore, si:

Është kërkuar me e-mail informacion tek INSTAT, por që nuk është kthyer përgjigje.

Janë marrë ofertat e tre OE që operojnë në këtë fushë, duke caktuar një mesatare të fondit limit prej 22,330,000 lekë kjo për 1400 punonjës sipas kategorive të përcaktuara në specifikimet teknike.

Në përfundim komisioni ka vendosur të marrë për bazë testimin e tregut pasi paraqet një vlerë më të ulët.

Titulli gjetjes: *Mos llogaritja e saktë e fondit limit.*

Situata:

Nga auditimi i procedurës me objekt “*Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2021*”, rezulton se fondi limit është përcaktuar në vlerën 22,330,000 lekë për sigurimin e 1400 punonjësve sipas pozicioneve të punës, duke mos i përcaktuar sipas vështirësive të punës në terren.

Referuar sa mësipërm fondi limit prej 22,330,000 lekë është planifikuar për sigurimin e 1400 punonjësve sipas pozicioneve të punës, duke mos i përcaktuar sipas vështirësive të punës në terren. Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në lidhje me numrin e punonjësve të siguruar sipas pozicioneve të renditura për vështirësi dhe sigurim jetë, ky numër nuk është 1400 pozicione por është 1388 pozicione, konkretisht si vijon:

Operator te remontit nëntokësor, ndihmës operator te remontit, sondist, traktorist remonti, janë 75 punonjës.

Elektricitet te fushës ose terrenit, janë 43 punonjës.

Saldator, janë 24 punonjës.

Drejtuues Mjetesh Transporti Mallrash si dhe drejtuesit e mjeteve janë 72 punonjës.

Manovratorë Mjetesh, vinçier, skrepist, buldozerist, e te ngjashëm janë 40 punonjës.

Punonjësit e stacioneve Kuçovë ,Zharrëz, Gorisht, Usoje, Visoke, Stacioni i Gazit Fier janë 77 punonjës.

Punonjësit e avarisë ne QEMNG janë 30 punonjës.

Reparti i fonderisë, kovacanes, prodhimit te detaleve prej gome janë 13 punonjës.

Brigada e likujdimit te avarive elektrike dhe ajo e linjave elektrike si dhe brigada e mjedisit janë 99 punonjës.

Përgjegjës Turni, Operator Prodhimi, Ndihmës Operator Prodhimi, Operator Studimi, janë 486 punonjës Dekantimi e të ngjashëm.

Fugist, Tornitor, Axhustator, Xhenerik, Mekanik Fushe dhe Mekanik Mjetesh janë 219 punonjës.

Stafi inxhiniero-teknik janë 174 punonjës.

Dega e Monitorimit te Brendshëm janë 18 punonjës.

Kontrolloret e pajisjeve te naftës, pranë qendrave te prodhimit janë 18 punonjës.

Nga të dhënat evidentohet fakti se numri i punonjësve për të cilën është kërkuar të sigurohen është më i lartë për **12 punonjës** (1400 – 1388) x 15,950 primë sigurimi), duke rënduar padrejtësisht

fondin limit për vlerën **191,400 lekë, veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.**

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: z. D.SH me profil Drejt/ Burimeve Njerëzore, **zj. E.Ç** me profil ing. Naftë, Drejt e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurimit teknik, **z. J.S** me profil Kryeinspektor i Kontrollit Shëndetësore, QEMNG Patos.

Kriteri:

Në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Ndikimi/Efekti:

Mos llogaritja e saktë e fondit limit, çon në rëndim të fondeve buxhetore dhe përdorim pa efikasitet të tyre.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga peronat përgjegjës.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë *Albpetrol sh.a Patos* të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës për llogaritje jo të saktë të fondit limit të procedurës me objekt “*Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2021*”, duke rënduar padrejtësisht për vlerën **191,400 lekë.**

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të cilat konsiderohen se, në mënyrë direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim, *konkretisht:*

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Lista e pozicioneve të punës në shoqërinë "Albpetrol" sh.a, me risk të lartë të dëmtimit të shëndetit dhe aksidenteve në punë.*

Operator te remontit nëntokësor, ndihmës operator te remontit, sondist, traktorist remonti.

Elektracist te fushës ose terrenit.

Saldator.

Drejtues Mjetesh Transporti Mallrash si dhe drejtuesit e mjeteve.

Manovratorë Mjetesh, vinçier, skrepist, buldozerist, e te ngjashëm.

Punonjësit e stacioneve Kuçovë ,Zharrëz, Gorisht, Usoje, Visoke, Stacioni i Gazit Fier.

Te gjithëpunonjësit e avarisë ne QEMNG.

Reparti i fonderisë, kovacanes, prodhimit te detaleve prej gome.

Brigada e likuidimit te avarive elektrike dhe ajo e linjave elektrike si dhe brigada e mjedisit.

Përgjegjës Turni, Operator Prodhimi, Ndihmës Operator Prodhimi, Operator Studimi, Dekantimi e të ngjashëm.

Fugist, Tornitor, Axhustator, Xhenerik, Mekanik Fushe dhe Mekanik Mjetesh.

Stafi inxhiniero-teknik.

Dega e Monitorimit te Brendshem.

Kontrolloret e pajisjeve te naftës, pranë qendrave te prodhimit.

Në këtë liste duhej të kishte dhënë edhe numrin e punonjësve sipas pozicioneve dhe se duhej të bëhen një ndarje e pozicioneve të punës, duke i vlerësuar sipas rëndësisë së tyre, pasi jo të gjithë punonjësit kanë të njëjtën vështirësi dhe rrezikshmëri sipas profileve që ato punojnë.

Në pikën 2.3-*Për kapacitet teknike*, në pikën (b) është kërkuar një punësim mesatar 10 persona. Një kërkesë e tillë është e paargumentuar për vetë natyrën e procedurës, pasi është një shërbim për të cilën nuk kërkohen prezenca e fuqisë punëtore.

Për samësipër ngarkohen me përgjegjësi: zj. E.Ç me profil ing. Naftë, Drejt e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurimit teknik, z. J.S me profil Kryeinspektor i Kontrollit Shëndetësorë, QEMNG Patos, zj. O.F me profil ing. Gjeologe, Drejt Prokurimit (Sek. llogaritjes së fondit limit).

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 23.3.2021 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë një bashkim OE, konkretisht “S...L U.....TRI”, “A.....G”, “S.....D”, “E...G”, me ofertë ekonomike 21,700,000 lekë pa TVSh.

Me PV nr. 3, datë 26.3.2021 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, nga data 23.3.2021 deri datë 26.3.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës.

Në përfundim KVO ka vendosur se bashkim OE, konkretisht “S...L U.....TRI”, “A.....G”, “S.....D”, “E...G”, me ofertë ekonomike 21,700,000 lekë pa TVSh.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “S...L U.....TRI”, “A.....G”, “S.....D”, “E...G” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

i- Nga shoqëritë pjesëmarrjes si bashkim OE nuk kanë paraqitur vërtetimin mbi taksën vendore në vendet e ushtrimit të aktivitet sipas QKB, si më poshtë:

Shoqëria “E...G” nuk paraqet vërtetim në bashkitë: Durrës, Fushë Arrëz, Ersekë, Prrenjas, Devoll, Peqin, Rrëshen, Gramsh, Librazhd, Burrel dhe Kavajë.

Shoqëria “A.....G” nuk paraqet vërtetim në bashkitë: Pogradec, Durrës dhe Pukë.

Shoqëria “S.....D” nuk paraqet vërtetim në bashkitë: Durrës, Korçë dhe Shkodër. Gjithashtu nga kjo shoqëria për bashkitë e tjera nuk janë paraqitur vërtetime, por mandat pagesa ose urdhër pagesa, e cila nuk kërkohet në DST, pasi në DST kërkohet vërtetim mbi pagesën e taksave.

j- Në lidhje me plotësimin e kriterit sipas **pikës 3.3/c** “*Operatori Ekonomik duhet që të paraqesë një marrëveshje të notëzuar me një prej spitaleve /klinikave mjekësore të licencuar që marrin përsipër kryerjen e kontrollit mjekësor, me afat të marrëveshjes i cili përfshin edhe afatin e ekzekutimit të kësaj kontrate. Gjithashtu të paraqitet dokumentacioni përkatës që provon licencimin e spitalit/klinikës që merr përsipër kryerjen e kontrollit mjekësor*”. Nga auditimi konstatohet se nga shoqëritë pjesëmarrjes si bashkim OE janë paraqitur marrëveshje të cilat janë jashtë afatit të zbatimit të kontratës. Gjithashtu disa prej marrëveshje janë lidhur me klinika mjekësore të cilat nuk plotësojnë kërkesat e paraqitura në specifikimet teknike për ekzaminimet që kërkohen. Asnjë nga spitalet apo klinikat me të cilat janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi nuk është paraqitur dokumentacioni ligjorë që provon licencimin dhe merr përsipër kontrollin mjekësor.

Shoqëria “E...G” ka akt-marrëveshje me Klinikën F....A nr. 15011/1288, datë 01.3.2021 dhe afat njëvjeçar.

Shoqëria “A.....G” ka akt-marrëveshje me Spitalin “C.....L” nr. 1219/19, datë 22.7.2016, jashtë afatit të zhvillimit të procedurës.

Shoqëria S.....D ka akt-marrëveshje me Klinikën F....A nr. 365/65, datë 9.2.2015, jashtë afatit të zhvillimit të procedurës

Shoqëria “S...L U.....TRI” ka akt-marrëveshje me Spitalin “C.....L” nr. ---, datë 01.01.2020, jashtë afatit të zhvillimit të procedurës.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë

19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, **duke ngarkuar me përgjegjësi: me detyrë ish- Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e KVO, respektivisht: F.A, S.M dhe zj. M. P.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarët e KVO (S.M, M. P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me mos paraqitjen e taksave vendore, sqarojmë se në ndarjen e bashkësigurimit të riskut OE lidër “S...L U.....TRI” sha, që mbulon 64.3%, nëse do kish mangesa në vërtetime do ishte shkak për kualifikim. OE e tjerë kanë paraqitur vërtetim mbi taksat vendore.

Në lidhje me konstatimin sipas pikës 3.3/c “Operatori Ekonomik duhet që të paraqesë një marrëveshje të noterizuar me një prej spitaleve /klinikave mjekësore të licencuar që marrin përsipër kryerjen e kontrollit mjekësor, me afat të marrëveshjes i cili përfshin edhe afatin e ekzekutimit të kësaj kontrate. Gjithashtu të paraqitet dokumentacioni përkatës që provon licencimin e spitalit/klinikës që merr përsipër kryerjen e kontrollit mjekësor”, sqarojmë se shoqëria “E...G” ka paraqitur kontrata bashkëpunimi me shoqërinë F...A shpk, klinikë mjekësore “Pro Life”, ku në nenin 4 të kontratës thuhet se: kjo kontrata lidhet për një periudhë një vjecare me të drejtë ripërsëritjke.

Qëndrimi i grupit të KLSH.

Për sa është argumentuar nga anëtarët e KVO, pretendimet nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë, pasi ato nuk shpjegojnë ato cka është konstatuar nga grupi i KLSH.

16- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi për ruajtjen e pronës”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi për ruajtjen e pronës”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 9757, datë 02.12.2021		4. Komisioni VO nr. 9757/1, datë 02.12.2021 I.K O.C, (Me shkresën nr. 9757/6, datë 6.01.2022 nga ish- Administratori z. F. M. është zëvendësuar anëtari i KVO znj. O.C me znj. A.GJ, me arsyetimin se është me Covid. Me urdhër nr. 9757/7, datë 7.01.2022 është bërë zëvendësimi i znj A.GJ me z. A.P, me pretendimin se është në kushtet e konfliktit të interesit me shoqërinë “M.....Y” E.B
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar me mjete elektronik”.	3. Njësia e Prokurimit nr. 9757, datë 02.12.2021 F. S. SH.B M. P	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 61,234,732 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “M.....Y” + F.....M ShPK me vlerën e ofertës 61,024,693 lekë pa TVSh, me afat 12 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 99.6%.
8. Data e hapjes së tenderit 15.01.2022 REF -13762-12-02-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 1: a-Skualifikuar 0 OE, b- Kualifikuar 1 OE,
11. Ankimim PO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K PO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 9757/13, datë 24.01.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 9,187,380 lekë me afat 12 muaj.	

Me urdhër të ish- Titullarit të AK z. F. M nr. 9111 prot, datë 16.11.2021 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e numrit të vendrojave, hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe të fondit limit. Për këtë është ngarkuar Drejtoria e Administrimit dhe ruajtjes së pronës.

Me shkresën nr. 9128 prot, datë 17.11.2021 nga z. A.A me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pronës janë hartuar specifikimet teknike. Me shkresën nr. 9129 prot, datë 17.11.2021 termat e referencës dhe me shkresën nr. 9208 prot, datë 18.1.2021 vlera e fondit limit. për ruajtjen e objekteve viti 2021, duke përllogaritur numrin e vendrojave dhe të fondit limit.

Sipas shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në zbatim të VKM nr. 1025, datë 16.12.2020 “për pagën minimale” është përcaktuar fondi limit në shumën 61,234,732 lekë pa TVSh.

Me urdhrin e prokurimit nr. 9757, datë 02.12.2021 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 61,234,732 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 9757/1, datë 02.12.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 15.01.2022.

Nga NjP është mbajtur PV nr. 9757/2, datë 02.12.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 9757, datë 7.5.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 15.01.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në auditimin e dokumentacionit në dosjen e subjektit, sugjerimeve të APP dhe kundërshtive të subjektit, rezulton se kriteret janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarët e NJP (F.S, R.P, E.V, A.P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me kriter që pasqyrat financiar të mos shoqërohen me akt ekspertizë financiare, sqarojmë se procedura është zhvilluar me ligjin e vjetër dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, thuhej se për të provuar kapacitet financiar, AK kërkon kopje të certifikuar të një ose më shumë bilanceve...

Në lidhje me konstatimin për punë të ngjashme ku thuhet në një vlerë jo më e vogël se 40%, sqarojmë se në zbatim të pikës 4 të nenit 27 të VKM nr. 914, datë 29.1.2014, i ndryshuar, thuhet se ...në çdo rast vlera e kërkuar duhet jo më e madhe se 40%.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Nga grupi i KLSH, pasi shqyrtojë observacionet e subjektit, kunkudon se argumentet qëndrojnë dhe merren në konsideratë.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 5.01.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht bashkimi i OE “M.....Y” + F.....M me ofertë ekonomike 61,024,693 lekë ose 99.6% e fondit.

Me PV nr. 3, datë 13.01.2021 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 15.01.2022 deri datë 13.01.2022 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Sipas KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit ka vlerësuar se bashkimi i OE “M.....Y” + F.....M shpk, plotëson kushtet për kualifikim dhe shpallje fitues me ofertë 61,024,693 lekë.

Me PV nr. 9757/9, datë 17.01.2022 është bërë marrja në dorëzim i dokumentacionit të firmës fituese.

Me shkresën nr. 9757/10, datë 17.01.2022 është plotësuar formulari i njoftimit fituesit për lotin e I^{re} me ofertë 61,024,693 lekë, I cili është shpallur në buletin e APP nr. 8, datë 24.01.2022.

Me shkresën nr. 9757/11, datë 20.01.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Midis bashkimi i OE “M....Y” + F....M Shpk dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata shërbimi nr. 9757/13, datë 24.01.2022 për “Shërbimi për ruajtjen e pronës” me vlerën 61,024,693 lekë pa TVSh. me afat punimesh 12 muaj.

Autoriteti Kontraktor nuk ka siguruar riskun e mos realizimit të shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike të objekteve e aseteve të shoqërisë.

Kontrata e sipërcituar nuk është formuluar sipas parakushteve të paracaktuar në nenin 18 “Kontrata ndërmjet palëve” të ligjit nr.75/2014 “Për Shërbimin privat të sigurisë fizike”, udhëzimit nr. 130, datë 05.03.2018, “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, Kreu V, Menaxhimi i shërbimeve të SHPSF-së, -Organizimi dhe drejtimi i SHPSF-së, që sanksionon që:

2.Kontrata ndërmjet palëve për kryerjen e shërbimeve nga SHPSF-të përmban: a) Nënkatëgorinë e licencës, drejtuesin teknik dhe objektin konkret në ruajtje. b) Mënyrën e ruajtjes së objektit, duke specifikuar llojin e shërbimit (me punonjës shërbimi, me pajisje sinjalizuese alarmi, me kamera sigurie, me qen, me kombinim të mënyrave të mësipërme etj.). c) Numrin e vendrojave kur objekti ruhet me roje dhe numrin e punonjësve të shërbimit, duke llogaritur 40 orë punë në javë ose koeficienti 1.66 për një punonjës shërbimi, si dhe skemat e ruajtjes së objektit. d) Rregulloren e brendshme të institucionit/ subjektit ku të përcaktohen rregullat për regjimin e hyrje/daljeve në objekt, ndriçimin, rrethimin dhe mjetet vëzhguese e sinjalizuese. e) **Trajtimin financiar të punonjësit të shërbimit të SHPSF-së, duke përcaktuar detyrimin që paga të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Pagesa bëhet me bankë.** f) Skemën e ruajtjes së objekteve, së bashku me planin e dislokimit, kur merren në ruajtje objekte. Skema e ruajtjes dhe plani i dislokimit përgatiten nga drejtuesi teknik i SHPSF-së. g) Llojin e armatimit, pajisjet, mjetet e shërbimit, uniformën, simbolet dhe shenjat dalluese. h) Detyrimet financiare midis tyre, në raste të shkaktit të dëmit. i) Detyrat dhe të drejtat e palëve. j) Kohëzgjatjen e kontratës dhe mënyrat e zgjidhjes së saj.

Për sa është trajtuar në akt-konstatimi nr. 20, datë 20.4.2023, nga subjekti i audituar shoqëria Albpetrol sh.a Patos është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 (nga KVO I.K, E.B dhe A.P), si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

- Për sa i përket konstatimit tuaj se, në formularin e vetdeklarimit bashkimi i operatorëve ekonomik, M...Y dhe F.P.M sipas shtojcës nr. 9 nuk e kanë plotësuar saktë, pasi nuk ka deklaruar emër e mbiemër te personit të cilit do të vendosë ne dispozicion, **sqarojmë se:**

Referuar kërkesave për kualifikim te DST, konkretisht shtojcës nr.9, nga ana e AK ne pikën B te kësaj shtojce, nuk është kërkuara që deklaruesi të deklarojë me emër e mbiemër personelin që do të vendosë ne dispozicion, por është kërkuar vetëm që ai të deklarojë numrin e punonjësve dhe profilin e tyre.

Nga ana e OE është plotësuar kjo rubrike duke deklaruar numrin e punonjësve, ndërsa për profilin e tyre është cilësuar se këta punonjës shërbimi janë certifikuar nga Drejtoria Vendore e Policisë për nënkategorinë 1.3.A. Po ashtu, dhe dokumentacioni për çdo punonjës i cili zotëron këtë certifikatë dhe që do të vendoset në dispozicion është ngarkuar në SPE si dokumente më vete. Në këto kushte vlerësimi i KVO është bërë ne përputhje me kërkesat për kualifikim të DST.

- Në lidhje me konstatimin tuaj se shoqëria M...Y, nuk plotëson kriterin e punimeve të ngjashme, duke deklaruar një vlerë me pak të ngjashme për shumën 12,865,625 lekë, **sqarojmë se:**

Në pikën 2.3.1 të kërkesave për kualifikim të DST është kërkuar “... furnizime të mëparshme të ngjashme ne një vlerë jo më të vogël se 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së kontratës...”

OE M...Y referuar kontratës së bashkëpunimit e ka përqindjen e pjesëmarrjes 87.5%, dhe rrjedhimisht është operatori i cili duhet ta plotësojë kushtin e shërbimeve të mëparshme të

ngjashme ne masën 40%, ndërsa OE, F...M duhet ta plotësojë këtë kriter, në përputhje me përqindjen e tij në këtë bashkim operatorësh.

Kontratat e paraqitura nga OE M...Y, të cilat i keni përmendur në këtë akt konstatimi, konkretisht Kontrata nr.413/11, datë 12.11.2019 me shoqërinë UK Lushnje me vlerë 21,320,703 lekë me dhe Kontrata nr.469, datë 25.07.2019 me shoqërinë UK Fier me vlerë 30,11,140 lekë, janë në një vlerë shumë herë më të madhe se sa masa 40% e kërkuar ne DST për shërbime të të mëparshme të ngjashme.

Llogaritja e bërë nga ana juaj në këtë akt konstatim, është në rastin kur kërkohen shërbime të mëparshme të ngjashme në masën 100% të vlerës së fondit limit që prokurohet, ndërkohë që siç përmendem edhe më sipër, por edhe për çdo procedurë prokurimi "Shërbimi", kushti është që OE duhet të provojë se ka shërbime të ngjashme është në masën 40 % të fondit limit që prokurohet dhe këto të realizuara në tre vitet e fundit.

- Ne lidhje me konstatimin se OE, F.P.M nuk plotëson piken 2.3.3 të DST në lidhje me vërtetimin e performancës, pasi sipas kësaj kresës kërkohen 80 punonjës shërbimi të certifikuar nga të cilët jo më pak se 45 punonjës shërbimi sipas vërtetimit të lëshuar nga DVP Fier, jo me pak se 20 punonjës shërbimi sipas vërtetimit të lëshuar nga DVP Vlorë dhe jo me pak se 15 punonjës shërbimi sipas vërtetimit të lëshuar nga DVP Berat, pasi nga shoqëria është paraqitur vërtetimi nr.5654/1 datë 16.12.2021 nga Drejtoria e policisë Vlorë, ku numri i punonjësve të shërbimit nuk është 80 por është 70. Ky vërtetim është lëshuar vetëm nga DVP Vlorë dhe jo nga DVP Fier dhe DVP Berat,

sqarojmë se:

Në Kushtet e Përgjithshme të Kualifikimit të DST, AK ka përcaktuar se:

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomike, do të paraqitet:

Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet OE, ku të caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim dhe elementet që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Referuar Kontratës së Bashkëpunimit të paraqitur nga këta OE, nr. Repertori 5741, nr.kol.1849, datë 31.12.2021, palët kanë rënë dakord që përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e kësaj kontrate do të jetë:

M...Y 87.5%

F.....M 12.5%, po ashtu në faqen e dytë të kontratës, palët kanë përcaktuar konkretisht edhe shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë në vendroje, që secili operatorë do të mbulojë.

Sipas kësaj ndarje, rezulton se OE, F.....M do të kryejë shërbimin e roje me vendroje vetëm në QPN Gorisht, pra vetëm në qarkun Vlorë, dhe konkretisht ne Sektorin Amonice dhe ne Sektorin e shërbimeve dhe ofiçinës në Vllahinë, të dyja këto objekte ndeshen në Qendrën e prodhimit të Naftës Gorisht, Vlorë.

Pra referuar këtij përcaktimi që palët kanë bërë në kontratë, OE, F.....M do të ofrojë shërbimin e ruajtjes së pronës vetëm në Qarkun Vlorë, dhe jo në Qarqet Fier dhe Berat dhe si rrjedhojë nuk ka si të paraqesë vërtetim performancë nga Drejtoritë Vendore të Policisë për këto qarqe, pasi këto dokumente i ka paraqitur OE M...Y, i cili do të mbulojë të treja qarqet me vendroje.

Për sa i përket numrit të punonjësve të OE, F.....M, ai duhet të ketë numrin e punonjësve në përputhje me përqindjen që ka në këtë bashkim, përqindje e cila është 12.5%, dhe vetëm për shërbimin që do të mbulojë ne Qarkun Vlorë, për ato vendroje që ka përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit.

- Për sa i përket konstatimit tuaj se OE M...Y ka paraqitur vërtetim performancë vetëm nga DVP Fier dhe nuk ka paraqitur nga DVP Vlore dhe Berat, **sqarojmë se:**

Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë në datë 16.12.2021, i ka dërguar OE M...Y, Vërtetimin e Performancës, sipas këtij vërtetimi numri i punonjësve të kësaj shoqërie ne këtë qark është shumë më i madh se ai i kërkuar në DST.

Po ashtu, edhe Drejtoria Vendore e Policisë Berat me shkresën 4945/1, datë 22.12.2021 i ka dërguar OE M...Y vërtetimin e performancës, sipas këtij vërtetimi numri i punonjësve të kësaj shoqërie ne këtë qark është shumë më i madh se ai i kërkuar në DST.

- Për sa i përket konstatimit se, nga shoqëria F.....M nuk plotësohet pika 2.2.2 e DST, ku shoqëria duhet të paraqesë pasqyrat financiare për vitet 2018, 2019 dhe 2020 të shoqëruar me akt ekspertizë e ekspertit kontabël të autorizuar...., **sqarojmë se:**

Shoqëria F.....M sh.p.k, nuk ka detyrimin ligjor të paraqesë pasqyrat financiare të shoqëruara në ekspertizë nga eksperti kontabël i autorizuar, kjo bazuar në përcaktimet që bën neni 41 i ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar me ligjin 10297, datë 8.7.2010 dhe me ligjin 47/2016.

Referuar pasqyrave financiare që ka paraqitur shoqëria F.....M shpk, ajo plotëson vetëm kriterin e numrit të punonjësve, ndërsa dy kriteret e tjera nuk i plotëson, si rrjedhojë nuk ka detyrim ligjor të kryejnë auditim ligjor të pasqyrave financiare.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa është observuar nga punonjësit e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, ne lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për vlerësim të gabuar të OE fitues, **sqarojmë se ato qëndrojnë dhe procedura është në përputhje me dispozitat e LPP në vlerësim.**

17- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje tubo pompe kompresori 31/2 TS, 27/8 TS”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje tubo pompe kompresori 3^{1/2} TS, 2^{7/8} TS.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 8008, datë 15.10.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 8008, datë 15.10.2021	4. Komisioni VO nr. 8008/1, datë 15.10.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur me mjete elektronik”,	F. S. , Përgj prokurime E.DH E.B	I.K S.Z M. P
5. Fondi Limit (pa TVSh) 24,825,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “S....B” ShPK me vlerën e ofertës 22,125,000 lekë pa TVSh, me afat 90 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,700 lekë pa TVSh ose 10.8 %.
8. Data e hapjes së tenderit 02.11.2021 REF -08444-10-15-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 3: a- Skualifikuar 2 OE b- Kualifikuar 1 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 8008/9, datë 2.12.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 22,125,000 lekë me afat 90 ditë	

Me urdhër nr. 7587, datë 6.10.2021 nga titullari i AK **z. F. M.** është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit dhe të specifikimeve teknike të procedurës me objekt: “Blerje tubo pompe kompresori 31/2 TS, 27/8 TS”, i përbërë nga **E.DH me profil ing. nafte, Drejt/ Prodhimit, z. I.Ç me profil ing. Nafte, Drejt/Prodhimit, z. A.P me profil ekonomist, Drejt/ Prokurimit dhe z. E. B me profil ekonomist, Drejt/Prokurimit.**

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 19, datë 20.4.2023, nga subjekti i audituar shoqëria Albpetrol sh.a Patos është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 (nga anëtarët e NJP A.P dhe E.B) si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Ne programin e vitit 2021 është parashikuar fondi 10,372,908 leke pa tvsh me objekt blerje “Tubo naftësjellësi”. Bazuar vendimin e Këshillit Mbikëqyrës me shkresën Nr 9 ,date 17.09.2021, i protokolluar ne Albpetrol Nr.6578/3 date 17.09.2021, është marre vendimin per rialokimin e fondeve per zërin me objekt prokurimi “Blere tubo naftësjellësi”. Ky vendim nga Këshilli Mbikëqyrës është marre per arsye se ka qene nje suate e veçantë e krijuar ne treg ku cmimet e çelikut ne atë periudhe kohe kane patur ndryshime te larta dhe te shpeshta. Situata ne atë kohe ka qene e pazakontë per arsye te pandemisë COVID-19, çmimit te larte te gazoilit ne treg, çmimi I

shtrënjtuar i energjisë elektrike, mungesa e produkteve në treg, u rriten çmimet e transportit dhe për pasojë këto rritje reflektuan mbi të gjitha çmimet me bazë çeliku. Kjo situatë ka qenë fakt në të gjithë botën dhe për këto arsye të cilat u përmenden më lartë është marrë vendimi për rialokim fondesh nga Këshilli Mbikëqyrës i Albpetrol sh.a Patos. Vlen të theksojë se çmimet e çelikut janë në bursë dhe ndryshojnë shpesh, bashkëngjitur keni çmimin e një burse ku tregon se në periudhën kur është përlllogaritja e fondit në tetor-dhjetor 2021 çmimi i çelikut ka kapërcyer në çmime shumë të larta.

Këshilli Mbikëqyrës duke ditur rëndësinë e këtyre artikujve për industrinë naftës, si dhe duke parë faktorët e sipërpërmendur me shkresën Nr 9, datë 17.09.2021 bëri rialokim fondesh për "Tubo naftës-jellësi" nga 10,372,908 leke është ndryshuar në vlerën prej 17,928,680 leke pa tvsh.

...Grupi i punës për të bërë një përlllogaritje sa më reale dhe sa më të drejtë për kushtet e tregut dhe për të krijuar mundësi pjesëmarrje sa më shumë operatoreve ekonomik, në zbatim të nenit 76 të VKM-se 285 datë 19/05/2021, ka kryer përlllogaritjen e fondit limit duke argumentuar dhe dokumentuar çdo pikë të nenit të sipërcituar, duke e argumentuar në proces verbalin Nr.10750 datë 30.12.2021 të përlllogaritjes së fondit limit.

Sa i përket respektimit të pikës "b" jemi bazuar në rregullat e tregut, kemi kryer studimin e tregut bazuar në rregullat e tregut nëpërmjet marrjes së ofertave për të njohur nivelin e tregut aktual dhe për të marrë një çmim sa më real të tregut. Kemi kontaktuar direkt (fizikisht) ose me email me subjektet që operojnë në treg për këto artikuj. (argumentimi është bashkëlidhur në PV).

Sa i përket respektimit të pikës "c" e kemi argumentuar në PV, kontratën e ngjashme të vitit 2020, procedurë që është zhvilluar që në vitin 2019 por kontrata është lidhur në 5.03.2020 nuk e morëm në konsideratë në përlllogaritjen e fondit limit, pasi siç e theksuam më sipër ka një vendim bordi për rialokim fondi, si dhe një situatë e veçantë e krijuar në treg, ku u rriten çmimet e transportit, çmimet e karburantit, çmimet e bazës materiale etj, në këtë situatë nuk mund të marrim në konsideratë kontratën e ngjashme, çmimi i Gazoilit sipas buletinit nr.8 datë 2.03.2020 është 474 \$/Ton periudhë që i përket kohës së kontratës së vjetër, ndërsa çmimi i Gazoilit sipas buletinit nr.187 datë 28.12.2021 është 646 \$/Ton pra është një rritje e konsiderueshme e çmimit të gazoilit që ndikon drejtpërdrejtë në çmimet e rritjes së tregut.

...Grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit i është referuar studimit dhe testimit të tregut duke marrë mesataren midis tre ofertave të marra rishtazi nga studimi dhe testimi i tregut duke bërë të mundur përlllogaritjen paraprake të fondit limit sa më optimal për nxitjen e konkurrencës për procedurën e prokurimit që do të zhvillohet.

Qëndrim i grupit të KLSH

Nga sa është observuar nga subjekti në lidhje me konstatimin e grupit të KLSH për mos llogaritje të saktë të fondit limit, argumentet e paraqitura merren në konsideratë.

Vlerësimi i kriterëve:

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuar kriterë në përputhje me kushtet zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 "Për prokurimin publik", si dhe neni 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Zhvillimi procedurës.

Me PV nr. 2, datë 02.11.2021 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

19. Shoqëria "S....B" shpk me ofertë 22,125,000 lekë.
20. Shoqëria "E.GJ" shpk pa ofertë ekonomike.
21. Shoqëria "V....S" shpk dhe ofertë 23,083,905 lekë.

Me PV nr. 3, datë 9.11.2021 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 02.11.2021 deri datë 9.11.2021.

Në përfundim KVO ka vendosur se nga 3 OE pjesëmarrës është skualifikuar 2 OE dhe kualifikuar 1 OE.

Janë skualifikuar:

1- Shoqëria "E.GJ" shpk pa ofertë ekonomik.

2- Shoqëria "V....S" shpk dhe ofertë 23,083,905 lekë, pasi nuk ka paraqitur akt-ekspertizë të ekspertit kontabël dhe kopje të pasqyrave financiare viti 2020, në kundërshtim me pikën 2.2.2 te DST.

Nga KVO është kualifikuar për plotësim të kriteresh shoqëria "S....B" shpk me ofertë 22,125,000 lekë, me ofertë më të leverdishme.

Me shkresën nr. 8008/6, datë 11.11.2021 është plotësuar formulari i njoftimit fituesit. Shpallur në buletin e APP nr. 163, datë 15.11.2021.

Me shkresën nr. 8008/7, datë 19.11.2021 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Me PV nr. 8008/8, datë 23.11.2021, KVO ka marrë në dorëzim dhe verifikoj dokumentacionin e firmës fitues përpara lidhjes së kontratës.

Midis shoqërisë "S....B" Shpk dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 8008/9, datë 02.12.2021 për "Blerje tubo pompe kompresori 31/2 TS, 27/8 TS" me vlerën 22,125,000lekë pa TVSh. me afat punimesh 90 ditë nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria "S....B" shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE dhe nga observacioni i paraqitur nga shoqëria Albetrol sh.a me nr. 11/123, datë 28.4.2023, vlerësimi i procedurës është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi plotësojnë kriteret e DST.

18- Në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje tubo naftësjellësi", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Blerje tubo pompë kompresori.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 10792, datë 30.12.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 10792, datë 30.12.2021	4. Komisioni VO nr. 10792/1, datë 30.12.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur me mjete elektronik",	F. S. , Përgj prokurime E.DH O.F	E.B V.M M. P
5. Fondi Limit (pa TVSh) 17,797,600 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) "A....O" ShPK me vlerën e ofertës 15,602,808 lekë pa TVSh, me afat 60 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,195 lekë pa TVSh ose 12.3 %.
8. Data e hapjes së tenderit 17.01.2022 REF -16818-12-30-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 6: a- Skualifikuar 4 OE b- Kualifikuar 2 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 10792/9, datë 15.3.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 15,602,808 lekë me afat 60 ditë	

Me urdhër nr. 7994, datë 15.10.2021 nga titullari i AK **z. F. M.** është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit dhe të specifikimeve teknike të procedurës me objekt: "Blerje tubo naftësjellësi", i përbërë nga **E.DH me profil ing. nafte, Drejt/ Prodhimit, z. LL. R me profil ing. Nafte, Drejt/Prodhimit, z. A.P me profil ekonomist, Drejt/ Prokurimit dhe z. E. B me profil ekonomist, Drejt/Prokurimit.**

Me PV nr. 10750, datë 30.12.2021 të hartuar nga grupi i punës (z. A.P dhe E.B) është bërë llogaritja e fondit limit, i miratuar me vendim nr. 41/1, datë 19.01.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit dhe nr. 25, datë 24.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar në programin

ekonomik të vitit 2021, i ndryshuar me nr. 686/Iprot, datë 21.9.2021 është në shumën 17,928,680 lekë pa TVSh.

- **Vlerësimi i kritereve:**

Në auditimin e kritereve të vendosura janë konstatuan kritere në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 17.01.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 6 OE, konkretisht:

22. OE “A....N” shpk me vlere oferte ne total 14,850,944 lekë pa TVSH.

23. OE “A....O” shpk me vlere oferte ne total 15,602,808 lekë pa TVSH.

24. OE “S....B” shpk me vlere oferte ne total 16,252,000 lekë pa TVSH.

25. OE V...S shpk me vlere oferte ne total 17,263,618.5 lekë pa TVSH.

26. OE “F shpk me vlere oferte ne total 17,489,949 lekë pa TVSH.

27. OE “LL....O shpk me vlere oferte ne total 17,708,475 lekë pa TVSH.

Me PV nr. 3, datë 4.2.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 17.01.2022 deri datë 4.2.2022. Në përfundim KVO ka vendosur se nga 6 OE pjesëmarrës është skualifikuar 4 OE dhe kualifikuar 2 OE.

Janë skualifikuar:

1- OE “A....N” shpk me vlere oferte ne total 14,850,944 lekë pa TVSH, për arsyet e mëposhtme:

Nuk ka paraqitur furnizime te mëparshme te ngjashme me objektin e prokurimit, ne kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.1. te DST-se.

Nuk ka paraqitur ISO 9001:2015 te vlefshme, ISO e paraqitur ka skaduar me date 11/04/2019, ne kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.4. te DST-se.

Konstatimi: Nga verifikimi mbi skualifikimin e këtij OE, rezulton se nga shoqëria është paraqitur certifikata ISO 9001:2015, siç kërkohet në DST.

Ndërsa në lidhje me kontratat e ngjashme konstatimi është i saktë.

2- OE “S....B” shpk me vlere oferte ne total 16,252,000 lekë pa TVSH, për arsyet e mëposhtme:

Nga verifikimi i ofertës së paraqitur, rezultoi se oferta e operatorit është me gabime aritmetike. Nga korrigjimi i gabimeve aritmetike rezulton se oferta duhet të jetë në vlerën 16,512,000 lekë pa TVSH kur ne fakt operatori ka paraqitur oferte me vlerën 16,252,000 lekë pa TVSH. Ne bazë të VKM Nr. 285 datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82 pika 3, ju kërkua operatorit nga adresa e nje prej anëtarëve te KVO që brenda ditës së nesërme data 02.02.2022 ora 13:00 të pranoje korrigjimin e ofertës, në të kundërt oferta do të refuzohet. Nuk ka patur asnjë kthim përgjigje nga ana e operatorit ekonomik, rrjedhimisht oferta refuzohet.

Konstatimi: Nga verifikimi mbi skualifikimin e këtij OE, rezulton se nga KVO është vlerësuar saktë, pasi nuk plotëson kriteret.

3- OE “F....C” shpk me vlere oferte ne total 17,489,949 lekë pa TVSH, për arsyet e mëposhtme:

Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës në kundërshtim me kërkesat e germës “b” të pikës 2 të DST-së.

Nuk ka paraqitur vërtetimin e xhiros së 3 viteve të fundit në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.2.1. te DST-së.

Nuk ka paraqitur kopje te bilancit te viteve 2018, 2019, 2020 në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.2.2. të DST-së.

Nuk ka paraqitur furnizime të ngjashme në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.1 të DST-së.

Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.2 të DST-së.

Nuk ka paraqitur katalog prodhuesi në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3. të DST-së.

Nuk ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015 në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.4. të DST-së.

Konstatimi: Nga verifikimi mbi skualifikimin e këtij OE, rezulton se nga KVO është vlerësuar saktë, pasi nuk plotëson kriteret.

4- OE “LL.....O” shpk me vlere oferte ne total 17,708,475 lekë pa TVSH, për arsytet e mëposhtme:

Nuk ka paraqitur furnizime të ngjashme në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.1 të DST-së.

Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.2 të DST-së. Nuk ka paraqitur katalog prodhuesi në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3. të DST-së.

Konstatimi: Nga verifikimi mbi skualifikimin e këtij OE, rezulton se nga KVO është vlerësuar saktë, pasi nuk plotëson kriteret.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se shoqëria “A....O” shpk, me një vlerë të përgjithshme prej 15,602,808 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme për OE të mbetur në garë, konkretisht shoqëria V...S shpk me vlere oferte ne total 17,263,618.5 lekë pa TVSH.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09.01.2020.

Nuk ka patur ankesa.

Me shkresën nr. 10792/7, datë 7.2.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit. Shpallur në buletinin e APP nr. 19, datë 14.2.2022.

Me shkresën nr. 10792/8, datë 16.2.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshtetur të gjithë procedurën.

Me PV nr. 10792/6, datë 7.2.2022, KVO ka marrë në dorëzim dhe verifikoj dokumentacionin e firmës fitues përpara lidhjes së kontratës.

Midis shoqërisë “A....O” Shpk dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 10792/9, datë 15.03.2022 për “Blerje tubo naftës/jellësi” me vlerën 15,602,808 lekë pa TVSh, me afat punimesh 60 ditë.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “A....O” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

k- Nga shoqëria nuk janë paraqitur raportet e ekspertit kontabël për vitet 2019 dhe 2020, në referencë të pikës 2.2.2 të DST. Në procedura të ngjashme ky kriter nga KVO është përdorur si kriter skualifikues.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, **duke ngarkuar me përgjegjësi: z. F. M. me detyrë ish- Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e KVO, respektivisht: E.B me profil Jurist, V.M me profil ing. Mekanik dhe M. P me profil Juriste.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarët e KVO (E.B, V.M, M. P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Për pikën a- OE plotëson kriteret e auditimit të pasqyrave financiare, në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”.

OE ka paraqitur kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2018 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku nuk duhet të ketë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore, dhe për vitet 2019, 2020 kopje të certifikuar të këtyre bilanceve nga administrata tatimore dhe bashkëlidhur tyre, faqen e fundit të akt-ekspertizës së ekspertit kontabël të autorizuar.

Sipas përcaktimeve të ligjit të sipërpërmendur, njësitë ekonomike, brenda 7 muajve nga data e raportimit, depozitojnë për publikim pranë autoritetit përkatës ku janë regjistruar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e auditimit, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Ndërsa në lidhje me mos paraqitjen e akt-ekspertizës financiare të bilance të vitit 2019 dhe 2020, argumenti nuk qëndron, pasi në kërkesa thuhet se pasqyrat financiare të viteve 2018-2020 duhet të jenë me akt-ekspertizë. Nga subjekti është depozituar vetëm e vitit 2018 dhe jo të viteve të tjera.

Nga të dhënat e sistemit shoqëria për të dy vitet 2019 – 2020, pasqyrat plotësojnë dy nga tre kushtet e nenit 41 të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”. **Procedura mbetet me probleme në vlerësim.**

19- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “Eternit” i çative të repartit Mekanik dhe repartit Elektrik në QMN Kuçovë”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “Eternit” i çative të repartit Mekanik dhe repartit Elektrik në QMN Kuçovë”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 8489, datë 29.10.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 8489, datë 29.10.2021	4. Komisioni VO nr. 8489/1, datë 29.10.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar me mjete elektronik”.	F.S R.G R.P	B.Ç A.P M. P
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,953,982 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “A....T” ShPK me vlerën e ofertës 9,187,380 lekë pa TVSh, me afat 8javë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) ose 92%.
8. Data e hapjes së tenderit 11.11.2021 REF -09962-10-29-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 4: a-Skualifikuar 3 OE, b- Kualifikuar 1 OE,
11. Ankimim PO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K PO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 8489/9, datë 3.3.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 9,187,380 lekë me afat 8 javë.	

Preventivi është hartuar nga specialistët **ing. R.G**, bazuar në çmimet sipas VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i çmimeve sipas manualit, konstatohet se ato janë nuk janë në zbatim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015, i ndryshuar, konkretisht:

Nr.	Nr. An	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi sipas preventivit	Çmimi sipas manualit	Vlera sipas preventivit	Vlera sipas manualit	Diferenca
1	2/214+256/b	Riparim catie + mbulim me sanduic	m2	476	4911	3816	2,337,636	1,816,416	521,220

Nga sa trajtuam mësipërm vlera e preventivit është rënduar më shumë prej 521,220 lekë, veprime me efekt negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në kundërshtim VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi ing. R.G.

- Vlerësimi i kriterëve:

Në aplikimin e kriterëve me gjithë ndërhyrjet e APP dhe ndryshimet të bërë nga AK, janë konstatuar kriterë **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat konsiderohen se, në mënyrë direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim, *konkretisht*:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

2. Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ose

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim, është kërkesë e tejkualuar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar. Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5⁸, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021.

Sa më sipër kjo kërkesë e pengon OE për të marrë pjesë në garë për një punë për të cilën ende nuk e kanë marrë certifikatën e marrjes në dorëzim.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë ku përfshihen.

Punime speciale ndërtimi

NS– 8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike e druri.

Referuar zërave të preventivit konstatohet se kjo kategori liçensa është e panevojshme në fazën e zbatimit dhe nuk duhej aplikuar.

⁸Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve..

2.3.3/e. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) ekspert zjarrfikës. Për të vërtetuar këtë të paraqitet:

Certifikata për “Ekspert Privat Zjarrfikës” në fushën e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, lëshuar nga drejtoria e PMZSH-së, ose nga shoqëri të akredituara ose organizma ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Kontratë individuale pune të vlefshme.

Kërkesa e AK mbi disponueshmërinë e një ekspert zjarrfikës, shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës, në kuptim të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

2.3.4/b. Operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit: **ISO 3834-2:2006 (ose ekuivalente)**

Certifikata EN-ISO 3834-2:2006 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e certifikata ENISO 3834-2:2006”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, Certifikimi i sipërcituar shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën e shkrirjes me saldim. Standarti EN ISO 3834-2 për certifikim ka të bëjë vetëm me burimin dhe cilësinë e produktit që mund të rrjedh nga burimi dhe operimet e ndërlidhura. Standartet janë përdorur si bazë për vlerësimin e cilësisë së saldimit të prodhuesve. Sa më sipër, referuar objektit të prokurimit objekt shqyrtimi, rezulton se nuk jemi në kushtet e blerjes së produkteve të prodhuara me metodën e shkrirjes me saldim, në mënyrë që të kërkohet që prodhuesi i tyre të disponojë certifikimin për standardin EN ISO 3834-2. Në këto kushte, kërkimi nga ana e autoritetit kontraktor për disponimin e certifikatës të sipërcituar, nuk është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor nuk duhej ta vendoste këtë kërkesë.

2.3.3/g. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar për të paktën 35 (tridhjetë e pesë) punonjës për tre muajt e fundit.

Nuk argumentohet me volume dhe orë pune kërkesa për 130 punonjës. Vendosja jo mirëargometuara e numrit të punonjësve çon në mos pjesëmarrjen e OE të mundshëm në tenderim të cilat me një numër të të vogël dhe në raport me volumin e punimeve sipas zërave që mund të realizojë punimet.

Për sa sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. F. M. me detyrë ish- Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e hartimit të specifikimeve teknike ing. R.G dhe art. G. L.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarët e NJP (F.S, R.P, R.G), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

- Lidhur me pretendimin se për kriterin: “2.3.1. Përvojën e suksesshme për punë të ngjashme përveç të tjerave të paraqitet edhe certifikata e marrjes në dorëzim..., është kërkesë e tejkaluar pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1-2 vjeçare, duke tejkaluar në këtë mënyrë afatin trevjeçar të periudhës së kërkuar”, **arsyetojmë se:**

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim të objektit ndër dokumentave të tjera që plotësohen, është kërkesë e bazuar në legjislacionin e posaçëm të ndërtimit. Certifikata e marrjes në dorëzim të objektit të përfunduar mund të jetë e përkohshme ose përfundimtare, pas mbarimit të afatit të garancisë. Në çdo rast është pranuar certifikata e marrjes në dorëzim. Kjo nuk ka qenë një kërkesë e paqartë dhe nuk ka përbërë asnjëherë shkak për skualifikimin e OE edhe

n.q.s. ata kanë dorëzuar certifikatën e përkohshme të marrjes në dorëzim të lëshuar pas aktit të kolaudit të objektit.

Gjithashtu vlen të theksojmë se për këtë kërkesë ashtu siç është shkruar në asnjë rast nuk është ndërhyrë nga Sektori i Koordinimit të Agjencisë së Prokurimit Publik me të cilin kemi bashkëpunim të vazhdueshëm. Pra kjo kërkesë ashtu siç është shkruar ka qenë e qartë dhe jo konfuze për të gjitha palët si OE ashtu edhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

- Lidhur me pretendimin se për kriterin: “2.3.2. për pikën e licencës NS-8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike e druri”, referuar zërave të preventivit konstatohet se kjo kategori është e panevojshme, **arsyetojmë se:**

Bazuar në dokumentet e procedurës nuk mund të realizohet kurrsesi një kapriate metalike pa këtë pike të licencës.

- Lidhur me pretendimin se për kriterin: “2.3.3. për stafin kryesor mbështetës, për inxhinierin mekanik referuar tipologjisë së procedurës punimeve sipas preventivit nuk është përcaktuar se mbi c’bazë teknike AK ka kërkuar një inxhinier mekanik, pasi nuk kemi të bëjmë me punime mekanike, **arsyetojmë se:**

Po për këtë arsye, prezenca e punimeve metalike e bën të domosdoshëm inxhinierin Mekanik. Kjo është domosdoshmëri për realizimin e punimeve, përfshirë stafin e hekurkthyesit, mekanikut dhe të saldatorit, etj, në baze të kërkesave tona për realizimin e punimeve si dhe të zbatimit të Kushteve teknike të projektimit dhe Kushteve teknike të zbatimit.

- Lidhur me pretendimin se për kriterin: “2.3.3/d për stafin teknik mekanik 2 persona, hekurkthyes 2 persona, saldator 2 persona, kërkesat nuk janë të mirëargumetuara pasi referuar zërave të punimeve sipas volumeve nuk kërkohen këto kategori punimesh, **arsyetojmë se:**

Kjo është domosdoshmëri për realizimin e punimeve përfshirë stafin e hekurkthyesit, mekanikut dhe të saldatorit, etj, në baze të kërkesave tona për realizimin e punimeve si dhe të zbatimit të Kushteve teknike të projektimit dhe Kushteve teknike të zbatimit.

- Lidhur me pretendimin se për kriterin: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar për të paktën 35 punonjës për tre muajt e fundit,...nuk argumentohen me volumin dhe grafikun e punimeve....”, **arsyetojmë se:**

Lidhur me sa më sipër, megjithëse në akt konstatim janë të paqarta nr. e punonjësve nga 35 në 130..gjithsesi numri 35 i punonjësve përfshirë stafin është në minimumin e vet duke llogaritur numrin e specialisteve, manovratorëve, punëtorëve të paspecializuar si dhe të stafit të domosdoshëm në një shoqëri të tilla, që të realizojë ndërtimin e këtij investimi. Ndaj në pretendojmë se numri i kërkuar i punonjësve është minimal.

- Lidhur me pretendimin se për kriterin 2.3.3/e: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1(një) mjek** në bazë të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Veçanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 ” Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar,...rezulton e tepërt dhe nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës, **arsyetojmë se:**

Për mjekun është kërkuar ndër të tjera

Listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat mjeku i sipërpërmendur duhet të figurojë ose kontratë shërbimi e cila duhet të përfshijë edhe afatin e zbatimit të punimeve të ndërtimit.

Pra shihet qartë se mjeku i kërkuar mund të jetë në listpagesë **ose** i kontraktuar me kontratë shërbimi minimalisht për afatin e zbatimit të punimeve të ndërtimit, duke zbatuar pikërisht VKM të cituar nga grupi i auditimit.

- Lidhur me pretendimin se “për certifikatën ISO 3834-2:2006 “Për sistemet e menaxhimit të cilësisë së saldimit” si kërkesë e gabuar, sqarojmë se:

Kjo ISO shërben për të treguar se OE përmbushin kërkesat dhe janë të certifikuar për prodhimin e pajisjeve teknologjike me anë të metodës së saldimit dhe për më tepër të pajisjeve nën presion siç është rezervuari metalik. Është domosdoshmëri kualifikimi i lartë dhe garancia për procesin e

saldimit. *Certifikata e sipërpërmendur është dokumenti i domosdoshëm për këtë garanci. Për sa më sipër kërkesa për paraqitjen e certifikatës iso është në përputhje të plotë me kushtet e procedurës dhe nuk është kërkuar përtej asaj që është e nevojshme.*

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa është observuar nga punonjësit e shoqërisë *Albpetrol sh.a Patos*, sqarojmë se për disa nga kriteret pretendimit e subjektit qëndrojnë dhe janë marrë në konsideratë, duke mos u reflektuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. Ndërsa në lidhje me kriteret e tjera argumentet nuk qëndrojnë dhe gjejnë pasqyrim në Raport Përfundimtar Auditimi, shpjegime të cilat janë dhënë përgjatë materialit.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 11.11.2021 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 4 OE, konkretisht:

1. *Operatori ekonomik "SH...7" shpk, me vlerë ofertën total 9,000,028 leke (pa TVSH).*
2. *Operatori ekonomik "6...N" shpk, me vlerë oferte në total 9,133,960 leke (pa TVSH).*
3. *Operatori ekonomik "A...T" shpk, me vlerë oferte në total 9,187,380 leke (pa TVSH).*
4. *Operatori ekonomik F...D shpk nuk ka paraqitur ofertë për këtë tender.*

Me PV nr. 3, datë 01.12.2021 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 11.11.2021 deri datë 01.12.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Sipas këtij PV nga 4 OE janë skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar 1 OE, konkretisht: *Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesi të mëposhtëm:*

1-OE "SH...7" shpk për arsyet e mëposhtme:

Nuk ka deklaruar në shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit", 2 punonjës që disponojnë certifikatë trajnimi "Për punimet në lartësi" dhe as nuk ka paraqitur dokumentacion, në kundërshtim me germën "f" të pikës 2.3.3. "Stafi kryesor mbështetës" të DST-së.

Nuk ka deklaruar në shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit", mjekun në stafin e tij dhe as nuk ka paraqitur dokumentacion, në kundërshtim me germën "e" të pikës 2.3.3. "Stafi kryesor mbështetës" të DST-së.

2-OE "6...N" shpk për arsyet e mëposhtme:

Ne shtojcën 8 në pikën 7 të rubrikës B "Deklarata për paraqitjen e ofertave të pavarura" ka deklaruar se është konsultuar ka komunikuar ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrenca në lidhje me këtë procedurë prokurimi, në kundërshtim kjo me paraqitjen e ofertës së pavarur siç kërkohet në germën "gj" të pikës 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit", të DST-së.

Në shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit", në pikën "c" "Deklaratë për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate", në tabelën e mjeteve me qira, konkretisht për zërat:

vinç min 5 ton, nuk ka plotësuar të dhënat për kontratën dhe afatin e saj.

vinç kollon min 5 ton nuk ka plotësuar të dhënat për kontratën dhe afatin e saj.

kamion me kosh për punime në lartësi, nuk ka plotësuar asnjë të dhënë lidhur me- nr. shasisë së mjetit, - nr. i kontratës së qirasë, - afati i kontratës, në kundërshtim me kërkesat e kësaj shtojce.

3- Operatori ekonomik "F...D" shpk për arsyet e mëposhtme:

Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit sipas shtojcës 8, në kundërshtim me germën "a" të pikës 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" të DST-së.

Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës në kundërshtim me germën "b" të pikës 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" të DST-së.

Nuk ka paraqitur xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, në kundërshtim me pikën 2.2.2. të pikës 2.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" i DST-së.

Nuk ka paraqitur deklaratën për angazhimin e mjeteve, në kundërshtim me pikën 2.3.6 të DST-së.

Nuk ka paraqitur grafikun e punimeve në kundërshtim me pikën 2.3.7. të DST-së.

Referuar PV të mësipërm për subjektin ‘A...T’ shpk, nga njëri prej anëtarëve të KVO është kërkuar dokumentacion shtesë, konkretisht:

- a- *Vërtetimi mbi xhiron e viteve 2018-2019-2020, pasi dokumenti i paraqitur është format aplikimi.*
- b- *Dokumentin sipas pikës 2.3.4 të DST të krahasuar me dokumentin në sistemin SPE në formën “A...T” 2021 OK.PDF, pasi ky file ka pasuar dëmtime dhe nuk hapet.*
- c- *Për pikën 2.3.5 të DST për zërat: fikse zjarri, kuti e ndihmës së shpejtë, tabela sinjalistikën të sigurimit teknik, projektor ndriçimi të vihen ne dispozicion faturat tatimore të blerjes me qëllim verifikimin nga ana e KVO.*

Nga ana e subjektit me shkresën nr. Datë 22.11.2021 (prot Albpetrol sh.a Patos me nr. 9464, datë 23.11.2021) është paraqitur dokumentacioni i kërkuar nga anëtari i KVO.

Sipas KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit rezulton se shoqëria ‘A...T’ shpk, nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt administrativ-ligjorë, sipas kërkesave të DST, **pasi kontrata e ngjashme nuk konsiderohen pune të ngjashme.**

Në përfundim KVO nuk ka vlerësuar asnjë nga OE pjesëmarrës në procedurë, pasi nuk plotësonin kriteret e DST.

Me shkresën nr. 889/6, datë 01.12.2021 të titullarit të AK është dërguar për publikim procedura në APP, i cili është shpallur në buletin nr. 174, datë 6.12.2021 por mos plotësim të kushteve nga OE pjesëmarrës, **duke mos shpallur asnjë fitues.**

ANKESË

Ne shtojcën 21 nga shoqëria “A...T” shpk është paraqitur ankesë për skualifikim të padrejtë në adresë të AK dhe KPP, datë xxxx, hyrë në ALBPELTROL sha nr. 10010, datë 9.12.2021, duke argumentuar dhe kriterin për të cilën është skualifikuar.

Nga shoqëria janë depozituar tre kontrata, konkretisht:

- 1- *Kontrata datë 23.8.2018 midis bashkimit të OE “A...T” shpk (90% të punimeve) dhe “ALB KORCA” shpk me 10% të punimeve dhe FSHZH me vlerë kontrate 43,490,748 lekë pa TVSh.*
- 2- *Kontrata datë 29.5.2017 midis Bashkisë Shijak dhe shoqërisë ‘A...T’ shpk për vlerën 82,806,230 lekë.*
- 3- *Kontrata e lidhur me datë 12.2.2018 midis Bashkisë Durrës dhe shoqërisë “A...T” shpk me vlerë 58,518,870 lekë.*

Me urdhër nr. 10010/1, datë 9.12.2021 të titullarit të AK z. F. M. është bërë pezullimi i procedurës deri në shqyrtimin e ankesës. Ngarkohet z. E.B për shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përkatës.

Me vendim nr. 10010/2, datë 14.12.2021 z. E.B ka vendosur pranimin e ankesës dhe rivlerësimin e procedurës nga KVO në përputhje me këtë vendim.

Me shkresën nr. 10010/3, datë 14.12.2021 titullari i AK z. F. M. ka njoftuar shoqërinë ‘A...T’ shpk për pranimin e ankesës.

Me shkresën nr. 10010/4, datë 14.12.2021 AK “ALBPETROL’ sha ka njoftuar KPP mbi shqyrtimin e ankesës dhe pranimin e sajë.

Me shkresën nr. 2465/4, datë 23.12.2021, KPP ka përcjell vendimin nr. 1034/2021, datë 23.12.2021 në të cilën thekson se mbyll çështjen e ankesës së paraqitur nga OE “A...T” shpk dhe lejon AK vijimin e procedurave.

Me PV nr. 4, datë 30.12.2021, duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, nisur nga fakti se nuk ka OE të tjerë të mbetur në garë, informojmë operatorin “A...T” shpk, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 9,187,380 lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferte e suksesshme.

Midis shoqërisë “A...T” ShPK dhe AK (ALBPETRO sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 8489/9, datë 3.3.2022 për “Zëvendësim i mbulesave eksitisi “Eternit” i çative të repartit Mekanik dhe repartit Elektrik në QMN Kuçovë” me vlerën 9,187,380lekë pa TVSh. me afat punimesh 8 javë.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria "A...T" shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK .

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga KVO-ja (B.Ç, A.P, M. P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

....Po ashtu, paralelisht edhe KPP, përfundimisht nëpërmjet shkresës me nr. 2465/4, datë 23.12.2021 ka përcjellë vendimin me nr. 1034/2021, datë 23.12.2021 në të cilën thekson se mbyll çështjen me një vendim brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga AK për ankesën pasi nuk ka pasur ankesë nga operatorët e tjerë ekonomikë të interesuar duke paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113, pika 1 të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe lejon AK për vijimin e procedurave.

Nga anëtarët e KVO është kundërshtuar me faktin se:

Pas publikimit të njoftimit të anulimit pranë Autoritetit Kontraktor më datë 09/12/2021 është paraqitur ankesa e operatorit ekonomik "AL.-A." shpk, regjistruar me Nr. 10010 prot. Me Urdhrin 10010/1 prot., datë 09/12/2021 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor është pezulluar procedura deri në shqyrtim të ankesës nga Zyrtari i autorizuar. Zyrtari I autorizuar me Vendimin Nr. 10010/2 prot., datë 14/12/2021 ka vendosur pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik "AL.-A." shpk dhe rivlerësimin e ofertës së këtij operatori nga KVO. Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 1034/2021 prot., datë 23/12/2021, ka vendosur mbylljen e çështjes për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "AL.-A." shpk, dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshme të procedurës.

Referuar nenit 24, nenit 114, nenit 115, të Ligjit 162, datë 23/12/2020, "Për Prokurimin Publik", Theksojmë se KVO me vlerësimin e saj e ka anuluar këtë procedurë, por duke mos pasur tagrin për të kundërshtuar vendimin e KPP-së si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme, ka zbatuar vendimin e KPP-së.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa është observuar nga punonjësit e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, sqarojmë se argumentet qëndrojnë dhe merren në konsideratë, pasi procedura është vlerësuar nga KPP.

- **Zbatimi i kontratës.**

Midis shoqërisë "A...T" Shpk dhe AK (ALBPETROL sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 8489/9, datë 3.3.2022 për "Zëvendësim i mbulesave eksitisi "Eternit" i çative të repartit Mekanik dhe reparti Elektrik në QMN Kuçovë" me vlerën 9,187,380 lekë pa TVSh. me afat punimesh 8 javë ose nga data 29.3.2022 (data e fillimit të punimeve) deri me datë 4.5.2022.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria Financës, rezulton se deri në datën e përfundimit të punës në terren nuk është likuaduar asnjë vlerë e situacionuar, kjo pasi sipas znj. A.B në dosjen teknike të përcjell për likuidim nuk është bashkëlidhur situacioni përfundimtar i punimeve.

Me shkresën nr. 134/6, datë 15.12.2022 të Drejtorit të Qendra Mekanike e Naftës QMN Kuçovë, përcjellë në adresë të Drejtorisë së Financës shkresa me lëndë "Dërgim dokumentacioni", në të cilën janë listuar dhe dokumentacioni që shoqëron. Në këtë liste është dhe situacioni përfundimtar. Me MEMO nr. 9218/1, datë 22.12.2022 të Drejtorisë së Programimit në adresë të E. D. me detyrë Administrator, është përcjellë informacion mbi zbatimin e kontratës me nr. 8449/12, datë 3.3.2022, duke informuar administratorit mbi fazat e zbatimit të kontratës nga momenti i përfundimit të punimeve datë 4.5.2022 deri në hartimin e akt kolaudimit. Në këtë MEMO në pikën 3 thuhet se

situacioni përfundimtar është në përputhje me Projektpreventivi. Këto dokumente janë bashkëlidhur shkresës.

Me shkresën nr. 134/7, datë 22.12.2022 (prot ALBPETROL nr. 9218, datë 22.12.2022), QMN Kuçovë kërkesë për likuidim, duke rreshtuar gjithë dokumentacionin e plotë.

Pas ballafaqimit të problematikës mbi arsyet e moslikuidimit nga znj. A.B u rishpjegua se dokumentacioni shoqërues nuk është i saktë. Për këtë me MEMO datë 17.01.2023 (e pa protokolluar në instuticioni)dhe panënskruar nga personat se kujt i është adresuar, thuhet se me anë të kësaj shkrese kërkohet plotësimi i praktikës me dokumentacion me argumentin se “Nuk mund të vijohet me procedurën e likuidimet pasi kjo kontratë është e paplotësuar me dokumentacioni justifikues dhe kërkohet plotësimi i saj.

Në këtë MEMO për veç faktit se nuk është e protokolluar dhe pa nënshkruar nga personat të cilëve ju është adresuar MEMO në instuticioni, në kundërshtim me rregulloren e Albpetroli sh.a Patos, sipas vendimit nr. 20, datë 3.12.2022, por nuk është e specifikuar se cilat nga dokumentacioni justifikues nuk është paraqitur ose është i parregullt.

Me shkresën nr. 1081, datë 13.2.2023 Drejtoria e Programimit për dijeni dhe Administratorit z. E. D i përcjellë Drejtorisë së Financës dokumentacionin e plotë për zbatimin e kontratës nr. 8489/9, datë 3.3.2022, duke listuar të gjithë dokumentet, ku bë pjesë dhe situacioni përfundimtar (nr. 27 i listës).

Nga znj. A.B për sqarimin e situatës është paraqitur situacioni i cili është pa datë por i nënshkruar nga gjithë peronat përgjegjës, situacion i cili në dosjen e zbatimit dhe dokumentacioni shoqërues për likuidim mungonte. Pretendimi i Drejt/Financës se situacioni është i pa nënshkruar nuk qëndron, pasi ai është nënshkruar nga subjekti, mbikëqyrësi dhe E. D. në cilësinë e Administratorit. **Referuar sa mësipërm fatura nr. 35/2022, datë 29.6.2022 në shumën 11,024,856 lekë e cila është depozituar në Drejtorinë e Financës me datë 22.12.2022 nuk është mundësuar likuidimi i sajë deri në datë 31.3.2023, në kundërshtim me nenin 29 pika 5⁹ e kontratës nr. 8489/9, datë 3.3.2022.**

Sipas dokumentacionit në financë, shoqëria “A....T” shpk ka paraqitur për likuidim faturën nr. 35/2022, datë 29.6.2022 në shumën 11,024,856 lekë me TVSh (vlera e plotë e kontratës.

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se nga shoqëria fatura është paraqitur jashtë **afatit të zbatimit dhe kjo e pashoqëruar me situacion përfundimtar** (data 29.6.2022), dokumentacion bazë që tregon përfundimin e punimeve për të cilën nga shoqëria Albpetroli sh.a Patos (Personat përgjegjës. Grupi i marrjes në dorëzim: P.SH, G.J.H, A.D dhe D.K), nuk janë llogaritur penalitetet në masën 4/1000 në ditë jo më pak se 25% e vlerës së kontratës, kjo në referencë të nenit 33¹⁰ të kontratës, për ditëvonesat përlllogaritjen prej **55 dite vonesë** nga data 4.5.2022 deri datë 29.6.202. Gjithashtu në dosje nuk depozitohet asnjë vendim administratori për shtyrje të punimeve, gjë e cila nuyk është paraqitur në në fazët e mëtejshme të evadimit të materialit.

Nga sa trajtuam mësipërm shoqëria “A....T” shpk nuk ka plotësuar kushtet e kontratës për mbylljen e sajë brenda afatit ligjorë duhet të llogaritet penaliteti në shumën **505,305 lekë** $\{ (9,187,380 \times 25\% = (22,96,845 \text{ lekë} \times 4/1000 \text{ ditë vonesë} \times 55 \text{ ditë}) \}$, **vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetroli sh.a Patos.**

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Komisioni për ndjekjen e punimeve i përbërë nga P.SH, G.J.H, A.D dhe D.K, Mbikëqyrësi i punimeve “M.C”, si dhe shoqëria “A....T” shpk për mos zbatim të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë

⁹Me përjashtim të rasteve kur parashoikohet në kontratë, pagesa peridudike për punë do të bëhet Brenda 30 ditëve.

¹⁰Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën si vijon:

Për cdo ditë vonesë tejk afatit për lëvrimin e mallit, kontraktuesi është i detyruar ti paguaj AK penalitetet në masën 4/1000 të vlerës së mbetur koresponduse pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% e vlerës së kontratës.

22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga grupi i punës AMN Kuçovë (P.SH, G.J.H, A.D dhe D.K), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Në kontratën nr. 8489/12, datë 3.3.2022 të lidhur midis AK (Albpetrol sh.a Patos) dhe shoqërisë “A...T” shpk, referuar nenit 2 të kontratës është hartuar urdhri i brendshëm i QMN Kuçovë nr.18, datë 4.3.2022 “Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

Komisioni i ngritur sipas këtij urdhri, me marrjen e njoftimit për përfundimin e punimeve me shkresën nr. 8489/12, datë 3.3.2022, si dhe bazuar në specifikimet teknike konstatoi se kontraktuesi nuk ka realizuar riparimin e strukturës mbajtëse të çative të dy reparteve. Për këtë u kërkua takim me kontraktuesin, takim në të cilin mungonte mbikëqyrësi i punimeve. Në zbatim të nenit 3 të kontratës (3.6; 3.11; 3.12), kontraktuesi ka për detyrë që për gabime në projekt duhet të kishte reklamuar tek AK. Bazuar në nenin 9 dhe 14 të kontratës, detyrimi i kontraktorit është përfundimi i punimeve afatin e parashikuar. Gjithashtu referuar pikës 5 të nenit 32, me përjashtim të forcës madhore çdo vonesë nga kontraktori e bën përgjegjës. Sipas nenit 32 pika 7, thuhet se AK mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera, nëse ka interes.

Për sa i përket ndjekjes së kontratës, referuar pikës 8 të nenit 46, është ngarkuar AMN Kuçovë dhe sektori i monitorimit të kontratave ndërtimore pranë Drejtorisë Programimit Albpetrol sh.a.

Në zbatim të urdhrit nr. 18, datë 4.3.2022, komisioni i ngritur ka për detyrë për të komunikuar me Drejtorinë e Prokurimeve Albpetrol sh.a Patos për rastin e mosrealizimit të kontratës brenda afatit, detyrë e cila i është ngarkuar:

a- Drejtorisë së AMN Kuçovë zj. A.C.

b- Sektori i monitorimit të kontratave pranë Drejtorisë Programimit Albpetrol sh.a Patos.

Gjithashtu referuar kontratës nr. 1736/3 prot, datë 01.3.2022, lidhur midis AK Albpetrol sh.a patos dhe mbikëqyrësit të punimeve “M.CH”, pikat 4.5; 4.9; 4.14; 4.15; 4.21 shkronja (d) dhe paragrafi i fundit i kësaj pike, është detyrë e mbikëqyrësit për ndjekjen e punimeve.

Nga komisioni i qendrës u kërkuar që pa kryer punimet nuk do vijohet me punimet e tjera. Kjo çojë në shtyrjen e kontratës deri në organizimin e një takimi tjetër midis palëve me datë 12.11.2022 në Drejtorinë e QMN Kuçovë.

Pasi përfundojë punimet firma kontraktuese dorëzoi në protokollin e QMN Kuçovë, dosjen teknike sipas PV nr. 134/5prot, datë 15.1.2022.

Pas shqyrtimit dosja u dërguar në shoqërinë “Albpetrol sh.a Patos për likuidim me shkresën nr. 134/7prot, datë 22.12.2022.

Nga sa parashtruam deri tani zgjatja e afatit të punimeve është pasojë e mos kryerjes së punimeve nga koontraktori.

Në lidhje me penalitetet, sqarojmë së në zbatim të nenit 29 (29.1), referuar kushteve të pagesës, veprimeve financiare, do të realizohet nga AK dhe në bazë të urdhrit të sipërpërmendur nuk është përgjegjësi e komisionit mos llogaritja.

Theksojmë se përveç këtij komisioni, ka pasur detyrë mbikëqyrje dhe Sektori i menaxhimit të kontratave pranë Drejtorisë së Programimit, të cilat janë bërë me dije për situatën. Gjithashtu përgjegjësi ka dhe mbikëqyrësi i punimeve,

Pra në zbatim të urdhrit nr. 18, datë 4.3.2022 për mbikëqyrjen e kontratës, detyra ka pasur mbikëqyrësi i punimeve.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa është argumentuar nga komisioni i QMN Kuçovë mbi konstatimin e grupit të KLSH, për mos përfundimin në afat të punimeve, sqarojmë se pretendimet **nuk qëndrojnë** dhe nuk qartësojnë problematikën, pasi ato thjeshtë kanë bërë interpretim të përgjegjësive së ndjekjes së kontratës.

Gjithashtu referuar urdhërit nr. 18, datë 4.3.2022 të lëshuar nga Drejtori znj. A.C, nuk ju largon nga përgjegjësia, pasi referuar pikës 2 të tij thuhet: “Hartimin e PV të marrjes në dorzim të punimeve”.

20- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbime për punime me autosondë me kullë me kapacitet ngritës > 70 ton”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbime për punime me autosondë me kullë me kapacitet ngritës > 70 ton”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 6081, datë 27.8.2021		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar me mjete elektronik”. Me lote Loti I. Shërbime me autosonde me kapacitet > 70 ton Loti II. Shërbime me autosonde me kapacitet > 100 ton	3. Njësia e Prokurimit nr. 6081, datë 27.8.2021 F.S I.Ç R.P	4. Komisioni VO nr. 6081/1, datë 27.8.2021 S.K A. V M. P
5. Fondi Limit (pa TVSh) 15,900,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “S....B” ShPK me vlerën e ofertës 14,900,000 lekë pa TVSh, me afat 12 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 93.7%.
8. Data e hapjes së tenderit 14.9.2021 REF -09962-10-29-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 1: a-Skualifikuar 0 OE, b- Kualifikuar 1 OE,
11. Ankimim PO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K PO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 6081/11, datë 30.9.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 9,187,380 lekë me afat 12 muaj.	

Me urdhër të ish- Titullarit të AK **z. F.M** nr. 5347 prot, datë 5.8.2021 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e projektit teknik, specifikimeve teknike, hartimin e Projektpreventivi, konkretisht: **K.L** dhe **z. I.Ç** me profil ing. Naftë, Drejt/ Prodhimit, **z. B.B** dhe **z. F.M** me profil ing. Naftë Q.P.N Gorrisht, **z. N.S** dhe **z. H.GJ** me profil ing. Naftë Q.P.N Fier, **zj. O.F** me profil ing. Gjeolog tek Drejt/ Prokurimit, **z. A.P** me profil ekonomist Drejt/ Prokurimit dhe **z. E. B** me profil ekonomist Drejt/ Prokurimit.

Me shkresën nr. 4038 prot, datë 15.6.2021 të **z. S.E** me detyrë Drejt Prodhimi i është kërkuar Drejt/ Prokurimit që bazuar në programin e zhvillimit ekonomik nr. 601/4, datë 26.01.2021 të miratuar me Venim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 25, datë 24.12.2021 dhe vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 411, datë 19.01.2021 realizimin e procedurës me objekt “Shërbimi punime me autosondë” me kapacitet 70 ton për 1000 orë pune dhe kapacitet 100 tonë për 300 orë pune”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga grupi i punës për llogaritjen e fondit limit (O.F, A.P, E. B), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me konstatimin tuaj se nga grupi nuk janë marrë në konsideratë kontratat e mëparshme me shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, sqarojmë se nuk janë marrë në konsideratë për faktin se rroga minimale ka pësuar rritje, po kështu dhe çmime te pjesëve të këmbimit, lëndë djegëse etj.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Përsa është argumentuar nga shoqëria pretendimet qëndrojnë dhe merret në konsideratë.

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve me gjithë ndërhyrjet e APP dhe ndryshimet të bërë nga AK, janë konstatuar kriterë janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 14.9.2021 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht shoqëria “S....B” me ofertë ekonomike 14,900,000 Lekë. Ndërsa loti i II, nuk ka pasur asnjë ofertues.

Me PV nr. 3, datë 15.9.2021 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 14.9.2021 deri datë 15.9.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Sipas KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit ka vlerësuar se shoqëria “S....B” shpk, plotëson kushtet për kualifikim dhe shpallje fitues me ofertë 14,900,000 lekë.

Me shkresën nr. 6081/6, datë 20.9.2021 është përcjellë për APP anulimi i procedurës për lotin e II. Shpallur në buletin e APP nr. 142, datë 27.9.2021.

Me shkresën nr. 6081/7, datë 20.9.2021 është plotësuar formulari i njoftim fituesit për lotin e I^{re} me ofertë 14,900,000 lekë, I cili është shpallur në buletin e APP nr. 142, datë 27.9.2021.

Me shkresën nr. 6081/8, datë 27.9.2021 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Me PV nr. 6081/10, datë 30.9.2021 është bërë marrja në dorëzim i dokumentacionit të firmës fituese. Midis shoqërisë “S....B” ShPK dhe AK (ALBPETROL sha), është hartuar dhe firmosur kontrata shërbimi nr. 6081/11, datë 30.9.2021 për “Shërbime për punime me autosondë me kullë me kapacitet ngritës > 70 ton” me vlerën 9,187,380 lekë pa TVSh. me afat punimesh 12 muaj.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “S....B” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, si dhe kundërshtive të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në fazën e aktkonstatimeve, rezulton se procedura është në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP.

Titulli gjetjes: Mos zbatimi i kushteve të kontratës nr. 6081/11, datë 30.9.2021

Situata:

Nga auditimi i kushteve të kontratës nr. 6081/11, datë 30.9.2021 me objekt “Shërbime për punime me autosondë me kullë me kapacitet ngritës > 70 ton”, të lidhur midis shoqërisë “S....B” shpk dhe AK (Albpetrol sha), me vlerën 14,900,000 lekë pa TVSh ose vlera 17,880,000 lekë me TVSh dhe afat punimesh 12 muaj ose nga data **30.9.2021 deri me datë 30.9.2022**, rezulton se:

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria Financës në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, konstatohet se nga shoqëria janë paraqitur për likuidim fatura në shumën totale 6,339,710 lekë, vlerë e cila është likuiduar nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos deri me datë 16.9.2022, konkretisht:

OE fitues	VI Kontrate	Nr/date fature	Vlera	Urdhër Shpenz	Vlera
S....B	17,880,000	375/2022 dt 11/04/22	1,683,223	21/07/2022	3,101,643
		438/2022 dt 29/04/22	1,418,420		
		740/2022 dt 29/07/22	2,037,962	16/08/2022	2,037,962
		920/2022 dt 16/09/22	1,074,051	27/09/2022	1,074,051
		921/2022 dt 16/09/22	126,054	16/08/2022	126,054
			6,339,710		6,339,710

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se nga ana e shoqërisë “S....B” nuk është mbyllur kontrata për vlerën 17,880,000 lekë, deri me datë 30.9.2022, duke mbetur pa zbatuar vlerën 11,540,290 lekë (17,880,000 – 6,339,710).

Për zbatimin e kësaj kontrate është ngarkuar **z. I.Ç me profil ing. Naftë pranë Drejt/Prodhimit**, në zbatim të urdhrit nr. 6081/12, datë 30.9.2021 të ish- Administratorit z. F. M..

Nga shoqëria “S....B” shpk ditë vonesat janë **180 dite vonesë nga data kur duhej mbyllur kontrata.**

Konstatohet se nuk ka asnjë dokument justifikues mbi vonesat e mos mbylljes në afat të kontratës, veprime në shkëlqje të nenit 14¹¹ të kontratës 6081/11, datë 30.9.2021, ku deri me datë 30.3.2023 detyrimi për kamatëvonesën e pallogaritur përllogaritet në shumën **2,682,000 lekë** (14,900,000 x 25%) = (3,725,000 lekë x 4/1000 x 180 ditë vonesë), **vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.**

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. I.Ç me profil ing. Naftë pranë Drejt/Prodhimit, znj. A.B me funksion Drejt/ Financë dhe shoqëria “S....B” shpk për mos zbatim të kushteve të kontratës.

Kriteri:

Mos zbatim i kushteve të kontratës nr. 6081/11, datë 30.9.2021.

Ndikimi/Efekti:

Veprime me efekt financiar në vlerën 2,682,000 lekë, nga mos zbatimi i kontratës në afat.

Shkaku:

Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Juridike, të marrin të gjitha masat për ndjekjen e procedurave administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës **2,682,000 lekë** nga shoqëria “S....B” shpk, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës në mos ndjekjen e kontratës sipas afateve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Drejtori i Financës znj. A.B, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Përsa ju keni konstatuar ju bëjmë me dije se ne si Drejtori Finance i referohemi dokumentacionit justifikues i cili na sillet për likuidim nga Qendra përkatëse dhe konkretisht nga QPN Fier , QPN Gorisht qe janë ndjekës dhe zbatues te kontratës. Ne te gjitha pagesat qe janë bere për këtë kontrate nuk ka asnjë dokumentacion justifikues as nga QPN Fier as nga QPN Gorisht qe te shprehen për vonese te kontratës. Kjo është një kontrate shërbimi me ore pune dhe pagesa është bere ne baze te orëve faktike te punuara.

Nisur sa me sipër ne si finance nuk mund te bënim llogaritje penalitetesh pa pasur asnjë indicje për vonesa ne lidhje me zbatimin e kontratës.

Llogaritja e peneliteteve bëhet nga Zyra e Financës të qendrave që e ndjekin dhe zbatojnë kontratën Nisur nga sa parashtruan më sipër, kërkojmë që observacioni i paraqitur nga ana jonë mbi konstatimet tuaja në lidhje me këtë Akt-Konstatim, të merren në konsideratë.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa është observuar nga znj. A.B, nuk është paraqitur asgjë e re nga ato të paritura në fazën e akt-konstatimeve, ku nga ana e grupit të KLSH është shprehur se:

Nga ana e juaj është bërë një interpretim i rregullores së funksionit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos (marrëdhënia midis drejtorive), dhe nuk është sqaruar mos zbatimi i kontratës sipas kushteve të saj.

¹¹Dëmet e likuajuara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën si vijon:

Për cdo ditë vonesë tej afatit për lëvrimin e mallit, kontraktuesi është i detyruar ti paguaj AK penelitet në masën 2/1000 të vlerës së mbetur koresponduese pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% e vlerës së kontratës.

21- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtim RVM 1500 m3 në parkun Dekantim Gorisht”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Ndërtim RVM 1500 m3 në parkun Dekantim Gorisht”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 6082, datë 27.8.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 6082, datë 27.8.2021 F. S. , Përgj prokurime K.N R.P	4. Komisioni VO nr. 6082/1, datë 27.8.2021 R.G A.P M. P
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur me mjete elektronik”,		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 14,666,892 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “A....6” ShPK me vlerën e ofertës 13,976,934 lekë pa TVSh, me afat 3muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 690 lekë pa TVSh ose 95%.
8. Data e hapjes së tenderit 14.9.2021 REF -04044-08-27-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 2: a-Skualifikuar 1 OE, b- Kualifikuar 1 OE,
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 6082/10, datë 15.10.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 13,976,934 lekë me afat 3 muaj.	

- Vlerësimi i kriterëve:

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të cilat konsiderohen se, në mënyrë direkte ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim, konkretisht:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ose

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit

Kërkesa **për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim**, është kërkesë e tejkualuar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar. Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5¹², të VKM nr. 285, datë 19/05/2021.

Sa më sipër kjo kërkesë e pengon OE për të marrë pjesë në garë për një punë për të cilën ende nuk e kanë marrë certifikatën e marrjes në dorëzim.

¹²Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi përpërvijë e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar për mbushjen të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislati në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë ku përfshihen.

Punime të përgjithshme ndërtimi:

3. NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

Punime speciale ndërtimi:

Në lidhje me këtë kriter, duke marrë shkas nga punimet e përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventiv, projekt, specifikimet teknike dhe relacion teknik), rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të mëposhtme, sipas VKM nr.42, datë 16.01.2008.

N.P- 12 Punime të inxhinierisë mjedisore - ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

- Nga AK, nuk është argumentuar me volume punimesh dhe me grafik numri i punonjësve (staf teknik + punëtorë) prej **25 punonjës**. NJHDT duhet t'i referohej Kreut III¹³, të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", si dhe në mospërputhje me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punësimit të ndërtimit dhe të analizës teknike të tyre, i ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

Për certifikatë ISO 3834-2:2005 "Per sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit", kërkesë e gabuar pasi shërben për prodhimin me saldimit, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktimit të kërkesat e cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën e shkrirjes me saldimit. Standartit EN ISO 3834-2 për certifikim ka të bëjë vetëm me burimin dhe cilësinë e produktit që mund të rrjedh nga burimi dhe operimet e ndërlydhura. Standartet janë përdorur si bazë për vlerësimin e cilësisë së saldimit të prodhuesve. Sa më sipër, referuar objektit të prokurimit objekt shqyrtimi. Nuk jemi në kushtet e blerjes së produkteve të prodhuara me metodën e shkrirjes me saldimit, në mënyrë që të kërkohet që prodhuesi i tyre të disponojë certifikimin për standardin EN ISO 3834-2. Në këto kushte, kjo certifikatë nuk është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet ta heqin këtë kërkesë.

Për sa sipër ngarkohen me përgjegjësi duke ngarkuar me përgjegjësi: z. F. M. me detyrë ish-Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e NJHDT F. S. , K.N dhe R.P.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga anëtarët e NJP (F.S, R.P, K.N), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

¹³"Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 22 mars – 23 tetor me 2(dy) turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3(tri) turne, për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera".

Pretendim i subjektit:

Lidhur me pretendimin se për kriterin: “2.3.1. Përvojën e suksesshme për punë të ngjashme përveç të tjerave të paraqitet edhe certifikata e marrjes në dorëzim..., është kërkesë e tejkualuar pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1-2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin trevjeçar të periudhës së kërkuar”, arsyetohet se:

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim të objektit ndër dokumenteve të tjera që plotësohen, është kërkesë e bazuar në legjislacionin e posaçëm të ndërtimit. Certifikata e marrjes në dorëzim të objektit të përfunduar mund të jetë e përkohshme ose përfundimtare, pas mbarimit të afatit të garancisë. Në çdo rast është pranuar certifikata e marrjes në dorëzim. Kjo nuk ka qenë një kërkesë e paqartë dhe nuk ka përbërë asnjëherë shkak për skualifikimin e OE edhe n.q.s. ata kanë dorëzuar certifikatën e përkohshme të marrje në dorëzim të lëshuar pas aktit të kolaudimit të objektit.

1. *Lidhur me pretendimin se për kriterin: “Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë ku përfshihen.*

NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

Lidhur me kërkesën për pikën e licencës (NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit) arsyetohet se: Terreni ku zhvillohen punimet ka një mjedis mjaft të ngarkuar me ndotje pasi është brenda stacionit të dekantimit Gorisht. Sheshi ku do të ndërtohet RVM-ja është bazamenti i përdorur më parë dhe ka një sasi të konsiderueshme ndotje të mbetjeve të ngurta si dhe punime të ndryshme që kanë të bëjnë me lidhjet me tubacionet në prezencë gazi. Këto e bëjnë të domosdoshëm praninë e punime të inxhinierisë mjedisore dhe si i tillë gjykojmë se po kështu i domosdoshëm është edhe prania e inxhinierit të mjedisit.

2. *Lidhur me pretendimin se për kriterin: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar për të paktën 25 (njëzet e pesë) punonjës për tre muajt e fundit,...nuk argumentohen me volumin dhe grafikun e punimeve....”, arsyetohet se:*

Lidhur me sa më sipër numri prej 25 punonjës të kërkuar përfshirë staf teknik plus punëtorë është në minimumin e vet, duke llogaritur numrin e specialisteve, manovratorëve, punëtorëve të pa specializuar si dhe të stafit të domosdoshëm në një shoqëri të tilla, që të realizojë ndërtimin e këtij investimi. Ndaj ne pretendojmë se numri i kërkuar i punonjësve është minimal.

3. *Lidhur me pretendimin se për kriterin: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij I(një) mjek në bazë të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Veçanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 ” Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar,...rezulton e tepërt dhe nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës, arsyetohet se:*

Pra shihet qartë se mjeku i kërkuar mund të jetë në listpagesë ose i kontraktuar me kontratë shërbimi minimalisht për afatin e zbatimit të punimeve të ndërtimit, duke zbatuar pikërisht VKM të cituar nga grupi i auditimit.

1. *Lidhur me pretendimin se “për certifikatën ISO 3834-2:2005 “Për sistemet e menaxhimit të cilësisë së saldimit” si kërkesë e gabuar, sqarojmë se:*

Kjo ISO shërben për të treguar se OE përmbushin kërkesat dhe janë të certifikuar për prodhimin e pajisjeve teknologjike me anë të metodës së saldimit dhe për më tepër të pajisjeve nën presion siç është rezervuari metalik. Është domosdoshmëri kualifikimi i lartë dhe garancia për procesin e saldimit. Certifikata e sipërpërmendur është dokumenti i domosdoshëm për këtë garanci. Për sa më sipër kërkesa për paraqitjen e certifikatës iso është në përputhje të plotë me kushtet e procedurës dhe nuk është kërkuar përtej asaj që është e nevojshme.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Grupi i KLSH pasi analizojë kundërshtitë e paraqitura në lidhje me kriteret e aplikuara, konkludon se nga subjekti nuk është paraqitur asgjë e re nga observacionete paraqitura në fazën e

aktkonstatimeve të cilat qëndrojnë dhe **nuk merren në konsideratë shpjegime** të cilat janë trajtuar mësipërm.

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV nr. 2, datë 14.9.2021 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

28. OE “**SH....7**” shpk, me vlerë oferte në total 12,500,000 lekë (pa TVSH).

29. OE “**A....6**” shpk, me vlerë oferte në total 13,976,934 leke (pa TVSH).

Me PV nr. 3, datë 22.9.2021 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 14.9.2021 deri datë 14.01.2022 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Në përfundim KVO ka vendosur se nga 2 OE pjesëmarrës është skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 1 OE.

Është skualifikuar shoqëria “**SH....7**” shpk për arsyet e mëposhtme:

Nuk ka deklaruar formularin përmbledhës të vetdeklarimit stafin teknik për punonjësit e kualifikuar, pasi:

Nuk paraqet diplomën e lartë për ing. Mekanik.

Nuk paraqet përgjegjës për sigurinë në punë.

Punonjësit hidraulik K.Y dhe P.A nuk rezultojnë në listpagesa për muajin gusht.

Për punonjësit karpirtjer, nga 2 që janë kërkuar vetëm njëri është. Punonjësi F.I ka çertifikatë kualifikimi.

Paraqet dokumentacion vetëm për 2 saldator nga 3 që kërkohen, ndërsa për secilin saldator D.R nuk ka dëshmi kualifikimi.

Nuk deklaron në formularin përmbledhës mjetet kalandër dhe zumatrice.

Pas vlerësimit të dokumentacionit teknik, KVO ka klasifikuar në vend të parë OE “**A....6**” shpk, me vlerë oferte në total 13,976,934 leke (pa TVSH), të cilit në zbatim të nenit 97 të ligjit nr. 162/2020 të LPP i është kërkuar paraqitja e dokumentacionit dhe lidhja e kontratës.

Njoftim fituesi me shkresën nr. 6082/7, datë 24.9.2021, shpallur në buletin e APP nr. 146, datë 4.10.2021.

Me shkresën nr. 6082/8, datë 4.10.2021 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Me PV nr. 6082/9, datë 8.10.2021, KVO ka marrë në dorëzim dhe verifikoj dokumentacionin e firmës fitues përpara lidhjes së kontratës, kjo në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.5.2021.

Midis shoqërisë “**A....6**” ShPK dhe AK (ALBPETROL sha), është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 6082/10, datë 15.10.2021 për “*Ndërtim RVM 1500 m³ në parkun Dekantim Gorisht*” me vlerën 13,976,934 lekë pa TVSh. me afat punimesh 3 muaj.

- **Vlerësimi procedurës:**

Nga auditimi i procedurës me objekt “*Ndërtim RVM 1500 m³ në parkun Dekantim Gorisht*”, me fond limit 14,666,892 lekë pa TVSh, në të cilën kanë marrë pjesë 2 OE, fitues është shpallur shoqëria A...6 shpk me ofertë 13,976,934 lekë më të lartë se OE i skualifikuar, rezulton se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “**A....6**” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se shoqëria nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

*l- Nga shoqëria nuk është deklaruar në shtojcën 8, ing. Mjedisit N.S sipas kontratës nr. 4151/2261, datë 31.12.2019, kërkesë në mos plotësim të pikës 2.3.3 të DST, për të cilën është skualifikuar shoqëria “**SH....7**” me ofertë më të leverdishme.*

m- Nuk plotësohet kriteri për 2 shofer dhe 3 manovratorë, gjithsej 5, pasi z. E,H një herë deklarohet si shofer dhe njëherë si manovratorë dhe një herë si shofer, duke lënë një numër mangat.

n- *Asnjë nga certifikatat ISO të kërkuara dhe paraqitura nga subjekti nuk dalin aktive të faqen e interneti të shoqërisë që i lëshoni ato.*

Nga sa trajtuar më sipër nga KVO, në mungesë të OE pjesmarrës në tender si rezultat i një vlerësimi më të saktë të KVO duheshin skualifikuar të dy OE pjesmarrës, ose midis OE me mëngësi në kritere, ku në raste të vecantë kanë dhe mangësi të njëta, KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “çmimi më i leverdishëm”, **për të efektin negativ midis dy OE në vlerën 1,476,934 lekë, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO, respektivisht: R.G, A.P dhe M. P.**

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 11/180 prot, datë 20.06.2023, (prot KLSH nr. 1202/22, datë 22.6.2023), “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga anëtarët e KVO (S,K, A. V, M. P), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendim i subjektit:

Në vlerësimin që keni bërë konsttaohet se nga ana juaj është bërë ngatëresë nga shoqëria ‘SH...7’ në shoqërinë ‘SH...7’, ku dhe kriteret të cilat ju i vlerësoni si të ngajshme në skualifikim mund të jenë të shoqërisë që keni ngatëruar në ndonjë provedurë tjetër.

Në lidhje me mos deklarimin në formularin e vetëdeklarimit të ing. Mjedisi Ndricim Salobehaj, arsyetojmë se ofertuesi ka ngarkuar në SPE me dokumentacion ing. Mjedisi, arsye kjo që ka cuar KVCO në vlerësim.

Në lidhje me konstatimin që nuk plotësonm numërin e shoferave dhe manovratorë ne 5 veta, pasi z. Endri Hoxha një herë deklarohet si shofer dhe njëherë si manuvrator, sqarojmë së personeli është i kualifikuar me më shumë se dy procese pune. Referuar kontrata midis punëdhënësit dhe punëmarrës është deklaruar qartë obkekti i tyre. Pra janë lidhur dy kontrata dhe palët kanë rënë dakori të marrin dhe japin me njëri tjetërin.

Në lidhje me konstatimin se certifikatat ISO nuk dalin në faqen e internetit të shoqërisë që i lëshon ato, nga KVO është vlerësuar fakti që ato janë të depozituara në sistem.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa është kundërshtuar nga KVO, sqarojmë se argumentet NUK qëndrojnë dhe merren në konsideratë, pasi:

- Në lidhje me ngatresën e emërit nga “SH...7” shpk në “SH...7” shpk, është nja lassus vetëm emëri i shoqësisë, **ndërsa kriteret për të cilat është skualifikuar nga KVO janë ato për të cilat jeni shprehur dhe ju.**

- **Në lidhje me mos deklarimin në shtojcën 8 të ing. Mjedisi Ndricim Salobehaj, sqarojmë se është në kundërshtim me Ligji nr. 162, date 21.12.2020 "per prokurimin publik", neni 82, pika5, VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregeillave te prokurimit publik,i ndryshar me vkm nr 710, datë 24.11.2021, neni 26, pika 6.**

Mbi paraqitjen e dokumentacionit administrativo ligjor per procedurat e prokurimit, pasi në formularin e vetëdeklarimit duhej shënuar emri i ing. Mjedisit. **Për të këtë mangësi është skualifikuar shoqëria “SH...7” shpk, ku thuhet se nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit stafin teknik për punonjësiy e specializuar në referim të pikës 2.3.3 germa (d).**

- Në lidhje me deklarimin dy herë të një personi, argumenti nuk qëndron, pasi nuk i plotësohet numri 5 punonjës që kërkohet në DST.

- Në lidhje me certifikatat ato nuk janë lëshuar nga shoqëria e licensimit pasi nuk dalin në sistem. **Procedura mbetet me probleme në vlerësim.**

Titulli gjetjes: Mos zbatimi i kushteve të kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021 për zbatimin e punimeve me objekt “Ndërtim RVM 1500 m3 në parkun Dekantim Gorisht”.

Situata:

Me shkresën nr. Ska, datë s'ka të Drejtorisë Financës i është kërkuar administratorit që në zbatim të kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021 dhe amendament kontrate nr. 605, datë 20.01.2022 që bazuar në dokumentacionin e administruar likujdimin e shumës 16,772,320 lekë me TVSh ndaj shoqërisë “A...6” shpk.

Sipas kontratës fillestare afati i përfundimit të punimeve është 3 muaj ose nga datë 15.10.2021 deri me datë 15.01.2022. Sipas të dhëna të Sektorit të Menaxhimit të Kontratave punimet kanë filluar me datë 21.10.2021. Nisur nga fakti se kjo kontratë ka shtesë afati për një periudhë 30 ditë, **afati i punimeve është nga data 20.10.2021 deri me datë 22.02.2022.**

Referuar dokumentacionit të depozituar në Drejtorinë e Financës dhe dosjes teknike, rezulton se:

Me shkresën nr. 3183, atë 19.4.2022 Drejt/Programimit dhe zhvillimit me autorizim zj. V.S) i është drejtuar Drejt/Financës për dijeni administratores znj. A. H. për likujdim situacioni përfundimtar, kjo në referencë të shkresë së QPN Gorisht nr. 282, datë 12.4.2022 (*prot Albetrol nr. 3183, datë 15.4.2022*).

Sipas kësaj shkresë me datë 6.4.2022 nr. 2862prot, është protokolluar në Albetrol sha dokumentacioni nga kolaudatori i punimeve shoqëria “V.....G” shpk.

Me shkresën nr. 3921prot, datë 20.5.2022 të zj. A.B me detyrë Drejt/Financës i është kërkuar interpretim Drejt/Çështjeje ligjor në lidhje me mangësitë e dokumentacionit shoqërues të faturës për likujdim, duke theksuar se dokumentacioni nuk është nënshkruar nga ish- administratori, pasi situacioni nuk është nënshkruar nga AK (Albetrol sha), por është nënshkruar nga komisioni i ngritur nga qendra e QPN Gorisht (persona që ndjekin kontratën).

Për këtë është kërkuar interpretimi juridik që bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2021 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve” që dokumentacioni i përcjellë juridikisht është i rregullt ose jo.

Nga Drejt/ Çështjeje ligjore me shkresën nr. 3921/1, datë 6.6.2022 i kthen përgjigje Drejt/Financë që situacioni përfundimtar i datës 30.3.2022 i cili rezulton i nënshkruar nga sipërmarrës, mbikëqyrësi i punimeve dhe komisioni i QPN Gorisht në cilësinë e përfaqësuesit të AK “Albetrol” sh, në zbatim të kreut II pika 7, pikën 17 dhe 18 të udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2021 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, dokumentacioni është i rregullt.

Me shkresën nr. 4462prot, datë 10.6.2022 Drejt/Financës i drejtohet Drejt/ Programimit se vlera e faturës për likujdim nuk përputhet me vlerën e situacionit përfundimtarë. Me shkresën nr. 4462/1prot, datë 13.6.2022 Drejt/Programimit i drejtohet Drejt/Financës se fatura tatimore elektronike është pranuar nga Sektori i Financës në QNP Gorisht, me faturën elektronike të korrigjuar nr. 384, datë 10.6.2021.

Me shkresën nr. 282, datë 12.4.2022 të Q.P.N Gorisht (*financieri S.D dhe Drejtori N.B*), i është drejtuar Drejt/Financës Albetrol sha për likujdimin e situacioni përfundimtar sipas faturës 109, datë 10.6.2022 në shumën 16,770,640 lekë me TVSh e cila është likujduar me datë 23.6.2022 në shumën 15,932,108 lekë me TVSh, duke zbritur garancinë 5%.

Me shkresën nr. Ekstra datë 01.4.2022 të shoqërisë “A...6” shpk është depozituar dokumentacioni për likujdimin e kontratës se punimeve nr. 6082/10, datë 15.10.2021.

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se punimet nuk kanë përfunduar në afatin e caktuar në kontratë dhe amendament kontratë, pra nga datë 22.10.2021 deri me datë 22.02.2022, **pasi ato janë mbyllur me datë 30.3.2022 (data situacioni përfundimtar) ose datë fatura 8.4.2022.**

Në zbatim të nenit 33 pika 33.1 germa (a), ndaja shoqërisë ‘A...6’ shpk nga Sektori Financës QPN Gorisht (S.D) dhe Drejt/Financës Albetrol sh.a Patos (A.B) duhej të ishin llogaritet penalitetet për mos respektim të kushteve të kontratës për afatet e zbatimit në vlerën **223,630 lekë** ($13,976,934 \times 25\% = 3,494,233$ pa TVSh $\times 4/1000 \times 16$ ditë vonesë), **veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e shoqërisë Albetrol sh.a Patos, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: z. S.D me detyrë shef finance QPN Gorisht, znj. A.B me detyrë Drejt/Finance Albetrol sha, komisioni i QPN Gorisht. M,N me**

funksion ing. Specialit i investimeve dhe i prodhimit, z. P.M me funksion ing. Përgjegjës sektori Dekantimi Gorisht dhe z. A.H me funksion specialit jurist QPN Gorisht, si dhe shoqëria “A...6” shpk.

Kriteri:

Në kundërshtim me nenin 33 pika 33.1 germa (a) e kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021 të lidhur midis shoqërisë “A...6” shpk dhe shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Ndikimi/Efekti:

Mos ndjekja e kushteve janë veprime me efekt negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në shumën 894,434 lekë.

Shkaku:

Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse në zbatimin e kushteve të kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021.

Rëndësia: I lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **223,630 lekë pa TVSh ndajë shoqërisë “A...6” shpk** për situacionin të punimeve dhe paraqitje të faturës jashtë kushteve të kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021.

Në lidhje me problematikat e konstatuara në AK nr. 24, datë 20.4.2023 mbi mos aplikimin e kamatëvonesave nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos (komisioni i përbërë ing. M,N, ing. P.M dhe juristi A.H dhe nga znj. A.B me detyrë Drejt/ Finance) me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023, sqarojmë se:

Pretendim i subjektit:

–Kontrate Sipërmarrje Punimesh Ndërtimesh Nr. 6082/10 Prot., date 15.10.2021 e nënshkruar ndërmjet AK, Albpetrol sh.a Patos dhe Kontaktorit “Shoqëria “A...6 “ shpk Fier është shoqëruar nga Albpetrol sh.a Patos me Dok. Nr.8086 Prot., date 19.10.2021 dhe protokolluar pranë Q.P.N./Gorisht me Nr. 497 Prot., date 19.10.2021.

– Me Dok.Nr.901 Prot., date 21.10.2021 nga ana e Drejtorisë së Q.P.N.Gorisht është ngritur Komisioni për ndjekjen e Punimeve ndërtimore që do të realizohen nga Shoqëria “A...6 “ shpk Fier për Kontrate Sipërmarrje Punimesh Ndërtimore me Objekt: “Ndërtim RVM1500 m³ në parkun e vjetër dekantimin.

Ne baze të Kontrate Sipërmarrje Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 , Neni 1 (Objekti i Kontratës) theksohet: “Afati i kryerjes së punimeve 3 (tre) muaj nga marr jane dorëzime sheshit të ndërtimit “.

-Me Dok. Nr.497/1 Prot., date 21.10.2021 është bere Akt Dorëzimi i Sheshit të Ndërtimit në prezence të Përfaqësuesit të AK Albpetrol sh.a Patos, Shoqërisë “A...6 “ shpk , Fier dhe Mbikëqyrësit të Punimeve , Shoqëria “D....S “ shpk.

– Me Dok. 903 Prot., date 22.10.2021 është nënshkruar“ PV për lirimin e ambienteve të punës “ku do të punohet menjëherë nga Shoqëria“ A...6 “ shpk Fier për zbatimin e Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 të Albpetrol sh.a Patos.

– Me date 22.10.2023 shoqëria Ndërtuese “A...6 “ shpk Fier dhe Mbikëqyrësi i Punimeve , Shoqëria “D....S “ shpk, njoftojnë AK Albpetrol sh.a Patos për fillimin e Punimeve dhe po këtë date 22.10.2023 me Dok.Nr.502/1 Prot. Komisioni i Q.P.N.Gorisht komunikim zyrtarisht me AK Albpetrol sh.a Patos për fillimin e punimeve .

– Me Dok. Nr. 20 Prot., date 10.01.2022,Q.P.N.Gorishtka konkluduar për shtytje të afateve të kohës së batimit të Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 të Albpetrol sh.a Patos., bazuar në kërkesë e bere nga Mbikëqyrësi i Punimeve , Shoqëria “D.....s “ shpk, depozituar në Albpetrol sh.a Patos me date 05.01.2022, sipas Kërkesës së bere nga Kontraktori, Shoqëria “A...6” shpk me date 04.01.2022 të depozituar pranë AK Albpetrol sh.a Patos, pasi nuk mund të realizohet grafiku i punimeve të programuara për efekt të veprimit të fuqive madhore natyrore .

– Me Dok. Nr.62 Prot., date 21.01.2022 Q.P.N.Gorisht njofton zyrtarisht AK Albpetrol sh.a Patos per përfundimin e afatit ligjor te përfundimit te punimeve ndërtimore te Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 te Albpetrol sh.a Patos.

- Me Dok. Nr.605 Prot., date 20.01.2022 te Albpetrol sh.a Patos, sekretuar pranë Q.P.N.Gorisht me Nr.29 Prot., date 24.01.2022 njoftohemi si Komisioni i Q.P.N.Gorisht per shtytje afatit punimeve 30 dite mbi parashikimin e afateve kontraktore si pasoje e arsyetimit te bere nga Specialiste te Albpetrol sh.a Patos per veprimin e Fuqive madhore natyrore .

- Me Dok. Nr.59 Prot., date 11.02.2022 është nënshkruar AktTekniki Kontrollit te Hermeticitetit te RVM 1500 m³ ne Dekantimin Gorisht ne prezencë te Komisionit te Q.P.N.Gorisht, Kontraktorit, Shoqëria “A...6” shpk Fier dhe Mbikëqyrësi I Punimeve, Shoqëria “ D....S “ shpk. I cili rezultoi i rregullt teknikisht.

– Me Dok. Nr.175 Prot., date 21.02.2022 Komisioni i Q.P.N.Gorisht Njofton AK Albpetrol sh.a Patos per përfundimin e plote te punimeve te Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 te Albpetrol sh.a.me Kontrate Mbikëqyrje Punimesh Nr.7796/2 Prot., date15.10.2021.

-Me Dok. Nr.1746 Prot., date 24.02.2022 te Albpetrol sh.a Patos , sekretuar pranë Q.P.N. Gorisht me Nr.77/1 Prot., date 24.02.2022, Shoqëria “A...6“ shpk Fier i drejtohet autoriteteve mbikëqyrëse me kërkesë per Marrje përsipër te punimeve te Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 te Albpetrol sh.a Patos.

-Me Dok. Nr.1747 Prot., date 24.02.2022 te Albpetrol sh.a Patos ,sekretuar pranë Q.P.N. Gorisht me Nr.78/1 Prot., date 24.02.2022, Shoqëria “A....6“ shpk Fier u drejtohet autoriteteve mbikëqyrëse me Deklaratën per realizimin cilësor dhe te plote te punimeve ndërtimore te Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 te Albpetrol sh.a Patos.

– Me Dok. Nr. Extra Prot., date 01/04.2022 e Shoqërisë “A....6“ shpk Fier ,sekretuar pranë Q.P.N. Gorisht me Nr.140 Prot., date 05.04.2022, depozitohen Dokumentet përmbyllëse te Punimeve ndërtimore te Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 te Albpetrol sh.a Patos, ku përfshihen:

1 -Situacioni Përfundimtar i Punimeve, nënshkruar me 30.03.2022 nga palët e ngarkuara nga kjo Kontrate.

2 – Certifikata e Garancisë se Punimeve dhe e Marrjes se Përkohshme ne Dorëzimi Objektiv, nënshkruar me 30.03.2022 nga Palët e ngarkuara nga kjo Kontrate.

3 – Akt Kolaudimi i Objektivit nënshkruar nga Kolaudatori, Shoqëria “ V....G” shpk Tirane me date 11.03.2022 ne prezence te Shoqërisë “A....6” shpk Fier dhe Mbikëqyrësit te Punimeve, Shoqëria “ D....S” shpk.

Shoqëria Kolaudatore “V....G” shpk Tirane është Kontraktuar nga AK, Albpetrol sh.a Patos sipas Kontrate mbi Kolaudimin e Punimeve te Ndërtimit Nr.10652/2 Prot, Date 05.01.2022, sekretuar pranë Q.P.N. Gorisht me Nr. 28 Prot. , Date 24.01.2022.

4 –Fatura Tatimore Elektronike e lëshuar me date 31.03.2022 , ora 09 : 31 : 15

Nga kronologjia e ndjekjes dhe zbatimit te Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 te Albpetrol sh.a Patos. nga ana e Komisionit te Q.P.N. Gorisht, kolaudojmë, duke ju bere me dije, se:

Me Dok. Nr.175 Prot., date 21.02.2022 Komisioni i Q.P.N.Gorisht Njofton AK Albpetrol sh.a Patos per përfundimin e plote te punimeve te Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 te Albpetrol sh.a Patos. te realizuara nga Shoqëria Kontraktore “A....6“ shpk Fier dhe te ndjekura nga Mbikëqyrësi i Punimeve Shoqëria “D....S” shpk, i kontraktuar me AK Albpetrol sh.a Patos me Kontrate Mbikëqyrje Punimesh Nr.7796/2 Prot., date15.10.2021.

Punimet ndërtimore te Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 te Albpetrol sh.a Patos jane përfunduar brenda afatit te përcaktuar nga kjo Kontrate dhe Amendamenti per shtyrje te afatit te punimeve nga ana e AK ku është njoftuar nga ne si Komision AK Albpetrol sh.a Patos.

Komisioni i Q.P.N. Gorisht i ndjekjes dhe zbatimit te Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 te Albpetrol sh.a Patos, ka ndjekur rregullisht hap pas hapi punimet dhe ka zbatuar ne mënyrë korrekte çdo detyrim te tij qe rrjedh nga Kontrata ne fjale, ndërkohë, gjate ndjekjes se punimeve ndërtimore te RVM 1500 m³ ne prezence te Specialisteve te Drejtorisë se Programim- Zhvillimit Strategjik te Albpetrol sh.a Patos qe ndjekin këto Kontrata ,ka mbajtur Raport Inspektimin e kantierin e punimeve .

Sipas Kontratë mbi Kolaudimin e Punimeve te Ndërtimit Nr.10654/2 Prot., date 05.01.2022 , ku ne Neni 4 – “ Te Drejtat dhe Detyra te Kolaudatorit te Punimeve “; Pika 4.6 – “Akt – Kolaudimi duhet te hartohet nga Kolaudatori, i cili është i detyruar ta dorëzojë pranë Specialistit te ndjekjes se Investimeve ne Drejtorinë e Programimit ne Albpetrol sha, dosjen me te gjitha materialet e kryera gjate procesit te Kolaudimit te Objektivit brenda 30 ditëve nga dita e përfundimit te Aktit te Kolaudimit “ .

Per respektimin e këtij afati kohor te Kolaudatorit, Komisioni ynë i Q.P.N.Gorisht nuk mban asnjë lloj përgjegjësie .

Sipas Kontrate per Mbikëqyrje Punimesh Nr.7796/2 Prot., date15.10.2021 , ku Neni 4 – “Te Drejtat dhe Detyrime te Mbikëqyrësit te Punimeve“; Pika 4.17 – “Te dorëzojë dosjen e ndjekjes se punimeve te Objektivit jo me vonë se 30 dite pas datës se njoftimit te përfundimit te punimeve te Kontraktuesit. ”dhe per respektimin e këtij afati kohor te Mbikëqyrësit te Punimeve, Komisioni ynë i Q.P.N.Gorisht nuk mban asnjë lloje përgjegjësie.

Komisioni i ngritur nga Drejtoria e Q.P.N.Gorisht per ndjekje dhe zbatim te Kontrate Sipërmarrje punimesh ndërtimore Nr.6082/10 Prot., date 15.10.2021 te Albpetrol sh.a Patos., vepron ne Emër te A Albpetrol sh.a Patos ,pasi Q.P.N.Gorisht është Njësie Strukturës Organizative te tij, prandaj Komisioni i Q.P.N.Gorisht nënshkruan ne Emër te AK Albpetrol sh.a Patos.

Mbas përfundimit te plote te punimeve te kësaj Kontrate ne fjale, gjë per te cilën Komisioni i Q.P.N.Gorisht ka qene korrekt me komunikimin zyrtar shkresor me AK Albpetrol sh.a Patos, brenda afateve qe ka Kolaudatori dhe Mbikëqyrësi i Punimeve te këtij Objekti per dorëzimin e Dosjes se punimeve te kësaj Kontrate Sipërmarrje Punimesh, Komisioni i Q.P.N.Gorisht ka firmosur sipas rregullave Situacionin Përfundimtar te këtyre Punimeve sepse është realizuar Kolaudimi dhe Certifikata e cilësisë se plote te punimeve, prandaj komisioni i Q.P.N.Gorisht është jashtë përgjegjësi qe parashikojnë Specialistet e KLSH Dok.Nr.11/29 Prot., date 20/04/2023.

Interpretimi Financiar i Punimeve te Kontratës ne fjale është kompetence e Drejtorisë se Financës dhe e vartësve te saj, prandaj, Komisioni i Q.P.N.Gorisht duke qene korrekt ne punën e tij per ndjekje dhe zbatim te afateve kohore te punimeve te Kontrate Sipërmarrje Punimesh temësipërmenukduhetepërfshihetdhetezhvishetndajmasësendalesëseparashikuarneDok.Nr.11/29 Prot., date 20/04/2023 , pasi nuk ka asnjë shkelje ne punën e tij si Komision. Punë Ingritur nga Drejtoria e Q.P.N.Gorisht.

Nga znj. A.B observuar si vijon:

Përsa ju keni konstatuar ju bëjmë me dije se ne si Drejtori Finance i referohemi dokumentacionit justifikues i cili na sillet per likuidim nga Qendra përkatëse si dhe është i konfirmuar nga Sektori i Ndjekjes dhe zbatimit te kontratave ndërtimore pjese e Drejtorisë se Programimit.

Konkretisht ne kemi ne dispozicion Aktin e Kolaudimit ne te cilën shprehet qarte koha e fillimit dhe e mbarimit te punimeve si dhe Certifikatën e përkohshme te marrjes ne Dorëzim te punimeve. Ne akt ka te përcaktuar qe nuk ka asnjë dite penalitet sipas kushteve te kontratës dhe jane zbatuar te gjitha afatet. Gjithashtu ne kërkesën per likuidim nuk ka asnjë dokumentacion tjetër shkresor qe te lidhet me punimet me vonese ne objekt. Po kështu po ti referohemi Udhëzimit Nr 3 date 15.2.2001 Per mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndërtimit ne piken 17 te tij përcaktohet “ Se situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi ne faza te ndryshme te punimeve kontrollohen nga Mbikëqyrësi i punimeve. PAGESA mund te kryhet vetëm ne baze te këtij miratimi. Këto dokumente dërgohen ne sektorin Financiar ” .

Nisur sa me sipër ne si finance nuk mund te bënim llogaritje penalitetesh pa pasur asnjë indicje per vonesa ne zbatim punimesh

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Për sa është sqaruar nga ana e komisionit të mbikëqyrjes së kontratës, nuk është sqaruar fakti pse situacioni dhe fatura janë hartuar jashtë afatit të zbatimit të kontratës, por është kaluar përgjegjësia tek Drejtoria e Financës. Argumentet e dhënë nga ana juaj në lidhje me korrespondencën janë me dije nga grupi i KLSH gjatë fazës së auditimi, por ato nuk argumentojnë arsyen e paraqitjes së situacionit përfundimtar dhe faturës jashtë afateve

Në lidhje me pretendimet e Drejt/ Financës, sqarojmë se qëndron fakti se në zbatim të udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2001 situacionet nënshkruhen nga Mbikëqyrësi, dhe se në rastin konkret situacioni është nënshkruar nga mbikëqyrësi, **por nga ana juaj nuk është parë që data e situacionit është jashtë afatit ligjorë të përfundimit të punimeve.**

Gjithashtu sqarojmë se në zbatim të po këtij udhëzimi shkresa për përfundimin e punimeve dhe akt marrja e përkohshme duhet të shoqërohet me situacionin përfundimtar dhe faturën në të njëjtën periudhë.

22- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i transportit të naftës Bruto”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi i transportit të naftës Bruto”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 3510, datë 01.6.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 3510, datë 01.6.2021	4. Komisioni VO nr. 3510/1, datë 01.6.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar me mjete elektronik”.	R.P D.H F.S	S.K V.SH D.F
5. Fondi Limit (pa TVSh) 46,771,938 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “E.....9” ShPK me vlerën e ofertës 46,771,938 lekë pa TVSh, me afat 12 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 100%.
8. Data e hapjes së tenderit 17.6.2021 REF -96994-06-01-2021	9. Burimi Financimit ALBETROL.	10. Operatorë Ekonomike 2: a-Skualifikuar 1 OE, b- Kualifikuar 1 OE,
11. Ankimim PO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K PO	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 3510/10, datë 13.7.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 46,771,938 lekë me afat 12 muaj.	

Me urdhër të ish- Titullarit të AK nr. 2939 *prot*, datë 10.5.2021 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e volumeve të naftës bruto sipas linjave të cilat do transportohet, llogaritjen e distancave të rrugëve, specifikimet teknike dhe fondit limit për kryerjen e transportit. Grupi i punës është: **z. E.B, z. E.GJ dhe z. H.GJ** për llogaritjen e distancave ku do transportohet nafta me të tretë.

Znj. E.H në cilësinë e specialistes së fushës (ing. Kimist), do hartojë specifikimet teknike.

Z. D.H dhe znj. E.Z në cilësinë e specialist të fushës të hartojë termat e referencës, specifikimet teknike.

Znj. O.F, z. E. B dhe z. A.P në cilësinë e specialistëve të sektor të llogaritjes së fondit limit, në zbatim të nenit 59 të VKM nr. 914, i ndryshuar.

Me PV nr. 2939/1, datë 01,6,2021 nga ana e komisionit është bërë përlllogaritje e fondit limit. Në zbatim të program zhvillimit të vitit 2021 është parashikuar për tu prokuruar zëri me objekt “Shërbim I transportit naftë bruto” për plotësimin e nevojave të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, parashikuar kjo në regjistrin e prokurimeve të vitit 2021 me nr. 686/1, datë 20.5.2021 për vlerën 47,234,000 lekë pa TVSh.

Me shkresën nr. 2976, datë 10.5.2021 Drejtoria e Shitjes ka përcaktuar linjat e transportit dhe sasi të naftës bruto. Sipas të dhënave sasia e naftës që kërkohet për transport është **91,600 ton.**

Nga ana e QFT Patos me e-mail është përcaktuar sasia e naftës bruto që mund të transportohet me mjetet e shoqërisë 'ALBPETROL' sha, e cila është 30,223 ton dhe mbetet për transport me të tretë sasia 61,377 ton.

Mbështetur në nenin 59, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, nga ana e komisionit u shqyrtuar variantet në lidhje me çmimin. Në fund komisioni përcaktojë si çmim mesataren e çmimit të kontratave të ngjashme dhe ofertave të testimit të tregut duke përcaktuar një fond limit në vlerën 46,771,938 lekë pa TVSh.

- **Vlerësimi i kritereve:**

Në aplikimin e kritereve me gjithë ndërhyrjet e APP dhe ndryshimet të bërë nga AK, janë konstatuar kritere **nuk janë në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 46 të nr. 9643, datë 20.11.2006 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenet 27 "Kontrata e mallrave" dhe neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", konkretisht:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3/b. *Një punësim mesatar per tre muajt e fundit, per te paktën 15 persona te siguruar. Kjo pike dokumentohet me vërtetim te lëshuar nga Administrata Tatimore.*

2.3/c. *OE duhet të ketë në pronësi ose me qira jo më pak se 15 autobote me kapacitet 28-33m³.*

Nuk ka argumentuar numrin e punonjësve në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës. Nuk ka përcaktuar nëse këta persona do të jenë drejtuesit e mjetit, pra nëse mjete do të merret me qera së bashku me drejtuesin?

Gjithashtu nuk është përcaktuar saktë dhe numri i mjeteve që kërkohen, pasi sipas të dhënave nga sasia totale e naftës që duhet të transportohet për një vit prej 91 600 ton, me 3 (tre) mjetet e veta transporton 30 223 ton naftë. Ndërsa me të tretë sasinë e mbetur prej 61 377 ton janë kërkuar 15 mjete. Raport ky i dyshimtë dhe që çon në aplikimin e një kriteri skualifikues për shumë OE te tjerë ekonomik që mund të kenë një numër më të vogël autobotesh për realizimin e transportit.

Per mjetet e marra me qira ofertuesi duhet te paraqesë kontrata/t e qiramarrjes ose te huapërdorjes te lidhura para noterit, me afat vlefshmërie qe mbulon te gjithë afatin e zbatimit te kontratës per këtë objekt prokurimi dhe e shoqëruar me dokumentacionin, lejen e qarkullimit te mjetit rrugor, siguracioni te vlefshëm, akt kolaudimi te vlefshëm, taksat vjetore.

Nuk duhej te kishte kërkuar kontrata paraprake qiramarrjes ose te huapërdorjes te lidhura para noterit, pasi kjo kërkesë e vendos operatorin ekonomik në rast të mos shpalljes fitues përpara kushteve kontraktuale. Kjo kërkesë nuk u përmbahet përcaktimit të dispozitave nënligjore të LPP në hartimin e kritereve për kualifikim, pasi kjo lloj kërkesë nuk është parashikuar në LPP.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi NJHDT: R.P, D.H me detyrë Kryeinxhinier QASHNG Patos dhe F. S. me detyrë Drejtor Drejtorja e Prokurimeve.

Për sa është trajtuar në akt-konstatimi nr. 22, datë 20.4.2023, nga subjekti i audituar shoqëria Albpetrol sh.a Patos është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 (nga anëtarët e KHST E.B me pozicion aktual pune Drejtor i QASHNG Patos, H.GJ me pozicion aktual pune Drejtor Kabinet dhe E.GJ me pozicion aktual pune K/Inxhinier i QFT Patos) si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Me urdhër të ish-titullarit të AK me nr.2939 prot., datë 10.5.2021 është ngritur grupi i punës për:- përcaktimin e volumeve të naftës bruto sipas linjave të cilat do transportohet;- llogaritjen e distancave të rrugëve;- specifikimet teknike; - fondi limit.

Ne si pjesë e grupit të punës në ndjekje dhe në zbatim të urdhrin të mësipërm, nëpërmjet shkresës tonë me nr. 2983, datë 11.5.2021, duke iu referuar shkresës me nr.2976, datë 10.5.2021 nga Drejtorja e Shitjes po në ndjekje dhe zbatim të këtij urdhri e cila na ka paraqitur linjat e transportit të naftës bruto, si më poshtë:Kuçovë – Zharrëz; Ballsh (Usojë) – Zharrëz; Visokë – Zharrëz; Amonicë – Zharrëz; Marinëz – Zharrëz; Gorisht – Zharrëz.

Nga ana juaj është cituar se ngarkohen me përgjegjësi si anëtarë të hartimit të specifikimeve teknike dhe llogaritjen e distancave ku do të transportohet nafta me të tretë **nuk qëndron** pasi ne si pjesë grupi në zbatim të urdhrit nr.2939 prot., datë 10.5.2021, **pika 3** e këtij urdhri jemi të ngarkuar **vetëm dhe vetëm** në përcaktimin e distancave të linjave ku janë të përcaktuara/kërkuara dhe **jo të specifikimeve teknike** sikurse është cituar nga ana juaj (bashkëngjitur dokumentacioni i praktikës).

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Për sa është sqaruar nga komisioni i specifikimeve teknike, merret në konsideratë fakti mbi përgjegjësinë e konstatimeve nga NJHDT.

Zhvillimi procedurës.

Me PV nr. 2, datë 17.6.2021 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

1. OE **“B...M”** shpk, me vlerë oferte në total 39,950,000 lekë (pa TVSH).

2. OE **“E.....9”** shpk, me vlerë oferte në total 46,771,938 lekë (pa TVSH).

Me PV nr. 3, datë 23.6.2021 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23/12/2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, nga data 17.6.2021 deri datë 23.6.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

OE “B...M” shpk, për arsyet e mëposhtme:

Formulari i ofertës nuk është paraqitur sipas formës së kërkuar në shtojcën 1. Nuk është deklaruar çmimi për njësi lek/ton/km. Gjithashtu nuk janë përcaktuar sasitë në ton si dhe destinacionet përkatëse siç kërkohet në DST. Ky fakt e bën formularin e ofertës të pavlefshëm.

Sipas dokumentacionit të paraqitur për mjetet, në pronësi të vet ose me qiramarrje, ka mangësi të theksuara në dokumentacion si Certifikatat ADR, Certifikatat për transport mallrash të rrezikshme, Certifikatat e inspektimit për cisternat, aktet e kolaudimit për mjetet, Siguracioni, taksat vjetore, në kundërshtim me piken 3.3 Kapaciteti teknik germa (c, d, e, f).

Vërtetimi për xhiron mesatare vjetore është paraqitur vetëm për dy vitet 2019, 2020 dhe jo për tre vite, në kundërshtim me piken 3.2 germa “b” kapaciteti ekonomik dhe financiar.

Nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që operatori ka disponon në adresën Tirane sipas adresës kryesore të deklaruar në ekstraktin e QKB, në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.1 germa “e”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, KVO ka vlerësuar se shoqëria “E.....9” shpk me adresë Mbrostar, rruga “Mbrostar- Kallëm” kilometri i pare, ndërtesa private me zone kadastrale 2636, numër pasurie 70/2-ND1, Fier, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 46,771,938 leke pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme, pasi plotëson kriteret e DST.

Me shkresën nr. 3510/6, datë 23.6.2021 është plotësuar njoftim fituesi, shpallur në buletin e APP nr. xx, datë 28.6.2021.

ANKESA

Me shkresën datë 28.6.2021 (prot Albpetrol nr. 4382, datë 29.6.2021) është paraqitur ankesë për kualifikim të padrejtë të shoqërisë “E.....9” shpk. Ankesën shoqëria e ka bërë dhe në KPP, si dhe ka likujtuar detyrimin në shumën 233,860 lekë.

Me urdhër nr. 4397, datë 29.6.2021, ish- Administratori është bërë pezullimi i procedurës dhe ngritur KSHA (**E.R, E.K dhe M. P**) për shqyrtimin e ankesës.

Me vendim nr. 4397/1, datë 30.6.2021 nga KSHA është vendosur mos pranimit i ankesës që paraqitur nga shoqëria “B...M” shpk, kjo pasi në referim të nenit 94 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të PP”, paraqitja e ankesës parashikon se:

Cdo OE i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e AK, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me LPP, ka të drejtë të ankohet pranë AK dhe KPP.

Nga verifikimi në fazën e KPP me datë 29.6.2021 është bërë ankesa në KPP.

Në ato raste kur subjekti ankimues rezulton i skualifikuar nga procedura, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezë së pretendimet e parashikuara në ankimimi e tij lidhen me OE e tjerë pjesëmarrjes në procedurë, do të pranohen, ankimuesit sërish nuk realizon interesin e tij.

Ky qëndrim është mbajtur dhe nga KPP në disa vendime për çështje të ngjashme.

Me shpresën nr. 4382/1, datë 30.6.2021 AK kthen përgjigje shoqërisë “B...M” shpk për mos pranim të ankesës.

Me vendim nr. 356/2021, datë 8.7.2021 është depozituar vendimi i KPP në të cilët thuhet se referuar kërkesë së subjektit datë 02.7.2021 për heqjen dorë nga ankimimi në zbatim të nenit 117, të ligjit nr. 162/2020 LPP për mos shqyrtimin e ankesës dhe vijimin e procedurës nga AK.

Me shkresën nr. 3510/7, datë 9.7.2021 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshtuar të gjithë procedurën.

Midis bashkimi i OE “E....9” Shpk dhe AK (ALBPETROL sha), është hartuar dhe firmosur kontrata shërbimi nr. 3510/10, datë 13.7.2021 për “Shërbimi i transportit të naftës Bruto” me vlerën 46,771,938 lekë pa TVSh, me afat 12 mujor.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “E....9” shpk në dosjen e **procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri është në kushtet e mos plotësimit** Ligji nr. 162, date 21.12.2020 "Per Prokurimin Publik", neni 82, pika5, VKM nr.285, datë19/05/2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 26, pika 6 “Mbi paraqitjen e dokumentacionit administrativo ligjor per procedurat e prokurimit “, pasi nga ofertuesi nuk deklaruar në sistemin SPE, këto dokumente:

1- Nuk plotëson pikën mbi numrin për 15 mjete me kapacitet nga 28-33 m³. Kështu nga auditimi rezulton se shoqëria ka paraqitur 14 mjete nga 15 që kërkohen, pasi mjeti me targë AA...DA është paraqitur dy herë dokumentacioni në sistem. Gjithashtu disa nga mjetet nuk janë të deklaruar nga shoqëria dhe nuk janë në pronësi, pasi nuk dalin as në QKB dhe as në inventarin e pasqyrave financiare, konkretisht mjetet me targë: AA...JU, AGR...7, AA...HN, FR...D.

2- Gjithashtu kapaciteti i tyre nuk është sipas kapacitet që kërkohet në DST nga 28-33 m³.

3- Mjetet e mara me qira nga shoqëria “I...9” me nr. 2750/1812, datë 16.6.2021, konstatohet se kontrata **nuk ka të përcaktuar afatin e përdorimit** se për sa periudhë është afati i kontratës.

Veprime me efekt negativ në buxheti në shumën **6,821,938 lekë** (46,771,938 – 39,950,00), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, **duke ngarkuar me përgjegjësi: me detyrë ish- Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe anëtarët e KVO, respektivisht: S.K, V.SH dhe D.F.**

Për sa është trajtuar në aktkonstatimi nr. 22, datë 20.4.2023, nga subjekti i audituar shoqëria Albpetrol sh.a Patos është paraqitur observacioni me shkresën nr. 11/133, datë 28.4.2023 (nga anëtarët e KVO D.F, S.K dhe V.SH), si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Nga subjekti është paraqitur lista e mjeteve ku në krah është shënuar tonazhi i tyre, si dhe sqarimi se nuk është efekt negativ, pasi dhe OE tjetër është në kushtet e mos plotësimit të disa prej kriterëve.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa është kundërshtuar nga subjekti, pretendimet **nuk qëndrojnë për faktin** se:

Nuk janë paraqitur dokumente shoqërues (leje qarkullimi) që tregon kapacitetin e mjeteve.

Nuk është argumentuar mungesa e mjetit nga 15 në 14 mjete.

Për mjetet në pronësi nuk është sqaruar pse nuk janë të regjistruara në QKB.
Mjetet e mara me qira nga shoqëria "I...9" me nr. 2750/1812, datë 16.6.2021, konstatohet se kontrata nuk ka të përcaktuar afatin e përdorimit se për sa periudhë është afati i kontratës.

Pika 2.8 e programit. Mbi zbatimin e procedurave të ankandeve për shitjen e naftës bruto, etj.

Më 29.01.2021, Autoriteti shitës, Albpetrol sh.a Patos njofton anulimin e procedurës të ankandit "Procedurë e hapur", me objekt "Shitje nafte bruto, sasia 158 201 ton", zhvilluar më datë 27.01.2021, ora 11.00, pranë ambienteve të MIE, për mungesë konkurrence, pasi nuk u paraqit asnjë ofertë, bazuar kjo në pikën 15, të urdhrit Nr. 83, datë 10.02.2012 "Për rregullat dhe procedurat e shitjes të produkteve hidrokarbure", i ndryshuar.

Më datë 25.02.2021 është bërë njoftim për shitjen e naftës bruto me sasi 120,000 ton, 40,000 për tu shitur brenda vendit dhe 80,000 për eksport.

Procedura për Lotin me sasinë 80,000 ton ka dështuar ndërsa procedura për sasinë 40,000 ton për shitje brenda vendit është fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria "R...E" sh.a., Elbasan, me NUIS ...dhe "A...L" sh.a., Tiranë me NUIS ...

Më datë 07.04.2021 është bërë njoftim ankandi për shitje naftë bruto me sasi 100,000 ton. Më datë 19.04.2021 është shpallur fitues Operatori ekonomik "E...A" sh.a. me NUIS ..., i cili ka ofruar për këtë ankand çmimin:

Në pikat e lëvrimin të Albpetrol sh.a Patos.

73.3 % e çmimit Brent – 3.6 \$/bbl + K

K = 0.0105 \$/bbl

Më datë 21.12.2021 është iniciuar procedura e ankandit për shitjen e 40,194 ton naftë bruto.

Më datë 30.12.2021, Autoriteti shitës, Albpetrol sh.a Patos njofton anulimin e procedurës të ankandit "Procedurë e hapur", me objekt "Shitje nafte bruto, sasia 40 194 ton", zhvilluar më datë 29.12.2021, ora 11.00, pranë ambienteve të MIE, për arsye të mungesës së konkurrencës, pasi nuk u paraqit asnjë ofertë, bazuar kjo në pikën 15, të urdhrit Nr. 83, datë 10.02.2012 "Për rregullat dhe procedurat e shitjes të produkteve hidrokarbure", i ndryshuar.

Më datë 29.04.2022 është njoftuar hapja e procedurës për shitjen e 120,000 ton naftë bruto. Më datë 03.06.2022 është lidhur kontrata me afat 12 muaj, me Kontraktori, BOE "E...A" sha me NUIS ... Tiranë, dhe "R...E" sha me NUIS ...Elbasan.

Çmimi i shitjes (pa TVSH):

Në pikat e lëvrimin të Albpetrol sha

75.33 % e Çmimit Brent – 3.36 USD/bbl + K

K=0.0105 USD/bbl

Titulli i Gjetjes 1: Mos përcaktimi sipas tregut i çmimit të shitjes së produktit naftë bruto në ankande

Situata:

-Bazuar në Aktin Normativ Nr. 2, datë 16.06.2010 të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28/07/1993 "Për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim)", të ndryshuar, shoqëria Albpetrol SHA mund të tregtojë produktet hidrokarbure për tregun vendas, apo për eksport sipas çmimit të bursës ndërkombëtare për hidrokarburet, ku Ministria përgjegjëse që drejton veprimtarinë, miraton procedurat e tregtimit të hidrokarbureve, të parashikuara në Urdhrin nr. 83, datë 10.02.2012 "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve Hidrokarbure" të ndryshuar.

Shoqëria Albpetrol, naftën bruto të prodhuar vetë, dhe sasinë e naftës bruto të përfituar nga kushtet e zbatimit të marrëveshjes me kontraktorët e ndryshëm, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës dhe gazit, e shet nëpërmjet ankandeve publike për tregun e brendshëm ose për eksport. Në lidhje me realizimin e procedurave të shitjes së naftës me ankand, grupi auditues kreu verifikimet mbi zbatimin e bazës ligjore në fuqi dhe përgjegjësi të parashikuara në aktet rregullatorë për strukturat përgjegjëse në shoqërinë Albpetrol sha, për të evidentuar problematikat kryesore si mos saktësime në Urdhrin nr. 83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve Hidrokarbure” të ndryshuar, si dhe zbatimin e tij.

-Në udhëzimin e mësipërm në lidhje me **përcaktimin e çmimit të shitjes** janë pikat 6 e 7, ku citohet: 6. *Çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes përcaktohet nga autoriteti shitës, nëpërmjet çmimit të produktit të publikuar në bursë për Brentin, në momentin e përlllogaritjes, duke marrë në konsideratë koeficientin e konvertimit të këtij çmimi sipas cilësisë së produktit të prodhuar, dhe përcaktohet gjithmonë përpara fillimit të procedurës së shitjes. Në çdo rast, çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes duhet të jetë më i lartë se çmimi i shitjes i programuar nga “Albpetrol” sh.a. për vitin përkatës.* 7. *Për nxjerrjen e të dhënave, sipas pikës 6, krijohet grup ekspertësh të fushës, të propozuar nga “Albpetrol” sh.a., dhe të miratuar nga Ministri. Grupi i ekspertëve duhet të përbëhet nga 3 deri në 5 persona.*

Nga verifikimet e bëra për koeficientin e konvertimit të çmimit Brent sipas cilësisë së produktit të prodhuar u konstatua se grupi i ekspertëve të propozuar nga Albpetrol sh.a Patos., përbëhet nga katër anëtar të shoqërisë si dhe një anëtar i MIE.

Për sa më sipër grupi i eksperteve, për përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar të shitjes së naftës bruto bazohet në studimin e faktorëve që ndikojnë në vendosjen e korrespondencës së cilësisë së naftës së prodhuar nga secili vendburim, duke e krahasuar me karakteristikat e naftës bruto me emrin “Brent”.

Nafta “Brent” është nafta që grumbullohet nga 15 vendburime të ndryshme në Detin e Veriut në portin Sullom Voe, me karakteristika:

Densiteti 37.5 gradë API

- **Përmbajtja e squfurit 0.4%**
- **Aciditeti 0.07 TAN mg KOH/g**

Këto karakteristika kuotohen në Bursën e Londrës me një çmimin Brent në kushte FOB.

Gjithashtu grupi i ekspertëve bën vlerësimin duke mundësuar në përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar të naftës brut në dy kushte të specifikuar si vijon.

-Përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar të naftës brut në kushtet e çmimit FOB (për eksport).

-Përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar të naftës brut në kushtet e çmimit EXË (shitje në pikat e lëvrimit të Shoqërisë)

Për sa më poshtë janë vlerat e marra në ankandin e zhvilluar në vitin 2022.

Sasia e naftës për të cilën janë nxjerrë të dhënat dhe do t'i përcaktohet çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes përbëhet nga:

a. Prodhimi i vetë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në të cilin përfshihet gjendja:

- në magazinat fiskale
- në Qendrat e prodhimit

b. Sasia që do të prodhohet gjatë vitit parashikuar në programin e zhvillimit.

Kjo sasi e ndarë sipas Vendburimeve është si më poshtë:

Naftë e Vendburimit Patos (shkresa nr. 1765 /6 date 18.03.2022)	11 468 ton
Zona 5 (Visokë)	5017.3 ton
Zona 6 (Zharrëz)	6450.7 ton
Naftë e Vendburimit Kuçovë	23 348 ton
Naftë e Vendburimit Gorisht+ Kocul+ Karbunarë	34 271 ton
Naftë e Vendburimit Cakran-Mollaj	14619 ton
Naftë e Vendburimit Amonicë	4857 ton

a) Sasia e naftës që do të merret në natyrë nga Kompanitë palë në Marrëveshje Hidrokarbure:

<u>Nga Kompania “A...L &G...S” sh.a</u>		
Vendburimi “Ballsh”	11 141	ton
<u>Nga Kompania “T...S” sh.a</u>		
Vendburimi Visokë	4 589	ton
<u>Nga Kompania “B.....”</u>		
Vendburimi Patos-Marinëz	15 147	ton
<u>Nga Kompania “SH...D” ltd</u>		
Vendburimi “Arrëz” Tapi	560	ton

Karakteristikat fiziko-kimike të naftave për të cilat janë nxjerrë të dhënat janë të pasqyruara në tabelat e mëposhtme. Këto karakteristika janë nxjerrë bazuar në të dhënat mesatare të analizave që janë kryer për naftat e prodhuara nga vendburimet respektive. Sasia e vendburimit Patos të QPN Fier (Patos), është ndarë në varësi të raportit të prodhimit bazuar në shkresën Nr. 1765/6 datë 18.03.2022 si dhe karakteristikave fizike të zonave në të cilat operohet.

Karakteristikat dhe potenciali i naftës brut për të cilat do të bëhet vlerësimi, metodikë tashmë e konsoliduar, të cilat përcaktojnë dhe relacionin e lidhjes me naftën bruto “Brent”, rezultojnë si më poshtë:

Vendburimi	Densiteti në 15°C i shprehur në (gr/cm ³)	Squfuri i shprehur në (%p)	Benzinë i shprehur në (%p)	Gazoil i shprehur në (%p)	Potenciali i shprehur në (%p)
Patos-Marinëz (B...M ltd)	1.00616	5.400	15.15	28.73	43.88
Visokë (T...S)	1.0126	4.500	14.62	36.03	50.65
Arrëz (SH...D ltd)	0.98	4.490	5.25	21.12	26.37
Ballsh (A...L & G...S)	0.992	5.966	14.7	36.85	51.55
Patos (Zona V)	1.0046	6.200	7.74	23.2	30.94
Patos (Zona VI)	1.0039	5.400	9.3	26.4	35.7
Kuçovë	0.9607	3.900	15.14	30.65	45.79
Cakran-Mollaj	0.9285	3.700	16.1	44.71	60.81
Gorisht-Kocul-Karburnarë	0.9687	5.200	17.97	35.21	53.01
Amonicë	0.9021	3.800	15.6	35.1	50.70

Sasisë që do ti përcaktohet çmimi/njësi minimal fillestar për shitje që prodhohet nga çdo vendburim është në raporte të ndryshme dhe si rrjedhojë karakteristikat dhe potenciali mesatar i ponderuar i naftës që do ti përcaktohet çmimi/njësi minimal fillestar dhe më pas do të përpunohet do të varet nga potencialet e karakteristikat e naftës sipas vendburimeve që përbëjnë sasinë totale, sasi që do ti përcaktohet çmimi/njësi minimal fillestar për shitje.

Siç shihet nga tabela nafta që prodhohet në vendburimet tona nuk plotëson karakteristikat e naftës së kuotuar në tregun ndërkombëtar të quajtur Brent, densiteti 0.8373 gr/cm³ (37.5 gradë API) përmbajtja e sqfurit 0.4 %, aciditeti 0.07 TAN mg KOH/g.

Grupi i ekspertëve në përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar analizon:

-Karakteristikat fiziko-kimike të naftës së prodhuar dhe parashikuar për t'u prodhuar nga aktiviteti i nxjerrjes së vetë Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të ndara sipas vendburimeve dhe ato që do të sigurohen nga marrëdhëniet kontraktuale që shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka me kompanitë e tjera në kuadër të zbatimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure përkatëse, sipas specifikimeve të mësipërme.

-Kostot e transportit, magazinim stokimit dhe sigurimit të produktit naftë brut në stokim dhe në lëvizje në kushtet FOB, kosto të cilat do të ndihmojnë në përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar në pikat e lëvrimit të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos(kushti EXË). Në përputhje me incoterms ndërkombëtarë nga pika EXË (pikat e brendshme e shoqërisë) +kostot e transportit +Risk ne lëvizje+detyrimet ne zonën doganore +ngarkim shkarkim deri ne anije) jane detyrime të shitësit =Çmimin në kushte FOB.

-Sipas buletinit te APP Çmimi në kushte FOB është i njohur kurse çmimi EXË është i panjohur prandaj për ta gjetur këtë çmim duhet nga kushtet FOB të zbriten kostot e mësipërme..

-Praktikat e deritanishme të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për shitjen e naftës brut të cilat kanë rezultuar në lidhjen e kontratave të shitjes së naftës bruto si më poshtë vijon:

-Albpetrol sh.a Patos ka realizuar kontratën me subjektin fitues “T...D Oil” sipas formulës së shitjes: **Çmim = (72.52%*Brent)-5.55USD/bbl + 0.1 \$ USD/bbl.**

-Albpetrol sh.a Patos ka realizuar kontratën me subjektin fitues “P...L” sipas formulës së shitjes: **Çmim = (69.54%*Brent)-3.53USD/bbl + 0.1 \$ USD/bbl.**

-Albpetrol sh.a Patos ka realizuar kontratën me subjektin fitues “P...L” sipas formulës së shitjes: **Çmim = (70.48%*Brent)-4.12 USD/bbl + 0.1 \$ USD/bbl.**

-Albpetrol sh.a Patos. ka realizuar kontratën me subjektin fitues “I...9” sipas formulës së shitjes: **Çmim = (71%*Brent)-4 USD/bbl + 0.1 \$ USD/bbl.**

-Albpetrol sh.a Patos. ka realizuar kontratën me subjektin fitues “T...I” sh.a sipas formulës së shitjes: **Çmim = (74.5%*Brent)- 3.26 USD/bbl + 0.0105\$ USD/bbl.**

-Albpetrol sh.a Patos. ka realizuar kontratën me subjektin fitues “A...L” sh.a sipas formulës së shitjes: **Çmim = (75.27%*Brent)- 2.97USD/bbl + 0.105\$ USD/bbl.**

-Albpetrol sh.a Patos. ka realizuar kontratën me subjektin fitues “ Bashkimi i Operatoreve; A...L sh.a dhe R...Ne sh.a.” sipas formulës së shitjes: **Çmim = (72.89%*Brent)- 3.31USD/bbl.**

-Albpetrol sh.a Patos. ka ne proces realizimi kontratën me subjektin fitues “E...A ” sh.a sipas formulës së shitjes: **Çmim = (73.3%*Brent)- 3.6USD/bbl + 0.0105\$ USD/bbl.**

Në përcaktimin e çmimit minimal fillestar për njësi të naftës bruto në kushtet FOB grupi ka përdorur formulën e cila bazohet në karakteristikat kimike-fizike të naftës bruto dhe ka për bazë modelin:

$$\Delta \text{ çmimit} = a + \Sigma \{ b_i \Delta(\text{cilësive}) \}$$

ku:

- ✓ a – është vlera e Brentit i shprehur ne \$ USD/bbl,
- ✓ b_i - vlera që mat ndikimin ne diferencën e çmimeve te çdo njësie të cilësive Brent (API (densiteti), % Squfuri, Aciditeti, potencialet e bardha).

Δ (cilësi) = ndryshimi i cilësisë së naftës tonë me atë të naftës (Brentit) që i referohet.

Për të përcaktuar karakteristikat e sasisë prej **120,000 ton naftë** bruto është përdorur koncepti i karakteristikave mesatar të ponderuar. Në mënyrë analitike kjo logjikë është shprehur në tabelën e mëposhtme:

Vendburimi	Prodhimi shprehur (ton)	Koeficienti i karakteristikave të naftës %	Rezultati
	a	b	a*b
Patos-Marinëz	15147	69.61	10543.8267
Visokë	4589	70.28	3225.1492
Arrëz	560	75.9	425.04
A...L G...S	11141	69.45	7737.4245
QPN Patos (Zona V)	5017.25	66.71	3347.00748
QPN Patos (Zona VI)	6450.75	69.93	4511.00948
Kuçovë	23348	79.63	18592.0124
Cakran-Mollaj	14619	84.03	12284.3457
Gorisht-Kocul-Karbunar	34271	74.64	25579.8744
Amonicë	4857	85.54	4154.6778
Gjithësej	120000	$\Sigma(a*b)/a=75.33 \%$	90400.3677

Nga kjo llogaritje rezulton se karakteristikat mesatare të ponderuara për njësi të sasisë prej **120,000 ton** naftë brut, sipas sasive dhe karakteristikave të sipërcituara, rezulton të jetë **75.33 %** e shprehur në lidhje me karakteristikat e naftës Brent, naftë e cila në Bursë vlerësohet me çmimin Brent në kushtet FOB.

Në udhëzimin nr. 83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve Hidrokarbure” të ndryshuar, si dhe zbatimin e tij, **mungon koeficienti i konvertimit të çmimit të produktit të publikuar në bursë për Brentin, në momentin e përlllogaritjes.**

Grupi i ekspertëve të Albpetrol, nuk u ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës modelin ku do të bazohet për koeficientin e konvertimit të çmimit Brent pro në mënyrë subjektive ka vendosur të përdorë modele që nuk janë vlerësuar e aprovuar nga organet përkatëse. Me emailin e datës 02.03.2023 znj. E.V, ka dërguar përkufizimin Brentit dhe modelin ku janë bazuar për konvertimin e çmimit Brent. Modeli bazohet në një relacion të Bankës Botërore në vitin 2004, për efekte parashikimi por që nuk ka asnjë koeficient se si ulet çmimi Brent me uljen e karakteristikave si densiteti (API), përmbajtjen e squzurit si dhe aciditetin (TAN). Në observacionin e projekt raportit nga grupi i ekspertëve është dërguar një model “C...L price diferencial”, i cili është pjesë e një materiali studimi që nuk tregon se nga cili autoritet është kryer, dhe i pa aprovuar. Në këtë material gjithashtu u konstatuan dy modele vlerësimi të tre komponentëve të mësipërm, të cilat japin rezultate të ndryshme me diferenca materiale kur aplikohen në çmimin Brent.

Si konkluzion, pa pretenduar të vlerësojmë përlllogaritjet specifike të kryera nga specialistët, konstatojmë se grupi i ekspertëve ka përdorur në mënyrë subjektive me relacione të Bankës Botërore në vitin 2004, për efekte parashikimi dhe statistikore, pa i verifikuar dhe aprovuar më parë këto vlera në autoritetet përkatës, duke rezultuar me çmime më të ulta se tregu real.

Ky model nuk është testuar me tregun, nuk është i studiuar për karakteristikat e naftës që nxirret në vendburimet tona si dhe nuk është aprovuar nga organet përkatëse.

Nga grupi i ekspertëve është observuar se raporti përfundimtar për uljen e çmimit Brent është aprovuar nga MIE, por në raport nuk është përcaktuar modeli i përdorur dhe koeficientet përkatës, por janë referuar vlerat përfundimtare.

Grupi i ekspertëve i është referuar dhe raportit të kryer nga një ekspert i jashtëm në vitin 2017. Në këtë raport përsëri nuk janë përcaktuar koeficientet e zbritjes së çmimit Brent, dhe te cili model duhet të bazohet puna e ekspertëve.

Mungesa e përcaktimit të qartë të këtyre koeficienteve të uljes së çmimit Brent sjell mungesë transparence, subjektivitet në realizimin e tyre dhe rrit riskun e mos realizimit të çmimit maksimal të shitjes së produktit kryesor të Albpetrol sha, pasi vlera të vogla të këtyre koeficienteve për arsye të vlerave të mëdha të kontratave reflektohen në të ardhura materiale të munguara nga shoqëria.

Nga verifikimet e kryera në shitjet që kanë kryer shoqëritë koncesionare, u konstatua se çmimet e shitjes që ka në tregun e jashtëm ose të brendshëm janë rreth 7-15 % më të larta.

-Grupi i auditimit konstatoi se në të gjitha procedurat e ankandit ftesat për ofertë, dokumentet me të dhënat dhe kriteret e kualifikimit janë dërguar për botim vetëm në gazetën kombëtare si dhe në gazetën e botuar në gjuhën angleze “Albanian Daily News”, dhe jo në gazeta të huaja me shpërndarje në Evropë. Ky veprim është në kundërshtim me pikën b, të kreut III, të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar.

-Në procesin e shitjes së produktit naftë bruto tek operatorët ekonomikë, fitues të ankanveve të shitjes, u konstatua se anëtarë të grupit të ekspertëve që përcaktonin karakteristikat specifike për uljen e çmimit Brent ishin dhe pjesë e komisioneve të marrjes së mostrave dhe analizave në cisternat 5,000 ton, në shitjen e produktit. Ky veprim është në kundërshtim me shkronjën b, të pikës 3, të nenit 22 të ligjit Nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ku citohet:

1. Titullarët e njësive publike miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

2. Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: a. procedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standard dhe të rasteve të veçanta; b. ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin;”

Ndikimi/Efekti:

Në kontratën për sasinë 40,000 ton për shitje brenda vendit e fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria “R...E” sh.a., Elbasan, me NUIS ...dhe “A...L” sh.a., Tiranë me NUIS ..., u konstatua diferenca nga çmimet e shitjes së shoqërive koncesionare me çmimet e llogaritura nga Albpetrol në vlerën **54,900 mijë lekë**.

Më datë 07.04.2021 është bërë njoftim ankandi për shitje naftë bruto me sasi 100,000 ton. Më datë 19.04.2021 është shpallur fitues Operatori ekonomik “E...A” sh.a. me NUIS Në zbatimin e kontratës prej 100,000 ton nga krahasimi i çmimeve të shitjes me ato të shoqërive koncesionare u konstatuan diferenca në vlerën **235,500 mijë lekë**.

Më datë 29.04.2022 është bërë njoftim ankandi për shitje naftë bruto me sasi 120,000 ton. Më datë 03.06.2022 është lidhur kontrata me afat 12 muaj, me Kontraktori, BOE “E...A” sha. dhe “R...E sha. Në zbatimin e kontratës prej 120,000 ton nga krahasimi i çmimeve të shitjes me ato të B...M u konstatuan diferenca në vlerën **536,300 mijë lekë**.

Vlera 826,750 mijë lekë është e ardhur e munguar për shoqërinë Albpetrol sha.

Shkaku: Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandeve të shitjes së naftës, të kryhet duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare. Në të ardhmen në procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë të botohen në gazetata e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfitur çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare. Në procesin e shitjes së produktit naftë bruto, drejtimi i shoqërisë të marrë masa që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin si dhe për kontrollin e karakteristikave thelbësore të produktit që shitet.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto, M.B, E.V, P. DH, B.N, P. D, A.B.

Nga ana e anëtarëve të grupit të ekspertëve janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me Projekt Raportin, sipas një shkresë të administruar në Albpetrol sha me nr. 11/159 prot., datë 16.06.2023 dhe në KLSH me nr. 1202/18, prot., datë 19.06.2023.

Pretendimi i subjektit:

Në përgjigje të shkresës suaj Nr.1202/15 prot., datë 19.05.2023 drejtuar Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, regjistruar me Nr. 11/134 prot., datë 23.05.2023, më lëndë “Dërgohet projekt Raport Auditimi”, pika 2.8 e programit “Mbi zbatimin e procedurave të ankandeve për shitjen e naftës bruto”.....

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Në lidhje me qëndrimet tuaja ju sqarojmë se nga ana juaj nuk janë sjellë dokumente ose argumenete shtesë nga sa janë sqaruar më parë, prandaj observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Titulli i Gjetjes 2: *Përlllogaritje të penaltiteteve për vonesa jo në përputhje me dokumentet e ankandit.*

Situata:

-Në kontratën e lidhur nga Albpetrol sh.a Patos., me shoqërinë E...L sh.a., me nr. 2815 Prot., datë 04.05.2021, për shitjen e sasisë 100,000 ton u konstatua se:

-Në Dokumentet Standarde të Ankandit Publik të përdorura në procedurën e ankandit për shitje, në pjesën kushtet e përgjithshme, neni nr. 1.1, “Qëllimi”, citohet: **Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK)** do të zbatohen për blerjen/shitjen e Mallrave/objekteve/ me anë të ankandit të hapur. Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 **Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:** b) *Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.*

Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet, 25.1 **Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së ofertuesit fitues.** Në kontratën e lidhur mes palëve neni 5.9, përcakton :” Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë apo në rast të mos tërheqjes së sasisë së mallit sipas mënyrës së përcaktuar (siç përcaktohet në aneksin nr. 1, bashkëlidhur), blerësi është dakord me penaltitetet ditore që do të llogariten sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”. Kontrata është lidhur bazuar në Urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, i ndryshuar. **Kontrata mes palëve nuk ka pasqyruar kushtet e përgjithshme të procedurës së ankandit.**

Këto mospërputhje kanë pasur efektet në përlllogaritjen e penaltiteteve ditore për vonesat në tërheqjen e sasive të mallit. Albpetrol sha ka përlllogaritur 25 ditë vonesë për vlerën 403,212 lekë penaltitete, kur sipas nenit 24 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës, ku vlera totale e kontratës është 4,594,332,577 lekë, pra 25 % është 1,148,583,144 lekë dhe 2/1000 është 2,297,166 lekë është penaltiteti ditor, për 25 ditë në total prej 57,025,938 lekë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë Albpetrol sha.

-Në kontratën e lidhur nga Albpetrol sh.a Patos., me BOE shoqërinë E...L sh.a., dhe “R...E”sh.a., me nr. 3493/15 Prot., datë 03.06.2022, për shitjen e sasisë 120,000 ton u konstatua se: -Në Dokumentet Standarde të Ankandit Publik të përdorura në procedurën e ankandit për shitje, në pjesën kushtet e përgjithshme, neni nr. 1.1, “Qëllimi”, citohet: **Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK)** do të zbatohen për blerjen/shitjen e Mallrave/objekteve/ me anë të ankandit të hapur. Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 **Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:** b) *Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.* Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet, 25.1 **Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së ofertuesit fitues.** Në kontratën e lidhur mes palëve neni 5.9, përcakton: ” Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë apo në rast të mos tërheqjes së sasisë së mallit sipas mënyrës së përcaktuar (siç përcaktohet në aneksin nr.1, bashkëlidhur), blerësi është dakord me penaltitetet ditore që do të llogariten sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”. Kontrata është lidhur bazuar në Urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, i ndryshuar.

Kontrata mes palëve nuk ka pasqyruar kushtet e përgjithshme të procedurës së ankandit.

Këto mospërputhje kanë pasur efektet në përlllogaritjen e penaliteteve ditore për vonesat në tërheqjen e sasive të mallit. Albpetrol ka përlllogaritur vonesa në vlerën 66,211 lekë penaltete, kur sipas nenit 24, Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore: Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlere do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës, ku vlera totale e kontratës është 4,769,065,763 lekë, pra 25 % është 1,192,266,441 lekë dhe 2/1000 është 2,384,533 lekë është penalteti ditor, për shoqërinë E...L sh.a., janë llogaritur 66,211 lekë, kur penaltetet janë 26,229,863 lekë dhe për shoqërinë "R...E"sh.a., janë llogaritur 89,110 lekë, kur penaltetet janë 54,844,259 lekë.

Vlera 80,918,801 lekë e pallogaritur si penaltetet për vonesat në tërheqjen e sasive të produktit naftë bruto përbën dëm ekonomik për shoqërinë Albpetrol sha.

Kriteri:

Ligji Nr. 9874, datë 14/02/2008 "Për ankandin publik" i ndryshuar me Ligjin Nr. 10 346, datë 04.11.2010, dhe Ligjin Nr. 12/2017, Kreu VI, zbatimi i kontratës, Neni 40 ku citohet: "*Kushtet për zbatimin e kontratës 1. Autoriteti shitës mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e ankandit ose në dokumentet e ankandit. 2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës. Neni 41 Rregullat që zbatohen për kontratën 24 1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e ankandit dhe në ofertën fituese.*"

Ndikimi/Efekti:

Vlerat 80,918,801 lekë dhe 57,025,938 lekë të pa-llogaritura si penaltetet për vonesat në tërheqjen e sasive të produktit naftë bruto përbëjnë të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.

Shkaku: Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtimi i shoqërisë të analizojë situatën në lidhje me të ardhurat e munguara të shoqërisë dhe të marrë masa që në të ardhmen në lidhjen e kontratave me operatorët ekonomikë fitues përlllogaritja e penaliteteve për vonesa në tërheqjen e produktit naftë bruto të bëhet sipas dokumenteve standarde të procedurës së ankandit.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish administratorët F. M.

Nga ana e ish administratorit është dërguar në KLSH observacion në lidhje me aktin e konstatimit, sipas një shkrese të administruar në me nr. 3683/10, prot., datë dhe në KLSH me nr. prot., datë .

Pretendimi i subjektit:

Ish administratori i referohet kontratës për shitjen e sasisë së naftës prej 120,000 ton ku nuk ka qenë në marrëdhënie pune në Albpetrol sha, por në akt konstatim gjetjet janë për kontratën e shitjes prej 100,000 ton, e iniciuar me urdhrin e tij nr. 2351/3 Prot., datë 06.04.2021 dhe me shkresën nr. 2351/13 Prot., datë 19.04.2021, titullari i AK ka miratuar raportin përmbledhës për zhvillimin e procedurës së ankandit me objekt shitje naftë 100,000 ton, ku është shpallur fitues shoqëria E...L sha.

Më datë 04.05.2021, shoqëria Albpetrol sha, përfaqësuar nga administratori ka lidhur kontratën me nr. 2815, me shoqërinë E...L sha.

Nga ana juaj janë pasqyruar nenet e kodit civil për penaltetet jashtë proporcioneve dhe qëllimi i penaliteteve në një kontratë mes palësh, duke ju referuar kreut të "Kushteve penale", neni 544, citon se: "Kur kushti penal është tepër i madh në krahasim me dëmin e pësuar nga kreditori, gjykata me kërkesën e debitorit mund të pakësojë kushtin disiplinor deri në nivelin e dëmit të pësuar.", kur përgjegjësia e titullarit të një shoqërie publike është të sigurojë interesat e shoqërisë.

Në observacion ju keni trajtuar kontradiktat ligjore midis Udhëzimit nr. 83 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure” dhe ligjit për ankandin publik, të cilat qëndrojnë dhe kanë reflektuar dhe në gjithë procedurën e ankandit.

Në pjesën e dokumenteve të ankandit të aprovuara nga ju si titullar i AK, janë të përcaktuara si në nenin 24, likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar në 2/1000 në ditë me minimalisht 25% të vlerës së kontratës. Pas përfundimit të procedurës dhe shpalljes së fituesit është firmosur kontrata mes palëve nga ana juaj me kushte të tjera të penalteteve.

Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008, “Për ankandin publik”, i ndryshuar, Neni 2 Parimet e zhvillimit të ankandit publik, ku citohet: “Zhvillimi i procedurave të ankandëve publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) **mosdiskriminimit dhe trajtimi i barabartë i pjesëmarrësve në procedurat e ankandit publik;** b) **transparenca në procedurat e ankandit publik;**”

Mos qartësia e kushteve të penalteteve ka bërë që Operatorë Ekonomikë potencialë të mos marrin pjesë në procedurë duke sjellë diskriminim dhe mungesë transparence.

Ju keni cituar rregulloren e Albpetrol në lidhje me rregulloren e brendshme të Albpetrol sh.a Patos. e cila në Kreun II), në pikën 10 të saj përcakton se, është sektori i prokurimeve publike dhe ankandëve që midis detyrave të tjera kryen edhe “Hartimin e kontratës dhe hartimin e urdhrin për monitorimin dhe zbatimin e kontratës”. Sektori i prokurimeve publike dhe ankandëve ka hartuar kontratën sipas kontratës tip, të përcaktuar në udhëzim.

Në nenin 49 të rregullores së Albpetrol sha, cilësohet se “Administratori është organi më i lartë ekzekutiv i shoqërisë i cili administron, drejton dhe përfaqëson shoqërinë lidhur me vënien në zbatim të politikave tregtare.” dhe në zbatim të nenit 3 të ligjit 10 296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, i cili citon: “Ky ligj zbatohet në njësitë publike, ku sipas ligjit përfshihen: 2. **Shoqëritë tregtare**, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme., dhe neni 8, Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit, ku citohet: “Titullarët e njësisë publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. “3. Titullarët e njësisë publike, të përmendura në pikat 2 e 3 të nenit 3 të këtij ligji, mund të caktojnë një nëpunës të nivelit më të lartë drejtues dhe t’i ngarkojnë atij përgjegjësi që janë të barsvlershme me ato të nëpunësit autorizues. 4. Në rast moskaktimi të nëpunësit autorizues, përgjegjshmëria menaxheriale dhe përgjegjësitë, sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij ligji, i takojnë titullarit të njësisë publike. Neni 9, Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues 1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton titullarit të njësisë publike për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmerisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe personi përfaqësues i shoqërisë, problematikat e dokumenteve standarde të procedurës së ankandit dhe kontratës tip, të cilat kanë sjellë diskriminim të operatorëve ekonomik si dhe mungesë transparence në ankandet e shitjes së naftës, është detyra e administratorit që problematikat dhe kontradiktat e sipërcituara të bëhen me dije në organin i cili ka tagrin dhe ka lëshuar Urdhrin nr. 83 “Për shitjen e naftës bruto” me ndryshime.

Observacioni merret pjesërisht në konsideratë në lidhje me kontradiktat që Urdhri nr. 83.

Titulli i Gjetjes 3: Parregullsi në trajtimin e produktit naftë bruto.

Situata:

-Më datë 05.01.2022, Dega e Doganës Fier me shkresën nr. 5087/3, i ka dërguar Albpetrol njoftimin e proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative. Si rezultat i verifikimit në vend të

magazinave fiskale u konstatuan mangësi të pajustificuara mes gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël në sistem. Referuar nenit 90 dhe 90/12 të Ligjit nr. 61/2012, “Për Akcizat në RSH”, i ndryshuar, për mangësitë e konstatuar e cila tejkalon 2% firot e krahasuar me regjistrat kontabël, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me trefishin e detyrimeve të akcizës së munguar. Sasia e gjetur në mungesë është 1,486,742 kg.

Detyrimi i papaguar është në vlerën 37,168,557 lekë plus penalitetet në vlerën 111,505,672 lekë, në total 148,674,230 lekë.

Vlera 148,674,230 lekë përbën shpenzime jo të justifikuara për shoqërinë Albpetrol sha.

-Albpetrol sha., më datë 03.03.2022 ka lidhur me shoqërinë A....6 shpk, kontratën me objekt “Riparim pjesor dhe pastrim i mbetjeve të RVM 5000/8 m3 në stacionin e shitjes së naftës në Zharrëz. Grupi i punës nga Albpetrol për përgatitjen e depozitës i përbërë nga D.H, A.Z, E.Ç dhe P. D, në relacionin me nr. 428 prot., datë 13.05.2022, pas procedurës së hapjes për efekt pastrimi, kanë kryer operacionet si largim uji dhe mbetje inerte ranore, është zhvendosur masa volumore e rezervuarit prej 311.1 ton, në gropen ekologjike pranë stacionit Zharrëz. Në këtë masë pas analizave kanë rezultuar 24.33 ton ujë i lirë, 53.62 ton ujë i lidhur, 145.1 ton mbeturina mekanike dhe 88.04 ton naftë. Kjo sasi naftë është propozuar për tu ulur nga bilanci i muajit prill 2022. Sasinë prej 311.1 ton që Albpetrol sha e ka hedhur si mbetje e ka pasur në bilancin e naftës si produkt gjendje. Grupi i inxhinierëve sa më sipër ka dhënë argumente lidhur me naftën që vjen në depozitë jo me standardet e përcaktuara.

Lidhur procesin e pastrimit të depozitës nga Albpetrol sha, i është dërguar një shkresë Doganës Fier, por në procesin e hapjes së depozitës si dhe në hedhjen e mbetjeve ranore në gropën ekologjike nuk ishte prezent asnjë përfaqësues i Doganës apo inspektor i Tatimeve për të certifikuar heqjen nga produkti i gatshëm naftë sasinë prej 311.1 ton.

Vlera e naftës 311.1 ton është 17,923,404 lekë. Gjoha nga organet tatimore është në vlerën 100% plus dhe 15%, 2,688,510 lekë, pra në total 20,611,914 lekë.

Nga mosveprimet e shoqërisë Albpetrol sha janë evidentuar efekte ekonomike negative me dëm në vlerën 20,611,914 lekë.

-Albpetrol sha në lidhje me veprimet që ka kryer për riparimin e depozitës RMV 8000/8 në Zharrëz nuk ka zbatuar udhëzimet në lidhje me ligjin për akcizën, ku citohen qartë lajmërimet që duhet të kryente si dhe detyrimin për prezencën e përfaqësuesve të Doganës në momentin e fillimit të riparimeve si dhe në momentin e groposjes së masës volumore 311.1 ton naftë bruto.

Kriteri:

*Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me pikën 3.6 të Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku citohet: “r. Firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit dhe transportimit etj., do të njihen si shpenzim i lejuar deri në nivelin e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, sipas pikës “m” të nenit 21 të ligjit. (Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 31, datë 29.12.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 206, datë 8 janar 2015). s. Në rastin e nxjerrjeve jashtë përdorimit ose shkatërrimit të materialeve apo mallrave të cilat për arsye të ndryshme, si dëmtime, kalim i afatit të skadencës, etj., janë të papërdorshme ose të pa tregtueshme apo tregtohen më çmime të ulura, përfshirë uljen sezonale, **shpenzimet përkatëse ose të ardhurat e reduktuara do të njihen për efekt fiskal vetëm nëse vërtetohen me proces-verbalin përkatës të mbajtur nga një komision të posaçëm vlerësimi, dhe subjekti ka njoftuar organin tatimor përkatës. Ky njoftim duhet të shoqërohet me një kopjo të procesverbalit përkatës. Organi tatimor mund të dërgojë përfaqësuesin e vet që të jete prezent në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit ose shkatërrimit të mallit, jo me vone se 5 dite nga data e njoftimit.. Proces-verbali i vlerësimit duhet të përmbajë të dhëna të plota mbi sasinë, vlerat, kohën e furnizimit, arsyet e zhvlerësimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit, duke i garantuar organeve tatimore mundësinë e verifikimit dhe kontrollit.***

VKM Nr. 612, datë 2.9.2012 i ndryshuar, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat” Neni 23, Mangësi/diferencat 1. Mangësi/diferencë në magazina fiskale do të konsiderohet 8: a) Në magazinat fiskale të prodhimit/përpunimit, diferenca ndërmjet sasisë së pritshme të prodhimit, e cila llogaritet në bazë të sasive të lëndëve të para të përdorura, normativave të procesit të prodhimit

dhe koeficienteve të humbjes në prodhim, përcaktuar në autorizimin e depozituesit të miratuar me sasinë e produkteve të akcizës, të deklaruar si të prodhuara nga këto lëndë të para. b) Në magazinat fiskale në stokim, diferenca ndërmjet sasisë së produkteve të akcizës, të regjistruara në regjistrat dhe kontabilitetin e stokut të magazinave fiskale dhe sasisë së mallrave të akcizës, të gjetura gjatë kryerjes së një kontrolli fizik të mallit gjendje. 2. Mangësi/diferencë në lëvizje është diferenca ndërmjet sasisë së produkteve të akcizës, të deklaruar në dokumentin administrativ shoqërues DSHA në vendin e nisjes (ose pikën e importit kur mallrat e akcizës janë të importuara) dhe sasisë së produkteve të akcizës, gjendje në mjetin e transportit kur dërgesa arrin në destinacion.

Neni 25, Humbjet aksidentale dhe avaritë në magazinën fiskale 1. Si parim, depozituesit e miratuar duhet të paguajnë detyrimet për sasi të humbura aksidentalisht apo nga avaritë në magazinat fiskale. 2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, mund të jepet autorizim nga autoritetet doganore për mospagim të detyrimeve të akcizës për sasi të humbura aksidentalisht në rastet e mëposhtme: a) Humbje që rezultojnë nga forcat madhore; b) Humbje që nuk rezultojnë nga forcat madhore, por aksidentale; c) Shkatërrim/asgjësim (ose dërgimi në një vend të autorizuar shkatërrimi/asgjësimi), nën kontrollin e administratës doganore për produktet e prishura/të bëra të papërdorshme. 3. Në momentin që depozituesi i miratuar konstaton një humbje aksidentale apo avari, cilido qoftë shkaku, duhet të lajmërojnë menjëherë zyrën doganore mbikëqyrëse me çdo lloj mjeti të shkruar, me qëllim që autoritetet doganore të inspektojnë vendin, duke bërë një procesverbal ku të shënohen rrethanat e ngjarjes, shkaqet dhe pasojat, si dhe për të konstatuar sasi të humbura. Ky procesverbal ka për qëllim të konstatojë sasi të mungojnë. 4. Autoritetet doganore në këto raste: a) procedojnë menjëherë me vlerësimin e sasive të humbura; b) bëjnë një numërim të sasive ekzistuese në magazinën fiskale nëse humbjet nuk mund të identifikohen menjëherë dhe në mënyrë tjetër; c) bëjnë një balancim të llogarive dhe regjistrojnë si dalje sasi të mangët që dalin nga ky balancim. 5. Administrata doganore mund të pranojë humbjen e sasive të produkteve, si rrjedhojë e aksidenteve në rastet e forcave madhore, parashikuar në nenin 30 të këtij vendimi, dhe humbjeve që nuk rezultojnë nga forca madhore, parashikuar në nenin 31 të këtij vendimi. 6. Në rastin kur këto aksidente ndodhin jashtë orarit zyrtar të zyrës doganore mbikëqyrëse, njoftohet menjëherë Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit dhe Drejtoria e Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. 9 Procedurat e mëtejshme kryhen sipas pikave 3 e 4 të këtij neni. 7. Këto dispozita aplikohen për të gjitha produktet nën regjimin e magazinës fiskale.

Neni 101 Punimet dhe ndërhyrjet për riparime në depozita 1. Për qëllime të pikës 3 të nenit 53 të ligjit, depozituesi i miratuar nuk duhet të ndërhyjë për të bërë riparime, zëvendësime dhe punime të tjera në rezervuarët (depozitat) e magazinës fiskale, të cilat kërkojnë heqjen e plumbçeve të vëna nga autoritetet doganore. Punimet e mësipërme bëhen pasi janë njoftuar, me shkrim, autoritetet doganore, pasi janë miratuar prej tyre dhe në prani të autoriteteve doganore. 2. Depozituesi i miratuar nuk duhet të bëjë ndërhyrje për të ndryshuar formën apo kapacitetin e depozitave të magazinës fiskale, pa njoftuar me shkrim autoritetet doganore dhe më pas ta pajisë rezervuarin (depozitën), ku ka ndërhyrë, me një certifikatë rikapacitimi, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Ndikimi/Efekti:

Nga mosveprimet e shoqërisë Albpetrol sha janë evidentuar efekte ekonomike negative me dëm në vlerën 20,611,914 lekë.

Shkaku: Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtimi i shoqërisë të marrë masa për të analizuar rastet kur nuk janë marrë masat për lajmërimet e detyrueshme të institucioneve doganore dhe tatimore, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për gjobat relative, si dhe marrjen e masave që në të ardhmen nëpunësi autorizues të identifikojë detyrimet doganore e fiskale të shoqërisë, dhe ndjekjen me përgjegjësi dhe profesionalitet nga personat përkatës.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish administratori K. C., administratori E.D dhe drejtori i Drejtorisë Ekonomike A.B.

Nga ana e znj. A.B janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me Projekt Raportin, sipas një shkrese të administruar në Albpetrol sha. me nr. 11/142, prot., datë 14.06.2023 dhe në KLSH me nr. 1202/18 prot., datë 19.06.2023.

Pretendimi i subjektit:

Znj. A.B pretendon se sasia e produktit naftë figuron në bilancin material dhe inventarët e shoqërisë, si dhe produkti naftë bruto nuk trajtohet si mallrat e zakonshëm por si objekt akcize përfshihet dhe në kontrollet doganore dhe më poshtë trajton nenin 80, të VKM 612 datë 05.09.2023 “Të Ligjit për Akcizat”, i ndryshuar, pikën (ë) dhe citoni nenin 30, 34, 39, dhe 80. Ju citoni se drejtimi i shoqërisë e ka gjendje në bilancin material dhe në inventaret e shoqërisë dhe se jeni në pritje të vendimmarrjes për këtë sasi.....

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi nuk janë paraqitur argumente ose dokumente shtesë.

Nga ana e E. D. janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me Projekt Raportin, sipas një shkrese të administruar në Albpetrol sha. Me nr 11/179, prot., datë 19.06.2023 dhe në KLSH me nr. 1202/18 prot., datë 19.06.2023.

Pretendimi i subjektit:

Për pikën 2.8 të Projekt Raportit “Mbi zbatimin e procedurave të ankandëve për shitjen e naftës bruto etj.” Gjetja 3: Parregullsi në trajtimin e produktit naftë bruto.

Së pari, ju sjell në vëmendje se unë kam filluar ushtrimin e detyrës së Administratorit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a me miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës të vendimit nr. 17, datë 10.10.2022, dhe vendimin nr. 7473/4, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, datë 13.10.2022.

1.Në lidhje me pastrimin e Rezervuarit 5000/8 në Zharrëz, ku më ngarkoni me përgjegjësi mua, me atributin e Administratorit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Ju bëj me dije se:

Në asnjë moment, unë si titullar i institucionit nuk kam marrë pjesë dhe nuk jam informuar zyrtarisht për çka citohet në këtë aktkonstatimi, gjë që provohet me vendimin e Aksionerit, për miratimin tim në këtë detyrë (10.10.2022.)

Gjithashtu, sjell në vëmendjen tuaj se shoqëria “Albpetrol” sh.a, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës së miuruar, me ndarje në Departamente, Drejtori dhe struktura të tjera të varësisë: Qendra prodhimi dhe shërbimi. Në këto kushte, detyrat dhe përgjegjësitë janë të ndara dhe të përcaktuara qartë.

2.Në lidhje me konstatimin mbi sasinë e ujit që tejkalojnë normat teknologjike në produktin naftë, ku unë, jam ngarkuar me përgjegjësi, ju informoj se nga ana ime, në cilësinë e Administratorit janë marrë të masat e nevojshme për të zbatuar urdhrin Nr.3312 Prot., datë 22.04.2022 “Për menyrën dhe procedurat e blerjes së produktit të gatshëm për shitje nga QPN drejt QASHNG Patos”, në të cilin është përcaktuar që për çdo procedurë shitje nga QPN drejt magazinave fiskale nën administrimin e QASHNG do të kryhet sipas akteve ligjore të përcaktuara dhe standardit shtetëror të shitjes së produktit hidrokarbur “Naftë Brut”, si dhe përgjegjësia ligjore dhe administrative.

Sjell në vëmendjen tuaj se, unë jam në detyrën e menaxherit të shoqërisë dhe shoqëria ka strukturat përkatëse që merren me detyra të përcaktuara në Rregulloren e Organizimit dhe funksionimit të shoqërisë dhe, në këtë kontekst, ju lutem të merni parasysh adresimin e përgjegjësive tek personat që e kanë këtë detyrë funksionale.

Në cilësinë e Administratorit të shoqërisë, në mënyrë kategorike nuk kam dhënë urdhra të jashtëligjshëm, përkundrazi kam ndjekur me përgjegjshmëri aktet ligjore në fuqi.

Sa më sipër, bashkëlidhur gjeni:

- urdhrin nr. 3312 prot., datë 22.04.2022,
- vendimit nr. 17, të Këshillit Mbikëqyrës të datë 10.10.2022,
- vendimin nr. 7473/4, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, datë 13.10.2022.

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Në lidhje me pretendimin tuaj se nuk kishit dijeni dhe nuk jeni njoftuar zyrtarisht për situatën e gruposjes së 311.1 ton produkt naftë, ju kujtojmë se:

Propozimi i Këshillit Mbikëqyrës për emërimin tuaj si administrator i Albpetrol sha është aprovuar nga Ministri i MIE, më datë 13.10.2022. Më datë 10.11.2022 me urdhrin nr. 8192 Port., si dhe me urdhrin nr. 9358 Prot., më datë 29.12.2022, keni ngritur komisionin për kryerjen e inventarit fizik të naftës bruto për muajin dhjetor, duke kërkuar në fund që një relacion ti dërgohet administratorit të shoqërisë. Më datë 30.12.2022, drejtori i QASHNG në zbatim të urdhrin tuaj i ka shtuar grupit të vendosur nga ju kryeinxhinierin, kryetarin e Degës Teknike, dhe inxhinier si pjesë përfaqësuese në inventarizim. Drejtoria e QASHNG më datë 10.01.2023, me shkresën nr. 13/1 Prot., ju ka njoftuar mbi bilancin e naftës dhe të gazit duke evidentuar dy problematika. Sasia e produktit naftë e pamarrshme në sasinë 413.2 ton në ish parkun e dekantimit Sheqishte – Marinëz, ku citohet: QASHNG Patos është në pritje të vlerësimit dhe miratimit nga ana juaj për zbritjen e sasisë së naftës prej 413.2 ton nga nafta e lëvizshme në stacionin e naftës Zharrëz dhe kalimin e kësaj sasive si naftë e pamarrshme. Pika e dytë citon procedurën e hapjes së RVM 5000/8, si dhe gruposjen e 311.1 ton naftë dhe përsëri njofton se është në pritje të vlerësimit nga ana juaj për zbritjen nga bilanci i QASHNG Patos.

Më datë 10.01.2023, me nr. 13 Prot., drejtori i QASHNG ka dërguar bilancin fizik të naftës e të gazit për muajin dhjetor 2022, me vendimin e drejtorisë si dhe mendimin e Këshillit Tekniko-Shkencor me nr. 13/2 Prot., datë 10.01.2023.

Këto shkresa janë hartuar dhe drejtuar për miratim për zbritje nga bilanci i naftës.

Për sa më sipër ju kujtojmë se bazuar në Udhëzimin nr. 30 datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” në pikat citon: “ 87. Nëpunësi Autorizues me të marrë dokumentacionin e inventarizimit, nxjerr urdhrin për ndjekje nga Nëpunësi Zbatues në lidhje me masat për kompensimin dhe sistemimin e diferencave të rezultuara. 90. Mungesat përtej normave të firove ligjore, prishjet dhe dëmtimet e aktiveve që u ngarkohen fajtorëve, vlerësohen si vijon: a. Aktivitet në magazine në bazë të çmimit të shitjes me pakicë, dhe, kur nuk ka të tillë, në bazë të kostos së blerjes; b. inventari i imët në përdorim dhe ambalazhi jo me pak se 50% të çmimit të blerjes ose të kostos. c. aktivitet afatgjatë materiale dhe jomateriale në bazë të vlefës bruto (vlefë fillestare dhe shpenzimet e mëpasshme të aktivitetit) të pakësuar me amortizimin efektiv, ose vlerës se drejte por jo me të vogël se vlera neto kontabël. 93. Nëpunësi autorizues i njësisë jep urdhër zhdëmtimit për mungesat e konstatuara në ngarkim të personave me përgjegjësi materiale. Nëpunësi Zbatues ndjek procesin dhe kryen regjistrimet kontabël përfundimtare. “

Nëpunësi Autorizues është Administratori i shoqërisë, i cili duhet të marrë masat përkatëse në rastet e evidentimit të mungesave në inventarizimet e aktiveve të shoqërisë.

Nga ana juaj nuk janë marrë masat përkatëse për të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe veprimet kontabël dhe deklarimet tatimore e doganore përkatëse.

Neni 47, Rregullorja e shoqërisë. Administratori i shoqërisë përgjigjet për vendosjen dhe përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të shoqërisë, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në mënyrë të ligjshme me efektivitet dhe eficiencë. Neni 48, pika e), përshkruan funksionin e Këshillit Tekniko-Shkencor që ka si qëllim të ndihmojë në mbarëvajtjen e problemeve teknike e shkencore që ka veprimtaria e shoqërisë nëpërmjet opinionëve ose rekomandimeve të Administratorit.

Observacioni nuk merret në konsideratë.

Nga ana e z. K. C. janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me Projekt Raportin, sipas një shkrese të administruar në Albpetrol sha. pa nr., prot., datë 16.06.2023 dhe në KLSH me nr. 1202/19 prot., datë 19.06.2023.

Pretendimi i subjektit:

Z. C ka paraqitur masat e mara me specialistët e Albpetrol sha., për diskutimet me grupet e ndryshme rreth problematikave të pastrimit të depos, por në asnjë rast nuk pasqyrohet se përse nuk u njoftuan organet tatimore.

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi nuk janë paraqitur argumente ose dokumente shtesë.

Titulli i Gjetjes 4: Prodhimi i produktit naftë bruto jo në konform me standardet përkatëse.**Situata:**

Në auditimin e lëvizjeve të produktit naftë bruto nga qendrat e prodhimit në qendrën e shitjeve u konstatua se produkti naftë në shumë raste dorëzohet jashtë standardit teknologjik S SH 51:1986 (Naftë bruto – Karakteristikat). Sipas standardit sasia e ujit nuk duhet të tejkalojë në përqindje për sektorët Ballsh 2%, Visokë 3%, Kasnicë 5%, Marinëz 2%, Marinëz sektorët 5,6,7 3%, Gorisht Amenicë 2% dhe Kuçovë 3%. Në fletë hyrjet e Qendrës së Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit, QASHNG, u konstatuan raste të pranimit të produktit naftë në kushtet kur tejkalohej sasia e pranuar e ujit.

-Në lidhje me sasinë e ujit që tejkalojnë normat teknologjike në produktin naftë argumentimet e specialistëve të QASHNG, Qendra e Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit, janë se nafta vjen jashtë standardeve nga qendrat e tjera, dhe për këtë fakt janë njoftuar administratorët, të cilët kanë lëshuar urdhra për pranimin e produktit naftë bruto dhe jashtë standardeve teknologjike, (me ujë mbi 3%, deri në 14%). Urdhrat nr. 182 datë 07.09.2021, “Për procedurë e inspektimit dhe kontrollit të qarkullimit të produktit Naftë Bruto”, 182/2 datë 16.12.2021, dhe 182/3 datë 17.12.2021.

Argumentet e sjella nga qendrat janë se nuk kanë pajisjet për të bërë ndarjen e plotë të ujit dhe se nuk mund të ndalojnë punën në puse. Në momentin kur produkti i gatshëm i shitet kompanive fituese të ankandëve, në depozitat e shitjes nafta bruto ngrohet dhe përgatitet në parametrat teknologjikë me përqindje uji më të vogël se 3%, ndërkohë që pjesa tjetër është produkt i gatshëm në mungesë.

QASHNG Patos është magazinë fiskale stokimi dhe nuk lejohen shkarkime uji teknologjik pas përgatitjes, si trajtim me sistem ngrohje me kaldajë mbi vlerën e lejuar.

Mos marrja e masave për zgjidhjen e problemeve për pasjen e produktit të gatshëm naftë bruto sipas standardeve teknike nga ana e administratorëve ka sjellë diferenca të produktit të gatshëm të kaluar në sistemin e doganës me kontabilitetin e mbajtur në shoqërinë Albpetrol sha.

Laboratorët e përdorur në Albpetrol sha për analizat e produktit naftë bruto nuk janë të akredituar nga autoritetet përkatëse.

Shoqëria Albpetrol sha, nuk ka përmbyllur investimet për të ngritjen e strukturave teknologjike të cilat do të mundësojnë heqjen e sasive të ujit mbi normë.

Kriteri: Standardet kombëtare të produktit naftë bruto.

Ndikimi/Efekti:

Duke qenë se produkti naftë lëvizet nga vendburimet në stacionin e shitjes me tubacione dhe autobote, verifikimi në depozitë për përqindjen e ujit dhe zbritja në kontabilitet si produkt i gatshëm shton riskun e abuzimeve në produktin e gatshëm.

Shkaku: Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore dhe standardeve përkatëse.

Rëndësia: E lartë**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtimi i shoqërisë të analizojë me kujdes situatën dhe të marrë masa për përfundimin e investimeve që do të mundësojnë përgatitjen e produktit naftë sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare për të rritur performancën dhe të ardhurat si dhe ulje e riskut të abuzimeve dhe cenimeve.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi administratorët e shoqërisë gjatë periudhës së auditimit F. M, K. C dhe E.D.

Nga ana e z. K. C. janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me Projekt Raportin, sipas një shkrese të administruar në Albpetrol sha. pa nr., prot., datë 16.06.2023 dhe në KLSH me nr. 1202/19 prot., datë 19.06.2023.

Pretendimi i subjektit:

Z. C ka pretenduar se ka marrë masat e duhura me Urdhrin nr. 140 datë 10.06.2022 si dhe me komunikim verbal është urdhëruar mospranimi nga QASHNG i naftës së qendrave të prodhimit mbi normën ujë 3%.

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi nuk janë paraqitur argumente ose dokumente shtesë.

Titulli i Gjetjes 5: *Pa saktësi në procesin e lëvrimin klientëve të sasive së produktit në depozitat e naftës.*

Situata:

Qendra e Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit menaxhon shitjen e produktit naftë bruto tek Operatori Ekonomik fitues i procedurave të ankandit. Procedurat e marrjes së kampioneve dhe analiza e naftës kryhet sipas nenit 6 të Udhëzimit nr. 83 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, i ndryshuar. Mbasi rezervuari pritës i naftës bruto të jetë mbushur sipas kushteve teknike, mbyllet saraçineska e hyrjes dhe e daljes së rezervuarit. Në momentin që do të dorëzohet rezervuari, kryhet matja fizike e lartësisë së lëngut në rezervuar. Më pas kryhet konvertimi në m³ sipas tabelave përkatëse të kalibrimit të çdo rezervuari. Në praninë e përfaqësuesve të autorizuar nga shitësi dhe blerësi organizohet marrja e kampionit të naftës bruto në rezervuarin e naftës të përgatitur për shitje sipas SSH 4786. Kampioni do të përgatitet nga përzjerja e sasive të (1-3-1) të naftës bruto të marrë në tre lartësi të ndryshme të rezervuarit, e konkretisht: – Kampioni i parë, 20 cm në nivelin e sipërm të lëngut në rezervuar (një njësi); – Kampioni i dytë, në mesin e nivelit të lëngut në rezervuar që është midis sipërfaqes së lëngut dhe aksit të saraçineskës të thithjes nga rezervuari (tre njësi); – Kampioni i tretë merret në aksin e saraçineskës të thithjes së rezervuarit (një njësi). Kampionimi dhe analizat kryhen nga personel i kualifikuar për matje të tilla dhe të autorizuar nga shitësi gjithmonë në prani të të dyja palëve. Para marrjes së kampioneve të naftës në prani të dyja komisioneve kontrollon rezervuari për përmbajtjen e ujit të lirë në nivelin e daljes nga rezervuari. Kampioni mesatar për analizë përgatitet nga përzjerja e tre mostrave të marra në të trija lartësitë e rezervuarit. Nga kjo përzjerje merret mostra për kryerjen e analizës për përcaktimin e përmbajtjes së ujit sipas SSH 35 dhe të mbetjeve mekanike në naftën bruto sipas SSH 43. Analizat kryhen në laboratorin e stacionit përkatës, në prani të të dyja komisioneve. Analiza e kampionit fillon me matjen e temperaturave mesatare të rezervuarit dhe të kampionit në cilindër.

Densiteti i kampionit përcaktohet sipas metodës SSH 33, duke përdorur një aerometër të përshtatshëm dhe të kontrolluar. Temperatura dhe densitetet e matura dhe të korrektuara regjistrohen në “Raportin e analizave të naftës bruto” të përgatitur për kampionim. Përmbajtja e ujit në kampionin mesatar bëhet duke përdorur metodën SSH 35 (Metoda Dean Stark). Përmbajtja e lëndëve mekanike do të bëhet duke përdorur metodën SSH 43 (centrifugë). Mbas analizës përgatitet “Raport i analizave të naftës bruto” (raport analizë)”.

Llogaritja e naftës bruto që do të shitet dhe plotësimi i faturës teknike bëhet me të dhënat: Vëllimi i naftës bruto neto në m³ në temperaturën mesatare të depos; Peshë e naftës bruto neto në ton. Blerësi merr në dorëzim depon dhe fillon evadimin e naftës bruto me autobote. Ky proces zgjat nga 4-7 ditë. **Zbrazja e depos vazhdon deri në një nivel të caktuar dhe nuk boshatset deri në fund.** Faturat bëhen për çdo autobot në bazë të peshës dhe duke marrë të dhënat e analizave të kryera në fillim të procesit dhe duke ju referuar temperaturës 15%.

Gjendja e strukturave dhe pajisjeve nga ku realizohet lëvrimi tek klientët është jashtë standardeve përkatëse. Depozitat e naftës, pajisjet matëse nuk janë certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, laboratorët që kryejnë analizat e mostrave nuk janë të akredituar nga institucionet përkatëse.

Nga kontrollat periodike të ushtruara nga Dega e Doganës Fier kanë rezultuar diferenca materiale të produktit naftë bruto të rezultuar nga matjet faktike me atë kontabël të mbajtur nga Albpetrol sha. Në observacionet e Albpetrol sha, ndaj diferencave të konstatuara janë sjellë si arsye sjellja e produktit naftë bruto me ujë mbi normat teknologjike si dhe për kontrollin e ushtruar më datë 21.09.2021, një defekt i bllokimit të galixhandit i cili ka sjellë një diferenca prej 101.3 m³.

Grupet e kontrollit të Degës së Doganës Fier, në kontrollat në lidhje për pagesat për akcizën, procedurat për matjen e sasive të naftës bruto në rezervuare, i kanë të përcaktuar në VKM nr. 612, datë 02.09.2012, ndryshuar, të cilat ndryshojnë nga metodologjia që përdor Albpetrol sha.

Kjo metodologji që përdor shoqëria nuk është e saktë dhe korrekte pasi kryhen tre matje të temperaturës dhe densitetit për një depozitë 5000 ton, dhe ndërkohë lëvrimi i sasisë mund të zgjasë deri në një javë si dhe depozita nuk zbrazet plotësisht. Në udhëzimin për akcizën citohet qartë se një luhajtje e vogël e temperaturës mund të shkaktojë lëvizje në mijëra litra në matje, po kështu dhe në densitetin e masës së produktit. Pra nëse komisioni bën një gabim në vlerësimin e densitetit në matjen e depozitës kryesore në shitje, depozitë e pa certifikuar nga DPM, si dhe duke marrë një numër të kufizuar mostrash, ky gabim reflektohet në gjithë sasinë e shitur.

Komisionet e caktuara për kryerjen e analizave të densitetit, bazohen në pikën 6.9, të Urdhrit nr. 83, ku citohet: *“Densiteti i kampionit do të përcaktohet sipas metodës SSH 33, duke përdorur një aerometër të përshtatshëm dhe të kontrolluar. Temperatura dhe densitetet e matura dhe të korrektuara do të regjistrohen në “Raportin e analizave të naftës bruto” të përgatitur për kampionim.”* Ky standard është shfuqizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve dhe është zëvendësuar me SSH EN ISO 3675:1998. Ky standard në lidhje me marrjen e mostrave i referohet ISO 3170 (SSH EN ISO 3170:2004 59 faqe, KT 19, Produkte të lëngëta të naftës - Marrjen e mostrave manualisht), ose ISO 3171 (SSH EN ISO 3171:1999 59 faqe, KT 19, Metodat e provës për naftën dhe produktet e saj - Lëngjet e naftës -Marrja automatike e mostrave me tubacion) .

Standardi ISO 3170 që ka si objekt marrjen e mostrave në mënyrë manuale, në pikën 8.1, Procedurat për naftën bruto dhe likuide të tjera vajore jo-homogjene, citon se: *“Nëse është e mundur marrja e mostrave në tuba në mënyrë automatike siç specifikohet në standardin ISO 3171, do të përdoret në marrjen e mostrave në naftën bruto kundrejt marrjes së mostrave në mënyrë manuale”*. Marrja e mostrave në mënyrë manuale mund të mos ofrojë mostra që janë përfaqësuese për arsyet të ndryshme si përqendrimi i ujit ndryshon dhe marrja e mostrave në pjesët e sipërme, të mesit dhe të poshtme mund të mos japë mostra përfaqësuese.

Nëse situata nuk lejon marrjen e mostrave në mënyrë automatike përdoret marrja manuale e tyre.

Në pikën 11.1.1, në lidhje me numrin e mostrave standardi përcakton në bazë të sasive komisioni bën një plan dhe përcakton numrin e mostrave që do të marrë për përcaktimin e densitetit të naftës bruto.

Mos përcaktimi i saktë i dendësisë së naftës bruto, në momentin e shitjes ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në çmimin e shitjes dhe reflekton në të ardhurat e shoqërisë.

Në elementët e llogaritjes së çmimit të shitjes, pjesa më e madhe është përcaktuar nga faktorë të tjerë si çmimi në bursë, kursi i këmbimit të dollarit, etj., që janë të kontrolluar dhe pas faktit. Dy elementët që variojnë dhe maten për çdo shitje janë peshat e autoboteve që transportojnë produktin që shitet dhe densiteti i naftës bruto i cili përcaktohet një herë për një depozitë prej 5000-8000 m³. Në përcaktimin e riskut për dëmtimin e aseteve të shoqërisë si vjedhje ose mashtrime këto dy elementë kanë riskun më të madh. Nëse në lidhje me peshën e autoboteve ka elementë shtesë si plotësimi i DSHA, si dhe organizma të tjerë që mund të ushtrorjnë kontrole si Dogana Fier, në lidhje me përcaktimin e temperaturës dhe densitetit të produktit ky verifikim mungon.

Nëse marrim si shembull shitjen e një depozite me 5,000 ton naftë dhe në procesin e llogaritjes së çmimit, ku densiteti i produktit është 0.9708, një ndryshim në 0.9601 me një çmim të Brentit 122.94 USD, diferenca në totalin e vlerës së shitur është 44,380 USD.

Qëllimi i shembullit është të tregojë rëndësinë që ka matja e saktë e densitetit dhe temperaturës së produktit që shitet.

Kriteri:

Ligji Nr. 10 296, datë 08/07/2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 22, *Veprimtaritë e kontrollit, Titullarët e njësive publike miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Veprimtaritë e kontrollit duhet të jenë të përshtatshme dhe kostoja e zbatimit të tyre nuk tejkalon përfitimet e pritshme. Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: procedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standard dhe të rasteve të veçanta; ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin; procedurat për raportimin, mbikëqyrjen, vlerësimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të veprimtarive; ë) procedurat e monitorimit; rregullat për menaxhimin e burimeve njerëzore; rregullat për dokumentimin e të gjitha transaksioneve dhe të veprimtarive që lidhen me mbarëvajtjen e njësive;*

VKM nr. 612, datë 02.09.2012, ndryshuar me: Vendimin Nr. 128 datë 20.2.2013, Vendimin Nr. 501, datë 22.5.2013, Vendimin Nr. 30, datë 14.1.2015, Vendimi nr. 38, date 21.01.2016, Vendimi nr. 28, date 18.01.2017 Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”. Neni 96 *Përkufizime Për qëllime të nenit 53 të ligjit, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. “Matja e kapacitetit”, tërësia e operacioneve të kryera nga specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë me qëllim përcaktimin e kapacitetit të rezervuarëve e depozitave deri në një apo disa nivele të mbushjes. Matja e kapacitetit çon në lëshimin e certifikatës së kalibrimit dhe të kapacitetit mbajtës. 2. “Enëmatës”, term i përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për të treguar një depozitë (rezervuar) të pajisur me shkallën e kapacitetit mbajtës. Neni 97 Matja e kapacitetit të rezervuarëve Për qëllime të nenit 53 të ligjit, operacioni i matjes së kapacitetit kërkon lëshimin e dokumenteve të mëposhtme: a) Një certifikate të kapacitetit në të cilën shënohen informacionet e mëposhtme: i) identifikimi i organizmit të miratuar të matjes së kapacitetit; ii) numri i certifikatës; iii) kufiri i vlefshmërisë (10 vjet); iv) numri i rezervuarit (depozitës); v) HTT (lartësia totale e gjetur); vi) karakteristikat kryesore të rezervuarit (depozitës); b) Një tabelë të vëllimeve (lidhja lartësi/vëllim) dhe një tabelë interpolimi milimetrike ose decimetrike; c) Për rezervuarët me tavan pluskues, një tabelë korrigjimi të tavanit pluskues, në funksion të masës vëllimore të produktit, në temperaturën faktike në momentin e matjes nën tavanin pluskues; ç) Një tabelë të fundit (tabanit) të rezervuarit (depozitës) me qëllim korrigjimin e volumit të produktit sipas formës së fundit të enës.*

Detyrimet e depozituesit të miratuar lidhur me matjet Për qëllime të neneve 20 dhe 53 pika 1 të ligjit, do të veprohet si më poshtë vijon: 1. Depozituesi i miratuar duhet të vërë në dispozicion të autoriteteve doganore një skicë të hollësishme të të gjitha tubacioneve (mbi dhe nëntokësore) që kanë lidhje me rezervuarët (depozitat) e stokimit apo të prodhimit të produkteve energjetike (vajrave minerale). 2. Në rastin kur akciza për produktet energjetike llogaritet duke iu referuar volumit të tyre, të gjithë rezervuarët (depozitat) e prodhimit dhe të magazinimit, të cilët shërbejnë si enëmatës në ambientet e magazinës fiskale, të miratuar nga autoritetet doganore, duhet të maten dhe të kalibrohen (të pajisen me certifikatën e kapacitetit dhe të kalibrimit) nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, sipas kërkesës së administratës doganore. 3. Vetëm rezervuarët që shërbejnë si enëmatës në magazinat fiskale të prodhimit ose të stokimit përfshihen në detyrimin e kontrollit metrologjik që përfshin matjen e kapacitetit të tyre. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë duhet të masë kapacitetin e rezervuarëve (depozitave), të cilët duhet të jenë të pajisur me një tabelë kapaciteti që është ende e vlefshme. Një verifikim periodik (rikapacitim) është i detyrueshëm çdo dhjetë vjet për rezervuarët (depozitat) e produkteve të gatshme dhe gjysmë të gatshme. 4. Kapaciteti i një depozite (rezervuari) të miratuar, të matur dhe të kalibruar duhet të

shënohet në një rënë anë të saj dhe sasia (volumi) e produkteve energjetike brenda depozitës duhet të matet duke përdorur pajisjet matëse përkatëse. 5. Të gjitha instrumentet dhe pajisjet matëse duhet të specifikohen në miratimin e magazinës fiskale të depozitimit e të prodhimit dhe të vulosën, shënohen apo të identifikohen sipas depozitës (rezervuarit), me të cilën ka lidhje instrumenti apo pajisja matëse. 6. Të gjitha pajisjet matëse të përshkruara më sipër duhet të maten dhe të kalibrohen (të pajisen me certifikatën e kalibrimit) nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, e cila vendos një vulë kontrolli. Këto pajisje matëse u nënshtrohen verifikimeve periodike 6-mujore ose vjetore, sipas legjislacionit për metrologjinë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 99 Metodologjia e matjes 1. Për qëllime të pikës 1 të nenit 53 të ligjit, operacionet e matjes (leximi i temperaturës, i lartësisë, i masës vëllimore etj.) që duhen bërë në kuadrin e kontrolleve ose inventarëve doganorë të magazinës fiskale të depozitimit ose të prodhimit, kryhen në prani të të gjitha palëve (në prani të autoriteteve doganore, depozituesit të miratuar ose përfaqësuesit të tij). 2. Gjatë kontrolleve dhe kryerjes së inventarëve doganorë bëhet bllokimi i pikave të hyrjes dhe të daljes të produkteve energjetike. 3. Metodologjia e matjes është përshkruar në mënyrë të hollësishme në aneksin 17/3 të këtij vendimi. 4. Përshkrimi i rezervuarëve, skicat e tipave të tyre dhe të pajisjeve të matjes, si dhe tabela përmbledhëse e matjes në boshllëk janë përshkruar në anekset 17/4 deri 17/12 të këtij vendimi.

Pika 2. Leximi i temperaturës. **Përcaktimi i temperaturës së produktit të kontrolluar është një element vendimtar në matjen e rezervuarit (depozitës). Një mospërputhje prej një grade në temperaturë mesatare mund të çojë në një diferencë prej një në një mijë në llogaritjen e vëllimit në 15⁰ C.** Nga ana tjetër kushte klimaterike në momentin e matjes (orientimi i enës ndaj diellit për shembull), kanë ndikimin e tyre në metodën e matjes së temperaturës, si dhe në rezultatet e këtij operacioni. Kështu, në të njëjtin plan horizontal, temperaturat mund të mos jenë identike në çdo pikë të rezervuarit. Gjatë verës, temperatura e shtresave të sipërme të rezervuarit mund të jetë më e lartë me rreth një gradë në krahasim me shtresat e poshtme dhe zbret në mënyrë lineare duke shkuar drejt tabanit të rezervuarit (depozitës). Nga ana tjetër, në stinën e ftohtë, produkti është më i ftohtë pranë sipërfaqes si dhe pranë tabanit. Në të njëjtën mënyrë, temperatura e produktit mund të variojë në funksion të tipit të rezervuarit (vertikal ose horizontal) dhe kapacitetit të tij. Gjithashtu, furnizimet e mëvonshme nëpërmjet naftës jellësit mund të sjellin formimin në rezervuar (depozitë) të shtresave me temperatura të ndryshme, të cilat autoriteti doganor duhet ti marrë në konsideratë. Në këto kushte, në përgjithësi matja në një pikë është e pamjaftueshme, dhe rekomandohet që të kryhet matja e produktit në shumë pika të vertikales së grykës qendrore (përveç rastiit kur është e pamundur për arsye sigurie), dhe llogaritet temperatura mesatare e produktit që përmban rezervuari (depozita). Si rrjedhim do të ishte më e përshtatshme që të evitohet marrja e temperaturave nga ajo anë e rezervuarit që e rreh dielli apo që është e ekspozuar ndaj erës.

Ndikimi/Efekti:

Përcaktimi i temperaturës së produktit të kontrolluar është një element vendimtar në matjen e rezervuarit (depozitës). Një mospërputhje prej një grade në temperaturë mesatare mund të çojë në një diferencë prej një në një mijë në llogaritjen e vëllimit në 15⁰ C.

Shkaku: Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë të analizojë situatën në të cilën kryhet procesi i shitjes së naftës bruto, të vlerësojë procedurat përkatëse të kontrollit, të evidentojë zonat me risk në cenimin e produktit të gatshëm, si dhe të krijojë grupe pune që në procesin e matjes së naftës bruto në shitjet që kryen shoqëria, të garantohet zbatimi i standardeve kombëtare e ndërkombëtare.

Në zbatim të standardeve SSH EN ISO 3170:2004 dhe SSH EN ISO 3171:2004, densiteti i naftës bruto të matet në mënyrë automatike dhe nëse nuk është e mundur të zbatohet standardi i matjes në mënyrë manuale, duke shpeshtuar matjet dhe numrin e kampioneve për të pasur të dhëna reale e të besueshme, me synim uljen e riskut të mos faturimit të sasive të produktit të shitur.

Titulli i Gjetjes 6: Ulje e të ardhurave të shoqërisë nga llogaritjet e shpenzimeve fiktive.

Situata:

Në tre procedurat e ankandëve të shitjes së naftës u konstatua se grupi i ekspertëve, për përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar të shitjes së naftës bruto ka bërë ulje shpenzimesh nga çmimi i shitjes së përcaktuar të ankandit, duke presupozuar shpenzime për vënien e produktit në kushtet FOB sipas kushteve të Bursës Ndërkombëtare për hidrokarburet (Bursës Ndërkombëtare Brent), bazuar në pikën 5, të udhëzimit 83, datë 10.02.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, ku citohet: “Çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes përcaktohet nga autoriteti shitës, nëpërmjet çmimit të produktit të publikuar në bursë për Brentin, në momentin e përlllogaritjes, duke marrë në konsideratë koeficientin e konvertimit të këtij çmimi sipas cilësisë së produktit të prodhuar, dhe përcaktohet gjithmonë përpara fillimit të procedurës së shitjes”. Të dhënat e bursës “Platts”, kuotojnë çmimin Naftë Bruto-Brent (Ddl), në dollarë dhe me kushte lëvrimi FOB (Free on Board), pra lëvrimi deri kuvertën e anijes në një port të caktuar.

Grupi i ekspertëve bën llogaritje të ndryshme për transportin me autobote në një port të caktuar, ngrohjen e naftës gjatë rrugës, siguracionin, magazinimin në port, shpenzime shkarkimi etj, duke rezultuar me një ulje në çmimin që duhet të paguajë Operatori Ekonomik fitues i ankandit të shitjes së naftës. Pjesa më e madhe e shpenzimeve që ulen nga çmimi i shitjes janë fiktive pasi nuk ndodhin se shitjet e naftës janë kryer në operatorë ekonomikë vendas dhe nuk ka pasur shoqëri të huaja që janë shpallur fitues të ankandëve.

Relacionet për përlllogaritjen e çmimit fillestar, pas aprovimit nga administratori, janë dërguar për miratim te Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës.

-Në procedurën për sasinë 40,000 ton e fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria “R...E” sh.a., Elbasan, dhe “A...L” sh.a., Tiranë, vlera e shpenzimeve jo të kryera ishte 3.55 USD/bbl për 40,000 ton, duke arritur në shumën 859,000 USD.

-Në procedurën për shitje naftë bruto me sasi 100,000 ton, me fitues “E...A”, vlera e shpenzimeve jo të kryera ishte 3.6 USD/bbl, për sasinë 100,000 ton, është në 2,307,000 USD.

-Në procedurën për shitjen e 120,000 ton naftë bruto, me fitues BOE “E...A” sha, dhe “R...E”sha, vlera e shpenzimeve jo të kryera arrin në 2,630,000 USD.

Vlera 5,797,000 USD përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.

Kriteri:

Ligji Nr. 10 296, datë 08/07/2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë. Neni 3, Fusha e zbatimit të ligjit Ky ligj zbatohet në njësitë publike, ku sipas ligjit përfshihen: 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme. 2. Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. Pika 5, udhëzimit 83, datë 10.02.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”.

Ndikimi/Efekti:

Vlera 5,797,000 USD përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.

Shkaku: Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që procesi i përcaktimit të çmimit të shitjes së naftës bruto të kryhet bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të kostove të shoqërisë, të çmimit të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të kostove reale që mund të dalin gjatë procesit të shitjes së produktit, për të shmangur mungesën e të ardhurave nga një proces jo transparent dhe jo efektiv.

Pika 2.9 e programit. Mbi zbatimin e detyrimeve të marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura me kompanitë e huaja që operojnë në sektorët e kërkimit dhe nxjerrjes së hidrokarbureve.

Në zbatim të pikës 9 të programit të auditimit “Nr.1202/1, datë 16.02.2023”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Marrëveshjet hidrokarbure
- Progres raportet përkatës
- Detyrimet e kompanive operuese

Të dhëna për treguesit e prodhimit dhe treguesit financiarë, për shoqërinë “B.....”.

Detyrime të prapambetura në naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (“PPE”) dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol (“PPA”), për periudhën deri më 31.12.2022.

➤ ***Për vitin 2021:***

- Nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se, detyrimi që shoqëria “B.....”, ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... sipas **Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2021 është 24,939.596 (njëzet e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë pikë pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto.
- Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 21,100.41 (njëzet e një mijë e njëqind pikë dyzet e një) Ton naftë bruto.
- Pra, **janë tërhequr rreth 3,839.186** (tre mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë pikë njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.**

Theksojmë se: Shoqëria “B.....”, me anë të shkresës me Nr. 329 Prot., datë 15.04.2022, protokolluar në Albpetrol me Nr. 3249 Prot., datë 20.04.2022 ka dërguar Llogaritjen e Faktorit R në fund të tremujorit të katërt të vitit 2021 (Q4-2021).

Në bazë të përlllogaritjeve, Faktori R, për zonën “Main/Kryesore” rezulton më i madh se 1 (një) në fund të tremujorit të katërt të vitit 2021.

Përsa më sipër, në përputhje me Nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” dhe Nenit 3.2 dhe 3.3 të Amendimit të Marrëveshjes Hidrokarbure, duke nisur nga Tremujori i katërt i vitit 2021, Pjesa e Prodhimit të Albpetrol (PPA), do të llogaritet nga 1% që është aktualisht, në 3% të naftës së dipsonueshme.

➤ ***Për vitin 2022:***

- Nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se, detyrimi që shoqëria “B.....”, ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... sipas **Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2022 është 29,884.163 (njëzet e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëqind e gjashtëdhjetë e tre) Ton naftë bruto.
- Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 14,407.612 (katërmëdhjetë mijë e katërqind e shtatë pikë gjashtëqind e dymbëdhjetë) Ton naftë bruto.
- Pra, **janë tërhequr rreth 15,476.551** (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë pesëqind e pesëdhjetë e një) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022.**

Detyrimi që shoqëria “B.....” ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) për periudhën nga data efektive deri më 31.12.2022 është 78,915.002 (shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë pikë zero zero dy) ton naftë bruto.

1- Detyrimet e shoqërisë “B.....”, për periudhën e objektit të auditimit (2021 – 9-mujori 2022).

Bazuar në sasinë e naftës së patërhequr për llogari të P....., për periudhën objekt auditimi rezulton se:

Viti	Sasia e naftës që BPAL i detyrohet Albpetrolit (Ton)	Çmimi mesatar i shitjes nga BPAL (\$/bbl)	Çmimi mesatar i shitjes nga BPAL (\$/Ton)	Vlera (USD)
Tremujori i Parë 2021 (Q1-2021)	5,893.40	48.22	301.06	1,774,244.49
Tremujori i Dytë 2021 (Q2-2021)	(1,124.95)	55.40	345.31	(388,450.66)
Tremujori i Tretë 2021 (Q3-2021)	(2,135.58)	58.65	364.98	(779,450.94)
Tremujori i Katër 2021 (Q4-2021)	1,206.32	64.95	405.68	489,379.99
Total Viti 2021	3,839.19			1,095,722.88
Tremujori i Parë 2022 (Q1-2022)	7,579.82	82.85	517.54	3,922,880.27
Tremujori i Dytë 2022 (Q2-2022)	7,525.42	95.70	597.17	4,493,967.43
Tremujori i Tretë 2022 (Q3-2022)	2,774.32	86.61	539.11	1,495,650.29
9-Mujori i Vitit 2022	17,879.56			9,912,497.99
Ne total 2021+9-Mujori 2022	21,718.75			11,008,220.87

Tabela 2: Detyrimet e prapambetura në naftë bruto, për llogari të P....., për vitin 2021+9-Mujorin 2022.

Shënim: Cmimi i shitjes së naftës është marrë nga Progres Raportet 3-Mujore të dërguar nga shoqëria “B.....”.

2- Të dhëna mbi treguesit financiar për periudhën 2021+9-Mujorin 2022.

Treguesit	Njesia Matese	01.01.2021 - 31.12.2021			01.01.2022 - 30.09.2022		
		Programi Punës dhe Buxheti	Fakt	Realizimi në %	Programi Punës dhe Buxheti	Fakt	Realizimi në %
<i>Puse aktive</i>		350	383	109%	415	396	95%
<i>Prodhimi ditor</i>	<i>Bbl/d</i>	10,348.00	10,373.00	100%	10,707.33	9,229.00	86%
<i>Prodhimi</i>	<i>MBbl</i>	3,773.00	3,786.19	100%	2,924.00	2,520.00	86%
<i>Prodhimi</i>	<i>Ton</i>	602,079.00	607,114.40	101%		403,978.10	
<i>Prodhimi i shitur</i>	<i>MBbl</i>		3,866.00			2,545.00	
<i>Brent</i>	<i>\$/Bbl</i>	47.00	70.73	150%	70.00	105.35	151%
<i>% e Brentit</i>		77%	80%	103%	84%	84%	99%
<i>Cmimi mesatar i shitjes</i>	<i>\$/Bbl</i>	36.40	56.32	155%	59.10	88.21	149%
<i>Cmimi mesatar i shitjes</i>	<i>\$/Ton</i>		354.30		551.27	549.61	100%
<i>Te ardhura Bruto</i>	<i>M\$</i>	137,337.00	217,508.00	158%	171,604.00	222,030.63	129%
<i>PPE</i>	<i>Ton</i>	16,000.00	16,303.33	102%	10,700.00	10,721.24	100%
<i>PPA</i>	<i>Ton</i>	5,800.00	8,636.27	149%	12,800.00	11,797.71	92%
<i>PPE&PPA</i>	<i>Ton</i>	21,800.00	24,939.60	114%	23,500.00	22,518.94	96%
<i>Vlera e PPE</i>	<i>M\$</i>	3,665.00	5,776.27	158%	3,981.00	5,892.50	148%
<i>Vlera e PPA</i>	<i>M\$</i>	1,339.00	3,059.83	229%	4,778.00	6,484.14	136%
<i>Vlera e PP&PPA</i>	<i>M\$</i>	5,004.00	8,836.10	177%	8,759.00	12,376.65	141%
<i>Te ardhura nga shitja</i>	<i>M\$</i>	132,333.00	208,671.90	158%	162,845.00	209,653.98	129%
<i>Renta</i>	<i>M\$</i>	13,367.20	21,173.17	158%	16,762.30	21,613.81	129%
<i>Opex&Oil Inventory</i>	<i>M\$</i>		54,656.00			44,293.00	
<i>Shpenzime Transporti</i>	<i>M\$</i>	8,562.00	12,812.00	150%	14,011.00	11,973.00	85%
<i>G&A</i>	<i>M\$</i>	16,408.00	11,326.00	69%	11,682.00	8,598.00	74%
<i>OPEX Total</i>	<i>M\$</i>	60,659.00	54,344.00	90%	46,692.00	44,394.00	95%
<i>OPEX+Shpenzime Transporti+G&A</i>	<i>M\$</i>	85,629.00	78,482.00	92%	72,385.00	64,965.00	90%
<i>CAPEX</i>	<i>M\$</i>	27,057.00	16,207.00	60%	57,802.00	28,787.00	50%
<i>Kosto Totale</i>	<i>M\$</i>	112,686.00	94,689.00	84%	130,187.00	93,752.00	72%
<i>Cash Flow from operation</i>	<i>M\$</i>	33,336.80	109,016.73		73,697.70	123,075.17	
<i>Cost Recovery</i>	<i>M\$</i>		92,809.73		15,895.70	94,288.17	

Tabela 3: Treguesit financiar për periudhën 2021 + 9-Mujor 2022.

➤ Nga tabela vëmë re për vitin 2021:

- **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria BPAL është realizuar, madje është tejkaluar. Gjatë vitit 2021 prodhimi ishte 3,786.19 MBbl, shifër kjo e cila është mbi parashikimin e bërë në PP&B 2021.

- **Shpenzimet Operative (OPEX)**. Shpenzimet operative kapin vlerën 54,344 M\$ nga 60,659 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 6,315 M\$ ose 10%.

Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi me një diferencë relativisht të vogël.

- **Shpenzimet Administrative (G&A):** Realizimi i G&A per vitin eshte realizuar mesatarish ne masen 69%.
- **Investimet Kapitale (CAPEX):** Realizimi i Capex per vitin eshte realizuar mesatarish ne masen 60%
- **Cost Recovered:** Në vitin 2021, sipas Faktit të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

➤ **Nga tabela vëmë re për vitin 2022:**

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria BPAL është realizuar vetëm në masën 86%. Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 prodhimi ishte 2,520 Mbbl , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021.

Shpenzimet Operative (OPEX): Shpenzimet operative kapin vlerën 44,394 M\$ nga 46692 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 2,298 M\$ ose 2%. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2022 janë më të ulta sesa parashikimi me një diferencë relativisht të vogël.

Shpenzimet Administrative (G&A): Realizimi i G&A per vitin eshte realizuar mesatarish ne masen 74%.

Investimet Kapitale (CAPEX): Realizimi i Capex per vitin eshte realizuar mesatarish ne masen 50%.

Cost Recovered: Në vitin 2022, sipas Faktit të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Ky Program Pune dhe Buxhet është miratuar nga shoqëria “Albpetrol” SH.A. (shkresa me Nr. 2586 Prot., datë 19.04.2021), me kusht përfshirjen e Skenarit të Rastit me Cmim të Lartë ne të, të paraqitur para këtij Komiteti, në mbledhjen vijuese të Komitetit Këshillimor # 34 prej BPAL dhe rekomandon dorëzimin e këtij Programi Pune dhe Buxhet pranë AKBN për rishqyrtim dhe aprovim të mëtejshëm.

- Programi i Punës dhe Buxheti i vitit 2022, protokolluar në Albpetrol sh.a Patos. me Nr. 5018 Prot., datë 04.07.2022.

➤ **Numri i puseve:**

Shoqëria "Bankers Petroleum Albania" Ltd.	Njësia	Periudha Kohore (Viti)																		
		2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	9-M 2022
2. Nr. i puseve gjithësej të dorëzuar nga Albpetrol	copë	51	55	105	122	136	80	199	383	0	0	0	4	0	8	11	2	0	1	
2.1. Nr. mesatar i puseve prodhuar nga Albpetrol (progresiv)	copë	26	47	97	155	180	174	187	177	143	128	110	74	49	39	33	23	25	24	
3. Nr. i puseve të rinj të shpuar nga Kontraktori	copë	0	0	0	0	14	10	56	89	128	146	161	63	10	24	51	83	0	0	
3.1. Nr. mesatar i puseve të rinj prodhuar (progresiv)	copë	0	0	0	0	8	15	39	88	169	277	391	452	371	311	312	362	356	366	
4. Nr. mesatar i totalit të puseve prodhuar (progresiv)	copë	26	47	97	155	188	189	226	265	312	405	501	526	420	350	345	385	381	390	

Tabela 4: Numri i puseve

➤ **Auditet e zhvilluara në Albpetrol bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure**

Në bazë të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure”
"Albpetroli do të ketë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj nga marrja e secilës deklaratë të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione përsa i përket ndonjë deklaratë të tillë të Llogarisë Kosto, me kusht që Albpetroli nuk do të titullohet të kryejë më shumë se dy audite të librave të Llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një Vit Fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakort për cdo rregullim të kërkuar. Dokumenta shtesë dhe llogarie do të bëhen të disponueshme për Albpetrolin gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës së mësipërme prej dymbëdhjetë (12) muaj Albpetroli nuk ka - këshilluar

Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë do të konsiderohet e aprovuar”.

Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:

- Shpenzime për interesa, shërbime bankare dhe të ngjashme (G&A) - 255,835.76 USD.
- Shpenzime të kategorizuara si Sponsorizime/Donacione - 136.32 USD.
- Shpenzime për Gjopa dhe/ose Penalitete - 549.00 USD.
- Verifikimi i Shpenzimeve për Qira toke “H...I” - 2,000,000 USD.
- Verifikimi i Shpenzimeve të kryera - 91,525.00 USD.
- Verifikimi i Shpenzimeve të kryera - 28,473.32 USD.
- Verifikimi i Shpenzimeve të kryera - 76,088.51 USD.
- Verifikimi i shpenzimeve të kryera nga “S...I sh.p.k” - 22,674.95 USD.
- Verifikimi i shpenzimeve të kryera nga furnitorë që kalojnë vlerën mbi 2,000,000 USD - Vlera do t'i bashkëngjitet raportit perfundimtar pasi Kompania “B.....”, të na paraqesë tenderat me vlerën mbi 2,000,000 USD.
- Verifikimi i Shpenzimeve të kryera nga “H...W & T...X” - 428,690.79 USD.
- Verifikimi i Shpenzimeve të kryeranga “H...T” 5,640.58 USD.
- Verifikimi i Shpenzimeve të kryera për shërbimet mediatike 4,254.13 USD.

Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020 për B.....A është 2,913,868.36 (dy milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e gjashtë) USD.

Llogaritja e Faktorit R: Të dhënat progresive.

Main Area	Cumulative Total End of 2020	Total at End of Q4-2021	Cumulative Total to Date 2021	Total at End of Q3-2022	Cumulative Total to Date Q3-2022
Revenue					
Crude Oil Sales	3,964,789	220,886	4,185,675	229,694	4,415,369
Less Albpetrol PEP&ASP&AKBN Share & Royalty Tax (10)%	590,333	30,581	620,914	35,826	656,740
Contractor's Revenue net of Albpetrol PEP&ASP AKBN Share & Royalty Tax (10)%	3,374,456	190,305	3,564,761	193,868	3,758,629
Costs					
Capex	1,654,090	16,144	1,670,234	28,614	1,698,848
Opex	1,728,439	85,228	1,813,667	127,147	1,940,814
Fixed Assets	22,089	54	22,143	170	22,313
Increase/(Decrease) Material Inventory	41,772	(2,981)	38,791	(1,028)	37,763
Increase/(Decrease) Operational Inventory	251	144	395	432	827
AKBN Rejected Costs	(225)	0	(225)	0	(225)
(Bk) Total Petroleum Costs Before mitigation	3,446,416	98,589	3,545,005	155,335	3,700,340
R Factor (Rn)			1.0056		1.0158

Tabela 5: Llogaritja e Faktorit R

➤ Inventarizimi i aseteve:

- Shoqëria “Albpetrol” SH.A. me shkresën me Nr. 10641 Prot., datë 24.12.2021 dërgon shkresë në lidhje me personat që do të marrin pjesë në procesin e inventarizimit të fundvitit 2021. (invenatirizimin e materialeve dhe atë të naftës bruto).
- Shoqëria “Albpetrol” SH.A., me shkresën me Nr. 1051 Prot., datë 03.02.2022, kërkon nga BPAL që të dërgojnë inventarin e matërialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2021, për vendburimin Patos-Marinëz.
- Në mungesë të një përgjigje nga ana e shoqërisë “B.....”, me shkresën me Nr. 1051/1 Prot., datë 22.04.2022, shoqëria “Albpetrol” Sh.A dërgon një kërkesë të përsëriur.
- Shoqëria “B.....”, me shkresën me Nr. 9145 Prot., datë 20.12.2022, njofton për procesin e inventarizimit të fundvitit 2022.

- Shoqëria “Albpetrol” SH.A., me shkresën me Nr. 1067 Prot., datë 13.2023, kërkon nga BPAL që të dërgojnë inventarin e matërialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2022, për vendburimin Patos-Marinëz.

Titulli i gjetjes: *Kontraktori ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure.*

Situata:

Për vitin 2021: Nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se, detyrimi që shoqëria “B.....”, ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2021 është 24,939.596 (njëzet e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë pikë pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto.

Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 21,100.41 (njëzet e një mijë e njëqind pikë dyzet e një) Ton naftë bruto.

Pra, **janë tërhequr rreth 3,839.186** (tre mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë pikë njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.**

Thkesojme se: Shoqëria “B.....”, me anë të shkresës me Nr. 329 Prot., datë 15.04.2022, protokolluar në Albpetrol me Nr. 3249 Prot., datë 20.04.2022 ka dërguar Llogaritjen e Faktorit R në fund të tremujorit të katërt të vitit 2021 (Q4-2021).

Në bazë të përlllogaritjeve, Faktori R, për zonën “Main/Kryesore” rezulton më i madh se 1 (një) në fund të tremujorit të katërt të vitit 2021.

Përsa më sipër, në përputhje me Nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” dhe Nenit 3.2 dhe 3.3 të Amendimit të Marrëveshjes Hidrokarbure, duke nisur nga Tremujori i katërt i vitit 2021, Pjesa e Prodhimit të Albpetrol (PPA), do të llogaritet nga 1% që është aktualisht, në 3% të naftës së dipsonueshme.

Për vitin 2022: Nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se, detyrimi që shoqëria “B.....”, ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2022 është 29,884.163 (njëzet e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëqind e gjashtëdhjetë e tre) Ton naftë bruto.

Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 14,407.612 (katërbëdhjetë mijë e katërqind e shtatë pikë gjashtëqind e dymbëdhjetë) Ton naftë bruto. Pra,

janë tërhequr rreth 15,476.551 (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë pesëqind e pesëdhjetë e një) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022.**

Detyrimi që shoqëria “B.....” ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) për periudhën nga data efektive deri më 31.12.2022 është 78,915.002 (shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë pikë zero zero dy) ton naftë bruto

Kriteri: Marrëveshja e hidrokarbureve

Ndikimi/efekti:

Mungesa e të ardhurave nga kompania Albpetrol për sasinë e naftës bruto e cila nuk është tërhequr për pamundësi depozitimi. **Vlera e sasisë 78,905.002 ton me çmimet e deklaruar nga kontraktori është 39,247,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.**

Shkaku: Mos korrektësi e kontraktorit për shlyerjen e detyrimit sipas përcaktimit të marrëveshjes, si dhe pa mundësi e Albpetrol, për magazinimi e sasisë së naftës bruto për llogari të prodhimit para-ekzistues (PPE) dhe të pjesës së Albpetrol (PPA).

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **78,905.002** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri më 31.12.2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure.

Vlera e sasisë 78,905.002 ton me çmimet e deklaruar nga kontraktori është 39,247,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.

-Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Titulli i gjetjes: *Kontraktori rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022.*

Situata:

Për vitin 2021: *Prodhimi i Përgjithshëm* i deklaruar nga shoqëria BPAL është realizuar, madje është tejkaluar. Gjatë vitit 2021 prodhimi ishte 3,786.19 MBbl, shifër kjo e cila është mbi parashikimin e bërë në PP&B 2021. **Shpenzimet Operative (OPEX).** Shpenzimet operative kapin vlerën 54,344 M\$ nga 60,659 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 6,315 M\$ ose 10%. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi me një diferencë relativisht të vogël. Shpenzimet Administrative (G.....A): Realizimi i G....A per vitin eshte realizuar mesatarish ne masen 69%.

Investimet Kapitale (CAPEX): Realizimi i Capex per vitin eshte realizuar mesatarish ne masen 60%

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për vitin 2022:

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria BPAL është realizuar vetëm në masën 86%. Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 prodhimi ishte 2,520 Mbbbl , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021.

Shpenzimet Operative (OPEX): Shpenzimet operative kapin vlerën 44,394 M\$ nga 46692 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 2,298 M\$ ose 2%. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2022 janë më të ulta sesa parashikimi me një diferencë relativisht të vogël. Shpenzimet Administrative (G&A): Realizimi i G&A per vitin eshte realizuar mesatarish ne masen 74%.

Investimet Kapitale (CAPEX): Realizimi i Capex per vitin eshte realizuar mesatarish ne masen 50%.

Cost Recovered: Në vitin 2022, sipas Faktit të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Kriteri: Marrëveshja e hidrokarbureve (plani i zhvillimit)

Ndikimi/efekti: Kontraktori nuk ka realizuar prodhimin e parashikuar dhe investimet kapitale

Shkaku: Kontraktori nuk ka realizuar objektivat në planin e zhvillimit, ashtu dhe planet vjetore të miratuara.

Rëndësia: E larte

Për këtë rekomandojmë:

Administratori në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol SHA, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol.

Titulli i gjetjes: *Përfshirja e disa shpenzimeve te kontraktorit ne llogarinë kosto hidrokarbure ne kundërshtim me marrëveshjen.*

Situata:

Albpetroli ka kryer auditet vjetore dhe rezultat e tyre në vite janë kontestuar nga B...S dhe janë çuar për gjykim në Gjykatën e Arbitrazhit.

Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:

Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperushme për vitin 2020 për B.....A është 2,913,868 (dy million e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e gjatshëdhjetë e tetë) USD.

Kriteri:

Në bazë të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure” *“Albpetroli do të ketë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj nga marrja e secilës deklaratë të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione përsa i përket ndonjë deklaratë të tillë të Llogarisë Kosto, me kusht që Albpetroli nuk do të titullohet të kryejë më shumë se dy audite të librave të Llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një Vit Fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakort për cdo rregullim të kërkuar. Dokumenta shtesë dhe llogarie do të bëhen të disponueshme për Albpetrolin gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës së mësipërme prej dymbëdhjetë (12) muaj Albpetroli nuk ka - këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë do të konsiderohet e aprovuar”.*

Ndikimi/efekti:

Shkaku: Përfshirja në kostot hidrokarbure të shpenzimeve të cilat nuk janë në përputhje me marrëveshjen hidrokarbure.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **2,913,868 USD** të konstatuar për vitin 20120.

Titulli i Gjetjes: *Mos prezenca e Albpetrol gjatë kryerjes së procesit të inventarizimit nga kontraktorët.*

Situata:

Shoqëria “Albpetrol” SH.A. me shkresën me Nr. 10641 Prot., datë 24.12.2021 ka dërguar njoftim në lidhje me personat që do të marrin pjesë në procesin e inventarizimit të fundvitit 2021. (invenatirizimin e materialeve dhe atë të naftës bruto). Shoqëria “Albpetrol” SH.A., me shkresën me Nr. 1051 Prot., datë 03.02.2022, ka kërkuar nga BPAL që të dërgojnë inventarin e matërialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2021, për vendburimin Patos-Marinëz. Në mungesë të një përgjigje nga ana e shoqërisë “B.....”, me shkresën me Nr. 1051/1 Prot., datë 22.04.2022, shoqëria “Albpetrol” Sh.A ka dërguar një kërkesë të përsëriur. Shoqëria “B.....”, me shkresën me Nr. 9145 Prot., datë 20.12.2022, njofton për procesin e inventarizimit të fundvitit 2022.

Shoqëria “Albpetrol” SH.A., me shkresën me Nr. 1067 Prot., datë 13.2023, ka kërkuar nga BPAL që të dërgojnë inventarin e matërialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2022, për vendburimin Patos-Marinëz.

Strukturat drejtuese të Albpetrol SHA me anë të mosverpimit të tyre kanë lenë në mungesë monitorimi gjendjen e aseteve të dhëna në përdorim si dhe blerjen e aseteve të reja nga kontraktori si dhe ecuria e jetëgjatësisë së tyre.

Kriteri:

Pika 2.4.2 e Marrëveshjes Hidrokarbure "Në intervale të arsyeshme, të paktën cdo vit, do të bëhen nga Kontraktori inventare për të gjithë Materialet e Kontrollueshëm, dhe në vijim të cdo inventari, do të rregullohen librat e llogarive dhe rregjistrimet për të reflektuar rezultatet e inventarit. Kontraktori do të njoftojë me shkrim tridhjetë (30) ditë për qëllim të inventarëve të tillë për të lejuar Albpetrolin për të zgjedhur nëse do të përfaqësohet apo nuk do të përfaqësohet kur të kryhet inventari. Kjo situatë është konstatuar me të gjithë kontraktorët e Marrëveshjeve Hidrokarbure.

Ndikimi/efekti: Mos evidentimi dhe vlerësimi i aseteve të dhëna në përdorim.

Shkaku: Albpetrol edhe pse është njoftuar në mënyrë të vazhdueshme nga kontraktorët nuk ka marrë pjesë në procesin e inventarizimit.

Rëndësia: e larte.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori të marrë masa që në çdo proces inventarizimi të kontraktorëve të Marrëveshjeve Hidrokarbure të dërgojë përfaqësues të Albpetrol SHA dhe të evidentohet me përgjegjësi ekzistenca e aseteve të dhëna në përdorim dhe statusi i përdorimit të tyre.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

B. Z., F. M, A. H., K. C, në cilësinë e ish Administratorit, për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2022

Të dhëna për treguesit e prodhimit dhe treguesit financiarë, për shoqërinë "A...." SH.A.

Detyrime të prapambetura në naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues ("PPE") dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol ("PPA"), dhe të naftës gjëndje në vendburim, për periudhën 02.05.2018 deri më 31.12.2022.

Detyrimet per periudhen deri me Q4-2022, për vendburimin Ballsh-Hekal, te shoqerise "Anios Oil & Gas" sh.a.										
Tremujori I Katert, Viti 2022										
Shoqeria "Anio Oil & Gas" sh.a. Vendburimi Ballsh-Hekal	Dorëzim naftë gjëndje (ton)	Dorëzim në natyrë PPE (ton)	Dorëzim në natyrë PPA (ton)	Detyrim naftë gjëndje (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPE (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPA (ton)	Diferenca për naftë gjëndje (ton)	Diferenca PPE (ton)	Diferenca PPA (ton)	Total diferenca (ton)
Viti 2018	0.000	0.000	0.000	342.340	5025.696	33.793	-342.340	-5025.696	-33.793	-5401.829
Viti 2019	149.668	2454.170	0.000	40.389	12013.513	248.767	109.279	-9559.343	-248.767	-9698.831
Viti 2020	0.000	1998.898	0.000	0.000	11524.018	297.264	0.000	-9525.120	-297.264	-9822.384
Viti 2021	0.000	7.816.946	0.000	0.000	10.427.357	346.133	0.000	-2.610.411	-346.133	-2.956.544
Janar 2022	0.000	815.052	0.000	0.000	822.790	20.527	0.000	-7.738	-20.527	-28.265
Shkurt	0.000	826.014	0.000	0.000	815.962	19.705	0.000	10.052	-19.705	-9.653
Mars	0.000	743.214	0.000	0.000	809.191	25.839	0.000	-65.977	-25.839	-91.816
Q1-2022	0.000	2.384.280	0.000	0.000	2.447.943	66.071	0.000	-63.663	-66.071	-129.734
Prill	0.000	561.008	0.000	0.000	802.475	26.406	0.000	-241.467	-26.406	-267.873
Maj	0.000	208.332	0.000	0.000	795.816	31.770	0.000	-587.484	-31.770	-619.254
Qershor	0.000	823.864	0.000	0.000	789.212	30.695	0.000	34.652	-30.695	3.957
Q2-2022	0.000	1.593.204	0.000	0.000	2.387.503	88.871	0.000	-794.299	-88.871	-883.170
Korrik	0.000	741.377	0.000	0.000	782.662	35.457	0.000	-41.285	-35.457	-76.742
Gusht	0.000	745.368	0.000	0.000	776.167	33.663	0.000	-30.799	-33.663	-64.462
Shtator	0.000	845.910	0.000	0.000	769.726	32.300	0.000	76.184	-32.300	43.884
Q3-2022	0.000	2.332.655	0.000	0.000	2.328.555	101.420	0.000	4.100	-101.420	-97.320
Tetor	0.000	735.995	0.000	0.000	763.338	36.458	0.000	-27.343	-36.458	-63.801
Nentor	0.000	726.641	0.000	0.000	757.003	34.315	0.000	-30.362	-34.315	-64.677
Dhjetor	0.000	797.308	0.000	0.000	770.721	32.257	0.000	46.587	-32.257	14.330
Q4-2022	0.000	2.259.944	0.000	0.000	2.271.062	103.030	0.000	-11.118	-103.030	-114.148
Total prej fillimit	149.67	20.840.10	-	382.73	48.425.65	1.285.35	-233.06	-27.585.55	-1.285.35	-29.103.96

Tabela 1: Detyrime në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjëndje në vendburim.

Shenim: -Ne detyrimet e mesiperme perfshihen edhe 342.34 ton naftë gjëndje, e dorezuar tek shoqeria A...L&G...S, ne momentin e dorezimit te puseve te dates 31.07.2018

Nga kjo sasi, 155.49 ton eshte naftë e levizshme dhe 186.85 ton eshte naftë e palevizshme, (bazuar na Proces Verbalin e dorezimit te puseve per Vb. Ballsh-Hekal te dates 31.07.2018.

- Ne detyrimet e mesiperme perfshihen gjithashtu, 28 ton naftë e levizshme dhe 12.389 ton naftë e palevizshme e dorezuar tek shoqeria A...L&G...S me pusët e dorezuar ne date 01.05.2019, (bazuar ne Proces Verbalin e dorezimit te puseve per vendburimin Ballsh-Hekal, te dates 01.05.2019).

- Theksojme se nje pjese e detyrimit te terhequr eshte bere ne baze te Marreveshjes midis shoqerise "Albpetrol" SH.A. dhe "A...." sh.a. me Nr. 7516 Prot., date 09.08.2019.

➤ **Për vitin 2021:**

- Nga tabela 1 vëmë re se, detyrimi që shoqëria “A....” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjëndje në vendburim **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2021 është 10,773.49 (dhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre pikë dyzet e nëntë) Ton naftë bruto.

- Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 7,816.946 (shtatë mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë nëntëqind e dyzet e gjashtë) Ton naftë bruto.

- Pra, **janë tërhequr rreth 2,956.544** (dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë pesëqind e dyzet e katër) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.**

➤ **Për vitin 2022:**

- Nga tabela 1 vëmë re se, detyrimi që shoqëria “A....” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjëndje në vendburim **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2022 është 9,794.455 (nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër pikë katërqind e pesëdhjetë e pesë) Ton naftë bruto.

- Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 8,570.083 (tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë pikë zero tetëdhjetë e tre) Ton naftë bruto.

- Pra, **janë tërhequr rreth 1,224.372** (një mijë e dyqind e njëzet e katër pikë treqind e shtatëdhjetë e dy) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022.**

Detyrimi që shoqëria “A....” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjëndje në vendburim, për periudhën nga 02.05.2018 deri më 31.12.2022 është 29,103.96 (njëzet e nëntë mijë e njëqind e tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë) ton naftë bruto.

Titulli i gjetjes: Kontraktori ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure.
--

Situata:

Kontraktori “A....” SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021, detyrimi që shoqëria “A....” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjëndje në vendburim **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2021 është 10,773.49 (dhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre pikë dyzet e nëntë) Ton naftë bruto. Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 7,816.946 (shtatë mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë nëntëqind e dyzet e gjashtë) Ton naftë bruto. Pra, **janë tërhequr rreth 2,956.544** (dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë pesëqind e dyzet e katër) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.** Për vitin 2022, detyrimi që shoqëria “A....” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjëndje në vendburim **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2022 është 9,794.455 (nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër pikë katërqind e pesëdhjetë e pesë) Ton naftë bruto.

Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 8,570.083 (tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë pikë zero tetëdhjetë e tre) Ton naftë bruto. Pra, **janë tërhequr rreth 1,224.372** (një mijë e dyqind e njëzet e katër pikë treqind e shtatëdhjetë e dy) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022.**

Detyrimi që shoqëria “A....” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjëndje në vendburim, për periudhën nga 02.05.2018 deri më 31.12.2022 është 29,103.96 (njëzet e nëntë mijë e njëqind e tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë) ton naftë bruto.

Kriteri: Marrëveshja e hidrokarbureve.

Ndikimi/efekti:

Mungese e te ardhurave nga kompania Albpetrol për sasinë e naftës bruto e cila nuk është tërhequr për pamundësi depozitimi. Vlera e sasisë 29,103.96 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 14,476,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.

Shkaku: Mos korrektësi e kontraktorit për shlyerjen e detyrimit sipas përcaktimit të marrëveshjes, si dhe pa mundësi e Albpetrol, për magazinimi e sasisë së naftës bruto për llogari të prodhimit para-ekzistues (PPE) dhe të pjesës së Albpetrol (PPA).

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **29,103.96** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe te Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31.12.2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. **Vlera e sasisë 29,103.96 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 14,476,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.**

-Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Detyrimet e shoqërisë "A...." SH.A., për periudhën e objektit të auditimit (2021 – 9-mujori 2022).

Bazuar në sasinë e naftës së patërhequr për llogari të P...., për periudhën objekt auditimi rezulton se:

Viti	Sasia e naftës që "Anio Oil & Gas" SH.A. i detyrohet Albpetrolit (Ton)	Çmimi mesatar i shitjes nga Anio (\$/bbl)	Çmimi mesatar i shitjes nga Anio (\$/Ton)	Vlera (USD)
Tremujori i Parë 2021 (Q1-2021)	2,785.18	41.25	259.00	721,360.58
Tremujori i Dytë 2021 (Q2-2021)	23.07	46.65	295.00	6,805.06
Tremujori i Tretë 2021 (Q3-2021)	125.89	50.09	317.00	39,907.76
Tremujori i Katër 2021 (Q4-2021)	22.41	54.14	341.00	7,641.13
Total Viti 2021	2,956.54			775,714.54
Tremujori i Parë 2022 (Q1-2022)	129.73	68.44	433.00	56,174.82
Tremujori i Dytë 2022 (Q2-2022)	883.17	79.53	503.00	444,234.51
Tremujori i Tretë 2022 (Q3-2022)	97.32	70.70	448.00	43,599.36
9-Mujori i Vitit 2022	1,110.22			544,008.69
Ne total 2021+6-Mujori 2022	4,066.77			1,319,723.23

Tabela 2: Detyrimet e prapambetura në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës , për vitin 2021+9-Mujorin 2022.

3- Të dhëna mbi treguesit financiar për periudhën 2021+9-Mujorin 2022.

Treguesit	Njësia matëse	Viti 2021			9-Mujori 2022								
		Fakt	Total	Realizimi ne % (Fakt/Program)	Q1-2022		Q2-2022		Q3-2022		9-Mujori 2022		Realizimi ne % (Fakt/Program)
					Fakt	Program	Fakt	Program	Fakt	Program	Fakt	Program	
Puse aktive		78.00	92.00		70.00	92.00	72.00		75.00				
Prodhimi i Përgjithshëm (ton)	Ton	14,827.30	27,228.00	184%	3,330.00	4,693.00	3,184.00	5,758.00	3,433.00	6,511.00	9,947.00	16,962.00	171%
Prodhimi i Përgjithshëm (Bbl)		104,559.00			23,661.70		22,918.00		24,505.00		71,084.70		
Prodhimi Para Ekzistues (PPE)	Ton	2,707.95	2,590.00	96%	635.72	635.72	620.03	620.03	604.72	604.72	1,860.47	1,860.47	100%
Prodhimi Para Ekzistues (PPE)	Bbl												
Nafte per Pardoim per nevojat e veta	Ton	334.10	272.00	81%	4.00	46.90	-	57.70	-	65.10	4.00	169.70	4243%
Pjesa e Prodhimit të Albpetrol (PPA)	Ton	117.85	244.00	207%	26.90	40.10	25.64	50.80	28.28	58.41	80.83	149.32	185%
Pjesa e Prodhimit të Albpetrol (PPA)	Bbl												
Brenti	S/bbl					352.23		352.23		352.23		1,056.69	
Cnimt mesatar i shitjes	S/bbl	41.00	38.00	93%	66.00	56.00	71.00	56.00	63.00	56.00	200.00	168.00	84%
Te ardhura bruto	MUS\$	4,286.92			1,561.67	1,653.01	1,627.18	2,028.13	1,543.82	2,293.36	4,732.67	5,974.51	126%
Sasia e prodhimit të shitur	Ton		24,112.00			3,970.00		5,030.00		5,782.00		14,782.00	
Sasia e prodhimit të shitur	Bbl	86,822.00			18,851.00		20,376.00		17,291.00		56,518.00		0%
Te ardhurat nga shitja	MUS\$	3,669.00	5,437.71	148%	1,167.00	1,398.35	1,458.00	1,771.71	1,091.00	2,036.59	3,716.00	5,206.65	140%
Te ardhurat te tjera	MUS\$	93.00	600.00	645%	14.00	135.00	5.00	135.00	15.00	135.00	34.00	405.00	1191%
Renta	MUS\$	366.00	543.77	148%	116.70	139.83	145.80	177.17	109.10	203.66	371.60	520.66	140%
Shpenzimet Operative (OPEX)	MUS\$	2,779.00	3,689.73	133%	517.00	1,002.22	630.00	1,045.17	619.00	1,075.52	1,766.00	3,122.92	177%
Shpenzimet te pergjithshme Administrative (G&A)	MUS\$	1,582.00	688.00	43%	372.00	340.00	364.00	190.00	394.00	30.00	1,130.00	560.00	50%
Shpenzimet Kapitale (CAPEX)	MUS\$	866.00	3,173.40	366%	716.00	512.60	163.00	1,302.60	57.00	417.60	936.00	2,232.80	239%
Total Koste	MUS\$	5,227.00	7,551.13	144%	1,605.00	1,854.82	1,157.00	2,537.77	1,070.00	1,523.12	3,832.00	5,915.72	154%
Cash Flow	MUS\$	(965.90)	1,116.21		175.30	51.29	323.20	494.37	(16.30)	862.41	482.40	1,408.07	292%
Cost Recovery	MUS\$	(1,831.90)	(2,057.19)		(540.70)	(461.31)	160.20	(808.23)	(73.30)	444.81	(453.60)	(824.73)	

Tabela 3: Treguesit financiar për periudhën 2021 + 9-Mujor 2022.

➤ **Nga tabela vëmë re për vitin 2021:**

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria A...O është 27,733.99 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 29,678 Ton, pra me një mosrealizim prej 7%. Ky është prodhimi më i lartë i realizuar në vendburimin Ballsh-Hekal.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 2,214.96 M\$ nga 1,899.7 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 315.26 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të larta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një realizim në masën 17% më shumë se parashikimi.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qënë 527.95 M\$ nga 410 M\$ të parashikuara në PP&B 2021 Realizimi i G&A per vitin eshte realizuar madje është tejkaluar në masën 29% nga parashikimi.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 janë kryer 1,893.74 M\$ Investime nga 3,628 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021. Sipas kontraktorit, kjo ka ardhur kryesisht prej mosrealizimit të investimeve që kërkojnë leje dhe që janë ende pezull.

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

➤ **Nga tabela vëmë re për 9-Mujorin e vitit 2022:**

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria A...O është 19,982.09 Ton , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 21,940.35 Ton, pra me një mosrealizim prej 9%.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 1,130.88 M\$ nga 1,693 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 562.12 M\$. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022, me një mosrealizim në masën 33% më pak se parashikimi.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e vitit 2022, kanë qënë 381.97 M\$ nga 366.75 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Realizimi i G&A per vitin eshte realizuar madje është tejkaluar në masën 4% nga parashikimi.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 1,605.51 M\$ Investime nga 2,597 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për 9-Mujorin e vitit 2022, janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022.

Cost Recovered: Për 9-Mujorin e vitit 2022, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Ky Program Pune dhe Buxhet është miratuar nga shoqëria “Albpetrol” SH.A. (shkresa me Nr.2517 Prot., datë 14.04.2021).

-Programi i Punës dhe Buxheti i vitit 2022, datë 04.04.2022.. Ky Program Pune dhe Buxhet është miratuar nga shoqëria “Albpetrol” SH.A. (shkresa me Nr.3166/1 Prot., datë 22.04.2022), me kushtet që:

-Shoqëria “A....” SH.A. brenda muajit Maj 2022 të paraqesë ndryshimet e Planit të Zhvillimit në fuqi:

-Shoqëria “A....” SH.A. të reflektojë në Programin e Punës dhe Buxhetin për vitin 2022 realizimin e treguesve të Programit të Punës dhe Buxhetit për vitin 2021, për vendburimin Ballsh-Hekal.

-Shoqëria “A....” SH.A. të reflektojë në Programin e Punës dhe Buxhetin për vitin 2022 cmimin Brent të azhurnuar, si dhe gjithë treguesit që ky ndryshim ndikon.

➤ **Auditet e zhvilluara në Albpetrol bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure**

Në bazë të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure”

“Albpetroli do të ketë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj nga marrja e secilës deklaratë të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione përsa i përket ndonjë deklarate të tillë të Llogarisë Kosto, me kusht që Albpetroli nuk do të titullohet të kryejë më shumë se dy audite të librave të Llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një Vit Fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakortpër cdo rregullim të kërkuar. Dokumenta shtesë dhe llogarie do të bëhen të disponueshme për Albpetrolin gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës së mësipërme prej dymbëdhjetë (12) muaj Albpetroli nuk ka - këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë do të konsiderohet e aprovuar ”.

Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim te Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Ballsh-Hekal” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:

Shpenzime për Gjoha dhe dëmshpërblime - 853.11 USD

Shpenzime për pritje dhe përfaqësime - 20,003.12 USD

Shpenzime të kategorizuara si Sponsorizime/Donacione - 753.3 USD

Shpenzime për “Transferime,udhëtime,dieta” - 1,317.33 USD

Shpenzime për “Zhdëmtim,rehabilitimin e tokës bujqësore”(Opex) - 6,770.87 - USD

Verifikimi i shpenzimeve të ndryshme operationale - 41,145.15USD

Shpenzimeve për “Komunikim dhe IT” - 463.330 USD

Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020 për A.... Sh.A është 71,306.21 USD

➤ **Inventarizimi i aseteve:**

- Shoqëria “Albpetrol” SH.A., me shkresën me Nr. 1047 Prot., datë 03.02.2022, kërkon nga A.... që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2021, për vendburimin Ballsh-Hekal.

- Në mungesë të një përgjigje nga ana e shoqërisë “Albpetrol” SH.A, me shkresën me Nr. 1047/1 Prot., datë 22.04.2022, shoqëria “Albpetrol” Sh.A dërgon një kërkesë të përsëritur.

- Me shkresën me Nr. 1047/2 Prot., Datë 09.05.2022, shoqëria “Albpetrol” SH.A dërgon inventarin e matjeve fizike të naftës në grupet e prodhimit dhe në Dekantim, mbajtur më datë 31.12.2021.

- Shoqëria “Albpetrol” SH.A, me shkresën me Nr. 8602 Prot., datë 25.11.2022, njofton për procesin e inventarizimit të fundvitit 2022.

- Shoqëria "Albpetrol" SH.A., me shkresën me Nr. 1071 Prot., datë 13.02.2023, kërkon nga A...O që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2022, për vendburimin Ballsh-Hekal.

Shoqëria "Albpetrol" SH.A nuk ka paraqitur inventarin e materialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2022, për vendburimin Ballsh-Hekal.

-Të dhëna për treguesit e prodhimit dhe treguesit financiarë, për shoqërinë "D...Y" SH.A..

Detyrime të prapambetura në naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues ("PPE") dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol ("PPA"), për periudhën deri më 31.12.2022.

Tremujori i Katert, Viti 2022										
Shoqëria "Delvina Gas Company" Ltd Delvine Kondesat	Dorezim naftë gjendje (ton)	Dorezim ne natyre PPE (ton)	Dorezim ne natyre PPA (ton)	Detyrim naftë gjendje (ton)	Detyrimi sipas M-H per PPE (ton)	Detyrimi sipas M-H per PPA (ton)	Diferenca naftë gjendje (ton)	Diferenca PPE (ton)	Diferenca PPA (ton)	Total diferenca (ton)
Viti 2014	0.000	0.000	0.000	0.000	390.140	0.000	0.000	-390.140	0.000	-390.140
Viti 2015	0.000	0.000	0.000	0.000	371.115	0.000	0.000	-371.115	0.000	-371.115
Viti 2016	0.000	0.000	0.000	0.000	353.010	0.000	0.000	-353.010	0.000	-353.010
Viti 2017	0.000	0.000	0.000	0.000	335.799	0.000	0.000	-335.799	0.000	-335.799
Viti 2018	0.000	0.000	0.000	0.000	319.421	0.000	0.000	-319.421	0.000	-319.421
Viti 2019	0.000	0.000	0.000	0.000	303.841	0.000	0.000	-303.841	0.000	-303.841
Viti 2020	0.000	0.000	0.000	0.000	289.025	0.000	0.000	-289.025	0.000	-289.225
Viti 2021	0.000	0.000	0.000	0.000	274.929	0.000	0.000	-274.929	0.000	-274.929
Janar 2022	0.000	0.000	0.000	0.000	22.296	0.000	0.000	-22.296	0.000	-22.296
Shkurt	0.000	0.000	0.000	0.000	22.204	1.340	0.000	-22.204	-1.340	-23.544
Mars	0.000	0.000	0.000	0.000	22.111	0.000	0.000	-22.111	0.000	-22.111
Q1-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	66.611	1.340	0.000	-66.611	-1.340	-67.951
Prill	0.000	0.000	0.000	0.000	22.019	0.000	0.000	-22.019	0.000	-22.019
Maj	0.000	0.000	0.000	0.000	21.928	0.000	0.000	-21.928	0.000	-21.928
Qershor	0.000	0.000	0.000	0.000	21.837	0.000	0.000	-21.837	0.000	-21.837
Q2-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	65.784	0.000	0.000	-65.784	0.000	-65.784
Korrik	0.000	0.000	0.000	0.000	21.746	0.000	0.000	-21.746	0.000	-21.746
Gusht	0.000	0.000	0.000	0.000	21.655	0.000	0.000	-21.655	0.000	-21.655
Shtator	0.000	0.000	0.000	0.000	21.565	0.000	0.000	-21.565	0.000	-21.565
Q3-2022	-	-	-	-	64.97	-	-	64.97	-	64.97
Tetor	0.000	0.000	0.000	0.000	21.476	0.000	0.000	-21.476	0.000	-21.476
Nentor	0.000	0.000	0.000	0.000	21.386	0.000	0.000	-21.386	0.000	-21.386
Dhjetor	0.000	0.000	0.000	0.000	21.297	2.520	0.000	-21.297	-2.520	-23.817
Q4-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	64.159	2.520	0.000	-64.159	-2.520	-66.679
Prej Fillimit	-	-	-	-	2,898.80	3.86	-	2,898.80	3.86	2,902.86

Tabela 1: Detyrime në naftë bruto, për llogari të P...., për vendburimin Delvina Kondesat.

Detyrimi që D..... ka ndaj Albpetrol sh.a Patos., në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën **nga data efektive deri më 31 Dhjetor 2022**, për vendburimin Delvinë Kondesat është 2,902.86 (dy mijë e nëntëqind e dy pikë tetëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto.

Titulli i gjetjes: Kontraktori ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure.

Situata:

Kontraktori D....., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Detyrimi që D..... ka ndaj Albpetrol sh.a Patos., në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën **nga data efektive deri më 31 Dhjetor 2022**, për vendburimin Delvinë Kondesat është 2,902.86 (dy mijë e nëntëqind e dy pikë tetëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto.. Detyrimi që D..... ka ndaj Albpetrol sh.a Patos., në

gaz natyror për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31 Dhjetor 2022, për vendburimin Delvinë Gaz është 23,630,398.320 (njëzet e tre milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë pikë treqind e njëzet) Nm3 Gaz.

Kriteri: Marrëveshja e hidrokarbureve

Ndikimi/efekti: Mungese e te ardhurave nga kompania Albpetrol për sasinë e naftës bruto e cila nuk është tërhequr për pamundësi depozitimi. **Vlera e sasisë 2,902.86 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 1,443,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Shkaku:** Mos korrektësi e kontraktorit për shlyerjen e detyrimit sipas përcaktimit të marrëveshjes, si dhe pa mundësi e Albpetrol, për magazinimi e sasisë së naftës bruto për llogari të prodhimit para-ekzistues (PPE) dhe të pjesës së Albpetrol (PPA).

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **2,902.86 ton naftë bruto**, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31.12.2022, dhe 23,630,398.320 Nm3 Gaz, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfutur nga marrëveshja hidrokarbure. **Vlera e sasisë 2,902.86 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 1,443,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.**

-Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Tremujori i Katert, Viti 2022							
Shoqëria "Delvina Gas Company" Ltd Delvina Gaz	Dorëzimi në natyrë i PPE Gaz Nm3	Dorëzimi në natyrë PPA Gaz Nm3	Detyrimi sipas M-H për PPE Gaz Nm3	Detyrimi sipas M-H për PPA Gaz Nm3	Diferenca e PPE Gaz Nm3	Diferenca e PPA Gaz Nm3	Total diferenca Gaz Nm3
Fundi i vitit 2014	6,308,716.273	111,356.817	16,945,532.230	111,356.817	-10,636,815.957	0.000	-10,636,815.957
Viti 2015	0.000	0.000	1,922,180.848	0.000	-1,922,180.848	0.000	-1,922,180.848
Viti 2016	0.000	0.000	1,828,434.982	0.000	-1,828,434.982	0.000	-1,828,434.982
Viti 2017	0.000	0.000	1,739,261.156	0.000	-1,739,261.156	0.000	-1,739,261.156
Viti 2018	0.000	0.000	1,654,436.388	0.000	-1,654,436.388	0.000	-1,654,436.388
Viti 2019	0.000	0.000	1,573,748.553	0.000	-1,573,748.553	0.000	-1,573,748.553
Viti 2020	0.000	0.000	1,496,995.949	0.000	-1,496,995.949	0.000	-1,496,995.949
Viti 2021	0.000	0.000	1,423,986.507	0.000	-1,423,986.507	0.000	-1,423,986.507
Janar 2022	0.000	0.000	115,482.900	0.000	-115,482.900	0.000	-115,482.900
Shkurt	0.000	0.000	115,002.700	0.000	-115,002.700	0.000	-115,002.700
Mars	0.000	0.000	114,524.520	0.000	-114,524.520	0.000	-114,524.520
Q1-2022	0.000	0.000	345,010.120	0.000	-345,010.120	0.000	-345,010.120
Prill	0.000	0.000	114,048.320	0.000	-114,048.320	0.000	-114,048.320
Maj	0.000	0.000	113,574.110	0.000	-113,574.110	0.000	-113,574.110
Qershor	0.000	0.000	113,101.870	0.000	-113,101.870	0.000	-113,101.870
Q2-2022	0.000	0.000	340,724.300	0.000	-340,724.300	0.000	-340,724.300
Korrik	0.000	0.000	112,631.590	0.000	-112,631.590	0.000	-112,631.590
Gusit	0.000	0.000	112,163.270	0.000	-112,163.270	0.000	-112,163.270
Shtator	0.000	0.000	111,696.900	0.000	-111,696.900	0.000	-111,696.900
Q3-2022	0.000	0.000	336,491.760	0.000	-336,491.760	0.000	-336,491.760
Tetor	0.000	0.000	111,232.460	0.000	-111,232.460	0.000	-111,232.460
Nëntor	0.000	0.000	110,769.960	0.000	-110,769.960	0.000	-110,769.960
Dhjetor	0.000	0.000	110,309.380	0.000	-110,309.380	0.000	-110,309.380
Q4-2022	0.000	0.000	332,311.800	0.000	-332,311.800	0.000	-332,311.800
Total prej fillimit	6,308,716.273	111,356.817	29,939,114.593	111,356.817	-23,630,398.320	0.000	-23,630,398.320

Tabela 2: Detyrime në naftë bruto, për llogari të P....., për vendburimin D....S.

Detyrimi që D..... ka ndaj Albpetrol sh.a Patos., në gaz natyror për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31 Dhjetor 2022, për vendburimin Delvinë Gaz është 23,630,398.320 (njëzet e tre milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë pikë treqind e njëzet) Nm3 Gaz.

4- Të dhëna mbi treguesit financiar për periudhën 2021+9-Mujorin 2022.

Nr.	Treguesit	Njesia matese	Viti 2021		9-Mujori 2022				
			Fakt	Program Pune dhe Buxhet	Realizimi ne % (Fakt/PP&B)	Fakt	Program Pune dhe Buxhet	Realizimi ne % (Fakt/PP&B)	
1	Puse aktive								
2	Prodhimi i Pergjithshem (gas)	m ³	-	25,680,000.00	0%	-	28,080,000.00	0%	
3	Prodhimi i Pergjithshem (kondesat)	Ton	-	3,550.00	0%	112.26	3,881.00	3%	
4	Prodhimi Para Ekzistues (PPE)(gas)	m ³	1,423,986.60	1,423,986.61	100%	1,022,226.16	1,022,137.00	100%	
5	Prodhimi Para Ekzistues (PPE) (kondesat)	Ton	274.93	274.93	100%	197.63	197.38	100%	
6	Pjesa e Prodhimit te Albpetrol (PPA)(gas)	m ³	-	745,740.16	0%	-	811,735.89	0%	
7	Pjesa e Prodhimit te Albpetrol (PPA)(kondesat)	Ton	-	101.74	0%	1.34	113.83	1%	
8	Brenti	S/bbl							
9	Cmimi i shitjes gas	S/m ³					0.22	0%	
10	Cmimi i shitjes se naftes (kondesat)	S/ton					586.22	0%	
12	Sasia e prodhimit te shitur (gas)	Bbl							
13	Sasia e prodhimit te shitur (kondesat)	Ton		3,289.56	0%				
14	Te ardhurat nga shitja (gas)	MUSD					4,136.33	0%	
15	Te ardhurat nga shitja (kondesat)	MUSD		1,256.30	0%		1,722.28	0%	
16	Te ardhurat nga shitja (kondesat)*0.3	MUSD		376.89	0%				
17	Te ardhura qe mbeten per te perballuar kostot (kondesat)	MUSD		879.41	0%		5,858.61	0%	
18	Renta			87.94	0%		585.86	0%	
19	Shpenzimet Operative (OPEX)	MUSD	657.00	778.52	84%	761.00	2,196.31	35%	
20	Shpenzime te pergjithshme Administrative (G&A)	MUSD	368.00	426.60	86%	406.00	1,178.10	34%	
21	Shpenzime Kapitale (CAPEX)	MUSD	5,701.00	19,842.88	29%	1,922.00	8,970.00	21%	
22	Fix Assets	MUSD	567.00			2.00			
23	Total Kosta	MUSD	7,293.00	21,048.00	35%	3,091.00	12,344.41	25%	
24	Te ardhura pas OPEX	MUSD	(1,025.00)	(413.65)	248%	(1,167.00)	1,898.34	-61%	
25	Cost Recovery	MUSD	(7,293.00)	(20,256.53)	36%	(3,091.00)	(7,071.66)	44%	

Tabela 3: Treguesit financiar për periudhën 2021 + 9-Mujorin 2022.

➤ Nga tabela vëmë re për vitin 2021:

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria “D...Y” Ltd., është 0 Ton naftë kondensat dhe 0 Nm³ Gaz, nderkohe që në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2021 kishin parashikuar 3,550 Ton naftë kondensat dhe 25,680,000 Nm³ Gaz.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 657 M\$ nga 778.52 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 121.52 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 16%.

Shpenzimet Administrative (G....A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qënë 368 M\$ nga 426.6 M\$ të parashikuara në PP&B 2021, me një mosrealizim prej 14%.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 janë kryer 5,701 M\$ Investime nga 19,842.88 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 71%.

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, shpenzimet kapin vlerën 7,293 M\$, duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

➤ Nga tabela vëmë re për 9-Mujorin e vitit 2022:

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria “D...Y” Ltd., është 112.26 Ton kondensat dhe 0 Nm³ Gaz, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 3,881 Ton kondensat dhe 288,080,000 m³.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 761 M\$ nga 2,196.31 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 1,435.31 M\$. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022, me një mosrealizim prej 65%.

Shpenzimet Administrative (G....A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e Vitit 2022, kanë qënë 406 M\$ nga 1,178.1 M\$ të parashikuara në PP&B 2022, me një mosrealizim prej gati 66%.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 1,922 M\$ Investime nga 8,970 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për 9-Mujorin e vitit 2022 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022, me një mosrealizim gati 79%.

Cost Recovered: Në 9-Mujorin e vitit 2022 sipas Faktit, shpenzimet kapin vlerën prej 3,091 M\$, duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

➤ **Auditet e zhvilluara në Albpetrol bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure**

Në bazë të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure”

“Albpetroli do të ketë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj nga marrja e secilës deklarate të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione përsa i përket ndonjë deklarate të tillë të Llogarisë Kosto, me kusht që Albpetroli nuk do të titullohet të kryejë më shumë se dy audite të librave të Llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një Vit Fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakortpër cdo rregullim të kërkuar. Dokumenta shtesë dhe llogarie do të bëhen të disponueshme për Albpetrolin gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës së mësipërme prej dymbëdhjetë (12) muaj Albpetroli nuk ka - këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë do të konsiderohet e aprovuar”.

Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Delvinë” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1, Q2, Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:

- Shpenzime “V...I”	- 10,077.23 USD
- Shpenzime “F...0”	- 28,837.17 USD
- Verifikimi i shpenzimeve për “Shërbime Konsulence”	- 79,999.99 USD
- Verifikimi i shpenzimeve për Qiranë e Zyrave	- 19,866.4 USD
- Verifikimi i shpenzimeve “Qira Toke”	- 22,892.5 USD

Pra, si më lart, Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperushme për vitin 2020 për shoqërinë “D...Y” LTD është 161,373.29 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre pikë njëzetë e nëntë) USD.

➤ **Inventarizimi i aseteve:**

- Shoqëria “Albpetrol” SH.A., me shkresën me Nr. 1048 Prot., datë 03.02.2022, kërkon nga Delvina që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe kondesatit në fundin e viti 2021, për vendburimin Delvinë.

- Në mungesë të një përgjigje nga ana e shoqërisë “D...Y” Ltd., me shkresën me Nr. 1048/1 Prot., datë 22.04.2022, shoqëria “Albpetrol” Sh.A dërgon një kërkesë të përsëritur.

- Shoqëria “Albpetrol” SH.A., me shkresën me Nr. 1068 Prot., datë 13.02.2023, kërkon nga Delvina që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe kondesatit në fundin e viti 2022, për vendburimin Delvinë.

- Me shkresën me Nr. 1068/1 Prot., Datë 01.03.2023, shoqëria “D...Y” informon se për shkak të aktivitetit të kompanisë gjatë periudhës nëntor 2022 – shkurt 2023 dhe operacioneve të zhvilluara në vendburim gjatë kësaj periudhe, është vendosur shtyrja e kryerjes së inventarit të materialeve për fundvitin 2022, për një periudhë më të përshtatshme.

-Të dhëna për treguesit e prodhimit dhe treguesit financiarë, për shoqërinë “T...S” SH.A..

Detyrime të prapambetura në naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (“PPE”) dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol (“PPA”), dhe të naftës gjëndje në vendburim, për periudhën deri më 31.12.2022.

Tremujori i Katert, Viti 2022										
Shoqëria "TerraOil Swiss" sh.a. (Ish TOG)	Dorëzimi i naftës gjendje (ton)	Dorëzimi në natyrë PPE (ton)	Dorëzimi në natyrë PPA (ton)	Detyrimi i naftës gjendje (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPE (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPA (ton)	Diferenca e naftës gjendje (ton)	Diferenca PPE (ton)	Diferenca PPA (ton)	Total diferenca (ton)
Fundi i vitit 2014	0.000	17681.475	0.000	1362.520	18597.470	370.750	-1362.520	-915.995	-370.750	-2649.265
Viti 2015	0.000	3640.241	0.000	0.000	4934.208	218.138	0.000	-1293.967	-218.138	-1512.105
Viti 2016	0.000	1659.341	0.000	0.000	4464.656	209.643	0.000	-2805.315	-209.643	-3014.958
Viti 2017	0.000	4681.633	0.000	0.000	4039.788	165.432	0.000	641.845	-165.432	476.413
Viti 2018	0.000	4656.081	0.000	0.000	3655.351	152.428	0.000	1000.730	-152.428	848.302
Viti 2019	0.000	4388.024	0.000	0.000	3307.499	144.101	0.000	1080.525	-144.101	936.424
Viti 2020	0.000	406.829	0.000	0.000	2992.750	115.987	0.000	-2585.921	-115.987	-2701.908
Viti 2021	0.000	657.793	0.000	0.000	2707.949	117.853	0.000	-2050.156	-117.853	-2168.009
Janar 2022	0.000	272.590	0.000	0.000	213.676	9.333	0.000	58.914	-9.333	49.581
Shkurt	0.000	371.817	0.000	0.000	211.903	8.241	0.000	159.914	-8.241	151.673
Mars	0.000	343.855	0.000	0.000	210.144	9.329	0.000	133.711	-9.329	124.382
Q1-2022	0.000	988.262	0.000	0.000	638.723	28.903	0.000	352.539	-28.903	323.636
Prill	0.000	0.000	0.000	0.000	208.400	8.116	0.000	-208.400	8.116	-216.516
Maj	0.000	0.000	0.000	0.000	206.671	8.473	0.000	-206.671	-8.473	-215.144
Qershor	0.000	356.928	0.000	0.000	204.956	9.050	0.000	151.972	-9.050	142.922
Q2-2022	0.000	356.928	0.000	0.000	620.027	25.639	0.000	-263.099	-25.639	-288.738
Korrik	0.000	0.000	0.000	0.000	202.255	8.817	0.000	-202.255	-8.817	-211.072
Gusht	0.000	0.000	0.000	0.000	201.568	9.764	0.000	-201.568	-9.764	-211.332
Shtator	0.000	379.502	0.000	0.000	199.895	9.701	0.000	179.607	-9.701	169.906
Q3-2022	0.000	379.502	0.000	0.000	604.718	28.282	0.000	-225.216	-28.282	-253.498
Tetor	0.000	0.000	0.000	0.000	198.236	9.603	0.000	-198.236	-9.603	-207.839
Novator	0.000	286.316	0.000	0.000	196.591	9.210	0.000	89.725	-9.210	80.515
Dhjetor	0.000	0.000	0.000	0.000	194.956	8.900	0.000	-194.956	-8.900	-203.856
Q4-2022	0.000	286.316	0.000	0.000	589.783	27.713	0.000	-303.467	-27.713	-331.180
Prej fillimit	-	39,782.43	-	1,362.52	47,149.92	1,602.87	-	1,362.52	-7,367.50	-1,602.87

Tabela 1: Detyrime në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjendje në vendburim.

Shënim: Sasia e naftës së lëvizshme gjendje në fillim dorëzuar kontraktorit, është 974.65 ton dhe naftë e palëvizshme gjendje në vendburim është 375.45 ton. Në sasinë e naftës gjendje, në tabelë, është përfshirë edhe sasia prej 12.42 ton naftë, që TOG ka marrë nga Albpetrol, për ta përdorur si hollues. Sasia prej 12.42 ton naftë, është marrë nga bilanci i naftës Albpetrol, viti 2010.

➤ **Për vitin 2021:**

- Nga tabela 1 vëmë re se, detyrimi që shoqëria "T...S" SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjendje në vendburim sipas **Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2021 është 2,825.802 (dy mijë e tetëqind e njëzet e pesë pikë tetëqind e dy) Ton naftë bruto.
- Shoqëria "Albpetrol" SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 657.793 (gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) Ton naftë bruto.
- Pra, **janë tërhequr rreth 2,168.009** (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë zero zero nëntë) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.**

➤ **Për vitin 2022:**

- Nga tabela 1 vëmë re se, detyrimi që shoqëria "T...S" SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjendje në vendburim sipas **Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2022 është 2,558.788 (dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë pikë shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) Ton naftë bruto.
- Shoqëria "Albpetrol" SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 2,011.008 (dy mijë e njëmbëdhjetë pikë zero zero tetë) Ton naftë bruto.
- Pra, **janë tërhequr rreth 547.78** (pesëqind e dyzet e shtatë pikë shtatëdhjetë e tetë) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022.**

Detyrimi që shoqëria "T...S" SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për periudhën nga data efektive deri më 31.12.2022 është 10,332.89 (dhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy pikë tetëdhjetë e nëntë) ton naftë bruto.

Titulli i gjetjes: Kontraktori ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure.

Situata:

Kontraktori "T...S" SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria "T...S" SH.A., ka ndaj

Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjendje në vendburim sipas **Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2021 është 2,825.802 (dy mijë e tetëqind e njëzet e pesë pikë tetëqind e dy) Ton naftë bruto.

Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 657.793 (gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) Ton naftë bruto.

Pra, **janë tërhequr rreth 2,168.009** (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë zero zero nëntë) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.**

Për vitin 2022 vërehet se, detyrimi që shoqëria “T...S” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjendje në vendburim sipas **Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2022 është 2,558.788 (dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë pikë shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) Ton naftë bruto.

Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 2,011.008 (dy mijë e njëmbëdhjetë pikë zero zero tetë) Ton naftë bruto.

Pra, **janë tërhequr rreth 547.78** (pesëqind e dyzet e shtatë pikë shtatëdhjetë e tetë) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022.**

Detyrimi që shoqëria “T...S” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për periudhën nga data efektive deri më 31.12.2022 është 10,332.89 ton naftë bruto.

Kriteri: Marrëveshja e hidrokarbureve

Ndikimi/efekti: Mungese e te ardhurave nga kompania Albpetrol për sasinë e naftës bruto e cila nuk është tërhequr për pamundësi depozitimi. Vlera e sasisë 10,332.89 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 5,139,553 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.

Shkaku: Mos korrektësi e kontraktorit për shlyerjen e detyrimit sipas përcaktimit të marrëveshjes, si dhe pa mundësi e Albpetrol, për magazinimi e sasisë së naftës bruto për llogari të prodhimit para-ekzistues (PPE) dhe të pjesës së Albpetrol (PPA)

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **10,332.89** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31.12.2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. **Vlera e sasisë 10,332.89 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 5,139,553 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.**

-Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

-Detyrimet e shoqërisë “T...S” SH.A., për periudhën e objektit të auditimit (2021 –2022).

Bazuar në sasinë e naftës së patërhequr për llogari të P...., për periudhën objekt auditimi rezulton se:

Viti	Sasia e naftës që "TerraOil Swiss" SH.A. i detyrohet Albpetrolit (Ton)	Çmimi mesatar i shitjes nga TOS (\$/bbl)	Çmimi mesatar i shitjes nga TOS (\$/Ton)	Vlera (USD)
Tremujori i Parë 2021 (Q1-2021)	729.89	37.00	232.72	169,862.43
Tremujori i Dytë 2021 (Q2-2021)	715.04	41.00	257.88	184,396.57
Tremujori i Tretë 2021 (Q3-2021)	699.77	44.00	276.75	193,661.08
Tremujori i Katër 2021 (Q4-2021)	23.31	52.00	327.07	7,623.01
Total Viti 2021	2,168.01			555,543.10
Tremujori i Parë 2022 (Q1-2022)	(325.64)	66.00	415.13	(135,180.09)
Tremujori i Dytë 2022 (Q2-2022)	288.74	71.00	446.58	128,943.40
Tremujori i Tretë 2022 (Q3-2022)	253.50	63.00	396.26	100,450.46
9-Mujori i Vitit 2022	216.60			94,213.77
Ne total 2021+9-Mujori 2022	2,384.61			649,756.87

Tabela 2: Detyrimet e prapambetura në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës , për vitin 2021+9-Mujorin 2022.

Shënim: Cmimi i shitjes së naftës është marrë nga Progres Raportet 3-Mujore të dërguar nga shoqëria "T...S" SH.A..

5- Të dhëna mbi treguesit financiar për periudhën 2021+9-Mujorin 2022.

Treguesit	Njësia matëse	Viti 2021			9-Mujori 2022									
		Total Fakt	Total Program	Realizimi ne % (Fakt/Program)	Q1-2022 Fakt	Q1-2022 Program	Q2-2022 Fakt	Q2-2022 Program	Q3-2022 Fakt	Q3-2022 Program	9-Mujori 2022 Fakt	9-Mujori 2022 Program	Realizimi ne % (Fakt/Program)	
Puse aktive		78.00	92.00		70.00	92.00	72.00		75.00					
Prodhimi i Përgjithshëm (ton)	Ton	14,827.30	27,228.00	184%	3,330.00	4,693.00	3,184.00	5,758.00	3,433.00	6,511.00	9,947.00	16,962.00	171%	
Prodhimi i Përgjithshëm (bbl)	Ton	104,559.00			23,661.70		22,918.00		24,505.00		71,084.70			
Prodhimi Para Ekzistues (PPE)	Ton	2,707.95	2,590.00	96%	635.72	635.72	620.03	620.03	604.72	604.72	1,860.47	1,860.47	100%	
Prodhimi Para Ekzistues (PPE)	bbl													
Naftë për Prodhimin për nevojat e veta	Ton	334.10	272.00	81%	4.00	46.90	-	57.70	-	65.10	4.00	169.70	4243%	
Pjesa e Prodhimit të Albpetrolit (PPA)	Ton	117.85	244.00	207%	26.90	40.10	25.64	50.80	28.28	58.41	80.83	149.32	185%	
Pjesa e Prodhimit të Albpetrolit (PPA)	bbl													
Rendi	S/Ton													
Cmimi mesatar i shitjes	S/Ton				352.23		352.23		352.23		352.23		1,056.69	
Cmimi mesatar i shitjes	\$/bbl	41.00	38.00	93%	66.00	56.00	71.00	56.00	63.00	56.00	200.00	168.00	84%	
Te ardhura bruto	MUS\$	4,286.92			1,561.67	1,653.01	1,627.18	2,028.13	1,543.82	2,253.36	4,732.67	5,974.51	126%	
Sasia e prodhimit të shitur	Ton	24,112.00			3,970.00		3,970.00		5,030.00		5,782.00		14,782.00	
Sasia e prodhimit të shitur	bbl	86,822.00			18,851.00		20,376.00		17,291.00		56,518.00		0%	
Te ardhura nga shitje	MUS\$	3,663.00	5,437.71	148%	1,167.00	1,398.35	1,458.00	1,771.71	1,091.00	2,036.59	3,716.00	5,206.65	140%	
Te ardhura të tjera	MUS\$	93.00	600.00	645%	14.00	135.00	5.00	135.00	15.00	34.00	405.00	1191%		
Rendi	MUS\$	366.90	543.77	148%	116.70	139.83	145.80	177.17	109.10	203.66	371.60	520.66	140%	
Shpenzimet Operative (OPEX)	MUS\$	2,779.00	3,689.73	133%	517.00	1,002.22	630.00	1,045.17	619.00	1,075.52	3,766.00	3,122.92	177%	
Shpenzimet të përgjithshme Administrative (G&A)	MUS\$	1,582.00	688.00	43%	372.00	340.00	364.00	190.00	394.00	30.00	1,130.00	560.00	50%	
Shpenzimet Kapitale (CAPEX)	MUS\$	866.00	3,173.40	366%	716.00	512.60	163.00	1,302.60	57.00	417.60	936.00	2,232.80	239%	
Total Kosto	MUS\$	5,227.00	7,551.13	144%	1,605.00	1,854.82	1,157.00	2,537.77	1,070.00	1,523.12	3,832.00	5,915.72	154%	
Cash Flow	MUS\$	(965.90)	1,116.21	115%	175.30	51.29	323.20	494.37	(16.10)	862.41	1,408.07	1,408.07	292%	
Cash Recovery	MUS\$	(1,831.90)	(2,057.19)	112%	(540.70)	(461.31)	160.20	(808.23)	(73.10)	444.81	(453.60)	(824.73)	182%	

Tabela 3: Treguesit financiar për periudhën 2021 + 9-Mujorin 2022.

➤ Nga tabela vëmë re për vitin 2021:

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria TOS është 14,827.3 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 27,228 Ton, pra me një mosrealizim prej 46%. Kjo diferencë përgjithësisht i atribuohet faktit që pavarësisht se të parashikuara në Buxhet 4-Projektet e përmirësimit të puseve ekzistuese nuk kanë dhënë akoma impaktin e parashikuar në Prodhim..

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 2,779 M\$ nga 3,689.73 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 910.73 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021.

Peshën me të madhe e zënë shpenzimet për energji elektrike dhe për holluesin teknologjik për shkak të karakteristikave që ka nafta e Vb. Visokë.

Shpenzimet Administrative (G...A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qënë 1,582 M\$ nga 688 M\$ të parashikuara në PP&B 2021 Realizimi i G...A për vitin është realizuar madje është tejkaluar.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 janë kryer 866 M\$ Investime nga 3,173.13 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021.

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

➤ **Nga tabela vëmë re për 9-Mujorin e vitit 2022:**

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria TOS është 9,947 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 16,962 Ton, pra me një mosrealizim prej 41%. Kjo diferencë përgjithësisht i atribuohet faktit që pavarësisht se të parashikuara në Buxhet 4-Projektet e përmirësimit të puseve ekzistuese nuk kanë dhënë akoma impaktin e parashikuar në Prodhim..

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 1,766 M\$ nga 3,122.92 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 1,356.92 M\$. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022.

Peshën me të madhe e zënë shpenzimet për energji elektrike dhe për holluesin teknologjik për shkak të karakteristikave që ka nafta e Vb. Visokë.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e Vitit 2022, kanë qënë 1,130 M\$ nga 560 M\$ të parashikuara në PP&B 2022 Realizimi i G&A per vitin eshte realizuar madje është tejkualuar.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 936 M\$ Investime nga 2,232.8 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për 9-Mujorin e vitit 2022 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022.

Cost Recovered: Në 9-Mujorin e vitit 2022 sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Programi i Punës dhe Buxheti 2021 me Nr. 6056 Prot., datë 30.10.2020.

Ky Program Pune dhe Buxhet është miratuar nga shoqëria "Albpetrol" SH.A. (shkresa me Nr.2184 Prot., datë 30.03.2021), sipas përmirësimeve të propozuara.

- Programi i Punës dhe Buxheti i vitit 2022, protokolluar në Albpetrol sh.a Patos. me Nr. 729 Prot., datë 25.01.2022

➤ **Auditet e zhvilluara në Albpetrol bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure**

Në bazë të Nenit 25 "Auditet" të Marrëveshjes Hidrokarbure" "Albpetroli do të ketë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj nga marrja e secilës deklaratë të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione përsa i përket ndonjë deklaratë të tillë të Llogarisë Kosto, me kusht që Albpetroli nuk do të titullohet të kryejë më shumë se dy audite të librave të Llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një Vit Fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakortpër cdo rregullim të kërkuar. Dokumenta shtesë dhe llogarie do të bëhen të disponueshme për Albpetrolin gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës së mësipërme prej dymbëdhjetë (12) muaj Albpetroli nuk ka - këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë do të konsiderohet e aprovuar".

Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim te Nenit 25 "Auditet" të Marrëveshjes Hidrokarbure "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Visoke" ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:

- Verifikimi i Shpenzimeve "Për pagat e punonjësve" - 10.000 USD
- Shpenzime per "Bileta Avioni" - 5.754 USD

- Shpenzime për "Fjetje" - 1.710 USD
- Shpenzime për "Fjetje" - 449 USD
- Shpenzime për "Fjete" - 630 USD
- Shpenzime për "Akomodim" - 426 USD
- Shpenzime për "Ambjente shërbimi dhe drekë pune". - 810 USD
- Shpenzime për Drekë pune" - 790 UDS

Vlera totale prej 20.569 USD nuk njihet si Kosto Hidrokarbure dhe duhet të zbritet nga Llogaria Kosto.

➤ **Llogaritja e Faktorit R: Të dhënat progresive.**

"TerraOil Swiss" sh.a.	Njësia matëse	Treguesit Progresiv deri me 31.12.2021	9-Mujori 2022	Treguesit Progresiv deri me 30.09.2022
Të ardhura për mbulim kosto	MUSD	39,376.90	3,377.00	42,753.90
Shpenzimet Operacionale dhe Administrative (OPEX+G&A)	MUSD	64,845.17	2,896.00	67,741.17
Shpenzimet Kapitale (CAPEX)	MUSD	36,315.23	936.00	37,251.23
Kosto totale Hidrokarbure	MUSD	101,160.40	3,832.00	104,992.40
Kosto të refuzuara nga Albpetrol	MUSD	213.23	-	213.23
Kosto të refuzuara nga AKBN	MUSD	2,387.00	-	2,387.00
Kosto totale Hidrokarbure (duke zbritur auditet e AKBN+Albpetrol)	MUSD	98,560.17	3,832.00	102,392.17
Faktori R (duke marrë parasysh auditet e AKBN+Albpetrol)		0.40		0.42

Tabela 5: Llogaritja e Faktorit R

Nga shoqëria "Albpetrol" SH.A. është ngritur si problem që në progres Raportet 3-Mujore shoqëria "T...S" SH.A., përdor 2 tabela të ndryshme në lidhje me zërin "Mbulimi i Kostove Hidrokarbure".

- 1- Një tabelë mbulim kosto, në të cilën merr për bazë kostot e refuzuara nga AKBN dhe nxjerr Faktorin R (AKBN), duke marrë për bazë vetëm kostot e refuzuara nga AKBN.
- 2- Një tabelë mbulim kosto, në të cilën merr për bazë kostot e refuzuara nga Albpetrol dhe nxjerr Faktorin R (Albpetrol), duke marrë për bazë vetëm kostot e refuzuara nga Albpetrol.

Ndërkohë që, Aneksi B, Neni 2.1 i Marrëveshjes Hidrokarbure thekson se Kontraktori do të mbajë një Llogari Kostoje në të cilën do të reflektohen të gjitha Kostot Hidrokarbure.

Gjithashtu, një problem tjetër i ngritur në Lidhje me Auditet e zhvilluara nga shoqëria "Albpetrol" SH.A. ka qënë fakti që në Progres Raportet 3-Mujore, TOS, ka zbritur vetëm vlerën korresponduese për vitet 2014 dhe 2016 dhe jo te gjithë vlerat korresponduese që i përaksin auditeve të viteve të tjera të zhvilluara nga Albpetrol.

➤ **Inventarizimi i aseteve:**

- Shoqëria "Albpetrol" SH.A., me shkresën me Nr. 1050 Prot., datë 03.02.2022, kërkon nga TOS që të dërgojnë inventarin e matërialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2021, për vendburimin Visokë
- Në mungesë të një përgjigje nga ana e shoqërisë "T...S" SH.A., me shkresën me Nr. 1050/1 Prot., datë 22.04.2022, shoqëria "Albpetrol" Sh.A dërgon një kërkesë të përsëriur.
- Me shkresën me Nr. 1050/2 Prot., Datë 04.05.2022, shoqëria "T...S" dërgon inventarin e matërialeve të naftës bruto në fund të vitit 2021, inventarin e automjeteve, inventarin e materialit gjendje në magazinë në datën 31.12.2021, inventarin e depozitave metalike dhe të betonit në Vb. Visokë.
- Shoqëria "T...S" SH.A., me shkresën me Nr. 8715 dhe 8716 Prot., datë 02.12.2022, njofton për procesin e inventarizimit të fundvitit 2022.

- Shoqëria "Albpetrol" SH.A., me shkresën me Nr. 1069 Prot., datë 13.02.2023, kërkon nga TOS që të dërgojnë inventarin e matërialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2022, për vendburimin Visokë
- Me shkresën me Nr. 1069/1 Prot., Datë 17.02.2023, shoqëria "T...S" dërgon inventarin e matërialeve të naftës bruto në fund të vitit 2022.

Të dhëna për treguesit e prodhimit dhe treguesit financiarë, për shoqërinë "F...M" SH.A. Detyrime të prapambetura në naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues ("PPE") dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol ("PPA"), dhe të naftës gjëndje në vendburim, për periudhën deri më 31.12.2022, për Vendburimin P...Z.

Tremujori i Katert, Viti 2022										
Shoqëria "Fin-Pek Petroleum" sh.a. Vendburimi Pekisht-Murriz	Dorëzim naftë gjëndje (ton)	Dorëzim në natyrë PPE (ton)	Dorëzim në natyrë PPA (ton)	Detyrimi naftë gjëndje (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPE (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPA (ton)	Diferenca naftë gjëndje (ton)	Diferenca e PPE (ton)	Diferenca e PPA (ton)	Total diferenca (ton)
Fundi i vitit 2014	0.000	26.065	0.000	25.180	137.562	0.501	-25.180	-111.497	-0.501	-137.178
Viti 2015	0.000	65.625	0.000	0.000	94.158	1.025	0.000	-28.533	-1.025	-29.558
Viti 2016	20.680	166.419	0.000	0.000	86.919	3.743	20.680	79.500	-3.743	96.438
Viti 2017	0.000	81.915	0.000	0.000	80.236	5.559	0.000	1.679	-5.559	-3.880
Viti 2018	0.000	42.462	0.000	0.000	74.067	4.748	0.000	-31.605	-4.748	-36.354
Viti 2019	0.000	313.994	0.000	0.000	68.373	6.040	0.000	245.621	-6.040	239.581
Viti 2020	0.000	0.000	0.000	0.000	63.116	2.076	0.000	-63.116	-2.076	-65.192
Viti 2021	0.000	0.000	0.000	0.000	58.265	17.732	0.000	-58.265	-17.732	-75.997
Janar 2022	0.000	0.000	0.000	0.000	4.648	1.165	0.000	-4.648	-1.165	-5.813
Shkurt	0.000	9.393	0.000	0.000	4.617	1.962	0.000	4.776	-1.962	2.814
Mars	0.000	0.000	0.000	0.000	4.587	2.887	0.000	-4.587	-2.887	-7.474
Q1-2022	0.000	9.393	0.000	0.000	13.852	6.014	0.000	-4.459	-6.014	-10.473
Prill	0.000	0.000	0.000	0.000	4.556	2.463	0.000	-4.556	-2.463	-7.019
Maj	0.000	0.000	0.000	0.000	4.526	2.455	0.000	-4.526	-2.455	-6.981
Qershor	0.000	0.000	0.000	0.000	4.496	1.986	0.000	-4.496	-1.986	-6.482
Q2-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	13.878	6.904	0.000	-13.878	-6.904	-20.482
Korrik	0.000	0.000	0.000	0.000	4.466	1.975	0.000	-4.466	-1.975	-6.441
Gusht	0.000	0.000	0.000	0.000	4.436	1.960	0.000	-4.436	-1.960	-6.396
Shtator	0.000	0.000	0.000	0.000	4.407	3.458	0.000	-4.407	-3.458	-7.865
Q3-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	13.309	7.393	0.000	-13.309	-7.393	-20.702
Tetor	0.000	0.000	0.000	0.000	4.377	2.662	0.000	-4.377	-2.662	-7.039
Nëntor	0.000	0.000	0.000	0.000	4.348	2.313	0.000	-4.348	-2.313	-6.661
Dhjetor	0.000	31.808	0.000	0.000	4.319	2.177	0.000	27.489	-2.177	25.312
Q4-2022	0.000	31.808	0.000	0.000	13.044	7.152	0.000	18.764	-7.152	11.612
Total prej fillimit	20.680	737.681	0.000	25.180	716.478	68.888	-4.500	21.203	-68.888	-52.185

Tabela 1: Detyrime në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjëndje në vendburim.

- **Për vitin 2021:**
 - Nga tabela 1 vëmë re se, detyrimi që shoqëria "F...M" SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjëndje në vendburim, për Vb. P...Z sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 75.997 (shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) Ton naftë bruto.
 - Shoqëria "Albpetrol" SH.A. nuk e ka tërhequr këtë sasi naftë gjatë vitit 2021.
- **Për vitin 2022:**
 - Nga tabela 1 vëmë re se, detyrimi që shoqëria "F...M" SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjëndje në vendburim, për Vb. P...Z sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 81.246 (tetëdhjetë e një pikë dyqind e dyzet e gjashtë) Ton naftë bruto.
 - Shoqëria "Albpetrol" SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 41.201 (dyzet e një pikë dyqind e një) Ton naftë bruto.
 - Pra, janë tërhequr rreth 40.045 (dyzet pikë zero dyzet e pesë) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022.

Detyrimi që shoqëria "F...M" SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjëndje në vendburim, për Vb. Pekishy-Murriz, për periudhën deri më 31.12.2022 është 52.185 (pesëdhjetë e dy pikë njëqind e tetëdhjetë e pesë) ton naftë bruto.

-Detyrime të prapambetura në naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues ("PPE") dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol ("PPA"), dhe të naftës gjëndje në vendburim, për periudhën deri më 31.12.2022, për Vendburimin F...E.

Tremujori i Katert, Viti 2022											
Shoqëria "Fin-Pek Petroleum" sh.a. Vëndburimi Finiq-Krane	Dorëzim naftë gjendje (ton)	Dorëzim në natyrë PPE (ton)	Dorëzim në natyrë PPA (ton)	Detyrim naftë gjendje (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPE (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPA (ton)	Diferenca naftë gjendje (ton)	Diferenca e PPE (ton)	Diferenca e PPA (ton)	Total diferenca (ton)	
Viti 2015	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	2.040	0.000	0.000	-2.040	-2.040	
Viti 2016	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.168	0.000	0.000	-0.168	-0.168	
Viti 2017	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	2.064	0.000	0.000	-2.064	-2.064	
Viti 2018	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	1.074	0.000	0.000	-1.074	-1.074	
Viti 2019	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	2.634	0.000	0.000	-2.634	-2.634	
Viti 2020	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.740	0.000	-0.740	0.000	-0.740	
Viti 2021	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	6.151	0.000	0.000	-6.151	-6.151	
Janar 2022	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.868	0.000	0.000	-0.868	-0.868	
Shkurt	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.788	0.000	0.000	-0.788	-0.788	
Mars	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.984	0.000	0.000	-0.984	-0.984	
Q1-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	2.640	0.000	0.000	-2.640	-2.640	
Prill	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	1.183	0.000	0.000	-1.183	-1.183	
Maj	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	1.936	0.000	0.000	-1.936	-1.936	
Qershor	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	2.014	0.000	0.000	-2.014	-2.014	
Q2-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	5.133	0.000	0.000	-5.133	-5.133	
Korrik	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	2.368	0.000	0.000	-2.368	-2.368	
Gusht	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	2.960	0.000	0.000	-2.960	-2.960	
Shtator	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	2.666	0.000	0.000	-2.666	-2.666	
Q3-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	7.994	0.000	0.000	-7.994	-7.994	
Tetor	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	2.520	0.000	0.000	-2.520	-2.520	
Nentor	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	2.830	0.000	0.000	-2.830	-2.830	
Dhjetor	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	2.402	0.000	0.000	-2.402	-2.402	
Q4-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	7.752	0.000	0.000	-7.752	-7.752	
Total prej fillimit	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	38.390	0.000	-0.740	-37.650	-38.390	

Detyrimi që shoqëria "F...M" SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. F...E, për periudhën deri më 31.12.2022 është 38.39 (tridhjetë e tetë pikë tridhjetë e nëntë) ton naftë bruto.

Titulli i gjetjes: Kontraktori ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P..., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure.

Situata:

Kontraktori "F...M" SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P..., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria "F...M" SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P... dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. P...Z sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 75.997 (shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) Ton naftë bruto. Shoqëria "Albpetrol" SH.A. nuk e ka tërhequr këtë sasi naftë gjatë vitit 2021.

Për vitin 2022: vërehet se, detyrimi që shoqëria "F...M" SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P... dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. P...Z sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 81.246 (tetëdhjetë e një pikë dyqind e dyzet e gjashtë) Ton naftë bruto. Shoqëria "Albpetrol" SH.A. ka tërhequr për llogari të P..., për vitin 2022, sasinë prej 41.201 (dyzet e një pikë dyqind e një) Ton naftë bruto.

Pra, janë tërhequr rreth 40.045 (dyzet pikë zero dyzet e pesë) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P..., për vitin 2022.

Detyrimi që shoqëria "F...M" SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. Pekishy-Murritz, për periudhën deri më 31.12.2022 është 52.185 (pesëdhjetë e dy pikë njëqind e tetëdhjetë e pesë) ton naftë bruto.

Kriteri: Marrëveshja e hidrokarbureve

Ndikimi/efekti: Mungese e te ardhurave nga kompania Albpetrol për sasinë e naftës bruto e cila nuk është tërhequr për pamundësi depozitimi. **Vlera e sasisë 52.185 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 25,954 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.**

Shkaku: Mos korrektësi e kontraktorit për shlyerjen e detyrimit sipas përcaktimit të marrëveshjes, si dhe pa mundësi e Albpetrol, për magazinimi e sasisë së naftës bruto për llogari të prodhimit para-ekzistues (PPE) dhe të pjesës së Albpetrol (PPA).

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **52.185** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga

data efektive deri me 31.12.2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. **Vlera e sasisë 52.185 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 25,954 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.**

Titulli i gjetjes: *Kontraktori ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure.*

Situata:

Kontraktori “**SH...M**”., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria “**SH...M**”., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2021 është 606.437 (gjashtëqind e gjashtë pikë katërqind e tridhjetë e shtatë) Ton naftë bruto. Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 590.068 (pesëqind e nëntëdhjetë pikë zero gjashtëdhjetë e tetë) Ton naftë bruto. Pra, **janë tërhequr rreth 16.369** (gjashtëmbëdhjetë pikë treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.**

Për vitin 2022 vërehet se, detyrimi që shoqëria SIPL., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2022 është 548.17 (pesëqind e dyzet e tetë pikë shtatëmbëdhjetë) Ton naftë bruto.

Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 567.949 (pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë nëntëqind e dyzet e nëntë) Ton naftë bruto.

Pra, **janë tërhequr rreth 19.779** (nëntëmbëdhjetë pikë shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) Ton naftë bruto **më shumë nga detyrimi për P...., për vitin 2022.**

Detyrimi që shoqëria “SH...M”., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31.12.2022 është 581.683 (pesëqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) ton naftë bruto.

Kriteri: Marrëveshja e hidrokarbureve

Ndikimi/efekti: Mungese e te ardhurave nga kompania Albpetrol për sasinë e naftës bruto e cila nuk është tërhequr për pamundësi depozitimi. **Vlera e sasisë 581.683 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 289,300 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.**

Shkaku: Mos korrektësi e kontraktorit për shlyerjen e detyrimit sipas përcaktimit të marrëveshjes, si dhe pa mundësi e Albpetrol, për magazinimi e sasisë së naftës bruto për llogari të prodhimit para-ekzistues (PPE) dhe të pjesës së Albpetrol (PPA).

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **581.683** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31.12.2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure.

Vlera e sasisë 581.683 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31.12.2022 është 289,300 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sha.

-Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Të dhëna mbi treguesit financiar për periudhën 2021+9-Mujorin 2022, Vendburimi P...Z.

Treguesit	Njesia matese	Viti 2021		9-Mujori 2022	
		Fakt	Program Pune dhe Buxhet	Fakt	Program Pune dhe Buxhet
Numri i puseve prodhues		10	11	15	11
Numri i puseve te rinj					
Numri i puseve qe do konvertohen per injektim polimeri					
Numri i puseve qe do riaktivizohen					
Brent	\$/Bbl				
Cmimi mesatar i shitjes	\$/Bbl	29.30	29.30	42.00	42.00
Prodhimi i pergjithshem	Bbl	6,459.70	2,426.00	7,221.80	1,967.60
Prodhimi i pergjithshem	Ton	944.85	370.80	1,056.32	287.00
Te ardhurat bruto	M\$	189.27	71.08	303.32	82.64
Prodhimi Para-Ekzistues (PPE)	Ton	58.27	57.00	40.71	40.74
Pjesa e Albpetrol (PPA)	Ton	17.73	6.30	20.31	4.92
PPE+PPA	Ton	76.00	63.30	61.02	45.66
PPE+PPA	Bbl	519.59	413.80	417.18	306.00
PPE+PPA ne vlere	M\$	15.22	12.12	17.52	12.85
Te ardhura nga shitja	M\$	280.62	58.96	446.69	69.79
Renta	M\$	28.06	5.90	44.67	6.98
Shpenzime Transporti	M\$				
OPEX	M\$	100.82	22.00	312.97	28.90
G&A	M\$	12.21	26.49	6.14	12.00
OPEX Total	M\$	113.03	48.49	319.10	40.90
Capex	M\$	-	18.00	12.73	9.50
Kosto Totale	M\$	113.03	66.49	331.83	50.40
Te ardhura pas OPEX	M\$	139.53	4.57	82.92	21.91
Cost Recovery	M\$	139.53	- 13.43	70.19	12.41

Tabela 3: Treguesit financiar për periudhën 2021 + 9-Mujor 2022, Vb. P...Z.

➤ Nga tabela vëmë re për vitin 2021, për Vendburimin P...Z:

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria F...K, është 944.85 Ton, shifër kjo e cila është mbi parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 370.8 Ton.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 100.82 M\$ nga 22 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të larta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021.

Shpenzimet Administrative (G...A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qënë 12.21 M\$ shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej nga 26.49 M\$.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 nuk janë kryer Investimet, ndërkohë që në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2021 ishin programuar 18 M\$.

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

➤ Nga tabela vëmë re për 9-Mujorin e vitit 2022, për Vendburimin P...Z:

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria F...K, është 1,056.32 Ton, shifër kjo e cila është mbi parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 287 Ton.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 312.97 M\$ nga 28.9 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të larta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022.

Shpenzimet Administrative (G...A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e vitit 2022, kanë qënë 6.14 M\$ shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej nga 12 M\$.

Investimet Kapitale (CAPEX): Investimet për 9-Mujorin e vitit 2022 kapin vlerën 12.73 M\$ ndërkohë që në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2022 ishin programuar 9.5 M\$.

Cost Recovered: Në 9-Mujorin e vitit 2022, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Të dhëna mbi treguesit financiar për periudhën 2021+9-Mujorin 2022, Vendburimi F...E.

Treguesit	Njesia matëse	Viti 2021		9-Mujori 2022	
		Fakt	Program Punë dhe Buxhet	Fakt	Program Punë dhe Buxhet
Numri i puseve prodhues			8.5	2	9
Numri i puseve të rinj					
Numri i puseve që do konvertohen për injektim polimeri					
Numri i puseve që do raktivizohen					
Brent	S/Bbl				
Cmimi mesatar i shitjes	S/Bbl	27.00	27.00	27.00	40.00
Prodhimi i përgjithshëm	Bbl		12,596.40	556.25	4,715.40
Prodhimi i përgjithshëm	Ton	307.53	1,963.40	89.00	735.00
Te ardhurat bruto	M\$		340.10	15.02	188.62
Pjesa e Albpetroli (PPA)	Ton	6.15	39.20	1.78	14.70
Pjesa e Albpetroli (PPA)	Bbl		251.10	11.13	94.30
Pjesa e Albpetroli (PPA)	M\$		6.79	0.30	3.77
Te ardhura nga shitja	M\$	53.14	333.31	318.67	184.84
Renta	M\$	5.31	33.33	3.19	18.48
Shpenzime Transporti	M\$				0.00
OPEX	M\$	59.70	145.20	9.48	80.91
G&A	M\$	9.59	90.33	4.92	33.50
OPEX Total	M\$	69.29	235.53	14.39	114.41
Capex	M\$	0.00	171.50	0.00	151.00
Kosto Totale	M\$	69.29	407.03	14.39	265.41
Te ardhura pas OPEX	M\$	-21.47	64.45	301.09	51.95
Cost Recovery	M\$	-21.47	-107.05	301.09	-99.05

Tabela 4: Treguesit financiar për periudhën 2021 + 9-Mujor 2022, Vb. F...E.

➤ Nga tabela vëmë re për vitin 2021, për Vendburimin F...E:

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria F...K, është 307.53 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 1,963.4 Ton.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 59.7 M\$ nga 145.2 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë nën parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021.

Shpenzimet Administrative (G...A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qënë 9.59 M\$ shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej nga 90.33 M\$.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 nuk janë kryer Investimet, ndërkohë që në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2021 ishin programuar 171.5 M\$.

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë te ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

➤ Nga tabela vëmë re për 9-Mujorin e vitit 2022, për Vendburimin F...E:

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria F...K, është 89 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 735 Ton.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 9.48 M\$ nga 80.91 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë nën parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022.

Shpenzimet Administrative (G...A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e vitit 2022, kanë qënë 4.92 M\$ shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej nga 33.5 M\$.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022, nuk janë kryer Investimet, ndërkohë që në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2022 ishin programuar 151 M\$.

Cost Recovered: Në 9-Mujorin e vitit 2022, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

➤ Auditet e zhvilluara në Albpetroli bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure

Në bazë të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure”, “Albpetroli do të ketë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj nga marrja e secilës deklarate të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione përsa i përket ndonjë deklarate të tillë të Llogarisë Kosto, me kusht që Albpetroli nuk do të titullohet të kryejë më shumë se dy audite të librave të Llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një Vit Fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakort për cdo rregullim të kërkuar. Dokumenta shtesë dhe llogarie do të bëhen të disponueshme për Albpetrolin gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës së mësipërme prej

dymbëdhjetë (12) muaj Albpetroli nuk ka - këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë do të konsiderohet e aprovuar ”.

Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin P...Z dhe F...E” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:

Nga kontrolli që grupi auditit të Albpetrol sh.a Patos, ka kryer mbi kompaninë “F.....M” Sh.a per periudhen Q1,Q2,Q3 dhe Q4 2020 si dhe pas kërkesave të shumta që u ka derguar përfaqësuesve të kesaj kompanie nëpërmjet postës elektronike dhe verbale, për dërgimin e një CRS-je të detajuar,fatura TVSH-je dhe statement banke, grupit të auditit nuk I është vënë në dispozicion asnjë nga dokumentat e kërkuara.

Për sa më sipër, *shoqëria Albpetrol sh.a Patos, kërkon të procedohet me zbritjen e të gjitha kostove me vlerën 77,977 USD (shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë)* dhe shpenzimeve nga Llogaria Kosto, për vitin 2020, të cilat nuk janë kualifikuar si kosto hidrokarbure në zbatim të të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Finiq-Kranë dhe P...Z”.

➤ **Inventarizimi i asetëve:**

- Shoqëria “Albpetrol” SH.A., me shkresën me Nr. 1044 Prot., datë 03.02.2022, kërkon nga F...K që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2021, për vendburimin F...E dhe P...Z.
- Në mungesë të një përgjigje nga ana e shoqërisë “F...M” SH.A., me shkresën me Nr. 1044/1 Prot., datë 22.04.2022, shoqëria “Albpetrol” Sh.A dërgon një kërkesë të përsëritur.
- Shoqëria “Albpetrol” SH.A., me shkresën me Nr. 1073 Prot., datë 13.02.2023, kërkon nga F...K që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2022, për vendburimin F...E dhe P...Z.

Të dhëna për treguesit e prodhimit dhe treguesit financiarë, për shoqërinë “SH...M”..

Detyrime të prapambetura në naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (“PPE”) dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol (“PPA”), për periudhën deri më 31.12.2022.

Tremujori i Katert, Viti 2022										
Shoqëria "Sherwood International Petroleum" Ltd Vendburimi Kucovë	Dorëzim naftë gjendje (ton)	Dorëzim në natyrë PPE (ton)	Dorëzim në natyrë PPA (ton)	Detyrim naftë gjendje (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPE (ton)	Detyrimi sipas M-H për PPA (ton)	Diferenca naftë gjendje (ton)	Diferenca PPE (ton)	Diferenca PPA (ton)	Total diferenca (ton)
Fundi i vitit 2014	0.000	334.240	0.000	0.000	1436.340	0.930	0.000	-1102.100	-0.930	-1103.030
Viti 2015	0.000	2026.837	0.000	0.000	946.788	17.412	0.000	1080.049	-17.412	1062.637
Viti 2016	0.000	899.763	0.000	0.000	990.734	18.805	0.000	-90.971	-18.805	-109.776
Viti 2017	0.000	1143.062	0.000	0.000	896.453	4.362	0.000	246.609	-4.362	242.246
Viti 2018	0.000	573.300	0.000	0.000	811.145	8.236	0.000	-237.845	-8.236	-246.080
Viti 2019	0.000	787.152	0.000	0.000	733.954	4.381	0.000	53.198	-4.381	48.817
Viti 2020	0.000	188.879	0.000	0.000	664.108	4.678	0.000	-475.229	-4.678	-479.907
Viti 2021	0.000	590.068	0.000	0.000	600.911	5.526	0.000	-10.843	-5.526	-16.369
Janar 2022	0.000	0.000	0.000	0.000	47.416	0.000	0.000	-47.416	0.000	-47.416
Shkurt	0.000	0.000	0.000	0.000	47.022	0.000	0.000	-47.022	0.000	-47.022
Mars	0.000	0.000	0.000	0.000	46.632	0.749	0.000	-46.632	-0.749	-47.381
Q1-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	141.070	0.749	0.000	-141.070	-0.749	-141.819
Prill	0.000	0.000	0.000	0.000	46.245	0.580	0.000	-46.245	-0.580	-46.825
Maj	0.000	0.000	0.000	0.000	45.861	0.451	0.000	-45.861	-0.451	-46.312
Qershor	0.000	0.000	0.000	0.000	45.481	0.422	0.000	-45.481	-0.422	-45.903
Q2-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	137.587	1.453	0.000	-137.587	-1.453	-139.040
Korrik	0.000	185.015	0.000	0.000	45.103	0.341	0.000	139.912	-0.341	139.571
Gusht	0.000	184.590	0.000	0.000	44.730	0.338	0.000	139.860	-0.338	139.522
Shtator	0.000	198.344	0.000	0.000	44.358	0.377	0.000	153.986	-0.377	153.609
Q3-2022	0.000	567.949	0.000	0.000	134.191	1.056	0.000	433.758	-1.056	432.702
Tetor	0.000	0.000	0.000	0.000	43.990	0.439	0.000	-43.990	-0.439	-44.429
Nentor	0.000	0.000	0.000	0.000	43.620	0.351	0.000	-43.620	-0.351	-43.971
Dhjetor	0.000	0.000	0.000	0.000	43.260	0.404	0.000	-43.260	-0.404	-43.664
Q4-2022	0.000	0.000	0.000	0.000	130.870	1.194	0.000	-130.870	-1.194	-132.064
Total prej fillimit	0.000	7111.250	0.000	0.000	7624.151	68.782	0.000	-512.901	-68.782	-581.683

Tabela 1: Detyrime në naftë bruto, për llogari të P....

- **Për vitin 2021:**
 - Nga tabela 1 vëmë re se, detyrimi që shoqëria S...L., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 606.437 Ton naftë bruto.
 - Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 590.068 Ton naftë bruto.
 - Pra, **janë tërhequr rreth 16.369 Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.**

- **Për vitin 2022:**
 - Nga tabela 1 vëmë re se, detyrimi që shoqëria SIPL., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto, për llogari të P.... sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 548.17 Ton naftë bruto.
 - Shoqëria “Albpetrol” SH.A. ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 567.949 Ton naftë bruto.
 - Pra, **janë tërhequr rreth 19.779 Ton naftë bruto më shumë nga detyrimi për P...., për vitin 2022.**

Detyrimi që shoqëria “SH...M”., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31.12.2022 është 581.683 (pesëqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) ton naftë bruto.

-Detyrimet e shoqërisë “SH...M”., për periudhën e objektit të auditimit (2021 – 9-mujori 2022).

Bazuar në sasinë e naftës së patërhequr për llogari të P...., për periudhën objekt auditimi rezulton se:

Viti	Sasia e naftës që "Sherwood International Petroleum" LTD. i detyrohet Albpetrolit (Ton)	Cmimi mesatar i shitjes nga SIPL (\$/bbl)	Cmimi mesatar i shitjes nga SIPL (\$/Ton)	Vlera (USD)
Tremujori i Parë 2021 (Q1-2021)	157.85	47.43	301.70	47,622.80
Tremujori i Dytë 2021 (Q2-2021)	(28.77)	52.01	333.95	(9,607.21)
Tremujori i Tretë 2021 (Q3-2021)	(38.93)	53.65	341.26	(13,285.49)
Tremujori i Katër 2021 (Q4-2021)	(73.78)	59.50	374.84	(27,655.59)
Total Viti 2021	16.37			(2,925.49)
Tremujori i Parë 2022 (Q1-2022)	141.82	-	-	-
Tremujori i Dytë 2022 (Q2-2022)	139.04	-	-	-
Tremujori i Tretë 2022 (Q3-2022)	(432.70)	93.56	586.45	(253,756.87)
9-Mujori i Vitit 2022	(151.84)			(253,756.87)
Ne total 2021+9-Mujori 2022	(135.47)			(256,682.36)

Tabela 2: Detyrimet e prapambetura në naftë bruto, për llogari të P...., për vitin 2021+9-Mujorin 2022.

Shënim: Cmimi i shitjes së naftës është marrë nga Progres Raportet 3-Mujore të dërguar nga shoqëria “SH...M”..

6- Të dhëna mbi treguesit financiar për periudhën 2021+9-Mujorin 2022.

Prodhimet	Niveli	Viti 2021			Q1-2022			Q2-2022			Q3-2022			9-Mujori 2022		
		Pikë	Progresi Përfaqësimi	Realizimi në % (Pikë/PP&M)	Pikë	Progresi Përfaqësimi	Realizimi në % (Pikë/PP&M)	Pikë	Progresi Përfaqësimi	Realizimi në % (Pikë/PP&M)	Pikë	Progresi Përfaqësimi	Realizimi në % (Pikë/PP&M)	Pikë	Progresi Përfaqësimi	Realizimi në % (Pikë/PP&M)
PROFITABILITETI	ROA	10.2	100%	100%	10.2	100%	100%	10.2	100%	100%	10.2	100%	100%	10.2	100%	100%
PROFITABILITETI	ROE	15.5	100%	100%	15.5	100%	100%	15.5	100%	100%	15.5	100%	100%	15.5	100%	100%
PROFITABILITETI	ROIC	12.8	100%	100%	12.8	100%	100%	12.8	100%	100%	12.8	100%	100%	12.8	100%	100%
PROFITABILITETI	ROCE	11.5	100%	100%	11.5	100%	100%	11.5	100%	100%	11.5	100%	100%	11.5	100%	100%
PROFITABILITETI	ROF	9.8	100%	100%	9.8	100%	100%	9.8	100%	100%	9.8	100%	100%	9.8	100%	100%
PROFITABILITETI	ROA	10.2	100%	100%	10.2	100%	100%	10.2	100%	100%	10.2	100%	100%	10.2	100%	100%
PROFITABILITETI	ROE	15.5	100%	100%	15.5	100%	100%	15.5	100%	100%	15.5	100%	100%	15.5	100%	100%
PROFITABILITETI	ROIC	12.8	100%	100%	12.8	100%	100%	12.8	100%	100%	12.8	100%	100%	12.8	100%	100%
PROFITABILITETI	ROCE	11.5	100%	100%	11.5	100%	100%	11.5	100%	100%	11.5	100%	100%	11.5	100%	100%
PROFITABILITETI	ROF	9.8	100%	100%	9.8	100%	100%	9.8	100%	100%	9.8	100%	100%	9.8	100%	100%

Tabela 3: Treguesit financiar për periudhën 2021 + 9-Mujor 2022.

➤ **Nga tabela vëmë re për vitin 2021:**

- **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria SIPL është 7,000 Bbl , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 9,909 Bbl, pra me një mosrealizim prej 29%.
- **Shpenzimet Operative (OPEX)**. Shpenzimet operative kapin vlerën 428 M\$ nga 481 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 53 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 11%.
- **Shpenzimet Administrative (G&A)**: Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qënë 173 M\$ nga 281 M\$ të parashikuara në PP&B 2021 Pra, Shpenzimet Administrative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 38%.
- **Investimet Kapitale (CAPEX)**: Gjatë vitit 2021 janë kryer 88 M\$ Investime nga 322 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021.
- **Cost Recovered**: Në vitin 2021, sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

➤ **Nga tabela vëmë re për 9-Mujorin e vitit 2022:**

- **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria SIPL është 4130.2 Bbl , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 8324 Bbl, pra me një mosrealizim prej 50%.
- **Shpenzimet Operative (OPEX)**. Shpenzimet operative kapin vlerën 351 M\$ nga 407 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 56 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e 9-Mujorit te vitit 2022, me një mosrealizim prej 14%.
- **Shpenzimet Administrative (G&A)**: Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e vitit 2022 kanë qënë 153 M\$ nga 114 M\$ të parashikuara në PP&B 2022 Pra, Shpenzimet Administrative për vitin 2021 janë mbi parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022.
- **Investimet Kapitale (CAPEX)**: Gjatë 9-Mujorit te vitit 2022 janë kryer 83 M\$ Investime nga 309 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2022 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022.
- **Cost Recovered**: Në vitin 2022, sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

➤ **Auditet e zhvilluara në Albpetrol bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure**

Në bazë të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure”, “Albpetroli do të ketë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj nga marrja e secilës deklarate të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione përsa i përket ndonjë deklarate të tillë të Llogarisë Kosto, me kusht që Albpetroli nuk do të titullohet të kryejë më shumë se dy audite të librave të Llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një Vit Fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakortpër cdo rregullim të kërkuar. Dokumenta shtesë dhe llogarie do të bëhen të disponueshme për Albpetrolin gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës së mësipërme prej dymbëdhjetë (12) muaj Albpetroli nuk ka - këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë do të konsiderohet e aprovuar”.

Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim te Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Kucovë” ka kryer auditimin e

raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:

- Verifikimi i shpenzimeve për qiratë e tokave – 84,776 USD
- Verifikimi i shpenzimeve të kryera nga “L...M” dhe “L...X” për çështjet gjyqësore – 164,031.14 USD
- Shoqëritë e shërbimit të sigurisë fizike.

Vlera totale e kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020, për SIPL është 248,807.14 USD.

Llogaritja e Faktorit R: Të dhënat progresive.

	Cumulative Total End of 2020	Total at End of Q4-2021	Cumulative Total to Date 2021	Total at End of Q3-2022	Cumulative Total to Date Q3-2022
Revenue					
Crude Oil Sales	2,632	398	3,030	339	3,369
Less Albpetrol PEP&ASP&AKBN Share & Royalty Tax (10)%	1,918	290	2,208	246	2,454
Contractor's Revenue net of Albpetrol PEP&ASP AKBN Share & Royalty Tax (10%)	714	108	822	93	915
Costs					
Capex	14,603	84	14,687	83	14,770
Opex	7,874	655	8,529	529	9,058
Fixed Assets	96	4	100	0	100
Increase/(Decrease) Material Inventory	1,127	(15)	1,112	(16)	1,096
Increase/(Decrease) Operational Inventory	8	(3)	5	0	5
(Bk) Total Petroleum Costs Before mitigation	23,708	725	24,433	596	25,029
R Factor (Rn)	0.0301		0.0336		0.0366

Tabela 5: Llogaritja e Faktorit R.

Burimi:

- Llogaritja e Faktorit R ne fund te Tremujorit te Katërt 2020, Nr. 3603 Prot., datë 03.06.2021.
- Llogaritja e Faktorit R ne fund te Tremujorit te Katërt 2021, Nr. 3252 Prot., datë 20.04.2022.
- Llogaritja e Faktorit R ne fund te Tremujorit te Tretë 2022, Nr. 245 Prot., datë 11.01.2023.

➤ Inventarizimi i aseteve:

- Shoqëria “Albpetrol” SH.A., me shkresën me Nr. 1049 Prot., datë 03.02.2022, kërkon nga SIPL që të dërgojnë inventarin e matërialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2021, për vendburimin Kucovë.
- Në mungesë të një përgjigje nga ana e shoqërisë S...L., me shkresën me Nr. 1049/1 Prot., datë 22.04.2022, shoqëria “Albpetrol” Sh.A dërgon një kërkesë të përsëritur.
- Shoqëria “Albpetrol” SH.A., me shkresën me Nr. 1072 Prot., datë 13.02.2023, kërkon nga S...L që të dërgojnë inventarin e matërialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2022, për vendburimin Kucovë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

B. Z., F. M, A. H., K. C, dhe E. D në cilësinë e ish Administratorit, për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2022.

-Të tjera

Titulli i Gjetjes 1: Mos zbatimi i detyrave funksionale.

Situata:

Nga auditimi i kryer në marrëdhëniet tregtare me Kontraktorin “B.....A”, u konstatuan shkelje të menaxhimit financiar. Drejtori i Drejtorisë së Financës A.B, me shkresën nr. 8087 prot. datë 19.10.2021 i është drejtuar Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, ku i citon detyrimin total të kontraktorit T...L deri më 30.09.2021, si dhe bashkëlidhur kësaj shkrese janë faturat për të cilat do të kërkohet urdhër ekzekutimi. Drejtoria e Financës në kartelën e detyrimeve ka nisur dhe detyrimet e kontraktorëve të tjerë ku ishte B...M. Nga drejtori i financës është deklaruar se në këtë kartelë ishte e përditësuar vetëm vlera për Kontraktorin T...L.

-Me shkresën Nr. 9401 prot. datë 23.11.2021 “Kërkesë për dokumentacion” të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit drejtuar Drejtorisë së Financës, shprehen se janë marrë të mirëqena detyrimet e paraqitura në kartelën e Drejtorisë së Financës, dhe kërkohen prova shkresore në lidhje me shumën e detyrimit në vlerën 948,890,511 lek nga debitori “B.....A”.

Në shkresë kërkohet një database ku të jenë të listuara faturat me numër dhe datë, për të cilat do të kërkohen librat e blerjes së deklaruara nga shoqëria Albpetrol SHA, pra organeve tatimore. Fatura tatimore shitjeje, të cilat duhet të jenë të nënshkruara rregullisht nga të dyja palët dhe të dorëzohen me procesverbal në origjinal pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, ku do të noterizohen dhe të ridorëzohen pranë Qendrës përkatëse me procesverbal dorëzimi. Ditarin/kartelën financiare/akt rakordimin e klientit, që është mbajtur nga kreditori dhe provon rakordimit midis palëve si dhe masën e detyrimit që përbën titull ekzekutiv. Nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit shprehen se janë informuar për shumën e detyrimit nga debitori shoqëria B.....A ndaj kreditorit shoqëria Albpetrol SHA, deri në fund të periudhës 9 mujore të vitit 2021, si detyrim i pashlyer për zërin “energji elektrike. Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit ka përgatitur kërkesën për lëshimin urdhër ekzekutimi drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Kjo shkresë është konceptuar nga juristja A.LL me detyrën e kryespecialistes dhe nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, R.Ç.

Në përgjigje të kësaj shkrese, drejtori i Drejtorisë së Financës, më datë 23.11.2021 i ka dërguar email specialisteve për nxjerrjen e llogarisë si dhe specialistes së Qendrës së Furnizimit dhe Shpërndarjes së Energjisë për sjelljen e faturave për drejtorinë juridike, duke vënë në dijeni dhe administratorin e shoqërisë. Në emailin e drejtorit të DF, A.B, faturat nuk janë specifikuar me numër rendor dhe serial por është shprehur të vihen në dispozicion sipas bisedës telefonike.

Me shkresën Nr.527, datë 24.11.2021 të Qendra e Furnizimit të Shërbimit të Energjisë, protokolluar në “Albpetrol” me Nr.9512, datë 24.11.2021, Qendra i ka përcjell Drejtorisë së Financës 4 (katër) fatura tatimore shitje me nr. 08, datë 17.02.2021, fatura nr.38, datë 23.03.2021, fatura nr.108 dhe nr.109, datë 17.05.2021, me vlerë totale 405,929,342 lekë të cilat pas ciklimit nga ana e Drejtorisë së Financës duhej që t’i dërgoheshin DÇLP, veprim i cili nuk ka gjurmë që këto fatura janë konfirmuar nga ana e Drejtorisë së Financës në “Albpetrol” sh.a.

Nga specialisti i financës pretendohet se i ka dorëzuar jo në mënyrë shkresore kryespecialistes Angjela Llambro kartelën financiare të kontraktorit ku saldo e debitorit deri në datën 30.09.2021 ishte 327,289,825 lekë, dhe në këtë saldo janë të pasqyruara dhe likuidimet e faturave që janë kërkuar më vonë si titull ekzekutiv.

Me shkresën Nr.10826 prot. datë 31.12.2021, nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku është kërkuar lëshim Urdhër Ekzekutimi për faturat dhe pas lëshimit të Urdhrit të Ekzekutimit, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit i është drejtuar Zyrës së Përmbartimit Privat “E...P” shpk për vënien në ekzekutim të titujve ekzekutiv Fatura Tatimore Shitje.

Midis Zyrës së Përmbartimit “E...P” shpk përfaqësuar nga përmbartuesi gjyqësor z. E. M dhe shoqërisë “Albeprol” sh.a. përfaqësuar nga Administratori z. F. M, është lidhur Kontrata e Shërbimit Nr.1113 prot. datë 04.02.2022 dhe Nr.27 prot. datë 04.02.2022, e cila është likuajduar në datë 09.02.2022 në shumën 14,613,456 lekë.

Nga auditimi i kartelës financiare dhe ditarit të bankës në Drejtorinë e Financës u konstatua se faturat me nr.08, datë 17.02.2021, fatura nr.38, datë 23.03.2021, fatura nr.108 dhe nr.109, datë 17.05.2021 janë likuajduar plotësisht nga kompania “B.....A”.

-Nga Drejtoria e Financës nuk është kthyer përgjigje shkresore nëpërmjet arkivës, shkresës Nr.9401, datë 23.11.2021 “Kërkesë për dokumentacion” të DÇLP, si dhe nuk ka akt rakordimi për detyrimet e ndërsjella me kompaninë “B.....A”, ku të pasqyrohet shuma e detyrimit e dokumentuar me dokumente justifikues.

Shkeljet e konstatuara në menaxhimin financiar janë:

Nëpunësi zbatues, drejtori i Drejtorisë së financës, është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta. Pra inicimi i procesit të mbledhjes së borxheve të paarkëtuara fillon nga nëpunësi autorizues i njësisë, administratori i cili pas informacionit të drejtorit të financës me anë të drejtorisë juridike i dërgon një shkresë zyrtare subjektit debitor ku i kërkon likuidimin e faturave të pa-paguara. Kjo shkresë shërben dhe si akt-rakordimi nëse nuk është bërë më parë. Në se subjekti debitor nuk përgjigjet ose ka pretendime të tjera atëherë administratori vijon me masat gjyqësore si nxjerrja e titullit ekzekutiv etj.

Nëpunësi zbatues, administratori i shoqërisë ka përgjegjësi për ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara si dhe mbikëqyrjen, menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit ka kryer veprime mbështetur në vlerën e saldove totale 948,890,551 lekë, të një shkrese të marrë nga Drejtoria e Financës për një kontraktor tjetër, dhe ka kryer veprime për nxjerrje titulli ekzekutiv pa pasur një aprovim nga kjo drejtori.

Ndërkohë që drejtorit i Drejtorisë së Financës A.B, sipas sektorit të protokollit, kjo shkresë i është dërguar në email sipas praktikave të aprovuara. Emailin e datës 23.11.2021, drejtori i DF A.B, ja ka dërguar specialistes së financës së administratës për nxjerrjen e kartelës financiare të kontraktorit deri më 30.09.2021, si dhe specialistes së Qendrës së Furnizimit dhe Shërbimit Elektrik, për të dërguar faturat që kishin diskutuar në telefon tek DÇLP.

Në shkresën nr. 527 Prot., datë 24.11.2021, drejtori i QFSHE, ka miratuar shkresën e specialistes për faturat dhe i ka dërguar Drejtorisë së Financës kopjet origjinale të faturave për muajt janar, shkurt e prill 2021. Në shkresë është cituar se pas aprovimit nga Drejtoria e Financës, faturat ti përcillen DÇLP. Në observacionin e z. R.Ç kjo shkresë bashkë ciklimin e Drejtorit të Departamentit, dhe citimin se faturat janë origjinale dhe për tu përdorur për procedurat gjyqësore, pretendohet se provojnë se faturat ishin aprovuar nga Drejtoria e Financës dhe se nuk mban përgjegjësi për veprimet e mëtejshme por shkresa e QFSHE i ishte drejtuar Drejtorisë së Financës dhe i kërkonte atyre verifikimin e faturave. Nga Drejtoria e Financës nuk ka pasur aprovim shkresor për faturat e sipërcituara. E pyetur për këtë çështje znj. A.B me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës ka deklaruar se i ka dërguar dorazi Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit kartelën financiare të kompanisë “B.....A”, por nuk i ka dërguar faturat tatimore të shitjes”.

Gjykimi i grupit të auditimit është se Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, drejtori i Drejtorisë së Financës dhe ish-administratori i shoqërisë me veprime ose mosveprime kanë sjellë në dëm ekonomik nga shoqërisë Albeprol sha në vlerën 14,613,456 lekë me TVSh.

Së pari ish drejtori i DÇLP R.Ç dhe kryespecialisti A.LL, kanë kërkuar në shkresën Nr. 9401 prot. datë 23.11.2021, një database ku të jenë të listuara faturat me numër dhe datë, për të cilat do të kërkohen librat e blerjes së deklaruara nga shoqëria, fatura tatimore shitjeje, të cilat duhet të jenë

të nënshkuara rregullisht nga të dyja palët dhe të dorëzohen me procesverbal në origjinal pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, ditarin/kartelën financiare/akt rakordimin e klientit, që është mbajtur nga kreditori dhe provon rakordimit midis palëve si dhe masën e detyrimit që përbën titull ekzekutiv.

Nga këto dokumente të kërkuara Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, ka pasur katër fatura dhe një saldo totale të detyrimit, si dhe nga specialistja e financës i është dorëzuar dhe kartela financiare. Nga shqyrtimi i kartelës financiare konstatohet se katër faturat (nr. 8, 38, 108 e 109) që janë bërë objekt i veprimeve gjyqësore janë likuiduar të gjitha deri më datë 16.07.2021, dhe të regjistruara në sistemin e kontabilitetit të shoqërisë. Z. R.Ç dhe znj. A.LL mund të bënin verifikimet në kartelë se faturat tatimore ishin likuiduar.

Së dyti drejtori i Drejtorisë së Financës, për çështje si likuidimin nga klientët ku është përgjegjës direkt, kërkesës së DÇLP për detyrimet e kontraktorit duhet ti përgjigjej me përgjegjshmëri, qartësi dhe saktësi. Gjendja debitore në një datë të caktuar nuk jep informacion të plotë dhe të saktë por nga kjo drejtori duhet të plotësohej një informacion i qartë shkresor me faturat e palikuiduara shoqëruar me detajet si dhe kamatëvonesat përkatëse të llogaritura.

Drejtori i Drejtorisë së Financës A.B në momentin e pagesës së shumës 14,613,456 lekë me TVSh duhet të bënte verifikimet nëse ekzistonin kushtet për pagesën e tarifës dhe nëse faturat ishin të likuiduara ose të palikuiduara.

Së treti ish administratori në momentet që ka urdhëruar procedurat gjyqësore si dhe ka firmosur në lidhjen e kontratës me përmbaruesin gjyqësor duhet të sigurohej me nëpunësen zbatuese për vërtetësinë e shkresave që firmoste.

Nga shoqëria Albpetrol sha është likuiduar në llogarinë bankare të Zyrës së Përmbarimit “E...P” shpk shuma 14,613,456 lekë me TVSH në datën 09.02.2022, sipas Kontratës së Shërbimit Nr.1113 prot. datë 04.02.2022 dhe Nr.27 prot. datë 04.02.2022, e lidhur midis Zyrës së Përmbarimit “E...P” shpk. dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a.. Ky likuidim është kryer nga Drejtoria e Financës pa u verifikuar shlyerja e faturave tatimore të shitjes për të cilat ka dalë urdhri ekzekutiv dhe është në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12 , pika 3 germa “e” ku citohet: “Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: “pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi”.

Në kushtet e pagesës së kontratës nuk janë përcaktuar pjesë si pagesa pas mbledhjes së detyrimit siç është bërë në kontrata të tjera, por është përcaktuar pagesë vetëm me paraqitjen e faturës tatimore nga ana zyrës përmbarimor.

Kriteri:

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, ***Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues*** Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kadrut ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: a) ***garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të economicitetit, efijencës dhe efektivitetit; g) garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të pa-arkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mbledhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta;***

Sa më sipër është në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të shoqërisë e miratuar me Vendimin Nr.20, datë 03.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës neni 66, germa A, pika 6, ku citohet:

Detyrat funksionale dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Financës, është përgjegjës për garantimin, para miratimit të shkresave/urdrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të economicitetit, efikasitetit dhe analizon realizimin e shpenzimeve operative sipas fondeve të planifikuara., pika 7, siguron menaxhimin e kontabilitetit të kompanisë dhe përgatit përmbledhëse periodike financiare. pika 8, përfaqëson Drejtorinë Ekonomike në marrëdhëniet me institucionet dhe shoqëritë e tjera jashtë Albpetrol sha.

-Ky veprim është në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të shoqërisë e miratuar me Vendimin Nr.20, datë 03.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës neni 53, gërma A, pika 5, ku citohet: “DÇLP bashkëpunon ngushtësisht me të gjitha Drejtoritë, Qendrat e varësisë si dhe sektorët respektivë të shoqërisë për mbarëvajtjen sa më të mirë të të gjitha proceseve gjyqësore”.

Ndikimi/Efekti:

Nga veprime e mosveprimet e ish drejtorit të DÇLP R.Ç dhe kryespecialistët A.LL, drejtorit të DF A.B dhe ish administratorit F. M shoqërisë Albpetrol Sha i është krijuar një dëm ekonomik prej **14,613,456 lekë**.

Shkaku: Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Albpetrol sha, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **14,613,456 lekë**, nga R.Ç, A.LL, A.B dhe F. M.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi R.Ç në cilësinë e ish drejtorit të DÇLP, kryespecialisti A.LL, drejtorit të Drejtorisë Financiare A.B dhe ish administratorit F. M shoqërisë Albpetrol sha.

Nga ana e ish drejtorit Drejtorisë së Çështjeve Ligjore R.Ç janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, sipas një shkrese të administruar në Albpetrol sha pa nr. prot., datë 16.06.2023 dhe në KLSH me nr. 1202/21, prot., datë 19.06.2023.

Pretendimi i subjektit:

Pretendimet e subjektit janë se Drejtoria e Financës ka pasur dijeni dhe i ka aprovuar faturat e vëna në dispozicion nga QFSHE. Për më shumë pretendimet janë sqaruar në pjesën më sipër.

Qëndrimi i Audituesve

Observacioni juaj **nuk merret në konsideratë** pasi nuk keni sjellë asnjë argument shtesë për të justifikuar vazhdimin e procedurave pa aprovim shkresor nga Drejtoria e Financës.

Nga ana e ish kryespecialistët së Drejtorisë së Çështjeve Ligjore, A.LL janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, sipas një shkrese të administruar në Albpetrol sha pa nr. prot., datë 6.06.2023 dhe në KLSH me nr. 1202/16, prot., datë 06.06.2023.

Pretendimi i subjektit

Nga subjekti janë sjellë vetëm prova e fakte që janë shqyrtuar në situatën e gjetjes.

Qëndrimi i Audituesve

Observacioni juaj **nuk merret në konsideratë** pasi nuk janë paraqitur prova ose fakte shtesë.

Nga ana e drejtorit të Drejtorisë së Financës A.B janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me Projekt Raportin e Auditimi, sipas një shkrese të administruar në Albpetrol sha me nr. 11/144 prot., datë 14.06.2023.

Pretendimi i subjektit:

Pretendimi i drejtorit të Drejtorisë së Financës është se kryespecialistët A.LL i është dorëzuar kartela financiare e kontraktorit B.....A, deri më 30.09.2021, me saldo prej 327,289,825 lekë, dhe nga ana e DCLP nuk është kërkuar më asnjë shpjegim për detyrimin.

Drejtoria e Finances, si drejtoria pergjegjese per mbajtjen e anes kontabel te shoqerise, me shkresen Nr 8087prot date 19.10.2021, i ka derguar Drejtorise se Çeshtjeve Ligjore e Perfaqesimit informacion ne lidhje me detyrimin e kontraktorit T...L.

Nga ana e Drejtorise se Çeshtjeve Ligjore e Perfaqesimit, me iniciative te saj, eshte derguar shkresa “ Kerkese per dokumentacion ” e cila mban daten 23.11.2021 me Nr Prot 9401, ne te cilen kerkohen faturat tatimore te shitjes per Kontraktorin B...M ltd me qellim per tju drejtuar Gjykates Fier per leshim Urdher Ekzekutimi.

Nga ana e Drejtorise se Finances kesaj shkrese nuk i eshte kthyer pergjigje zyrtare,por i eshte drejtuar me email QFSHE qe eshte ndermarje ne varesi te Albpetrol sha si dhe K/specialistes se Sektorit te Finances se Kompanise e cila administron Programin Financa 5 dhe ka te azhornuara detyrimet e kontraktorit ne fjale per te dhene informacionin e kerkuar.

Nga ana e QFSHE ne pergjigje te emailit eshte derguar shkresa Nr 527 date 24.11.2021 ku jane derguar Faturat tatimore te shitjes dhe ne shkrese citohet qe keto fatura duhet te konfirmohen nga Drejtoria e Finances nese jane te likuiduara apo jo dhe vetem pas ketij konfirmimi ti percillen Drejtorise Juridike per te ndjekur procedurat ligjore.

Rezultoni se nga ana e Drejtorise se Finances nuk jane cikluar keto fatura te sjella nga QFSHE dhe si rrjedhoje prej nesh nuk eshte dhene konfirmim per dergimin e tyre ne gjykate.

Qëndrimi i Audituesve:

Observacioni i juaj nuk merret në konsideratë pasi ju si nëpunës zbatues në momentin që jeni njoftuar për kërkesën për gjendjen debitore të kontraktorit, duhet të merrnit masa për dërgimin e plotë të kërkesave të bëra në shkresën Nr. 9401 prot. datë 23.11.2021, ku kërkohej: një database ku të jenë të listuara faturat me numër dhe datë, për të cilat do të kërkohej librat e blerjes së deklaruara nga shoqëria, fatura tatimore shitjeje, të cilat duhet të jenë të nënshkruara rregullisht nga të dyja palët dhe të dorëzohen me procesverbal në origjinal pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, ditarin/kartelën financiare/akt rakordimin e klientit, që është mbajtur nga kreditori dhe provon rakordimit midis palëve si dhe masën e detyrimit që përbën titull ekzekutiv.

Titulli i Gjetjes 2: Mos veprime në zbatimet e detyrimeve të koncesionarëve të Marrëveshjeve Hidrokarbure.

Situata:

Gjatë periudhës 2021-2022, kompania B...M nuk ka kryer pagesat për energjinë elektrike. Për këto mospagesa Albpetrol sh.a Patos. ka maturuar penalitete e kamatëvonesa. Gjatë vitit 2022 Albpetrol ka ndërmarrë veprime administrative duke marrë vendime gjykate si tituj ekzekutiv për faturat e papaguara. Gjithashtu është marrë si titull ekzekutiv dhe një faturë penalitetesh për mospagesat e faturave të energjisë elektrike. Llogaritja e kamatëvonesave është kryer sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Llogaritja bazuar në këtë ligj është më e vogël se kamatëvonesa që ka aplikuar O...E për faturat e papaguara nga Albpetrol sh.a Patos. Vlera e kamatëvonesës së aplikuar nga O...E me atë që ka llogaritur Drejtoria Ekonomike e Albpetrol sh.a Patos., përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

O...E sh.a. ka bërë një akt-rakordimi për detyrimet që ka Albpetrol sh.a Patos., për principlin dhe kamatë vonesat.

Ligji Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Neni 19, Përgjegjësitë e ERE-s, citon: “Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ERE ka këto përgjegjësi: a) miraton rregullat e tregut të energjisë elektrike; b) miraton dhe publikon, në përputhje me parimin e transparencës, metodologjitë e llogaritjes së tarifave të transmetimit, shpërndarjes, si dhe metodologjitë e tjera të aplikueshme;”

Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, Miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018, Neni 10, Çmimi i Energjisë Elektrike, 10.1 Në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e energjisë

elektrike, çmimi i energjisë elektrike përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare, apo sipas nivelit të konsumit, i bëhen të ditur Klientit në faturën e konsumit të energjisë elektrike. *11.2 Çdo faturë e energjisë elektrike duhet të përmbajë minimalisht: Të dhënat teknike mbi pikën e lidhjes; Të dhëna identifikuese të Klientit; Data e leximit; Periudha e faturuar; Leximi i matësit dhe konsumi përkatës për periudhën e faturuar; Çmimi për njësi sipas strukturës së tarifave dhe përbërësit e tij; Shuma në lekë që i korrespondon periudhës së faturimit; Shumat e taksave që i korrespondojnë sipas legjislacionit në fuqi; Data limit e pagimit të faturës; Kamatëvonesa e aplikuar për çdo ditë vonesë; Penalitetet e mundshme për pagesë të vonuar; Vlera e detajuar e debisë së Klientit.*

Shoqëria Albpetrol sha duhet të pasqyrojë në marrëdhëniet me shoqëritë koncesionare të gjitha detyrimet që i lindin nga kontratat që ka me Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Albpetrol sha ka kërkuar kamatëvonesa për pagesat me vonesë të B...M në vlerën 175,458,324 lekë, kur detyrimi që Albpetrol ka ndaj FSHU sha, për kontratat përkatëse për kamatëvonesa është 1,356,345,939 lekë.

Kriteri:

Ligji Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Neni 19, Përgjegjësitë e ERE-s. Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, Miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018,

Ndikimi/Efekti:

Vlera 1,180,887,615 lekë përbën shpenzime jo të justifikuara nga Albpetrol sha.

Shkaku: Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Albpetrol sha, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **1,180,887,615 lekë** nga shoqëria B.....A.

Për sa më sipër mban përgjegjësi ish administratori i shoqërisë K. C., administratori E.D dhe drejtori i Drejtorisë Ekonomike A.B.

Nga ana e administratorit të shoqërisë Albpetrol sha E. D janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me aktet e konstatimit, sipas një shkrese të administruar në Albpetrol sha me nr. 11/179 prot., datë 19.06.2023.

Pretendimi i subjektit:

Pretendimi i administratorit është se ka lidhur marrëdhëniet e punës më datë 13.10.2022, dhe grupi i punës me urdhrin nr. 204, datë 21.07.2022 dhe se ka firmosur aktin e rakordimit me FSHU më datë 06.12.2022, si dhe po zbaton aktin e ERRE-s, për çmimin që do të zbatohet.

Qëndrimi i Audituesve

Observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi:

Veprimet që keni paraqitur janë pjesë të detyrës suaj funksionale, por që kanë lidhje me mbledhjen e detyrimit që ka kontraktori, si dhe në zbatim të nenit 8, Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit, të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, është detyra e juaj për: “Titullarë të njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. 4.Në rast mos caktimi të nëpunësit autorizues, përgjegjshmëria menaxheriale dhe përgjegjësitë, sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij ligji, i takojnë titullarit të njësive publike.

Nga ana e drejtorit të Drejtorisë së Financës A.B janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, sipas një shkrese të administruar në Albpetrol sha me nr. 11/144prot., datë 14.06.2023.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me mos paraqitjen e detyrimeve të kamatëvonesave të FSHU, drejtori A.B jep pretendimin se me këta kontraktorë nuk ka pasur kontrata të lidhura si dhe ERE ka miratur çmimin e shitjes më datë 31.03.2023 duke i shtrirë efektet nga 01.01.2022. Drejtori i Drejtorisë së Financës nuk vlerëson faktin që pas firmosje së akt rakordimit me FSHU sha, kamatëvonesën e ka marrë përsipër ta paguajë Albpetrol sha., dhe nga ana tjetër pretendon se duhet të përlllogariten kamatëvonesat sipas ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Qëndrimi i Audituesve:

Observacioni i juaj nuk merret në konsideratë pasi ju si nëpunës zbatues merrni përsipër pagesës së diferencës 1,180,887,615 lekë nga Albpetrol sha duke zvogëluar aktivet e shoqërisë dhe mos kërkimin e kësaj vlere kontraktorit që i përket.

Nga ana e ish administratorit të shoqërisë K. C janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, sipas një shkrese të administruar në Albpetrol sha pa nr. prot., datë dhe në KLSH me nr. 1202/19, prot., datë 19.06.2023.

Pretendimi i subjektit:

Ish administratori pretendon se kontraktori B...S nuk pranonte të lidhte kontratë furnizimi me energji elektrike duke justifikuar mos marrjen e masave përkatëse.

Qëndrimi i Audituesve:

Observacioni i juaj nuk merret në konsideratë pasi nuk keni sjellë argumente ose dokumente ligjore shtesë për sa trajtuar më sipër.

Pika 2.10. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të auditit të brendshëm.

Titulli i gjetjes 1: *Mangësi në vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që cenojnë Shoqërinë.*

Situata:

Nuk është hartuar dhe miratuar plani i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

-Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen, ngritjen dhe zhvillimin profesionale të stafit. Mungojnë programe për trajnimin e stafit, si dhe u konstatuan mangësi në njohjen e ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar

- Nuk është kryer vlerësimi i punës për çdo punonjës dhe ky vlerësim mungon në dosjeve personale të punonjësve.

-Nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik, nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e riskut, regjistri i riskut, gjurma e auditimit, lista e proceseve, si dhe nuk janë përcaktuar persona përgjegjës për monitorimin dhe zvogëlimin e risqeve, duke mos u identifikuar dhe vlerësuar risqet që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit.

-Nuk ka procedura të përcaktuara anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullive.

-Nuk është plotësuar pyetëtori i vetëvlerësimit, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ku të përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi, nevoja për përmirësim, si dhe kjo deklaratë nuk është raportuar në MFE.

-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

-Nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Aktualisht Shoqëria ka faqe zyrtare e cila është e dedikuar për aktivitetin e kërkimit, prodhimit të naftës dhe gazit. Për periudhën nga 03.09.2019, deri më datën 31.12.2020, posta elektronike zyrtare dhe faqja e shoqërisë kanë pasur mungesë të certifikatës së sigurisë, mungesë

rinovimi licencash, duke çuar në pasigurinë e funksionim të sistemit të komunikimit në faqen zyrtare.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, germa “a” dhe “b”, neni 15, pikat 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 18, pika 1, neni 21, pikat 1-3, neni 27, pika 2, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli IV, pika 4.2.8, Kapitulli II, pika 2.5.2, pika 3.2, Kapitulli IV, Shtojca 2, dhe Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe Raportit Përfundimtar vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, germa “a” dhe “b”, neni 15, pikat 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 18, pika 1, neni 21, pikat 1-3, neni 27, pika 2, Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli IV, pika 4.2.8, Kapitulli II, pika 2.5.2, pika 3.2, Kapitulli IV, Shtojca 2, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15.

Ndikimi/efekti:

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, nevojiten aktivitete shtesë për të forcuar kontrollet në raportimin menaxherial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut.

Shkaku:

Mos njohje sa dhe si duhet e dispozitave ligjore që rregullojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Rëndësia: I Lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Shoqëria Albpetrol sh.a Patos të merren masa për të rritur performancën e saj në drejtim të përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit sipas planeve të biznesit, që menaxhmenti i kësaj shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve, por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë dobiprurëse.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Administratori i Shoqërisë të merret të gjitha masat e nevojshme për rinovimin e licencave për faqen zyrtare dhe postën elektronike si dhe pajisjen e tyre me certifikatë sigurie, me qëllim mirëfunksionimin e tyre dhe ruajtjen e të dhënave kofidenciale të vetë institucionit.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë të bëjnë me forcimin e performancës së institucionit që të marrë vendime më të mira ku të ofrohen shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për parandë.

Për të arritur këtë menaxhimi financiar dhe kontrolli synon që menaxhmenti i institucionit të jetë përgjegjës jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë dobiprurëse dhe në interes më të mirë të publikut.

Kjo do të thotë që të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit.

Në drejtim të vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për përdorimin me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të institucionit.

Nëpunësit e Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Në zbatim të nenit 24 dhe nenit 38, të Rregullores së Brendshme të Shoqërisë të miratuar me Vendimin nr. 30, datë 04.12.2019, të Këshillit Mbikëqyrës si dhe duke u bazuar në Urdhrin nr. 22, datë 02.03.2020, protokolluar me nr. 1339 prot., datë 02.03.2020, të Administratorit E.M është miratuar Kodi i Etikës i cili aplikohet dhe zbatohet nga administrata dhe të gjitha qendrat e prodhimit.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga drejtuesi i institucionit duhet të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konfliktin e interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, në lidhje me ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin.

Në funksion të Ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, detyra e nëpunësit zbatues nuk është deleguar, kompetencë të cilën e ka ushtruar Administratori i Shoqërisë duke ushtruar edhe njëkohësisht funksionin e Koordinatorit të Riskut.

-Nga Shoqëria Albpetrol sh.a Patos nuk është hartuar dhe miratuar plani i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, veprime këto në kundërshtim me nenin 8, gërma a, të Ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Kapitulli IV, “Zbatimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Për periudhën objekt auditimi u konstatua se, mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Nuk ka një procedurë transparente për rekrutimin e punonjësve të rinj. Evidentohet në disa raste mungesa e deklarimeve për vende të lira pune në këtë Shoqëri, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

Mbi politikat dhe praktikat e ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore janë përcaktuar detyrat vetëm sipas drejtorive dhe linjat e raportimit, por nuk ka miratuar ndarje detyrash dhe përgjegjësisë në nivel përgjegjës sektorësh dhe specialisti. Nuk ka përshkrime detyrash individuale, e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesa lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës.

Në opinionin e grupit të auditimit organet drejtuese të Shoqërisë duhet të kishin bërë parashikime të detajuara statusore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

Shoqëria nuk ka hartuar dhe miratuar programe specifike për trajnimin e stafit. Punonjësit kanë mangësi të mëdha në trajnime, pasi nuk janë përfshirë në programe trajnimi, si dhe njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin rezultojnë të jenë shumë të dobëta, veprime këto në kundërshtim me Kapitullin III, pika 3.1, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010.

2. Menaxhimi i riskut

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e

mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut. Koordinator i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinator i Riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund të delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës, funksion i cili nuk është i deleguar.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura. Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të silllet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

-Shoqëria nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e kësaj strategjie, veprime këto në kundërshtim të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe Kapitulli II, pika 2.5.2, “Menaxhimi i riskut”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010.

Për periudhën objekt auditimi Shoqëria nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura, veprime këto në kundërshtim të nenit 8, pika b, nenit 27, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

3. Aktivitet e kontrollit

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, përfshirë edhe shitjen e pronës, urdhër-shërbimet, dhe kryerja e pagesës, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa. Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit. Sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare. Të gjithat angazhimet likuidimet financiare nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues sipas periudha të sipërpërmendura.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione. Titullarët e njësive

publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Sipas Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, parashikohet se: Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës. Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuar të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit: Përgatitja e Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës.

Për periudhën objekt auditimi Shoqëria nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar Gjurmët e Auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, veprime këto në kundërshtim të nenit 16, pika 2-3, të Ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe Kapitulli III Procesi i implementimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe pika 3.2 “Cikli i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin”, të Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010.

4. Monitorimi

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura. Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të brendshëm. Procedura nëpërmjet vetëvlerësimit, një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës. Në deklaratë, Nëpunësi Autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar. Qëllimi i kësaj deklarate është për

të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

Për periudhën e audituar nuk është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, veprime këto në kundërshtim të nenit 18, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, si dhe pika 15, të Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”.

Shoqëria nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli, veprime këto në kundërshtim të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Kapitulli V, Shtojca 2 “Pyetësori i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Shoqëria nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave, nuk ka informacion të vazhdueshëm për titullarin për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime këto në kundërshtim të nenit 21, pika 1 dhe pika 3, të Ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe Kapitulli II.

- Nga auditimi u konstatuan mangësi në implementimin e rregullave për menaxhimin dhe kontrollin e brendshëm financiar publik, si vijon:

-Nuk është hartuar dhe miratuar plani i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

-Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen, ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Mungojnë programe për trajnimin e stafit, si dhe u konstatuan mangësi në njohjen e ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

- Nuk është kryer vlerësimi i punës për çdo punonjës dhe ky vlerësim mungon në dosjeve personale të punonjësve.

-Nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik, nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e riskut, regjistri i riskut, gjurma e auditimit, lista e proceseve, si dhe nuk janë përcaktuar persona përgjegjës për monitorimin dhe zvogëlimin e risqeve, duke mos u identifikuar dhe vlerësuar risqet që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit.

-Nuk ka procedura të përcaktuara anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive.

-Nuk është plotësuar pyetësori i vetëvlerësimit, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ku të përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi, nevoja për përmirësim, si dhe kjo deklaratë nuk është raportuar në MFE.

-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

-Nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Aktualisht Shoqëria ka faqe zyrtare e cila është e dedikuar për aktivitetin e kërkimit, prodhimit të naftës dhe gazit. Për periudhën nga 03.09.2019, deri më datën 31.12.2020, posta elektronike zyrtare dhe faqja e shoqërisë kanë pasur mungesë të certifikatës së sigurisë, mungesë rinovimi licencash, duke çuar në pasigurinë e funksionim të sistemit të komunikimit në faqen zyrtare.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, germa “a” dhe “b”, neni 15, pikat 1-4,

neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 18, pika 1, neni 21, pikat 1-3, neni 27, pika 2, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli IV, pika 4.2.8, Kapitulli II, pika 2.5.2, pika 3.2, Kapitulli IV, Shtojca 2, dhe Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe Raportit Përfundimtar vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15.

- **Mbi vlerësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.**

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm në Shoqërinë Albpetrol sh.a Patos funksionon në bazë të nenit 3, gërma “b”, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i cili përcakton detyrimin e shoqërive tregtare me kapital shtetëror, të krijojnë strukturat e auditimit të brendshëm në përbërje të tyre.

Ka pavarësi funksionale në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, të detyrueshme për zbatim në bazë të nenit 8, gërma “a”, si edhe të nenit 10, pika 2, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Si njësi organizative, DAB e kësaj Shoqërie është krijuar në përputhje me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit në sektorin publik”, i ndryshuar, varet dhe raporton përpara Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, i cili është titullari në kuptim të nenit 4/18 të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Punësimi i stafit të DAB-së, kryhet duke respektuar kërkesat e Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 11 të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Rregullores së Brendshme të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë. Emërimet dhe largimet nga detyra të specialistëve të kësaj drejtorie kryhen vetëm me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

Mbi kualifikimet e punonjësve të strukturës së DBA paraqiten si më poshtë:

- 1) A. H me detyrë Kryespecialist Auditit ka përfunduar studimet e larta në degën Ekonomi Financës, i certifikuar si “Audit i Brendshëm në Sektorin Publik” me eksperiencë pune 26 vjeçare nga këto 17 vite si auditues.
- 2) L. M me detyrë Specialist Auditit ka përfunduar studimet e larta në degën Financë Kontabilitet, i certifikuar si “Audit i Brendshëm në Sektorin Publik” me eksperiencë pune 26 vjeçare nga këto 11 vite si auditues.
- 3) A. M me detyrë Specialist Auditit ka përfunduar studimet e larta në degën Inxhinieri, i certifikuar si “Audit i Brendshëm në Sektorin Publik” me eksperiencë pune 33 vjeçare nga këto 3 vite si auditues.
- 4) E. SH me detyrë Specialist Auditit ka përfunduar studimet e larta në degën Drejtësi, i certifikuar si “Audit i Brendshëm në Sektorin Publik” me eksperiencë pune 10 vjeçare nga këto 8 vite si auditues.

Për vitin 2021 janë planifikuar 11 auditime dhe realizuar 15 auditime, më konkretisht:

- 7 auditime përputhshmërie dhe financiar.
- 5 auditime përputhshmërie me kërkesë të Administratorit.
- 1 auditim për zbatimin e rekomandimeve.
- 2 auditime janë në proces.

Nga auditimet e kryera janë lënë 86 rekomandime nga të cilat:

- 25 rekomandime organizative.
- 52 rekomandime për përmirësimin e sistemeve.
- 7 rekomandime për detyrim arkëtimi.
- 2 rekomandime të tjera.

Pika 2.11 e programit. Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi fundit.

Titulli i gjetjes 1: *Albpetrol sha nuk ka zbatuar rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH.*

Situata:

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, drejtuar KLSH, Administratori i Albpetrol sha ka dërguar informacion (Planin e Masave) mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së, brenda afatit 20 ditor.

Në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, nga Albpetrol sha është raportuar me shkrim për zbatimin e rekomandimeve të lëna, brenda 6 muajve nga dërgimi i shkresës së KLSH-së.

Albpetrol sha nuk i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 50 masa organizative, nga të cilat nuk janë zbatuar 8 masa, janë në proces realizimi 8 masa dhe 34 masa nuk janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 10 masa për shpërblim dëmi, në vlerën 346,696,708 lekë, nga të cilat 2 masa janë zbatuar dhe 8 masa nuk janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 22 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat janë në proces realizimi 1 masa, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 18 masa nuk janë zbatuar.

-Është rekomanduar 1 masë Administrative, e cila nuk është zbatuar.

Kriteri: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, nenet 15 germa “j” 30, pika 2.

Ndikimi/efekti: Në arritjen e objektivave dhe politikave të shoqërisë Albpetrol sha.

Shkaku: Albpetrol sha nuk ka vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Shoqëria Albpetrol sha, të marri masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara.

Për sa më sipër është dërguar observacioni me nr. 11/179 prot., datë 19.06.2023 nga E. D. nga ana e të cilit pretendohet se:

Pretendimi i subjektit:

Ju risjell në vëmendje se unë kam filluar ushtrimin e detyrës...Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit...duke kundërshtuar pretendimet dhe gjetjet në to...

Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH-së:

Lidhur me pretendimin tuaj, ju sqarojmë se nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi konstatohet se mungojnë rregulla të shkruara dhe kriteret për zhvillimin dhe administrimit e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe rregulla lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

-Mbi politikat dhe praktiket e ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë janë përcaktuar detyrat vetëm sipas drejtorive dhe linjat e raportimit, por nuk janë miratuar ndarje detyrash dhe përgjegjësish në nivel përgjegjës sektorësh dhe specialisti. Nuk ka përshkrime detyrash individuale, duke sjellë mosnjohjen e tyre dhe përgjegjësiive individuale për secilin punonjës, e si rezultat edhe pamundësinë e matjes së nivelit të përmbushjes së detyrave nga drejtimi i shoqërisë për punonjësit.

Mungesat e mësipërme nuk evidentojnë ngarkesën konkrete me punë të secilit punonjës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9, Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, “Politikat dhe Praktikrat që lidhen me Burimet Njerëzore, Kapitulli II. (Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 211-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese të Albpetrol ShA të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë.

Qëndrimi i Albpetrol sha për Rekomandimin e mësipërm:

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, me afat deri me datë 15.07.2022, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi znj. F.A, me detyrë ish Drejtoreshë dhe z. A.C me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore në shoqërinë Albpetrol sha.

Rekomandimi nuk është zbatuar

1.2. Rekomandim: Në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë hartimi i detyrave dhe përgjegjësi të shtrihet për të gjithë punonjësit dhe jo vetëm në nivel drejtorie, në mënyrë që secili punonjës të ketë të qartë detyrën funksionale dhe përgjegjësi sipas pozicionit të punës.

Deri më 31.07.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, me afat deri me datë 15.07.2022, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi znj. F.A, me detyrë ish Drejtoreshë dhe z. A.C me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore në shoqërinë Albpetrol sha.

Rekomandimi nuk është zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan mangësi në implementimin e rregullave për menaxhimin dhe kontrollin e brendshëm financiar publik, si vijon:

-Nuk është hartuar dhe miratuar plani i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

-Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen, ngritjen dhe zhvillimin profesionale të stafit. Mungojnë programe për trajnimin e stafit, si dhe u konstatuan mangësi në njohjen e ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

- Nuk është kryer vlerësimi i punës për çdo punonjës dhe ky vlerësim mungon në dosjeve personale të punonjësve.

-Nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik, nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e riskut, regjistri i riskut, gjurma e auditimit, lista e proceseve, si dhe nuk janë përcaktuar persona përgjegjës për monitorimin dhe zvogëlimin e rrisqeve, duke mos u identifikuar dhe vlerësuar risqet që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit.

-Nuk ka procedura të përcaktuara anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullive.

-Nuk është plotësuar pyetësi i vetëvlerësimit, deklaratat dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ku të përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi, nevoja për përmirësim, si dhe kjo deklaratë nuk është raportuar në MFE.

-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

-Nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Aktualisht Shoqëria ka faqe zyrtare e cila është e dedikuar për aktivitetin e kërkimit,

prodhimin të naftës dhe gazit. Për periudhën nga 03.09.2019, deri më datën 31.12.2020, posta elektronike zyrtare dhe faqja e shoqërisë kanë pasur mundësi të certifikatës së sigurisë, mundësi rinovimi licencash, duke çuar në pasigurinë e funksionit të sistemit të komunikimit në faqen zyrtare.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, germa “a” dhe “b”, neni 15, pikat 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 18, pika 1, neni 21, pikat 1-3, neni 27, pika 2, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli IV, pika 4.2.8, Kapitulli II, pika 2.5.2, pika 3.2, Kapitulli IV, Shtojca 2, dhe Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe Raportit Përfundimtar vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15.

2.1. Rekomandim: Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik, të hartohet strategjia e riskut, regjistri i riskut, gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës dhe lista e proceseve.

Të përcaktohen procedurat anti-korrupsion, rregulla të shkruara për sinjalizimin e parregullsive, si dhe të hartohen programe trajnimi për punonjësit.

Në fund të çdo viti të plotësohet pyetësi i vetëvlerësimit, si dhe deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ku të përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi, nevojat për përmirësim, si dhe kjo deklaratë të raportohet në MFE.

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi znj. A. DH, Y.S dhe z. H.GJ me detyrë Drejtor Kabineti në shoqërinë Albpetrol sha.

Rekomandimi nuk është zbatuar

2.2. Rekomandim: Nga Administratori i shoqërisë të merret të gjitha masat e nevojshme për rinovimin e licencave për faqen zyrtare dhe postën elektronike si dhe pajisjen e tyre me certifikatë sigurie, me qëllim mirëfunksionimin e tyre dhe ruajtjen e të dhënave kofidenciale të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Drejtoria e Menaxhimit të Sistemeve Informatike dhe Drejtoria e Prokurimeve Publike. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi znj. L. B ish Drejtoreshë, z. TH. D me detyrë Drejtor aktual i Menaxhimit të Sistemeve Informatike dhe z. F. S me detyrë Drejtor i Prokurimeve Publike në shoqërinë Albpetrol sha

Rekomandimi nuk është zbatuar

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për të gjithë tremujoret prodhimi i përgjithshëm i deklaruar nga kompania është realizuar ose tejkaluar. Përsa i përket të ardhurave diferencat që krijohen duke krahasuar sasinë të naftës bruto të prodhuara (fakti) me programin e punës dhe buxhetin edhe pse prodhimi është më i lartë, ka ndikuar çmimi i bursës së naftës e cila ka pësuar rënie me rreth 23%. Kontraktori ka realizuar mesatarisht rreth 76% të treguesve të programuar. Gjithashtu, për shkak të çmimit të ulët të shitjes ka ndikuar edhe në vlerat e ulëta si: PEP,ASP, Te Ardhura Nga Shitja dhe Renta Minerare. Shpenzimet Operative (OPEX) për të tre tremujoret kanë qene nen buxhetin e parashikuar. Realizimi i (OPEX) për të gjithë tremujoret është realizuar mesatarisht në masën 83% kundrejt shifrave të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetit të vitit 2019 dhe 2020. Realizimi i G&A për të gjithë tremujoret është realizuar mesatarisht në masën 86% kundrejt shifrave të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetit të vitit 2019 dhe 2020. Realizimi i shpenzimeve kapitale (Capex) për të gjithë tremujoret është realizuar mesatarisht në masën 63% kundrejt shifrave të parashikuara në programin e punës dhe buxhetit të

vitit 2019 dhe 2020. Shumë nga projektet kapitale janë ndjeshëm nën parashikimin e bërë në buxhet për shkak të vonësive, por në fokus ka qene gjithashtu edhe përdorimi i pajisjeve të përdorura për të kompletuar pjesë të projekteve, atje ku është e mundur, në vend që të bliheshin pajisje të reja. Realizimi i Capex për Projektin Termal për të gjithë tremujoret është realizuar mesatarisht në masën 24%.

Gjithashtu theksojmë se Capex për Projektin Termal nuk futet në kostot e rikuperueshme nëse nuk del projekt me fitim. Programi i punës dhe buxheti i vitit 2019 është miratuar nga ana e Albpetrol dhe AKBN. Programi i punës dhe buxheti i vitit 2020 u miratua nga ana e Albpetrol me propozimet e parashtruara nga anëtarët e KTSH.

3.1.Rekomandim: Administratori në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol ShA, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbur të kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makinerive e pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol ShA.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, nga Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure kryhet monitorim i përditshëm mbi aktivitetin hidrokarbur që zhvillojnë koncensionaret, janë të pasqyruara në raportet e përditshëm.

Rekomandimi është realizuar

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se praktika e ndjekur nga Albpetrol ShA, nuk jep informacion të plotë dhe gjithashtu siguri, për ekzistencën dhe gjendjen e aseteve të dhëna në përdorim. Me shkresën nr. 1369, datë 04.12.2019 “Inspektim i inventarëve të fund vitit 2019” dhe shkresën nr. 1124, datë 16.12.2020 “Inspektim i inventarëve të fund vitit 2020”, subjekti B..... ka njoftuar Albpetrol sha për fillimin e procesit të inventarizimit, si pjesë të detyrimeve të marrëveshjes. Nga Albpetrol ShA, për të dy rastet nuk u vendos në dispozicion asnjë dokument shkresor mbi përgjigjen e kthyer për kontraktorin.

Strukturat drejtuese të Albpetrol ShA me anë të mosveprimit të tyre kanë lenë në mungesë monitorimi gjendjen e aseteve të dhëna në përdorim, blerjen e aseteve të reja nga kontraktori si dhe ecurinë e jetëgjatësisë së tyre.

Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me pika 2.4.2 e Marrëveshjes Hidrokarbure “Në intervale të arsyeshme, të paktën çdo vit, do të bëhen nga kontraktori inventarë për të gjithë materialet e kontrollueshëm dhe në vijim të çdo inventari, do të rregullohen librat e llogarive dhe regjistrimet për të reflektuar rezultatet e inventarit. Kontraktori do të njoftojë me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve për qëllim të inventarëve të tillë për të lejuar Albpetrol sha për të zgjedhur nëse do të përfaqësohet ose jo kur të kryhet inventari.

Kjo situatë është konstatuar me të gjithë kontraktorët e marrëveshjeve hidrokarbure. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA, të marrë masa që në çdo proces inventarizimi që kruhet nga kontraktorët e marrëveshjeve hidrokarbure, të dërgojë përfaqësues të institucionit, të cilët të evidentojnë ekzistencën dhe gjendjen e aseteve të dhëna në përdorim nga Albpetrol ShA.

Në vijimësi

Nga ana e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure janë dërguar shkresat përkatëse për njoftimin se do dërgoj përfaqësues të shoqërisë personat përgjegjës për këtë proces janë punonjësit e ngarkuar monitorimin e kontraktorve.

Rekomandimi është realizuar

5.Gjetje nga auditimi: Bazuar në nenin 25 “Auditet” të marrëveshjes hidrokarbure, Albpetrol ShA ka zhvilluar procesin e auditimit të “T...S” ShA. Në përfundim të procesit kanë nënshkruar akt-

marrëveshje midis palëve, datë 10.04.2019 me nr. 3188 prot., për shtyrjen e afatit të auditimit të dorëzimit të listës së pretendimeve në datat 07.10.2018 me nr. 3188/4. Bazuar në këto shkresa, i është kërkuar kontraktorit zbritja nga kostot hidrokarbure dhe rillogaritje e Faktorit R.

Për periudhën janar-dhjetor 2017, kontraktori ka përfshirë në kostot hidrokarbure shpenzime në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën 90,683 \$, vlerë e cila duhet të zbritet nga kjo llogari, duke rishikuar koeficientin R.

Në bazë të kësaj shkrese, “T...S” ShA duhet të reflektoj shumën prej 788,415,000 lekë në kredi të të ardhurave të shoqërisë dhe shumën 32,365,000 leke ta reflektoje si kosto hidrokarbure.

Ndryshimet duhet t’i paraqesë në raportet 3-mujore dhe të rillogaris Faktorin – R.

Për periudhën janar-dhjetor 2018, kontraktori ka përfshirë në kostot hidrokarbure shpenzime në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën 211,709 \$, vlerë e cila duhet të zbritet nga kjo llogari, duke rishikuar koeficientin R.

Në bazë të kësaj shkrese, “T...S” ShA duhet të reflektoj shumën prej 88,867,779 leke në kredi të të ardhurave të shoqërisë ose t’i zbresë nga kostot hidrokarbure.

Ndryshimet duhet t’i paraqesë në raportet 3-mujore dhe të rillogaris Faktorin – R.

Sa më sipër trajtuar, rezulton se kontraktori ka përfshirë në kostot hidrokarbure shpenzime në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure, për periudhën janar – dhjetor 2017 dhe janar – dhjetor 2018 në vlerën 302,392 USD. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandim: Albpetrol ShA duhet t’i kërkojnë kontraktorit “T...S” ShA zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure, rillogaritje të koeficientit R dhe njohjen e detyrimit për pjesën takuese të Albpetrol ShA.

Menjëherë

Qëndrimi i subjektit: Sipas praktikave me të mira ndërkombëtare, Albpetrol sha dhe kontraktori ulen bashkërisht në një takim pajtues për të diskutuar mbi pretendimet e ngritura nga Albpetrol sha mbi mosnjohjen e kostove hidrokarbure si të zbritshme. Gjatë takimit kontraktori shpreh observacionet e tij. Vlerat në listën

Rekomandimi është në proces

6.Gjetje nga auditimi: Sipas relacionit mbi operacionet hidrokarbure dhe mbi monitorimin e programit të punës dhe buxhetit të vitit 2019 dhe 2020 të Drejtorisë së Marrëveshjes Hidrokarbure, të datë 25.11.2019 me nr. prot. 10688, është monitoruar vendburimi Visokë në administrimin e kompanisë kontraktore “T...S” ShA, duke i kërkuar kontraktorit marrjen e masave të menjëhershme për zhvillimin e vendburimit. Inspektimi është kryer me datë 19.11.2019 nga grupi i punës i përbërë nga pesë specialistë.

Nga inspektimi i bërë nga specialistët në vendburimin e naftës Visokë, konstatohet se fluidi i prodhuar nga fusha grumbullohet në grupe dhe prej andej transportohet me autobot ose pompohet për në dekantim. Në grupe ka ndotje të mjedisit si pasojë e shkarkimit të H₂O teknologjik dhe rrjedhje të naftës gjatë mbushjes së autoboteve të transportit të ujit dhe naftës. Është konstatuar se ka ujë teknologjik dhe mbetje hidrokarbure në mjedis dhe prej andej këto shpërndahen në kanalet përreth. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me marrëveshjet hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Visokë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA, Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, për rastin konkret dhe në vazhdimësi t’i kërkojnë shoqërisë “T...S” Sha të marrë masa të menjëhershme për:

- Të mos lejuar shkarkimin në ambientet të H₂O të lirë.
- Ngritjen e argjaturës mbrojtëse në grupe për të siguruar derdhjet e mundshme në rast të çarjes së ndonjë depoje, për të mos shkaktuar ndotje mjedisore.
- Eliminimin e ndotjeve të vjetra në puse dhe në afërsi të grupeve.
- Të pastrohen dhe sistemohen sheshet e grupeve të puseve.

Menjëherë

Nga ana e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure janë dërguar shkresat përkatëse për problematikat e konstatuara, gjithashtu është njoftuar edhe AKBN mbi këto problematika. Nga ana e Konkensionarit është kthyer përgjigje i cili nuk pranon problematikat e konstatuara. Rekomandimi do të konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga kontraktorët raportet mujore dhe progres-raportet tremujore dërgohen me vonesë përtej afateve në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure, duke penguar kështu dhënien e informacionit në kohë të aktivitetit të kontraktorit të Albpetrol sha, gjë që ndikon në realizimin e objektivave.

-Në nenin 4.3 aneksi (B) i marrëveshjes hidrokarbure Ballsh-Hekal, parashikohet që “Pas fillimit të prodhimit kontraktori brenda 30 ditësh pas përfundimit të secilit 3-mujor do ti dorëzojë Albpetrol ShA një raport prodhimi ku të tregohet sasia e naftës për zonën e zhvillimit dhe prodhimit e shprehur në Ton, m³ dhe barrelë”. Kanë rezultuar se janë dërguar me vonesë: Progres-Raporti Q3 2019, Progres-Raporti Q2 2020 i kontraktorit A...L & G...Z për vendburimet Ballsh-Hekal.

- Bazuar në kontratën e lidhur midis Albpetrol ShA dhe A...L për shitje gazi nga Albpetrol ShA kontraktorit, në nenin 4 pika 4.2, citohet: “Blerësi në momentin e lidhjes së kontratës duhet të paguajë në Albpetrol shumën 20% të vlerës së kontratës së lidhur, shumë e cila lirohet në fund të afatit të kontratës “. Nga auditimi u konstatua se nuk ekziston dokument për derdhjen e kësaj shumë nga kontraktori A...L për llogari të Albpetrol ShA.

- Neni 4.3 aneksi B i marrëveshjes hidrokarbure P...Z, F...E, parashikohet që “Pas fillimit të prodhimit kontraktori brenda 30 ditësh pas përfundimit të secilit 3-mujor do ti dorëzojë Albpetrol një raport prodhimi ku të tregohet sasia e naftës për zonën e Zhvillimit dhe Prodhimit e shprehur në Ton, m³ dhe barrelë”. Kanë rezultuar se janë dërguar me vonesë: Progres-Raporti Q3 2019, Progres-Raporti Q2 2020 i kontraktorit F...M për vendburimet P...Z-Rras dhe F...E. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandim: Administratori i shoqërisë Albpetrol ShA dhe Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure të marrin masa që kontraktorët të respektojnë afatin e dorëzimit sipas marrëveshjes të raporteve mujore dhe 3-mujore. Në çdo rast të zbatohet çdo nen të kontratave të lidhura dhe ti kushtojë vëmendje të veçantë derdhjes së shumave si paradhënie nga kontraktorët.

Në vijimësi

Nga ana e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure janë dërguar shkresat përkatëse në mënyrë të vazhdueshme për dërgimin e progres raporteve 3 mujore të përcaktuara në marrëveshjet hidrokarbure. Nga ana e Konkensionarve progres raportet sillen jo si pas afateve të përcaktuara.

Rekomandimi është në proces

8.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e dhënies së tre vendburimeve Amonicë, Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul u konstatua se është ngritur grupi i punës, i cili duhet “Të përgatisë Draftin e Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe t’ia paraqesë Administratorit për miratim. Të vlerësojë aplikimet e mundshme bazuar në kapacitetin teknik, financiar si dhe termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjes hidrokarbure dhe t’ia paraqesë Administratorit për miratim”.

Me shkresën nr. 1422/1, datë 26.02.2018 “Dërgojmë për miratim Draft – Formularin e aplikimit për vendburimet ekzistuese “Gorisht - Kocul”, “Cakran – Mollaj”, “Amonicë”” i Kryetarit të Grupit të Punës z. B. L, drejtuar Administratorit ku dërgon për miratim Draft – Formularin e procedurës. Administratori ka miratuar Draft – Formularin në datë 26.02.2018.

Nga Albpetrol ShA nuk u vendos asnjë dokumentacion tjetër të përgatitur nga grupi i punës, në kundërshtim me urdhrin e brendshëm nr. 12, datë 15.02.2018 (Nr. 1422 prot., datë 15.02.2018) “Për ngritjen e Grupit të Punës për zbatimin e Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 150, datë 15.02.2018”.

Me shkresën nr. 2990, datë 03.04.2018 “Përcjellim dosjet e aplikimit nga subjektet e interesuara për lidhjen e Marrëveshjes Hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Cakran - Mollaj”. “Gorisht

- Kocul”, “Amonicë” e Administratorit z. K. B, vendim i cili është në kundërshtim me pikë 2 të “Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure, Liçencë Marrëveshjes si dhe Afatet Përkatëse” të urdhrit nr. 246, datë 12.03.2018 për miratimin e rregullores së mësipërme, ku thuhet:

“Në rast se ka më shumë se një aplikim për një bllok ose vendburim të lire, AKBN ose Albpetrol sipas rastit, përcjellin në Ministri dokumentacionin e shoqërive aplikuese dhe vlerësimin e tyre bazuar në kapacitetin teknik, financiar si dhe termat dhe kushtet kryesore të marrëveshjes hidrokarbure. Mbi këtë dokumentacion të paraqitur, Ministria bën vlerësimin e saj për këtë shoqëri” Nga auditimi konstatohet se nga MEI dhe Albpetrol Sha nuk janë hartuar dhe miratuar specifikime ekonomike, teknike e objektive që duhet të plotësojnë operatorët pjesëmarrës në procedurë (kriteret bazë të nevojshme). Grupi i punës në asnjë rast nuk ka shprehur një gjykim apo vlerësim mbi kriteret objektive por thjesht janë shprehur që mendojnë ose gjykojnë por jo vlerësim objektiv mbi zëra specifik se çfarë nuk plotësojnë operatorët. (Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandim: Albpetrol Sha në bashkëpunim me MIE të marrin masa që të hartohet një rregullore e qartë mbi procedurat e dhënies së marrëveshjeve hidrokarbure, ku të përcaktohen kriteret e domosdoshme ekonomik, teknik e të tjera, që duhet të plotësojnë operatorët pjesëmarrës dhe këto kriteret të jenë baza për vlerësimin dhe shpalljen e fituesit.

Menjëherë

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Administratori i shoqërisë Albpetrol sha për tju drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë mbi zgjidhjen e kësaj problematike. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi z. K. C. me detyrë ish Administrator dhe E. D. me detyrë Administrator aktual.

Rekomandimi nuk është zbatuar

9.Gjetje nga auditimi: Programi i zhvillimit ekonomik të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për vitin 2019 është miratuar me vendimin nr. 328 datë 14.01.2019 të Ministrit Infrastrukturës dhe Energjisë. Procesi i ristrukturimit si një proces i rëndësishëm, i gjatë dhe tepër kompleks ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019, me synim përmirësimin e treguesve ekonomikë dhe financiar, zhvillimin e aktivitetit hidrokarbur dhe veprimtarisë brenda standardeve ligjore. Për vitin 2019 ka pasur një rishikim dhe ndryshim të programit ekonomik. Ky ndryshim është miratuar me vendimin nr. 6252/1, datë 15.07.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Edhe pse programi ekonomik u rishikua dhe u ndryshua duke parë ecurinë e shoqërisë për periudhën janar-maj 2019, përsëri në fund të vitit disa nga zërat kryesorë kanë qenë mjaft të ndryshme nga ato të parashikuara.

Këto ndryshime janë paraqitur në mënyrë më të detajuar si më poshtë:

Është parashikuar prodhimi i 83,291 ton naftë dhe realizimi faktik është 75,415 ton ose 90.5% e programit (7,876 ton naftë më pak).

Detyrimet e pashlyera të naftës nga kontraktorët në fund të vitit 2019 janë rritur me rreth 12,255.6 ton (60,397.57 ton me 31 dhjetor 2018). Kjo tregon për punën e dobët që është bërë gjatë vitit 2019 në drejtim të vjeljes së këtyre detyrimeve.

Investimet për vitin 2019 janë realizuar në vlerën 187,562 mijë lekë nga 602,540 mijë lekë të programuar ose 31 %. Duke qenë një aspekt i rëndësishëm për shoqërinë mosrealizimi i tyre ka dhënë efekt edhe në mosrealizimin e prodhimit të naftës dhe gjithë treguesit ekonomikë e financiar të shoqërisë për këtë periudhë. Megjithatë nga ana e shoqërisë ky mosrealizim lidhet më së shumti se shumë investime janë në proces dhe do të përfundojnë në vitin 2020 duket qartë mos planifikimi i saktë i nivelit të investimeve dhe një fryrje e vlerave nga strukturat e shoqërisë. Të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin 2019 prej 4,229,110 mijë lekë krahasuar me ato të programuara, janë realizuar 76.4 % ose me një mosrealizim me rreth 1,302,784 mijë lekë. Faktorët që kanë ndikuar në uljen e të ardhurave nga shitja e naftës dhe gazit dhe mosrealizimin e tyre janë:

- 5) Mosrealizimi i prodhimit të naftës nga vetë shoqëria Albpetrol ShA prej 7,876 ton
- 6) Mosrealizimi i prodhimit të gazit nga vetë shoqëria Albpetrol ShA me 294 mijë N/m³.
- 7) Mos realizimi i detyrimeve të gazit nga MH për vitin 2019, prej 2336.127 mijë N/m³
- 8) Mos realizimi i shitjeve të naftës (sasi) , prej 44,864 ton
- 9) Mos realizimi i çmimit mesatar të shitjes së naftës me një diferencë me çamin e miratuar prej 706 lekë/ton.

Kjo përqindje realizimi tregon performancën e dobët të shoqërisë dhe në veçanti drejtorja e shitjeve e cila nuk ka mundur të arrij pritshmëritë e shoqërisë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 51-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa konkrete për kryerjen e investimeve në sektorët strategjik të Shoqërisë me qëllim maksimizimin e prodhimit të naftës si burimi i saj kryesor i të ardhurave dhe uljen e kostove për nxjerrjen e saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e institucionit të bëjnë dhe një analizë të thelluar për arsyet e mos realizimit të zërave kryesor të programuara në fillim viti.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi nga Drejtoria Teknike, Drejtoria Organizative dhe Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi z. A.P, A.B dhe znj. A. H..

Rekomandimi nuk është zbatuar

10.Gjetje nga auditimi: Programi ekonomik-financiar për vitin 2020 është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.1, date 03.02.2020 dhe me Vendimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.1043/3, date 24.02.2020. Në këto kushte është konstatuar se për parashikimin e programit ekonomik-financiar për vitin 2020 është vepruar në kundërshtim me pikën 2 të kapitullit III të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, ku citohet se drejtoritë e shoqërive ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projekt programet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacionin shpjegues pranë këshillave mbikëqyrëse, brenda datës 1 dhjetor të çdo viti. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 51-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë Albpetrol ShA në të ardhmen të merren masa që programi ekonomik-financiar ti dërgohet për shqyrtim dhe miratim organeve kompetente në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në vijimësi

Nga Shoqëria Albpetrol sha janë marrë masat përkatëse duke dërguar për shqyrtim dhe miratim organeve kompetente i cili është Këshilli Mbikëqyrës. Rekomandimi konsiderohet i realizuar.

Rekomandimi është realizuar

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2019 investimet u realizuan në vlerën 187,562 mijë lekë nga 602,540 mijë lekë të parashikuara, ose në masën 31%. Në vitin 2020 përsëri ka një parashikim prej 792,051 mijë lekë (edhe më shumë se parashikimi i vitit paraardhës), e cila tregon për një parashikimin jo saktë dhe jo të studiuar për këtë zë. E njëjta gjë ndodh dhe me zërin e sasisë së naftës së shitur ku në vitin 2019 realizimi është 84,182 ton nga 129,046 ton të parashikuar, ndërsa në vitin 2020 përsëri është parashikuar vlera 122,438 ton duke mos u bazuar dhe analizuar problematikën e vitit paraardhës.

Shpenzimi për shërbime konsulence gjatë vitit 2019 është parashikuar në vlerën 25,500 mijë lekë, shërbim i cili nuk është kryer deri me 31.12.2019, por në programin ekonomik të vitit 2020 ky zë shpenzimi është parashikuar sërish dhe në vlerë edhe më të madhe nga viti paraardhës. Ky shpenzim është parashikuar në vlerën 80,000 mijë lekë.

Nga shoqëria Albpetrol nuk disponohet asnjë dokument ku të justifikohet kjo vlerë e parashikuar duke qenë se nuk ka as kontrata të mëparshme, as kontrata të ngjashme me të. Të gjitha këto parashikime të pabazuara në një analizë të detajuar tregojnë për një mungesë bashkëpunimi mes drejtorive kryesore të shoqërisë, çka kanë sjellë dhe këto diferenca në zërat kryesor të planifikuara dhe të realizuara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 51-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe të gjitha drejtoritë që marrin pjesë në hartimin e programit ekonomik financiar, në të ardhmen të merren masa, për kryerjen e parashikimeve realiste, të studiuara dhe të arritshme për zërat kryesorë të shoqërisë, duke u bazuar në rezultatet e vitit paraardhës.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është realizuar

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nga shoqëria Albpetrol ShA nuk janë respektuar afatet ligjore për përfundimin e hartimit të pasqyrave financiare.

Hartimi i pasqyrave financiare për periudhën 2019 është përfunduar më datë 4.12.2020, duke tejkaluar afatin ligjor, i cili është 31 mars i periudhës pasardhëse. Me vendimin nr. 26, datë 24.12.2020, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar pasqyrat financiare të shoqërisë dhe me vendimin nr. 653/1 datë 18.03.2021, asambleja e ortakëve ka miratuar rezultatin e ushtrimit në vlerën 8,911,000 lekë për humbjen e periudhave të mëparshme.

-Depozitimi në sistemin tatimor është kryer jashtë afatit ligjor në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 29 “Deklarimi tatimor” dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit.

-Aprovimi është kryer jashtë afatit të caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1.

-Depozitimi në regjistrin e QKB, është kryer jashtë afateve ligjore në kundërshtim me nenin 43, 46 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar.

Vonesat në hartimin, aprovimin dhe depozitimin kanë pasoja në vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike si dhe për vendim-marrjet e palëve të interesuara. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Nëpunësi Zbatues të merren masa që në të ardhmen pasqyrat financiare të hartohen, të aprovohen dhe të depozitohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë e vlerësimin e performancës ekonomike, në interes të vendim-marrjeve që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredi dhënie etj.

Në vijimësi

Nga Nëpunësi Zbatues janë marrë masat përkatëse aprovimin dhe të depozitimin brenda afateve ligjore dhe certifikuar nga ekspertet kontabël.

Rekomandimi është realizuar

13.Gjetje nga auditimi: Nga departamenti i financës, qendrat e punës në Albpetrol ShA regjistrimet e veprimeve kontabël janë kryer me regjistra ose në programin Excel dhe jo me “Bartës informatikë”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe japin mundësinë e gjenerimit të raporteve financiare. Kjo mënyrë pune ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe sjell mundësinë e gabimeve gjatë kuadrimit të veprimeve kontabël.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3, pika 14 që përcakton mënyrën si mbahet dokumenti kontabël, si dhe pikën 15 “Bartësit kontabël”, neni 3 dhe neni 7.

Mungesa e programit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabile dhe të pasqyrave financiare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55 -67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1.Rekomandim: Nga administratori i shoqërisë dhe nëpunësi zbatues të merren masa që regjistrimet kontabël të kryhen me programe informatike, të autorizuara nga organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e saktësisë dhe cilësisë së informacionit financiar.

Deri më 30.06.2022

Janë kryer lidhjet me Qëndrat dhe pritjet të futet në funksion sistemi, ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi dhe do të kontrollohet auditimin e ardhshëm.

Rekomandimi është në proces

14.Gjetje nga auditimi: Shoqëria Albpetrol ShA gjatë vitit 2018 i është nënshtruar kontrollit financiar nga Drejtoria e Tatim Paguesve të Mëdhenj për periudhën prill 2013 deri në qershor të vitit 2017. Në përfundim të kontrollit të ushtruar, me shkresën Nr.1172/6, datë 13.07.2018 “Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore”, rezulton se Albpetrol ShA duhet të paguajë për periudhën e audituar detyrime në vlerën 930,501,960 lekë, nga i cili detyrim principal në vlerën 655,643,186 lekë dhe gjoba 274,858,774 lekë. Albpetrol ShA e ka ankimuar në Komisionin e Shqyrtimit në Apelimin Tatimor këtë konstatim, por kërkesa nuk është marrë në konsideratë duke lënë në fuqi njoftim vlerësimin e organeve tatimore. Albpetrol ShA më pas ka bërë ankimim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka shfuqizuar vendimin nr. 49, datë 13.11.2019 dhe ka pranuar pjesërisht kërkesën e akt padisë, duke e përcaktuar detyrimin e Albkontrollit në vlerën 647,000,000 lekë. Këtë vendim shoqëria e ka dërguar për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë me datë 21.06.2019 dhe është në pritje të datës së procesit. Në sistemin tatimor deri në periudhën e auditimit, shoqëria rezulton me detyrime tatimore në vlerën rreth 315,000,000 lekë. Për vlerat e mësipërme, drejtimi i shoqërisë në hartimin e pasqyrave financiare nuk ka kryer vlerësimet përkatëse për provizionet e aktiveve që do të zvogëlohen. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 5, dhe SNK nr. 37 Provizionet, Pasivet dhe Aktivët e Kushtëzuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55 -67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për deklarimin në kohë të të gjitha detyrimeve tatimore, si dhe paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare. Gjithashtu të merren masa për llogaritjen e provizioneve, për detyrimet e kërkuara nga administrata tatimore.

Në vijimësi

Janë kryer deklaratimet në kohë të detyrimeve tatimore si dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi dhe do të kontrollohet auditimin e ardhshëm.

Rekomandimi është në proces

15.Gjetje nga auditimi: Zëri kontabël “Llogari të arkëtueshme të tjera”, në pasqyrën e pozicionit financiar paraqitet në vlerën 3,588,920,000 lekë. Në këtë vlerë përfshihen të drejta ndaj të tretëve për kontrata hidrokarbure në vlerën neto 2,640,630,000 lekë më 31 dhjetor 2019. Këto vlera

përfaqësojnë vlerën neto përkatëse të sasisë së produktit, që është llogaritur sipas parashikimeve të kontratave hidrokarbure, por që nuk është lëvruar fizikisht në depozitat e Albpetrol ShA. Këto vlera në tërësi nuk konfirmohen si detyrim nga ana e kontraktorëve, janë të kontestuara ose janë kundërshtuar në rrugë ligjore prej tyre. Shoqëria nuk ka krijuar provizione lidhur me këto fakte dhe ngjarje ekonomike.

-Për vlerësimin e produktit të gatshëm gjendje në fund të vitit, nga hartuesit e pasqyrave financiare në zbatimin e SNK nr.2, nuk është përdorur çmimi mesatar i realizuar i vitit 2019, por vlera të ndryshme për kontraktorë të ndryshëm.

-Gjithashtu, shoqëria paraqet prodhimin e vet në zërin produkte të gatshme, brenda zërit inventarët, në vlerën 1,271,869,000 lekë. Nëse sasia e prodhimit do të ishte paraqitur me çmimet e tregut të konstatuara në periudhën vijuese në të cilën do të realizohen shitjet e këtij prodhimi, atëherë produkti i gatshëm do të kishte një vlerë jo më të madhe se 650,000,000 lekë. Në këto rrethana, shoqëria duhet të kishte njohur një humbje prej rreth 621,000,000 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11. Diferenca që vjen nga veprimet sa më sipër sjell efektet që shoqëria ka pasur si rezultat financiar fitim të periudhës ushtrimore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i shoqërisë të marrin masa që në të ardhmen, përgatitja dhe hartimi i pasqyrave financiare të kryhet me vërtetësi, duke pasqyruar situatën financiare dhe performancën ekonomike, për disponimin në kohë të informacioneve nga palët e interesuara, për vendim- marrjet përkatëse.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Drejtoria e Financës. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi z. A.B, me detyrë Drejtor Finance në shoqërinë Albpetrol sha.

Rekomandimi nuk është realizuar

16.Gjetje nga auditimi: Albpetrol ShA nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër si përshkrimin e aktivitetit, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30.

Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivitetet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues duhet të marrin masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që shoqëria zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Deri më 31.05.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Drejtoria e Financës. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi z. A.B, me detyrë Drejtor Finance në shoqërinë Albpetrol sha.

Rekomandimi nuk është realizuar

17.Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2019 janë përlogaritur shpenzime amortizimi në vlerën 590,537,000 lekë. Në shënimet shpjeguese nga drejtimi i Albpetrol ShA nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme së AAM-ve, pra për normat e amortizimit të aplikuara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore.

-Duke mos përdorur norma të mirë argumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar saktë jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe rrisur e daljes nga përdorimi për shkak të zhvillimit të teknologjisë, Albpetrol SHA rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

-Albpetrol SHA nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 75 të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Mos paraqitje e saktë e pasqyrave financiare dhe mos planifikim i zëvendësimit të aktiveve afatgjatë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të merren masa që në të ardhmen jetëgjatësia e aktiveve të përcaktohet mbështetur në manualin përkatës, ekspertiza të specialistëve të fushës, me përgjegjshmëri dhe besueshmëri.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Drejtoria e Financës. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi z. A.B, me detyrë Drejtor Finance në shoqërinë Albpetrol sha.

Rekomandimi nuk është realizuar

18.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i zërave kontabël të pasqyrave financiare u konstatua se në magazinat e Albpetrol ShA në inventarin e datës 31.12.2019, kishte gjendje mallra stok në vlerën 1,171,415,686 lekë dhe mallra me qarkullim të ngadalshëm në vlerën 255,158,876 lekë.

Nga drejtimi i shoqërisë nuk janë kryer analiza për periudhat kur janë bërë hyrje në magazinë, përqindjet e shfrytëzimit të tyre, si dhe pasojat e mos mbajtjes së të dhënave të kontabilitetit me programe kompjuterike, nuk mundësojnë vlerësime të detajuara për rritjen e mallrave stok.

-Rritja e vlerave të mallrave stok dhe e mallrave me qarkullim të ngadalshëm ka ardhur si pasojë e përlogaritjeve jo me saktësi e përgjegjshmëri të sasive të artikujve të kërkuar, duke krijuar material stok, që përveç se ka shpenzuar fonde financiare të shoqërisë, ka dhe rrisur që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe eficient të burimeve financiare. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10 296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe strukturat e tjera kërkues të mallit/aktivit, të llogaritet me kujdes nevojat për blerje, duke evidentuar më parë gjendjen ekzistuese në magazinë dhe nevojat reale mbi këtë gjendje. Kërkesat për mall të shoqërohen me argumentim dhe relacion përkatës, duke përcaktuar saktë përdorimin e mallit pas blerjes.

Në vijimësi

Nga Shoqëria Albpetrol sha janë kryer kërkesat e nevojës për blerje, duke ju drejtuar magazinës mbi gjendjen. Në relacione është përcaktuar edhe arsyeja e nevojës së mallit. Rekomandimi konsiderohet i realizuar.

Rekomandimi është realizuar

19.Gjetje nga auditimi: Albpetrol ShA ka pasur një situatë të përkeqësuar të detyrimeve kreditore, duke u rritur nga viti 2019 në 2020 në vlerën 1,230,903,487 lekë. Kjo vlerë në pjesën më të madhe ka ardhur nga mos pagesat e faturave të energjisë elektrike nga kompanitë hidrokarbure. Gjithashtu në llogaritë e Albpetrol ShA janë të përfshira dhe llogari kreditore të subjekteve të cilët kanë kaluar afatin më shumë se 12 vite. Aktualisht prej disa viteve ka kaluar afati i parashkrimit të detyrimeve nga të tretët. Në Albpetrol ShA nuk ekziston asnjë kërkesë e subjekteve kreditore për shlyerje detyrimi dhe njëkohësisht është parashkruar afati për tu kërkuar në rrugë gjyqësore.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 3, të nenit 12, të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të merren masat për të kryer pagesat e detyrimeve ndaj të tretëve në afatet e duhura, për të evituar penalitetet nga mos shlyerja e detyrimeve.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Drejtoria e Financës. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi z. A.B, me detyrë Drejtor Finance në shoqërinë Albpetrol sha.

Rekomandimi nuk është realizuar

20.Gjetje nga auditimi: Albpetrol ShA nuk ka kryer inventarizimin e plotë të aktiveve afatgjata dhe detyrimeve për periudha 2019 e 2020 duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, të detyrimeve, të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës përkatës. -Lidhur me asetet që u janë dhënë në dorëzim koncesionarëve, investimeve në marrëveshjet hidrokarbure, në pajisje e materiale që janë pranuar mes palëve, si dhe ato që janë në diskutim, nga ana e Albpetrol ShA, nuk janë kryer inventarizime lidhur me verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, Inventari i aktiveve dhe detyrimeve dhe pika 74 e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, date 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike dhe financiare është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe detyrimeve e të drejtave për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Drejtoria e Financës. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi z. A.B, me detyrë Drejtor Finance në shoqërinë Albpetrol sha.

Rekomandimi nuk është realizuar

21.Gjetje nga auditimi: Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol ShA nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e llogarive të arkëtueshme. Në pasqyrat financiare janë paraqitur të drejta që i përkasin periudhave të mëparshme, duke kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumente ligjore, subjekte që kanë falimentuar etj. Për këto llogari nga shoqëria është kryer vlerësim dhe nuk janë parashikuar provizionet

përkatëse. Për një pjesë të tyre është provizionuar nga ana e Drejtorisë së Financës. vlera 642,939,837 lekë, pa adresuar dhe llogaritë e tjera.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me SKK37, “Provizionet, Pasivet dhe Aktivët e Kushtëzuara”, pika 25 Çmuarja e besueshme e detyrimit.

Mos kryerja e zhvlerësime të aktiveve financiare sjell mos paraqitje të besueshme të situatës ekonomike të institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa që Drejtoria Ekonomike gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Drejtoria e Financës. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi z. A.B, me detyrë Drejtor Finance në shoqërinë Albpetrol sha.

Rekomandimi nuk është realizuar

22.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i pagesave të furnitorëve u konstatua se nga Departamenti Ekonomik dhe i Financës nuk është ngritur dhe miratuar procedura e monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë, si dhe për të dokumentuar që pagesat kryhen sipas skadencave kronologjike.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 1,12 dhe neni 16, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për të ngritur dhe miratuar procedura të monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve sipas kontratave përkatës, me qëllim shmangien e penaliteteve për mos pagesa në afat.

Deri më 31.05.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Drejtoria e Financës. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi z. A.B, me detyrë Drejtor Finance në shoqërinë Albpetrol sha.

Rekomandimi nuk është realizuar

23.Gjetje nga auditimi: Albpetrol ShA nëpërmjet shkresës nr. 1702/1 prot. datë 11.03.2020, ka miratuar fillimin e procedurave për shitjen e naftës bruto dhe krijimin e grupit të eksperteve për caktimin e çmimit minimal fillestar të shitjes së naftës bruto.

Procedura e shitjes së naftës bruto prej 117,639 ton ka filluar mbi bazën e urdhrit nr.936/2 prot. datë 27.03.2020 ku është përcaktuar çmimi fillestar minimal.

Procedura e ankandit është zhvilluar në datë 08.04.2020 dhe për mungesë të paraqitjes së ofertuesve, ankandi është anuluar.

Strukturat përgjegjëse në Albpetrol ShA nuk kanë analizuar shkaqet që ndikuan në anulimin e ankandit për shitjen e naftës bruto në sasinë 117,639 ton, në kundërshtim me piken nr. 15 të urdhrit nr. 83, datë 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure” i ndryshuar.

Në shoqërinë Albpetrol ShA nuk ka funksionuar autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave sipas legjislacionit në fuqi, në kundërshtim me nenin 38, pika 3, të rregullores së brendshme. Një nga anëtarët e grupit të ekspertëve për përcaktimin e formulës dhe çmimin e ankandit, përfaqësuesi i propozuar nga MIE, është njëkohësisht edhe anëtar i këshillit mbikëqyrës të Albpetrol. Gjate shqyrtimit të dosjes së ankandit për shitjen e naftës bruto prej 117,639 ton, një anëtare e komisionit të eksperteve për përcaktimin e çmimit minimal fillestar të shitjes së naftës bruto, nuk ka plotësuar deklaratën e konfliktit të interesit, në kundërshtim me nenin 38 pika 1, të rregullores së brendshme “parandalimi i konfliktit të interesit” 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 163-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1.Rekomandim: Administratori i shoqërisë Albpetrol ShA duhet të ngrejë dhe të bëjë funksional autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, për të mbajtur dhe përditësuar regjistrin e deklaramit të konfliktit të interesave të punonjësve të shoqërisë Albpetrol ShA. Në rastet e anulimit të procedurës së ankandit, të analizohen dhe përcaktohen arsyet që kanë ndikuar. në anulimin e ankandit për shitjen e naftës bruto.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk është marrë asnjë masë nga Drejtoria Organizative. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi A.B, me detyrë Drejtor Organizativ në shoqërinë Albpetrol sha.

Rekomandimi nuk është realizuar

24.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dosjes së ankandit, sipas shkresës me nr. 936 prot. datë 11.02.2020, u konstatuan parregullsitë si vijojnë: -mungesë planifikimi për sasinë që do të shitej, mungesë koordinimi midis Drejtorisë së Programimit dhe Zhvillimit Strategjik me Drejtorinë e Prokurimeve, ku sipas përcaktimeve të nenin 55 pika 1, Objektivat e drejtorisë së prokurimeve janë: *Kryerjen e procedurave të prokurimeve publike të përqendruara për kontrata e mallrave, shërbimeve dhe punëve civile, marrëveshjeve kuadër dhe procedurave të ankandëve në emër dhe për llogari të 11 qendrave të prodhimit dhe të shërbimit të Albpetrol sh.a Patos., në rolin e organit qendror blerës, në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik dhe të ankandit në fuqi.*; -Tejkalim të kompetencave nga drejtoria e prokurimeve gjatë fazës së planifikimit të sasisë dhe vendburimeve për fillimin e procedurave të ankandit; -Mungese të analizës së riskut të mosrealizimit të planit të nxjerrjes së naftës, si dhe faktorëve të tjerë që do të ndikonin në një analizë, më realiste e resurseve; -Mungesë kontrolli nga administratori për ushtrimin e kompetencave nga strukturat e vartësisë, veprime në kundërshtim me rregulloren e përgjithshme të Shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 163-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1.Rekomandim: Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik duhet të koordinoj dhe të bashkëpunoj me Drejtorinë e Prodhimit, të Shitjes, QFSHAG dhe sektorët e monitorimit të marrëveshjeve hidrokarbure, për të planifikuar sasi të naftës bruto sipas vendburimeve të Albpetrol ShA, në mënyrë që të optimizojë kapacitetet e veta të magazinimit e stokimit, për të rritur të ardhurat e shoqërisë nga realizimi i shitjes së naftës bruto nëpërmjet procedurave të ankandit.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi nga Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik, Drejtoria e Shitjes së Naftës dhe Gazit dhe Drejtoria e Prodhimit. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi znj. A. H., z. XH. S dhe z. J. D.

Rekomandimi nuk është realizuar

25.Gjetje nga auditimi: Tarifa e magazinimit dhe lëvizjes së produktit naftë bruto në pikën e lëvrimit në një nga dy portet e vendit, është përcaktuar nga komisioni i ekspertëve në mungesë të referencës së miratuar nga administratori i shoqërisë.

Grupi i eksperteve të caktuar për llogaritjen e çmimit/njësi minimal fillestar të shitjes së 117,639 Ton naftë bruto, në proces verbalin nr. 1765 prot., datë 17.03.2020 në seksionin “Vlerësimi i kostove të stokimit (përfshirë koston e magazinimit, analizimi i matjes dhe sigurimit të ngarkesës, dhe temperaturës)” kanë përcaktuar tarifën e magazinimit dhe lëvizjes së naftës Bruto me 8.5 euro/ton/vit, duke ju referuar sasisë deri në 60KT (60 000 Ton) dhe mbi këtë bazë, kanë përcaktuar vlerën e magazinimit të sasisë 117,639 Ton, për një periudhë 6 mujore mesatarisht me 4.25 euro/Ton ose **0.740 USD/BBL**

Nga auditimi konstatohet se:

-Grupi i eksperteve ka vendosur tarifën e magazinimit të naftës bruto në mungesë të referencës zyrtare të tarifave të magazinimit dhe lëvizjes së produktit.

-Tarifa prej 8.5 euro/ton/vit i referohet sasisë 60,000 ton.

-Tarifa e magazinimit nuk i referohet sasisë mbi 100,000 ton, ku mund të përfshihej sasia prej 117,639 ton.

Vlera 0.740 USD/BBL e magazinimit për sasinë 117,639 ton, konsiderohet si kosto fiktive e shtuar padrejtësisht nga grupi i ekspertëve, në totalin e kostove mesatare (transport, magazinim, sigurim në stokim dhe lëvizje, analizim, ngrohje dhe pagë operatorit).

Në rast se kjo procedurë do të realizohej kostoja shtesë e magazinimit prej 0.740 USD/BBL, e vendosur apriori nga grupi i ekspertëve pa një referencë të miratuar nga administratori, do të ulte ndjeshëm të ardhurat e shoqërisë së Albpetrol ShA nga shitja e kësaj sasive naftë bruto, pasi do të shtonte kostot e zbritshme sipas formulës së miratuar, nga ky komision:

Çmimi minimal fillestar për një njësi = $72.2\% * \text{çmimi Brent} - (2.383 \text{ USD/BBL} + 0.740 \text{ USD/BBL})$
Ku vlera 0.740 USD/BBL përfaqëson tarifën probabël të magazinimit në një nga dy portet e vendit në Vlorë ose në Durrës në kushtet e çmimit FOB (për eksport).

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Urdhrin nr.83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve Hidrokarbure” të ndryshuar, duke pasur si efekt uljen e të ardhurave të shoqërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 163-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA të miratojë tarifën e magazinimit dhe të lëvizjes së produktit naftë bruto në pikat e lëvrimit në dy portet e vendit, mbi bazën e ofertave të operatorëve që ofrojnë këto shërbime, të cilat të shërbejnë si referencë për komisionin e ekspertëve gjatë përcaktimit të çmimit minimal të shitjes së naftës bruto.

Menjëherë

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi nga Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik, Drejtoria e Shitjes së Naftës dhe Gazit dhe Drejtoria e Prodhimit. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi znj. A. H., z. XH. S dhe z. J. D.

Rekomandimi nuk është realizuar

26.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i ankesës së bërë në faqen zyrtare të KLSH, në datën 18.09.2021, u konstatua si vijon:

Shoqëria Albpetrol sha me shkresën nr. 9184/2 prot., datë 18.10.2019 ka vendosur plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ku te rubrika masa shpërbllim dëmi, rekomandimi 4.1, i është lënë detyrë për zbatimin e këtij rekomandimi Drejtorisë Organizative, Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë Juridike. Nga auditimi i kryer për zbatimin e rekomandimeve të lëna rezultoi se kjo masë ka qenë në proces, pasi është shtyrë afati i zbatimit të saj nga Drejtoria Juridike për shkak se punonjësit nuk ishin më në marrëdhënie pune dhe hapja e procesit gjyqësor u shty për shkak të kushteve të pandemisë.

Për masën e mësipërme është ngarkuar për zbatim Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit me afat për zbatim brenda datës 31.03.2021.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Shoqëria Albpetrol sha nuk rezulton të jenë ndërmarrë hapa ligjorë për arkëtimin e shumës të konsideruar dëm ekonomik nga KLSH deri në fund të periudhës së auditimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për këtë çështje rezulton se:

Është kryer hetimi administrativ nga Agjencia e Prokurimit Publik, Drejtoria Juridike, e Verifikimit dhe Integritetit, ku me vendimin nr. 54, datë 17.07.2019 ka vendosur të dënojë me gjobë në masën 120.000 lekë secilin z. B. L, z. S. L dhe z. S.H, anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave, për mos përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 53 të LPP. Me shkresën nr. 3391/6 prot., datë 17.07.2019 është njohur me vendimin nr. 54, datë 17.07.2019 Autoriteti Kontraktor (Albpetrol ShA) dhe është ngarkuar për zbatimin e masave të vendosura në këtë vendim, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e tij.

z. S.H ka bërë ankim në Gjykatën Administrative Vlorë me nr. 1359 akti, datë 14.08.2019 për shfuqizimin pjesërisht të Aktit Administrativ. Por me vendimin nr. 1219, datë 19.11.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë pretendimi është rrëzuar.

Grupi i Auditimit iu drejtua Shoqërisë Albpetrol ShA për informacion me anë të postës zyrtare elektronike mbi zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative Vlorë, Shoqëria Albpetrol ShA në kthim përgjigje thotë se: “Në arkiv-protokollin tonë nuk ndodhet vendimi i Gjykatës Administrative Vlorë me nr. 84-2019-2019, datë 20.01.2020”. U konstatua se për zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative Vlorë nuk është ndërmarrë asnjë hap ligjor për arkëtimin e gjobës së vendosur nga Agjencia e Prokurimit Publik, pasi Albpetrol ShA pretendon se nuk është njohur me vendimin e Gjykatës, pavarësisht se vendimi është i bërë publik në faqen e Gjykatës Administrative Vlorë dhe është lehtësisht i aksesueshëm.

Gjate kohës që z. S.H ka qene ne procese gjyqësore është rimarr në punë me vendimin nr. 303 , datë 27.11.2020 dhe i ka filluar marrëdhëniet e punës me datë 02.12.2020 si Këshilltar në Kabinetin e Administratorit, pa mbaruar procesin gjyqësor (i cili ka përfunduar me datë 16.03.2021).Shoqëria Albpetrol ShA jo vetëm që nuk ka ndjekur zbatimin e rekomandimeve të KLSH që në rrugë ligjore te ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 2,523,484 lekë, nga anëtarët e KVO, z. B. L, znj. R.G dhe z. S.H, por e ka rimarr ne pune, megjithëse ka pasur procese te hapur ndaj Albpetrol ShA.

Vendimi nr. 423, datë 16.03.2021 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, është apeluar në Gjykatën e Apelit Vlorë nga shoqëria Albpetrol ShA dhe është regjistruar në Gjykatën e Apelit Vlorë me datë 27.05.2021 , me gjyqtar Relator S. D, pa u caktuar datë gjyqi akoma.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për këtë çështje rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier i ka dhënë të drejtë palës paditëse z. S.H për largim të padrejtë nga puna. Çështja momentalisht ndodhet në Gjykatën e Apelit Vlorë pasi është apeluar nga Shoqëria Albpetrol sha, por Gjykata nuk ka marrë vendim akoma për këtë çështje. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqe 233-235 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga institucion i KLSH, APP, etj., përsa i përket çështjes së mësipërme.

Menjëherë

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi z. A.T.

Rekomandimi nuk është realizuar

27.Gjetje nga auditimi: 1-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje lende djegëse solar me përmbajtje squfuri jo me tepër se 1% ndaj peshës”, me vlerë të fondit limit 21,298,000

lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, kanë marrë pjesë tre operatorë ekonomik, të cilët nuk i plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit: OE “T...S” sha me marzhë fitimi 4.4%, i s’kualifikuar, OE “R...R” ShA, me marzhë fitimi 15% i skualifikuar dhe OE “E...A” ShA, me marzhë fitimi 21% i kualifikuar dhe shpallur fitues. Në vlerësimin e ofertave ekonomike KVO ka vepruar me dy standarde, pasi dy operatorë ekonomik me marzhë fitimi më të ulët i ka s’kualifikuar në mënyrë të drejtë, ndërkohë që operatorin ekonomik “E...A” ShA, me marzhë fitimi më të lartë edhe pse ndodhet në të njëjtat kushte, pasi nuk i plotëson kriteret, e ka kualifikuar dhe i ka propozuar titullarit të autoritetit kontraktor për shpalljen fitues të tij. Veprimet e mësipërme të KVO janë në kundërshtim me pikën 5, të nenit 53 dhe nenin 55 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

2- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje tubo naftës-jellësi” viti 2020, u konstatuan anomali në hartimin e specifikimeve teknike të cilat janë jo të qarta e të kuptueshme, si dhe kriteret e vendosura, të cilat nuk janë argumentuar teknikisht. Në procedurën “Blerje tubo naftës-jellësi” janë vendosur kritere diskriminuese e të panevojshme.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

3- Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje kabull fuqie dhe aksesore elektrike dhe materiale ndihmëse” u konstatuan parregullsi. Komisioni i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit ka kontaktuar me subjekte që operojnë në treg dhe kanë vlerësuar çmimet më të ulta të ofertave të tregut me ato të kontratës së mëparshme, për llogaritjen e fondit limit. Operatorët që kanë marrë pjesë janë S...K ShPK, me ofertë 7,481,500 lekë pa TVSh, operatori A...6 ShPK, me vlerë 8,081,000 lekë pa TVSh, dhe operatori E...L shpk, me vlerë 8,154,750 lekë.

Grupi i auditimit shprehet me rezervë për procesin e testimit të tregut, duke u nisur nga oferta e dhënë nga operatori S...K ShPK, pasi nga zhvillimi i procedurës u konstatua se OE fitues i procedurës V...4 ShPK, me ofertë fituese 7,067,400 lekë pa TVSh, i ka marrë materialet nga operatori S...K, si dhe transporti për në ambientet e Albpetrol është bërë me mjetet e S...K ShPK. Kjo konstatohet nga të dhënat e faturës të lëshuar nga OE V...4 shpk, me nr. 1, datë 26.03.2021, ku te të dhënat e transportuesit është S...K ShPK, filiali Fier, me mjetin me targë

Nga auditimi i specifikimeve teknike të përcaktuara në DST u konstatuan parregullsi në hartimin e specifikimeve teknike, të cilat nuk përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, AK nuk ka kërkuar dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Nga procesi i kualifikimit të OE fitues u konstatua se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, e për rrjedhojë duhet të ishte skualifikuar dhe tenderi duhet të anulohet.

4 -Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje kushineta”, viti 2020 u konstatuan parregullsi në procesin e përlllogaritjes së sasive dhe specifikimet teknike. Mungojnë kërkesat e qendrave, sektorëve për llojet specifike të kushinetave që do të blihen, mungon një argumentim i saktë lidhur me numrin e makinerive, llojet dhe se ku do të përdoren, mungon korrespondenca me qendrën që menaxhon magazinat e shoqërisë për konfirmim nëse ka gjendje, sa ka dhe sa duhet të merret. Mungesa e dokumenteve të gjurmës së auditimit bën më të vështirë procesin e përgjegjshmërisë në shpërndarjen e tyre.

Përshkrimi i mallrave nuk përmban specifikimet teknike që duhet të plotësohen dhe nuk përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor. Nga përshkrimi i mallrave nuk përcaktohen kërkesat që kanë lidhje me këto mallra nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale etj.

Në procesin e vlerësimit nga KVO u konstatua se OE “V...U” i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e DST e për rrjedhojë duhet të ishte skualifikuar dhe procedura e prokurimit duhet të ishte anuluar.

5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Shërbimi i sigurimit të punonjësve nga aksidentet në punë” viti 2020, u konstatuan parregullsi në hartimin e specifikimeve teknike. Është kërkuar që sigurimi të përfshijë 1. Sigurimin e aksidenteve personale në punë deri në shumën 4,000,000 lekë.

2. Sigurimin në rastin e humbjes së jetës si pasojë e aksidenteve në punë në shumën 4,000,000 lekë.

3. Sigurimi i Shëndetit të Punonjësve nëpërmjet kryerjes së kontrolleve mjekësore parandaluese si analizat e fenoleve 1 herë në vit, për punonjësit të cilët janë të ekspozuar nga aksidentet në punë. Mbledhja në një procedurë prokurimi e tre shërbimeve të cilat kërkojnë licenca specifike, në bazë të ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri-sigurimit”, i ndryshuar, ka ndikuar në uljen e konkurrencën në prokurim.

Në procesin e vlerësimit nga KVO u konstatua se BOE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e DST e për rrjedhojë AK duhet të skualifikonte BOE fitues dhe të anulonte procedurën e prokurimit.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 23, 24 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik” dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 93-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA Patos të analizojë situatën dhe të përcaktojë arsyet për vlerësimin e gabuar të bërë nga anëtarët e KVO. Të marrë masa për eliminimin e praktikave të kualifikimit të një operatori ekonomik që nuk i plotëson kriteret e vendosura në dokumenteve standarde të tenderit.

Nga ana e Drejtorisë së Prokurimit janë propozuar gjithmonë si anëtarë të KVO specialistë të fushës përkatëse që kanë lidhje me procedurën e prokurimit si dhe anëtarë me eksperience në fushën e prokurimeve.

Rekomandimi është në proces

27.2.Rekomandim: Nga njësia e prokurimit, grupet e ngritura për hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike të DST, të merren masa që në çdo procedurë prokurimit të vendosen kriteret të argumentuara teknikisht, të përcaktohen standardet që duhet të plotësojnë produktet/mallrat objekt prokurimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga ana e Drejtorisë së Prokurimit janë propozuar gjithmonë si anëtarë të KVO specialistë të fushës përkatëse që kanë lidhje me procedurën e prokurimit si dhe anëtarë me eksperience në fushën e prokurimeve.

Rekomandimi është në proces

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi shpenzimet e konsumit të karburantit për automjete të Albpetrol sh.a Patos konstatohet se:

1. Me vendimin nr. 4, datë 21.01.2005, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë janë miratuar normativat për konsumin e karburantit në total për 211 mjete, makineri-pajisje të cilat janë aplikuar edhe në periudhën objekt auditimi. Ndërkohë që ky vendim nuk përfshin 47 mjete të cilat kanë kaluar në pronësi të shoqërisë pas vitit 2005. Lidhur me këtë situatë nga organet drejtuese të Shoqërisë nuk ka një vendimmarrje për përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për këto 47 mjete por nga Dega Teknike/Normistët e Qendrave të Prodimit si referencë janë marrë normativat e katalogëve të mjeteve.

Nuk është kryer një analizë e detajuar mbi konsumin real për caktimin e normativave të karburantit për mjetet që janë bërë pjesë e institucionit pas vitit 2005, duke marrë parasysh edhe amortizimin apo riparimet dhe shërbimet ndër vite.

2. Për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistrohen shpenzimet që janë kryer për to, kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe fund vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike.

3. Lidhur me dokumentacionin justifikues:

-Në rubrikën “Kryerja e detyrës” nuk evidentohet sa është kilometrazhi i mjetit në fillim të kryerjes së shërbimit dhe sa është në përfundim të lëvizjes. Gjithashtu çdo shërbim nuk është i nënshkruar nga drejtuesi i mjetit.

-Nga mjetet e përzgjedhura në 10 raste kilometrazhi dhe treguesi i furnizimit me karburant ndodhen jashtë funksionit.

-Nuk ka një rakordim të i cili duhet të bazohet mbi raportet mujore mbi realizimin apo tejkalimin e konsumit të karburantit për secilin mjet.

-Nuk ka një rakordim midis magazinë dhe degës teknike mbi konsumin e karburantit.

4. Lidhur me përdorimin dhe monitorimin nga sistemi i GPS për lëvizjen e mjeteve:

-Sistemi GPS ka qenë funksional në mënyrë të pjesshme për arsye se nuk janë likuiduar detyrimet kartave SIM.

-Sistemi GPS nuk mbulon të gjithë zonat/hartën mbi të cilat lëvizin mjetet.

-Sistemi GPS nuk përmbush të gjitha kërkesat e monitorimit efikas konkretisht matjen e konsumit të gazoilit dhe orët e punës për mjetet teknologjike.

-Sistemi GPS nuk harton raporte mujore mbi lëvizjen e mjetit ku të jetë i përcaktuar grafiku ditor dhe kilometrat e përshkruara nga mjeti.

5. Nga organet drejtuese të shoqërisë nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit të karburantit për mjetet e shoqërisë sipas drejtorive dhe sektorëve në administratën qendrore dhe qendrat e prodhimit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 10, neni 19, dhe neni 22, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 5-10, dhe pikat 35-36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 72-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshirë ata që kanë mjete në ngarkim) i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë gjendjen teknike të mjeteve dhe më pas të caktojë normativat mbi konsumin e karburantit për mjetet që ushtrojnë aktivitetin në Shoqëri pa normativa të miratuara.

28.2. Rekomandim: Nga Drejtoria e Ekonomike dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

28.3. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës ku të vendosen në gjendje pune të gjithë GPS duke kryer riparimet teknike dhe instalimet e aplikacioneve ku të përfshihet e gjithë harta në të cilën lëvizin mjetet, matjen e konsumit të gazoilit, orët e punës për mjetet teknologjike dhe kilometrat e përshkruara nga mjeti raportet mujore mbi realizimin apo tejkalimin e konsumit të karburantit për secilin mjet. Për mjetet të cilat kanë janë funksionit treguesin e furnizimit me karburant të kryhen riparimet përkatëse.

28.4. Rekomandim: Nga organet drejtuese të Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për hartimin e rregullave në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet, makineritë-pajisjet e shoqërisë si dhe në të të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve në administratën qendrore dhe qendrat e prodhimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi nga Drejtoria Teknike, Drejtoria Organizative, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Logjistikës dhe Drejtoria e Prodhimit. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi z. A.P, A.B, z. A. B dhe z. XH. S.

Rekomandimi nuk është realizuar

29. Gjetje nga auditimi: Niveli i pagave i aplikuar nga Shoqëria Albpetrol sh.a Patos për vitin 2019 nuk është miratuar nga Asambleja Aksionare (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), por vetëm nga Këshilli Mbikëqyrës, ndërsa për vitin 2020 me Vendimin nr. 1043/1, datë 29.01.2020, të Asamblesë Aksionare është miratuar ndryshimi i nivelit të pagave për punonjësit e qendrave të

prodhimit të Shoqërisë. Organet drejtuese të Shoqërisë, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori e kanë quajtur të ezauruar miratimin e nivelit të pagave për vitin 2019, vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 6, pika 1, të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese të Shoqërisë në të ardhmen të merren masat e duhura për miratimin e nivelin të pagave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore dhe statutore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi z. K. C. dhe E. D., me detyre Administrator i shpëqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

30. Gjetje nga auditimi: Përgjatë periudhës objekt auditimi janë kryer 235 emërime dhe lëvizje punonjësish të cilat janë bërë pa kërkesë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për vendet vakante, nuk ka procedurë nga institucioni, si shpallje në faqen zyrtare të shoqërisë, vendosje kriteresh për pozicionet e vendeve të punës etj. Gjithashtu nuk ka asnjë dokumentacion për kërkesat apo nevojat e vendeve vakante nga administrata qendrore apo qendrat e prodhimit. Për këta punonjës nuk ka dosje personale të plotësuar, pasi emërimet dhe lëvizjet paralele janë bërë vetëm me vendim apo urdhër të Administratorëve të Shoqërisë.

Nga auditimi me zgjedhje i proceseve të rekrutimeve për punonjësit e marrë rishtas në punë në 5 raste formimi profesional i tyre nuk përputhet me pozicionin e punës sipas strukturës së miratuar të shoqërisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratat kolektive të punës me nr. 8781 prot., datë 29.12.2017, dhe nr. 10645 prot., datë 22.11.2019, nenet 53-56. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

30.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat e duhura që emërimi i punonjësve të rinj dhe lëvizjet brenda institucionit të bëhet në bashkëpunim dhe konsultim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe në përputhje me kuadrin rregullator të rekrutimeve në punë.

30.2. Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në rastet e emërimeve të reja, më parë të përcaktojë vendosjen e kriterëve përkatëse për çdo pozicion pune sipas strukturës organizative. Gjithashtu të marrë masat e duhura mbi plotësimin e dosjeve personale të punonjësve me dokumentacionin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi z. K. C. dhe E. D., me detyre Administrator i shpëqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

31. Gjetje nga auditimi: Gjatë 3-mujorit të fundit të vitit 2019 konstatohet se janë kryer gjithsej ndërprerje të marrëdhënieve të punës për 75 punonjës ndërkohë në po të njëjtën periudhë janë punësuar 22 punonjës. Konkretisht janë kryer ndërprerje e marrëdhënieve të punës për 21 punonjës në muajin tetor, 27 punonjës në muajin nëntor dhe 26 punonjës në muajin dhjetor 2019 *(mbi 20 punonjës janë larguar në secilin prej muajve)*, pra brenda 90 ditëve është kryer ndërprerje e marrëdhënieve të punës në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar neni 148, pika 1, ku thuhet: “Vlerësohet pushim kolektiv

nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, **të paktën,20 punëmarrës për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës**". Për sa më sipër situata është në kushtet e një pushimi kolektiv, por nuk janë zbatuar procedurat e duhura, pasi nuk është bërë njoftim me shkrim të organizatave përfaqësuese për pushim kolektiv nga puna të punonjësve si dhe nuk është marrë miratimi i Ministrisë për largimin e punonjësve.

Për shkak të reduktimit të shpenzimeve administrative me urdhrin nr. 68, datë 26.03.2020 të Administratorit të Shoqërisë është urdhëruar anulimi i të gjithë urdhrave për emërimet e punonjësve të rinjë nga data 01.03.2020, urdhër i dërguar në protokoll me vonesë, më 07.04.2020, veprim i cili është refuzuar për tu kryer nga përgjegjëse sektorit të protokoll/arkivit.

Vendimet për emërimet e reja nga Administratori i Shoqërisë janë kryer në një kohë kur struktura e shoqërisë është në proces reduktimi si rezultat Vendimit nr. 28, datë 04.12.2019, të Këshillit Mbikëqyrës në të cilin është miratuar struktura e re e Shoqërisë, nga 1790 punonjës në 1600 punonjës pra duke e ulur numrin e fuqisë punëtore.

Edhe pse Shoqëria ka qenë në fazën e ristrukturimit e cila është në proces reduktimi konstatohet se, për periudhën janar-prill janë kryer 60 emërimet të reja. Nga Administratorit të Shoqërisë. Në këto emërimet 26 prej tyre janë kryer nga data 10-24 mars 2020, ndërkohë që me Vendimin nr. 68, datë 26.03.2020, të Administratorit të Shoqërisë është kërkuar heqja e disa prej tyre nga puna duke revokuar vendimmarrjet mbi punësimet dhe ç' deklaratimet e tyre nga sistemi i tatimeve. Personat të cilët janë emëruar me vendim të Administratorit, regjistruar në sistemin e deklaratimit të punësuarve dhe më pas janë larguar nga sistemi

- Gjithashtu nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të largimeve nga puna të punonjësve konstatohet se në 16 raste punonjësit janë larguar vetëm në bazë të vendimit të Administratorit të Shoqërisë E.M, pas asnjë procedurë për largimin e tyre. Pesë prej tyre kanë bërë padi në gjykatë për dëmshpërblim page dhe ekziston mundësia e efekteve financiare në buxhet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 148, pika 1, neni 153 e vijues, Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 8, Kontratat Kolektive të Punës me nr. 8781 prot., datë 29.12.2017, dhe nr. 10645 prot., datë 22.11.2019, nenet 53-56. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1. Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës të analizojë largimet e punonjësve nga puna dhe të monitorojë të mënyrë të vazhdueshme procesin e shpërbërjes të marrëdhënieve të punës duke kërkuar informacione periodike mbi vendimmarrjen e Administratorit të Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë të marrë masat e duhura që gjatë largimit të punonjësve nga puna ky proces të kryhet në përputhje me kuadrin rregullator ligjor për të shmangur pasojat e mundshme financiare që vijnë nga proceset gjyqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohen me përgjegjësi Këshilli Mbikëqyrës, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i shpërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë pagesave për muajt korrik 2019-dhjetor 2020 rezulton se në kontratat kolektive të punës të lidhura midis Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe Sindikatës së Re të Naftëtarëve me nr. 8781 prot., datë 29.12.2017 dhe nr. 10645 prot., datë 22.11.2019, të miratuara respektivisht me vendimin nr. 68, datë 29.12.2017, dhe nr. 11246/5, datë 12.12.2019 të Këshillit Mbikëqyrës, në nenet 30 të secilës kontratë përcaktohet se "Punëdhënësi me autorizim me shkrim nga punëmarrësi mund të zbrësë nga paga kuotizacionet sindikale sipas konfirmimit të sindikatës në masën 100 lekë/muaj, ndërkohë që mund të heqë dorë në çdo kohë nga kjo kuotë

mujore. Sipas arkëtimeve të mbajtura nga paga e punonjësve shuma e mbledhur nga kuotizacionet do të xhirohet në çdo muaj nga Shoqëria në llogarinë bankare të Sindikatës”. Shuma totale e akumuluar për periudhën objekt auditimi është 1,985,202 lekë prej së cilës është derdhur për llogari të SRNSH shuma prej 509,800 lekë, mbetur pa u derdhur shuma 1,385,402 lekë si detyrim i Albpetrol sh.a Patos për llogari të SRNSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratat kolektive nr. me nr. 8781 prot., datë 29.12.2017 dhe nr. 10645 prot., datë 22.11.2019, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 117, pika 1 dhe pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 22-51 të Projekt Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat e duhura për derdhjen e fondit të akumuluar si detyrim të pa kaluar për llogari të Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptar në shumën 1,385,402 lekë.

Menjëherë

Nga Drejtoria e Financës është kryer derdhja e fondit të akumuluar si detyrim për llogari të Sindikatës së re të Naftëtarëve Shqiptar në shumën 1,385,402 lekë me datë 14.07.2021.

Rekomandimi është realizuar

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit të Departamentit Teknik u konstatua se janë punësuar 21 punonjës me profesion elektrikist pa dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, duke mos dhënë siguri për nivelin e shkallës profesionale të punonjësit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 10-36 të Projekt Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

33.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Departamenti Teknik të merren masa për pajisjen e punonjësve që punojnë në pozicionet e punës elektrikist me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, për të parandaluar çdo ngjarje në dëm të shëndetit dhe jetës së tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Punonjësit në pozicionet e punës elektrikist i ka të pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Çdo vit është kryer procedura e prokurimit për këtë zë dhe gjithmonë kemi pasur kontratë me të tretë për ofrimin e këtij shërbimi. Dëshmitë e kualifikimit të punonjësve skadojnë rreth muajit korrik dhe për këtë arsye është nisur procedura për lidhjen e kontratës për këtë vit.

Rekomandimi është në proces

34.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vendimeve të marra nga Këshilli Mbikëqyrës në Albpetrol ShA për vitin 2019 u konstatua se këto vendime nuk paraprihen nga dokumentacionet ose projekt vendimet e propozuara në Këshillin Mbikëqyrës të cilat kanë çuar në marrjen e vendimeve përkatëse. Vendime të tilla janë: vendimi nr. 32, datë 26.12.2019 “Për miratimin për ndryshimin e pagave të punonjësve të qendrave të shoqërisë Albpetrol ShA”, vendimi qarkullues nr. 2 date 27.03.2020 “Pezullimin e Prokurimeve në Shoqërinë Albpetrol ShA”, vendimi qarkullues nr. 3, datë 30.03.2020 “Miratimin e çmimit të shitjes së naftës bruto në Shoqërinë Albpetrol ShA” etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me rregulloren e brendshme të shoqërisë Albpetrol ShA, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 30, datë 04.12.2019, Kreu III, “Funksionimi i Shoqërisë”, Neni 15, “Marrëdhëniet me Këshillin Mbikëqyrës”, Pika 1, germa d. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

34.1.Rekomandim: Nga Albpetrol ShA të merren masa në mënyrë që në të gjitha rastet e propozimeve për marrje vendimi nga Këshilli Mbikëqyrës, projekt vendimet të shoqërohen me dokumentacionin mbështetës për çdo çështje.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është realizuar

35.Gjetje nga auditimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Albpetrol ShA nuk është krijuar komiteti për përcaktimin e standardeve për emërimin e Administratorit nga Asambleja e Përgjithshme, për përcaktimin e skemës së shpërblimit individual të Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, për kontrollin e mbarëvajtjes dhe kontabilitetit të shoqërisë Albpetrol ShA, si dhe komiteti i kontrollit financiar. Mos krijimi i komiteteve të lartpërmendura është veprim në kundërshtim me statutin e shoqërisë Albpetrol ShA Patos, Kreu V, Neni 21 “Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës dhe të Komiteteve të tij”, Paragrafi 3, Pika 1, 2 dhe 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

35.1.Rekomandim: Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masa për krijimin e Komiteteve sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë Albpetrol ShA.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është realizuar

36.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së këshillit mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi, u konstatua se nga ky këshill janë emëruar 4 administrator të shoqërisë Albpetrol ShA. Në të gjitha rastet nuk është nënshkruar kontratë pune midis këshillit mbikëqyrës dhe administratorit të shoqërisë Albpetrol ShA, veprim në kundërshtim me statutin e shoqërisë, kreu IV, neni 17 “Emërimi i Administratorit”, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

36.1.Rekomandim: Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masa për lidhjen e kontratës së punës me administratorin aktual të shoqërisë dhe kjo praktikë të ndiqet në vijimësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Është nënshkruar kontratë individuale pune nga Këshilli Mbikëqyrës, z. I. G., Kryetar i Këshillit dhe Administratorit aktual E. D.

Rekomandimi është realizuar

37.Gjetje nga auditimi: Shoqëria Albpetrol ShA ka të dokumentuara 3,500 puse nga të cilat 160 prej tyre me vërtetime hipotekore dhe 3,340 puse me certifikate pronësie, që do të thotë se ende 4,5% e kësaj lloji prone nuk zotërohet e regjistruar me certifikate pronësie.

Objektet e dokumentuara në ZRPP vendore gjithsej 454, nga të cilat 25 janë me vërtetim hipotekor ndërsa 429 janë të dokumentuara me certifikate pronësie.

Pra janë regjistruar gjithsej 3,954 pasuri, puse dhe objekte të shoqërisë nga të cilat 185 pasuri janë me vërtetim hipotekor dhe 3,769 pasuri të shoqërisë janë me certifikate pronësie të rregullta. Pronat e regjistruara me vërtetim hipotekor zënë rreth 4,7% të pronave të regjistruara me certifikate pronësie.

Gjithashtu konstatohet se janë të pa regjistruara në ASHK përkatëse 1,776 puse dhe 21 objekte të shoqërisë. Numri i pasurive të patundshme të shoqërisë është gjithsej 5,751 pasuri. Numri i pronave të paregjistruara zë një peshë prej 31,2%. Nëse do të llogarisim edhe 4,7% të pronave që janë regjistruar me vërtetim hipotekor, pasuritë pa certifikatën e pronësisë shkon 39% e numrit total të pronave. Ky është një numër shumë i lartë i pronave të paregjistruara dhe tregon për një punë të dobët prej gjithë stafeve drejtuese të shoqërisë, si Drejtoria Juridike, Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës dhe në linjë vertikale kjo mangësi shkon deri tek stafet e Ministrisë së Linjës e cila duhet të kishte bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të shmangur të gjitha pengesat subjektive të këtij procesi. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 158/dh i ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për tregtarët

dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 67-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

37.1.Rekomandim: Nga Administratori i Albetrol ShA të merren të gjitha masat e duhura ligjore për rregjistrimin e pronave ende të pa rregjistruara në ASHK.

Deri më 31.05.2022

Drejtoria e Administrimit dhe Kontrollit të Pronës i është drejtuar ASHK Fier, ku është ngritur shqetësimi për vazhdimin e procedurave të regjistrimit për 297 pasuri. Për të cilat është kryer aplikim por nuk janë pajisur ende me certifikata pronësie.

Rekomandimi është në proces.

38.Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes Pronave, në bashkëpunim me Qendrat e Shoqërisë dhe me ASHK e rretheve, ka të listuar dhe të përditësuara të gjitha pronat e zëna nga posedues të paligjshëm si dhe pronat me mbivendosje. Këto prona janë zënë gjatë një periudhe të gjatë përpara periudhës së auditimit dhe megjithëse nga grupet e mëparshme të KLSH-së është rekomanduar që të ndërmerren hapa ligjor për këtë problematik, nga Albetrol ShA ende nuk është marrë një veprim i tillë. Nga auditimi i dokumentacionit është konstatuar se janë gjithsej 34 pasuri të zëna nga posedues të paligjshëm dhe janë probleme të mbartura e të pazgjidhura nga Administratori, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 67-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

38.1.Rekomandim: Nga Administratori i Albetrol ShA, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për marrjen në administrim nga institucioni të gjitha pronat e zëna nga posedues të paligjshëm. Gjithashtu të zgjidhet çështja e pronave me mbivendosje.

Deri më 31.05.2022

Drejtoria e Administrimit dhe Kontrollit të Pronës ka kërkuar nga të gjitha qendrat nën varësi të cilat janë posedues të këtyre aseteve, të shprehen mbi problematikat që këto asete kanë. Por nuk janë ndërmarrë hapa ligjorë për zgjidhjen e kësaj problematike. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi z. D.SH, z. A.T, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

39.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për objektet e lëshuara me qira nga Albetrol ShA, konstatohet se detyrimet e qiramarrësve nuk janë paguar sipas kontratave. Dhënia me qira e objekteve në përgjithësi nuk iniciohet sipas rregullave të vendosura në VKM 54, datë 5.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Shoqëria nuk ka ndjekur procedura ligjore komunikimi me publikun dhe i mungon informacioni online për publikun në faqen e saj mbi objektet që ajo është e interesuar të lëshojë me qira. Albetrol ShA ka shumë objekte të tilla që nuk kryejnë asnjë funksion por që administrohen nga qendrat e saj pa produkt konkret. Zakonisht procedimi i dhënies me qira kryhet nëpërmjet të interesuarve që bëjnë konstatim fizik mbi objektet jashtë funksioni në pronësi të Shoqërisë Albetrol ShA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 67-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

39.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës të merren masa që në të ardhmen për secilën kontratë qiraje të zbatohen të gjitha etapat e përshkruara në kuadrin ligjor, për lidhjen dhe zbatimin e tyre. Të kryhet publikimi në faqen zyrtare të shoqërisë i pronave që jepen me qira, me qëllim informimin e publikut dhe rritjen e interesit prej tij për këto prona.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion

justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi z. D.SH, z. A.T, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

40. Gjetje nga auditimi: Shoqëria A...L ShA, e cila ka marrë të drejtat e shfrytëzimit të vendburimeve Ballsh-Hekal, për vitin 2018 e 2019, nuk ka dorëzuar sasitë e naftës PPE, ndaj Albpetrol SHA, sipas marrëveshjes pasi pretendon se paraardhësi i saj shoqëria T...A, ka dorëzuar më tepër rreth 15,418.6 ton naftë deri më 2017.

Përmbauesi gjyqësor A. V, në zbatim të disa urdhrave të ekzekutimit të Albpetrol SHA, ku kreditor ishin subjekte të ndryshme dhe debitor ishte shoqëria T...C, ka kryer disa veprime procedurale:

-Ka vendosur sekuestro konservative mbi të drejtat që lindin nga Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin Ballsh Hekal, lidhur midis Albpetrol dhe shoqërisë S...M (në atë kohë T...A);

-Ka caktuar ekspertë kontabël për vlerësimin e të drejtave që lindin nga Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin Ballsh Hekal;

-Ka vendosur vlerën e sendit, bazuar kjo në raportin e vlerësimit të ekspertit;

-Lajmërim për shitjen e sendit të sekuestruar dhe të vlerësuar;

-Shpallje për shitje të sendit të luajtshtëm në ankand;

-Vendim për caktimin e vlerësimit të ri të sendit pas dështimit të ankandit të parë;

-Shpallje për shitje të sendit të luajtshtëm në ankandin e dytë.

Pas procesit të Ankandit të dytë, të zhvilluar në datë 26.7.2017, fitues i këtij ankandi është shpallur shoqëria A...L G...S, me oferte 700,000 (shtatëqind mijë) USD, në këtë mënyrë kësaj shoqërie i kaluan të drejtat e lindura nga Marrëveshja Hidrokarbure për zhvillimin e hidrokarbureve për vendburimin Ballsh Hekal. Në datën 02.10.2017, me shkresën nr. 270 përmbauesi gjyqësor A. V, ka urdhëruar kalimin e të drejtave të shoqëria A...L G...S Sha.

-Lidhur me firmosjen e Instrumentit të Transferimit, nga ana e Albpetrol ShA ky dokument është firmosur nga z. A. H, i autorizuar nga administratori z. E. P, me shkresën nr. 6600 prot., datë 04.10.2017, për periudhën kohore 03.10.2017-09.10.2017.

Nga shqyrtimi i dokumentit të "Instrumenti i Transferimit", në faqen e parë ka si datë vetëm vitin 2017 dhe në pjesën e fundit përfaqësuesi i AKBN në anë të nënshkrimit ka vënë dhe datën 02.05.2018. Sipas deklaratës së z. A. H, ka komunikuar me z. E. P, lidhur me urdhrin e përmbauesit dhe se e ka firmosur "Instrumentin e Transferimit". Instrumenti i Transferimit është firmosur nga Albpetrol ShA, pa kryer një vlerësim nëse shoqëria A... ShA i plotësonte kushtet teknike dhe financiare për marrjen në dorëzim të vendburimit. Këshilli Tekniko Shkencor është mbledhur më datë 20.10.2017 për dhënien e mendimit, pra pas firmosjes së dokumentit.

Firmosja e Instrumentin të Transferimit u krye në kushtet kur shoqëria A...L nuk kishte vënë në dispozicion dokumente e dëshmi të arsyeshme për kompetencën teknike dhe financiare, veprim në kundërshtim me pikën b, të nenit nr. 16, të marrëveshjes hidrokarbure. ((b) Personi te cilit i behet transferimi do t'i paraqesë Albpetrol ShA dëshmi te arsyeshme te kompetencës se tij e teknike dhe/ose financiare).

-Lidhur me të dhënat që ka përdorur për vlerësimin e vlerës reale të të drejtave të lidhura nga Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin Ballsh Hekal, nga informacioni i disponuar në Albpetrol ShA, u konstatua se përmbauesi A. V, nuk ka kërkuar me shkresa të protokolluara të dhëna ekonomiko financiare për vendburimin Ballsh-Hekal. Gjithashtu për shoqërinë T...A, nuk mund të shprehemi, por duke u nisur nga korrespondenca që ka pasur me Albpetrol ShA, kanë kërkuar për marrjen e vendburimit deri në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2018, kur AKBN vendosi kalimin e të drejtave, pra nuk kishin interesa tu jepnin informacione për vend burimin. Të drejtën e auditimit dhe kontrollit të marrëveshjes e ka Albpetrol ShA dhe AKBN, por këto janë njoftuar me shkresat e përmbauesit A. V, pasi procesi i vlerësimit të ekspertit kishte përfunduar.

Të dhënat ekonomiko financiare të përdorura nuk janë të konfirmuara nga burimet zyrtare si dhe jo të vërteta për të nxjerrë një vlerë reale.

Në lidhje me sasinë e naftës që pretendohet se është dhënë tepër sqarojmë: Nga informacionet e marra nga Albpetrol ShA, si praktikë që përdoret marrja e PPE, (prodhimit para-ekzistues, pra

prodhimi që kishte Albpetrol ShA para se ta merrte shoqëria kontraktore), del si detyrim çdo fund muaji, kur palët bëjnë rakordimet dhe nxjerrin detyrimet përkatëse. Situata në vendburimin Ballsh Hekal ishte se për arsye të mos hapjes së magazinës fiskale nga T...A, Albpetrol ShA mbante gjendje sasinë e naftës që i takonte shoqërisë T...A dhe ka pasur korrespondencë për kompensimin e mos dhënies së sasive të naftës nga vendburimet e tjera që kjo shoqëri i detyrohej Albpetrol ShA. Në nenin 3.5 të marrëveshjes hidrokarbure, ku përcaktohet mënyra e marrjes së prodhimit, citohet “prodhimi i gjykuar”, që pasi nxirret nafta, bëhen llogaritë se sa i takon Albpetrol ShA. Pra koncepti i “*dhënies tepër*” nuk ekziston në asnjë paragraf të kontratës hidrokarbure.

Sasinë 15,418 ton shoqëria Albpetrol ShA e ka mbajtur si produktin e shoqërisë T...A dhe nuk kishte bërë ndonjë marrëveshje se kjo sasi ishte *paradhënie për vitet e ardhshme 2018-2019 për prodhimin që duhej dorëzuar*.

Gjendja e detyrimeve debitore e kreditore e Albpetrol SHA me T...K është 16 milion USD debi të T...K ndaj Albpetrol ShA, dhe sasia e naftës prej 15,418 ton e nxjerrë me tepër se sa detyrimet në vendburimin Ballsh Hekal.

Në veprimet e veta drejtimi i Albpetrol ShA duhet të kompensonte vlerën e 15,418 ton të naftës tepër në balancë me detyrimet që T...K kishte.

Përmbauesi A. V, me anë të aktit të ekspertit ka vlerësuar të drejtat dhe detyrimet e marrëveshjes Ballsh Hekal, (*gjithnjë sipas interpretimit të tij pasi në asnjë nen të marrëveshjes hidrokarbure Ballsh Hekal, nuk përmendet sasi e dhënë tepër por bëhet fjalë për detyrim mujor, pra sasia tepër i takon shoqërisë T...K,*) dhe duke marrë vlerën 3,198,063 Usd të sasisë 15,418.6 ton naftë, (me çmimin e vlerësimit të një ankandi të kryer në vitin 2017, këtë vlerë duke e ulur me vlera investimesh të pakryera nga të dhëna jo të zyrtarizuara dhe vetëm për vitin 2017 në vlerën 1,845,987, kosto abandonimi në vlerën 350,000 USD), duke i dhënë shoqërisë fituese të ankandit A...L pretendimin të mos i japë Albpetrol ShA sasinë e naftës që i takojnë nga marrëveshja hidrokarbure për vitet 2018-2019, deri në plotësimin e sasisë 15,418 ton.

Në thelb përmbauesi ka marrë detyrimin e Albpetrol ShA 15,418 ton, me vlerë 3,198,063 USD, e ka ulur deri në 700,000 USD, deri në shitje, duke futur dhe debitorë të tjerë që kishte T...K dhe në fund i ka likuiduar Albpetrol një vlerë rreth 216,000 USD dhe duke lënë problematikën e mos marrjes së sasisë së naftës që i takon nga marrëveshja hidrokarbure.

Përmbauesi privat A. V, megjithëse kishte lidhur kontrata shërbimi me Albpetrol ShA, për zbatimin e titullit ekzekutiv për faturat tatimore të shitjeve nr. 29 datë 06.06.2014, nr. 48, datë 12.08.2014, nr. 49, datë 12.08.2014, dhe nr. 50, datë 12.08.2014, të cilat së bashku kanë vlerën 16,519,262 USD, me përfitues Albpetrol ShA dhe debitor shoqëria T...A, për të cilat është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr. 4061 date 20.06.2016, i korrigjuar me urdhrin Nr. 320, date 06.03.2017 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka bllokuar dhe nxjerrë në ankand një aktiv (sasinë e naftës prej 15,419.6 tonë), detyrim të Albpetrol ShA ndaj T...A.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqe 235-261 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

40.1.Rekomandim: Drejtimi i shoqërisë të marrë masat për vlerësimin e situatës dhe të vazhdojë me veprimet e mëtejshme për anulimin e detyrimit që pretendon shoqëria A...L ShA, për sasinë e produktit naftë prej 15.418 ton. Drejtimi i shoqërisë të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për kundërshtimin e veprimeve të përmbauesit privat, të cilat kanë çënuar aktivet e shoqërisë.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. A.T, z. K. C. dhe E. D., me detyre Administrator i shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

41.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Albpetrol ShA ka shpenzuar vlerën 864,077 lekë për ndihmë ushqimore për 360 familjet e jetimëve të Shoqatës Kombëtare të Jetimëve”, Qarku

Fier. Për këtë sponsorizim nga grupi i auditimit u konstatua se përcaktimi i vlerës së fondit limit nuk është bërë mbi bazën e asnjë prej mënyrave që përcakton LPP, por për mallin e marrë është kryer pagesë direkt te operatori ekonomik, duke shmangur procedurat e prokurimit publik, dokumentacionin për hyrje-dalje në magazinën e Albpetrol, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30, datë 27/12/2011 të MF “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 , faqe 72-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

41.1.Rekomandim: Nga Albpetrol SHA në rastet e kryerjes së shpenzimeve për blerje malli, apo shërbimi, të zbatohen procedurat që përcakton kuadri rregullator në fuqi për llogaritjen e fondit limit dhe për procesin e hyrjes dhe daljes së mallit nga magazina.

Menjëherë dhe në vijimësi

Grupet e punës veprojnë në përputhje të plotë me kuadrin rregullator sa i përket përlllogaritjes së fondit limit duke zbatuar me përpikmëri të gjitha fazat që detyron legjislacioni i prokurimeve. Gjithashtu pas lidhjes së kontratës për cdo rast ngrihet grupi i punës për marrjen në dorëzim të mallit ose shërbimit i cili kryen të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me hyrje daljet e mallit nga magazina.

Rekomandimi është realizuar

42.Gjetje nga auditimit: Prej vitit 2003 Albpetrol ShA zotëron të drejtën e furnizimit dhe tregtimit me energji elektrike të klientëve të kualifikuar, por nuk ka lidhur kontratë furnizimi të energjisë elektrike me kontraktorët.

Albpetrol ShA ka 78 kontrata të lidhura me O...E për furnizimin me energji elektrike, pjesa më e madhe e të cilave furnizojnë zonat ku nxirret produkti naftë nga kontraktorët e marrëveshjeve hidrokarbure dhe nga vetë shoqëria.

Nga auditimi rezulton se detyrimet e pa likuiduara për energjisë elektrike të kontraktorëve ndaj Albpetrol ShA janë 1,260,615,465 lekë. Përveç kësaj, Albpetrol ShA ka edhe detyrime të veta të akumuluar ndaj O...E .

-Në pasqyrat financiare të hartuara nga shoqëria nuk është paraqitur vlera e kamatëvonesave të mos pagesave të faturave të O...E . Detyrimi i principalit është në vlerën 1,170,520,570 lekë dhe kamatëvonesat në vlerën 1,323,265,398 lekë.

Lidhur me detyrimet deri më 31.10.2021, të dërguara nga O...E , shpjegimet nga departamenti i financës për Albpetrol janë: Nga faturimet e O...E kërkesa për arkëtim është 2,445,792,267 lekë principal, ndërsa sipas Albpetrol ShA detyrimi principal në bazë të kontratave të lidhura është 1,911,456,951 lekë, pra me një diferencë midis këtyre dy vlerave prej 534,335,316 lekë, e cila përbëhet nga: 204,001,347 lekë shpenzime për mirëmbajtje rrjeti dhe humbje në rrjet, të cilat O...E nuk ja njeh shoqërisë Albpetrol ShA; 76,286,839 lekë fatura të shoqërisë T...C të cilat O...E ja faturon shoqërisë Albpetrol ShA; 245,188,000 lekë janë likuidime të bëra në muajin nëntor 2021 për faturat shtator dhe tetor.

Totali i kamatëvonesave që janë llogaritur në sistemin e O...E është në vlerën 1,909,362,631 lekë, e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Albpetrol ShA, ka ardhur nga mos pagesa në kohë e faturave të energjisë elektrike.

42.1.Rekomandim: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në cilësinë e pronarit aksionar) të marrë masa për analizimin e situatës së krijuar me detyrimet e Albpetrol SHA ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA për energjinë elektrike. Të vlerësojë kalimin e rrjetit transmetues të energjisë elektrike tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ShA dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal ShA në mënyrë që kontraktorët e marrëveshjeve hidrokarbure të lidhin kontrata direkt me furnizuesin kryesor të energjisë elektrike mbi bazën e kuadrit rregullator përkatës, duke eliminuar në këtë mënyrë mosmarrëveshjet që Albpetrol ShA ka me O...E për çështjen e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit, si dhe mosmarrëveshjet midis kontraktorve të marrëveshjeve hidrokarbure me Albpetrol ShA.

Deri më 30.9.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. K. C. dhe E. D., me detyre Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

43. Gjetje nga auditimi: Referuar situatës së krijuar të pandemisë COVID-19 procesi i ristrukturimit është pezulluar me vendimin nr. 6, datë 29.04.2020, të Këshillit Mbikëqyrës duke e shtyrë afatin e njoftimit deri në një vendim të dytë dhe sipas vendimit punonjësit të cilët preken nga procesi do të trajtohen me pagën e luftës. Me shkresën nr. 1821 prot., datë 30.03.2020, Administratori i Shoqërisë ka hartuar një plan masash shtrënguese në kuadër të shpalljes së gjendjes emergjente për shkak të pandemisë së COVID-19. Me shkresën nr. 1821/1 prot., datë 01.04.2020, nga Administratori i Shoqërisë janë njoftuar Drejtoritë dhe qendrat e prodhimit në varësi të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për zbatimin e planit të masave sipas përcaktimeve përkatëse. Referuar planit të masave është parashikuar ndër të tjera:

Reduktimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore (brenda datës 06.04.2020), reduktimi i shpenzimeve për dieta dhe orët jashtë orarit (nga data 01.04.2020), aplikimi i lejes së zakonshme për vitin 2020 (brenda datës 03.04.2020), pezullimi i këshillave teknik dhe ndalimi i pagesave të tyre (duke filluar nga data 01.04.2020), shfuqizimi i dhënies së shtesave mbi pagë për komisionet e drejtoritë përkatëse (menjëherë), reduktimi i konsumit të karburantit të programuar për muajin prill (duke filluar nga data 01.04.2020), kryerjen e inventarit fizik të mallrave gjendje në magazinë (brenda datës 10.04.2020), etj.,. Me shkresën nr. 2521 prot., datë 28.04.2020, Administratori i Shoqërisë G. G i ka paraqitur Këshillit Mbikëqyrës një relacion mbi reduktimin e pagave të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos ku është paraqitur dhe një plan masash shtrënguese në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Referuar shkresës nr. 1821/1 prot., datë 01.04.2020, mbi planin e masave shtrënguese janë parashikuar ndryshime në fondin e pagave. Gjithashtu referuar kushteve të pandemisë është kërkuar:

1. Reduktimi i pagave të punëmarrësve të shoqërisë, për një periudhë të pacaktuar, deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisë me këto detaje:

- Uljen e pagës bazë me 60% për punëmarrësit e administratës qendrore dhe administratës së qendrave të prodhimit të cilët vazhdojnë punën në zyrë (sipas listës që miraton Administratori) por që, kjo listë u kërkuar dhe nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit.
- Elementë të pagës për punëmarrësit e administratës qendrore dhe administratës së qendrave të prodhimit do të jenë, paga bazë dhe shtesa për vjetërsi.
- Punëmarrësit e terrenit, ata të cilët lidhen drejtpërdrejtë me prodhimin, nuk preken nga ky vendim dhe vazhdojnë të përfitojnë të njëjtat të drejta në pagë.
- Trajtimin me pagën e luftës të punëmarrësve të administratës të cilët qëndrojnë në shtëpi sipas grafikëve të miratuar nga Administratori.
- Trajtimi me pagën e luftës të punëmarrësve të terrenit kur qëndrojnë në shtëpi, sipas grafikut të miratuar nga Administratori.

2. Pezullimin e ristrukturimit dhe shtyrjen e afatit të njoftimit deri në një vendimmarrje të dytë. Këta punëmarrës të trajtohen me pagën e luftës.

3. Të gjitha shtesat mbi pagë të cilat janë aplikuar me vendim administratorësh ndër vite shfuqizohen. Çdo vendimmarrje Administratorit për shtesë elementësh mbi pagë miratohet në Këshillin Mbikëqyrës.

4. Të mos lejohen orët jashtë kohës normale të punës si dhe pezullohen pagesat për dietat për punëmarrësit e Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos deri në një vendimmarrje të dytë.

5. Efektet financiare të reflektohen në programin ekonomik të vitit 2020.

Për sa më sipër është kërkuar shqyrtimi dhe miratimi e draftit mbi reduktimin e pagave të punonjësve dhe efektet e tij të shtrihen nga data 01.04.2020, për një periudhë minimale 3 muaj, deri në rikthimin e situatës financiare të shoqërisë në normalitet. Ky reduktim do të sjellë një

zvogëlim të fondit të pagave dhe të fondit të kontributit të sigurimeve shoqërore. Me Vendimin qarkullues nr. 6, datë 29.04.2020, të Këshillit Mbikëqyrës është vendosur miratimi i pikave të mësipërme dhe “Ulja e pagave të punëmarrësve të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për një periudhë të pacaktuar deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të Shoqërisë. Gjithashtu ndër të tjera në pikën 5 të tij, është vendosur që ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 01.04.2020. Vendimi qarkullues është nënshkruar nga E.B Kryetar, dhe anëtarët E.M, I. G., A.G dhe L.O. Vendimi i mësipërm në pikën 5 të tij citon për shtrirjen e efekteve për muajin prill ndërkohë që vendimmarrja është në fund të muajit prill, pra ky vendim është një akt absolutisht i pavlefshëm pasi bie ndesh me të drejtat e pagës për punonjësit e shoqërisë, Kodin e Punës, Kontratën Kolektive të Punës dhe kontratën individuale të punonjësve.

Me Urdhrin nr. 114, datë 08.05.2020, administruar me shkresën nr. 2684 prot., datë 08.05.2020, të Administratorit të Shoqërisë G. G, është urdhëruar vënia në zbatim e Vendimit nr. 06, datë 29.04.2020, të Këshillit Mbikëqyrës vendim i cili duhet të ndiqet dhe zbatohet nga nëpunësit e administratës qendrore dhe qendrave të prodhimit në varësi të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos. Vendimi i marrë nga Këshilli Mbikëqyrës në gjykimin e grupit të auditimit është një akt i cili bie ndesh me marrëdhëniet e punës e konkretisht me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Kontratën Kolektive të Punës së Shoqërisë, kontratën individuale të çdo punonjësi pasi:

- Një vendim i tillë nuk mund të ketë efekte prapavepruese pasi cenon drejtpërsëdrejti pagën në një kohë kur puna është kryer për atë muaj dhe nuk mund të reduktohet me 60% të pagës bazë për punonjësit e administratës së qendrore dhe administratës së qendrave të prodhimit.

- Gjithashtu vendimi ka përcaktuar reduktimin me 60% të pagës ndërkohë që referuar tabelës së miratuar të pagave rezulton se, në administratën e disa qendrave ka dhe paga të cilat nëse reduktohen, cenojnë pagën minimale të miratuar prej 26,000 lekë të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, pika 1.

- Vendimi i marrë cenon parimin e mirëbesimit ku palët duhet të informojnë njëri tjetrin për ndryshimet përkatëse parashikuar në nenin 11/1, nenin 12, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Bazuar në kodin e punës, punëdhënësi ka detyrimin të paguajë punëmarrësit pagën sipas kontratës kolektive dhe kontratës individuale. Përsa i përket zbritjeve nga paga për tatimin mbi të ardhurat apo pagesën për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, punëmarrësi, është i detyruar të paguajë kontributet sipas kontratës individuale mbi pagën bazë të miratuar për pozicionin e punës ku punëmarrësi kryen detyrën e tij, pasi ndikon drejtpërsëdrejti në rastet e llogaritjes së masës së pensionit, rastet e paaftësisë në punë, lejet e lindjes etj, referuar Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Reduktimi i pagës me 60%, sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës i cili konsiston në faktin se do të trajtohen dhe preken vetëm punonjësit e administratës qendrore dhe administratës së qendrave të prodhimit, *konsiderohet nga grupi auditues si diskriminues dhe një veprim jo i barabartë* për shtrirjen e efekteve të tij vetëm në një pjesë të punonjësve të Shoqërisë i cili bie ndesh me Kodin e Punës dhe Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Sa i përket vendimmarrjes rezulton se, drejtimi i Shoqërisë nuk ka pasur diskutime dhe nuk është informuar me përfaqësuesit e Sindikatës së Naftëtarëve të Shqipërisë konfirmuar kjo edhe nga Konstandin Kina kryetari i Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptar.

- Njëkohësisht ky veprim do të sjellë edhe pasojë financiare në rast se punonjësit të cilët janë prekur nga ky vendim do të drejtohen organeve gjyqësore për fitimin e të drejtës mbi pagën, dhe do të sillte një efekt financiar për shoqërinë si pasojë e shpenzimeve gjyqësore, pagesat e mbrojtësve përfaqësues (Avokatëve), shpenzimet përmbartimore si dhe interesat për shumën e pa paguar që mund të gjenerohen nëse do të kërkohen në gjykatë nga punonjësit. Kjo situatë do të sjellë edhe

pasoja akoma më të mëdha duke tejkeluar dhe përfitimin që Shoqëria të cilat nuk mund të llogariten apo parashikohen nga grupi i auditimit.

- Gjendja likuide e aktiveve monetare të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në llogaritë bankare është në shumën totale prej 502,049,060 lekë në fund të muajit mars 2020, në shumën 331,103,454 lekë në fund të muajit prill 2020 dhe në shumën 263,946,141 lekë në fund të muajit maj 2020, në shumën 230,999,085 lekë në fund të muajit qershor 2020, *fakt i cili nuk mund të justifikojë reduktimin e pagave si pasojë e vështirësisë financiare për përmbushjen e detyrimeve ndaj marrëdhënieve të punës së punonjësve të shoqërisë.*

Sipas pretendimeve të cilat shtrohen në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës se reduktimi i pagës me 60% bëhet për përballimin e situatës financiare është një fakt i pa argumentuar dhe justifikuar mbi një analizë financiare duke qenë një shumë jetike për familjarët e punonjësve të shoqërisë dhe nuk ka ndikim të të madh për rregullimin e situatës financiare të saj.

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nuk ka të përcaktuar aftin e përfundimit të efekteve të këtij vendimi, duke e bërë të paqartë këtë vendimmarrje, i cili parashikon që reduktimi i pagave të punëmarrësve të Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos do të zgjasë për një periudhë të pacaktuar deri në kthimin në normalitet të situatës financiar. Referuar listë pagesave rezulton se punonjësit e Administratës në disa qendra janë paguar për muajin maj 2020, në kundërshtim me vendimin e KM pa asnjë urdhër të drejtimit të shoqërisë. Nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë marrë masat e duhura për garantimin dhe zbatimin e urdhrave me karakter financiar lidhur me ligjshmërinë e realizimit të shpenzimeve për veprimtarinë ekonomiko-financiare të Shoqërisë, konkretisht për pagat e kryera për Administratën e qendrave, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 11/1, neni 12, Ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, pika 1, Kontratën Kolektive të Punës të Shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 22-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

43.1. Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë, të marrë masat e duhura për të revokuar vendimin e marrë mbi reduktimin e pagave ndaj punonjësve të administratës qendrore dhe administratës së qendrave të prodhimit. Gjithashtu në përmbushje të detyrimeve të kontratave me punonjësit, të marrë masat e duhura për të kompensuar pagat e reduktuara.

Deri më 30.06.2022

Rekomandimi i mësipërm nuk është pranuar nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albpetrol sha. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi Këshilli Mbikëqyrës i përbërë nga z. I. G., Kryetar, z. E.B, znj. E.M, znj. L.O, anëtarë.

Rekomandimi nuk është realizuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Administratori i Albpetrol ShA Patos**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi Zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **346,696,708 lekë** si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Albpetrol ShA pas realizimit të ankandit për shitjen e naftës bruto në sasinë 75,101 ton, ka nënshkruar kontratën nr. 4902 prot. datë 22.05.2019

me objekt “Shitja e produktit hidrokarbur (naftës bruto) sasia 75,101 ton”, me subjektin blerës A...L ShA. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi realizimin e kontratës rezulton se:

-Subjekti blerës A...L ShA ka bërë sigurimin e kontratës nëpërmjet formularit të sigurimit të kontratës me nr. serial 71466660, më datë 21.05.2020, në formën “garanci sigurimi” pranë kompanisë së sigurimit A....G, në shumën prej 328,107,588 lekë (10% të vlerës totale të kontratës prej 3,281,075,873 lekë me TVSH), për blerjen e sasisë prej 75,101 ton naftë bruto, e cila është llogaritur dhe përcaktuar nga komisioni i ankandit sipas të dhënave të datës 14.05.2019 të kursit zyrtar të këmbimit valutor dhe informacionit të çmimeve të karburanteve të datës 14.05.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, botuar në buletin e prokurimeve publike nr. 20, të datës 20.05.2019 (*vlera e sig. = 36,407.37 leke/t * 1.2 * 75,101t*).

Vlera totale e kontratës në lekë do të ndryshojë në varësi të çmimit Brent dhe kursit ditor të konvertimit të monedhës në dollar, ditën që realizohet shitja nga QSHANG Patos. Afati i realizimit të kontratës është përcaktuar 270 ditë, nga data e nënshkrimit të saj. Shoqëria Albpetrol ShA ka llogaritur si afat të përfundimit të kontratës datën 22.02.2020. Kontrata ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj, pra më datën 22.05.2019 me afat zbatimi 270 ditë, pra kontrata e lidhur midis Albpetrol dhe shoqërisë A...L për blerjen e naftës bruto ka përfunduar më datën 16.02.2020. Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Shitjeve, zbatimi i kontratës nga ana e subjektit blerës A...L ShA, për sasinë 75,101 ton naftë bruto, është realizuar në masën 90.16% të sasisë totale të kontraktuar. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Shitjeve, për periudhën nga data 22.05.19 deri 16.02.2020, sasia e pa tërhequr e naftës bruto nga subjekti A...L ShA është 7,442 ton ose 9.84% e sasisë totale. Bazuar në të dhënat e bilancit të naftës, shitja e fundit e bërë nga QASHNG-Patos për subjektin A...L ShA, brenda afateve kohore të realizimit të kontratës është kryer në datën 11.02.2020.

-Ish administratorja e shoqërisë Albpetrol ShA znj. E.M me shkresën 936/1 datë 12.02.2020 drejtuar MIE, ka konfirmuar që sasia e pa tërhequr në magazinat fiskale të stokimit është 7,442 ton nga subjekti blerës A...L ShA deri më datë 11.02.2020.

-Shoqëria A...L ShA në datën 14.02.2020 (dy ditë para përfundimit të kontratës) në referim të nenit 7 të kontratës, me shkresën nr. 1001 datë 14.02.2020, ka kërkuar amendimin e kontratës me 30 ditë duke siguruar kompaninë Albpetrol ShA për realizimin me sukses të kontratës nr. 4902 prot., datë 22.05.2019 me objekt "Shitje e produktit hidrokarbur (naftë bruto), sasia 75 101 ton". Nuk janë kryer veprime konkrete nga Albpetrol ShA në përgjigje të kërkesës së mësipërme të bërë nga A...L ShA për shtyrje të afatit të kontratës.

-Kontrata e shitjes së naftës me subjektin “A...L” ShA rezulton si një kontratë jo e suksesshme, e cila nuk është realizuar tërësisht, por në masën 90.16% të saj.

Ish administratorja znj. E.M, si përfaqësuese e shoqërisë Albpetrol ShA me palët e treta, lidhur me situatën e mos tërheqjes së sasisë së plotë të naftës së kontraktuar me A...L ShA, duke analizuar kërkesën e subjektit për shtyrje të afatit të kontratës duhet të ndërmerre dy hapa:

1- Të pranonte kërkesën për shtyrje afati duke mundësuar shitjen e sasisë së mbetur të naftës e pa tërhequr. Ish Administratorja E.M ka pasur mundësinë e amendimit të kontratës me 30 ditë, në referim të nenit 7 të kontratës dhe nenit 23.3. të Dokumenteve Standard të Ankandit (DSA) mbi bazën e kërkesës së subjektit A...L ShA.

2- Të mos pranonte kërkesën për shtyrje afati duke e mirë argumentuar mospranimin, pasi një çështje të tillë shoqëria A...L ShA mund ta dërgonte për gjykim në Gjykatën Shkallës së Parë dhe më pas të kërkonte marrjen e sigurimit të kontratës për mos realizim me sukses.

Ish Administratorja e Albpetrol ShA nuk ka kryera asnjë nga veprimet e mësipërme.

Administratori i shoqërisë znj. E.M, si organi më i lartë ekzekutiv i shoqërisë, i cili administron, drejton dhe përfaqëson shoqërinë lidhur me vënien në zbatim të politikave tregtare, duhej të kërkonte nga shoqëria e sigurimit, transferimin në llogarinë e shoqërisë Albpetrol ShA të vlerës 328,107,588 lekë të sigurimit të kontratës, si kompensim për mosrealizimin e kontratës nga kontraktuesi A...L ShA, sipas përcaktimeve të kontratës nr. 4902 prot. datë 22.05.2019 “Shitja e produktit hidrokarbur (naftës bruto) sasia 75,101 ton” neni 4 pika 4.3 të kontratës, ku thuhet: “shuma e sigurimit të kontratës duhet t’i paguhet autoritetit shitës si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës”.

Mos kërkimi nga Albpetrol ShA për transferimin në llogarinë e vet të vlerës së sigurimit të kontratës nga shoqëria A...L ShA, ka sjellë si pasojë dëm ekonomik në vlerën 328,107,588 lekë.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 4 pika 3, neni 7, neni 11 pika 6 të Kontratës nr. 4902 prot., datë 22.05.2019 “Shitja e produktit hidrokarbur (naftës bruto) sasia 75,101 ton”, pika 23.3. e Dokumenteve Standard të Ankandit (DSA), neni 55 pika 9 II, neni 55 pika 4, neni 63 i rregullores së brendshme të shoqërisë Albpetrol ShA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 163-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandim: Nga administratori i shoqërisë Albpetrol sha të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **328,107,588 lekë**, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

Deri më 30.06.2022

Qëndrimi i subjektit: Është vendosur kërkimi i vlerës prej 9.84% të kontratës si të porealizuar ndaj shoqërisë A...L sha nëpërmjet rrugës ligjore, duke ju drejtuar Gjykatës me padi shpërblimi dëmi.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi nga Drejtoria e Ceshtjeve Ligjore dhe Përfaqësimit. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. A.T, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se: Me urdhrin nr. 9038 prot, datë 07.10.2019 të Administratorit të Shoqërisë E.M është ngritur grupi i punës për përzgjedhjen e kandidatëve pjesëmarrës të cilët do të përzgjidhen si ekspertë të jashtëm për hartimin e paketës rregullore të shoqërisë.

-Referuar dokumentacionit të bankës rezultoi se janë kryer shpenzime për 6 kontrata me nga 956,250 lekë secila pagesë, të lidhura me persona fizik për hartimin e rregullores së brendshme të shoqërisë dhe qendrave.

-Përzgjedhja është bërë, pa procedurë prokurimi, pa kritere përzgjedhje, pa llogaritje të fondit limit, duke përcaktuar vlerën për ditë pune 25,000 lekë për 45 ditë dhe për 4 prej ofruesve të shërbimit konstatohet se nuk rezultojnë si subjekt i regjistruar për fushën e veprimtarisë që ofron. Gjithashtu rezultoi se nuk ka dokumente për vënien në dorëzim të produktit definitiv nga ofertuesi, pra varianti përfundimtar i rregullores së brendshme të shoqërisë. Për secilën kontratë është nënshkruar që do të paguhet në shumën 1,125,000 lekë nga e cila do të mbahet tatimi në burim prej 15%, pra secili subjekt është paguar në shumën 956,250 lekë duke ju mbajtur vlera prej 168,750 lekë si tatim në burim. Shuma totale e shpenzuar prej 5,737,500 lekë (6 persona x 956,250 lekë) është kryer pa fatura tatimore, njëkohësisht nuk ka urdhër për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratave, si dhe asnjë dokumentacion për marrjen në dorëzim të shërbimit të kërkuar, veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator ligjor të prokurimit publik, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe udhëzimet përkatëse.

-Albpetrol ShA për përgatitjen e rregulloreve të brendshme nuk duhet të kontraktonte ekspertë të jashtëm. Shoqëria ka pasur rregullore të mëparshme, mbi bazën e së cilës duhet të bëheshin ndryshimet e nevojshme, pasi është detyrë e nëpunësit autorizues që nëpërmjet stafit të tij të hartojë rregullore dhe procedura të brendshme të shoqërisë.

Nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues, pagesa e ekspertëve të cilët janë kontraktuar për hartimin e paketës rregullatore të shoqërisë, në vlerën **5,737,500 milion lekë është bërë pa faturë tatimore.**

Për sa më sipër vlera prej 5,737,500 lekë konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e Albpetrol ShA.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 dhe 2, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 2, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 1, neni 2, neni 3 pika 2, neni 8, neni 9, neni 12, udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e njësive në sektorin publik”, i ndryshuar, pikat 34-36 dhe pika 42. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 72-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandim: Nga administratori i shoqërisë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës **5,737,500 lekë**, nga znj.E.M, znj.G.A, znj.K.M, znj.L.RR, znj.D.A, znj.J.N, znj.E.A. z.A.M.

Deri më 30.06.2022

Qëndrimi i subjektit: Me ngritjen e grupit të punës nuk është përgjegjësia e Administratorit të shoqërisë ndjekja e procedurave për sigurimin e shërbimit, por nga e grupit të punës së ngritur për këtë qëllim. Nga Drejtoria e Financës është përcjell Administratorit praktika e saktë/plotë për kryerjen e pagesës. Në asnjë rast nuk ka komunikim se po procedohet në mungesë dokumentacioni ose në kundërshtim me ligjin.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga ana e subjektit Albpetrol sha u vendos në dispozicion vendimi nr. 406., datë 05.10.2022 i Administratorit të Shoqërisë ku ka vendosur si të pabazuara gjetjet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke vendosur mospranimin e rekomandimit. Theksojmë se Administratori i Shoqërisë Albpetrol sha nuk ka asnjë kompetence ligjore për mos pranimin e rekomandimit të lënë nga ana e KLSH-së për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet si i papranuar dhe i pazbatuar. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. K. C., me detyre ish Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është zbatuar

3.Gjetje nga auditimi: Në vitin 2019 Albpetrol ShA Patos ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt “Blerje autoambulancë”, në të cilën është shpallur fitues operatori ekonomik: “M.....S, me vlerë 9,506,000 leke pa TVSh. Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nga autoriteti kontraktor është ndjekur metoda e çmimit të tregut, bazuar në marrjen e tre ofertave ekonomike, për dy prej të cilave nuk është dokumentuar korrespondenca e institucionit me ofertuesit. Referuar nenit 59 -Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave.

Referuar procedurave të prokurimit të zhvilluara nga autoritete të tjera kontraktore, në faqen zyrtare të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara (openprocurement.al), konstatohet se në datën 03.09.2018 është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Blerje autoambulanca për Shërbimin Kombëtar të Urgjencës Mjekësore”, për 30 copë autoambulanca (Data e hapjes së tenderit në Albpetrol” sha: 24.06.2019).

Sipas DST, në të dy rastet nga të dy autoritetet kontraktore është kërkuar e njëjta autoambulance, modeli A (specifikimet teknike si viti i prodhimit, modeli etj. përputhen tërësisht). Nga auditimi konstatohet se bazuar në deklaratën doganore vlera e mjetit të transportit (pa paisjet shëndetësore) që është përshtatur për autoambulancës, ka hyrë në doganë si mjet transporti i tipit New Ford Tranzit, në datën 23.01.2019, me vlerë 17,561 euro. Në vijim ky mjet është përshtatur për autoambulancë, por nuk ka të dhëna për vlerën e paisjeve mjekësore, pasi oferta është hartuar si paketë autoambulancë.

Në tenderin e zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (në të cilin janë blerë 30 autoambulanca), fondi limit për një autoambulancë ka vlerën 6,136,505 lekë pa TVSh, ndërsa fondi limit i llogaritur nga Albpetrol ShA është 9,800,000 lekë, i cili i shprehur në lekë është 3,663,495 lekë më shumë se vlera e fondit limit të llogaritur nga ABP, ose 37% më i lartë.

Oferta fituese në tenderin e zhvilluar nga ABP për autoambulancën ka vlerën 5,454,750 lekë pa TVSh, ndërsa oferta fituese në tenderin e zhvilluar nga Albpetrol sh.a Patos ka vlerën 9,506,000 lekë pa TVSh, ose 4,051,250 lekë më shumë se vlera e ofertës në ABP, shprehur në përqindje, 43% më e lartë.

Diferenca prej 681,755 lekë midis ofertës fituese dhe fondit limit në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, tregon se pavarësisht nga fondi limit, tregu ka ende rezerva në çmim, pra ka mundësi të ofrojë këtë mall me çmim akoma më të ulët. Ulja e çmimit prej 681,755 lekë midis fondit limit dhe vlerës së ofertës fituese, sigurisht që ka si efekt edhe faktin se nuk blihet një autoambulancë, por 30 copë, pra ka si efekt uljen e çmimit për shkak të shitjes me shumicë.

Në këto kushte në qoftë se nga Albpetrol ShA do të merrej si vlerë e fondit limit vlera e kontratës fituese prej 5,454,750 lekë pa TVSh, e korrektuar me vlerën prej 681,755 lekë (diferencë midis fondit limit dhe vlerës së ofertës fituese në ABP), korrektim i cili diktohet nga “shitja me shumicë” prej 30 copë në rastin e ABP, atëherë vlera e fondit limit nga Albpetrol ShA, do të ishte llogaritur 6,136,505 lekë pa TVSh. Pra “shitja me shumicë” prej 30 copë në rastin e ABP do të kompensohej me rritjen e fondit limit nga Albpetrol ShA (meqenëse është një autoambulancë), në vlerën prej 681,755 lekë pa TVSh mbi vlerën e ofertës fituese të ABP. Duke qenë se Albpetrol ShA ka pasur në dispozicion dy çmime të ndryshme nga dy burime të ligjshme, duhet të ishte zgjedhur ajo mënyrë e llogaritjes së fondit limit, e cila ofron kosto më të ulët. Nga Albpetrol ShA, në llogaritjen e fondit limit nuk është bërë një harmonizim i mënyrave që përcaktohen në nenin 59 -Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pra nga e gjithë analiza, gjykojmë se nga Albpetrol ShA, vlera e fondit limit për autoambulancën, nuk duhet të ishte llogaritur më e lartë se 6,136,505 lekë pa TVSh.

Për këtë arsye vlera prej **3,369,495 lekë pa TVSh** e shpenzuara mbi vlerën prej 6,136,505 lekë pa TVSh, **konsiderohet dëm ekonomik** për buxhetin e Albpetrol sh.a Patos, e cila është diferenca e vlerës së ofertës fituese prej 9,506,000 lekë në Albpetrol ShA, me vlerën e fondit limit prej 6,136,505 lekë pa TVSH, të llogaritur nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, e cila duhet të ishte marrë si referencë për vlerë të fondit limit nga Albpetrol sh.a Patos. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë jo në përputhje të plotë me nenin 59 -Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës. Nga Albpetrol ShA nuk janë mirë përdorur fondet publike, duke mos u plotësuar qëllimi i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i përcaktuar në nenin 1, pika (b). Fondet publike janë përdorur pa ekonomikitet dhe efikasitet, duke mos u plotësuar qëllimi i ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2, nenin 4, pika 9 dhe nenin 8, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 93-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Nga administratori i shoqërisë Albpetrol ShA të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,369,495 lekë**, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. A.T, me detyrë Drejtor i Ceshtjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga takimi ballafaques përmbyllës në KLSH me përfaqësuesit e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, ka dalë problematika se përpara periudhës objekt auditimit disa punonjës të Albpetrol ShA kanë marrë hua pa interes (paradhënie page) dhe një pjesë e tyre nuk kanë likuiduar të plotë ende vlerën e marrë, duke kaluar afatet e përcaktuar në kontratë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Shoqëria Albpetrol sh.a Patos për këtë çështje nëpërmjet postës elektronike u konstatuar se:

Në total për vitet 2014-2019 janë dhënë për punonjësit e Shoqërisë paradhënie page (3 deri në 5 paga mujore) pa interes për 67 raste, 52 prej tyre janë shlyer, 9 janë në proces shlyerje nga punonjësit që janë në marrëdhënie pune, 6 prej tyre nuk janë në marrëdhënie pune të cilët kanë mbetur detyrimin në shumën totale 2,408,353 lekë.

Punonjësit e larguar të cilët kanë detyrimin e mësipërm janë: z. E.SH për vlerën 633,000 lekë, z. F.E për vlerën 120,000 lekë, z. E.B për vlerën 223,042 lekë, z. A.D për vlerën 1,270,000 lekë, z. A.L për vlerën 97,311 lekë, z. L.V për vlerën 65,000 lekë.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se shuma e detyrime të pa shlyera nga ish-punonjësit e Shoqërisë në vlerën **2,408,353 lekë konsiderohet dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a Patos**. Në të gjitha rastet e dhëna paga paradhënie, nuk janë plotësuar kriteret për dhënien e tyre. Këto paga nuk janë dhënë për raste fatkeqësisë apo problemeve shëndetësore por referuar kërkesa të punonjësve për kushte të vështira ekonomike. Edhe në ato raste për të cilat punonjësi i referohet problemeve shëndetësore bashkëngjitur kërkesës nuk disponohet asnjë dokumentacion që e faktin këtë situatë.

Në 17 raste nuk disponohet kërkesa e punonjësve drejtuar Administratorit të Shoqërisë për paradhënie page apo kontratë huaje pa interes.

- Në 29 raste janë dhënë më shumë se tre paga paradhënie veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 116, pika 3.

Në 25 raste nuk specifikohet sa paga paradhënie i jepet punonjësit por vetëm vlera sa përfiton punonjësi të cilat variojnë nga 120,000 lekë deri në 800,000 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Nga Administratori i Albpetrol ShA dhe Drejtoria Ligjore të merren masat e duhura duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin i shumës **2,408,353 lekë** nga ish-punonjësit përfitues të kontratave të huave pa interes.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. A.T, me detyrë Drejtor i Cështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

5. Gjetje nga auditimi: Me vendimin nr. 139 datë 05.04.2019, administratori i shoqërisë ka miratuar kuotën mujore prej 700 litra/gazoil/benzine, ku tërheqja e kësaj sasive do të bëhet me tollona pranë magazinës së Albpetrol ShA nga drejtoria e përfaqësimit dhe koordinimit me institucionet. Në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për muajin maj, qershor, korrik, gusht, shtator dhe tetor viti 2019.

Me vendimin nr. 547 datë 19.11.2019, administratori ka shfuqizuar vendimin nr. 139 datë 05.04.2019 duke përcaktuar si kuotë mujore, për këshillin mbikëqyrës sasinë prej 400 litra/gazoil/benzinë. Në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për muajin nëntor, dhjetor viti 2019, janar, shkurt, mars, prill dhe maj 2020.

Me vendimin nr. 115, datë 24.06.2020, administratori i shoqërisë ka miratuar kuotën mujore prej 1000 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për muajin qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor viti 2020.

Të gjithë vendimet e sipërcituara baza ligjore e përdorur për dhënien e këtyre vendimeve nuk justifikon miratimin e dhënies së kuotës mujore me karburant për llogari të Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu në urdhër nuk është përcaktuar objekti dhe arsyeja e dhënies së sasisë së karburantit për Këshillin Mbikëqyrës dhe si do të justifikohet konsumi i karburantit të dhënë. Nga auditimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës nuk konstatohet të jenë kryer mbledhje në selinë e Shoqërisë Albpetrol ShA, por të gjitha mbledhjet në të cilat është marrë vendim për shoqërinë janë mbajtur në Tiranë.

Vendimi nr. 139 datë 05.04.2019, vendimi nr. 547 datë 19.11.2019 dhe vendimi nr. 115, datë 24.06.2020, bie në kundërshtim me:

Ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 160, pika 1, VKM nr. 570, datë 03/10/2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, pika 6. Për sa me lart, vlera e karburantit e përfituar nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës është në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqindhe nuk është parashikuar në asnjë akt rregullator, të shoqërisë Albpetrol ShA.

Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës nuk është mbajtur ose administruar pranë shoqërisë Albpetrol ShA asnjë dokumentacion justifikues ligjorë mbi dokumentimin e konsumit të karburantit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 10.

Karburanti është tërhequr nga magazina e Albpetrol ShA nga z. S.SH me detyrë drejtues mjete, z. I.B me detyrë dispeçer, z.L.O me detyrë drejtues mjete dhe z.A.O me detyrë ish anëtarë i Këshillit Mbikëqyrës.

Për sa më sipër nga magazina është tërhequr **vlera 2,126,154 lekë për të cilën mungon dokumentacioni justifikues dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol ShA.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandime: Administratori i Shoqërisë të marri masat për arkëtimin e vlerës **2,126,154 lekë** nga personat përgjegjës të cilët kanë tërhequr karburantin si dhe nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët bazuar në urdhrin e Administratorit vërtetohet se kanë konsumuar karburantin, sipas normativave të miratuara.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. A.T, me detyrë Drejtor i Ceshitjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë pagesave për muajt korrik 2019-dhjetor 2020, për administratën qendrore dhe qendrat e prodhimit rezulton se janë dhënë shpërblime për anëtarët e Këshillit Tekniko-Shkencor të Shoqërisë, nga të cilët 28 punonjës janë të administratës qendrore dhe 56 punonjës të administratave të qendrave të prodhimit sipas vendimit nr. 365, datë 02.12.2013, të Administratorit të Shoqërisë. Pagesa e tyre mujore është nga 2,000 lekë deri 10,000 lekë në muaj. Këto shpërblime janë dhënë në kundërshtim me ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 4, pika 3, ku përcaktohet: “Këshilli i Ministrave, sipas rastit, me propozimin e Ministrit të Financave, miraton shpërblimin e anëtarëve të këshillave, të bordeve ose të komisioneve të institucioneve qendrore, kur legjislacioni përkatës parashikon krijimin e një këshilli ose të bordit drejtues me të drejtë pagese në këto institucione”. Kjo problematikë është konstatuar edhe në auditimet e mëparshme të KLSH-së, për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse dhe përsëri rezulton e njëjta shkelje. Shuma totale e shpërblimeve për

anëtarët e Këshillit Tekniko-Shkencor për periudhën objekt auditimi është **2,121,091 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat e duhura dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës **2,121,091 lekë** nga punonjësit përfitues të administratës qendrore dhe qendrave të prodhimit (sipas listës në tabelën nr. 8 dhe 8/1, në aksin nr. 2, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit). Gjithashtu nga Administratori i Shoqërisë të nxjerrë akt administrativ për të revokuar vendimin nr. 365, datë 02.12.2013, të ish-Administratorit, me qëllim mos vazhdimin më tej të këtyre shpërblimeve.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. A.T, me detyrë Drejtor i Ceshitjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përputhshmërinë me kuadrin rregullator në fuqi të konsumin e karburantit u konstatua se nga Administratori i Shoqërisë me vendimin nr. 115, datë 24.06.2020 është miratuar plan shpërndarja për konsumin e karburantit për drejtoritë e administratës qendrore të shoqërisë.

Në këtë plan shpërndarje nuk janë dhënë argumente për arsyen e furnizimit me karburant të drejtorive përkatëse, arsye të cilat duhet të kenë lidhje me nevojën e kryerjes së detyrës funksionale të secilës drejtori, si dhe nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e përdorimit të karburantit (si kërkesa për mallin, objekti i shpenzimit, struktura miratuese, monitorimi i shpenzimit, vërtetimi i shpenzimit të karburantit etj.).

Për periudhën qershor-dhjetor 2020 nga struktura e administratës së Albpetrol ShA është tërhequr nga magazina sasia 12,600 litra, në vlerën 1,878,527 lekë. Strukturat të cilat kanë shpenzuar karburant në zbatim të urdhrit të mësipërm, si dhe personat të cilët kanë bërë tërheqjen e karburantit nga magazina janë: Drejtoria e Prokurimit: z. E.H sasia 300 litra në vlerën 45,376 lekë; Drejtoria e Burimeve Njerëzore: znj. J.M sasia 1,500 litra në vlerën 224,028 lekë; Drejtorinë e Administrimit të Pronës: z.S.SH sasia 1,500 litra në vlerën 224,028 lekë, z. S.P sasia 1,500 litra në vlerën 224,028 lekë; Drejtoria e Marketingut z. E.J sasia 500 litra në vlerën 74,676 lekë; Drejtoria e Informatikës dhe Inovacionit: z. I.P sasia 300 litra në vlerën 45,610 lekë, sipas të dhënave më të detajuara në tabelën nr.1, aneksi 6/1, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për konsumin e karburantit në sasinë **12,600 litra dhe vlerën 1,878,527 lekë** nuk u paraqit dokumentacion justifikues për të vërtetuar se shpenzimi i kësaj vlere është kryer me objekt pune që lidhet me nevojat e aktivitetit të shoqërisë, pra mungojnë dokumente si kërkesë për nevojën e furnizimit, program apo urdhër pune, urdhër shërbimi, fletë udhëtimi, etj. **Vlera 1,878,527 lekë konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 5-10, dhe pikat 35-36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 72-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandim: Administratori i Shoqërisë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,878,527 lekë**, nga personat të cilët kanë bërë tërheqjen e karburantit në magazinën e Albpetrol ShA, sipas listës së lënë nga KLSH në tabelën nr.1, aneksi 6/1, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Nëse në vijim vetë Albpetrol ShA nëpërmjet strukturës së auditit të brendshëm, apo dokumenteve të tjera, evidenton se vlera e mësipërme është përdorur edhe nga punonjës të tjerë, të marrë masa që prej tyre të zhdëmtohet vlera e përdorur, duke i shtuar këta persona në listën e lënë nga KLSH.

7.2. Rekomandim: Nga Administratori i shoqërisë, të merren masa që për çdo urdhër të nxjerrë për furnizim me karburant, të përcaktohet qartë qëllimi i përdorimit, i cili të jetë i argumentuar dhe të lidhet drejtpërdrejtë me domosdoshmërinë e kryerjes së aktivitetit të shoqërisë. Të përcaktohen rregulla të shkruara për furnizimin me karburant (procesi fillon me kërkesën nga struktura përkatëse për nevojën për karburant etj.), si dhe pas konsumit të plotësohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që vërteton shpenzimin e sasisë së tërhequr.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. A.T, me detyrë Drejtor i Ceshetjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

8.Gjetje nga auditimi: Në kontratën e lidhur midis Albpetrol ShA dhe “A....G” ShPK janë konstatuar problematikat si më poshtë:

- 1.Shfrytëzimit më të madh të truallit nga “A....G” ShPK, sesa nga ai i përcaktuar në kontratë.
- 2.Ndotje mjedisore për shkak të derdhjeve të naftës.
- 3.Shoqëria nuk ka dorëzuar asnjë dokument për të vërtetuara investimet e kryera në funksion të zhvillimit të aktivitetit, parashikuar kjo në kontratë.
- 4.Për të gjitha punimet e parashikuara në investimet sipas fazave përkatëse në kontratë, qiramarrësi nuk ka paraqitur leje ndërtimi për zhvillimin e projektit, të parashikuara në nenin 5.9 të kontratës. Këto problematika janë konstatuar nga njësia e monitorimit të kontratës dhe gjetjet e tyre i janë pasqyruar ish administratorit znj. E.M, me shkresën nr.9472, datë 22.10.2019, në raportimin për 6 mujorin e dytë mbi monitorimin e kontratës me shoqërinë “A....G “ ShPK, të ardhurat e realizuara nga kjo kontratë janë 918,000 lekë.

Për periudhën e auditimit këto problematika janë konstatuar nga njësia e monitorimit të kontratës dhe raportuar tek titullari. Është kërkuar informacion për këtë kontratë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 2016 prot., datë 21.02.2020, në përgjigje të së cilës Administratori i Shoqërisë Albpetrol ShA i ka informuar se: *Nga monitorimi i kësaj kontrate dhe nga dokumentacioni i sjellë ju informojmë se kjo shoqëri përveç vlerës së kontratës nuk ka përmbushur asnjë detyrim duke shkelur të gjitha nenet e kontratës si dhe shfrytëzon më shumë hapësirë funksionale nga ajo e përcaktuar në kontratë.*

Titullari i Shoqërisë Albpetrol ShA i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 1066 prot., datë 11.02.2021, ku informon se për këtë kontratë për vitin 2020 nga kjo shoqëri nuk është derdhur asnjë detyrim ndaj Albpetrol ShA, në kundërshtim me kontratën e lidhur. Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë shkresë që të jetë ndërmarrë ndonjë hap ligjor për këto shkelje të rënda të kontratës dhe marrjen e masave ndaj shoqërisë “A....G” ShPK, nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë apo nga shoqëria Albpetrol ShA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 67-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë Albpetrol ShA, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Adminstrimit dhe Ruajtjes së Pronës të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e vlerës **948,000 lekë** nga subjekti “A....G” ShPK, e cila konsiderohet **dëm ekonomik** për buxhetin e Albpetrol ShA, si dhe të kërkohet që “A....G” ShPK të zbatojë të gjitha detyrimet e tjera të përcaktuara në kontratë.

Me shkresën nr. 2870 prot., datë 06.04.2022, është kryer likuidimi i vlerës 948.000 lekë nga ana e A....G shpk. Rekomandimi do të konsiderohet i realizuar.

Rekomandimi është realizuar

8.2. Rekomandim: Në rast të mos arkëtimit të vlerës **948,000 lekë** nga subjekti “A....G” ShPK, apo moszbatimit të detyrimeve të tjera kontraktuale, ti propozohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe

Energjisë për zgjidhjen e kontratës, mbështetur në nenin 8, “Zgjidhja e Kontratës”, pika 8.2, germa c dhe d të kontratës.

Deri më 30.06.2022

Është bërë zgjidhja e kontratës nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Është nisur procesi gjyqësor me objekt: “Kthim sendi dhe pagimin e të gjitha detyrimeve dhe penaltiteve që rrjedhin nga kontrata”.

Rekomandimi është realizuar

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE

1.Gjetje nga auditimi: Vlera e faturimeve të energjisë elektrike që Albpetrol ShA ka të regjistruar në pasqyrat financiare, ndryshojnë në vlera të konsiderueshme me vlerat e faturuara nga O...E . Akt rakordimi i fundit që është kryer mes palëve është i datës 07.08.2014. Nga informacionet e kërkuara nga “Furnizuesi i Shërbimit Universal” ShA, lidhur me situatën debitore të Albpetrol ShA, u konstatuan diferenca të mëdha mes raportimeve të secilës palë.

-Në pasqyrat financiare të hartuara nga shoqëria nuk është paraqitur vlera e kamatëvonesave për faturat e pa likujduara në kohë. Sipas Albpetrol ShA, detyrimi i principalit është në vlerën 1,170,520,570 lekë dhe kamatë vonesat në vlerën 1,323,265,398 lekë, ose 113% më shumë se principal.

Lidhur me detyrimet deri më 31.10.2021 të dërguara nga O...E , shpjegimet nga departamenti i financës për Albpetrol ShA janë: Nga faturimet e O...E **kërkesa për arkëtim është 2,445,792,267 lekë principal.** Sipas Albpetrol detyrimi principal në bazë të kontratave të lidhura është 1,911,456,951 lekë, me një diferencë prej 534,335,316 lekë nga vlera që paraqet O...E . Kjo diferencë përbëhet nga: 204,001,347 lekë shpenzime për mirëmbajtje rrjeti dhe humbje në rrjet të pretenduara nga Albpetrol, por të panjohura nga O...E ; 76,286,839 lekë fatura të shoqërisë T...K të cilat O...E ja faturon Albpetrol; 245,188,000 lekë janë likuidime të bëra në muajin nëntor 2021 për faturat shtator-tetor.

Totali i kamatëvonesave që janë llogaritur në sistemin e O...E është në vlerën 1,909,362,631 lekë, e cila ka ardhur nga mos pagimi në kohë i faturave të energjisë elektrike dhe konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e Albpetrol ShA. Kamatëvonesat përbëjnë 78% e vlerës së principalit.

Drejtimi i shoqërisë duhet të paraqiste në pasqyrat financiare kamatëvonesat që ka akumuluar nga mos pagesat e faturave të O...E , për të dhënë me besueshmëri situatën ekonomike të Albpetrol ShA.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr.9228, d/atë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare parimet dhe përbërësit e pasqyrave financiare”, neni 9, neni 18;

-Kudrin konceptual për raportimin financiar, pjesa për paraqitjen besnike;

-Ligjin 10296, datë 8.7.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

-Nenin 10 të kontratës me O...E për jo familjar, kamatëvonesa për pagesë të vonuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për likuidimin e faturave të energjisë elektrike në afatet e përcaktuara nga kuadri rregullator në fuqi, për të mos krijuar kamatëvonesa, të cilat rëndojnë artificialisht buxhetin e institucionit.

1.2.Rekomandimi: Për arsye se shitësi i energjisë dhe blerësi kanë vlera të ndryshme për detyrimin që Albpetrol ShA ka për energjinë elektrike, të kryhet rakordim me operatorin e enegjisë elektrike për këto detyrime për të zgjidhur mosmarrëveshjet për vlerën e diskutuar.

1.3.Rekomandimi: Të hartohet një plan emergjent për shlyerjen e të gjitha detyrimeve që Albpetrol ShA ka për energjinë elektrike, si dhe të nxirren përgjegjësitë për kamatëvonesat e krijuara në vlerën 1,909,362,631 lekë.

Deri më 30.06.2022

Nga ana e shoqërisë Albpetrol sha janë kryer likuidimet për energjinë elektrike për vitin 2021 e në vazhdim është bërë akt marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura me qëllim ndalesën e mbajtjes së kamatvonesave. Realizuar sipas shkresës nr. 8322 prot., datë 16.11.2022, në lidhje me detyrimet kundrejt O...E Grup.

Rekomandimi është realizuar pjesërisht

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën e zbatimit të marrëveshjes hidrokarbure janë krijuar detyrime për pjesën e PPE dhe ASP duke filluar nga viti 2014.

- Detyrimi për vitin 2019 që shoqëria “T...S” ShA ka ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto për llogari të P.... sipas marrëveshjes hidrokarbure është **3,451.6** ton naftë bruto. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos për vitin 2019 ka tërhequr për llogari të P.... sasinë prej 4,388.024 ton naftë. Pra, janë tërhequr rreth 936.424 ton naftë më shumë nga detyrimi për P.... për vitin 2019.

- Detyrimi për 5-mujorin e parë të vitit 2020, që shoqëria “T...S” ShA ka ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për llogari të P...., sipas marrëveshjes hidrokarbure është në sasinë prej **1,332.619** ton naftë bruto. Për këtë periudhë Albpetrol sh.a Patos nuk ka tërhequr asnjë sasi naftë për llogari të P.... Pra për periudhën objekt auditimi, detyrimi i kopanisë “T...S” ShA, ndaj shoqërisë Albpetrol ShA, është në sasinë 396.195 ton (1,332.619-936.424).

- Ndërkohë që për periudhën nga lidhja e marrëveshjes deri me 31.05.2020 detyrimi që kompania “T...S” ShA ka ndaj Albpetrol sh.a Patos, detyrimi në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të pjesës së Albpetrol (PPA) është **6,247.809** ton naftë bruto.

Sasia e naftës që “T...S” ShA i detyrohet Albpetrol “T...S” ShA, përfaqëson diferencën ndërmjet sasisë së detyrimit që “T...S” ShA i detyrohet Albpetrol ShA për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol (PPA) sipas Marrëveshjes Hidrokarbure me sasinë e naftës që është tërhequr nga Albpetrol ShA. “Çmimi i shitjes së naftës” përfaqëson çmimin mesatar të shitjes së naftës të deklaruar nga kontraktori në progres raportet 3-mujore përkatëse.

Referuar vendimit nr. 1, datë 03.02.2020 të Këshillit Mbikëqyrës, çmimi i përcaktuar në programin ekonomik të zhvillimit të shoqërisë Albpetrol është në vlerën 32,000 lekë/ton. Sa më sipër, detyrimi total i “T...S” ShA, ka ndaj Albpetrol sh.a Patos, është në shumën **199,929,888 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Albpetrol ShA** (6,247.809 ton naftë * 32,000 lekë/ton). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandim: Administratori i Shoqërisë Albpetrol ShA dhe Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Drejtoria Juridike, të kërkojnë me të gjitha rrugët e mundshme ligjore shlyerjen e detyrimit prej 6,247.809 ton/naftë në vlerën 199,929,888 lekë nga kontraktori “T...S” ShA

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4730 prot., datë 23.06.2022, Albpetrol sha i është drejtuar shoqërisë “T...S” në lidhje me shlyerjen e detyrimeve totale por nga ana e shoqërisë koncensionare nuk është kthyer përgjigje. Përsa i përket ndjekjes së procedurave ligjore në lidhje me shlyerjen e vlerës nuk është marrë asnjë hap konkret nga ana e shoqërisë Albpetrol sha. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. A.T, me detyrë Drejtor i Ceshetjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

3.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i aktiveve jo materiale të Albpetrol u konstatua se janë blerë nga periudha 2016-2018 një sasi e këtyre aktiveve në vlerën 154,599,990 lekë. Në verifikimet e kryera nga komisionet e ngritura nga drejtimi i shoqërisë, në periudhën e auditimit u konstatua se pjesa më e madhe janë marrë në dorëzim dhe nuk janë vënë në funksionim asnjëherë. Programet janë sisteme software për GIS, për krijimin e bibliotekës dixhitale, dixhitalizimin e arkivës gjeologjike, sistemit të raportimit, për menaxhimin e magazinave dhe pajisja e tyre me barkode, aplikacione për menaxhimin e problemeve të sistemeve dhe pajisjeve etj. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. Nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 2.

Vlera 154,599,990 lekë investime në aktive jo materiale afatgjata, por jo të përdorur realisht përbën shpenzim pa efektivitet nga Albpetrol ShA. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Nga Administratori i Albpetrol ShA dhe drejtoritë përkatëse sipas natyrës ku do të përdoret aktivi, të merren masa për vënien në përdorim të aktiveve të blera dhe të pa përdorura, sipas destinacionit të përcaktuar në momentin e hartimit të kërkesave për blerje. Të nxirren përgjegjësitë për persona konkretë për mos vendosjen në efikasitet deri tani të këtyre aktiveve, si dhe nëse ka aktive të cilat nuk kanë mundësi përdorimi për shkak të blerjeve të pa nevojshme.

3.2.Rekomandim: Në rastet hartimit të kërkesave për blerjeve të aktiveve, nga kërkuesi i mallit të argumentohet saktë nevoja e blerjes, ndërsa nga drejtimi i shoqërisë, përpara miratimit të kërkesave, të analizohen këto kërkesa nëse janë në përputhje të plotë me nevojat reale të shoqërisë Albpetrol ShA. Çdo kërkesë për blerje malli të shoqërohet me situatën e gjendjes së magazinës për këtë mall.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtyre rekomandimeve.

Rekomandimi nuk është realizuar

4.Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se kontraktori T...S ShA ka detyrime financiare të papaguara për shërbimet e ofruara nga Albpetrol sha deri më fund të periudhës objekt auditimi në vlerën prej **138,457,460 lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e Albpetrol ShA. Këto detyrime janë lidhur me shërbimet me agregatë, faturat e energjisë elektrike etj. Krijimi i këtyre detyrimeve ngarkon me përgjegjësi Administratorin, Drejtoritë e Financës dhe atë Juridike, të cilët kanë lejuar ofrimin e shërbimeve kontraktorit të marrëveshjes hidrokarbure, pa kryer pagesat periodike përkatëse, në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA, Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike dhe Qendra e Furnizimit dhe Shërbimit Elektrik (QFSHE) të marrin masat e nevojshme për të arkëtuar detyrimet financiare të kontraktorit “T...S” ShA për shërbimet e ofruara nga Albpetrol ShA në vlerën prej **138,457,460 lekë**.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 1580 prot., datë 18.02.2022 është lidhur marrëveshje me kontraktorin T...L dhe vazhdon likuidimi me këste i detyrimit.

Rekomandimi është Proces

5.Gjetje nga auditimi: Shoqëria Albpetrol ShA ka në detyrimet afatgjata vlerën 2,882,966,924 lekë e cila përbën vlerën e dividendit të papaguar në llogarinë e ortakut të vetëm, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Pagesa e fundit është kryer në vitin 2017, e më pas nuk janë kryer më likuidime. Megjithatë shoqëria ka paraqitur pasqyra financiare me fitime ndër vite dhe ka vendosur për kalimin e tyre në dividend për tu paguar ndaj aksionarit kryesor, ritmet e pagesës së këtij detyrimi janë shumë të ulëta.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Kreun VI, “Dividentët dhe kalimi i fitimeve në kapitalin themeltar”, neni 27 të statutit të shoqërisë.

Kosto e buxhetit të shtetit për mos disponimin e këtyre fondeve duke iu referuar të dhënave të Bankës së Shqipërisë për vitin 2019 ka një normë mesatare të ponderuar rreth 3.2% dhe për detyrimin sa më sipër është 92,254,000 lekë. Për vitin 2018 duke e llogaritur me një normë mesatare të ponderuar prej 3.3%, kjo vlerë është 95,137,000 lekë. **Vlerat totale e detyrimit për dividendin për të dy vitet 2018 dhe 2019 është 187,391,000 lekë, e cila konsiderohen efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 55-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Albpetrol ShA të marrin të gjitha masat për kryerjen e pagesës prej **92,254,000 lekë** ndaj ortakut të vetëm, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. A.B, me detyrë Drejtor i Financës, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

6.Gjetje nga auditimi: Albpetrol ShA ka kryer auditet vjetore dhe rezultat e tyre në vite janë kontestuar nga B..... dhe janë çuar për gjykim në Gjykatën e Arbitrazhit.

Albpetrol ShA në zbatim të nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimit dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos - Marinëz”, ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1, Q2, Q3, Q4 të vitit 2018.

Për vitin 2018 rezulton se nga Albpetrol ShA nuk janë njohur si kosto hidrokarbure ndaj BPAL vlera **3,232,161 USD**, vlerë e cila duhet të zbritet nga shpenzimet hidrokarbure të vitit 2018.

Për vitin 2019 rezulton se nga Albpetrol ShA nuk janë njohur si kosto hidrokarbure ndaj BPAL vlera **3,605,196.79 USD**, vlerë e cila duhet të zbritet nga shpenzimet hidrokarbure të vitit 2019.

Ulja e shpenzimeve të deklaruara nga kontraktori si shpenzime hidrokarbure, sjell një ndryshim të ri të llogaritjes së faktorit “R”, i cili është përcaktuesi kryesor në ndarjen e fitimit, konkretisht nga 0% në 50%.

Në qoftë se vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit i jep të drejtë Albpetrol ShA në lidhje me shpenzimet e panjohura, atëherë vlera që B.....a duhet ti paguaj Shtetit Shqiptar për fitimin e realizuar është 42,451,168.5 USD, që nga ndryshimi i marrëveshjes, ndërsa pjesa takuese për periudhën objekt auditimi është 15,843,598 USD.

Kjo vlerë do të ndryshojë duke u rritur me daljen e rezultateve të auditit të kryer nga Albpetrol ShA për llogarinë kosto të vitit 2020, pasi nuk ka përfunduar afati prej 12 muajsh dhe nuk është dakortësuar midis palëve.

Për periudhën objekt auditimi detyrimi i B.....A për PPA nga ndryshimi i Koeficientit R:

Për vitin 2018 $15,361.23 * 456.58 = 7,013,630.39$ USD

Për vitin 2019 $17,273.90 * 312.11 = 5,391,356.93$ USD

Për vitin 2020 $13,106.36 * 204.9 = 2,685,493.16$ USD

Në total të ardhurat e munguara të Albpetrol ShA nga PPA si pasojë e rillogaritjes së faktorit “R”, janë 15,090,480.5 USD, pjesa takuese për periudhën objekt auditimi 8,076.850 USD. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t’i kërkojnë kontraktorit B.....A zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure, në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure, në vlerën **3,232,161 USD** të konstatuar për vitin 2018 dhe **3,605,196.79 USD** të konstatuar për vitin 2019.

Administratori të ngrejë një grup pune dhe të marrë masa për reflektimin e situatës së detyrimeve reale të BPAL ku të përfshihet edhe situata e ri llogaritjes së faktorit R dhe detyrimit prej **57,541,649 USD**.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e

sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, I.K, me detyrë Drejtor i Marrëveshjeve Hidrokarbure, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

7.Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vendosur nga Albpetrol ShA, detyrimi që “B.....” ka ndaj Albpetrol ShA në naftë bruto për llogari të P.... sipas marrëveshjes hidrokarbure, për vitin 2019 është **30,634.860 ton naftë bruto**. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P.... një sasi prej **27,159.34 ton naftë bruto**, për vitin 2019. Pra Albpetrol ShA nuk ka tërhequr ende sasinë **3,475.52 ton naftë bruto** nga detyrimi për P.... për vitin 2019, ndërkohë që detyrimi i kompanisë “B.....” për vitin 2020 ndaj Albpetrol-it për llogari të P...., sipas marrëveshjes hidrokarbure është **24,494.49 ton naftë bruto**. Nga ana e Albpetrol ShA nuk është tërhequr asnjë sasi naftë për llogari të P.... për vitin 2020.

Detyrimi që shoqëria “B.....” ka ndaj Albpetrol ShA në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) për periudhën nga data efektive deri më 31.12.2020 është **59,599.264 ton naftë bruto**

- Kontraktori “A....” ShA ka blerë energji nga Albpetrol ShA sipas marrëveshjes dypalëshe, për periudhën objekt auditimi rezultoi se kontraktori ka detyrime të pashlyera për energji elektrike ndaj Albpetrol ShA në shumën **21,354,950** lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e shoqërisë Albpetrol ShA

- Kontraktori F...K ShA ka blerë energji nga Albpetrol ShA gjatë gjithë periudhës objekt auditimi, por referuar informacionit të dhënë nga Sektori i Marrëveshjeve Hidrokarbure, kontraktori ka detyrime të pashlyera për energji elektrike ndaj Albpetrol ShA në vlerën **420,277** lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandim: Administratori i shoqërisë Albpetrol ShA të marrë masa për tërheqjen e sasisë **59,599.264 ton naftë bruto**, për llogari të prodhimit para-ekzistues (PPE) dhe të pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri më 31.12.2020, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit, të përcaktoj sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure, ose të kërkojë vlerën ekuivalente të saj prej **18,580,070 USD** (59,599.264 ton * 311.75 USD/ton) nga kontraktori, sipas kuadrit ligjor dhe mbështetur në dokumentacion justifikues. Kjo vlerë është llogaritur me çmimin mesatar të vitit 2019 si vit i pa ndikuar nga pandemia por që çmimi duhet rillogaritur nga një grup pune i Albpetrol ShA mbështetur në dokumentacionin e marrë nga kontraktori.

7.2.Rekomandim: Nga Administratori i Albpetrol ShA të marrë masa për arkëtimin e vlerës **21,354,950 lekë** nga kontraktori “A....” ShA dhe vlerës **420,277 lekë** nga kontraktori F...M ShA, si dhe të lidh marrëveshje/kontrata me kontraktorët subjekt të blerjes së energjisë elektrike, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe duke parashikuar dhe aplikuar kamatë vonesa për faturat e energjisë elektrike të pa likuiduara.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, I.K, me detyrë Drejtor i Marrëveshjeve Hidrokarbure, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

8.Gjetje nga auditimi: Prej vitit 2003 Albpetrol ShA zotëron të drejtën e furnizimit dhe tregtimit me energji elektrike të klientëve të kualifikuar, por nuk ka lidhur marrëveshje apo kontrata me këta klientë.

Kontraktori B...S Petrol Albania (BPAL) ka blerë energji elektrike nga Albpetrol ShA dhe deri në fund të periudhës objekt auditimi (31.12.2020), kompania BPAL është debitor ne shumën **1,099,475,784 lekë** ndaj Albpetrol ShA për energjinë elektrike.

Albpetrol ShA nuk aplikon kamatë vonesa për mos likuidimin ne kohe te faturave te energjisë elektrike nga BPAL. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandim: Administratori të marre masa për kryerjen e pagesës së energjisë elektrike në shumën **1,099,475,784 lekë** nga Kontraktori BPAL, si dhe lidh marrëveshje/kontratë me kontraktorët subjekt të blerjes se energjisë elektrike, duke përcaktuar te drejtat dhe detyrimet e palëve dhe duke parashikuar dhe aplikuar kamatë vonesa për faturat e energjisë elektrike të pa likuiduara.

8.2.Rekomandim:Referuar problematikave të dala gjatë auditimit në lidhje me detyrimet e kontraktorëve të marrëveshjeve hidrokarbure për pagesën energjisë elektrike, detyrimet e akumuluar të Albpetrol ndaj O...E dhe kamat vonesat për energjinë elektrike, i rekomandojmë MIE kalimin e asetëve për transmetimin e energjisë elektrike nga Albpetrol ShA, në pronësi të së cilit janë aktualisht, tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, si dhe lidhjen e kontratave të shërbimit të energjisë elektrike me Furnizuesin e Shërbimit Universal ShA.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, I.K, me detyrë Drejtor i Marrëveshjeve Hidrokarbure, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

9.Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 247 prot., datë 12.10.2020 “Kërkesë për hyrje në negociata për marrjen nga shoqëria “Albpetrol ShA” në para të vlerës korresponduese të sasisë së prodhimit të gjykuar dhe të pjesës së Albpetrol ShA (PPA)”, shoqëria A...L i është drejtuar Albpetrol ShA ku i paraqet shqetësimin e saj se kjo e fundit nuk po tërheq sasinë e PPE dhe PPA dhe për pasojë ka shkaktuar dëme.

Të ndodhur në këtë situatë A...L ka propozuar që në bazë të Vendim nr. 947, datë 29.12.2014 “Për autorizimin e Albpetrol ShA për të marrë në para, vlerën koresponduese të sasisë së prodhimit të gjykuar dhe të pjesës së Albpetrol ShA, që i takon në bazë të zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure, të lidhura me kontraktorët, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës e të gazit” dhe Udhëzimit të Përbashkët nr. 1, datë 26.05.2015 “Rregullat dhe procedurat e marrjes, në para, të vlerës koresponduese të sasisë së prodhimit të gjykuar dhe të pjesës së Albpetrol-it”, të dakortësohet marrja e shumës monetare ekuivalente me detyrimin e PPE dhe PPA.

Me urdhrin nr. 260, datë 25.11.2020 “Mbi grupin e punës që do të zhvillojë negociatat me Kontraktorin “A...” ShA dhe përgatisë draftin e kontratës për marrjen në para të vlerës korresponduese të sasisë së PPE dhe PPA që i takon Albpetrol sh.a Patos”, është ngritur grupi i punës për trajtimin e kërkesës.

Grupi i punës ka hartuar relacionin nr. 7399, datë 23/12/2020 “Relacion mbi ecurinë e negociatave me kontraktorin “A...” ShA për marrjen në para të vlerës korresponduese të sasisë së Prodhimit të Gjykuar (PPE) dhe pjesës së (PPA) që i takon Albpetrol sh.a Patos në bazë të Marrëveshjes Hidrokarbure për vendburimin Ballsh - Hekal”, ku shpjegon situatën.

Detyrimi nuk është likuiduar plotësisht në naftë bruto pasi shoqëria Albpetrol ShA nuk ka pasur kapacitet depozitues në vitin 2020, si pasojë e pandemisë dhe dështimit të ankandeve. Shoqëria “A...” ShA e ka shitur këtë sasi për 1,132,595 \$, operacion i cili nuk është i bazuar në marrëveshjet hidrokarbure dhe nuk pranohet nga Albpetrol ShA, e cila vazhdon të kërkojë këtë sasi naftë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandim: Administratori dhe Drejtoria e Marrëveshje Hidrokarbure të marrin masa për ngritjen e një grupi pune, analizimin e situatës dhe kërkimin e dokumentacioneve përkatëse nga shoqëria “A....” ShA me qëllim verifikim e shumës 1,132,595 USD. Në rast se vlera është e mbështetur në dokumentacion justifikues, të kërkohet arkëtimi i saj, si një e ardhur e munguar për shoqërinë Albpetrol ShA.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, I.K, me detyrë Drejtor i Marrëveshjeve Hidrokarbure, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

10.Gjetje nga auditimi: Referuar marrëveshjes së Albpetrol ShA me shoqërinë “A....” ShA, si dhe kontratës në pikën 3.1,4.1 të saj citohet se:

1.Pika 3.1 ”Furnizuesi merr përsipër të furnizoj me gaz me cikle, në sasinë 25,000N/m³, në muaj.
2.Pika 4.1 “Blerësi duhet të paguajë detyrimin e shprehur në faturën mujore të hartuar nga të dyja palët brenda 30 ditëve nga paraqitja e faturës tatimore nga furnizuesi.
3. Sipas llogaritjeve të grupit të auditimit, rezulton se sasia e cila duhet të raportohet është 25,000 N/m³, prej të cilës subjekti merr përsipër furnizimin me gaz me cikle me çmim 50 lekë për 1000N/m³(në kontratë), pra $(50*25,000/1000=1,250$ lekë në muaj), ndërkohë që çmimi në raportin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë është përcaktuar që të jetë 50 lekë për 1 N/m³. Pra $50*25,000$ N/m³=1,250,000 lekë /muaj duhet të ishin të ardhurat për shoqërinë Albpetrol Sha dhe për periudhën nga korriku deri në përfundim të kontratës dt.05.11.2019, kjo shumë është $(1,250,000*4\text{muaj}) + (1,250/30 \text{ ditë} * 5) = 5,000,000 + 208,333 = 5,208,333$ lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e shoqërisë Albpetrol ShA. Në bazë nenit 5 pika 5.6 të kontratës së furnizimit nr.11010 prot.dt.05.11.2018 citohet: “Kjo kontratë mund të përfundojë para afatit të saj, vetëm në rast të dhënies së urdhrin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”. Asnjë urdher i tillë nuk rezulton të jetë dhënë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA dhe Drejtoria Juridike të negociojë dhe të vërë në kushte ligjore kontratën e furnizimit me gaz për kontraktorin “A....” ShA, duke vendosur çmimin e shitjes 50 lekë për N/m³, sipas përcaktimit të këtij çmimi të shitjes në programin ekonomik të Albpetrol Sha, duke eliminuar të ardhurat e munguara të cilat për periudhën objekt auditimi janë 5,208,333 lekë.

Deri më 31.05.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. A.T, me detyrë Drejtor i Ceshtjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

11.Gjetje nga auditimi: Në bazë të marrëveshjes hidrokarbure për zhvillimin e hidrokarbureve në vendburimin Ballsh-Hekal, P...Z dhe Finiq-Kranë, neni 10 pika 10.2 dhe neni 9 “Punësimi dhe Bonuset, kontraktorët duhet të kryejnë shpenzime vjetore për trajnimin e stafit, si vijon:

-Kontraktori “A....” ShA duhet të shpenzojë një minimum prej 20000 USD për çdo vit kontraktual, për punonjësit e Albpetrol ShA, në lidhje me Bonuset e Trainimit Vjetor, për vendburimin Ballsh-Hekal;

-Kontraktori "F...M" ShA duhet të derdhë Bonus Trajnimi për punonjësit në shumën prej 5,000 USD për vendburimin P...Z dhe 5,000 USD për vendburimin Finiq-Kranë, për çdo vit fiskal. Nga auditimi u konstatua se nuk rezultojnë të jenë kryer këto derdhje nga kontraktorët në favor të Albpetrol ShA, në kundërshtim me marrëveshjen e hidrokarbureve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 179-211 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA dhe Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, të marrin të gjitha masat e duhura ligjore me qëllim që kontraktori "A..." ShA dhe "F...M" ShA të bëjnë respektivisht derdhjen e shumës 20,000 USD dhe 10,000 USD për trajnimin e stafit me qëllim rritjen e aftësisë profesionale të tyre.

Deri më 30.06.2022

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, I.K, me detyrë Drejtor i Marrëveshjeve Hidrokarbure, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për veprimet e kryera me bankë është konstatuar se janë kryer shpenzime për festën e fund vitit për fëmijët e punonjësve si dhe për dhurata në vlerën 842,000 lekë. Në këtë procedurë është bashkëngjitur lista emërore e punonjësve dhe numri i fëmijëve të tyre, por nuk është e firmosur nga asnjë person.

Për këtë procedurë është konstatuar se nuk disponohet marrje oferte nga tregu, por vetëm fatura e shitjes nga operatori fitues. Për kryerjen e kësaj feste konstatohet se është vepruar në kundërshtim me VKM nr.929, datë 17.11.2019 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", e ndryshuar ku theksohen se pas situatës të tërmetit të 26.11.2019 dhe shpalljes së fatkeqësisë natyrore ndalohen të gjitha festat dhe evenimentet social-kulturore për vitin 2019 si edhe është shmangur procedura e prokurimi publik, në kundërshtim me LPP. Vlera 842,000 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë Albpetrol ShA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 72-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1.Rekomandimi: Nga Albpetrol ShA të ndërpriten praktikrat e natyrës së shpenzimeve të cilat nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe jashtë natyrës së aktivitetit të shoqërisë.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është realizuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në vitin 2020 nga Albpetrol ShA është zhvilluar procedura e prokurimit për "Shërbimin e sigurimit të punonjësve nga aksidentet në punë" me fond limit 20,937,455 lekë. Në specifikimet teknike të kësaj procedure janë vendosur pozicionet e punës me risk të lartë në punë dhe duke u bazuar te punonjësit aktual në këto vende pune është nxjerrë numri prej 1,309 punonjësish për tu siguruar. Në ofertën fituese çmimi/prim për person është 15,950 lekë. Nga auditimi i pagesës në bankë u konstatua se te grafiku me listat emërore të punonjësve që do sigurohen rezulton se për 1,309 punonjës, 52 rreshta që përkojnë me vlerën 829,400 lekë, janë bosh pa emër, por thjesht pozicioni i punës. Duke qenë se në specifikimet teknike dhe në kontratë është shprehur qartë se 1,309 punonjësit që do sigurohen janë aktualisht në punë, ka qenë e nevojshme që në specifikimet teknike dhe në kontratë të specifikohet se për vendet aktualisht të pa plotësuar, apo në rastet kur për një pozicion pune të caktuar do të zëvendësohet

punonjësi, kontrata ka fuqi për pozicionin e punës, pavarësisht emrit të punonjësit. **Pagesa prej 829,400 lekë, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.**

Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27/12/2011 i Ministrit të Financave “Për menaxhimin e njërive në sektorin publik” i ndryshuar dhe Rregullorja e Brendshme e Shoqërisë, Ligji nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 72-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandim: Nga Administratori i shoqërisë të merren masa që në rastet e sigurimit të punonjësve për vendet e punës që kanë rrisht të lartë, specifikimet teknike dhe kontrata të parashikojnë që sigurimi mbulon punonjësin si dhe vendin e punës, pavarësisht emrit të punonjësit në rastet kur punonjësi aktual zëvendësohet me një tjetër.

13.2. Rekomandim: Për vendet e punës bosh në momentin e zhvillimit të tenderit, në specifikime teknike dhe në kontratë të përcaktohet se pavarësisht se këto vende janë përfshirë në fondin limit, pagesa për sigurim do të bëhet vetëm për atë periudhë që këto vende do të jenë të plotësuara konkretisht me punonjës dhe nuk do të kryhet pagesë për periudhën kur vendi është bosh.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

14. Gjetje nga auditimi: Duke u bazuar në zbatimin e strukturës organizative për administratën qendrore dhe qendrat e prodhimit konstatohet se është tejkaluar numri i fuqisë punëtore në total me 84 punonjës si pasojë e rekrutimit të punonjësve me kontrata tre mujore. Për vitin 2019 për muajin korrik janë rekrutuar 23 punonjës, për muajin gusht 18 punonjës, për muajin shtator 21 punonjës, për muajin tetor 13 punonjës, për muajin nëntor 6 punonjës dhe për muajin dhjetor 2 punonjës, nga struktura e miratuar me vendimin nr. 8, datë 07.06.2018 të Këshillit Mbikëqyrës e cila është aplikuar edhe për vitin 2019. Referuar nivelit të pagave të miratuar, shuma totale e likuiduar për punonjësit mbi strukturën e miratuar është **4,553,500 lekë e cila konsiderohet një shpenzim me efekt financiar negativ për buxhetin e Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.** Ky efekt ka ardhur si pasojë e punësimeve për punonjës të rinj por edhe të punonjësve me kontrata tre mujore të cilat janë kryer nga Administratorët e Shoqërisë Dritan Spahiu dhe E.M sipas vendimeve përkatëse të emërimeve.

Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorit të Programimit dhe Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Administratës nuk janë marrë masat e duhura për bashkërendimin e punës mbi zbatimin e strukturës së miratuar mbi të cilën nuk duhej të kalohej numri total i punonjësve, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 8, nenin 11, të Rregullores së Brendshme nr. 1357 prot, datë 22.04.2013, dhe strukturën organizative të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikëqyrës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Programimit të merren masat e duhura që në të ardhmen të respektohet numri i fuqisë punëtore në punë në përputhje me strukturën e miratuar dhe legjislacionin në fuqi, me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

15.Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, Albpetrol ShA ka zbatuar 90 vendime gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largimin nga puna të punonjësve, për të cilat ka shpenzuar vlerën **183,463,900 lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet**. Nga shuma e mësipërme, vlera prej 84,817,120 lekë i përket periudhës 01.07.2019 deri më 31.12.2019 për 51 procese gjyqësore, ndërsa vlera prej 98,646,780 lekë, i përket vitit 2020 për 39 vendime gjyqësore. Gjithashtu janë në proces gjykimi edhe 92 procese të tjera gjyqësore me të njëjtin objekt, të cilat pritet të kenë ndikimin e tyre negativ në buxhet në vijim. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Titullari dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime, në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga Albpetrol ShA në proceset e largimit të punonjësve nga puna, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kontratën e punës dhe ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare në buxhet për këto çështje. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 22-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga institucioni itë zbatohen të gjitha procedurat e duhura ligjore që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Klsh, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë pagesave për periudhën korrik 2019-dhjetor 2020 për administratën qendrore dhe qendrat e prodhimit, rezulton se referuar kontratave kolektive të punës me nr. 8781 prot., datë 29.12.2017 dhe nr. 10645 prot., datë 22.11.2019, si dhe kontratave individuale të punës, nga Albpetrol ShA është bërë keq interpretim i pikës 2, germa “a” të VKM nr. 68, datë 07/02/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”. Duke mos kryer përditësimet në kontratat e sipërpërmendura bazuar në ndryshimet ligjore që ka pësuar kjo VKM, punonjësit janë trajtuar për këtë bonus me vlerën 500 lekë për ditë pune, por në fakt duhet të ishin trajtuar me vlerën 300 lekë për ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masat e duhura për përditësimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimore, në kundërshtim me VKM e sipërpërmendur. Kjo problematikë është përmendur edhe në auditimet e mëparshme të kryera nga KLSH për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse dhe përsëri rezulton se nuk ka asnjë vendimarrje për to. Nga llogaritja e listë pagesave për periudhën objekt auditimi ky përfitim është në masën 318,827,954 lekë, nga 191,296,773 lekë që duhej të paguhej sipas VKM. Për sa më sipër është paguar më tepër vlera **127,531,181 lekë e cila konsiderohet efekt negativ financiar në buxhet**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 22-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese të shoqërisë Albpetrol ShA të merren masat e duhura për përditësimin e kontratës së punës me legjislacionin në fuqi. Pagesa e dietës ushqimore të vijojë sipas vlerën 300 lekë për ditë pune dhe jo 500 lekë për ditë pune.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, Administratori i shoqërisë Albpetrol sha ka përcaktuar detyrat sipas Drejtorive përkatëse për marrjen e masave për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, pavarësisht Urdhrit nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor mbi nisjen apo realizimin e këtij rekomandimi. Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi, z. K. C. dhe E. D., me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Rekomandimi nuk është realizuar

D. MASA ADMINISTRATIVE

Për përjashtim nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik

Bazuar në nenin 13, pika 3/a, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 15 shkronja (c dhe ç), nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, përjashtimin nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet, të operatorit ekonomik: E...A” ShA për shkeljet e mëposhtme:

- Në procedurën e prokurimit publik me objekt “Blerje lende djegëse solar me përmbajtje sqfuri jo me tepër se 1% ndaj peshës”, me vlerë të fondit limit 21,298,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019, REF-....., në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomik “E...A” ShA, rezultoi se: Listë pagesat e paraqitura në tender, të cilat janë ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ofertues “E...A” ShA me NIPT ..., nuk janë të këtij operatori ekonomik, por të subjektit “E...L Trans” ShPK, me NIPT L51729502A. Këto listë pagesa nuk përmbajnë të dhëna për subjektin ofertues “E...A” ShA, pjesëmarrës në tender, por për subjektin “E...L Trans” ShPK, i cili nuk është pjesëmarrës në tender. Si përfundim këto listë pagesa përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në kundërshtim me kërkesat e nenit 45 dhe 47 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ndryshuar. Kjo shkelje nuk është raportuar në APP nga Autoriteti Kontraktor.

E. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit nr.37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe Kontratës kolektive për punonjësit e Shoqërisë Albpetrol ShA, kapitulli i shtatë “Masat disiplinore”, nenet 53-56, kërkojmë nga Administratori i Shoqërisë fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Pika 2.12 e programit. TË NDRYSHME (shqyrtim ankesash)

Për kryerjen e verifikimit të ankesës drejtuar Kontrollit të Lartë të shtetit, nr. 228 prot, datë 07.03.2023.

Shtetasi M.G ka qenë punonjës pranë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos deri më datë 25.07.2014, në të cilën i është zgjidhur kontrata e punës. Në momentin e zgjidhjes së kontratës së punës, shtetasi M.G ka qenë me detyrën e rojes pranë Qendrës Administrimit dhe Ruajtjes (Q.A.R) Patos, qendër në varësi të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Me shkresën nr.137 prot., datë 13.03.2014 të Sektorit të parë Sheqishtë është propozuar dhënie masë disiplinore “Vërejtje me shkrim” për shtetasin M.G, me detyrë roje në objekt tubacion magjistrat me motivacionin “Mosrespektim i rregullave të punës (nuk është paraqitur në vendin e punës) në datë 08.03.2014.

Me shkresën nr.139/6 prot. datë 17.03.2014 të Sektorit Sheqishtë është propozuar dhënie masë disiplinore “Vërejtje me shkrim” për shtetasin M.G, me detyrë roje në objekt tubacion Povelç, me motivacionin “Mosrespektim i rregullave të punës (nuk është paraqitur në vendin e punës) në datë 14.03.2014.

Me shkresën nr.321/1 prot. datë 18.03.2014 të Drejtorit të Qendrës së Administrimit dhe Ruajtjes Patos, është urdhëruar Zyra e Administratës dhe Personelit të Sektorit të Parë, dhënia e masës disiplinore shtetasit M.G me detyrë roje objekti magjistral “Vërejtje” me motivacion “Mosrespektim i rregullave të punës gjatë shërbimit më datë 08.03.2014 (nuk është paraqitur në vendin e punës).

Me shkresën nr.323/1 prot. datë 21.03.2014 të Drejtorit të Qendrës së Ruajtjes dhe Administrimit të Pronës Patos, është urdhëruar Zyra e Administratës dhe Personelit të Sektorit të Parë, pika 4, dhënia e masës disiplinore shtetasit M.G me detyrë roje në objekt tubacion Povelç t’i jepet masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës” me motivacionin “Mosrespektim i orarit dhe rregullave të punës (nuk gjendet në vendin e punës më datë 14.03.2014).

Më datë 09.07.2014, ora 11.00 është mbajtur Protokolli nr.11, në zyrën e shefit të sektorit në prani të Drejtorit të Q.A.R Patos dhe shefit të S.R.S.Z, për të analizuar veprimin flagrant të punonjësit M.G, i cili nuk është paraqitur në vendin e punës dhe ka grisur librin e shërbimit. Punonjësi M.G është njoftuar për mbledhje dhe nuk është paraqitur. “Sipas njoftimeve të bëra nga ana juaj në vendrojen nr.9 Bubullimë është ushtruar kontroll në orën 07.15 të datës 09.07.2014 nga shefi i sektorit z. L.T, përgjegjësi i turnit z.A.H, u konstatua se roja M.G nuk është paraqitur për të marrë punën në dorëzim konform rregullave. Në orën 07.30, kur është paraqitur për punën ka parë, që në librin e shërbimit ishte bërë shënim akt – kontroll për M.G, në këtë moment ai ka grisur fletën nr.54 të Librit të shërbimit dhe është larguar nga vendi i punës duke marrë me vete fletën”.

Nga ekipi i kontrollit të ngritur është mbajtur procesverbali datë 09.07.2014 ora 08.30 për konstatimin e grisjes së faqes nr 54 të Librit të shërbimit nga ana e punonjësit M.G.

Nga ana e shtetasit K.P, me detyrë roje, është nënshkruar një deklaratë më datë 09.07.2014, ku deklaron veprimet e kryera nga shtetasi M.G me detyrë roje, në momentin e paraqitjes në punë dhe grisjen e fletës 54 të librit të shërbimit.

Me shkresën nr.667 prot, datë 10.07.2014 të Drejtorit të Qendrës së Ruajtjes dhe Administrimit të Pronës Patos, drejtuar administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Administratës është kërkuar: “Propozim për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës individuale të punës për z. M.G”.

Me shkresën nr. 5727 prot, datë 14.07.2014 Qendra Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës Patos, i është drejtuar z.M.G, se bazuar në nenin 144 të Kodit të Punës duhet të paraqitet pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Administratës së shoqërisë Albpetrol sh.a Patos më datë 18.03.2014 ora 13.00, për të diskutuar vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës.

Me Vendim nr. 477 datë 25.07.2014, me nr.6035 prot. datë 25.07.2014 të Administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos., është vendosur:

1.Zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës, për arsyet që janë parashtruar dhe në takimin e datës 18.07.2014 në të cilin nuk u paraqit, si më poshtë:

*a)z. G...j ka marrë vërejtje me shkrim për shkak të mosrespektimit të orarit dhe kohës së punës, mosrespektimit të rregullave, duke kryer akte si: fyerje, sharrje të eprorit dhe punonjësve të tjerë.
2.Marrëdhëniet e punës dhe ato financiare, do të përfundojnë zyrtarisht më datë 25.07.2014.*

Pas vendimit për zgjidhjen e kontratës së punës prej shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nga ana e shtetasit M.G është paraqitur kërkesë padi në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Fier, me palë:

Paditës: M.G

I Paditur: Shoqëria Albpetrol sh.a Patos

Objekt: 1. Detyrimin e punëdhënësit Albpetrol sh.a Patos për të më paguar diferencën e pagës që ekziston ndërmjet pagës së vendit të punës së mëparshme që kisha në dhjetor 2013 si “përgjegjës turni” dhe pagës së vendit të punës që po kryeja si roje nga janari 2014 deri në momentin e zgjidhjes

se marrëdhënieve të punës, detyrimi është për 8 muaj, sepse ndryshimi i vendit të punës, që Punëdhënësi Albpetrol sh.a Patos ka kryer ndaj meje, është kryer pa pëlqimin tim dhe pa një marrëveshje të shkruar mes meje si punëmarrës dhe Albpetrol sh.a Patos, si punëdhënës, siç parashikon neni 21 i Kodit të Punës.

2. Detyrimin e punëdhënësit Albpetrol sh.a Patos për dëmshpërblimin me një vit pagë për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës pa shkaqe të justifikuara.

1. Detyrimin e punëdhënësit Albpetrol sh.a Patos për pagimin e dëmshpërblimit me dy paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

2. Detyrimin e punëdhënësit Albpetrol sh.a Patos për pagimin e dëmshpërblimit me tre paga mujore për mosrespektim të afateve të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës.

3. Detyrimin e punëdhënësit Albpetrol sh.a Patos të më paguajë shpërblimin për vjetërsi në punë sa paga e një pesëmbëdhjetë ditësh, për 44 vite të plotë punë pra palës së paditur, gjithsej 22 paga mujore.

4. Detyrimin e punëdhënësit Albpetrol sh.a Patos të paguajë shkallën e kualifikimit atë të "titullit mjeshtër" për tre vitet e fundit të punës në masën 10% të pagës bruto, si detyrim që rrjedh nga ligji, VKM-ja me nr. 478 datë 18.07.2007 dhe kontrata kolektive dhe individuale e punës.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin e saj nr. 62-2015-1487 (541) datë 24.04.2015**, ka vendosur:

1. Pranimin e pjesshëm të padisë.

2. Rrëzimin e pikës 1, të objektit të padisë, si të pabazuar në ligj.

3. Detyrimin e palës së paditur Albpetrol sh.a Patos, për t'i paguar palës paditëse M.G 1 vit pagë për zgjidhje të menjëhershme të kontratës së punës.

4. Detyrimin e palës së paditur Albpetrol sh.a Patos, për t'i paguar palës paditëse M.G 2 paga mujore, për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes të menjëhershme të kontratës së punës.

5. Detyrimin e palës së paditur Albpetrol sh.a Patos, për t'i paguar palës paditëse M.G 3 paga mujore, për mosrespektim të afateve të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës.

6. Detyrimin e palës së paditur Albpetrol sh.a Patos, për t'i paguar palës paditëse M.G 22 paga mujore, si shpërblim vjetërsie në punë.

7. Detyrimin e palës së paditur Albpetrol sh.a Patos, për t'i paguar palës paditëse M.G, shkallën e kualifikimit të titullit "Mjeshtër", për 3 vitet e fundit duke u nisur nga zgjidhja e kontratës së punës, në masën 10% të pagës bruto, si detyrim i rrjedhur nga VKM nr. 478 datë 18.07.2007, dhe kontrata kolektive e punës datë 30.05.2011 – 30.05.2012, dhe kontratës individuale datë.01.06.2012, neni 19 i saj.

8. Përlllogaritja e dëshshpërblimit të bëhet, në bazë të pagës së tij mujore (bruto), që përfitonte paditësi M.G, **në përfundim të marrëdhënieve të tij të punës**, në pozicionin "përgjegjës turni".

9. Shpenzimet gjyqësore dhe shpërblimi me avokat i ngarkohen palës së paditur, në përpjesëtim me pjesën e pranuar të padisë.

10. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së tij.

Kundër këtij vendimi është ushtruar ankimi nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.1198, datë 28.10.2015 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.541 datë 24.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Njëkohësisht, shtetasi M.G ka paraqitur kërkesë padi përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me palë:

Paditës: M.G.

Ndërrhyrës Dytësor: L.G, E.G, E.G.

Të Paditur: Shoqëria Albpetrol sh.a Patos

Person i Tretë: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Tiranë.

Objekti: 1. Konstatimin e faktit të diskriminimit dhe viktimizimit ndaj paditësit e kryer nga ana e punëdhënësit Albpetrol sh.a Patos.

2. Ndrejten e shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura duke detyruar punëdhënësin Albpetrol sh.a Patos, të rikthej paditësin në vendin e mëparshëm të punës në pozicionin përgjegjës turni pranë palës së paditur, ose në një pozicion të barasvlershëm me të.

3. Detyrimin e punëdhënësit Albpetrol sh.a Patos ta dëmshpërblej paditësin duke e kompesuar për dëmet pasurore të shkaktuara në formën e fitimit të munguar për mosmarrjen e pagës si përgjegjës turni pranë palës së paditur, nga momenti i pushimit nga puna në datë 25.07.2014 deri në rikthimin e tij në këtë punë.

4. Detyrimin e punëdhënësit Albpetrol sh.a Patos të dëmshpërblej paditësin për dëmin jopasuror të pësuar.

5. Detyrimin e punëdhënësit Albpetrol sh.a Patos të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe ato të përfaqësimit me avokat.

Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nr. 62-2016-915 (240), datë 24.02.2016 është vendosur:

1. Pranimin pjesërisht të padisë së paditësit M.G.

2. Konstatimin e faktit të diskriminimit dhe viktimizimit të paditësit nga ana e palës së paditur Albpetrol sh.a Patos.

3. Detyrimin e të paditurit Albpetrol sh.a Patos ta dëmshpërblej paditësin M.G për dëmin pasuror dhe jo pasuror të pësuar në shumën 3,665,185 lekë brenda një afati kohor prej dy vitesh.

4. Rrëzimin e padisë për pjesët e tjera.

5. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palëve në përpjesëtim me pjesën e pranuar dhe refuzuar të padisë.

6. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë Brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes.

7. Për palët në mungesë ky afat fillon nga dita e marrjes dijeni të vendimit.

Me vendim nr.1296 datë 21.12.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë është vendosur:

Prishjen e vendimit nr. nr. 240 datë 24.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Me vendim nr.00-2022-1497 datë 11.05.2022 të Gjykatës së Lartë është vendosur:

Prishjen e vendimit nr. nr. 1296 datë 21.12.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Pas rigjyimit në Gjykatën e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 60-2023-82 datë 24.01.2023 është vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 240 datë 24.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me këtë ndryshim:

Detyrimin e palës së paditur Albpetrol sh.a Patos të paguajë paditësin me pagën që do të përfitonte nga data 25.07.2014 deri në datën e daljes në pension 15.07.2020. Niveli i pagës që do të jepet dëmshpërblim i t'i referohet pagës bruto në momentin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur si në gjykimin në shkallë të parë dhe në gjykimin në Apel. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe urdhërohet shërbimi përbarimor për ekzekutimin e tij.

Në bazë të Vërtetimit me nr.1067 prot datë 25.11.2015 të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, vërtetohet së z.M.G ka qenë punonjës i Qendrës së Administrimit dhe Ruajtjes Patos. Për muajin Nëntor 2013, Dhjetor 2013 dhe Janar 2014, është paguar si më poshtë:

	Nëntor 2013	Dhjetor 2013	Janar 2014
Përgjegjës turni			Roje
Paga bazë	47,080	47,080	37,000
Paga bruto	60,747		65,413 48,000
Paga neto	48,137	53,355	41,516

Për shkak se vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë, përmbaruesi gjyqësor privat ka marrë vendimin nr.1 datë 08.02.2023 për kalimin menjëherë në ekzekutim të detyrueshëm të vendimit nr. 240 datë 24.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fieri, ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 60-2023-82 datë 24.01.2023 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Referuar vendimit të përmbaruesit gjyqësor shuma që shoqëria Albpetrol sh.a Patos detyrohet të paguajë është 9,764,843 lekë, në të cilën përfshihen shuma objekt detyrimi, shpenzimet gjyqësore, tarifën përmbarimore si dhe çdo shpenzim tjetër, që mund të kryhet gjatë procesit përmbarimor, bazuar në nenin 525 K.Pr.Civile.

Pas bashkëpunimit me Drejtorinë e Financës të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, dhe konfirmimit prej saj, rezultoi se shuma e detyrimit të vendosur nga ana e përmbaruesit gjyqësor nuk përputhej me vendimin gjyqësor nr. 60-2023-82 datë 24.01.2023 të Gjykatës së Apelit Vlorë, në të cilën ishte vendosur se: ***“Detyrimin e palës së paditur Albpetrol sh.a Patos të paguajë paditësin me pagën që do të përfitonte nga data 25.07.2014 deri në datën e daljes në pension 15.07.2020. Niveli i pagës që do të jepet dëmshpërblim i t’i referohet pagës bruto në momentin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës”***.

Shtetasi M.G në momentin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me shoqërinë Albpetrol sh.a Patos ka qenë me detyrën e rojes pranë Qendrës së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës në varësi të shoqërisë (referuar dokumentacionit të mësipërm dhe Vendimit nr.477 datë 25.07.2014) dhe paga bruto mbi të cilën duhet të bëhet llogaritja e vlerës që shoqëria Albpetrol sh.a Patos., i detyrohet në zbatim të vendimeve të gjykatës, është 48,000 lekë.

Për sa më sipër është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier ankimi me objekt kundërshtim veprimesh përmbarimore dhe çështja është në proces gjykimi.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore z. A.C dhe në cilësinë e Drejtorit Juridik z. A.T.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se deklarimi në sistem për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021 është bërë me datë 31.03.2022. Me shkresën nr. 1528.prot, datë 14.02.2022 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka caktuar audituesit ligjorë për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2021, me të cilët është lidhur kontratë shërbimi me nr. 4726 prot., datë 23.06.2022 nga Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe shtesë kontrate nr. 4726/3 pro., datë 22.08.2022 me afat shtyrje deri me datë 18.09.2022.

Me vendimin nr. 21, datë 08.11.2022, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar pasqyrat financiare të shoqërisë dhe me vendimin nr. 9393/1, datë 30.12.2022, Asambleja e Ortakëve ka miratuar rezultatin e vitit ushtrimorë në vlerën 10,857 mijë lekë, procedurë kjo e kryer jashtë afatit të caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1. Për pasojë depozitimi i pasqyrave financiare të periudhës 2021, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, është kryer jashtë afateve ligjore dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46, pika 1. Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t’i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa që në të ardhmen pasqyrat financiare të hartohen, të aprovohen dhe të depozitohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë e vlerësimin e performancës ekonomike, në interes të vendim-marrjeve që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredi dhënie etj.

Menjëherë dhe në vijmë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se nga pronat të kaluara me VKM nr. 219/2004, datë 16.04.2004 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në administrim Albpetrol sh.a Patos.”, VKM nr.784/2006, datë 15.09.2006 “Për Ristrukturimin e Shoqërive Tregtare me Kapital Shtetëror Albpetrol sh.a Patos, “S...M” sh.a dhe “T...A” sh.p.k”, VKM nr. 275/2010, datë 26.04.2010 “Për përthithjen nga Albpetrol sh.a Patos të “U...E” dhe “U...S” shpk, Urdhri nr. 1480/2016, datë 29.02.2016 për zbatimin e Vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.2037/2017, datë 04.07.2017 të “Për kalimin e pronësisë së sendit të pranuar si blerje e kreditorit” të Shoqërisë Përmbarimore private “T...P” shpk, shoqërisë Albpetrol sh.a Patos kanë kaluar në pronësi Troje për 10 962 126 m² (Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 2 029 038 m², Puse me sipërfaqe për 4 198 588 m² dhe Rrugë për 4 198 588 m²) të pasqyruara në kontabilitet për vlerën 9, 533,519 mijë lekë. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka certifikuar 3 950 459 m² (Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 1 207 108 m², Puse me sipërfaqe për 2 448 000 m² dhe Rrugë për 295 351 m²) ose 36% e totalit dhe nuk ka certifikatë 6 958 117 m² (Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 821 930 m², Puse me sipërfaqe për 2 232 950 m² dhe Rrugë për 3 903 237 m²) ose 64% e totalit ose nga 6497 prona janë certifikuar 3799 prona ose 58% e totalit, janë në proces për regjistrim 870 prona. **Rezultojnë që ka 28 prona me mbivendosje dhe 440 prona të zaptuara nga të tretë të cilat shfrytëzohen pa asnjë detyrim financiar ndajë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, duke krijuar të ardhura të munguara.**

Sa më lart kontabilizimi i tyre nuk është mbështetur në dokumente hipotekore në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kapitulli III, pika 35. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për evidentimin e gjendjes fizike të pronave të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të kaluara me VKM dhe regjistrim në ASHK Drejtoria Fier.

Gjithashtu, Drejtoria e Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

2.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në bashkëpunim me Drejtorinë e Auditit të Brendshëm të marrë mision auditimi të veçantë në të gjitha Asetet në përdorim/pronësi të kaluara me VKM të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për evidentimi e tyre mbi gjendjen fizike, si dhe shfrytëzimin e tyre të tretë.

Për rastet e konstatuara për shfrytëzim nga të tretë të kërkohet lidhja e kontratës së qirave për rastet e objekteve me certifikatë pronësie ose bllokimi i pronës dhe marrja në përdorim nga vetë shoqëria Abpetrol sh.a

Brenda datës 31.12.2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se në grupin e “*Aktive Afatgjata Materiale*” të pasqyruara në bilanc në vlerën 31,115,579 mijë lekë është e përfshirë dhe vlera prej 344,365 mijë lekë që i përket banesave të cilat janë ndërtuar nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos por që nuk administrohen më për arsye se në zbatim të VKM nr. 97, datë 03.02.2008 “*Për procedurat privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe i ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, kanë kaluar në administrim të Bashkive respektive me qëllim privatizimin e tyre nga qytetarë të cilët i përdorin.*

Sa më sipër shoqëria Albpetrol sh.a Patos **nuk ka zbatuar kërkesat e SNK 16 duke njohur vlerën prej 344,365 mijë lekë në paksim** të “*Aktive Afatgjata Materiale*” dhe paraqitjen e tyre në vlerën sipas inventarit fizik dhe Udhëzimin të MF nr. 30, datë 27/12/2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” me ndryshime, Kapitulli III, pika 28. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos nëpërmjet Drejtorisë së Financës, të marrë masa për transferimin e objekteve të kthyer në banesa që administrohen nga Bashkitë, me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur nga “*Aktive Afatgjata Materiale*” vlerën 344,365 mijë lekë.

Brenda datës 31.12.2023

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se zëri kontabël “*Aktivet afatgjata materiale*”, me kosto historike në fund të periudhës 31.12.2021 paraqitet në vlerën 32,017,937 mijë lekë (viti 2020: 31,894,548 mijë lekë). Nga procesi i inventarizimit të kryer në zbatim të Urdhrit nr. 203, datë 21.09.2021 “*Për inventarizimin e përgjithshëm të pasurisë për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos për vitin 2021*”, kanë rezultuar makineri e pajisje, mjete transporti dhe pajisje zyre dhe informatike të cilat nga grupet e inventarizimit sipas Qendrave janë vlerësuar si inventarë jashtë përdorimit.

Me vendim nr. 378, datë 13.09.2022 të Komisionit Qendror i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos pas shqyrtimit të procesverbaleve të përgatitura nga Komisionet e Vlerësimit të Qendrave për makineri e pajisje, mjete transporti dhe pajisje zyre dhe informatike të cilat janë vlerësuar dhe propozuara për jashtë përdorimit, ka vendosur të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të **2214 copë makineri e pajisje, mjete transporti dhe pajisje zyre dhe informatike me vlerë të mbetur 96,264,022 lekë.**

Sa më sipër për “*Aktivet afatgjata materiale*”, të vlerësuara për jashtë përdorimit për periudhën objekt auditimi u konstatua se **nuk është ngritur komision për asgjësimin dhe vlerësimin si mbeturinë**, skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27/12/2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” me ndryshime, pikat 109, 110 dhe 111. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos t'i kërkojë Këshillit Mbikëqyrës të, të marrë masa që për “*Aktivet afatgjata materiale*”, vlerësuara për jashtë përdorimit

për vlerën 96,264,022 lekë, të ngrejë komisionin për asgjësimin dhe vlerësimin si mbeturinë, skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.

Brenda datës 31.12.2023

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se shoqëria në regjistrat e saj ka materiale të cilat janë stok ose me qarkullim të ngadalshëm për shkak të ndryshimit të teknologjisë apo kalimit të afatit të skadencës në vlerën **1,306,029 mijë lekë** për të cilat shoqëria ka njohur zhvlerësime vetëm për vlerën **137,487 mijë lekë** në periudha të mëparshme, **pra sipas SNK 2 “Inventarët”**, duhet të njihen dhe të pasqyrohen në kontabilitet për vlerën më të vogël.

Nga drejtimi i shoqërisë nuk janë kryer analiza për periudhat kur janë bërë hyrje në magazinë si dhe përqindjet e shfrytëzimit të tyre, si dhe pasojat e mos mbajtjes së të dhënave të kontabilitetit me programe kompjuterike, nuk mundësojnë vlerësime të detajuara për rritjen e mallrave stok. Rritja e vlerave të mallrave stok dhe e mallrave me qarkullim të ngadalshëm ka ardhur si pasojë e përlllogaritjeve jo me saktësi e përgjegjshmëri të sasive të artikujve të kërkuar, duke krijuar material stok, që përveç se ka alokuar fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, pika 103, 107, 108 dhe 109. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse Qendrave kërkues të mallit/aktivitetit, të llogarisin me kujdes nevojat për blerje të materialeve teknologjike e tjera, duke evidentuar më parë gjendjen ekzistuese në magazinë dhe nevojat reale mbi këtë gjendje. Kërkesat për mall të shoqërohen me argumentim dhe relacion përkatës, duke përcaktuar saktë nevojën e përdorimit të tyre përdorimin e mallit dhe jo lënien në magazinë dhe daljen jashtë funksioneve.

Brenda datës 31.12.2023

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se me datë 31.12.2020 debitorët janë deklaruar në vlerën 18,671,912 mijë lekë dhe me datë 31.12.2021 janë deklaruar për vlerën 18,887,733 mijë lekë, (“A...O” sh.a në vlerën 11,464,502 mijë lekë, *Subjekte Privatë në vlerën 6,835,836 mijë lekë, Subjekte Shtetërore në vlerën 331,858 lekë dhe O...E në vlerën 255,535 mijë lekë*), me rritje gjatë vitit 2021, në **vlerën 215,821 mijë lekë** debitorë privat, ku sipas moshës së krijimit debitorë mbi 5 vite janë në vlerën 16,086,667 mijë lekë ose 85 % e debitorëve në total.

Për detyrimin që “A...O” sh.a, ka ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos e cila është në proces gjyqësor, shoqëria Albpetrol sh.a Patos, ka detyrime ndaj shoqërisë “A...O” sh.a, për shumën 6,312,329 mijë lekë, konstatohet se për diferencën 5,152,172 mijë lekë *(11,464,502 -6,312,329)*, janë krijuar provigjone në vitin 2021.

Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e “Llogarive të arkëtueshme tregtare” në vlerën **13,174,589 mijë lekë**. Në pasqyrat financiare janë paraqitur të drejta që i përkasin periudhave të mëparshme duke iu kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumente ligjore, subjekte që kanë falimentuar etj. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, pika 3, germa “g”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit dhe Drejtorisë së Financës, të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën **18,887,733 mijë lekë**, si dhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

Brenda datës 31.12.2023

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se “*Të drejta ndaj të tretëve për kontrata hidrokarbure*”, në vlerën 3,679,529 mijë lekë (2020: 3,408,472 mijë lekë). Këto vlera përfaqësojnë vlerën neto përkatëse të sasisë së produktit, që është llogaritur sipas parashikimeve të kontratave hidrokarbure, por që nuk është lëvruar fizikisht në depozitat e Albpetrol sh.a Patos.

Këto vlera në tërësi nuk konfirmohen si detyrim nga ana e kontraktorëve, janë të kontestuar ose janë kundërshtuar në rrugë ligjore prej tyre, për këto shoqëria ka njohur zhvlerësim lidhur me këto të drejta për vitin 2021 në vlerën 400,000 mijë lekë (2020: 200,000 mijë lekë).

-*Të drejta ndaj të tretëve për huadhënie*, në vlerën 652,634 mijë lekë (2020: **652,634 mijë lekë**). Këto vlera përfaqësojnë huatë e dhëna për shoqëri që kanë pushuar aktivitetin e tyre, shoqëria ka njohur zhvlerësim për këto të drejta vetëm për vlerën 112,800 mijë lekë.

-*Aktive të tjera mbi një vit*, në vlerën 1,440,564 mijë lekë (2020: 1,438,450 mijë lekë). Këto vlera përfaqësojnë, debitorë të tjerë në vlerën 1,365,728 mijë lekë dhe Akcizë në vlerën 74,836 mijë lekë, shoqëria ka njohur zhvlerësim për këto të drejta vetëm për vlerën 983,254 mijë lekë. Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e “*Llogarive të arkëtueshme të tjera*” në vlerën **4,276,594 mijë lekë**. Në pasqyrat financiare janë paraqitur të drejta që i përkasin periudhave të mëparshme duke iu kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumente ligjore, subjekte që kanë falimentuar etj. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, neni 12, pika 3, germa “g”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit dhe Drejtorin e Financës, të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve që lindin nga kontratat e hidrokarbureve dhe debitorëve të tjerë, si dhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

Brenda datës 31.12.2023

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se “*Llogari të pagueshme tregtare*” (Furnitorët) me datë 31.12.2020 janë deklaruar në vlerën 10,307,953 mijë lekë dhe me datë 31.12.2021 janë deklaruar për vlerën 10,043,406 mijë lekë, (“*A...O*” sh.a në vlerën 6,312,329 mijë lekë, *Subjekte Privatë në vlerën 1,583,255 mijë lekë, Subjekte Shtetërore në vlerën 147,504 mijë lekë dhe O...E në vlerën 2,000,317 mijë lekë*), me paksim gjatë vitit 2021, në vlerën 264,547 mijë lekë (*furnitor privat në vlerën 188,976 mijë lekë, furnitorë shtetërorë në vlerën 101,254 mijë lekë dhe furnitorë O...E në vlerën 25,930 mijë lekë*), sipas moshës së detyrimeve furnitorët mbi 5 vite janë në vlerën 8,606,957 mijë lekë ose 86 % e furnitorëve në total.

Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real të gjendjes së “*Llogari të pagueshme tregtare*” (Furnitorët) në vlerën **10,043,406 mijë lekë** në të cilat janë të përfshira dhe llogari kreditore të subjekteve të cilët kanë kaluar afatin më shumë se **10 vite**. Aktualisht prej disa viteve ka kaluar afati i parashkrimit të detyrimeve, nuk ekziston asnjë kërkesë e subjekteve kreditore për shlyerje detyrimi dhe njëkohësisht është parashkruar afati për tu kërkuar në rrugë gjyqësore. Për më tepër qendrat nuk zotërojnë dokumentacionin provë për detyrimin e lindur. Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë vlerësuar risqet për pagesat e kreditorëve në afat për të shmangur kamatëvonesat apo penalitetet të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, neni 12, pika 3, germa “g”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masat për të kryer pagesat e detyrimeve ndaj të tretëve në afatet e duhura, për të shmangur kamatëvonesat apo penalitetet të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë.

Brenda datës 31.12.2023

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se shoqëria Albpetrol sh.a Patos. për muajt Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2022, ka blerë energji elektrike me TVSH në vlerën 863,819,525

lekë, me TVSh të zbritshme në shumën **143,969,921 lekë**, nga ku rezulton se kjo sasi e energjisë elektrike nuk është faturuar për konsumatorët fundor **shoqëritë koncesionare**, private dhe qendrat e vetë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Në deklaratimet mujore të TVSH, rezulton se kjo sasi është deklaruar si TVSh e zbritshme, gjë e cila çon që situata e TVSH në shitje në muajt përkatës **të mos jetë reale** për pasojë vlera e TVSH së pagueshme nuk është e saktë, **pasi nga shoqëria nuk është deklaruar TVSh e shitje së energjisë së këtyre muajve në adresë të koncesionarëve.**

Nga të dhënat e FDP-ve për muajt Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2022, shitjet e tatueshme janë deklaruar në vlerën 3,625,810,585 lekë me TVSH të llogaritur në vlerën 681,690,817 lekë, kur në fakt shitje të tatueshme duhej të deklaroheshin në vlerën 4,489,630,110 lekë, me TVSH të llogaritur në vlerën 825,660,768 lekë, **pra nuk janë** deklaruar të ardhura nga shitje të energjisë elektrike, minimalisht llogaritur sipas çmimit të blerjes në vlerën **863,819,525 lekë** me TVSH, me TVSH të llogaritur në vlerën **143,969,921 lekë**, **veprime të cilat çojnë në deformim të situatës për TVSH e zbritshme dhe TVSH së pagueshme.**

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, neni 97 “*Lëshimi i faturave*”, pika 1. Personi i tatueshëm duhet të sigurohet për lëshimin e faturës nga ai vetë ose nga blerësi i tij ose në emrin e tij dhe për llogaritjen e tij nga të tretët, në rastet e mëposhtme, germa “a” për çdo furnizim malli ose shërbimi që kryen kundrejt një personi tjetër të tatueshëm ose një personi juridik të patatueshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi:

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masat për faturimin e energjisë së blerë dhe të përdorur nga konsumatorët fundor për të shmangur penalitete që lindin nga mos deklarimi i shitjeve nga organet fiskale, të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit për blerje karburanti për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, u konstatua se sasia e përcaktuar për blerje dhe fondi limit përkatës nuk është llogaritur në përputhje me dispozitat ligjore, kjo për sasinë 820 000 litra vitit 2021 dhe sasinë 1 150 000 litra vitit 2022, pasi:

Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se nga shoqëria *Albpetrol sh.a* nuk është të argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi sasinë e karburantit gazoil/benzinë, gjendje në magazinë, me analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (*motogjenerator, kaldaja, etj.*) në qarkullim e gjendje pune inventar i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, apo gjendje inventar në njësitë shpenzuese vartësi e bashkisë, mbi sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit Administrativ, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit, veprime në kundërshtim me neni 1 “*Objekti dhe qëllimi*” pika 2, gjerat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “*Për prokurimin publik*”, si dhe VKM nr. 914, datë 27.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Kreu II “*Rregullat e Përgjithshme të prokurimit*” neni 9 “*Llogaritja e vlerës së kontratës*” i ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve dhe Furnizimit, të marrë masa për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje në lidhje me konsumin e karburantit dhe pjesëve të ndërrimit në Qendrën e Furnizimit dhe Transportit (QFT) u konstatua se, për katër mjete KIA me targë AA...BE, KIA me targë AA...AI, KIA me targë AA...AT dhe KIA me targë AA...AL, për vitin 2021 janë kryer shpenzime për riparim, konkretisht:

c- Për mjetin KIA me targë AA...AL, në vlerën 41,900 lekë.

d- Për mjetin KIA me targë AA...AI, në vlerën 70,000 lekë nga kjo (goma në 56,000 lekë).

Për vitin 2022 janë kryer shpenzime vetëm për mjetin KIA me targë AA...AI, në vlerën 211,500 lekë.

Për konsumin e karburanti rezultoi se qendrat bëjnë kërkesë për furnizim pranë Drejtorisë së Shërbimeve dhe Furnizimit. Nga auditimi në lidhje me kërkesat për karburant nga QFT për katër mjete KIA me targë AA...BE, KIA me targë AA...AI, KIA me targë AA...AT dhe KIA me targë AA...AL rezultoi se për vitin 2021 janë furnizuar me 6990 litra karburant (*KIA me targë AA...AI, për 3065 litra dhe KIA me targë AA...AL, 3925 litra*).

Nga të dhënat e marra nga kartelat e harxhimit të karburantit të QFT rezulton se, për mjetet KIA me targë AA...AI dhe KIA me targë AA...AL, sipas flet udhëtimeve janë harxhuar 7745 litra (*KIA me targë AA...AI, për 3485 litra dhe KIA me targë AA...AL, për 4260litra*), **më shumë 755 litra.**

Për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk ka rakordim midis Drejtorisë së Shërbimeve dhe Furnizimit dhe Qendrën e Furnizimit dhe Transportit (QFT) për sasinë e karburantit të furnizuar dhe shpenzimit faktik sipas fletë udhëtimeve.

Gjithashtu rezulton se fletë udhëtimeve, e plotësuar për harxhimin e karburantit nuk janë plotësuar saktë për km e përshkruara, nuk kanë emirin e personit që kanë firmosur për shërbimin e kryer, nuk janë të qarta për km dhe volumet e punëve të kryera, nuk janë nënshkruar nga nëpunësi urdhërues, janë plotësuar me shkrim të pakuptueshëm, nuk është mbajtur Procesverbal për konsumin e karburantit për çdo muaj, daljet e karburantit nga magazina nuk janë shoqëruar me urdhër dorëzimi dhe me flet kërkesë, pra dokumentacioni për argumentimin e konsumit të karburantit mungon, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27/12/2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikën 36. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marri masa për hartimin e dokumentacionit ligjor në menaxhimin e karburantit, duke evidentuar me dokumentacion të saktë sasinë e harxhuar nga çdo Qendër e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos që është përdoruese e gazoilin në veprimtaritë vjetore.

11.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të nxjerrë mision auditimi për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e një kontrolli të thellur të dokumentacionit ligjorë të përdorimit të gazoilin, të gomave dhe pjesëve të këmbimit të mjeteve nga çdo Qendër për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022 nga momenti i furnizimit të tyre. Në rast të konstatimit të diferencave të pashoqëruara me dokumentacion ligjorë të evidentohen përgjegjësit dhe të merren masa për shpërbllim të dëmit.

Menjëherë dhe vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Ndryshimet e shpeshta në drejtimin e Albpetrol sh.a Patos, për periudhën objekt auditimi janë emëruar dhe shkarkuar 6 administratorë, dhe kjo ka sjellë për pasojë emërimin dhe shkarkimin nga detyra të 35 drejtorëve të drejtorive të kësaj shoqërie për vitin 2021 dhe 24 drejtorë drejtorie për vitin 2022.

Po ashtu për vitin 2021 janë emëruar 172 punonjës dhe janë larguar 179 punonjës. Për vitin 2022 janë emëruar 115 punonjës dhe janë larguar 154 punonjës.

Për vitin 2021 shkaqet e largimeve nga detyra janë: largime nga puna me motivacion shkelje disiplinore / mungesë në vendin e punës 21%, dalje në pension 41%, dhe dorëheqje 15%.

Për vitin 2022 shkaqet e largimeve nga detyra janë: largime nga puna me motivacion shkelje disiplinore / mungesë në vendin e punës 24%, dalje në pension 51%, dhe dorëheqje 20%.

Ndryshimet e shpeshta të Administratorëve dhe të drejtorëve të shoqërisë Albpetrol sh.a, rrezikojnë të sjellin pasiguri dhe performancë të ulët te punonjësit e shoqërisë për shkak të paqëndrueshmërisë në vendin e punës. Vihet re trendi rritës i pushimeve nga puna dhe dorëheqjeve, që për pasojë ka

rezultuar në kosto shtesë në procese gjyqësore, dëmshpërblime për largimin e padrejtë nga puna, duke rënduar kështu situatën ekonomiko - financiare të kësaj shoqërie. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të analizohet situata e lëvizjeve të shumta të punonjësve dhe të strukturave drejtuese dhe të merren masa lidhur me qëndrueshmërinë e punonjësve duke përmirësuar performancën e shoqërisë Albpetrol sh.a.

Menjëherë dhe vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Sipas programit ekonomik në Albpetrol sh.a Patos për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 1,790 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezultojnë se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar 1,745 punonjës. Fondi i pagave është 1,222,944 mijë lekë, pra **61,125 mijë lekë** më pak se programi.

Sipas programit ekonomik në Albpetrol sh.a për vitin **2022**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezultojnë se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2022 është realizuar 6,156 punonjës. Fondi i pagave është 1,272,792 mijë lekë, pra **179,741 mijë lekë** më pak se programi.

Mos plotësimi i nevojave të shoqërisë me numrin e parashikuar të punonjësve ndikon në performancën dhe në rezultatin e saj financiar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e nevojave për punonjës të shoqërisë referuar parashikimeve të programit ekonomik.

Menjëherë dhe vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi konstatohet se në Albpetrol sh.a:

-Nuk është hartuar “Procedura e lëvizjeve të stafit”, “Rregullore për emërimet”.

-Nuk është bërë për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve.

-Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzore, pranë Albpetrol sh.a nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura.

Po ashtu procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhjes nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.

-Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 188 masa disiplinore, nga këto 35 masa “Tërheqje vëmendje”, 18 masa “Vërejtje me gojë”, 58 masa “Vërejtje me shkrim”, 8 masa “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, 6 masa “Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët”, dhe 63 masa “Pushim nga puna”. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedurë transparente, dhe nuk ka komision apelimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimi dhe miratimi i rregulloreve për emërimin dhe procedurat e lëvizjeve të stafit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

14.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me masat disiplinore në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.

Menjëherë dhe vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 Albpetrol sh.a ka arritur një rezultat financiar bruto rreth 412.2 milion lekë. Ndikim në përmirësimin e situatës kanë patur: **rritja e çmimit të naftës Brut nga 37,169 lekë/ton në 51,893 lekë/ton**, pra me një rritje prej 139,6%.

-Për vitin 2022 është realizuar një volum shitje prej 95,883 ton, kundrejt 108,736 ton të programuar ose 88.2%

-Nga aktiviteti i shoqërisë prodhimi i naftës është realizuar 70,570.5 ton kundrejt 75,920 ton të programuar ose 93%, me mosrealizim prej 5,350 ton naftë. Mosrealizimi vjetor i prodhimit të naftës nga shoqëria, vendburimet në administrimin e saj ka ardhur kryesisht për pasojë të 6 mujorit të parë, me një defiçit ndaj programit -6,577 ton naftë dhe një bazë ditore prej 171.7 ton/ditë kundrejt 208 ton/ditë të programuar.

-Detyrimet e mbetura pa shlyera deri më 31 Dhjetor 2022 ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a nga kompanitë konçesionare për naftën bruto rezultojnë 134,401 ton naftë duke u rritur me rreth 17,557 ton krahasuar me fundin e vitit 2021.

-Gazi i prodhuar nga vet Albpetrol është gaz shoqërues dhe për vitin 2022 është realizuar 110 mijë N/m³ nga 270 mijë N/m³ programuar ose 40.8 %.

-Investimet për vitin 2022 janë realizuar në vlerën 243,602 mijë lekë nga 836,126 mijë lekë të programuar ose rreth 29.1 %.

-Janë realizuar të ardhura rreth 6.59 miliardë lekë dhe janë kryer shpenzime rreth 7.6 miliardë lekë. Duke filluar nga muaji Shkurt 2022, në evidencën e bilancit të grumbullimit dhe shpërndarjes të naftës për kompaninë, nuk janë përpunuar të dhënat për vitin 2022, referuar faktit që bilanci i dërguar nga Qendra e Administrim Shitjeve të Naftës dhe Gazit ka patur problematika të cilat janë bërë prezente zyrtarisht nga Drejtoria e Programimit, pasi nevojitet vendimmarrje e shoqërisë.

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit sipas pasqyrës PASH të bilancit kontabël të shoqërisë janë realizuar 6,587,574 mijë lekë.

Krahasuar me ato të programuara 5,851,206 mijë lekë janë realizuar 112.6 % ose me tejkalim prej 736,367 mijë lekësh, kryesisht nga tejkalimi i të ardhurave nga shitja e naftës.

Për vitin 2022 ne Regjistrin e prokurimeve publike janë parashikuar për tu prokuruar 167 procedura, detajuar për Investime 78 procedura, Materiale 48 procedura dhe Shërbime 41 procedura.

Nga monitorimi i elementeve të Regjistrit të Prokurimeve për vitin 2022, rezulton se nga 167 elementë të parashikuar në regjistër 54 elementë ose 33 % e totalit kanë vijuar me procedurat, ndërsa 113 elemente ose 67 % e totalit janë me statusin të pazhvilluar (ose anuluar).

Nga procedurat e parashikuara për tu prokuruar në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2022, është arritur të realizohen procedura me kontratë gjithsej 54 procedura me vlerë totale të kontratave 564,227,021 lekë.

-Gazi i prodhuar nga vet Albpetrol është gaz shoqërues dhe për vitin 2022 është realizuar **110 mijë N/m³ nga 270 mijë N/m³ programuar ose 40.8 %**.

10) Detyrimet e kontraktorëve për prodhimin e gazit ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a rezultojnë në sasinë 24,426,313 Nm³.

Sa më sipër bie në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat e tjera të shoqërisë, të marrë masa konkrete për kryerjen e investimeve në sektorët strategjik të shoqërisë me qëllim maksimizimin e prodhimit të naftës si burimi i saj kryesor i të ardhurave dhe uljen e kostove për nxjerrjen e saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e institucionit të bëjnë dhe një analizë të thelluar për arsyet e mos realizimit të zërave kryesor të programuara në fillim viti.

Menjëherë dhe vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, rezulton se:

Nga **74** procedura me fond limit 1,170,945 mijë lekë, janë zhvilluara procedura prokurimi **me 1 OE**, gjithsej 32 procedura me fond limit 449,105 mijë lekë ose 38% e fondit të prokuruar, nga e cila: të vitit 2021 janë 17 procedura me fond limit 365,722 mijë lekë ose 50.9 % e fondit dhe të vitit 2022 janë 15 procedura me fond limit 83,383 mijë lekë ose 18.3% e fondit të prokuruar.

Kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me llojin e procedurës dhe të mirë argumentuara, gjë e cila ka çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, veprime këtë që çojnë në përdorimin e fondeve pa efektivitet si rezultat u mungesë së konkurrencës në garë.

Për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022 në **8 procedura** me fond limit **254,111 mijë lekë** u konstatua **vendosja e kriterëve** të paargumentuara jo në përputhje me procedurat e zhvilluara, të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE ose në skualifikimin e OE me oferta të leverdishme, konkretisht:

- Për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit, etj.

- Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim, është kërkesë e tejkualuar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar. Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, konstatohet se nga AK në të gjitha rastet është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (një) mjek të përgjithshëm** të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për periudha të ndryshme.

- Është kërkuar certifikatë ISO 3834-2:2005 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, kërkesë e gabuar pasi shërben për prodhimin me saldim.

Veprime këto në shkelje të neneve 1, 2, pika 1 e nenit 21, neni 78 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve dhe 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në bashkëpunime me Drejtorinë e Prokurimit Publik, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Menjëherë dhe vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit rezulton se:

- Nuk është hartuar dhe miratuar plani i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

-Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen, ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Mungojnë programe për trajnimin e stafit, si dhe u konstatuan mangësi në njohjen e ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

- Nuk është kryer vlerësimi i punës për çdo punonjës dhe ky vlerësim mungon në dosjeve personale të punonjësve.

-Nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik, nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e riskut, regjistri i riskut, gjurma e auditimit, lista e proceseve, si dhe nuk janë përcaktuar persona përgjegjës për monitorimin dhe zvogëlimin e risqeve, duke mos u identifikuar dhe vlerësuar risqet që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit.

-Nuk ka procedura të përcaktuara anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullive.

-Nuk është plotësuar pyetëtori i vetëvlerësimit, deklaratat dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ku të përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi, nevoja për përmirësim, si dhe kjo deklaratë nuk është raportuar në MFE.

-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

-Nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Aktualisht Shoqëria ka faqe zyrtare e cila është e dedikuar për aktivitetin e kërkimit, prodhimit të naftës dhe gazit. Për periudhën nga 03.09.2019, deri më datën 31.12.2020, posta elektronike zyrtare dhe faqja e shoqërisë kanë pasur mungesë të certifikatës së sigurisë, mungesë rinovimi licencash, duke çuar në pasigurinë e funksionimit të sistemit të komunikimit në faqen zyrtare.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, germa “a” dhe “b”, neni 15, pikat 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 18, pika 1, neni 21, pikat 1-3, neni 27, pika 2, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli IV, pika 4.2.8, Kapitulli II, pika 2.5.2, pika 3.2, Kapitulli IV, Shtojca 2, dhe Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe Raportit Përfundimtar vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa për të rritur performancën e saj në drejtim të përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit sipas planeve të biznesit, që menaxhmenti i kësaj shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve, por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë dobiprurëse.

17.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë të gjitha masat e nevojshme për rinovimin e licencave për faqen zyrtare dhe postën elektronike si dhe pajisjen e tyre me certifikatë sigurie, me qëllim mirëfunksionimin e tyre dhe ruajtjen e të dhënave kofidenciale të vetë institucionit.

Menjëherë dhe vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se mungojnë dokumentacionet ose projekt vendimet e propozuara në Këshillin Mbikëqyrës të cilat kanë çuar në marrjen e vendimeve. Mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albpetrol sh.a për vendimet e datave 08.11.2022, 24.01.2022, 04.02.2022, 08.04.2022, 27.05.2022, 16.05.2022, 02.08.2022, 08.11.2022 dhe 15.12.2022.

-Nuk është nënshkruar kontratë pune midis Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorëve të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, veprim në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë.

Është nënshkruar kontratë individuale pune nga Këshilli Mbikëqyrës, z. I. G., Kryetar i Këshillit dhe Administratorit aktual E. D., u konstatua se kontrata e nënshkruar është e pa protokolluar në shoqërinë Albpetrol sh.a. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që në të gjitha rastet e propozimeve për marrje vendimi nga Këshilli Mbikëqyrës, projekt vendimet të shoqërohen me dokumentacionin mbështetës për çdo çështje.

Këshillit Mbikëqyrës të marrë masa për lidhjen e kontratës së punës me Administratorin e Shoqërisë sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë Nr.6245, datë 01.09.2021 i lidhur me subjektin “K...I” sh.p.k. u konstatua se në dosje nuk ka procesverbal të dorëzimit të objektit të dhënë me qira, si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës, si dhe për arkëtimin e të ardhurave, gjithashtu në dosje ndodhet dhe një procesverbal ku është konstatuar që subjekti përdor 53.184 m² sipërfaqe ndërtimi më shumë se sa kontrata, dhe 4610.816 m² sipërfaqe funksionale më shumë se sa kontrata dhe duhet të bëhet arkëtimi i detyrimit mujor 142,186 lekë.

- Nga auditimi i kontratës së qirasë Nr.9030, datë 12.11.2021 i lidhur me subjektin “B...M” shpk, dhe kontratës së qirasë Nr.9030, datë 12.11.2021 i lidhur me subjektin “G...D” sh.p.k. me objekt kontrate “ish-Remonti Kapital në ish-QPN Marinëz” në administrim nga QAKP Patos, janë dy kontrata qiraje me të njëjtin numër protokolli, por me dy subjekte të ndryshme, në dosje nuk ka

procesverbal të dorëzimit të objektit të dhënë me qira, si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës, si dhe për arkëtimin e të ardhurave, gjithashtu në dosje ndodhet dhe një procesverbal nga 4 punonjës të Albpetrol sh.a Patos ku është konstatuar që subjekti “B...M” sh.p.k. përdor 2466.89 m² sipërfaqe funksionale më shumë se sa kontrata dhe duhet arkëtuar detyrimi mujor 69,073 lekë nga subjekti, si dhe të përcaktohet periudha që është përdorur objekti padrejtësisht nga subjekti. Për të njëjtin objekt janë dy kontrata qiraje me të njëjtin numër protokoll, por me dy subjekte të ndryshme, nuk ka proces verbal të dorëzimit të objektit si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1 dhe pikën 7 të nenit 5 të Kontratës së Qirasë.

- Kontratë qiraje me nr.671 prot , datë 24.01.2022 ndërmjet qiradhënësit “Albpetrol “ sh.a dhe qiramarrësit Z. A. M. , për dhënien me qira të objektit “*Ish guzhina Vllahinë*” me sipërfaqe 48 m², në administrim të Qendrës Prodhimit të Naftës Gorisht. Çmimi i kontratës nr.671 prot , datë 24.01.2022 është llogaritur në përputhje me pika 5 të kreut III te VKM nr.54, datë 05/02/2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies më qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar (48m² x 75 lekë/m² = 3600 lekë /muaj pa t.v.sh). Në shumën prej 3600 lekë/muaj nuk është e përfshirë konsumi i energjisë elektrike dhe ujit nga qiramarrësi. Subjekti A. M. në rolin e qiramarrësit objektin me sipërfaqe 48 m² do e përdor për ushtrim aktiviteti privat (Bar – kafe). Në nenin 2 të kontratës nr.671 prot, datë 24.01.2022 nuk është përcaktuar kohëzgjatja e kontratës të nënshkruar nga palët “Albpetrol” sh.a dhe subjektit A. M. , në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05/02/2014 germa “a”, pika 5, kreu I në të cilën citohet “*dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m² të jepen me afat deri në 1 vit*”.

- Kontratë qiraje me nr.1132 prot, datë 04.02.2022 ndërmjet qiradhënësit “Albpetrol” sh.a dhe qiramarrësit dhe shoqërisë “A...6” shpk, për dhënien me qira të makinerisë “Vinç Cjap 5 Ton”. Çmimi i kontratës nr.1132 prot, datë 04.02.2022 është llogaritur në përputhje me kreun III, pika 5 e VKM nr.54, datë 05/02/2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies më qira , enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Makineria “ Vinç Cjap 5 Ton “ është dhënë me qira shoqërisë “A...6” shpk , mbështetur në kreu I, pika 5, germa b të VKM nr.54 , datë 05/02/2014 ku citohet: “*makineritë dhe pajisjet e shkëputura jepen me qira për një afat 1 vjeçar*”. Kontrata nr.1132 prot , datë 04.02.2022 është nënshkruar më 04.02.2022 , por në nenin 2 të saj nuk është përcaktuar afati i skadimit të saj. Makineria “Vinç Cjap 5 Ton” është në administrim të Q.F.T Patos dhe nuk është e nevojshme për ushtrimin e aktivitetin e kësaj qendre , per pasojë është dhënë në gëzim të përkohshëm shoqërisë “A...6 “ shpk me çmimin e përcaktuar në nenin 3 të kontratës nr.1773 prot , datë 24.02.2022. Për makineritë dhe pajisjet vlera e detyrimit mujor të qirasë përcaktohet sa 1/10 e vlerës aktuale minimale të llogaritur si diferencë e vlerës fillestare të kontabilizuar minus amortizimin në vite, mbështetur në Vendimin nr. 401 , datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave (pjesa për investime) shumëzuar me indeksin e çmimeve të muajit përkatës publikuar nga INSTAT-i . Në pikën 2 të nenit 3 të kontratës cilësohet se detyrimi mujor i qiramarrësit “A...6 “ sh.p.k është në vlerën 2000 lekë.

Nga auditimi u konstatua se dhënia me qira e objekteve, në përgjithësi nuk inicohet sipas rregullave të vendosura dhe disiplinuar në VKM 54, datë 5.02.2014, “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”. Shoqëria nuk ka ndjekur procedura ligjore komunikimi me publikun dhe i mungon informacioni online për publikun në faqen e saj mbi objektet që ajo është e interesuar të lëshojë me qira, pasi Albpetrol ka shumë objekte të tilla që nuk kryejnë asnjë funksion por që administrohen nga qendrat e saj. Zakonisht procedimi i dhënies me qira kryhet nëpërmjet të interesuarve që bëjnë konstatim fizik mbi objektet jashtë funksioni në pronësi të Shoqërisë Albpetrol. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 144-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës të marrë masa që në të ardhmen për secilën kontratë qiraje të zbatohen të gjitha etapat e përshkruara shumë qartë në kuadrin ligjor, për lidhjen dhe zbatimin e tyre.

19.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës dhe Drejtorinë e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik, të ndërmarrë një plan konkret masash për rritjen e efikasitetit për lëshimin e objekteve me qira, veçanërisht në fushën e marketingut të shoqërisë.

Menjëherë dhe vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes Pronave, në bashkëpunim me Qendrat e Shoqërisë dhe me ZVRPP-të e rretheve, ka të listuar dhe të përditësuara të gjitha pronat e zëna nga posedues të paligjshëm si dhe pronat me mbivendosje. Këto prona janë zënë gjatë një periudhe të gjatë përpara periudhës së auditimit dhe megjithëse dhe nga grupet e mëparshme të KLSH-së është rekomanduar që të ndërmerren hapa ligjorë për këtë problematik, nga ana e Albpetrol sh.a ende nuk është marrë një veprim i tillë.

Administratori i shoqërisë i kërkon të gjitha Qendrave që në rast të konstatimit të poseduesve të paligjshëm në asetet e shoqërisë duhet ti kallëzojnë ato pranë organeve ligj zbatuese. Ky urdhër ka mbetur thjesht si një procedurë burokratike pasi ende nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret që këto objekte apo pasuri truall të zaptuara, apo sipërfaqe të Shoqërisë me mbivendosje në ZVRPP të rikthehen e gëzohen në përdorim e pronësi të Shoqërisë.

Shoqëria Albpetrol Sh.a ka të dokumentuara 3,500 puse nga të cilat ka 160 puse me vërtetime hipotekore dhe 3,340 puse me certifikate pronësie që do të thotë se ende 4,5% e kësaj lloji prone nuk zotërohet e regjistruar me certifikate pronësie.

Objektet e dokumentuara në ZRPP vendore gjithsej 454 objekte, nga të cilat 25 janë me vërtetim hipotekor ndërsa 429 janë të dokumentuara me certifikate pronësie.

Pra, janë regjistruar gjithsej 3,954 pasuri, puse dhe objekte të shoqërisë nga të cilat 185 pasuri janë me vërtetim hipotekor dhe 3,769 pasuri të shoqërisë janë me certifikate pronësie të rregullta. Pronat e regjistruara me vërtetim hipotekor zënë rreth 4,7% të pronave të regjistruara me certifikate pronësie.

Konstatohet se janë të pa regjistruara në ZVRPP vendore përkatëse 1,776 puse dhe 21 objekte të Shoqërisë ose në total 1,797 pasuri të shoqërisë janë të paregjistruara.

Nga auditimi rezulton se, pasuritë e patundshme të shoqërisë janë gjithsej 5,751 pasuri. Numri i pronave të paregjistruara zë një peshë prej 31,2% por duke llogaritur edhe 4,7% të pronave që janë regjistruar me vërtetim hipotekor, pasuritë pa dokumentin ligjor të vërtetimit të pronësisë, certifikatën e pronësisë, shkon në 39% të numrit total të pronave që tregon për një punë të dobët të stafit drejtues të Shoqërisë dhe Ministrisë së linjës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 144-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës të ndërmarr hapa konkret duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në bashkëpunim me organet kompetente ligj zbatuese për marrjen në dorëzim të pronave të ligjshme të shoqërisë.

20.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë hapa konkret për regjistrimin e asetëve të pa regjistruara. Regjistrimi dhe certifikimi i tyre sa më shpejtë ndikon në mënyrë direkte në rritjen e vlerës së shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 4546 *prot.*, datë 14.06.2022, drejtuar KLSH, Administratori i Albpetrol sh.a ka dërguar informacion (Planin e Masave) mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së, brenda **afatit 20 ditor**.

Albpetrol sh.a nuk i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 50 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8 masa, janë në proces realizimi 8 masa dhe 31 masa nuk janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 10 masa për shpërblim dëmi, në vlerën 346,696,708 lekë, nga të cilat 2 masa janë zbatuar dhe 7 masa nuk janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 22 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat janë në proces realizimi 1 masa, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 14 masa nuk janë zbatuar.

-Është rekomanduar 1 masë Administrative, e cila nuk është zbatuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.11 faqe 300-350, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marri masat për zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pa zbatuara, dhe të zbatuara pjesërisht. Ndërsa për të gjitha rekomandimet e tjera, që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2023, si më poshtë:

- **Rekomandimet për 31 masa organizative, të pa zbatuara**, respektivisht:

1.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese të Albpetrol ShA të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë.

Menjëherë

1.2. Rekomandim: Në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë hartimi i detyrave dhe përgjegjësi të shtrihet për të gjithë punonjësit dhe jo vetëm në nivel drejtorie, në mënyrë që secili punonjës të ketë të qartë detyrën funksionale dhe përgjegjësit sipas pozicionit të punës.

Menjëherë

2.1. Rekomandim: Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik, të hartohet strategjia e riskut, regjistri i riskut, gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës dhe lista e proceseve.

Të përcaktohen procedurat anti-korrupsion, rregulla të shkruara për sinjalizimin e parregullsive, si dhe të hartohen programe trajnimi për punonjësit.

Në fund të çdo viti të plotësohet pyetësori i vetëvlerësimit, si dhe deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ku të përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi, nevojat për përmirësim, si dhe kjo deklarata të raportohet në MFE.

Menjëherë

2.2. Rekomandim: Nga Administratori i shoqërisë të merret të gjitha masat e nevojshme për rinovimin e licencave për faqen zyrtare dhe postën elektronike si dhe pajisjen e tyre me certifikatë sigurie, me qëllim mirëfunksionimin e tyre dhe ruajtjen e të dhënave kofidenciale të institucionit.

Menjëherë

6.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA, Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, për rastin konkret dhe në vazhdimësi t'i kërkojnë shoqërisë "T...S" Sha të marrë masa të menjëhershme për:

- Të mos lejuar shkarkimin në ambientet të H₂O të lirë.

- Ngritjen e argjaturës mbrojtëse në grupe për të siguruar derdhjet e mundshme në rast të çarjes së ndonjë depoje, për të mos shkaktuar ndotje mjedisore.

- Eliminimin e ndotjeve të vjetra në puse dhe në afërsi të grupeve.

- Të pastrohen dhe sistemohen sheshet e grupeve të puseve.

Menjëherë

8.1.Rekomandim: Albpetrol ShA në bashkëpunim me MIE të marrin masa që të hartohet një rregullore e qartë mbi procedurat e dhënies së marrëveshjeve hidrokarbure, ku të përcaktohen kriteret e domosdoshme ekonomik, teknik e të tjera, që duhet të plotësojnë operatorët pjesëmarrës dhe këto kriteret të jenë baza për vlerësimin dhe shpalljen e fituesit.

Menjëherë

9.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa konkrete për kryerjen e investimeve në sektorët strategjik të Shoqërisë me qëllim maksimizimin e prodhimit të naftës si burimi i saj kryesor i të ardhurave dhe uljen e kostove për nxjerrjen e saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e institucionit të bëjnë dhe një analizë të thelluar për arsyet e mos realizimit të zërave kryesor të programuara në fillim viti.

Menjëherë

11.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe të gjitha drejtoritë që marrin pjesë në hartimin e programit ekonomik financiar, në të ardhmen të merren masa, për kryerjen e parashikimeve realiste, të studiuara dhe të arritshme për zërat kryesorë të shoqërisë, duke u bazuar në rezultatet e vitit paraardhës.

Menjëherë

15.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i shoqërisë të marrin masa që në të ardhmen, përgatitja dhe hartimi i pasqyrave financiare të kryhet me vërtetësi, duke pasqyruar situatën financiare dhe performancën ekonomike, për disponimin në kohë të informacioneve nga palët e interesuara, për vendim- marrjet përkatëse.

Menjëherë

16.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues duhet të marrin masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që shoqëria zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Menjëherë

17.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të merren masa që në të ardhmen jetëgjatësia e aktiveve të përcaktohet mbështetur në manualët përkatëse, ekspertiza të specialistëve të fushës, me përgjegjshmëri dhe besueshmëri.

Menjëherë

19.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të merren masat për të kryer pagesat e detyrimeve ndaj të tretëve në afatet e duhura, për të evituar penalitetet nga mos shlyerja e detyrimeve.

Menjëherë

20.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe detyrimeve e të drejtave për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Menjëherë

21.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa që Drejtoria Ekonomike gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidencë të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

Menjëherë

22.1.Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për të ngritur dhe miratuar procedura të monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve sipas kontratave përkatës, me qëllim shmangien e penaliteteve për mos pagesa në afat.

Menjëherë

23.1.Rekomandim: Administratori i shoqërisë Albpetrol ShA duhet të ngrëjë dhe të bëjë funksional autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, për të mbajtur dhe përditësuar regjistrin e deklarimit të konfliktit të interesave të punonjësve të shoqërisë Albpetrol ShA. Në rastet e anulimit të procedurës së ankandit, të analizohen dhe përcaktohen arsyet që kanë ndikuar në anulimin e ankandit për shitjen e naftës bruto.

Menjëherë

24.1.Rekomandim: Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik duhet të koordinojë dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e Prodhimit, të Shitjes, QFSHAG dhe sektorët e monitorimit të marrëveshjeve hidrokarbure, për të planifikuar sasi të naftës bruto sipas vendburimeve të Albpetrol ShA, në mënyrë që të optimizojë kapacitetet e veta të magazinimit e stokimit, për të rritur të ardhurat e shoqërisë nga realizimi i shitjes së naftës bruto nëpërmjet procedurave të ankandit.

Menjëherë

25.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA të miratojë tarifën e magazinimit dhe të lëvizjes së produktit naftë bruto në pikat e lëvrimin në dy portet e vendit, mbi bazën e ofertave të operatorëve që ofrojnë këto shërbime, të cilat të shërbejnë si referencë për komisionin e ekspertëve gjatë përcaktimit të çmimit minimal të shitjes së naftës bruto.

Menjëherë

26.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga institucion i KLSH, APP, etj., përsa i përket çështjes së mësipërme.

Menjëherë

28.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë mjete në ngarkim) i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë gjendjen teknike të mjeteve dhe më pas të caktojë normativat mbi konsumin e karburantit për mjetet që ushtrojnë aktivitetin në Shoqëri pa normativa të miratuara.

28.2. Rekomandim: Nga Drejtoria e Ekonomike dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

28.3. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës ku të vendosen në gjendje pune të gjithë GPS duke kryer riparimet teknike dhe instalimet e aplikacioneve ku të përfshihet e gjithë harta në të cilën lëvizin mjetet, matjen e konsumit të gazoilit, orët e punës për mjetet teknologjike dhe kilometrat e përshkruara nga mjeti raportet mujore mbi realizimin apo tejkalimin e konsumit të karburantit për secilin mjet. Për mjetet të cilat kanë janë funksionit treguesin e furnizimit me karburant të kryhen riparimet përkatëse.

28.4. Rekomandim: Nga organet drejtuese të Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për hartimin e rregullave në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit të shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet, makineritë-pajisjet e shoqërisë si dhe në të të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve në administratën qendrore dhe qendrat e prodhimit.

Menjëherë

29.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese të Shoqërisë në të ardhmen të merren masat e duhura ligjore për miratimin e nivelin të pagave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore dhe statutores.

Menjëherë

30.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat e duhura që emërimi i punonjësve të rinj dhe lëvizjet brenda institucionit të bëhet në bashkëpunim dhe konsultim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe në përputhje me kuadrin rregullator të rekrutimeve në punë.

30.2. Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në rastet e emërimeve të reja, më parë të përcaktojë vendosjen e kriterëve përkatëse për çdo pozicion pune sipas strukturës organizative. Gjithashtu të marrë masat e duhura mbi plotësimin e dosjeve personale të punonjësve me dokumentacionin përkatës.

Menjëherë

31.1. Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës të analizojë largimet e punonjësve nga puna dhe të monitorojë të mënyrë të vazhdueshme procesin e shkëputjeve të marrëdhënieve të punës duke kërkuar informacione periodike mbi vendimmarrjen e Administratorit të Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë të marrë masat e duhura që gjatë largimit të punonjësve nga puna ky proces të kryhet në përputhje me kuadrin rregullator ligjor për të shmangur pasojat e mundshme financiare që vijnë nga proceset gjyqësore.

Menjëherë

34.1.Rekomandim: Nga Albpetrol ShA të merren masa në mënyrë që në të gjitha rastet e propozimeve për marrje vendimi nga Këshilli Mbikëqyrës, projekt vendimet të shoqërohen me dokumentacionin mbështetës për çdo çështje.

Menjëherë

35.1.Rekomandim: Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masa për krijimin e Komiteteve sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë Albpetrol ShA.

Menjëherë

38.1.Rekomandim: Nga Administratori i Albpetrol ShA, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për marrjen në administrim nga institucioni të gjitha pronat e zëna nga posedues të paligjshëm. Gjithashtu të zgjidhet çështja e pronave me mbivendosje.

Menjëherë

39.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës të merren masa që në të ardhmen për secilën kontratë qiraje të zbatohen të gjitha etapat e përshkruara në kuadrin ligjor, për lidhjen dhe zbatimin e tyre. Të kryhet publikimi në faqen zyrtare të shoqërisë i pronave që jepen me qira, me qëllim informimin e publikut dhe rritjen e interesit prej tij për këto prona.

Menjëherë

40.1.Rekomandim: Drejtimi i shoqërisë të marrë masat për vlerësimin e situatës dhe të vazhdojë me veprimet e mëtejshme për anulimin e detyrimit që pretendon shoqëria A...L ShA, për sasinë e produktit naftë prej 15.418 ton. Drejtimi i shoqërisë të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për kundërshtimin e veprimeve të përmbauesit privat, të cilat kanë çënuar aktivet e shoqërisë.

Menjëherë

42.1.Rekomandim: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në cilësinë e pronarit aksionar) të marrë masa për analizimin e situatës së krijuar me detyrimet e Albpetrol SHA ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA për energjinë elektrike. Të vlerësojë kalimin e rrjetit transmetues të energjisë elektrike tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ShA dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal ShA në mënyrë që kontraktorët e marrëveshjeve hidrokarbure të lidhin kontrata direkt me furnizuesin kryesor të energjisë elektrike mbi bazën e kuadrin rregullator përkatës, duke eliminuar në këtë mënyrë mosmarrëveshjet që Albpetrol ShA ka me O...E për çështjen e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit, si dhe mosmarrëveshjet midis kontraktorve të marrëveshjeve hidrokarbure me Albpetrol ShA.

Menjëherë

43.1. Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë, të marrë masat e duhura për të revokuar vendimin e marrë mbi reduktimin e pagave ndaj punonjësve të administratës qendrore dhe administratës së qendrave të prodhimit. Gjithashtu në përmbushje të detyrimeve të kontratave me punonjësit, të marrë masat e duhura për të kompensuar pagat e reduktuara.

Menjëherë

-Rekomandimet për 7 masa për shpërblim dëmi me vlerë 346,696,708 lekë, të pa zbatuara, respektivisht:

1.1.Rekomandim: Nga administratori i shoqërisë Albpetrol sha të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **328,107,588 lekë**, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

Menjëherë

2.1.Rekomandim: Nga administratori i shoqërisë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës **5,737,500 lekë**, nga znj.E.M, znj.G.A, znj.K.M, znj.L.RR, znj.D.A, znj.J.N, znj.E.A. z.A.M.

Menjëherë

3.1.Rekomandim: Nga administratori i shoqërisë Albpetrol ShA të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,369,495 lekë**, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

Menjëherë

4.1. Rekomandim: Nga Administratori i Albpetrol ShA dhe Drejtoria Ligjore të merren masat e duhura duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin i shumës **2,408,353 lekë** nga ish-punonjësit përfitues të kontratave të huave pa interes.

Menjëherë

5.1.Rekomandime: Administratori i Shoqërisë të marri masat për arkëtimin e vlerës **2,126,154 lekë** nga personat përgjegjës të cilët kanë tërhequr karburantin si dhe nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët bazuar në urdhrin e Administratorit vërtetohet se kanë konsumuar karburantin, sipas normativave të miratuara.

Menjëherë

6.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat e duhura dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës **2,121,091 lekë** nga punonjësit përfitues të administratës qendrore dhe qendrave të prodhimit (sipas listës në tabelën nr. 8 dhe 8/1, në aksin nr. 2, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit). Gjithashtu nga Administratori i Shoqërisë të nxjerrë akt administrativ për të revokuar vendimin nr. 365, datë 02.12.2013, të ish-Administratorit, me qëllim mos vazhdimin më tej të këtyre shpërblimeve.

Menjëherë

7.1.Rekomandim: Administratori i Shoqërisë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,878,527 lekë**, nga personat të cilët kanë bërë tërheqjen e karburantit në magazinën e Albpetrol ShA, sipas listës së lënë nga KLSH në tabelën nr.1, aneksi 6/1, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Nëse në vijim vetë Albpetrol ShA nëpërmjet strukturës së auditit të brendshëm, apo dokumenteve të tjera, evidenton se vlera e mësipërme është përdorur edhe nga punonjës të tjerë, të marrë masa që prej tyre të zhdëmtohet vlera e përdorur, duke i shtuar këta persona në listën e lënë nga KLSH.

7.2. Rekomandim: Nga Administratori i shoqërisë, të merren masa që për çdo urdhër të nxjerrë për furnizim me karburant, të përcaktohet qartë qëllimi i përdorimit, i cili të jetë i argumentuar dhe të lidhet drejtpërdrejtë me domosdoshmërinë e kryerjes së aktivitetit të shoqërisë. Të përcaktohen rregulla të shkruara për furnizimin me karburant (procesi fillon me kërkesën nga struktura përkatëse për nevojën për karburant etj.), si dhe pas konsumit të plotësohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që vërteton shpenzimin e sasisë së tërhequr.

Menjëherë

-Rekomandimet për 14 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat nuk janë zbatuar, respektivisht:

2.1.Rekomandim: Administratori i Shoqërisë Albpetrol ShA dhe Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Drejtoria Juridike, të kërkojnë me të gjitha rrugët e mundshme ligjore shlyerjen e detyrimit prej 6,247.809 ton/naftë në vlerën 199,929,888 lekë nga kontraktori "T...S" ShA

Menjëherë

3.1.Rekomandim: Nga Administratori i Albpetrol ShA dhe drejtoritë përkatëse sipas natyrës ku do të përdoret aktivi, të merren masa për vënien në përdorim të aktiveve të blera dhe të pa përdorura, sipas destinacionit të përcaktuar në momentin e hartimit të kërkesave për blerje. Të nxirren përgjegjësitë për persona konkretë për mos vendosjen në efincë deri tani të këtyre aktiveve, si dhe nëse ka aktive të cilat nuk kanë mundësi përdorimi për shkak të blerjeve të pa nevojshme.

3.2.Rekomandim: Në rastet hartimit të kërkesave për blerjeve të aktiveve, nga kërkuesi i mallit të argumentohet saktë nevoja e blerjes, ndërsa nga drejtimi i shoqërisë, përpara miratimit të kërkesave, të analizohen këto kërkesa nëse janë në përputhje të plotë me nevojat reale të shoqërisë Albpetrol ShA. Çdo kërkesë për blerje malli të shoqërohet me situatën e gjendjes së magazinës për këtë mall.

Menjëherë

5.1.Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Albpetrol ShA të marrin të gjitha masat për kryerjen e pagesës prej **92,254,000 lekë** ndaj ortakut të vetëm, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Menjëherë

6.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojnë kontraktorit B.....A zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure, në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure, në vlerën **3,232,161 USD** të konstatuar për vitin 2018 dhe **3,605,196.79 USD** të konstatuar për vitin 2019.

Administratori të ngrëjë një grup pune dhe të marrë masa për reflektimin e situatës së detyrimeve reale të BPAL ku të përfshihet edhe situata e ri llogaritjes së faktorit R dhe detyrimit prej **57,541,649 USD**.

Menjëherë

7.1.Rekomandim: Administratori i shoqërisë Albpetrol ShA të marrë masa për tërheqjen e sasisë **59,599.264 ton** naftë bruto, për llogari të prodhimit para-ekzistues (PPE) dhe të pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31.12.2020, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit, të përcaktoj sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure, ose të kërkojë vlerën ekuivalente të saj prej **18,580,070 USD** (59,599.264 ton * 311.75 USD/ton) nga kontraktori, sipas kuadrit ligjor dhe mbështetur në dokumentacion justifikues. Kjo vlerë është llogaritur me çmimin mesatar të vitit 2019 si vit i pa ndikuar nga pandemia por që çmimi duhet rillogaritur nga një grup pune i Albpetrol ShA mbështetur në dokumentacionin e marrë nga kontraktori.

7.2.Rekomandim: Nga Administratori i Albpetrol ShA të marre masa për arkëtimin e vlerës **21,354,950 lekë** nga kontraktori "A...." ShA dhe vlerës **420,277 lekë** nga kontraktori F...M ShA, si dhe të lidh marrëveshje/kontrata me kontraktorët subjekt të blerjes së energjisë elektrike, duke përcaktuar te drejtat dhe detyrimet e palëve dhe duke parashikuar dhe aplikuar kamatë vonesa për faturat e energjisë elektrike të pa likuiduara.

Menjëherë

8.1.Rekomandim: Administratori të marre masa për kryerjen e pagesës së energjisë elektrike në shumën **1,099,475,784 lekë** nga Kontraktori BPAL, si dhe lidh marrëveshje/kontratë me kontraktorët subjekt të blerjes së energjisë elektrike, duke përcaktuar te drejtat dhe detyrimet e palëve dhe duke parashikuar dhe aplikuar kamatë vonesa për faturat e energjisë elektrike të pa likuiduara.

8.2.Rekomandim: Referuar problematikave të dala gjatë auditimit në lidhje me detyrimet e kontraktorëve të marrëveshjeve hidrokarbure për pagesën energjisë elektrike, detyrimet e akumuluar të Albpetrol ndaj O...E dhe kamat vonesat për energjinë elektrike, i rekomandojmë MIE kalimin e asetëve për transmetimin e energjisë elektrike nga Albpetrol ShA, në pronësi të së cilit janë aktualisht, tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, si dhe lidhjen e kontratave të shërbimit të energjisë elektrike me Furnizuesin e Shërbimit Universal ShA.

Menjëherë

9.1.Rekomandim: Administratori dhe Drejtoria e Marrëveshje Hidrokarbure të marrin masa për ngritjen e një grupi pune, analizimin e situatës dhe kërkimin e dokumentacioneve përkatëse nga shoqëria "A...." ShA me qëllim verifikim e shumës **1,132,595 USD**. Në rast se vlera është e mbështetur në dokumentacion justifikues, të kërkohet arkëtimi i saj, si një e ardhur e munguar për shoqërinë Albpetrol ShA.

Menjëherë

10.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA dhe Drejtoria Juridike të negociojë dhe të vërë në kushte ligjore kontratën e furnizimit me gaz për kontraktorin "A...." ShA, duke vendosur çmimin e shitjes **50 lekë për N/m³**, sipas përcaktimit të këtij çmimi të shitjes në programin ekonomik të Albpetrol ShA, duke eliminuar të ardhurat e munguara të cilat për periudhën objekt auditimi janë **5,208,333 lekë**.

Menjëherë

11.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA dhe Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, të marrin të gjitha masat e duhura ligjore me qëllim që kontraktori "A...." ShA dhe "F...M" ShA

të bëjë respektivisht derdhjen e shumës 20,000 USD dhe 10,000 USD për trajnimin e stafit me qëllim rritjen e aftësisë profesionale të tyre.

Menjëherë

12.1.Rekomandimi: Nga Albpetrol ShA të ndërpriten praktikat e natyrës së shpenzimeve të cilat nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe jashtë natyrës së aktivitetit të shoqërisë.

Menjëherë

13.1.Rekomandim: Nga Administratori i shoqërisë të merren masa që në rastet e sigurimit të punonjësve për vendet e punës që kanë rrisht të lartë, specifikimet teknike dhe kontrata të parashikojnë që sigurimi mbulon punonjësën si dhe vendin e punës, pavarësisht emrit të punonjësit në rastet kur punonjësi aktual zëvendësohet me një tjetër.

13.2. Rekomandim: Për vendet e punës bosh në momentin e zhvillimit të tenderit, në specifikime teknike dhe në kontratë të përcaktohet se pavarësisht se këto vende janë përfshirë në fondin limit, pagesa për sigurim do të bëhet vetëm për atë periudhë që këto vende do të jenë të plotësuara konkretisht me punonjës dhe nuk do të kryhet pagesë për periudhën kur vendi është bosh.

Menjëherë

14.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Programimit të merren masat e duhura që në të ardhmen të respektohet numri i fuqisë punëtore në punë në përputhje me strukturën e miratuar dhe legjislacionin në fuqi, me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

Menjëherë

15.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga institucioni të zbatohen të gjitha procedurat e duhura ligjore që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë

16.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese të shoqërisë Albpetrol ShA të merren masat e duhura për përditësimin e kontratës së punës me legjislacionin në fuqi. Pagesa e dietës ushqimore të vijojë sipas vlerën 300 lekë për ditë pune dhe jo 500 lekë për ditë pune.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Albpetrol sh.a, bazuar në Aktin Normativ Nr. 2, datë 16.06.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28/07/1993 “Për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim)”, të ndryshuar, mund të tregtojë produktet hidrokarbure për tregun vendas, apo për eksport sipas çmimit të bursës ndërkombëtare për hidrokarburet, ku Ministria përgjegjëse që drejton veprimtarinë, miraton procedurat e tregtimit të hidrokarbureve, të parashikuara në Urdhrin nr. 83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve Hidrokarbure” të ndryshuar.

Shoqëria Albpetrol, naftën bruto të prodhuar vetë, dhe sasinë e naftës bruto të përfutuar nga kushtet e zbatimit të marrëveshjes me kontraktorët e ndryshëm, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës dhe gazit, e shet nëpërmjet ankandeve publike për tregun e brendshëm ose për eksport. Në lidhje me realizimin e procedurave të shitjes së naftës me ankand, grupi auditues kreu verifikimet mbi zbatimin e bazës ligjore në fuqi dhe përgjegjësitë të parashikuara në aktet rregullatorë për strukturat përgjegjëse në shoqërinë Albpetrol sh.a, për të evidentuar problematikat kryesore si mos saktësim në Urdhrin nr. 83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve Hidrokarbure” të ndryshuar, si dhe zbatimin e tij. -Në udhëzimin e mësipërm në lidhje me **përcaktimin e çmimit të shitjes** janë pikat 6 e 7, ku citohet:

6-Çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes përcaktohet nga autoriteti shitës, nëpërmjet çmimit të produktit të publikuar në bursë për Brentin, në momentin e përlllogaritjes, duke marrë në konsideratë koeficientin e konvertimit të këtij çmimi sipas cilësisë së produktit të prodhuar, dhe

përcaktohet gjithmonë përpara fillimit të procedurës së shitjes. Në çdo rast, çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes duhet të jetë më i lartë se çmimi i shitjes i programuar nga Albpetrol sh.a Patos për vitin përkatës.

7. Për nxjerrjen e të dhënave, sipas pikës 6, krijohet grup ekspertësh të fushës, të propozuar nga Albpetrol sh.a Patos, dhe të miratuar nga Ministri. Grupi i ekspertëve duhet të përbëhet nga 3 deri në 5 persona.

Nga verifikimet e bëra për koeficientin e konvertimit të çmimit Brent sipas cilësisë së produktit të prodhuar u konstatua se grupi i ekspertëve të propozuar nga Albpetrol sh.a Patos, përbëhet nga katër anëtar të shoqërisë si dhe një anëtar i MIE. Për sa më sipër grupi i eksperteve, për përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar të shitjes së naftës bruto bazohet në studimin e faktorëve që ndikojnë në vendosjen e korrespondencës së cilësisë së naftës së prodhuar nga secili vendburim, duke e krahasuar me karakteristikat e naftës bruto me emrin “Brent”.

Nafta “Brent” është nafta që grumbullohet nga 15 vendburime të ndryshme në Detin e Veriut në portin Sullom Voe, me karakteristikat, **densiteti 37.5 gradë API, përmbajtja e sqfurit 0.4% dhe aciditeti 0.07 TAN mg KOH/g.**

-Grupi i auditimit u kërkoi specialistëve të Albpetrol sh.a Patos se në cilën metodologji, referencë, ose manuale të tregjeve botërore që kuotojnë çmimin Brent, bazohej formula e mësipërme e cila përcakton se luhatjet nga norma të disa komponentëve kanë efekt në uljen e çmimit.

Dokumenti kryesor dhe i vetëm për përcaktimin e çmimit është një raport që ka bërë Banka Botërore në tetor të vitit 2004, për parashikimet e çmimeve të naftës bruto nga qeveritë e vendeve në zhvillim, të cilët nuk përfshijnë në komponentët e cilësisë dhe faktorin e aciditetit.

Pa pretenduar të vlerësojmë përllogaritjet specifike të kryera nga specialistët, konstatojmë se veprohet me një model që nuk i korrespondon tregut të naftës bruto, por është një relacion i Bankës Botërore në vitin 2004, për efekte parashikimi. Ky model nuk është testuar me tregun, nuk është i studiuar për karakteristikat e naftës që nxirret në vendburimet tona si dhe nuk është aprovuar nga organet përkatëse. Nga verifikimet e kryera në shitjet që kanë kryer shoqëritë koncesionare, u konstatua se çmimet e shitjes që ka në tregun e jashtëm ose të brendshëm janë rreth 7-15 % më të larta.

-Grupi i auditimit konstatoi se në të gjitha procedurat e ankandit ftesat për ofertë, dokumentet me të dhënat dhe kriteret e kualifikimit janë dërguar për botim vetëm në gazetën kombëtare si dhe në gazetën e botuar në gjuhën angleze “Albanian Daily News”, dhe jo në gazeta të huaja me shpërndarje në Evropë. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën b, të kreut III, të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar dhe me nenin 16 të Ligjit Nr. 9874, datë 14/02/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 10 346, datë 04.11.2010, dhe Ligjin Nr. 12/2017, ku citohet: **Metodat e përllogaritjes së vlerës fillestare në ankandin publik. Përcaktimi i vlerës fillestare të një objekti ankandi bazohet në Vlerën Aktuale Monetare (VAM), çmimet e tregut, të dhënat e INSTAT-it apo të organeve të tjera shtetërore. Në vlerën fillestare përfshihen edhe detyrimet fiskale që lidhen me natyrën e objektit. Mënyra e përllogaritjes së vlerës fillestare do të përcaktohet në rregullat e ankandit publik.**

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën b, të kreut III, të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar, ku citohet:

“b) Ftesa për ofertë

Ftesa për ofertë sipas nenit 25 të LAP-së, përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t’u krijojë mundësinë ofertuesve/kandidatëve të plotësojnë dhe dorëzojnë ofertat e tyre. Ky informacion përfshin: një referencë për njoftimin e botuar; kriteret e shpalljes së fituesit; vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertës dhe vendin, datën dhe orën për hapjen e tyre; gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve; ndonjë informacion të mëtejshëm, që është vlerësuar i dobishëm nga autoriteti shitës. Në rastet kur objekte e shitjes janë mallra të një rëndësie të veçantë dhe me vlerë fillestare shitje mbi 100.000.000 lekë, ftesa do të botohet edhe në një gazetë të huaj me shpërndarje në Evropë.”

Në kontratën për sasinë 40,000 ton për shitje brenda vendit e fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria “R...E” sh.a., Elbasan, dhe “A...L” sh.a., Tiranë, u konstatua diferenca nga

çmimet e shitjes së shoqërive koncesionare me çmimet e llogaritura nga Albpetrol në vlerën **54,900 mijë lekë**.

Më datë 07.04.2021 është bërë njoftim ankandi për shitje naftë bruto me sasi 100,000 ton. Më datë 19.04.2021 është shpallur fitues Operatori ekonomik “E...A” sh.a.. Në zbatimin e kontratës prej 100,000 ton nga krahasimi i çmimeve të shitjes me ato të shoqërive koncesionare u konstatuan diferenca në vlerën **235,500 mijë lekë**.

Më datë 29.04.2022 është bërë njoftim ankandi për shitje naftë bruto me sasi 120,000 ton. Më datë 03.06.2022 është lidhur kontrata me afat 12 muaj, me Kontraktori, BOE “E...A” sha. dhe “R...E sha. Në zbatimin e kontratës prej 120,000 ton nga krahasimi i çmimeve të shitjes me ato të B...M u konstatuan diferenca në vlerën **536,300 mijë lekë**.

Modelet e llogaritjeve mund të përdoren për orientime ose për parashikime por është tregues që vendos se sa është çmimi i produktit (nafta bruto), dhe në rastin kur ky produkt naftë bruto nga shoqëritë koncesionare që menaxhojnë burimet hidrokarbure në Shqipëri e shesin me çmim më të lartë është tregues se modeli ekzistues nuk është i saktë dhe i krijon humbje financiare shoqërisë për një vlerë prej **826,750 mijë lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që në të ardhmen procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandëve të shitjes së naftës, të kryhet duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë të botohen në gazetata e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Në procesin e shqyrtimit të kontratave të ankandëve u konstatuan përlllogaritje të penalteteve për vonesa jo në përputhje me dokumentet e ankandit.

-Në kontratën e lidhur nga Albpetrol sh.a Patos, me shoqërinë E...L sh.a., me nr. 2815 Prot., datë 04.05.2021, për shitjen e sasisë 100,000 ton u konstatua se:

-Në Dokumentet Standarde të Ankandit Publik të përdorura në procedurën e ankandit për shitje, në pjesën kushtet e përgjithshme, neni nr. 1.1, “Qëllimi”, citohet: **Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK)** do të zbatohen për blerjen/shitjen e Mallrave/objekteve/ me anë të ankandit të hapur. Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 **Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:** b) *Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.*

Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet, 25.1 **Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së ofertuesit fitues.** Në kontratën e lidhur mes palëve neni 5.9, përcakton :” Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë apo në rast të mos tërheqjes së sasisë së mallit sipas mënyrës së përcaktuar (siç përcaktohet në aneksin nr. 1, bashkëlidhur), blerësi është dakord me penaltetet ditore që do të llogariten sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”. Kontrata është lidhur bazuar në Urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, i ndryshuar. **Kontrata mes palëve nuk ka pasqyruar kushtet e përgjithshme të procedurës së ankandit.**

Këto mospërputhje kanë pasur efektet në përlllogaritjen e penalteteve ditore për vonesat në tërheqjen e sasive të mallit. Albpetrol sh.a ka përlllogaritur 25 ditë vonesë për vlerën 403,212 lekë penaltete, kur sipas nenit 24 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës

së kontratës, ku vlera totale e kontratës është 4,594,332,577 lekë, pra 25 % është 1,148,583,144 lekë dhe 2/1000 është 2,297,166 lekë është penalteti ditor, për 25 ditë në total prej 57,025,938 lekë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos

-Në kontratën e lidhur nga Albpetrol sh.a Patos, me BOE shoqërinë E...L sh.a., dhe "R...E" sh.a., me nr. 3493/15 Prot., datë 03.06.2022, për shitjen e sasisë 120,000 ton u konstatua se: -Në Dokumentet Standarde të Ankandit Publik të përdorura në procedurën e ankandit për shitje, në pjesën kushtet e përgjithshme, neni nr. 1.1, "Qëllimi", citohet: **Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK)** do të zbatohen për blerjen/shitjen e Mallrave/objekteve/ me anë të ankandit të hapur. Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 **Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:**

b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës. Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet, 25.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së ofertuesit fitues.

Në kontratën e lidhur mes palëve neni 5.9, përcakton: " Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë apo në rast të mos tërheqjes së sasisë së mallit sipas mënyrës së përcaktuar (siç përcaktohet në aneksin nr.1, bashkëlidhur), blerësi është dakord me penaltetet ditore që do të llogariten sipas Ligjit nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare". Kontrata është lidhur bazuar në Urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure", i ndryshuar.

Kontrata mes palëve nuk ka pasqyruar kushtet e përgjithshme të procedurës së ankandit.

Këto mospërputhje kanë pasur efektet në përlllogaritjen e penalteteve ditore për vonesat në tërheqjen e sasive të mallit. Albpetrol ka përlllogaritur vonesa në vlerën 66,211 lekë penaltete, kur sipas nenit 24, Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore: Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës, ku vlera totale e kontratës është 4,769,065,763 lekë, pra 25 % është 1,192,266,441 lekë dhe 2/1000 është 2,384,533 lekë është penalteti ditor, për shoqërinë E...L sh.a., janë llogaritur 66,211 lekë, kur penaltetet janë 26,229,863 lekë dhe për shoqërinë "R...E" sh.a., janë llogaritur 89,110 lekë, kur penaltetet janë 54,844,259 lekë.

Vlera 80,918,801 lekë e pa llogaritur si penaltetet për vonesat në tërheqjen e sasive të produktit naftë bruto përbën dëm ekonomik për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin Nr. 9874, datë 14/02/2008 "Për ankandin publik" i ndryshuar me Ligjin Nr. 10 346, datë 04.11.2010, dhe Ligjin Nr. 12/2017, Kreu VI, zbatimi i kontratës, Neni 40.

Vlerat 80,918,801 lekë dhe 57,025,938 lekë të pa-llogaritura si penaltetet për vonesat në tërheqjen e sasive të produktit naftë bruto përbëjnë të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrësi i shoqërisë Albpetrol sh.a, Patos, të analizojë situatën në lidhje me të ardhurat e munguara të shoqërisë në vlerat **80,918,801 lekë dhe 57,025,938 lekë, si dhe** të marrë masa që në të ardhmen të llogarisë penaltetet për vonesa në tërheqjen e produktit naftë bruto nga OE fitues sipas dokumenteve standarde të procedurës së ankandit.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e lëvizjeve të produktit naftë bruto nga qendrat e prodhimit në qendrën e shitjeve u konstatua se produkti naftë në shumë raste dorëzohet jashtë standardit teknologjik S SH 51:1986 (Naftë bruto – Karakteristikat). Sipas standardit sasia e ujit nuk duhet të tejkalojë në përqindje për sektorët Ballsh 2%, Visokë 3%, Kasnicë 5%, Marinëz 2%, Marinëz sektorët 5,6,7 3%, Gorisht Amenicë 2% dhe Kuçovë 3 %. Në fletë hyrjet e Qendrës së Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit, QASHNG, u konstatuan raste të pranimit të produktit naftë në kushtet kur tejkalohet sasia e pranuar e ujit.

-Në lidhje me sasi të ujit që tejkalojnë normat teknologjike në produktin naftë argumentimet e specialistëve të QASHNG, Qendra e Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit, janë se nafta vjen jashtë standardeve nga qendrat e tjera, dhe për këtë fakt janë njoftuar administratorët, të cilët kanë lëshuar urdhra për pranimin e produktit naftë bruto dhe jashtë standardeve teknologjike, (me ujë mbi 3%, deri në 14 %). Urdhrat nr. 182 datë 07.09.2021, “Për procedurë e inspektimit dhe kontrollit të qarkullimit të produktit Naftë Bruto”, 182/2 datë 16.12.2021, dhe 182/3 datë 17.12.2021.

Argumentet e sjella nga qendrat janë se nuk kanë pajisjet për të bërë ndarjen e plotë të ujit dhe se nuk mund të ndalojnë punën në puse. Në momentin kur produkti i gatshëm i shitet kompanive fituese të ankandëve, në depozitat e shitjes nafta bruto ngrohet dhe përgatitet në parametrat teknologjikë me përqindje uji më të vogël se 3%, ndërkohë që pjesa tjetër është produkt i gatshëm në mungesë. QASHNG Patos është magazinë fiskale stokimi dhe nuk lejohen shkarkime uji teknologjik pas përgatitjes, si trajtim me sistem ngrohje me kaldajë mbi vlerën e lejuar.

Mos marrja e masave për zgjidhjen e problemeve për pasjen e produktit të gatshëm naftë bruto sipas standardeve teknike nga ana e administratorëve ka sjellë diferenca të produktit të gatshëm të kaluar në sistemin e doganës me kontabilitetin e mbajtur në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.

Laboratorët e përdorur në Albpetrol sh.a për analizat e produktit naftë bruto nuk janë të akredituar nga autoritetet përkatëse.

Shoqëria Albpetrol sh.a, nuk ka përmbyllur investimet për të ngritjen e strukturave teknologjike të cilat do të mundësojnë heqjen e sasive të ujit mbi normë.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me VKM Nr. 612, datë 2.9.2012 i ndryshuar, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, aneksi nr.17 matjet e produkteve, dhe me Standardet kombëtare të produktit naftë bruto.

Duke qenë se produkti naftë lëvizet nga vendburimet në stacionin e shitjes me tubacione dhe autobote, verifikimi në depozitë për përqindjen e ujit dhe zbritja në kontabilitet si produkt i gatshëm shton riskun e abuzimeve në produktin e gatshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a, të analizojë me kujdes situatën dhe të marrë masa për përfundimin e investimeve që do të mundësojnë përgatitjen e produktit naftë sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare për të rritur performancën dhe të ardhurat si dhe uljen e riskut të abuzimeve dhe cenimeve të aktiveve të shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

25. Gjetje nga auditimi: Qendra e Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit menaxhon shitjen e produktit naftë bruto tek Operatori Ekonomik fitues i procedurave të ankandit. Procedurat e marrjes së kampioneve dhe analiza e naftës kryhet sipas nenit 6 të Udhëzimit nr. 83 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, i ndryshuar.

Faturat bëhen për çdo autobot në bazë të peshës dhe duke marrë të dhënat e analizave të kryera në fillim të procesit dhe duke ju referuar temperaturës 15%.

Gjendja e strukturave dhe pajisjeve nga ku realizohet lëvrimi tek klientët është jashtë standardeve përkatëse. Depozitat e naftës, pajisjet matëse nuk janë certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, laboratorët që kryejnë analizat e mostrave nuk janë të akredituar nga institucionet përkatëse.

Nga kontrollat periodike të ushtruara nga Dega e Doganës Fier kanë rezultuar diferenca materiale të produktit naftë bruto të rezultuar nga matjet faktike me atë kontabël të mbajtur nga Albpetrol sh.a Patos.

Grupet e kontrollit të Degës së Doganës Fier, në kontrollat në lidhje për pagesat për akcizën, procedurat për matjen e sasive të naftës bruto në rezervuare, i kanë të përcaktuar në VKM nr. 612, datë 02.09.2012, ndryshuar, të cilat ndryshojnë nga metodologjia që përdor Albpetrol sh.a Patos

Kjo metodologji që përdor shoqëria nuk është e saktë dhe korrekte pasi kryhen tre matje të temperaturës dhe densitetit për një depozitë 5000 ton, dhe ndërkohë lëvrimi i sasisë mund të zgjasë deri në një javë si dhe depozita nuk zbrazet plotësisht.

Komisionet e caktuara për kryerjen e analizave të densitetit, bazohen në pikën 6.9, të Urdhrit nr. 83, ku citohet: “Densiteti i kampionit do të përcaktohet sipas metodës SSH 33, duke përdorur një aerometër të përshtatshëm dhe të kontrolluar. Temperatura dhe densitetet e matura dhe të korrektuara do të regjistrohen në “Raportin e analizave të naftës bruto” të përgatitur për kampionimi.” Ky standard është shfuqizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve dhe është zëvendësuar me SSH EN ISO 3675:1998. Ky standard në lidhje me marrjen e mostrave i referohet ISO 3170 (SSH EN ISO 3170:2004 59 faqe, KT 19, Produkte të lëngëta të naftës - Marrjen e mostrave manualisht), ose ISO 3171 (SSH EN ISO 3171:1999 59 faqe, KT 19, Metodatat e provës për naftën dhe produktet e saj - Lëngjet e naftës -Marrja automatike e mostrave me tubacion).

Mos përcaktimi i saktë i dendësisë së naftës bruto, në momentin e shitjes ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në çmimin e shitjes dhe reflekton në të ardhurat e shoqërisë. Në elementët e llogaritjes së çmimit të shitjes, pjesa më e madhe është përcaktuar nga faktorë të tjerë si çmimi në bursë, kursi i këmbimit të dollarit, etj., që janë të kontrolluar dhe pas faktit. Dy elementët që variojnë dhe maten për çdo shitje janë peshat e autoboteve që transportojnë produktin që shitet dhe densiteti i naftës bruto i cili përcaktohet një herë për një depozitë prej 5000-8000 m³. Në përcaktimin e riskut për dëmtimin e asetëve të shoqërisë si vjedhje ose mashtrime këto dy elementë kanë riskun më të madh. Veprimet më sipër janë në kundërshtim me ligjin Nr. 10 296, datë 08/07/2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 22.

VKM nr. 612, datë 02.09.2012, ndryshuar me: Vendimin Nr. 128 datë 20.2.2013, Vendimin Nr. 501, datë 22.5.2013, Vendimin Nr. 30, datë 14.1.2015, Vendimi nr. 38, date 21.01.2016, Vendimi nr. 28, date 18.01.2017 Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”. Neni 96, Neni 99 Pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të analizojë situatën në të cilën kryhet procesi i shitjes së naftës bruto, të vlerësojë procedurat përkatëse të kontrollit, të evidentojë zonat me risk në cenimin e produktit të gatshëm, si dhe të krijojë grupe pune që në procesin e matjes së naftës bruto në shitjet që kryen shoqëria, të garantohet zbatimi i standardeve kombëtare e ndërkombëtare.

Menjëherë dhe vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tre procedurave të ankandeve të shitjes së naftës u konstatua se grupi i eksperteve, për përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar të shitjes së naftës bruto ka bërë ulje shpenzimesh nga çmimi i shitjes së përcaktuar të ankandit, duke presupozuar shpenzime për vënien e produktit në kushtet FOB sipas kushteve të Bursës Ndërkombëtare për hidrokarburet (Bursës Ndërkombëtare Brent), bazuar në udhëzimin 83, datë 10.02.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, pika 5, Të dhënat e bursës “Platts”, kuotojnë çmimin Naftë Bruto-Brent (Ddl), në dollarë dhe me kushte lëvrimi FOB (Free on Board), pra lëvrimi deri kuvertën e anijes në një port të caktuar.

Grupi i ekspertëve ka bërë përlllogaritje të ndryshme për transportin me autobote në porte të caktuara, ngrohjen e naftës gjatë rrugës, siguracionin, magazinimin në port, shpenzime shkarkimi etj, duke rezultuar me një ulje në çmimin që duhet të paguajë Operatori Ekonomik fitues i ankandit të shitjes së naftës. Pjesa më e madhe e shpenzimeve të përlllogaritura në çmimet e shitjes nuk ndodhin pasi shitjet e naftës janë kryer me operatorë ekonomikë vendas.

Relacionet për përlllogaritjen e çmimit fillestar, pas aprovimit nga administratori, janë dërguar për miratim te Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës.

-Në procedurën për sasinë 40,000 ton e fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria “R...E” sh.a., Elbasan, dhe “A...L” sh.a., Tiranë, vlera e shpenzimeve të pa kryera janë 3.55 USD/bbl për sasinë 40,000 ton, arrijnë në shumën **859,000 USD**.

-Në procedurën për shitje naftë bruto me sasi 100,000 ton, me fitues “E...A”, vlera e shpenzimeve të pa kryera janë 3.6 USD/bbl, për sasinë 100,000 ton, arrijnë në shumën **2,307,000 USD**.

-Në procedurën për shitjen e 120,000 ton naftë bruto, me fitues BOE “E...A” sha, dhe “R...E” sha, vlera e shpenzimeve të pa kryera arrin në shumën **2,630,000 USD**.

Vlera 5,797,000 USD përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 296, datë 08/07/2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2,. Neni 3, udhëzimit 83, datë 10.02.2012, “Për

rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure” Pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që procesi i përcaktimit të çmimit të shitjes së naftës bruto të kryhet bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të kostove të shoqërisë, të çmimit të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të kostove reale që mund të dalin gjatë procesit të shitjes së produktit, për të shmangur mungesën e të ardhurave nga një proces jo transparent dhe jo efektiv.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “B.....”, rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se, Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria BPAL është realizuar, madje është tejkaluar. Gjatë vitit 2021 prodhimi ishte 3,786.19 Mbbl, shifër kjo e cila është mbi parashikimin e bërë në PP&B 2021. **Shpenzimet Operative (OPEX).** Shpenzimet operative kapin vlerën 54,344 M\$ nga 60,659 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 6,315 M\$ ose 10%. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi me një diferencë relativisht të vogël. Shpenzimet Administrative (G...A): Realizimi i G...A për vitin është realizuar mesatarisht në masën 69%.

Investimet Kapitale (CAPEX): Realizimi i Capex për vitin është realizuar mesatarisht në masën 60%. Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për vitin 2022: Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria BPAL është realizuar vetëm në masën 86%. Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 prodhimi ishte 2,520 Mbbl , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021.

Shpenzimet Operative (OPEX): Shpenzimet operative kapin vlerën 44,394 M\$ nga 46692 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 2,298 M\$ ose 2%. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2022 janë më të ulta sesa parashikimi me një diferencë relativisht të vogël. Shpenzimet Administrative (G&A): Realizimi i G&A për vitin është realizuar mesatarisht në masën 74%.

Investimet Kapitale (CAPEX): Realizimi i Capex për vitin është realizuar mesatarisht në masën 50%. Cost Recovered: Në vitin 2022, sipas Faktit të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1.Rekomandimi: Administratori në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol.

Menjëherë dhe vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “B.....” ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetroli ka kryer auditet vjetore dhe rezultat e tyre në vite janë kontestuar nga B...S dhe janë çuar për gjykim në Gjykatën e Arbitrazhit. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:

Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020 për B.....A është 2,913,868 (dy milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) USD

Në bazë të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure” “Albpetroli do të ketë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj nga marrja e secilës deklaratë të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione përsa i përket ndonjë deklaratë të tillë të Llogarisë Kosto, me kusht që Albpetroli nuk do të titullohet të kryejë më shumë

se dy audite të librave të Llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një Vit Fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakord për çdo rregullim të kërkuar. Dokumente shtesë dhe llogarie do të bëhen të disponueshme për Albpetrolin gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës së mësipërme prej dymbëdhjetë (12) muaj Albpetroli nuk ka -këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë do të konsiderohet e aprovuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **2,913,868 USD** të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë

29. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i korrespondencës me palëve u konstatua mos prezenca e Albpetrol gjatë kryerjes së procesit të inventarizimit nga kontraktorët e marrëveshjeve hidrokarbure. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos me shkresën me Nr. 10641 Prot., datë 24.12.2021 ka dërguar njoftim në lidhje me personat që do të marrin pjesë në procesin e inventarizimit të fund vitit 2021. (inventarizimin e materialeve dhe atë të naftës bruto). Shoqëria Albpetrol sh.a Patos, me shkresën me Nr. 1051 Prot., datë 03.02.2022, ka kërkuar nga BPAL që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2021, për vendburimin Patos-Marinëz. Në mungesë të një përgjigje nga ana e shoqërisë "B.....", me shkresën me Nr. 1051/1 Prot., datë 22.04.2022, shoqëria "Albpetrol" Sh.A ka dërguar një kërkesë të përsëritur. Shoqëria "B.....", me shkresën me Nr. 9145 Prot., datë 20.12.2022, njofton për procesin e inventarizimit të fundvitit 2022.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos, me shkresën me Nr. 1067 Prot., datë 13.2023, ka kërkuar nga BPAL që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2022, për vendburimin Patos-Marinëz.

Strukturat drejtuese të Albpetrol sh.a me anë të mosveprimit të tyre kanë lenë në mungesë monitorimi gjendjen e aseteve të dhëna në përdorim si dhe blerjen e aseteve të reja nga kontraktori si dhe ecuria e jetëgjatësisë së tyre.

Pika 2.4.2 e Marrëveshjes Hidrokarbure "Në intervale të arsyeshme, të paktën çdo vit, do të bëhen nga Kontraktori inventarë për të gjithë Materialet e Kontrollueshëm, dhe në vijim të çdo inventari, do të rregullohen librat e llogarive dhe regjistrimet për të reflektuar rezultatet e inventarit. Kontraktori do të njoftojë me shkrim tridhjetë (30) ditë për qëllim të inventarëve të tillë për të lejuar Albpetrolin për të zgjedhur nëse do të përfaqësohet apo nuk do të përfaqësohet kur të kryhet inventari.

Kjo situatë është konstatuar me të gjithë kontraktorët e Marrëveshjeve Hidrokarbure. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

29.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që në çdo proces inventarizimi të kontraktorëve të Marrëveshjeve Hidrokarbure të dërgojë përfaqësues të Albpetrol sh.a Patos dhe të evidentohet me përgjegjësi ekzistenca e aseteve të dhëna në përdorim dhe statusi i përdorimit të tyre.

Menjëherë dhe vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Kontraktori "A...." SH.A. rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se, **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria A...O është 27,733.99 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 29,678 Ton, pra me një mosrealizim prej 7%. Ky është prodhimi më i lartë i realizuar në vendburimin Ballsh-Hekal.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 2,214.96 M\$ nga 1,899.7 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 315.26 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të larta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një realizim në masën 17% më shumë se parashikimi.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 527.95 M\$ nga 410 M\$ të parashikuara në PP&B 2021 Realizimi i G&A per vitin është realizuar madje është tejkaluar në masën 29% nga parashikimi.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 janë kryer 1,893.74 M\$ Investime nga 3,628 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021. Sipas kontraktorit, kjo ka ardhur kryesisht prej mosrealizimit të investimeve që kërkojnë leje dhe që janë ende pezull.

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për 9-Mujorin e vitit 2022 vërehet se:

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria A...O është 19,982.09 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 21,940.35 Ton, pra me një mosrealizim prej 9%.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 1,130.88 M\$ nga 1,693 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 562.12 M\$. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022, me një mosrealizim në masën 33% më pak se parashikimi.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e vitit 2022, kanë qenë 381.97 M\$ nga 366.75 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Realizimi i G&A per vitin është realizuar madje është tejkaluar në masën 4% nga parashikimi.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 1,605.51 M\$ Investime nga 2,597 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për 9-Mujorin e vitit 2022, janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022.

Cost Recovered: Për 9-Mujorin e vitit 2022, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Shoqëria A... sha, megjithëse ka pasur rritje të të ardhurave nuk ka realizuar investimet e parashikuara në Planin e Punës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, duke kërkuar respektimin e planit të miratuar, bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol.

Menjëherë dhe vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “A...” SH.A. ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Ballsh-Hekal” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:

Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020 për A.... Sh.A është 71,306.21 USD. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **71,306,.21 USD** të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë

32. Gjetje nga auditimi: Kontraktori D....., rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria “D...Y” Ltd., është 0 Ton naftë kondesat dhe 0 NM3 Gaz, ndërkohe që në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2021 kishin parashikuar 3,550 Ton naftë kondesat dhe 25,680,000 Nm3 Gaz. **Shpenzimet Operative (OPEX).** Shpenzimet operative kapin vlerën 657 M\$

nga 778.52 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 121.52 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 16%. **Shpenzimet Administrative (G&A):** Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 368 M\$ nga 426.6 M\$ të parashikuara në PP&B 2021, me një mosrealizim prej 14%. **Investimet Kapitale (CAPEX):** Gjatë vitit 2021 janë kryer 5,701 M\$ Investime nga 19,842.88 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 71%. **Cost Recovered:** Në vitin 2021, sipas Faktit, shpenzimet kapin vlerën 7,293 M\$, duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për 9-Mujorin e vitit 2022 vërehet se Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria "D...Y" Ltd., është 112.26 Ton kondesat dhe 0 Nm3 Gaz, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 3,881 Ton kondesat dhe 288,080,000 m3.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 761 M\$ nga 2,196.31 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 1,435.31 M\$. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022, me një mosrealizim prej 65%.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e Vitit 2022, kanë qenë 406 M\$ nga 1,178.1 M\$ të parashikuara në PP&B 2022, me një mosrealizim prej 66%

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 1,922 M\$ Investime nga 8,970 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për 9-Mujorin e vitit 2022 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022, me një mosrealizim gati 79%. **Cost Recovered:** Në 9-Mujorin e vitit 2022 sipas Faktit, shpenzimet kapin vlerën prej 3,091 M\$, duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol sh.a Patos.

Menjëherë dhe vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Kontraktori D...., ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 "Auditet" të Marrëveshjes Hidrokarbure "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Delvinë" ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar se vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020 për shoqërinë "D...Y" LTD është 161,373.29 USD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

33.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **161,373.29 USD** të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë dhe vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Kontraktori "T...S" SH.A., rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se, **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria "T...S" SH.A. është 14,827.3 Ton , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 27,228 Ton, pra me një mosrealizim prej 46%. Kjo diferencë përgjithësisht i atribuohet faktit që pavarësisht se të parashikuara në Buxhet 4-Projektet e përmirësimit të puseve ekzistuese nuk kanë dhënë akoma impaktin e parashikuar në Prodhim. **Shpenzimet Operative (OPEX)**, shpenzimet operative kapin vlerën 2,779 M\$ nga 3,689.73 M\$ të

parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 910.73 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021. Peshën me të madhe e zënë shpenzimet për energji elektrike dhe për holluesin teknologjik për shkak të karakteristikave që ka nafta e Vb. Visokë. **Shpenzimet Administrative (G&A):** Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 1,582 M\$ nga 688 M\$ të parashikuara në PP&B 2021 Realizimi i G&A për vitin është realizuar madje është tejkaluar. **Investimet Kapitale (CAPEX):** Gjatë vitit 2021 janë kryer 866 M\$ Investime nga 3,173.13 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021. **Cost Recovered:** Në vitin 2021, sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për 9-Mujorin e vitit 2022, vërehet se, **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria TOS është 9,947 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 16,962 Ton, pra me një mosrealizim prej 41%. Kjo diferencë përgjithësisht i atribuohet faktit që pavarësisht se të parashikuara në Buxhet 4-Projektet e përmirësimit të puseve ekzistuese nuk kanë dhënë akoma impaktin e parashikuar në Prodhim. **Shpenzimet Operative (OPEX).** Shpenzimet operative kapin vlerën 1,766 M\$ nga 3,122.92 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 1,356.92 M\$. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022. Peshën me të madhe e zënë shpenzimet për energji elektrike dhe për holluesin teknologjik për shkak të karakteristikave që ka nafta e Vb. Visokë. **Shpenzimet Administrative (G&A):** Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e Vitit 2022, kanë qenë 1,130 M\$ nga 560 M\$ të parashikuara në PP&B 2022 Realizimi i G&A për vitin është realizuar madje është tejkaluar. **Investimet Kapitale (CAPEX):** Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 936 M\$ Investime nga 2,232.8 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për 9-Mujorin e vitit 2022 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022. **Cost Recovered:** Në 9-Mujorin e vitit 2022 sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Visoke” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar se vlera totale prej 20,569 USD nuk njihet si Kosto Hidrokarbure dhe duhet të zbritet nga Llogaria Kosto. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

34.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **20,569 USD** të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë dhe vijimësi

35. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “F...M” SH.A., rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se, **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria F...K, është 944.85 Ton, shifër kjo e cila është mbi parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 370.8 Ton. **Shpenzimet Operative (OPEX).** Shpenzimet operative kapin vlerën 100.82 M\$ nga 22 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të larta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 12.21 M\$ shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej nga 26.49 M\$.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 nuk janë kryer Investimet, ndërkohë që në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2021 ishin programuar 18 M\$.

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për 9-Mujorin e vitit 2022, për Vendburimin P...Z, vërehet se **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria F...K, është 1,056.32 Ton, shifër kjo e cila është mbi parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 287 Ton. **Shpenzimet Operative (OPEX)**. Shpenzimet operative kapin vlerën 312.97 M\$ nga 28.9 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të larta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022. **Shpenzimet Administrative (G&A)**: Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e vitit 2022, kanë qene 6.14 M\$ shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej nga 12 M\$. **Investimet Kapitale (CAPEX)**: Investimet për 9-Mujorin e vitit 2022 kapin vlerën 12.73 M\$ ndërkohë që në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2022 ishin programuar 9.5 M\$. **Cost Recovered**: Në 9-Mujorin e vitit 2022, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

35.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol sh.a Patos.

Menjëherë dhe vijimësi

36. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “F.....M” Sh.a, ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Nga kontrolli që grupi auditit të “Albpetrol” Sha, ka kryer mbi kompaninë “F.....M” Sh.a për periudhën Q1,Q2,Q3 dhe Q4 2020 si dhe pas kërkesave të shumta që u ka dërguar përfaqësuesve të kësaj kompanie nëpërmjet postës elektronike dhe verbale, për dërgimin e një CRS-je të detajuar, fatura TVSH-je dhe statement banke, grupit të auditit nuk i është vënë në dispozicion asnjë nga dokumentet e kërkuara. Për sa më sipër, shoqëria “Albpetrol” Sha, ka kërkuar të procedohet me zbritjen e të gjitha kostove me vlerën 77,977 USD dhe shpenzimeve nga Llogaria Kosto, për vitin 2020, të cilat nuk janë kualifikuar si kosto hidrokarbure në zbatim të të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Finiq-Kranë dhe P...Z”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

36.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën 77,977 USD të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë dhe vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “SH...M”.., rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se, **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria SIPL është 7,000 Bbl , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 9,909 Bbl, pra me një mosrealizim prej 29%. **Shpenzimet Operative (OPEX)**. Shpenzimet operative kapin vlerën 428 M\$ nga 481 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 53 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 11%.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 173 M\$ nga 281 M\$ të parashikuara në PP&B 2021 Pra, Shpenzimet Administrative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 38%. **Investimet Kapitale (CAPEX)**: Gjatë vitit 2021 janë kryer 88 M\$ Investime nga 322 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021.

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për 9-Mujorin e vitit 2022 vërehet se, **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria SIPL është 4130.2 Bbl , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 8324 Bbl, pra me

një mosrealizim prej 50%. **Shpenzimet Operative (OPEX).** Shpenzimet operative kapin vlerën 351 M\$ nga 407 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 56 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e 9-Mujorit të vitit 2022, me një mosrealizim prej 14%.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e vitit 2022 kanë qene 153 M\$ nga 114 M\$ të parashikuara në PP&B 2022 Pra, Shpenzimet Administrative për vitin 2021 janë mbi parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022. **Investimet Kapitale (CAPEX):** Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 83 M\$ Investime nga 309 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2022 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022. **Cost Recovered:** Në vitin 2022, sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

37.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol sh.a Patos.

Menjëherë dhe vijimësi

38. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “SH...M”, ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Kucovë” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar se, vlera totale e kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020, për SIPL është 248,807 USD. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

38.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **248,807 USD** të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë dhe vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27/12/2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Administratori i Albpetrol sh.a Patos**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi Zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **4,416,935,188 lekë** si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se detyrimet e koncesionarëve ndajë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për energjinë e shitur/faturuar me dhe pa kontrata janë në shumën 1,429,616 mijë lekë, nga e cila kamatëvonesë për mos pagim në afat për vlerë 1,583,865 mijë lekë. Nga ana e sajë shoqëria Albpetrol sh.a Patos, ka vijuar me pagesat sipas akt-marrëveshjes datë 03.10.2022, midis FSHU sh.a dhe shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për pagesë me 24 këste të detyrimeve, duke paguar në mënyrë të padrejtë dhe për detyrimet e koncesionarëve.

Gjithashtu, shoqëria Albpetrol sh.a Patos, nga ana e saj nuk ka marrë asnjë masë shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve të energjisë elektrike të konsumuar nga shoqëritë koncesionareve. **Ky veprim përben risk të lartë për shoqërinë “ALBPETOL” sha me efekt financiar me dëm në shumën 3,013,481,000 lekë së bashku me kamatëvonesat, pasi në rast falimentimi ose largimi të ndonjë prej shoqërive koncesionare detyrimet për energjisë mbesin për likuidim shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, gjë e cila bëhet akoma dhe më e vështirë për ato shoqëri koncesionare që nuk kanë kontratë shitje energjie për të kërkuar në gjykatë detyrimet, duke rënduar situatën financiare të shoqërisë Albpetrol.**

Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 3, Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës shkronja “g”, ku citohet:

Garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mbledhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta.

si dhe neni 10 i kontratës me O...E për jo familjar, kamatëvonesa për pagesë të vonuar, ku citohet:

“Pas kalimit të afatit të pagesës caktuar në nenin 9.1, Klienti është i detyruar të paguajë një kamatë vonesë të barabartë me 0.1 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të njoftoj Këshillin Mbikëqyrës dhe të nxjerrë përgjegjësitë për detyrimet që shoqëritë koncesionare kanë ndajë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për energjinë e shitur/faturuar me dhe pa kontrata, si dhe të ndjek të gjithë rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,013,481,000 lekë** (principlial në vlerën 1,429,616,000 lekë dhe kamatëvonesë në vlerën 1,583,865,000 lekë), për të shmangur lindjen e borxhit të keq.

Brenda datës 31.12.2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “Përmirësim i infrastrukturës së stacionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos”, me fond limit 59,970,906 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur shoqëria “Z....I” shpk me vlerë kontrate (pa TVSh) prej 59,955,454 lekë, rezulton se nuk janë zbatuar kushtet e kontratës nr. 2905/9, datë 22.6.2021 të lidhur midis shoqërisë “Z....I” shpk dhe Autoritetit Kontraktor Albpetrol sh.a Patos, për përfundimin e punimeve brenda afatit të 4 muajve, ose nga **data 22.6.2021 deri me datë 21.10.2021.**

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Financës në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, është likuiduar shuma totale 71,944,212 lekë.

Nga shoqëria “Z....I” shpk janë paraqitur fatura për likuidimin e situacioneve jashtë afatit të zbatimit të kontratës (data 21.10.2021), konkretisht fatura nr. 5/2022, datë 15.3.2022 në shumën 10,473,575 lekë me TVSh ose në vlerën 8,727,979 lekë pa TVSh, për të cilën nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos (personat përgjegjës) nuk janë llogaritur penalitet në referencë të nenit 9 të kontratës, **kjo për 144 dite vonesë.**

Gjithashtu nga shoqëria “Z....I” shpk nuk është bërë i mundur që në momentin e deklarimit të përfundimit të punimeve dhe akt-marrjes së përkohshme të depozitohet dhe fatura e shoqëruar me situacion përfundimtar për punimet e mbyllura, duke lënë jashtë afateve vlerën e mësipërme, për të cilën nga personat përgjegjës duhej të llogaritej penaliteti në vlerën **8,633,585 lekë** $\{(59,955,454 \text{ lekë} \times 25\%) = (14,988,863 \text{ lekë} \times 4/1000 \text{ ditë vonesë} \times 144 \text{ ditë})\}$, **vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos**, në kundërshtim me nenin 9 të kontratës nr. 2905/9, datë 22.6.2021 për “Përmirësim i infrastrukturës së Stacionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin masa duke ndjekur të

gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **8,633,585 lekë**, për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 2905/9, datë 22.6.2021 nga shoqëria “Z...I” shpk.

Brenda datës 31.12.2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “Blerje kalimatës naftë (flow-metër)”, me fond limit 37,936,920 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur shoqëria “V...S” me vlerë kontrate (pa TVSh) 37,178,181 lekë, rezulton se nuk janë zbatuar kushtet e kontratës nr. 1079/9, datë 19.4.2022 të lidhur midis shoqërisë “V...S” shpk dhe Autoritetit Kontraktor shoqërisë Albpetrol sh.a për përfundimin e punimeve brenda afatit 4 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës ose **nga data 19.4.2022 deri me datë 19.8.2022.**

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Financës në shoqërinë *Albpetrol sh.a Patos*, konstatohet se është paraqitur për likuidim vlera 44,613,816 lekë, nga e cila likuiduar në masën 80% sipas pikës 3.2 të nenit 3 të kontratës në vlerën 35,691,053 lekë dhe nuk është likuiduar vlera prej 8,922,763 lekë ose 20% e kontratës po sipas nenit 3 të kontratës, pika 3.2, **pasi 20% do likuidohet pasi pajisja të jetë instaluar në vend.**

Mallrat janë bërë hyrje në magazinë e QFT Patos, kjo sipas pikës 4.8/a të nenit 4 të kontratës, konstatuar kjo dhe nga komisioni i marrjes në dorëzim me PV nr. 472/2, datë 16.9.2022, sipas urdhrorit datë 20.4.2022.

Konstatohet se nuk është bërë instalimi i kalimatasve, vënia në punë dhe realizimi i asistencë teknike, **siç përcaktohet në pikën 2.4.3 të nenit 4 të kontratës me 180 ditë vonesë**, ku megjithëse nga shoqëria *Albpetrol sh.a Patos* është kërkuar me urgjencë për shitjen e naftës sipas kërkesave të doganës, akoma edhe sot qëndrojnë të pamontuara në magazinë dhe të pa vënë në punë, duke bërë që nafta të matet me sasi/ton, duke e klasifikuar këtë shpenzim një shpenzim paefektivitet për shoqërinë me **fond 37,936 mijë lekë nga mosvënia në punë e kalimatasve për të cilën është realizuar procedura e prokurimit.**

Nga sa trajtuam kontrata nuk ka përfunduar sipas kushteve të përcaktuara në nenin 9 të kontratës, brenda periudhës 4 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës së bashku me shtesën ose **nga data 19.4.2022 deri me datë 31.8.2022, pasi mallrat qëndrojnë akoma në magazinë pa u vënë në funksion për të cilën shoqëria “ALBPETROL” sha ka kryer shpenzimin.**

Kështu për vlerën 8,922,763 lekë, që korrespondon 20% të vlerës së kontratës e cila nuk është zbatuar, penaliteti përllëgaritet në vlerën **1,606,096 lekë** ($8,922,763 \text{ lekë} \times 25\% = 2,230,690 \text{ lekë}$ $\times 4/1000 \times 180 \text{ ditë vonesë}$), **veprime me dëm në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.**

Gjithashtu konstatojmë se pavarësisht faktit se nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 6774 prot, datë 24.9.2020 dhe shkresës së Drejtorisë së Doganës Fier nr. 2399 prot, datë 7.6.2021 i është kërkuar shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për pajisjen e pikave fundore të shitjes së naftës bruto me paisje për matjen (kaliamtës), nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos megjithëse procedura është zhvilluar dhe lidhur kontrata me subjektin fitues “V...S” shpk, **nuk është bërë i mundur vënia në punë e këtyre aparaturave sipas kushteve të kontratës ose nga data 23.8.2022**, megjithëse këto paisje janë bërë hyrje në magazinë, duke e bërë këtë një shpenzim jo me efektivitet dhe **që pengon procesin e shitjes së naftës**, në kundërshtim me nenin 20 të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në RSH”, i ndryshuar dhe kushtet e kontratës nr. 1079/10, datë 19.4.2022 për realizimin e blerjes me objekt “Blerje Kalimatës naftë (flow-metër)”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a të ngrejë një grup pune dhe të analizojë përgjegjësinë e personave përgjegjës në mos zbatimin e kushteve të kontratës me objekt “Blerje Kalimatës naftë (flow-metër)”, ku për personat përgjegjës të kërkohet shpërblymi i dëmit në vlerën **1,606,096 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët. Të marra masa të menjëhershme për vënien në punë të kalimatasve sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e zbatimit.

Brenda datës 31.12.2023

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “Eternit” i çative të repartit Mekanik dhe reparti Elektrik në QMN Kuçovë”, me fond limit

9,953,982 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur shoqëria “A....T” me vlerë kontrate (pa TVSh) 9,187,380 lekë, rezulton se:

Preventivi është hartuar nga specialistët *ing. R.G*, bazuar në çmimet sipas VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar. Nga verifikimi i çmimeve sipas manualit, konstatohet se ato janë nuk janë në zbatim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015, i ndryshuar, *konkretisht*:

Nr. An	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi sipas preventivit	Çmimi sipas manualit	Vlera sipas preventivit	Vlera sipas manualit	Diferenca
2/214+256/b	Riparim catie + mbulim me sanduic	m2	476	4911	3816	2,337,636	1,816,416	521,220

Nga sa trajtuam mësipërm vlera e preventivit është rënduar më shumë prej **521,220 lekë**, veprime me efekt negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në kundërshtim VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjor për arkëtimin e vlerës **521,220 lekë**, ndaj *ing. R.G* si personi përgjegjës për hartimin e disa prej zërave të projektit në kundërshtim VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Brenda datës 31.12.2023

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “Eternit” i çative të reparitit Mekanik dhe reparti Elektrik në QMN Kuçovë”, me fond limit 9,953,982 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur shoqëria “A....T” me vlerë kontrate (pa TVSh) 9,187,380 lekë, rezulton se nuk janë zbatuar kushtet e kontratës nr. 8489/9, datë 3.3.2022 të lidhur midis shoqërisë “A....T” Shpk dhe Autoritetit Kontraktor Albpetrol sh.a Patos, për përfundimin e punimeve brenda afatit të 8 javëve, ose nga **data 29.3.2022** (*data e fillimit të punimeve*) **deri me datë 4.5.2022**.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria Financës, rezulton se nuk është likuiduar asnjë vlerë e situacionuar, kjo pasi sipas znj. A.B në dosjen teknike të përcjell për likuidim nuk është bashkëlidhur situacioni përfundimtar i punimeve.

Me shkresën nr. 134/6, datë 15.12.2022 të Drejtorit të Qendra Mekanike e Naftës QMN Kuçovë përcjellë në adresë të Drejtorisë së Financës shkresa me lëndë “Dërgim dokumentacioni”, në të cilën janë listuar dhe dokumentacioni që shoqëron. Në këtë liste është dhe situacioni përfundimtar. Me MEMO nr. 9218/1, datë 22.12.2022 të Drejtorisë së Programimit në adresë të E. D. me detyrë Administrator, është përcjellë informacion mbi zbatimin e kontratës me nr. 8449/12, datë 3.3.2022, duke informuar administratorit mbi fazat e zbatimit të kontratës nga momenti i përfundimit të punimeve datë 4.5.2022 deri në hartimin e akt kolaudimit. Në këtë MEMO në pikën 3 thuhet se situacioni përfundimtar është në përputhje me projekt preventivit.

Me shkresën nr. 134/7, datë 22.12.2022 (*prot ALBPETROL nr. 9218, datë 22.12.2022*), DMN Kuçovë kërkesë për likuidim, duke rreshtuar gjithë dokumentacionin e plotë.

Pas ballafaqimit të problematikës mbi arsyet e moslikuidimit nga znj. A.B u rishpjegua se dokumentacioni shoqërues nuk është i saktë. Për këtë me MEMO datë 17/01/2023 (*e pa protokolluar në instucioni*) dhe pa nënshkruar nga personat se kujt i është adresuar, thuhet se me anë të kësaj shkrese kërkohet plotësimi i praktikës me dokumentacion me argumentin se “Nuk mund të vijohet me procedurën e likuidimit pasi kjo kontratë është e paplotësuar me dokumentacioni justifikues dhe kërkohet plotësimi i saj”.

Në këtë MEMO për veç faktit se nuk është e protokolluar dhe pa nënshkruar nga personat të cilëve ju është adresuar MEMO në institucioni, në kundërshtim me rregulloren e Albpetrol sh.a Patos (miratuar me vendimit nr. 20, datë 3.12.2022), por nuk është e specifikuar se cilat nga dokumentacioni justifikues nuk është paraqitur ose është i parregullt.

Me shkresën nr. 1081, datë 13.2.2023 Drejtorja e Programimit për dijeni dhe Administratorit z. E. D i përcjellë Drejtorisë së Financës dokumentacionin e plotë për zbatimin e kontratës nr. 1081, datë 13.2.2023, duke listuar të gjithë dokumentat, ku bë pjesë dhe situacioni përfundimtar (nr. 27 i listës).

Nga znj. A.B për sqarimin e situatës është paraqitur situacioni i cili është pa datë por i nënshkruar nga gjithë peronat përgjegjës, situacioni i cili në dosjen e zbatimit dhe dokumentacioni shoqërues për likuidim mungonte. Pretendimi i Drejt/Financës se situacioni është i panënshkruar nuk qëndron, pasi ai është nënshkruar nga subjekti, mbikëqyrë si dhe E. D. në cilësinë e Administratorit.

Referuar sa mësipërm fatura nr. 35/2022, datë 29.6.2022 në shumën 11,024,856 lekë e cila është depozituar në Drejtorinë e Financës me datë 22.12.2022 nuk është mundësuar likuidimi i saj deri në datë 31.3.2023, në kundërshtim me nenin 29 pika 5 e kontratës nr. 8489/9, datë 3.3.2022.

Sipas dokumentacionit në financë, shoqëria "A...T" shpk ka paraqitur për likuidim faturën nr. 35/2022, datë 29.6.2022 në shumën 11,024,856 lekë me TVSh (vlera e plotë e kontratës).

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se nga shoqëria fatura është paraqitur jashtë **afatit të zbatimit dhe kjo e pashoqëruar me situacion përfundimtar** (data 29.6.2022), dokumentacion bazë që tregon përfundimin e punimeve për të cilën nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos nuk janë llogaritur penalitetet në masën 4/1000 në **ditë jo më pak se 25% e vlerës së kontratës**, kjo në referencë të nenit 33 të kontratës, për ditëvonesat përllogaritjen prej **55 dite vonesë nga data 4.5.2022 deri datë 29.6.2022.**

Nga sa trajtuam mësipërm shoqëria "A...T" shpk nuk ka plotësuar kushtet e kontratës për mbylljen e sajë brenda afatit ligjorë duhet të llogaritet penaliteti në shumën **505,305 lekë** $\{(9,187,380 \times 25\% = (22,96,845 \text{ lekë} \times 4/1000 \text{ ditë vonesë} \times 55 \text{ ditë})\}$, **vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **505,305 lekë**, për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 8489/9, datë 3.3.2022 nga shoqëria "A...T" shpk

Brenda datës 31.12.2023

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt: "Shërbime për punime me autosondë me kullë me kapacitet ngritës > 70 ton", me fond limit 15,900,000 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur fitues shoqëria "S...B" shpk me vlerë kontrate (pa TVSh) prej 14,900,000 lekë, rezulton se:

Nga shoqëria nuk janë plotësuar kushtet e kontratës nr. 6081/11, datë 30.9.2021 të lidhur midis shoqërisë "S...B" shpk dhe AK (Albpetrol sh.a), me vlerën 14,900,000 lekë pa TVSh ose vlera 17,880,000 lekë me TVSh për zbatimin e afatit brenda 12 muajve ose nga **data 30.9.2021 deri me datë 30.9.2022.**

Nga të dhënat e marra nga Drejtorja Financës në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, shoqëria ka paraqitur për likuidim fatura në shumën totale 6,339,710 lekë, vlerë e cila është likuiduar nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos deri me datë 16.9.2022.

Nga ana e shoqërisë "S...B" shpk nuk është mbyllur kontrata për vlerën 17,880,000 lekë, kjo deri me datë 30.9.2022, duke mbetur pa zbatuar vlerën 11,540,290 lekë (17,880,000 – 6,339,710), për ditë vonesat janë **180 dite vonesë nga data kur duhej mbyllur kontrata..**

Për zbatimin e kësaj kontrate është ngarkuar **z. I.Ç me profil ing. Naftë pranë Drejt/Prodhimit**, në zbatim të urdhrin nr. 6081/12, datë 30.9.2021.

Konstatohet se nuk ka asnjë dokument justifikues mbi vonesat e mos mbylljes në afat të kontratës, veprime në shkëlqje të nenit 14 të kontratës 6081/11, datë 30.9.2021, ku deri me datë 30.3.2023

detyrimi për kamatëvonesën e pallogaritur përlllogaritet në shumën **2,682,000 lekë** (14,900,000 x 25%) = (3,725,000 lekë x 4/1000 x 180 ditë vonesë), **vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin të gjitha masat për ndjekjen e procedurave administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës **2,682,000 lekë** nga shoqëria **“S....B” shpk**, si dhe marrjen e masave ndajë personave përgjegjës në mos ndjekjen e kontratës sipas afateve.

Brenda datës 31.12.2023

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt *“Ndërtim RVM 1500 m3 në parkun Dekantim Gorisht”*, me fond limit 14,666,892 lekë pa TVSh viti , në të cilën kanë marrë pjesë 2 OE, fitues është shpallur shoqëria *“A...6”* shpk me ofertë 13,976,934 lekë më të lartë se OE i skualifikuar, *rezulton se:*

Me shkresën nr. *Ska*, datë *ska* të Drejtorisë Financës i është kërkuar Administratorit që në zbatim të kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021 dhe amendament kontrate nr. 605, datë 20.01.2022 likuidimin e shumës 16,772,320 lekë me TVSh ndaj shoqërisë *“A...6”* shpk.

Sipas kontratës fillestare afati i përfundimit të punimeve është 3 muaj ose nga datë 15.10.2021 deri me datë 15.01.2022. Sipas të dhëna të Sektorit të Menaxhimit të Kontratave punimet kanë filluar me datë 21.10.2021. Nisur nga fakti se kjo kontratë ka shtesë afati për një periudhë 30 ditë, **afati i punimeve është nga data 20.10.2021 deri me datë 22.02.2022.**

Me shkresën nr. 3183, atë 19.4.2022 Drejt/Programimit dhe zhvillimit me autorizim zj. V.S i është drejtuar Drejt/Financës për dijeni administratoros znj. A. H. për likuidim situacioni përfundimtar, kjo në referencë të shkresë së QPN Gorisht nr. 282, datë 12.4.2022 (*prot Albpetrol nr. 3183, datë 15.4.2022*).

Sipas kësaj shkrese me datë 6.4.2022 nr. 2862prot, është protokolluar në Albpetrol sh.a dokumentacioni nga kolaudatori i punimeve shoqëria *“V....G”* shpk.

Me shkresën nr. 3921prot, datë 20.5.2022 të znj. A.B me detyrë Drejt/Financës i është kërkuar interpretim Drejt/Çështjeve ligjor në lidhje me mangësitë e dokumentacionit shoqëruar të faturës për likuidim, duke theksuar se dokumentacioni nuk është nënshkruar nga ish- administratori, pasi situacioni nuk është nënshkruar nga AK (Albpetrol sh.a), por është nënshkruar nga komisioni i ngritur nga qendra e QPN Gorisht (persona që ndjekin kontratën).

Për këtë është kërkuar interpretim juridik që bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2021 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”* që dokumentacioni i përcjellë juridikisht është i rregullt ose jo.

Nga Drejt/ Çështjeve ligjore me shkresën nr. 3921/1, datë 6.6.2022 i kthen përgjigje Drejt/Financë që situacioni përfundimtar i datës 30.3.2022 i cili rezulton i nënshkruar nga sipërmarrës, mbikëqyrësi i punimeve dhe komisioni i QPN Gorisht në cilësinë e përfaqësuesit të AK Albpetrol sh.a Patos sh, në zbatim të kreut II pika 7, pikën 17 dhe 18 të udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2021 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”*, dokumentacioni është i rregullt.

Me shkresën nr. 4462prot, datë 106.2022 Drejt/Financës i drejtohet Drejt/ Programimit se vlera e faturës për likuidim nuk përputhet me vlerën e situacionit përfundimtarë. Me shkesën nr. 4462/1prot, datë 13.6.2022 Drejt/Programimit i drejtohet Drejt/Financës se fatura tatimore elektronike është pranuar nga Sektori i Financës në QNP Gorisht, me faturën elektronike të korrigjuar nr. 384, datë 10.6.2021.

Me shkresën nr. 282, datë 12.4.2022 të Q.P.N Gorisht (*financiari S.D dhe Drejtori N.B*), i është drejtuar Drejt/Financës Albpetrol sh.a për likuidimin e situacioni përfundimtar sipas faturës 109, datë 10.6.2022 në shumën 16,770,640 lekë me TVSh e cila është likujduar me datë 23.6.2022 në shumën 15,932,108 lekë me TVSh, duke zbritur garancinë 5%.

Me shkresën nr. *Ekstra* datë 01.4.2022 të shoqërisë *“A...6”* shpk është depozituar dokumentacioni për likuidimin e kontratës se punimeve nr. 6082/10, datë 15.10.2021.

Nga të dhënat e mësipërme punimet nuk kanë përfunduar në afatin e caktuar në kontratë dhe amendament kontratë, pra nga datë 22.10.2021 deri me datë 22.02.2022, **pasi ato janë mbyllur me datë 30.3.2022 (data situacioni përfundimtar) ose datë fatura 8.4.2022.**

Në zbatim të nenit 33 pika 33.1 germa (a), ndaja shoqërisë 'A...6' shpk nga Sektori Financës QPN Gorisht (S.D) dhe Drejt/Financës Albpetrol sh.a Patos (A.B) duhej të ishin llogaritet penalitetet për mos respektim të kushteve të kontratës për afatet e zbatimit në vlerën **223,630 lekë** ($13,976,934 \times 25\% = 3,494,233$ pa TVSh $\times 4/1000 \times 16$ ditë vonesë), në kundërshtim me nenin 33 pika 33.1 germa (a) e kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021 të lidhur midis shoqërisë "A...6" shpk dhe shoqërisë Albpetrol sh.a Patos. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **223,630 lekë pa TVSh** ndaj shoqërisë "A...6" shpk për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021.

Brenda datës 31.12.2023

8. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit konstatoi se bazuar në listë pagesat e periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 janë paguar dieta për trajtim ushqimor në masën 500 lekë ndërkohë që me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 68, datë 7.2.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë", pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar në masën 300 lekë. Në lidhje me këtë VKM rezulton se nga Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit nuk është marrë asnjë iniciativë për implementimin dhe zbatimin e saj, si dhe vënien në dijeni të Administratorit dhe aparatit të shoqërisë, për përmirësimet ligjorë, duke qenë një detyrë funksionale e kësaj drejtorie.

-Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se me VKM nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë", pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, Drejtorisë së Burimeve njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjorë për caktimin e dietës ushqimorë në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet përkatëse për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive.

Nga llogaritja e listpagesave të periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 425,231,740 lekë, nga 255,231,740 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej **170,092,696 lekë** e cila konsiderohet **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë. (Shënim: Llogaritja është kryer në bazë të shumës totale të përfituar, pjesëtuar me vlerën prej 500 lekë/ditë, dhe më pas është shumëzuar me 200 lekë/ditë, e cila është shuma e përfituar më tepër). Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore", pika 2, germa a). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masat dhe të ndiqen procedurat administrative e ligjore ndaj personave përgjegjës për arkëtimin e shumës **170,092,696 lekë**, për mos përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive rekomanduar kjo dhe në auditimet e tjera të KLSH.

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit të marrë masat e duhura dhe të kryejë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatës për mos vazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga përcaktimet ligjore.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Referuar situatës së krijuar të pandemisë COVID-19 procesi i ristrukturimit është pezulluar me Vendimin nr. 6, datë 29.04.2020, të Këshillit Mbikëqyrës duke e shtyrë afatin e njoftimit deri në një vendim të dytë dhe sipas vendimit punonjësit të cilët preken nga procesi do të trajtohen me pagën e luftës.

Me shkresën nr. 1821 prot., datë 30.03.2020, Administratori i Shoqërisë E.M ka hartuar një plan masash shtrënguese në kuadër të shpalljes së gjendjes emergjente për shkak të pandemisë së COVID-19. Me shkresën nr. 1821/1 prot., datë 01.04.2020, nga Administratori i Shoqërisë E.M janë njoftuar Drejtoritë dhe qendrat e prodhimit në varësi të Shoqërisë “Albpetrol” Sh.a për zbatimin e planit të masave sipas përcaktimeve përkatëse.

Reduktimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore (brenda datës 06.04.2020), reduktimi i shpenzimeve për dieta dhe orët jashtë orarit (nga data 01.04.2020), aplikimi i lejes së zakonshme për vitin 2020 (brenda datës 03.04.2020), pezullimi i këshillave teknik dhe ndalimi i pagesave të tyre (duke filluar nga data 01.04.2020), shfuqizimi i dhënies së shtesave mbi pagë për komisionet e drejtoritë përkatëse (menjëherë), reduktimi i konsumit të karburantit të programuar për muajin prill (duke filluar nga data 01.04.2020), kryerjen e inventarit fizik të mallrave gjendje në magazinë (brenda datës 10.04.2020), etj.

-Punonjësit e Albpetrol sh.a kanë hapur padi ndaj shoqërisë dhe për periudhën objekt auditimi kanë fituar çështje gjyqësore si më poshtë:

-Pagat e fituara me vendime gjyqësore në vlerën **2,438,069 lekë**,

-Shpenzime gjyqësore në vlerën **658,520 lekë**,

-Tarifa e shërbimit përbarimor plus TVSH në vlerën **361,200 lekë**.

Sa më sipër për shkak të vendimeve të kundër ligjshme, dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar, vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe tarifa e shërbimit përbarimor plus TVSH rezulton në vlerën **1,019,720 lekë** dhe konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Për këtë rekomandojmë: Këshilli Mbikëqyrës në bashkëpunim me Administratorin e shoqërisë Albpetrol sh.a, të analizojë situatën dhe të marrin masa për ndjekjen e rrugëve ligjore lidhur me arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **1,019,720 lekë nga personat përgjegjës.**

Brenda datës 31.12.2023

10. Gjetje nga auditimi: Me vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021, administratori i shoqërisë ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil/benzine, ku tërheqja e kësaj sasive do të bëhet me tollona pranë magazinës së Albpetrol nga drejtoria e përfaqësimit dhe koordinimit me institucionet. Në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për 7 muaj të vitit 2021.

Me vendimin nr. 5132 datë 28.07.2021, administratori ka shfuqizuar vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021 duke përcaktuar si kuotë mujore, për këshillin mbikëqyrës sasinë prej 1000 litra/gazoil/benzinë, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për një muaj.

Me vendimin nr. 5256 prot., datë 03.08.2021, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për muaj të vitit 2021. Me vendimin nr. 2529 prot., datë 24.03.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 250 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 5256/1 prot., datë 04.06.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 7911 prot., datë 31.10.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 1000 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës.

Të gjithë vendimet e sipërcituara baza ligjore e përdorur për dhënien e këtyre vendimeve nuk citon për miratimin e dhënies së kuotës mujore me karburant për llogari të Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu nuk është përcaktuar arsyeja e dhënies së sasisë së karburantit për Këshillin Mbikëqyrës dhe si do të justifikohet nga ana e Këshillit konsumi i karburantit të dhënë. Nga auditimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura nga Sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës nuk konstatohet të jenë kryer mbledhje në selinë e Shoqërisë Albpetrol sh.a por të gjitha mbledhjet ku Këshilli ka marrë vendime për shoqërinë janë mbajtur në Tiranë.

Pra vendimet e administratorit për periudhën respektive të ushtrimit të funksionit brenda periudhës së auditimit. Për sa me lart, vlera e karburantit e përfituar nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës është

në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi, dhe nuk është parashikuar në asnjë akt rregullator, të shoqërisë Albpetrol. Nga ana e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe anëtarëve të tij, nuk është mbajtur ose administruar pranë shoqërisë Albpetrol sh.a asnjë dokumentacion justifikues ligjorë mbi dokumentimin e konsumit të karburantit. Vlera prej 3,320,276 lekë do të konsiderohet shpenzim për të cilat mungon dokumentacioni justifikues ligjor dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a, dëm i cili duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit përfitues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **3,320,276 lekë** nga personat përgjegjës.

10.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të analizojë me kujdes vlerën 3,320,276 lekë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara për mos plotësimin me dokumentacion plotësues dhe justifikues të konsumit të karburantit nëpërmjet tollonave nga Këshilli Mbikëqyrës, si dhe marrjen e masave për korigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2023

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë pagesave të administratës së shoqërisë Albpetrol sh.a për periudhën Maj-Shtator 2022, u konstatua se për këtë periudhë janë trajtuar me dieta z. K. C., me detyrë ish-administrator i shoqërisë dhe L. L, me detyrë ish-shofer i Administratorit.

Vlerat e përfituara padrejtësisht janë si më poshtë:

Muaji	K. C.	L. L
Qershor	17,000 lekë	18,600 lekë
Korrik	20,000 lekë	26,200 lekë
Gusht	20,000 lekë	26,300 lekë
Shtator	20,000 lekë	22,800 lekë
Tetor	4,000 lekë	
TOTALI	81,000 lekë	93,900 lekë

Vlera prej 174,900 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a, dëm i cili duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit përfitues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **174,900 lekë** nga personat përgjegjës.

Brenda datës 31.12.2023

12. Gjetje nga auditimi: Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar shpërblim për anëtarët e vet, në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë mujore të njëvleftshme me pagën e Administratorit të Albpetrol sh.a shpërblim janë:

Zj. E.B për vlerën **226,100 lekë**.

Zj. E.M për vlerën **226,100 lekë**.

Z. I. G për vlerën **226,100 lekë**.

Zj. L.O për vlerën **226,100 lekë**

Zj. R.B për vlerën **226,100 lekë**.

Për vlerën totale prej 1,130,500 lekë të përfituar nga Këshilli Mbikëqyrës në trajtën e shpërblimit financiar, nuk provohet plotësisht bazueshmëria ligjore e përfitimit të tij. Vlera prej 1,130,500 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili është në vlerën 226,100 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,130,500 lekë** nga personat përgjegjës.

Të merren masa urgjente për korigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2023

14. Gjetje nga auditimi: Vendimi nr. 1796 prot., datë 12.03.2021 “Mbi miratimin e pagesës së shpërblimit të disa punonjësve të Albpetrol sh.a”. Ky vendim është marrë pas propozimit me shkresën nr. 1795 prot., datë 12.03.2021 mbi këtë shpërblim nga ana e 3 Drejtorive, Prokurimeve, Organizative dhe Juridike.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë shpërblim janë:

Z. M.B për vlerën **195,760 lekë,**

Zj. A.B për vlerën **140,000 lekë,**

Zj. E.V për vlerën **95,000 lekë,**

Zj. B.N për vlerën **95,000 lekë,**

Zj. A.D për vlerën **80,000 lekë**

Zj. XH.H për vlerën **95,000 lekë.**

Vlera prej 700,760 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 2 paga shpërblim janë: z. F.M për vlerën 280,000 lekë, z. R.Ç për vlerën 280,000 lekë, z. D.H për vlerën 210,000 lekë, z. E.B për vlerën 280,000 lekë, zj. E.T për vlerën 230,000 lekë, z. S.K për vlerën 380.000 lekë, zj. A. H. për vlerën 280,000 lekë, z. A.L për vlerën 280,000 lekë, z. D.F për vlerën 230,000 lekë dhe zj. O.F për vlerën 230,000 lekë.

Vlera prej 2,680,000 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Vendimi nr. 3238 prot., datë 21.05.2021 “Mbi miratimin e pagesës së shpërblimit të disa punonjësve të Albpetrol sh.a”.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 2 paga shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1	M.B	195,760
2	A.B	140,000
3	E.V	95,000
4	B.N	95,000
5	A.D	160,000
6	S.S	230,000
7	A.P	380,000
8	R.Ç	0
9	D.H	210,000
10	H.GJ	280,000
11	E.T	0
12	S.K	0
13	A. H.	0
14	R.P	280,000
15	O.F	0
16	F.S	230,000
17	SH. H	230,000
	TOTALI	2,525,760

Vlera prej 2,525,760 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Vendimi nr. 5129 prot., datë 27.07.2021 “Në kushtet e një pune intensive nga punonjësit e QEMNG Patos”.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1	H.LL	80,000
2	D.K	50,000
3	T.S	50,000
4	A.RR	50,000
5	P.K	45,000

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
6	T.SH	50,000
7	G.P	50,000
8	Y.B	45,000
9	E.M	45,000
	TOTALI	465,000

Vlera prej 465,000 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga ana e punonjësve të shoqërisë Albpetrol sh.a është 6,371,520 lekë vlerë e cila do të konsiderohet dëm ekonomik për shoqërinë. Pasi personat përfitues nuk kanë kryer asnjë detyrë jashtë detyrave funksionale të tyre të mirpërcaktuara në rregulloren e shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marri masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **6,371,520 lekë** nga personat përgjegjës.

Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2023

15. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 7605 prot., datë 06.10.2021, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për paradhënie për pjesëmarrjen në konferencën me temë Eage delivering for the energy challenge today and tomorrow” në Amsterdam. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë: znj. A.H., I.M, z. R.Ç, z. S.K, znj. R.B. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për 7 ditë qëndrimi, dy ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 400 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 48,640 lekë në total për 5 punonjësit. *Vlera prej 400 € do të konsiderohet si efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, me konkretisht nga secili është në vlerën 80€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 9,728 lekë.*

-Me shkresën nr. 831 prot., datë 27.01.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje në kurset e trajnimit Leadership & People Managment Skills dhe International Oil and G...S Explotation Contracts” në Londër. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë: znj. A. H., z. R.Ç, D.B, A.Z, I.K dhe Y.S. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për periudhën 20-28.03.2022, katër ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 960 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 117,504 lekë në total për 6 punonjësit. *Vlera prej 960 € do të konsiderohet si efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht nga secili është në vlerën 160€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 19,584 lekë.*

-Me shkresën nr. 2054 prot., datë 04.03.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje në kursin e trajnimit Corrosion Control Oil and G...S Exploration Industry” në Londër. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë: E.DH, A.RR, S.LL, N.B dhe znj. R.B. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për periudhën 05-12.06.2022, pesë ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 1000 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 120,600 lekë në total për 5 punonjësit. Vlera prej 1000 € do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili është në vlerën 200€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 24,120 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marri masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **286,744 lekë** nga personat përgjegjës.

Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2023

16. Gjetje nga auditimi: Bazuar në e mailin e dërguar pranë Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure me datë 04.11.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje e punonjësve të shoqërisë Albpetrol sh.a, në takimin që do të zhvillohet me avokatët e studios ligjore C...., në kuadër të Arbitrazhit Ndërkombëtar kundër shoqërisë B.....A” në Milano, Itali, drejtuar Administratorit. Nga ana e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a është marrë vendimi me nr. 8219 prot., datë 10.11.2022 për marrjen pjesë në këtë takim, në emailin e dërguar nga studio ligjore C.... specifikohet se punonjësit që janë ftuar për të marrë pjesë janë I.K, J.S dhe A.Z. Punonjësit do të qëndrojnë nga data 29.11.2022 deri me 03.12.2022.

Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit të cilët kanë udhëtuar për në Milano janë: A.B, I.K, J.S, A.Z, znj. A. H., dhe znj. R.B.

Për punonjësit A.B, znj. A. H. dhe znj. R.B, pjesëmarrja në këtë takim nuk është e justifikuar pasi jo vetëm që nuk kanë qenë të ftuar në këtë takim por as nuk kanë qenë pjesë përbërëse e grupit i cili është marrë me këtë proces për të cilin është zhvilluar takimi, nuk arsyetohet nga ana e Administratorit të shoqërisë arsyeja e marrjes pjesë në këtë takim. Për këto arsye udhëtimi i kryer nga këto punonjës ka renduar buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a duke i shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 96,726 lekë.

Nga auditimi i të gjithë praktikave të udhëtimeve jashtë vendit nuk vërtetohet nëse është paguar tarifa e regjistrimit në konferenca, nuk vërtetohet pjesëmarrja nga ana dokumentare dhe nuk vërtetohet nëse këta punonjës janë trajtuar financiarisht nga bonuset e trajnimit siç është specifikuar në vendimin e Administratorit, ku janë ngarkuar për dokumentimin e plotë të praktikës me kompanitë koncensionare Drejtoria e Marrëveshjeve, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Kabinetit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marri masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **96,726 lekë** nga personat përgjegjës.

Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2023

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në marrëdhëniet tregtare me kontraktorin “B.....A”, u konstatuan shkelje të menaxhimit financiar.

Me shkresën Nr.10826 prot. datë 31.12.2021, nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku është kërkuar lëshim Urdhër Ekzekutimi për faturat dhe pas lëshimit të Urdhrit të Ekzekutimit, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit i është drejtuar Zyrës së Përmbartimit Privat “E...P” shpk për vënien në ekzekutim të titujve ekzekutiv Fatura Tatimore Shitje.

Midis Zyrës së Përmbartimit “E...P” shpk përfaqësuar nga përmbartuesi gjyqësor z. E. M dhe shoqërisë “Albpetrol” sh.a. përfaqësuar nga Administratori z. F. M, është lidhur Kontrata e Shërbimit Nr.1113 prot. datë 04.02.2022 dhe Nr.27 prot. datë 04.02.2022, e cila është likujduar në datë 09.02.2022 në shumën 14,613,456 lekë.

Nga auditimi i kartelës financiare dhe ditarit të bankës në Drejtorinë e Financës u konstatua se faturat me nr.08, datë 17.02.2021, fatura nr.38, datë 23.03.2021, fatura nr.108 dhe nr.109, datë 17.05.2021 janë likujduar plotësisht nga kompania “B.....A”.

-Nga Drejtoria e Financës nuk është kthyer përgjigje shkresore nëpërmjet arkivës, shkresës Nr.9401, datë 23.11.2021 “Kërkesë për dokumentacion” të DÇLP, si dhe nuk ka akt rakordimi për detyrimet e ndërsjella me kompaninë “B.....A”, ku të pasqyrohet shuma e detyrimit e dokumentuar me dokumente justifikues.

Shkeljet e konstatuara në menaxhimin financiar janë:

Drejtorja e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit ka kryer veprime mbështetur në vlerën e saldos

totale 948,890,551 lekë, të një shkresë të marrë nga Drejtoria e Financës për një kontraktor tjetër, dhe ka kryer veprime për nxjerrje titull ekzekutiv pa pasur një aprovim nga kjo drejtori.

Ndërkohë që drejtorit i Drejtorisë së Financës A.B, sipas sektorit të protokollit, kjo shkresë i është dërguar në email sipas praktikave të aprovuara. Emailin e datës 23.11.2021, drejtori i DF A.B, ja ka dërguar specialistes së financës së administratës për nxjerrjen e kartelës financiare të kontraktorit deri më 30.09.2021, si dhe specialistes së Qendrës së Furnizimit dhe Shërbimit Elektrik, për të dërguar faturat që kishin diskutuar në telefon tek DÇLP.

Në shkresën nr. 527 Prot., datë 24.11.2021, drejtori i QFSHE, ka miratuar shkresën e specialistes për faturat dhe i ka dërguar Drejtorisë së Financës kopjet origjinale të faturave për muajt janar, shkurt e prill 2021. Në shkresë është cituar se pas aprovimit nga Drejtoria e Financës, faturat ti përcillen DÇLP. Në observacionin e z. R.Ç kjo shkresë bashkë ciklimin e Drejtorit të Departamentit, dhe citimin se faturat janë origjinale dhe për tu përdorur për procedurat gjyqësore, pretendohet se provojnë se faturat ishin aprovuar nga Drejtoria e Financës dhe se nuk mban përgjegjësi për veprimet e mëtejshme por shkresa e QFSHE i ishte drejtuar Drejtorisë së Financës dhe i kërkonte atyre verifikimin e faturave. Nga Drejtoria e Financës nuk ka pasur aprovim shkresor për faturat e cipërcituara. E pyetur për këtë çështje znj. A.B me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës ka deklaruar se i ka dërguar dorazi Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit kartelën financiare të kompanisë “B.....A”, por nuk i ka dërguar faturat tatimore të shitjes”.

Gjykimi i grupit të auditimit është se Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, drejtori i Drejtorisë së Financës dhe ish-administratori i shoqërisë me veprime ose mosveprime kanë sjellë në dëm ekonomik nga shoqërisë Albpetrol sh.a në vlerën 14,613,456 lekë me TVSh.

Së pari, ish drejtori i DÇLP z. R.Ç dhe kryespecialista zj. A.LL, kanë kërkuar në shkresën Nr. 9401 prot. datë 23.11.2021, një database ku të jenë të listuara faturat me numër dhe datë, për të cilat do të kërkohen librat e blerjes së deklaruara nga shoqëria, fatura tatimore shitjeje, të cilat duhet të jenë të nënshkruara rregullisht nga të dyja palët dhe të dorëzohen me procesverbal në origjinal pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, ditarin/kartelën financiare/akt rakordimin e klientit, që është mbajtur nga kreditori dhe provon rakordimit midis palëve si dhe masën e detyrimit që përbën titull ekzekutiv.

Nga këto dokumente të kërkuara Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, ka pasur katër fatura dhe një saldo totale të detyrimit, si dhe nga specialistja e financës i është dorëzuar dhe kartela financiare. Nga shqyrtimi i kartelës financiare konstatohet se katër faturat (nr. 8, 38, 108 e 109) që janë bërë objekt i veprimeve gjyqësore janë likuiduar të gjitha deri më datë 16.07.2021, dhe të regjistruara në sistemin e kontabilitetit të shoqërisë. Z. R.Ç dhe znj. A.LL mund të bënin verifikimet në kartelë se faturat tatimore ishin likuiduar.

Së dyti, drejtori i Drejtorisë së Financës, për çështje si likuidimin nga klientët ku është përgjegjës direkt, kërkesës së DÇLP për detyrimet e kontraktorit duhet ti përgjigjej me përgjegjshmëri, qartësi dhe saktësi. Gjendja debitore në një datë të caktuar nuk jep informacion të plotë dhe të saktë por nga kjo drejtori duhet të plotësohej një informacion i qartë shkresor me faturat e palikuiduara shoqëruar me detajet si dhe kamatëvonesat përkatëse të llogaritura.

Drejtori i Drejtorisë së Financës A.B në momentin e pagesës së shumës 14,613,456 lekë me TVSh duhet të bënte verifikimet nëse ekzistonin kushtet për pagesën e tarifës dhe nëse faturat ishin të likuiduara ose të palikuiduara.

Së treti, ish administratori në momentet që ka urdhëruar procedurat gjyqësore si dhe ka firmosur në lidhjen e kontratës me përmbaruesin gjyqësor duhet të sigurohej me nëpunësen zbatuese për vërtetësinë e shkresave që firmoste.

Nga shoqëria Albpetrol sh.a është likuiduar në llogarinë bankare të Zyrës së Përmbarimit “E...P” shpk shuma 14,613,456 lekë me TVSH në datën 09.02.2022, sipas Kontratës së Shërbimit Nr.1113 prot. datë 04.02.2022 dhe Nr.27 prot. datë 04.02.2022, e lidhur midis Zyrës së Përmbarimit “E...P” shpk. dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a.. Ky likuidim është kryer nga Drejtoria e Financës pa u verifikuar shlyerja e faturave tatimore të shitjes për të cilat ka dalë urdhri ekzekutiv dhe është në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12 , pika 3 germa “e” ku citohet: “Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike

përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: “pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollin pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi”.

Në kushtet e pagesës së kontratës nuk janë përcaktuar pjesë si pagesa pas mbledhjes së detyrimit siç është bërë në kontrata të tjera, por është përcaktuar pagesë vetëm me paraqitjen e faturës tatimore nga ana zyrës përmbartimor.

Nga veprime e mosveprimet e ish drejtorit të DÇLP R.Ç dhe kryespecialistes A.LL, drejtorit të DF A.B dhe ish administratorit F. M shoqërisë Albpetrol sh.a i është krijuar një dëm ekonomik prej **14,613,456 lekë**.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10 296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me Rregulloren e Brendshme të shoqërisë e miratuar me Vendimin Nr.20, datë 03.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës neni 64, paragrafi I Sektori i Financës, pika 37. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Nga Albpetrol sh.a, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **14,613,456 lekë, nga R.Ç, A.LL, A.B dhe F. M.**

Brenda datës 30.10.2023

18. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës 2021-2022, kompania B...M nuk ka kryer pagesat për energjinë elektrike. Për këto mospagesa Albpetrol sh.a Patos ka maturuar penaltete e kamatëvonesa. Gjatë vitit 2022 Albpetrol ka ndërmarrë veprime administrative duke marrë vendime gjykate si tituj ekzekutiv për faturat e papaguara. Gjithashtu është marrë si titull ekzekutiv dhe një faturë penaltetesh për mospagesat e faturave të energjisë elektrike. Llogaritja e kamatëvonesave është kryer sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”. Llogaritja bazuar në këtë ligj është më e vogël se kamatëvonesa që ka aplikuar O...E për faturat e papaguara nga Albpetrol sh.a Patos Vlera e kamatëvonesës së aplikuar nga O...E me atë që ka llogaritur Drejtoria Ekonomike e Albpetrol sh.a Patos, përbën dëm ekonomik për shoqërinë. O...E sh.a. ka bërë një akt-rakordimi për detyrimet që ka Albpetrol sh.a Patos, për principalin dhe kamatë vonesat.

Ligji Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Neni 19, Përgjegjësitë e ERE-s, citon se është ERE që miraton dhe publikon, në përputhje me parimin e transparencës, metodologjitë e llogaritjes së tarifave të transmetimit, shpërndarjes, si dhe metodologjitë e tjera të aplikueshme si dhe kontratat mes palëve si dhe kamatëvonesat e aplikuar për çdo ditë vonesë.

Shoqëria Albpetrol sh.a nuk ka pasqyruar në marrëdhëniet me shoqëritë koncesionare të gjitha detyrimet që i linden nga kontratat që ka me Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Albpetrol sh.a ka kërkuar kamatëvonesa për pagesat me vonesë të B.....A në vlerën 175,458,324 lekë, kur detyrimi që Albpetrol ka ndaj FSHU sha, për kontratat përkatëse për kamatëvonesa është 1,356,345,939 lekë. **Vlera 1,180,887,615 përbën shpenzime jo të justifikuar nga Albpetrol sh.a.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Nga Albpetrol sh.a, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **1,180,887,615 lekë** nga shoqëria B.....A.

Brenda datës 30.10.2023

19. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e lëvizjeve të produktit natë bruto u konstatuan parregullsi në mes gjendjes fizike dhe kontabël. Më datë 05.01.2022, Dega e Doganës Fier me shkresën nr. 5087/3, i ka dërguar Albpetrol njoftimin e proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative. Si rezultat i verifikimit në vend të magazinave fiskale u konstatuan mangësi të pajustificuara mes gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël në sistem. Referuar nenit 90 dhe 90/12 të Ligjit nr. 61/2012, “Për Akcizat në RSH”, i ndryshuar, për mangësitë e konstatuar e cila tejkalon 2% firot e krahasuar me regjistrat kontabël, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me trefishin e detyrimeve të akcizës së munguar. Sasia e gjetur në mungesë është 1,486,742 kg.

Detyrimi i papaguar është në vlerën 37,168,557 lekë plus penaltetet në vlerën 111,505,672 lekë, në total **148,674,230 lekë**.

-Albpetrol sh.a Patos, më datë 03.03.2022 ka lidhur me shoqërinë A...6 shpk, kontratën me objekt "Riparim pjesor dhe pastrim i mbetjeve të RVM 5000/8 m3 në stacionin e shitjes së naftës në Zharrëz. Grupi i punës nga Albpetrol për përgatitjen e depozitës i përbërë nga D.H, A.Z, E.Ç dhe P. D, në relacionin me nr. 428 prot., datë 13.05.2022, pas procedurës së hapjes për efekt pastrimi, kanë kryer operacionet si largim uji dhe mbetje inerte ranore, është zhvendosur masa volumore e rezervuarit prej 311.1 ton, në gropën ekologjike pranë stacionit Zharrëz. Në këtë masë pas analizave kanë rezultuar 24.33 ton ujë i lirë, 53.62 ton ujë i lidhur, 145.1 ton mbeturina mekanike dhe 88.04 ton naftë. Kjo sasi naftë është propozuar për tu ulur nga bilanci i muajit prill 2022. Sasinë prej 311.1 ton që Albpetrol sh.a e ka hedhur si mbetje e ka pasur në bilancin e naftës si produkt gjendje. Grupi i inxhinierëve sa më sipër ka dhënë argumente lidhur me naftën që vjen në depozitë jo me standardet e përcaktuara.

Lidhur procesin e pastrimit të depozitës nga Albpetrol sh.a, i është dërguar një shkresë Doganës Fier, por në procesin e hapjes së depozitës si dhe në hedhjen e mbetjeve ranore në gropën ekologjike nuk ishte prezent asnjë përfaqësues i Doganës apo inspektor i Tatimeve për të certifikuar heqjen nga produkti i gatshëm naftë sasinë prej 311.1 ton.

Vlera e naftës 311.1 ton është 17,923,404 lekë. Gjoha nga organet tatimore është në vlerën 100% plus dhe 15%, 2,688,510 lekë, pra në total 20,611,914 lekë.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me pikën 3.6 të Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar VKM Nr. 612, datë 2.9.2012 i ndryshuar, "Për dispozitat zbatuese të ligjit "Për akcizat" Neni 23, Mangësitë/diferencat Neni 25, **Humbjet aksidentale dhe avaritë në magazinën fiskale 1. Si parim, depozituesit e miratuar duhet të paguajnë detyrimet për sasi të e humbura aksidentalisht apo nga avaritë në magazinat fiskale Neni 101 Punimet dhe ndërhyrjet për riparime në depozita.**

Nga mosveprimet e shoqërisë Albpetrol sh.a janë evidentuar efekte ekonomike negative me dëm në vlerën 20,611,914 lekë dhe shpenzime jo të justifikuar në vlerën 148,674,230 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 233-252 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa për të analizuar rastet kur nuk janë marrë masat për lajmërimet e detyrueshme të institucioneve doganore dhe tatimore, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për gjambat relative, si dhe marrjen e masave që në të ardhmen nëpunësi autorizues të identifikojë detyrimet doganore e fiskale të shoqërisë, dhe ndjekjen me përgjegjësi dhe profesionalitet nga personat përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit konstatohet se në pesë raste punonjësit (në pozicione drejtuese) janë shkarkuar nga detyra me urdhër Administratori. Këta punonjës kanë ngritur padi dhe kanë nisur procese gjyqësore kundër Albpetrol sh.a, duke detyruar shoqërinë të paguajë **dëmshpërblim** ndaj tyre në vlerën **11,977,746 lekë**, si dhe **shpenzime gjyqësore dhe tarifë përmbarimi**, me urdhër sekuestro në vlerën **1,887,270 lekë**.

Këta punonjës janë ripunësuar në Albpetrol sh.a (në pozicione drejtuese), përgjithësisht gjatë proceseve gjyqësore. Në asnjë rast nuk ka qenë objekt padie rikthimi i tyre në punë.

-Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, nga ku janë humbur 25 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, si dhe janë humbur e janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë.

-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **42,600,758 lekë**, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë **3,931,821 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,146,912 lekë**.

-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **61,851,420 lekë**, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë **6,272,200 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,172,200 lekë**.

Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **104,452,178 lekë e cila konsiderohet efektit financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe vlera shpenzimeve përmbartimore lidhur me ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatave dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar për çdo rast, duke rezultuar në pagesë të këtyre vlerave me urdhër sekuestro bankare, prej **14,486,894 lekë** konsiderohet **dëm ekonomik** në buxhetin e shoqërisë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015, neni 155, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 233-252 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandim: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të analizohet dëmi ekonomik në vlerën **14,486,894 lekë**, dhe të marrë masa të menjëhershme për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore lidhur me dëmin ekonomik.

Brenda datës 31.12.2023

21. Gjetje nga auditimi: Lidhur me “Detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale” dhe “Kontributin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë paguar gjoha dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën **726,099 lekë**, vlerë kjo që konsiderohet **dëm ekonomik** në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos

Afatet e deklarimit dhe pagesës se kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Mos likuidimi sipas afateve ligjore të detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ka sjellë pasojë dem ekonomik në vlerën **726,099 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 233-252 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandim: Nga Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Financës të merren të analizohet situata dhe të ndiqen të gjitha procedurat lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën **726,099 lekë**.

Brenda datës 31.12.2023

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE, SI DHE MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në dosjet e procedurave dhe sistemin SPE, rezulton se në **3** procedurave OE e shpallur fitues nga KVO nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK. Gjithashtu gjatë auditimit të këtyre procedurave është konstatuar fakti se disa nga mangësitë e evidentuara në mos plotësimin e kriterëve nga OE të shpallur fitues, KVO i ka përdorur si element skualifikues në OE e skualifikuar por me ofertë ekonomike më të leverdishme se OE e shpallur fitues (qëndrim me dy standarte), veprime me efekt financiar negativ në vlerën **10,364,872 lekë (diferenca midis dy OE), respektivisht:**

a- Procedura me objekt “Blerje goma automjetesh”, me fond limit 12,815,800 lekë për vitin 2022, ku fitues është shpallur shoqëria “SI & CO” shpk me ofertë 12,402,000 lekë pa TVSH, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht: Nuk përmbushet kriteri i përcaktuar në DST, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” nën pika 2.3.1, ku përcaktohet se: “Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit

limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës” pasi faturat e paraqitura dhe dokumentacioni per te vërtetuar furnizime te ngjashme është ne nje vlere me te vogël se 40 % e fondit limit, pasi sipas dokumentacionit të paraqitur paraqet një xhiro prej 5,525,260 lekë nga vlera 6,151,584 lekë që duhet të paraqisje.

Nga të dhënat e kontratave/faturave të ngjashme, rezulton se jo të gjitha faturat/kontrat kanë shitje gomash, pasi kanë dhe shitje pjesë këmbimi. Gjithashtu fatura nr. 10/2021 datë 3.12.2021 në shumën 381,000 lekë e paraqitur si shitës, shoqëria “S...O” shpk është blerës dhe jo shitës.

Gjithashtu nuk plotëson pikën 2.2.2 të DST, ku kërkohet kopje te certifikuar te bilancit për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet, te konfirmuar nga administrata tatimore, pasi pasqyrat financiar të viteve 2019, 2020 dhe 2021 nuk janë të të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël.

Nga sa trajtuar më sipër shoqëria “S...O” shpk nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST dhe se gjatë auditimit është evidentuar fakti se disa nga kriteret e konstatuara nga gripi i KLSH për mos plotësim, KVO i ka përdorur si kriterë skualifikuse për shoqërinë “S....2” me ofertë më të leverdishme, veprime me efekt negativ financiar në shumën **2,066,000 lekë**.

b- Procedura me objekt “Ndërtim RVM 1500 m³ në parkun Dekantim Gorisht”, me fond limit 14,666,892 lekë pa TVSh viti 2021, në të cilën kanë marrë pjesë 2 OE, fitues është shpallur shoqëria “A...6” shpk me ofertë 13,976,934 lekë më të lartë se OE i skualifikuar, rezulton se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “A...6” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, shoqëria nuk plotëson disa nga kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

o- Nga shoqëria nuk është deklaruar në shtojcën 8, **ing. Mjedisit N.S** sipas kontratës nr. 4151/2261, datë 31.12.2019, kërkesë në mos plotësim të pikës 2.3.3 të DST, për të cilën është skualifikuar shoqëria “SH...I” me ofertë më të leverdishme.

p- Nuk plotësohet kriteri për 2 shofer dhe 3 manovratorë, gjithsej 5, pasi z. E.H një herë deklarohet si shofer dhe njëherë si manovratorë dhe një herë si shofer, duke lënë një numër mangut.

q- Asnjë nga çertifikatat ISO të kërkuara dhe paraqitura nga subjekti nuk dalin aktive të faqen e interneti të shoqërisë që i lëshoni ato.

Nga sa trajtuar më sipër shoqëria “A...6” shpk nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST dhe se gjatë auditimit është evidentuar fakti se disa nga kriteret e konstatuara nga gripi i KLSH për mos plotësim, KVO i ka përdorur si kriterë skualifikuse për shoqërinë “SH.....I” me ofertë më të leverdishme, veprime me efekt negativ financiar në shumën **1,476,934 lekë**.

c- Procedura me objekt “Shërbimi i transportit të naftës Bruto”, me fond limit 46,771,938 lekë për vitin 2021, në të cilën kanë marrë pjesë 2 OE, ku OE me ofertë ekonomike më të leverdishme është skualifikuar duke kualifikuar shoqërinë “E.....9” shpk me ofertë 46,771,938 lekë më të lartë se OE i skualifikuar, rezulton se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “E.....9” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, kjo shoqëri është në kushtet e mos plotësimit të ligjit nr. 162, date 21.12.2020 "Per Prokurimin Publik", neni 82, pika 5, si dhe VKM nr.285, datë19/05/2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 26, pika 6 “Mbi paraqitjen e dokumentacionit administrativo ligjor per procedurat e prokurimit “, pasi nga ofertuesi nuk deklaruar në sistemin SPE, këto dokumente:

4- Nuk plotëson pikën mbi numrin për 15 mjete me kapacitet nga 28-33 m³. Kështu nga auditimi rezulton se shoqëria ka paraqitur 14 mjete nga 15 që kërkohen, pasi mjeti me targë AA672DA është paraqitur dy herë dokumentacioni në sistem. Gjithashtu disa nga mjetet nuk janë të deklaruara nga shoqëria dhe nuk janë në pronësi, pasi nuk dalin as në QKB dhe as në inventarin e pasqyrave financiare, konkretisht mjetet me targë: AA..JU, AGR..., AA..HN, FR...D.

5- Gjithashtu kapaciteti i tyre nuk është sipas kapacitet që kërkohet në DST nga 28-33 m³.

6- Mjetet e mara me qira nga shoqëria “I...9” me nr. 2750/1812, datë 16.6.2021, konstatohet se kontrata **nuk ka të përcaktuar afatin e përdorimit** se për sa periudhë është afati i kontratës.

Nga sa trajtuar më sipër shoqëria “E....9” shpk nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST dhe se gjatë auditimit është evidentuar fakti se disa nga kriteret e konstatuara nga gripi i KLSH për mos plotësim, KVO i ka përdorur si kriterë skualifikuese për shoqërinë “B...M” me ofertë më të leverdishme, veprime me **efekt negativ financiar në shumën 1,476,934 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a, Patos, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për vlerësimin e fakteve të konstatuara nga grupi i KLSH dhe nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës për vlerësimin e gabuar të procedurës në shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të miratuara nga AK, si dhe trajtimin e dy standarte në vlerësim, duke skualifikuar OE me mangësi të njëjta dhe mos vlerësuar kriterin kryesorë “çmimi më i leverdishëm”, veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, Patos, për vlerën **10,364,872 lekë pa TVSh**.

Brenda datës 30.10.2023

2. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi i procedurës me objekt “*Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2022*”, rezulton se fondi limit është përcaktuar në vlerën 22,330,000 lekë për sigurimin e 1400 punonjësve sipas pozicioneve të punës, duke mos i përcaktuar sipas vështirësive të punës në terren.

Gjithashtu nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore por dhe nga observacioni i paraqitur nga z. E.L me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore me shkresën nr. 11/103, datë 28.4.2023, në lidhje me numrin e punonjësve të siguruar sipas pozicioneve të renditura për vështirësi dhe sigurim jetë, ky numër nuk është 1400 pozicione **por është 1338 pozicione**, pra numri i punonjësve për të cilën është kërkuar të sigurohen është më i lartë për **62 punonjës** duke rënduar padrejtësisht fondin limit për vlerën **928,388 lekë** $\{(1400 - 1338) \times 14,917 \text{ primë sigurimi}\}$, veprime në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

- Nga auditimi i procedurës me objekt “*Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2021*”, rezulton se fondi limit është përcaktuar në vlerën 22,330,000 lekë për sigurimin e 1400 punonjësve sipas pozicioneve të punës, duke mos i përcaktuar sipas vështirësive të punës në terren.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në lidhje me numrin e punonjësve të siguruar sipas pozicioneve të renditura për vështirësi dhe sigurim jetë, ky numër nuk është 1400 pozicione por është 1388 pozicione, konkretisht si vijon:

Operator te remontit nëntokësor, ndihmës operator te remontit, sondist, traktorist remonti, janë 75 punonjës.

Elektracist te fushës ose terrenit, janë 43 punonjës.

Saldator, janë 24 punonjës.

Drejtues Mjetesh Transporti Mallrash si dhe drejtuesit e mjeteve janë 72 punonjës.

Manovratorë Mjetesh, vinçier, skrepist, buldozerist, e te ngjashëm janë 40 punonjës.

Punonjësit e stacioneve Kuçovë, Zharrëz, Gorisht, Usoje, Visoke, Stacioni i Gazit Fier janë 77 punonjës.

Punonjësit e avarisë ne QEMNG janë 30 punonjës.

Reparti i fonderisë, kovacanes, prodhimit te detaleve prej gome janë 13 punonjës.

Brigada e likujdimit te avarive elektrike dhe ajo e linjave elektrike si dhe brigada e mjedisit janë 99 punonjës.

Përgjegjës Turni, Operator Prodhimi, Ndihmës Operator Prodhimi, Operator Studimi, janë 486 punonjës Dekantimi e të ngjashëm.

Fugist, Tornitor, Axhustator, Xhenerik, Mekanik Fushe dhe Mekanik Mjetesh janë 219 punonjës.

Stafi inxhiniero-teknik janë 174 punonjës.

Dega e Monitorimit te Brendshëm janë 18 punonjës.

Kontrolloret e pajisjeve te naftës, pranë qendrave te prodhimit janë 18 punonjës.

Nga të dhënat evidentohet fakti se numri i punonjësve për të cilën është kërkuar të sigurohen është më i lartë për **12 punonjës** (1400 – 1388) x 15,950 primë sigurimi), duke rënduar padrejtësisht fondin limit për vlerën **191,400 lekë**, në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës për llogaritje jo të saktë të fondit limit të procedurës me objekt “Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2022”, duke rënduar padrejtësisht për vlerën **1,129,788 lekë**, nga e cila për vitin 2022 në vlerën 928,388 lekë dhe në vitin 2021 për vlerën 191,400 lekë.

Brenda datës 30.10.2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të listpagesave në muaj të caktuar, rezultoi se:

Pagesa e orëve shtesë lidhur me ditët normale të punës, dhe në ditët e pushimit/festive, hartohet duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

-Kryespecialisti i secilës drejtori konceptohen shkresë për punën e kryer nga punonjësi/t e shoqërisë Albpetrol sh.a.

-Drejtori i Drejtorisë pranon dhe konfirmohet nga Drejtori Organizativ ose Drejtori Teknik (sipas varësive të eprorëve përkatës).

-Miratohet nga Administratori i shoqërisë.

Pas kontrollit të dokumentacionit dhe rakordimit të formularëve me listëprezencën e orëve jashtë orarit (kopjet origjinale të firmosura nga eprorët përkatës), orët për çdo punonjës hidhen në sistemin e pagave, të ndara në ditë feste, të diela dhe orët normale.

-Përlllogaritja për orët shtesë të punës që punëdhënësi duhet t’i paguajë punëmarrësit është shtesa prej 25% mbi pagën normale.

Orët shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompensohen me një shtesë prej 50% mbi pagë normale.

Vlera totale e orëve jashtë orarit për periudhën objekt auditimi rezultoi në vlerën **4,412,419 lekë** dhe konsiderohet **efektit financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me Urdhri e Administratorit nr.5620 prot, datë 12.08.2021, ku përcaktohet se:

“2.Kërkesat për miratimin e pagës për orët jashtë kohës normale të punës do t’i nënshtrohen procedurës së mëposhtme:

-Qendra e Transportit dhe Furnizimit Patos, në çdo rast të marrjes së konfirmimit me e-mail nga QASHNG Patos, për çdo lëvizje mbas orarit 15:00 të produktit “Naftë Brut” me mjetet e shoqërisë, do të njoftojë për numrin e mjeteve dhe drejtuesit përkatës nëpërmjet e-mail zyrtar po atë ditë të marrjes së kërkesës Drejtorin Teknik, Drejtorin Organizativ dhe Administratorin.

-Çdo javë QFT Patos do të përcjellë një evidencë për orët e kryera jashtë kohës normale të punës duke e shoqëruar dhe me dokumentacionin provues.

-Mbas kryerjes së kësaj procedure konfirmimi, drejtorja e financës do të kryejë pagesën.

3.Ndalimn e aplikimit për orë jashtë kohës normale të punës për punonjësit e Administratës për të cilët, në zbatim të Kodit të Punës, akteve nënligjore dhe Kontratës Kolektive në fuqi, do të trajtohen me ditë pushimi rast pas rasti.

4.Përjashtime do të ketë vetëm për punonjësit që do të angazhohen në detyra specifike, me Urdhër të posaçëm të Administratorit të shoqërisë.”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të analizojë efektin financiar prej **4,412,419 lekë**, si rezultat i kryerjes së pagesave në kundërshtim me urdhrin e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos nr. 5620 prot, datë 12.8.2021 dhe korrigjimin e pagesave për orët shtesë sipas orëve dhe ditëve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se në pesë raste punonjësit (në pozicione drejtuese) janë shkarkuar nga detyra me urdhër Administratori. Këta punonjës kanë ngritur padi dhe kanë nisur procese gjyqësore kundër Albpetrol sh.a, duke detyruar shoqërinë të paguajë **dëmshpërblim** ndaj tyre në vlerën **11,977,746 lekë**, si dhe **shpenzime gjyqësore dhe tarifë përmbarimi**, me urdhër sekuestro në vlerën **1,887,270 lekë**.

Këta punonjës janë ripunësuar në Albpetrol sh.a (në pozicione drejtuese), përgjithësisht gjatë proceseve gjyqësore. Në asnjë rast nuk ka qenë objekt padie rikthimi i tyre në punë.

-Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, nga ku janë humbur 25 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, si dhe janë humbur e janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë.

-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **42,600,758 lekë**, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë **3,931,821 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,146,912 lekë**.

-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **61,851,420 lekë**, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë **6,272,200 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,172,200 lekë**.

Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **104,452,178 lekë e cila konsiderohet efektit financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe vlera shpenzimeve përmbarimore lidhur me ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatave dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar për çdo rast, duke rezultuar në pagesë të këtyre vlerave me urdhër sekuestro bankare, prej **14,486,894 lekë** konsiderohet **dëm ekonomik** në buxhetin e shoqërisë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015, neni 155, pika 3”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të analizojnë efekti financiar negativ në shumën prej **104,452,178 lekë**, si dhe të merren masa ndaj personave përgjegjës për shkëputjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, pasojë e së cilës janë vendimet gjyqësore për dëmshpërblimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Brenda datës 31.12.2023

5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit në dosjet e procedurave dhe sistemin SPE, është konstatuar se në **7 procedura** me fond limit **318,476 mijë lekë**, OE të shpallur fitues nga KVO nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK. Nga KVO këto OE nuk duhej të ishin shpallur fitues dhe lidhur kontrata shërbimesh/punimesh, por duhej anuluar dhe zhvilluar procedura të tjera me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE në procedura për një përdorim me efektiv të fondeve të prokura për vlerën **318,476 mijë lekë**, konkretisht procedurat:

Nr/R	Emertimi	Fondi limit leke pa TVSh
Procedura viti 2021		
1	Sigurim I jetës se punonjësve, sig. shëndeti nga aksidentet ne pune	22,330,000
2	Tube naftës/jellësi	17,797,600
3	Blerje Purteka (16 mm, 22 mm,25mm)	17,585,000
4	Riparim pjesore+ pastrim RVM 5000/8 dhe pastrim i mbeturinave mekanike te dy RVM 700 m3 /3/4 ne stacionin Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	18,337,055
Procedura viti 2022		
5	Sigurim i jetës se punonjësve ,sig. shëndeti nga aksidentet ne pune	20,883,330
6	Gazoil 10 ppm	182,692,600
7	Tube pompe kompresori TS	38,854,800

Veprime në shkëlqje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkëlqje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “B.....”, ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021, nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se, detyrimi që shoqëria “B.....”, ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të P.... **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2021 është 24,939.596 Ton naftë bruto.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 21,100.41 Ton naftë bruto.

Pra, **janë tërhequr rreth 3,839.186** Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021**. Shoqëria “B.....”, me anë të shkresës me Nr. 329 Prot., datë 15.04.2022, protokolluar në Albpetrol me Nr. 3249 Prot., datë 20.04.2022 ka dërguar Llogaritjen e Faktorit R në fund të tremujorit të katërt të vitit 2021 (Q4-2021).

Në bazë të përlllogaritjeve, Faktori R, për zonën “Main/Kryesore” rezulton më i madh se 1 (një) në fund të tremujorit të katërt të vitit 2021.

Përsa më sipër, në përputhje me Nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” dhe Nenit 3.2 dhe 3.3 të Amendimit të Marrëveshjes Hidrokarbure, duke nisur nga Tremujori i katërt i vitit 2021, Pjesa e Prodhimit të Albpetrol (PPA), do të llogaritet nga 1% që është aktualisht, në 3% të naftës së disponueshme.

Për vitin 2022, nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se, detyrimi që shoqëria “B.....”, ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të P.... **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2022 është 29,884.163 (njëzet e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëqind e gjashtëdhjetë e tre) Ton naftë bruto.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 14,407.612 Ton naftë bruto. Pra, **janë tërhequr rreth 15,476.551** (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë pesëqind e pesëdhjetë e një) Ton naftë bruto **më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022**.

Detyrimi që shoqëria “B.....” ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) për periudhën nga data efektive deri me 31/12/2022 është 78,915.002 ton naftë bruto, me vlerë 39,247,000 USD. Këto veprime kanë sjellë ulje të të ardhurave nga kompania Albpetrol për sasinë e naftës bruto e cila nuk është tërhequr për pamundësi depozitimi.

Për tu theksuar është dhe problemi se kur këto sasi të tërhiqen nga Albpetrol sh.a, çmimi mund të ulet duke sjellë dëm ekonomik për shoqërinë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa për tërheqjen e sasisë **78,905.002** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. **Vlera e sasisë 78,905.002 ton** me çmimet e

deklaruar nga kontraktori është **39,247,000 USD**, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.

6.2. Rekomandimi: Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

7. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “A....” SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021, detyrimi që shoqëria “A....” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 10,773.49 Ton naftë bruto. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 7,816.946 Ton naftë bruto. Pra, janë tërhequr rreth 2,956.544 Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.

Për vitin 2022, detyrimi që shoqëria “A....” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të P.... dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 9,794.455 Ton naftë bruto.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 8,570.083 Ton naftë bruto. Pra, janë tërhequr rreth 1,224.372 Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2022.

Detyrimi që shoqëria “A....” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për periudhën nga 02.05.2018 deri më 31/12/2022 është 29,103.96 ton naftë bruto. Vlera e sasisë 29,103.96 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është **14,476,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **29,103.96** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. **Vlera e sasisë 29,103.96 ton** me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është **14,476,000 USD**, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.

7.2. Rekomandimi: Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

8. Gjetje nga auditimi: Kontraktori D....., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Detyrimi që D..... ka ndaj Albpetrol sh.a Patos, në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më **31 Dhjetor 2022**, për vendburimin Delvinë Kondesat është 2,902.86 Ton naftë bruto.. Detyrimi që D..... ka ndaj Albpetrol sh.a Patos, në gaz natyror për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më **31 Dhjetor 2022**, për vendburimin Delvinë Gaz është 23,630,398.320 Nm³ Gaz. **Vlera e sasisë 2,902.86 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 1,443,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **2,902.86** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, dhe 23,630,398.320 Nm³ Gaz, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. **Vlera e sasisë 2,902.86 ton** me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është **1,443,000 USD**, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.

8.2. Rekomandimi: Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

9. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “T...S” SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P..., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria “T...SS” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të P... dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 2,825.802 Ton naftë bruto. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P..., për vitin 2021, sasinë prej 657.793 Ton naftë bruto.

Pra, janë tërhequr rreth 2,168.009 Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P..., për vitin 2021. Për vitin 2022 vërehet se, detyrimi që shoqëria “T...S” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të P... dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 2,558.788 Ton naftë bruto.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P..., për vitin 2022, sasinë prej 2,011.008 Ton naftë bruto.

Pra, janë tërhequr rreth 547.78 Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P..., për vitin 2022.

Detyrimi që shoqëria “T...SS” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për periudhën nga data efektive deri më 31/12/2022 është 10,332.89 ton naftë bruto.

Vlera e sasisë 10,332.89 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 5,139,553 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa, për tërheqjen e sasisë 10,332.89 ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. Vlera e sasisë 10,332.89 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 5,139,553 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos

9.2. Rekomandimi: Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

10. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “F...M” SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P..., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria “F...M” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të P... dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. P...Z sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 75.997 Ton naftë bruto. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos nuk e ka tërhequr këtë sasi naftë gjatë vitit 2021.

Për vitin 2022 vërehet se, detyrimi që shoqëria “F...M” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të P... dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. P...Z sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 81.246 Ton naftë bruto. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P..., për vitin 2022, sasinë prej 41.201 Ton naftë bruto.

Pra, janë tërhequr rreth 40.045 Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P..., për vitin 2022.

Detyrimi që shoqëria “F...M” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. Pekishy-Murriz, për periudhën deri më 31/12/2022 është 52.185 ton naftë bruto”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Petrol të marrë masa, për tërheqjen e sasisë 52.185 ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që

gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. **Vlera e sasisë 52.185 ton** me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është **25,954 USD**, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.

Brenda datës 30.10.2023

11. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “SH...M”., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të P...., sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria “SH...M”., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të P.... **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2021 është 606.437 Ton naftë bruto. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2021, sasinë prej 590.068 Ton naftë bruto. Pra, **janë tërhequr rreth 16.369 Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për P...., për vitin 2021.**

Për vitin 2022 vërehet se, detyrimi që shoqëria SIPL., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të P.... **sipas Marrëveshjes Hidrokarbure**, për vitin 2022 është 548.17 Ton naftë bruto. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të P...., për vitin 2022, sasinë prej 567.949 Ton naftë bruto.

Pra, janë tërhequr rreth 19.779 Ton naftë bruto më shumë nga detyrimi për P...., për vitin 2022. Detyrimi që shoqëria “SH...M”., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31/12/2022 është 581.683 (pesëqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) ton naftë bruto”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **581.683 ton** naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe te Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure.

Vlera e sasisë 581.683 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është **289,300 USD**, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.

11.2. Rekomandimi: Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

D. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni nr.37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe neni 14 të kontratës kolektive për punonjësit e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, **i rekomandojmë Këshillit Mbikëqyrës i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos**, fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për **8 punonjës** si më poshtë:

a- Ndërprerje të marrëdhënies së punës, sipas neni 14 pika (c) e kontratës.

1. Z. E. D, me detyrë Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Në lidhje me sasinë e ujit që tejkalojnë normat teknologjike në produktin naftë argumentimet e specialistëve të QASHNG, Qendra e Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit, janë se nafta vjen jashtë standardeve nga qendrat e tjera, dhe për këtë fakt janë njoftuar administratorët, të cilët kanë lëshuar urdhra për pranimin e produktit naftë bruto dhe jashtë standardeve teknologjike, (me

ujë mbi 3%, deri në 14 %). Urdhrrat nr. 182 datë 07.09.2021, “Për procedurë e inspektimit dhe kontrollit të qarkullimit të produktit Naftë Bruto”, 182/2 datë 16.12.2021, dhe 182/3 datë 17.12.2021.

Argumentet e sjella nga qendrat janë se nuk kanë pajisjet për të bërë ndarjen e plotë të ujit dhe se nuk mund të ndalojnë punën në puse. Në momentin kur produkti i gatshëm i shitet kompanive fituese të ankandeve, në depozitat e shitjes nafta bruto ngrohet dhe përgatitet në parametrat teknologjikë me përqindje uji më të vogël se 3%, ndërkohë që pjesa tjetër është produkt i gatshëm në mungesë.

Nga mosveprimet e shoqërisë Albpetrol sha janë evidentuar efekte ekonomike negative me dëm në vlerën 20,611,914 lekë.

-Albpetrol sha në lidhje me veprimet që ka kryer për riparimin e depozitës RMV 8000/8 në Zharrëz nuk ka zbatuar udhëzimet në lidhje me ligjin për akcizën, ku citohen qartë lajmërimet që duhet të kryente si dhe detyrimin për prezencën e përfaqësuesve të Doganës në momentin e fillimit të riparimeve si dhe në momentin e grosjes së masës volumore 311.1 ton naftë bruto.

-Gjatë periudhës 2021-2022, kompania B...M nuk ka kryer pagesat për energjinë elektrike. Për këto mospagesa Albpetrol sh.a Patos ka maturuar penalitete e kamatëvonesa. Gjatë vitit 2022 Albpetrol ka ndërmarrë veprime administrative duke marrë vendime gjykate si tituj ekzekutiv për faturat e papaguara. Gjithashtu është marrë si titull ekzekutiv dhe një faturë penaltetesh për mospagesat e faturave të energjisë elektrike. Llogaritja e kamatëvonesave është kryer sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Llogaritja bazuar në këtë ligj është më e vogël se kamatëvonesa që ka aplikuar O...E për faturat e papaguara nga Albpetrol sh.a Patos Vlera e kamatëvonesës së aplikuar nga O...E me atë që ka llogaritur Drejtoria Ekonomike e Albpetrol sh.a Patos, përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

O...E sh.a. ka bërë një akt-rakordimi për detyrimet që ka Albpetrol sh.a Patos, për principalin dhe kamatë vonesat.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Albpetrol sha ka kërkuar kamatëvonesa për pagesat me vonesë të B...M në vlerën 175,458,324 lekë, kur detyrimi që Albpetrol ka ndaj FSHU sha, për kontratat përkatëse për kamatëvonesa është 1,356,345,939 lekë.

Vlera 1,180,887,615 lekë përbën shpenzime jo të justifikuar nga Albpetrol sha.

1. Bazuar në e-mailin e dërguar pranë Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure me datë 04.11.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje e punonjësve të shoqërisë Albpetrol sha, në takimin që do të zhvillohet me avokatët e studios ligjore C..., në kuadër të Arbitrazhit Ndërkombëtar kundër shoqërisë B.....A” në Milano, Itali, drejtuar Administratorit. Nga ana e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sha është marrë vendimi me nr. 8219 prot., datë 10.11.2022 për marrjen pjesë në këtë takim, në e-mailin e dërguar nga studio ligjore C... specifikohet se punonjësit që janë ftuar për të marrë pjesë janë I.K, J.S dhe A.Z. Punonjësit do të qëndrojnë nga data 29.11.2022 deri me 03.12.2022.

Nga auditimi i të gjithë praktikave të udhëtimeve jashtë vendit nuk vërtetohet nëse është paguar tarifa e regjistrimit në konferenca, nuk vërtetohet pjesëmarrja nga ana dokumentare dhe nuk vërtetohet nëse këta punonjës janë trajtuar financiarisht nga bonuset e trajnimit siç është specifikuar në vendimin e Administratorit, ku janë ngarkuar për dokumentimin e plotë të praktikës me kompanitë koncesionare Drejtoria e Marrëveshjeve, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Kabinetit.

2. Për mos marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

3. Në shumicën e udhëtimeve jashtë vendit pjesëmarrëse është edhe sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës znj. R.B, pjesëmarrja e znj. B. nuk është e justifikuar pasi nuk është punonjëse e shoqërisë Albpetrol sha, por është punonjëse e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu detyra e saj funksionale është e përcaktuar qartë se nuk është përfaqësuese e Këshillit Mbikëqyrës, përfaqësues të Këshillit Mbikëqyrës janë vetëm anëtarët e tij siç është përcaktuar qartë në Statutin e shoqërisë Albpetrol sha. Nuk ka asnjë arsye përse Administratori i shoqërisë urdhëron që sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës të marrë pjesë në konferenca të ndryshme me shpenzimet e shoqërisë Albpetrol sha përderisa sekretarja e Këshillit ka vetëm detyrën e mbajtjes së

dokumentacionit mbi Këshillin Mbikëqyrës dhe asnjë detyrë apo kontribut tjetër në shoqërinë Albpetrol sha, caktimi i sekretares së Këshillit rëndon shpenzimet e shoqërisë Albpetrol sha.

4. Me vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021, administratori i shoqërisë ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil/benzine, ku tërheqja e kësaj sasi do të behej me tollona pranë magazinës së Albpetrol nga drejtoria e përfaqësimit dhe koordinimit me institucionet. Në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për 7 muaj të vitit 2021.

Me vendimin nr. 5132 datë 28.07.2021, administratori ka shfuqizuar vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021 duke përcaktuar si kuotë mujore, për këshillin mbikëqyrës sasinë prej 1000 litra/gazoil/benzinë, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për një muaj.

Me vendimin nr. 5256 prot., datë 03.08.2021, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për muaj të vitit 2021. Me vendimin nr. 2529 prot., datë 24.03.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 250 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 5256/1 prot., datë 04.06.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 7911 prot., datë 31.10.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 1000 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës.

Të gjithë vendimet e sipërcituara baza ligjore e përdorur për dhënien e këtyre vendimeve nuk citon për miratimin e dhënies së kuotës mujore me karburant për llogari të Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu nuk është përcaktuar arsyeja e dhënies së sasisë së karburantit për Këshillin Mbikëqyrës dhe si do të justifikohet nga ana e Këshillit konsumi i karburantit të dhënë. Nga auditimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura nga Sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës nuk konstatohet të jenë kryer mbledhje në selinë e Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos por të gjitha mbledhjet ku Këshilli ka marrë vendime për shoqërinë janë mbajtur në Tiranë.

2. Znj. A.B, në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto dhe të Drejtorit të Financës.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandeve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetën e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

-Më datë 05.01.2022, Dega e Doganës Fier me shkresën nr. 5087/3, i ka dërguar Albpetrol njoftimin e proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative. Si rezultat i verifikimit në vend të magazinave fiskale u konstatuan mangësi të pajustificuara mes gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël në sistem. Referuar nenit 90 dhe 90/12 të Ligjit nr. 61/2012, “Për Akcizat në RSH”, i ndryshuar, për mangësitë e konstatuar e cila tejkalon 2% firot e krahasuar me regjistrat kontabël, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me trefishin e detyrimeve të akcizës së munguar. Sasia e gjetur në mungesë është 1,486,742 kg.

Detyrimi i papaguar është në vlerën 37,168,557 lekë plus penaltetet në vlerën 111,505,672 lekë, në total 148,674,230 lekë.

Vlera 148,674,230 lekë përbën shpenzime jo të justifikuara për shoqërinë Albpetrol sha.

-Albpetrol sha., më datë 03.03.2022 ka lidhur me shoqërinë A....6 shpk, kontratën me objekt “Riparim pjesor dhe pastrim i mbetjeve të RVM 5000/8 m3 në stacionin e shitjes së naftës në Zharrëz. Grupi i punës nga Albpetrol për përgatitjen e depozitës në relacionin me nr. 428 prot., datë 13.05.2022, pas procedurës së hapjes për efekt pastrimi, kanë kryer operacionet si largim uji dhe mbetje inerte ranore, është zhvendosur masa volumore e rezervuarit prej 311.1 ton, në gropen ekologjike pranë stacionit Zharrëz. Në këtë masë pas analizave kanë rezultuar 24.33 ton ujë i lirë, 53.62 ton ujë i lidhur, 145.1 ton mbeturina mekanike dhe 88.04 ton naftë. Kjo sasi naftë është propozuar për tu ulur nga bilanci i muajit prill 2022. Sasinë prej 311.1 ton që Albpetrol sha e ka hedhur si mbetje e ka pasur në bilancin e naftës si produkt gjendje. Lidhur procesin e pastrimit të depozitës nga Albpetrol sha, i është dërguar një shkresë Doganës Fier, por në procesin e hapjes së

depozitës si dhe në hedhjen e mbetjeve ranore në gropën ekologjike nuk ishte prezent asnjë përfaqësues i Doganës apo inspektor i Tatimeve për të certifikuar heqjen nga produkti i gatshëm naftë sasinë prej 311.1 ton.

Vlera e naftës 311.1 ton është 17,923,404 lekë. Gjopa nga organet tatimore është në vlerën 100% plus dhe 15%, 2,688,510 lekë, pra në total 20,611,914 lekë.

Nga mosveprimet e shoqërisë Albpetrol sha janë evidentuar efekte ekonomike negative me dëm në vlerën 20,611,914 lekë.

-Albpetrol sha në lidhje me veprimet që ka kryer për riparimin e depozitës RMV 8000/8 në Zharrëz nuk ka zbatuar udhëzimet në lidhje me ligjin për akcizën, ku citohen qartë lajmërimet që duhet të kryente si dhe detyrimin për prezencën e përfaqësuesve të Doganës në momentin e fillimit të riparimeve si dhe në momentin e groposjes së masës volumore 311.1 ton naftë bruto.

Veprime në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe me Rregulloren e Brendshme të shoqërisë e miratuar me Vendimin Nr.20, datë 03.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës neni 66, gërma A, pika 6.

Nga mos kryerja e detyrave funksionale është krijuar një dëm ekonomik prej 14,613,456 lekë.

-Gjatë periudhës 2021-2022, kompania B...M nuk ka kryer pagesat për energjinë elektrike. Për këto mospagesa Albpetrol sh.a Patos ka maturuar penalitete e kamatëvonesa. Gjatë vitit 2022 Albpetrol ka ndërmarrë veprime administrative duke marrë vendime gjykate si tituj ekzekutiv për faturat e papaguara. Gjithashtu është marrë si titull ekzekutiv dhe një faturë penaltetesh për mospagesat e faturave të energjisë elektrike. Llogaritja e kamatëvonesave është kryer sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Llogaritja bazuar në këtë ligj është më e vogël se kamatëvonesa që ka aplikuar O...E për faturat e papaguara nga Albpetrol sh.a Patos Vlera e kamatëvonesës së aplikuar nga O...E me atë që ka llogaritur Drejtoria Ekonomike e Albpetrol sh.a Patos, përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

O...E sh.a. ka bërë një akt-rakordimi për detyrimet që ka Albpetrol sh.a Patos, për principalin dhe kamatë vonesat.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Albpetrol sha ka kërkuar kamatëvonesa për pagesat me vonesë të B...M në vlerën 175,458,324 lekë, kur detyrimi që Albpetrol ka ndaj FSHU sha, për kontratat përkatëse për kamatëvonesa është 1,356,345,939 lekë.

Vlera 1,180,887,615 lekë përbën shpenzime jo të justifikuara nga Albpetrol sha.

Nga auditimi i listë pagesave të administratës së shoqërisë Albpetrol sha për periudhën Maj-Shtator 2022, u konstatua se për këtë periudhë janë trajtuar me dieta z. K. C., me detyrë ish-Administrator i shoqërisë dhe L. L, me detyrë ish-shofer i Administratorit.

Vlerat e përfituara padrejtësisht janë si më poshtë:

Muaji	K. C.	L. L
Qershor	17,000 lekë	18,600 lekë
Korrik	20,000 lekë	26,200 lekë
Gusht	20,000 lekë	26,300 lekë
Shtator	20,000 lekë	22,800 lekë
Tetor	4,000 lekë	
TOTALI	81,000 lekë	93,900 lekë

Të dhënat Albpetrol sha

Vlera prej **174,900 lekë** përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, dëm i cili duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit përfitues.

- Për mos marrjen e masave për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimore në përputhje me VKM nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune., dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet përkatëse për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive.

Nga llogaritja e listpagesave të periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 425,231,740 lekë, nga 255,231,740 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej **170,092,696 lekë** e cila konsiderohet **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë Albpetrol SHA.

- Për shkak të vendimeve të kundër ligjshme, dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse, të cilat janë shpallur palë fituese nga gjykatat e Republikës të Shqipërisë, për Ekzekutim Vullnetar, vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe tarifa e shërbimit përmbartimor plus TVSH rezulton në vlerën **15,506,614 lekë** dhe konsiderohet **dëm ekonomik** në buxhetin e Shoqërisë Albpetrol SHA.
- Situata e krijuar lidhur me “Detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale” dhe “Kontributin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë paguar gjopa dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën **726,099 lekë**, vlerë kjo që konsiderohet **dëm ekonomik** në buxhetin e shoqërisë Albpetrol SHA.
- Mos zbatimi i urdhrat të Administratorit nr.5620 prot, datë 12.08.2021, lidhur me orët e punës jashtë orarit për periudhën objekt auditimi rezulton në vlerën **4,412,419 lekë** dhe konsiderohet **efektit financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

3. Z. A.T, me detyrë Drejtor i Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit në Albpetrol SHA, për periudhën objekt auditimi 2021 – 2022.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos marrjen e masave për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimore në përputhje me VKM nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune., dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet përkatëse për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive.

Nga llogaritja e listpagesave të periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 425,231,740 lekë, nga 255,231,740 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej **170,092,696 lekë** e cila konsiderohet **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë Albpetrol SHA.

- Për shkak të vendimeve të kundër ligjshme, dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse, të cilat janë shpallur palë fituese nga gjykatat e Republikës të Shqipërisë, për Ekzekutim Vullnetar, vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe tarifa e shërbimit përmbartimor plus TVSH rezulton në vlerën **15,506,614 lekë** dhe konsiderohet **dëm ekonomik** në buxhetin e Shoqërisë Albpetrol sh.a..

4. Zj. E.V, në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandeve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetata e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

5. Z. P. DH, në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandeve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetata e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

6. Zj. B.N, në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandëve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetata e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

7. Zj. P. D, në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandëve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetata e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

b- Vërejtje me shkrim për paralajmërim për largim nga puna sipas nenit 14 pika (c), e kontratës.

1. Zj. M.B, në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandëve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetata e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

D.1. Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional.

a. Për 8 ish drejtuesit dhe punonjësit, për të cilët nuk kemi adresim institucional për marrëdhënie pune në administratën publike, masa disiplinore e propozuar nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar do të ishte rekomanduar masa *“Ndërprerje e Marrëdhënieve të punës”*, sipas shkallës së përgjegjësisë, respektivisht:

- 1. Z. B. Z,** ish Administrator i Albpetrol sh.a, për periudhën janar – mars 2021.
- 2. Z. F.M,** ish Administrator i Albpetrol sh.a, për periudhën mars – korrik 2021.
- 3. Z. F.M,** ish Administrator i Albpetrol sh.a, për periudhën korrik 2021 – mars 2022.
- 4. Z. K.C,** ish Administrator i Albpetrol sh.a, për periudhën maj – tetor 2022.
- 5. Z. R.Ç,** me detyrë ish-Drejtor i Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit në Albpetrol sh.a.
- 6. Z. A.L,** me detyrë ish-Drejtor i Financës në Albpetrol sh.a.
- 7. Z. R.Ç,** në cilësinë e ish drejtorit të DÇLP.
- 8. Zj. A.LL,** në cilësinë e ish kryespecialistes së DÇLP.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

V. ANEKSET

Aneksat e mëposhtme, tabelat dhe pasqyrat janë pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit, ku në mënyrë më të zgjeruar trajtohen çështje të caktuara.

Aneksi nr. 1

Materialiteti dhe faktorët e riskut për subjektin shoqëria Albpétrol sh.a Patos

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 1%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqëruar (praktikën e urdhër transfertave).

Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht në pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogaritë u vlerësua nga 0.7 deri 2; dhe
- ✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përlllogaritjes si më poshtë:

Në 000/lekë

Subjekti Albpétrol 2021			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	1,467,098	0.70	11
Sigurime Shoqërore (601)	197,447	0.70	2
Mallra e Shërbime (602)	3,880,621	0.70	30
Investime të brend. (230-231)		2.00	0
Te tjera transfer. korren (604)		0.70	0
Total	5,545,166		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	110,903		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	110,903		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	11,090		
Nëntotali	99,813		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	89,832		

Subjekti Albpétrol 2021			
Emërtimi i të ardhurave	Vlera e popullatës	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Të ardhurat gjithsej	5,676,396	0.70	43
		0.70	0
Total	5,676,396		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti	113,528		

Kalkulimi i precizionit	
Materialiteti	113,528
Gabimi i lejuar (10% -20%)	11,353
Nëntotali	102,175
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%
Vlera e precizionit	91,958

MBI VLERËSIMIN E RISKUT ALBPETROL SH.A PATOS.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (*analiza*), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

- U krye planifikimi dhe identifikimi i riskut të auditimit. Njohja me subjektin që auditohet për të kuptuar të gjithë elementët e mjedisit të kontrollit. U identifikuan dhe vlerësuan zonat kryesore të llogarisë dhe shënimeve shpjeguese për të përcaktuar pohimet kryesore të auditimit në bazë të materialitetit të përcaktuar.

-U përcaktua strategjia dhe vlerësimi i riskut duke identifikuar klasat e transaksioneve dhe kontrolleve kyçe. Kuptimi i proceseve të rrjedhjes së punës dhe kontrollet bazë të aplikuara. U përcaktuan kontrollet kryesore për tu testuar dhe vlerësimi paraprak i kombinuar i riskut (*i rishikuar përgjatë gjithë punës audituese*). U përcaktuan testet e kontrolleve dhe testet thelbësore të auditimit që do të kryhen në bazë risku.

- U ekzekutuan procedurat e testimit si testimi i funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshirë zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe saktësia e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare.

Aneksi 2.3.1

Kontrata për vitin 2022 te lidhura, urdherat për likuidim për vitin 2022

Nr	Emri Mbiemri	Qendra	FSHATI	Nr. I pusit	Sip m2	Nr. Parc	Shuma	Nr Ven	Data	6.muji 2022
1		Q.P.N.Gorish	Karbunarë	Vendburimi.Karbu	150	170/3	21,600	95	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
2		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	162	170	49,421	93	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
3		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	318	170	82,368	93	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
4		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	128	60/8	20,276	94	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
5		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	322	60/9	51,005	94	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
6		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Amonicë	500	331	48,000	96	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
7		QPN Fier	Kuqar	P-4001	450		72 000	352	23.11.2022	20.10.22-20.10.23
8		QPN Fier	Kuqar	P-4001	400		62 400	356	23.11.2022	17.11.22-17.11.23
9		QPN Fier	Kuqar	P-4001	450		129 600	353	23.11.2022	20.02.22-20.08.22
10		Q.P.N.Fier	Germej	311,314	340	232, 233	31,824	358	23.11.2022	20.10.22-20.04.23
11		Q.P.N.Fier	Germej	320	1190		111 384	359	23.11.2022	20.10.22-20.04.23
12		QPN Fier	Kuqar	P-4000	1150		179 400	354	23.11.2022	04.04.22-04.10.22
13		Q.P.N.Fier	Germej	311, 314	1000	232, 233	93,600	360	23.11.2022	20.10.22-20.04.23
14		Q.P.N.Gorish	Karbunarë	Vendburimi.Karbu	200	170	19,008	364	24.11.2022	25.06.22-25.11.22
15		Q.P.N.Gorish	Karbunarë	Vendburimi.Karbu	92	171	26 312	337	11.11.2022	11.05.22-11.11.22
16		QPN Fier	Kuqar	P-4000	1150		182 400	357	23.11.2022	20.10.22-20.10.23
17		Q.P.N.Fier	Germej	320	1190		114 240	361	23.11.2022	13.02.22-13.08.22
18		Q.P.N.Fier	Germej	311, 314	1000	232, 233	96 000	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
19		Q.P.N.Fier	Germej	-----	340	232, 233	32 640	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
20		Q.P.N.Fier	Germej	-----	450	232, 233	43 200	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
21		Q.P.N.Fier	Germej	-----	170	232, 233	16 320	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
22		Q.P.N.Fier	Germej	-----	150	232, 233	14 400	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
23		Q.P.N.Fier	Germej	-----	160	232, 233	15 360	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
24		Q.P.N.Fier	Germej	-----	160	232, 233	15 360	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
25		Q.P.N.Fier	Germej	-----	300	232, 233	28 800	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
27		Q.P.N.Fier	Germej	-----	400	232, 233	38 400	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22

Shuma total

1 595 318 Lekë

Kontrata për vitin 2021 të lidhura, urdhërat për likuidim 6 mujori dytë

Nr	Emri Mbiemri	Qendra	Fshati	Nr. I pusit	Sip m2	Nr. Parc	Shuma	Nr Ven	Data	6 Mujori dytë
1		Q.P.N.Fier	Germenj	311, 314	1000	232, 233	93,600	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
2		Q.P.N.Fier	Germenj	-----	340	232, 233	31,824	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
3		Q.P.N.Fier	Germenj	-----	450	232, 233	42,120	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
4		Q.P.N.Fier	Germenj	-----	170	232, 233	15,912	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
5		Q.P.N.Fier	Germenj	-----	150	232, 233	14,040	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
6		Q.P.N.Fier	Germenj	-----	160	232, 233	14,976	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
7		Q.P.N.Fier	Germenj	-----	160	232, 233	14,976	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
8		Q.P.N.Fier	Germenj	-----	300	232, 233	28,080	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
9		Q.P.N.Fier	Germenj	-----	400	232, 233	37,440	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
10		QPN Fier	Frakull	Fr.111	100	602/1-9	15,600	120	27.05.2022	04.04.2022-04.10.2022
11		Q.P.N.Gorish	Karbunarë	Vendburimi.Karbu	150	170/3	22,680	11	12.01.2022	04.10.2021-04.04.2022
12		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	162	170	73,030	9	12.01.2022	15.07.2021-15.01.2022
13		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	318	170	47,175	9	12.01.2022	15.07.2021-15.01.2022
14		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	128	60/8	19,354	5	12.01.2022	15.07.2021-15.01.2022
15		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	322	60/9	48,687	5	12.01.2022	15.07.2021-15.01.2022
16		Q.P.N.Gorish	Karbunarë	Vendburimi.Karbu	200	170	19,200	13	14.01.2022	20.12.2021-20.06.2022
17		Q.P.N. Gorisht	Amonicë		500	331	46,800	7	12.01.2022	15.07.2021-15.01.2022

Shuma Totale është 585,494 Lekë

Aneksi 2.3.2

Zhdëmtime bujqësore, drufrutorë dhe riaftësim toke bujqësore të fermerëve për vitin 2022

Nr	Emer Mbiemer	Qendra	Fshati	Shuma	Nr. Vend	Data
1		QPN FIER	Drenove	85,580	8	12.01.2022
2		QPN GORISHT		94,208	6	12.01.2022
3		QPN FIER	Usoje	62,090	8	12.01.2022
4		QPN FIER	Usoje	85,432	8	12.01.2022
5		QPN FIER	Usoje	45,360	29	04.02.2022
6		QPN GORISHT	Rexhepaj	42,642	92	20.04.2022
7		QPN FIER	Zharrez	77,760	8	12.01.2022
8		QPN FIER	Usoje	53,460	29	04.02.2022
9		QPN FIER	Usoje	71,280	29	04.02.2022
10		QPN FIER	Usoje	65,340	29	04.02.2022
11		QPN FIER	Lavdan	132,896	35	10.02.2022
12		QPN FIER	Lavdan	162,084	50	28.02.2022

Nr	Emer Mbiemer	Qendra	Fshati	Shuma	Nr. Vend	Data
13		QPN FIER	Lavdan	45,383	50	28.02.2022
14		QPN FIER	Lavdan	72,305	35	10.02.2022
15		QPN FIER	Dukas	70,432	35	10.02.2022
16		QPN FIER	Drenove	45,620	50	28.02.2022
17		QPN FIER	Usoje	57,446	50	28.02.2022
18		QPN FIER	Drenove	41,200	50	28.02.2022
19		QPN FIER	Drenove	71,320	50	28.02.2022
20		QPN FIER	Usoje	38,880	90	20.04.2022
21		QPN FIER	Usoje	47,376	90	20.02.2022
22		QPN FIER	Dukas	181,550	90	20.04.2022
23		QPN FIER	Drenove	60,507	90	20.02.2022
24				56,160	90	20.04.2022
25		Qpn Kuçovë	Avaleas	92,025	91	20.04.2022
26		QPN FIER		51,840	90	20.04.2022
27		QPN FIER		79,963	90	20.04.2022
28		QPN FIER		73,940	90	20.04.2022
29		QPN GORISHT	Kocul	79,200	165	28.06.2022
30		QPN FIER	Drenove	127,860	137	09.06.2022
31		QPN FIER	Drenove	83,754	137	09.06.2022
32		Qpn Fier	Dukas	172,342	137	09.06.2022
33		QPN FIER	Dukas	147,309	164	28.06.2022
34		QPN FIER	Dukas	186,900	164	28.06.2022
35		QPN FIER	Rroms	51,000	166	28.06.2022

Shuma totale është 2,912,444 Lekë

Blerjet e vogla për Vitin 2021.

Nr	Objekti i prokurimeve	Fondi limit(pa TVSH)	Vlera e kontratës pa (TVSH)	Operatori ekonomik	Vlera e likuidimit me (TVSH)
1	Ganxha te vinçave me kapacitet 3,5,10,12 ton per Q.M.N. Kuçove	310,000	290,000	N...4	348,000
2	Blerje adblue per autobotet	600,000	225,000	A...O	270,000
3	Blerje Benzine	489,810	459,195	A....I	335,629
4	Distrubutor karburanti elektronik	600,000	588,750	P...I	706,500
5	Oksigjen,azot,acetilen	796,000	795,000	G....A	439,860
6	Blerje mater.sanitare(detergj,pastrues etj)	793,300	720,000	RR.D	864,000
7	Sfera inoksi per UMN Kucove	252,00	225,000	A...V	270,000
8	Brume Gome antivaj+Gome Batistrad	267,500	247,500	A...V	297,000
9	Rezistenca tubolare	899,934	879,900	A....G	1,055,880
10	Gur abraziv	984,700	943,520	A....O	1,131,024
11	Sherbim per vertetim perputhshmerie te projekteve teknologjike	796,00	795,000	ECIT	954,000
12	Sherbim per paisjen me deshmi aftesie te punonjesve per paisjet nen presion.	680,000	650,000	A...T	780,000
13	Sherbim per kontrollin periodik te paisjeve nen presion	590,000	550,000	A...T	660,000
14	Sherbim per kualifikim specialisteve Elektrik	414,600	270,600	N....L	304,920
15	Sherbim data per pajisjet GPS	585,600	292,800	O...A	334,777
16	Sherbim periodik te 3 autoboteve tip reanult QF&T Patos	990,800	978,809	M.....S	1,104,179
17	Sherbim per mirembajtje printer, PC, Fotokopje,gjenerator etj	590,815	409,000	T.....S	490,800
18	Sherbim Furnizim me uje te pijshem te Administrates	779,000	760,000	L...T	760,604
19	Garanci per suport dhe shtim funksionalitetesh i faqes Web: WWW.albpetrol.al	795,000	790,000	K.....X	943,260
20	Garanci per suport per sistemin e monitorimit me kamera dhe DVR	795,967	748,900	S.....J	871,680
21	Certifikate eInspektimit te cisternove (transportit te lendeve te rrezikshme)	293,500	264,000	A...H	237,600
22	Sherbim per paisjen me certifikate ADR te autoboteve te Albpetrolit	220,000	132,000	A...H	153,600
	Totali	12,477,574	12,014,974		13,313,313

Blerjet e vogla për Viti 2022

Nr	Objekti i prokurimeve	Fondi limit(pa TVSH)	Vlera e kontratës pa (TVSH)	Operatori ekonomik	Vlera e likuidimit me (TVSH)
1	Gjenerator saldimi (Vb. Amonice)	886,667	870,000	V....U"	1,044,000
2	Blerje Adblue	333,440	213,333	E...L	256,000
3	Blerje Ripa trapezoidal(volanti/kalbri/pompe/tjere)	623,020	575,000	A...V	690,000
4	Blerje Kushineta	827,400	775,000	A...V	930,000
5	Blerje Leter A4/A3	924,735	777,777	L...U	933,332
6	Blerje Materiale sanitare	844,034	600,000	A...O	720,000
7	Blerje Brume gome antivaj+gome batistrad	325,000	317,500	A...V	381,000
8	Sherbim per kualifikim spec.Elektrik	489,176	249,950	S....A.....A...A	292,260
9	Furnizim-vendosje moket profesional	298,886	250,000	A...J	300,000
10	Furnizim-vendosje motor utomjeti tip "LAND-ROVERI"	980,000	980,000	E.ZH	1,176,000
11	Sherbim Furnizim me uje te pijshem	795,000	790,000	L...T	0
12	Paisja me vertetim teknik te paisjeve nen presion	483,000	350,000	A....T	0
13	Sherbim mirembajtje kondicionere	267,500	198,500	A.....2018	238,200
14	Sherbim per riparim kaldaje nga 500 Kkal deri 2200 Kkal.	1,000,000	945,800	A.....2018	0
15	Sherbim per mirembajtje tuba presioni te larte per mjetet hidraulike te shoqerise.	991,417	969,000	M...G	515,523
16	Sherbim karta sim	288,000	273,600	O...A	0
17	Mirembajtje per pajisjet fotokopjuese/printuese	962,664	855,000	A...A	0
18	Fon per paisje me pasaport cisternash.	263,183	149,000	ECIT	147,600
19	Fond per paisjen me certifikate ADR te autoboteve te Albpetrolit+lende rrezikshme	300,000	165,000	A...H	92,400
20	Certifikate e Inspektimit te cisternove te transportit te lendeve te rrezikshme	293,500	161,700	A...H	137,280
	Totali	12,176,622	10,466,160		7,853,595

Aneksi 2.3.1

Kontrata për vitin 2022 te lidhura, urdherat për likuidim për vitin 2022

Nr	Emri Mbiemri	Qendra	FSHAti	Nr. I pusit	Sip m2	Nr. Parc	Shuma	Nr Ven	Data	6.muj.I 2022
1		Q.P.N.Gorish	Karburnarë	Vendburimi.Karbu	150	170/3	21,600	95	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
2		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karburnarë	162	170	49,421	93	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
3		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karburnarë	318	170	82,368	93	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
4		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karburnarë	128	60/8	20,276	94	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
5		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karburnarë	322	60/9	51,005	94	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
6		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Amonicë	500	331	48,000	96	20.04.2022	22.02.2022-22.08.2022
7		QPN Fier	Kuqar	P-4001	450		72 000	352	23.11.2022	20.10.22-20.10.23
8		QPN Fier	Kuqar	P-4001	400		62 400	356	23.11.2022	17.11.22-17.11.23
9		QPN Fier	Kuqar	P-4001	450		129 600	353	23.11.2022	20.02.22-20.08.22
10		Q.P.N.Fier	Germej	311,314	340	232, 233	31,824	358	23.11.2022	20.10.22-20.04.23
11		Q.P.N.Fier	Germej	320	1190		111 384	359	23.11.2022	20.10.22-20.04.23
12		QPN Fier	Kuqar	P-4000	1150		179 400	354	23.11.2022	04.04.22-04.10.22
13		Q.P.N.Fier	Germej	311, 314	1000	232, 233	93,600	360	23.11.2022	20.10.22-20.04.23
14		Q.P.N.Gorish	Karburnarë	Vendburimi.Karbu	200	170	19,008	364	24.11.2022	25.06.22-25.11.22
15		Q.P.N.Gorish	Karburnarë	Vendburimi.Karbu	92	171	26 312	337	11.11.2022	11.05.22-11.11.22
16		QPN Fier	Kuqar	P-4000	1150		182 400	357	23.11.2022	20.10.22-20.10.23
17		Q.P.N.Fier	Germej	320	1190		114 240	361	23.11.2022	13.02.22-13.08.22
18		Q.P.N.Fier	Germej	311, 314	1000	232, 233	96 000	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
19		Q.P.N.Fier	Germej	-----	340	232, 233	32 640	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
20		Q.P.N.Fier	Germej	-----	450	232, 233	43 200	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
21		Q.P.N.Fier	Germej	-----	170	232, 233	16 320	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
22		Q.P.N.Fier	Germej	-----	150	232, 233	14 400	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
23		Q.P.N.Fier	Germej	-----	160	232, 233	15 360	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
24		Q.P.N.Fier	Germej	-----	160	232, 233	15 360	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
25		Q.P.N.Fier	Germej	-----	300	232, 233	28 800	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22
27		Q.P.N.Fier	Germej	-----	400	232, 233	38 400	365	24.11.2022	13.02.22-13.08.22

Shuma total

1 595 318 Lekë

Kontrata për vitin 2021 të lidhura, urdhërat për likuidim 6 mujori dytë

Nr	Emri Mbiemri	Qendra	Fshati	Nr. I pusit	Sip m2	Nr. Parc	Shuma	Nr Ven	Data	6 Mujori dytë
1		Q.P.N.Fier	Germej	311, 314	1000	232, 233	93,600	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
2		Q.P.N.Fier	Germej	-----	340	232, 233	31,824	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
3		Q.P.N.Fier	Germej	-----	450	232, 233	42,120	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
4		Q.P.N.Fier	Germej	-----	170	232, 233	15,912	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
5		Q.P.N.Fier	Germej	-----	150	232, 233	14,040	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
6		Q.P.N.Fier	Germej	-----	160	232, 233	14,976	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
7		Q.P.N.Fier	Germej	-----	160	232, 233	14,976	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
8		Q.P.N.Fier	Germej	-----	300	232, 233	28,080	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
9		Q.P.N.Fier	Germej	-----	400	232, 233	37,440	10	12.01.2022	13.08.2021-13.02.2022
10		QPN Fier	Frakull	Fr. 111	100	602/1-9	15,600	120	27.05.2022	04.04.2022-04.10.2022
11		Q.P.N.Gorish	Karbunarë	Vendburimi.Karbu	150	170/3	22,680	11	12.01.2022	04.10.2021-04.04.2022
12		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	162	170	73,030	9	12.01.2022	15.07.2021-15.01.2022
13		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	318	170	47,175	9	12.01.2022	15.07.2021-15.01.2022
14		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	128	60/8	19,354	5	12.01.2022	15.07.2021-15.01.2022
15		Q.P.N. Gorisht	Amonicë	Vendburimi Karbunarë	322	60/9	48,687	5	12.01.2022	15.07.2021-15.01.2022
16		Q.P.N.Gorish	Karbunarë	Vendburimi.Karbu	200	170	19,200	13	14.01.2022	20.12.2021-20.06-2022
17		Q.P.N. Gorisht	Amonicë		500	331	46,800	7	12.01.2022	15.07.2021-15.01.2022

Shuma Totale është 585,494 Lekë

Aneksi 2.3.2

Zhdëmtime bujqësore, drufrutorë dhe riaftësim toke bujqësore të fermerëve për vitin 2022

Nr	Emer Mbiemer	Qendra	Fshati	Shuma	Nr. Vend	Data
1		QPN FIER	Drenove	85,580	8	12.01.2022
2		QPN GORISHT		94,208	6	12.01.2022
3		QPN FIER	Usoje	62,090	8	12.01.2022
4		QPN FIER	Usoje	85,432	8	12.01.2022
5		QPN FIER	Usoje	45,360	29	04.02.2022
6		QPN GORISHT	Rexhepaj	42,642	92	20.04.2022
7		QPN FIER	Zharrez	77,760	8	12.01.2022
8		QPN FIER	Usoje	53,460	29	04.02.2022
9		QPN FIER	Usoje	71,280	29	04.02.2022
10		QPN FIER	Usoje	65,340	29	04.02.2022

Nr	Emer Mbiemer	Qendra	Fshati	Shuma	Nr. Vend	Data
11		QPN FIER	Lavdan	132,896	35	10.02.2022
12		QPN FIER	Lavdan	162,084	50	28.02.2022
13		QPN FIER	Lavdan	45,383	50	28.02.2022
14		QPN FIER	Lavdan	72,305	35	10.02.2022
15		QPN FIER	Dukas	70,432	35	10.02.2022
16		QPN FIER	Drenove	45,620	50	28.02.2022
17		QPN FIER	Usoje	57,446	50	28.02.2022
18		QPN FIER	Drenove	41,200	50	28.02.2022
19		QPN FIER	Drenove	71,320	50	28.02.2022
20		QPN FIER	Usoje	38,880	90	20.04.2022
21		QPN FIER	Usoje	47,376	90	20.02.2022
22		QPN FIER	Dukas	181,550	90	20.04.2022
23		QPN FIER	Drenove	60,507	90	20.02.2022
24				56,160	90	20.04.2022
25		Qpn Kuçovë	Avaleas	92,025	91	20.04.2022
26		QPN FIER		51,840	90	20.04.2022
27		QPN FIER		79,963	90	20.04.2022
28		QPN FIER		73,940	90	20.04.2022
29		QPN GORISHT	Kocul	79,200	165	28.06.2022
30		QPN FIER	Drenove	127,860	137	09.06.2022
31		QPN FIER	Drenove	83,754	137	09.06.2022
32		Qpn Fier	Dukas	172,342	137	09.06.2022
33		QPN FIER	Dukas	147,309	164	28.06.2022
34		QPN FIER	Dukas	186,900	164	28.06.2022
35		QPN FIER	Rroms	51,000	166	28.06.2022

Shuma totale është 2,912,444 Lekë

Blerjet e vogla për Vitin 2021.

Nr	Objekti i prokurimeve	Fondi limit(pa TVSH)	Vlera e kontratës pa (TVSH)	Operatori ekonomik	Vlera e likuidimit me (TVSH)
1	Ganxha te vinçave me kapacitet 3,5,10,12 ton per Q.M.N. Kuçove	310,000	290,000	N...4	348,000
2	Blerje adblue per autobotet	600,000	225,000	A...O	270,000
3	Blerje Benzine	489,810	459,195	A...I	335,629
4	Distributor karburanti elektronik	600,000	588,750	P...I	706,500
5	Oksigjen,azot,acetilen	796,000	795,000	G...A	439,860
6	Blerje mater.sanitare(detergj,pastrues etj)	793,300	720,000	RR.D	864,000
7	Sfera inoksi per UMN Kucove	252.00	225,000	A...V	270,000
8	Brume Gome antivaj+Gome Batistrad	267,500	247,500	A...V	297,000
9	Rezistenca tubolare	899,934	879,900	A...G	1,055,880
10	Gur abraziv	984,700	943,520	A...O	1,131,024
11	Sherbim per vertetim perputhshmerie te projekteve teknologjike	796.00	795,000	E...T	954,000
12	Sherbim per paisjen me deshmi aftesie te punonjesve per paisjet nen presion.	680,000	650,000	A...T	780,000
13	Sherbim per kontrollin periodik te paisjeve nen presion	590,000	550,000	A...T	660,000
14	Sherbim per kualifikim specialisteve Elektrik	414,600	270,600	N...L	304,920
15	Sherbim data per pajisjet GPS	585,600	292,800	O...A	334,777
16	Sherbim periodik te 3 autoboteve tip reanult QF&T Patos	990,800	978,809	M...S	1,104,179
17	Sherbim per mirembajtje printer, PC, Fotokopje,gjenerator etj	590,815	409,000	T...S	490,800
18	Sherbim Furnizim me uje te pijshem te Administrates	779,000	760,000	L...T	760,604
19	Garanci per suport dhe shtim funksionalitetesh i faqes ëeb: ëëë.albpetrol.al	795,000	790,000	K...X	943,260
20	Garanci per suport per sistemin e monitorimit me kamera dhe DVR	795,967	748,900	S...J	871,680
21	Certifikate eInspektimit te cisternove (transportit te lendeve te rrezikshme)	293,500	264,000	A...H	237,600
22	Sherbim per paisjen me certifikate ADR te autoboteve te Albpetrolit	220,000	132,000	A...H	153,600
	Totali	12,477,574	12,014,974		13,313,313

Blerjet e vogla për Viti 2022

Nr	Objekti i prokurimeve	Fondi limit(pa TVSH)	Vlera e kontratës pa (TVSH)	Operatori ekonomik	Vlera e likuidimit me (TVSH)
1	Gjenerator saldimi (Vb. Amonice)	886,667	870,000	V...U"	1,044,000
2	Blerje Adblue	333,440	213,333	E...L	256,000
3	Blerje Rripa trapezoidal(volanti/kalbri/pompe/tjere)	623,020	575,000	A...V	690,000
4	Blerje Kushineta	827,400	775,000	A...V	930,000
5	Blerje Leter A4/A3	924,735	777,777	L...U	933,332
6	Blerje Materiale sanitare	844,034	600,000	A...O	720,000
7	Blerje Brume gome antivaj+gome batistrad	325,000	317,500	A...V	381,000
8	Sherbim per kualifikim spec.Elektrik	489,176	249,950	S....A....A...A	292,260
9	Furnizim-vendosje moket profesional	298,886	250,000	A...J	300,000
10	Furnizim-vendosje motor utomjeti tip "LAND-ROVERI"	980,000	980,000	E.ZH	1,176,000
11	Sherbim Furnizim me uje te pijshem	795,000	790,000	L...T	0
12	Paisja me vertetim teknik te paisjeve nen presion	483,000	350,000	A....T	0
13	Sherbim mirembajtje kondicionere	267,500	198,500	A.....2018	238,200
14	Sherbim per riparim kaldaje nga 500 Kkal deri 2200 Kkal.	1,000,000	945,800	A.....2018	0
15	Sherbim per mirembajtje tuba presioni te larte per mjetet hidraulike te shoqerise.	991,417	969,000	M...G	515,523
16	Sherbim karta sim	288,000	273,600	O...A	0
17	Mirembajtje per pajisjet fotokopjuese/printuese	962,664	855,000	A...A	0
18	Fon per paisje me pasaport cisternash.	263,183	149,000	E...T	147,600
19	Fond per paisjen me certifikate ADR te autoboteve te Albpetrolit+ lende rrezikshme	300,000	165,000	A...H	92,400
20	Certifikate e Inspektimit te cisternove te transportit te lendeve te rrezikshme	293,500	161,700	A...H	137,280
	Totali	12,176,622	10,466,160		7,853,595

Aneksi 2.7.1

Të dhënat mbi regjistrat e prokurimit periudha 01.01.2022 – 31.12.2022

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Vlerësuar për auditim	Audituar
1	Blerje Bateri	2,206,000	2,150,000	A...V		
2	Blerje Boje printeri dhe fotokopje	4,945,500	3,413,322	M...N		
3	Blerje Dedektore gazi individuale	3,660,000	2,750,000	A...L		
4	Blerje Demulgator (servo)	9,957,386	9,454,000	A...I		
5	Blerje Goma Automjetesh	12,934,500	12,402,000	S...C....Y		
6	Blerje Lllamarine celiku+valezuar	15,038,800	14,697,000	N...4	PO	PO
7	Blerje Oksigjen&acitilen	2,271,900	2,020,410	G...A.		
8	Blerje Paisje mbrojtese individuale per punonjesit dhe veshmbathje	8,917,584	8,590,000	V...4		
9	Blerje Pjese per kaldaja , berner etj	1,545,500	1,519,410	E...K		
10	Blerje Profile hekuri	2,053,040	1,352,100	N...4		
11	Blerje Purteka (16 mm, 22 mm,25mm)	18,267,960	17,319,100	""U...O""	PO	PO
12	Blerje Vula sigurie	5,496,260	4,097,212	L...B		
13	Gazoil 10 ppm	195,570,000	182,692,012	A...I	PO	
14	Lende djegese e lenget per perdorim teknik dhe industrial(per kaldajat)	35,100,000	32,224,230	R...R	PO	
15	Pjese kembimi per automjete	28,340,680	27,500,000	A...V	PO	PO
16	Rinovim dhe shtim postesh program Financa 5	2,500,000	1,952,440	I....R		
17	Rinovim Garancie Doganore te Magazinave Fiskale	11,911,250	11,424,300	S...A		
18	Sherbim interneti	2,700,000	2,339,064	A...M		
19	Sherbim per mirembajtje tuba presioni te larte per mjetet hidraulike te shoqerise	1,000,000	969,000	M...G		
20	Sherbim per riparim inverter te Programuar P=75 KË	2,920,000	1,810,000	A...G		
21	Sherbim per riparim kaldaje nga 500 Kkal deri 2200 Kkal	1,000,000	945,800	A....2018		
22	Sherbim per siguracion, sherbim TPL+kasko	4,945,939	4,826,500	S...A		
23	Sherbim periodik per 3 autobotet	1,134,909	1,075,375	Q...J		
24	Sigurim i jetes se punonjesve ,sig. shendeti nga aksidentet ne pune	21,700,000	20,465,200	S...A	PO	PO
25	Transport i punonjesve te QPN Gorisht	9,939,000	9,861,800	G...E		
26	Tubo pompe kompresori TS	39,658,000	38,271,978	V...S	PO	
27	shuma viti 2021	445,714,208	416,122,253			

Të dhënat mbi regjistrat e prokurimit periudha 01.01.2021 – 31.12.2021

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Vleresuar per auditim
1	Autobote 30-33 m3 per Q.F.&T. Patos	63,000,000	58,780,000	A...H	PO
2	Autobot transport naftë 10 m3 (me pompe) per Q.F.&T. Patos	6,000,000	5,790,000	G.....K....M	
3	Automjet zjarrfikse per Q.E.M.N.G. Patos	12,000,000	11,290,000	"L....07"	PO
4	Blerje aksesor elektrike+materiale ndihmese	10,215,900	9,789,000	V...4	
5	Blerje bateri	2,257,000	2,226,000	K...IL	
6	Blerje Demulgator (servo)	10,822,429	10,765,580	A...I	
7	Blerje Gazoil 10 ppm	126,593,000	25	A...I	PO
8	Blerje inverter te programuar(Tiristor)etj.	7,046,320	5,950,000	A...G	
9	Blerje kancelari te ndryshme	1,000,000	937,000	I.....E	
10	Blerje lende djegese e lenget per perdorim teknik dhe industrial(per kaldajat)	20,000,000	15	R...R	PO
11	Blerje paisje mbrojtese individuale per punonjesit dhe veshmbathje	16,000,000	15,012,990	V...4	
12	Blerje pjese kembimi per automjetet	9,000,000	8,875,000	A...V	
13	Blerje shkume sintetike	2,100,000	1,739,100	i - F...E	
14	Blerje, kolaudim dhe rimbushje Paisje per MNZ dhe sig teknik	4,000,000	3,399,100	i - F...E	
15	Boje printeri dhe fotokopje	4,800,000	3,270,000	I.....E	
16	Cakull dhe stabilizant	5,480,000	5,040,000	G....N	
17	Çift rrotor stator per PCP per Q.P.N. Gorisht+ Polishrot per pusët me PCP per Q.P.N. Gorisht	12,650,000	11,987,530	S....B	
18	Gure Abrziv	1,000,000	942,520	A...O	
19	Kalimates naftë (floë-M...Er), 4 (kater) cope	38,400,000	37,178,181	V....S	PO
20	Kamion Vacuum truck 10 m3	10,000,000	9,695,000	Q.S....J	
21	Kamion vetshkarkues me 4 akse 20 m3	10,000,000	8,720,000	"SH....7"	
22	Lende e I-re dhe materiale ndihmese per fonderine QMN Kucove	5,193,000	5,050,000	A...V	
23	Litar çeliku	7,653,620	2,825,000	A...V	
24	Llamarine celiku dhe e valezuar	10,000,000	9,484,000	N...4	
25	Lubrifikante(Vajra+graso)	13,000,000	9,425,600	K...IL	
26	Materiale laboratorike	1,157,760	1,130,030	K....N	
27	Ndertim i bazamentit te peshores dhe sistemim i sheshit perreth tij ne stacionin Visoke	1,200,000	1,067,430	SH.....I	
28	Permiresimi i infrastruktures se Stacionit te Shitjes se Naftes Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	60,000,000	59,955,454	Z...I	PO
29	Profile hekuri dhe çeliku	2,034,760	1,990,040	N...4	
30	Prokate çeliku	7,644,933	6,855,200	S....B	
31	Pajisje kompjuterike per qendrat dhe administraten	3,500,000	3,476,825	P....E	

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Vleresuar per auditim
32	Rikonstruksion i zyrave te Administrates dhe ambjenteve te tjera ne teritorin e ndermarjes ne Q.M.N. Kuçove	8,100,000	5,180,932	F...D	
33	Riparim pjesore+ pastrim RVM 5000/8 dhe pastrim i mbeturinave mekanike te dy RVM 700 m3 /3/4 ne stacionin Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	18,400,000	17,383,255	A....6	PO
34	Sherbim interneti	2,500,000	1,800,000	A....M	
35	Sherbim per kolaudim aparatesh matese QFSHE	1,585,421	1,454,550	HTT -sts	
36	Sherbim per punime me autosonde	21,450,000	14,900,000	S.....B	PO
37	Sherbim per rinovim Garancie Doganore te Magazinave Fiskale	18,580,275	16,439,402	S...L U.....TRIA	PO
38	Sherbim per ruajtjen e prones	61,234,734			PO
39	Sherbim per siguracion te mjeteve , taksa sherbim TPL	5,000,000	4,504,383	S...L U.....TRIA	
40	Sherbim per transport nafte bruto	47,234,000	46,771,938	E....9	PO
41	Sherbime periodike te 3 autoboteve tip renault QF&T Patos	1,000,000	978,809	M.....S	
42	Sigurim I jetes se punonjesve ,sig. shendetit nga aksidentet ne pune	24,000,000	21,700,000	S...L U.....TRIA	PO
43	Tubo naftesjellesi	17,928,680	15,602,808	A....O	PO
44	Tubo pompe kompresori 3 1/2 TS, 2 7/8 TS	24,900,000	22,125,000	S.....B	PO
45	Zevendesim i mbulesave ekzistuese"Eternit" i çatave te repartit Mekanik dhe repartit Elektrik ne Q.M.N. Kuçove	10,000,000	9,187,380	A....T	
	Shuma viti 2021	745,661,832	490,675,077		

